

KUD: 05:3(=18)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

STUDIME SHOQËRORE

11



KUD: 05:3(=18)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

STUDIME SHOQËRORE

11

KUD: 05:3(=18)

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SECTION OF SOCIAL SCIENCES

SOCIAL STUDIES

11

Editorial board

Muhamedin Kullashi, editor-in-chief
Frashër Demaj, secretary
Oliver Schmitt, member
Justina Shiroka-Pula, member
Gjyljeta Mushkolaj, member



PRISHTINA
2024

KUD: 05:3(=18)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

STUDIME SHOQËRORE

11

Këshilli redaktues

Muhamedin Kullashi, kryeredaktor
Frashër Demaj, sekretar
Oliver Schmitt, anëtar
Justina Shiroka-Pula, anëtare
Gjyljeta Mushkolaj, anëtare



PRISHTINË
2024

Copyright © ASHAK

Adresa / Address:

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës
Redaksia e revistës “*Studime shoqërore*”
Rr. Agim Ramadani, nr. 305
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel. + 383 38 249 303
E-mail: ashak@ashak.org

PËRMBAJTJA

ARTIKUJ KUSHTUAR PROFESOR FEHMI AGANIT ME RASTIN E 25-VJETORIT TË VRASJES.....	9
Hivzi Islami AKADEMIK FEHMI AGANI – FIGURË SHUMËPLANËSHE E SHEKULLIT XX	11
Muhamedin Kullashi LIBRIN QË IA KUSHTUAM FEHMI AGANIT NË PARIS	15
Anton Kolë Berishaj FEHMI AGANI - KONTEKSTI SHKENCOR SOCIOLOGJIK I AKTIVITETIT POLITIK	21
Skënder Demaliaj, Albana Demaliaj, Neralba Demaliaj KËNDVËSHTRIME TË REJA TË FEHMI AGANIT PËR VETËVENDOSJEN E SHQIPTARËVE TË KOSOVËS. RASTI I KONFERENCËS SË BUJANIT	41
Blerina Rogova Gaxha LETËRSIA SI DËSHMI: FUQIA E LETËRSISË PËR TA MBAJTUR GJALLË MEMORIEN E LUFTËS	61
Hivzi Islami KONCEPTIMI I BALLKANIT, KOSOVA DHE HILET E EUROPËS “PLAKË”	75
Muhamedin Kullashi LINDJA E BIOPOLITIKËS SIPAS MICHEL FOUCAULT	119

Elita Çeku & Justina Shiroka-Pula STRATEGIC DECISION-MAKING IN SMALL AND MEDIUM ENTERPRISE	133
Mirlinda Jashanica Gashi, Eneida Hoxha, Ira Gjika PËRDORIMI I INTEGRUAR I INSTRUMENTEVE MENAXHERIALE DHE DIGJITALE NË MENAXHIMIN EFEKTIV TË BIZNESEVE.....	157
Ajkuna Mujo, Dhimitri Tole THE IMPACT OF ARTIFICIAL INTELLIGENCE ON STARTUPS	175
Eros Angjeli, Eriola Hoxha, Adrian Civici EKONOMIA DHE FINANCAT E BIZNESIT, MIKROKREDIA	185
Arsim Bajrami SFIDAT DHE KONTRAVERSAT E DIALOGUT KOSOVË- SERBI.....	197
Marenglen Verli ÇËSHTJA E KOSOVËS NË PARLAMENTIN SHQIPTAR 1920- 1924.....	235
Beatrice Garapon TRAVAILLER SUR UN PARTI POLITIQUE EN L'ABSENCE DE SOURCES INSTITUTIONNELLES	259
Gëzim Selaci JU, POPULLI I KOSOVËS: DISA KONSIDERATA PËR LEGJITIMITETIN E KUSHTETUTËBËRJES NDËRKOMBËTARE2	283
Abdulla Rexhepi PERËNDIMI DHE MODERNITETI NË KËNDVËSHTRIMIN E MENDIMTARËVE BASHKËKOHORË IRANIANË: AHMED FERDID DHE DARIUSH SHAYEGAN.....	303

Petar Bojanic

LE PROJET DE LA DERNIÈRE GUERRE POUR LA PAIX
LES SOUPIRS PHILOSOPHIQUES..... 321

Ibrahim Gashi

ZHVILLIMET NË KOSOVË PAS DEMONSTRATAVE TË
VITIT 1968 SIPAS BURIMEVE DIPLOMATIKE SHQIPTARE..... 339

RECENSIONE

Muhamedin Kullashi

NË Ç'MËNYRË FOCALT E KA LEXUAR NIETZCHEN..... 355

Frashër Demaj

HIVZI ISLAMI DHE ARSIM EJUPI “GJEOPOLITIKA,
TERRITORI, KONFLIKTI: POLITIKAT HEGJEMONISTE,
KOLONIALISTE DHE KOLONIZUESE SERBE NDAJ
KOSOVËS DHE SHQIPTARËVE” ASHAK, 2024, FQ. 570 359

Hivzi Islami

STUDIM ME RËNDËSI SHKENCORE DHE PRAKTIKE..... 363

Hivzi Islami

AKADEMIK MUHAMEDIN KULLASHI, NJË PERSONALITET
I SHQUAR NË FUSHËN E SHKENCËS DHE TË
DIPLOMACISË KOSOVARE 369

ARTIKUJ KUSHTUAR
PROFESOR FEHMI AGANIT

Me rastin e 25-vjetorit të vrasjes



Hivzi Islami

AKADEMIK FEHMI AGANI – FIGURË SHUMËPLANËSHE E SHEKULLIT XX

1. Akademik Fehmi Agani bënte pjesë në lagjen e personaliteteve më të shquara të shkencës, të kulturës dhe të proceseve politike të shoqërisë kosovare dhe të asaj shqiptare në përgjithësi në pjesën e dytë të shekullit XX. Me formësim ishte në radhë të parë sociolog, por duke pasur njohuri të thella edhe nga politikologjia dhe filozofia konsiderohej ndër njohësit më brilantë të problemeve më neuralgjike të politikës dhe të shoqërisë. Pa profesor Fehmiun mendimi politik shqiptar pa dyshim do të ishte i varfër dhe historia e Kosovës deri në çlirimin e saj më 1999 nuk mund të shkruhej pa veprimtarinë e prof. Aganit.

2. Studimet e tij për teoritë shoqërore dhe politike, për kombin, vetëvendosjen dhe demokracinë, për ndërtimin e shoqërisë civile, për raportet normale njerëzore me fqinjët, për marrëdhëniet ndëretnike dhe ato ndërkombëtare, për emancipimin kulturor dhe vlerat universale njerëzore, mbesin të kapërcyeshme në mendimin shkencor dhe në praktikën politike dhe shoqërore. Dha një kontribut të madh në bashkëpunimin e instancave shkencore dhe kulturore të Kosovës me institucionet e Republikës së Shqipërisë. Vështrimet e tij me vizion të qartë teorik, ishin në funksion të mbrojtjes së kërkesave themelore të shqiptarëve dhe të drejtave të tyre legjitime, duke e vështruar çështjen e Kosovës dhe mëvetësinë e saj si përbërës të çështjes së përgjithshme shqiptare.

3. Në procesin e emancipimit social dhe kulturor të shqiptarëve akademik Agani luajti një rol të madh në krijimin, ngritjen dhe pavarësimin e institucioneve shkencore, kulturore dhe kombëtare të Kosovës dhe shqiptarëve, që nga Instituti Albanologjik i Prishtinës në rithemelim më 1967, si drejtor i parë i tij, e deri te themelimi i Universitetit të Prishtinës dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Nëpërduart e prof. Fehmiut kaluan breza të tërë studentësh dhe nën drejtimin e tij u formuan shumë kadro shkencore nga disiplinat e ndryshme të shkencave shoqërore. Kishte përkthyer edhe shumë vepra të autorëve të huaj nga fusha e sociologjisë dhe filozofisë për nevoja të studentëve dhe opinionin e gjerë. Pas vitit 1981, në valën e diferencimeve ideo-

politike, prof. Aganin pushteti politik komunist e përjashtoi nga procesi mësimor, por ai nuk hoqi dorë nga qëndrimet e veta, nuk mori distancë ndaj kërkesave të studentëve dhe vazhdoi veprimtarinë emancipuese shoqërore. Me gjithë angazhimet e shumta në lëvizjen politike shqiptare vitet e fundit prof. Agani gjente kohë të punonte edhe në shumë projekte shkencore në Fakultetin Filozofik, në Institutin e Sociologjisë dhe të Filozofisë dhe në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ku printe me idetë e tij gjithnjë inventive.

4. Në vitet 90, tok me Rugovën dhe intelektualët e tjerë, u vu në krye të lëvizjes politike të shqiptarëve të Kosovës. Ishte pjesëmarrës aktiv në jetën shkencore, politike e kombëtare dhe prijës i shumë proceseve progresive me rëndësi historike për Kosovën e më gjerë. Së bashku me akademik Gazmend Zajmin, që nga viti i Madh 1968, siç e quante ai, ishte ideolog i projektit për pavarësinë e Kosovës, për të cilin punoi me tërë qenien deri në minutën e fundit të jetës, por nuk arriti ta gëzonte jetësimin e saj, Ditën e Pavarësisë së Kosovës, 17 -Shkurtin e Madh. Më 6 maj 1999, në rrjedhën e deportimit masiv, në rrugën e frikësimit, të tmerrit e të gjenocidit, e vrau pushteti serbohegjemontist i Milosheviqit. Pas një muaj e gjysmë qëndrimi në Prishtinë, duke i ndërruar disa vendqëndrime, kur më nuk kishte mundësi të fshihej e aq më pak të vepronte, vendosi të dalë me “trenin e zi” për Maqedoni, i bindur se nga jashtë do të mund të kontribuonte më shumë. Por autoritetet serbomaqedonase, me mbylljen e kufirit, e kthyen trenin mbrapsht. U nxor nga treni së bashku me të gjithë udhëtarët nga forcat serbe diku midis Lipjanit dhe Fushë Kosovës. Pasi i dërguan në një fushëgropë, urdhëruan që të ulen të gjithë dhe filluan ndarjen e të rinjve për pushkatim. Sipas dëshmitarëve me emër e mbiemër, prof. Fehmiu ngrihet në këmbë, i bindur se me identifikimin e tij forcat serbe do të merren me të dhe në këtë mënyrë do të shpëtojnë të rinjtë nga ekzekutimi. Policët që e njohën, bërtitën, ja ku qenka ky që na solli NATO-n. U privua nga liria dhe menjëherë, pas urdhrat të marrë nga Beogradi, u ekzekutua. E dha jetën për të tjerët, për rininë kosovare dhe popullin shqiptar dhe idealet e tij.

5. Në vitet 90, me Rugovën në krye, prof. Fehmiu ishte figura e dytë e lëvizjes politike shqiptare, e cila në rrethanat e represionit e të terrorit hegjemontist serb kundër shqiptarëve luftonte për vetëvendosjen e shqiptarëve, çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës dhe zhvillimin e saj demokratik. Të gjithë përfaqësuesit e partive politike shqiptare të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Luginës së Preshevës i kërkonin konsultimet dhe këshillat e prof. Fehmiut; edhe vetë Rugova i drejtonte tek ai.

Nuk kishte dokument, deklaratë, program apo platformë politike ku ai nuk ishte kryehartues; i dha kahet dhe orientimet ideore partisë më të madhe në Kosovë, që vepronte si një lëvizje, duke drejtuar tërë logjistikën e saj të brendshme dhe duke prezantuar atë para botës demokratike në mënyrën më të denjë. Me formimin teorik dhe përvojën jetësore e politike që kishte, ishte negociatori më i fortë shqiptar, që nga Konferenca e Hagës deri tek ajo e Parisit. Armiku e vrau, por në tavolinën e bisedimeve nuk mund të mos e respektonte mendimin dhe vizionin e tij. Ishte politikani më i respektuar shqiptar te diplomatët e huaj, duke mos lejuar në asnjë çast të cenoheshin qëllimet bazë të lëvizjes politike shqiptare dhe objektivat e çështjes kombëtare.

6. Në planin njerëzor prof. Fehmiu ishte i qetë, modest, i matur, gjakftohtë, tolerant, i qartë, shembëllesë e mirësisë, personalitet me karakter të fortë dhe cilësi të larta morale, i thellë në mendime, racional në gjykime dhe i përgjegjshëm në paraqitje publike dhe i vëmendshëm në veprime. Kishte guxim të madh qytetar dhe intelektual ta thoshte atë që e mendonte. Me thellësinë e tij intelektuale, ishte polemist i mprehtë dhe konfrontues parimor me bartësit e pikëpamjeve të kundërta, ku në radhë të parë me argumente shkencore demaskonte tezat e hegjemonisë serbomadhe dhe posesivizmin serb ndaj Kosovës. Me mençurinë, kurajon intelektuale e njerëzore dhe sensin e posaçëm politik që kishte, si përfaqësues i Kosovës në Komisionin e shkencave shoqërore të Këshillit për ndarjen e shpërblimit të AVNOJ-it (KAÇKJ) në vitet 70, si çmimi më i lartë në ish-Jugosllavi, prof. Agani arriti ta refuzonte propozimin që Vasa Çubrilloviqit, hartues i dy elaborateve për dëbimin dhe zhdukjen fizike të shqiptarëve, t'i jepej ky çmim.

7. Akademik Fehmi Agani kudo që gjendej vepronte pushtonte me butësinë, optimizmin dhe fjalën e tij të ngrohtë. Ishte i afërt me të gjithë, i dashur nga të gjithë dhe i sinqertë ndaj të gjithëve; kishte sens të veçantë për humor të hollë. Gjithkund dhe gjithëherë përpiquej t'i gjente argumentet vetëm për t'i afruar dhe bashkuar njerëzit dhe strukturat e subjektet politike dhe jopolitike, duke i mënjeluar elementet e ndasive edhe atje ku ato njëmend ekzistonin. Në deklaratën e fundit që i kishte lënë me shkrim gazetës “Koha Ditore” para 24 marsit 1999, por që nuk u botua për shkak të ndalimit të gazetës, në pyetjen e redaksisë se kush ishte fajtor për mosunitetin e faktorit politik shqiptar, akademik Agani kishte theksuar: “Shqetësuese janë dhe gjithsesi të dëmshme, të rrezikshme, diferencat dhe diferencimet e tjera në lëvizjen politike shqiptare në formë rivalitetesh të shfrenuara dhe të ekskluzivizmit të

partive dhe grupimeve politike, të rivaliteteve deri në atë masë sa gati të harrohet qëllimi” (5.6.1999).

8. Ishte bartës i bashkërenditjes së veprimeve politike e shoqërore, të nevojshme më parë se kurrë në ato kthesa historike për Kosovën dhe shqiptarët. Dhe vendimi i tij që pas kaq ditësh vuajtjesh në Prishtinë, me shëndet të rrënuar (tensioni, zemra, diabeti, lodhja e përgjithshme), të dalë në Maqedoni, ishte pikërisht pengimi i ndasive dhe i konflikteve brendashqiptare, që vazhdonin edhe jashtë Kosovës. Ky fakt do të ishte arsyeja e dytë, mbase vendimtare pse regjimi nazifashist i Beogradit e likuidoi.

9. Vepra e tij shkencore u botua në 8 vëllime nga Shtëpia Botuese “Dukagjini”. Veprën e përgatiti akademik Rexhep Ismajli. Vepra sigurisht nuk është e plotë. Mbetet të gjurmohen shkrimet, trajtesat dhe reflektimet kritike të tij për çështje të ndryshme të rrjedhave shoqërore dhe politike në shtypin dhe periodikun e kohës në Kosovë dhe jashtë saj edhe në bibliotekën e tij personale. Është një fat që pjesën dërmuese të veprës së tij e kemi në bibliotekë.

10. Veprimtaria dhe vepra e tij, do ta bëjnë të pavdekshëm akademik Fehmi Aganin, krenar dhe nderin e vërtetë të kombit shqiptar dhe të kulturës së tij. Jetoj dhe punoi për Kosovën e lirë dhe sovranë dhe vdiq për të. Trashëgimia e ndritur që la pas do të mbetet shembull dhe frymëzim për brezat që vijnë dhe themel i pakapërcyeshëm për mbarë shoqërinë shqiptare. Si personalitet kompleks, që dha kontribut të madh në zhvillimin shkencor, kulturor-arsimor, politik e kombëtar të shqiptarëve, e meritoi ngritjen e shtatores para Fakultetit ku punoi shumë dekada, sikundër që e meritoi emrin e Universitetit të vendit të lindjes (Gjakovës) para 92 vjetëve!

Lavdi e përjetshme!

KUD: 321.01
323(496.51)

Muhamedin Kullashi

LIBRIN QË IA KUSHTUAM
FEHMI AGANIT NË PARIS

"Kosovo. Etablir les faits", Editions Esprit, Paris, 2001

Ky libër u përgatit nga anëtarët e Komitetit të Kosovës (Paul Ricoeur, Claude Lefort, Edgar Morin, Olivier Mongin, Pierre Hassner, Antoine Garapon, M.Kullashi etj.) në Paris, në mbarim të vitit 1999. Ai përmban dokumente dhe analiza për krimet masive që Serbia i bëri që nga viti 1981 deri në vitin 1999 ndaj shqiptarëve të Kosovës. Mbledhjen e dokumenteve dhe redaktimin e librit e bëri Jowl Hubrecht. Ky libër përmban përgjigje ndaj një fushate të gjerë (në medie, në protesta etj.) në Francë e orkestruar nga qarqet proserbe dhe majtistët « antiimperialistë » kundër intervenimit të NATO-s ndaj Serbisë dhe caqeve të saj ushtarake. Kundërvënien ndaj intervenimit të NATO-s, në vitin 1999, këto qarqe e mbështetnin në dy « arsyetime-argumente » kryesore: ata e cilësonin intervenimin e NATO-s si intervenim i « fuqive imperialiste » për ta realizuar « sundimin e tyre imperialist » në Ballkan e kundër « Serbisë si shtet sovran ». « Argumenti » i dytë shpalosej me mohimin e plotë të krimeve të shtetit serb ndaj shqiptarëve të Kosovës: ato qarqe i cilësonin pohimet për krimet masive serbe si « gënjeshtër e shpifje » (negacionizëm ky si ai që mohonte dikur krimet ndaj hebrenjve), kurse intervenimin e NATO-s, i udhëhequr nga SHBA-ja, e cilësuan si « agresion ». Ndërkaq, ky operacion, në të vërtetë, ndërpreu masakrat e shqiptarëve nga serbët e njëherësh e bëri të mundur kthimin e afro 1 milion shqiptarëve në vendin e tyre, në Kosovë. Kësisoj kundërshtimi i intervenimit të NATO-s ishte mbështetje e vazhdimit të krimeve masive kundër shqiptarëve.

Ky libër ofron dokumente dhe analiza të shumta të autorëve të shquar francezë që dëshmojnë për thellësinë dhe shumanshmërinë e terrorit ndaj shqiptarëve të Kosovës gjatë shumë vjetëve. Libri njëherësh vë në pah lëshimet dhe hezitimet e vendeve karshi politikave agresive të regjimit serb kundrejt Sllovenisë, Kroacisë dhe Bosnjës, të cilat do të kenë ndikim në vendimin për ndërhyrje në vitin 1999.

Titulli i parathënies së librit kërkon: « Të respektohen deshmitarët, të nderohen viktimat ». Autorët e parathënies së këtij libri, Antoine Garapon, Pierre Hassner dhe Olivier Mongin, theksojnë se ky libër i kushtohet profesor Fehmi Aganit: « Na duket se kësisoj ky është homazhi më i bukur që mund t'ia bëjmë këtij njeriu të madh të Kosovës duke publikuar këto të dhëna dhe duke ndriçuar këtë ngjarje që ka shënuar fundshekullin evropian, epilogu i të cilit ende nuk dihet. » Autorët përkujtojnë arrestimin dhe vrasjen mizore të Fehmi Aganit në maj të vitit 1999, si dhe vendimin e Komitetit të Kosovës që të themelohet shoqata « Fehmi Agani » në Paris.

Do të shtoja se rrethanat e vrasjes së akademik Fehmi Aganit, njëri nga themeluesit e Universitetit të Prishtinës dhe Institutit të Albanologjisë, tregojnë se maja politike dhe ushtarake e Serbisë e ka parë si shumë të rrezikshëm rolin e tij në skenën politike të Kosovës.

Kultura e tij politike, intelijenca e hollë dhe aftësitë e tij në analizën e problemeve të rënda e komplekse të Kosovës dhe në prezantimin e tyre para përfaqesuesve të lartë ndërkombëtarë kanë lënë gjurmë të pashlyeshme. Intelktualë të shquar francezë dhe diplomatë të rangut të lartë, jo vetëm francezë, gjatë qëndrimit tim 30-vjeçar në Paris, më kanë shprehur respektin e madh që kishin për personalitetin e tij politik dhe në veçanti për luciditetin e analizave të tij për Kosovën dhe Serbinë.

Libri do të zbërthejë ngjarjet kyçe, të cilat bënë që Kosova gradualisht të shndërrohet jo vetëm në hapësirë të shumëfishimit të trajtave të ndryshme të dhunës dhe diskriminimit, por edhe në fushë ku fillon procesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, i përcjellë me rivalitetet dhe tensionet më të theksuara midis njësive federale. Këto tensione e antagonizma do të shpijnë në katër lufta të njëpasnjëshme: tek agresionet ushtarake të Serbisë kundër Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjës dhe ndaj Kosovës.

Në të vërtetë, në hapësirën publike të Francës nuk do të jenë aq të pranishme, në fillim të viteve '90, analizat e debatet lidhur me ngjarjet dramatike që janë zhvilluar në Kosovë në fillim të viteve '80. Me zgjerimin dhe thellimin e kërkimeve shkencore dhe debateve publike për luftërat në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë, do të fillojnë të paraqiten analiza edhe për ngjarjet në Kosovë. Gradualisht, do të dalin në shesh format dhe përmasat e spastrimit etnik të institucioneve të Kosovës gjatë një decenie. Lidhshmëria midis spastrimit etnik të institucioneve dhe spastrimit etnik të territorit të Kosovës nga mbarimi i viteve '90 do të fillojë të diktohet me thellimin e shqyrtimeve për Kosovën sa në mjediset intelektuale e shkencore, aq edhe në ato të sferave politike.

Brenda këtyre debateve publike në Francë do të jenë të pranishme ndikimet e interpretimeve politike e historiografike të cilësuar me qasje të

theksuar proserbe: kjo vlen sa për kërkimet dhe botimet shkencore për Kosovën, po aq edhe për ato politike, në nivele të ndryshme. Midis këtyre interpretimeve do të shquhen, veç të tjerave, pikëpamje e paradigma mbi Kosovën si « djep i serbizimit », të shoqëruara me një varg paragjykimesh ndaj shqiptarëve, ndaj historisë dhe kulturës së tyre. Krahas këtyre interpretimeve dhe në ballafaqim me të parat do të zhvillohen pikëpamje, kërkime e qëndrime të tjera lidhur me Kosovën.

Kaptina të veçanta të këtij libri trajtojnë debatet dhe *polarizimet* politike e intelektuale, në nivele të ndryshme të hapësirës publike të Francës, për aspekte të caktuara të historisë politike bashkëkohore të Kosovës, në veçanti, ato që cilësohen si ngjarje më dramatike. Debatet për apo kundër pjesëmarrjes së Francës në intervenimin e NATO-s kundër çaqeve ushtarake të Serbisë do të dominojnë nga mbarimi i viteve '90.

Për ideologët e lëvizjes populliste-nacionaliste serbe, njëri nga aspektet më të rënda të « tradhtisë së interesave kombëtare serbe » qëndronte « te fakti se sistemi ua bëri të mundur shqiptarëve si popull joslav të marrin pjesë në sovranitetin e vendit ». Sipas tyre, kjo « tradhti » ua hapi udhën shqiptarëve që të paraqiten në skenën politike, me gjuhën dhe simbolet e tyre, « të infiltrohen » në të gjitha institucionet politike, sociale e kulturore të Jugosllavisë. Kësisoj, realizimi i pjesshëm i parimit kushtetues të barazisë së popujve, afirmimi i gjuhës dhe kulturës së tyre, u stigmatizuan nga intelektualët nacionalistë serbë si një « plan perfid që kishte për qëllim ta rrudhë qenien nacionale serbe ». Tani, programi nacional serb, në variantet e tij të ndryshme, do ta theksojë domosdonë e heqjes së diversiteteve kulturore, heqjen e tjetrit si kusht i « ripërtritjes së identitetit nacional serb ». Ideologët e kësaj lëvizjeje shtonin së këto qëllime antiserbe u arritën sidomos me koalicionin e partive komuniste të Kroacisë dhe të Sllovenisë dhe mbështetjen e strukturave politike të Kosovës, të mbisunduara nga shqiptarët.¹

Më tutje kam vënë në pah disa nga format e rënda të *realizimit të programit nacional serb*, përkatësisht, masat represive që shteti serb i kishte realizuar në Kosovë: suprimimin e institucioneve të Kosovës, duke filluar nga Kuvendi, spastrimin etnik të institucioneve me dëbimin e shqiptarëve prej tyre, me ç'rast nga institucionet e arsimit u larguan më se 400.000 nxënës, studentë dhe profesorë, por edhe mijëra të tjerë nga institucionet e shëndetësisë, ekonomisë, administratës shtetërore, kulturës, medieve etj.² Ndërkaq për ta vënë në pah thellësinë dhe gjerësinë e represionit policor,

¹ Po aty

² *La République, L'Europe et l'Universel*, po aty, f.100.

citova Raportin zyrtar të shefit të policisë së Kosovës, Rrahman Morina, i paraqitur në Kuvendin e Kosovës, në maj të vitit 1988. Sipas këtij raporti në periudhën midis viteve 1981 dhe 1988, « u trajtuan nga policia 580.000 (nga më pak se 2 milionë banorë) shqiptarë, prej të cilëve 22.000 u dënuan prej 5 deri në 20 vjet burg, për aktivitetet politike të padhunshme (shkrimi i pamfleteve, ose parullave « Kosova Republikë », për pjesëmarrje në greva dhe demonstrata). Theksova se këto të dhëna i publikuan edhe organizata të mëdha ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (*Federata Ndërkombëtare e Helsinkit, FIDH* në Paris, *Amnesty International*). Në raportet e analizave të tyre, ata cekën se të dënuarit u dënuan për « deliktin e opinionit ».³

Më tutje theksohet se në dy vitet e fundit (1989-1991) Serbia ndërmoi në Kosovë, sipas zhargonit të zyrtarëve të saj, një varg të « intervenimeve kirurgjike ». Megjithatë, vlen të ceket se suprimimi i Kuvendit të Kosovës ishte, në fakt, në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së RSF të Jugosllavisë dhe se ai suprimim shënon rrënimin e sistemit kushtetues të Federatës. Kjo vlen edhe për masat diskriminuese. Fjala vjen, diskriminimet në paga sipas përkatësive etnike për ata pak shqiptarë që kishin mbetur në punë, janë vetëm disa nga trajtat e kësaj politike të *aparteidit* në Kosovë të vendosura nga Serbia.⁴

Në gjysmën e dytë të viteve '80, më saktësisht më 1987, në skenën politike të Serbisë erdhi Slobodan Milosheviçi. Ardhjen e tij në pushtet e ndihmuan strukturat partiake e shtetërore të Serbisë, të cilat do të sajojnë një *projekt të ri politik* mbi raportet me njësitë federative dhe popujt e tjerë në Jugosllavi. Brenda këtij projekti prijësi i ri, Milosheviçi, kishte për rol që t'i ndihmojë masat serbe, në saje të një identifikimi afektiv me prijësin si shpëtimtar, të kapërcejnë frikën dhe pasigurinë e tyre; kështu paraqitja e tij sikur u përgjigjej pritjeve të masave brenda krizës politike e ekonomike në Jugosllavi. Ç'është e vërteta portretin e tij e patën vijëzuar, disa vjet para ardhjes së tij në skenën politike, intelektualë të shquar e me ndikim, në tekstet dhe fjalimet e tyre, si një « personalitet i fuqishëm dhe i vendosur » për t'i riparuar « padrejtësitë dhe përbuzjet e popullit ».

* Autorët e librit *Në pasqyrën e luftës* theksojnë në kontekst të këtyre debateve e analizave se ishte i pranishëm, tek ato rryma intelektuale e politike « aksioni i derealizimit të ngjarjes » kur flisnin për ngjarjet në Kosovë. Në veçanti janë shquar mediet që kundërshtonin me prizma ideologjike intervenimin e NATO-s: si *l'Humanité*, i Partisë Komuniste Franceze dhe intelektualëve të saj, *Marianne* me një qasje kuazi qytetare dhe

³ Po aty, f.101.

⁴ Po aty, f.102.

Le Monde diplomatique, mujorja me ndikim e qarqeve majtiste « antiimperialiste ». Brossat e Potel vunë në pah në analizat e këtyre gazetave synimin për « t'i diskredituar rrëfimet për krimet në Kosovë » si shprehje e propagandës të « arkeonacionalistëve të tërbuar ».⁵

Këta prosede autorët i ndriçojnë si « ndërmarrje e banalizimit të krimit kundër njerëzimit. ». Në këtë ndërmarrje merrnin pjesë intelektualët, gazetarët, por edhe pushtetarët si ministri i Punëve të Jashtme të Francës, Jean-Pierre Chevenement (Zhan-Pier-Shëvenëman). Kjo ndërmarrje synonte t'i japë krah « anomisë së gjyqimit sa i takon natyrës së ngjarjes që ndodhte si dhe *lloji* i krimeve që bëheshin në Kosovë ». Ata diktonin aty « themelin e fundit të një dëshire violente që të mos shohin e të mos dinë një aspiratë të theksuar për ta lënë anash gjykimin përballë kësaj shtate, për t'u shkëputur prej saj ». Duke praktikuar edhe amalgamin midis agresorëve dhe të agresuarëve, e kjo ishte shprehje e një « shembjeje të gjyqimit historik ».⁶

Prijësi ndërkaq i kuptoi mirë këto pritje që u sajuan me punën e elitave dhe të lëvizjes populliste « të ndodhurit e popullit » (« dogadjanje naroda ») dhe qysh në fillim u premtoi: « Serbia ose do të jetë e fortë dhe e bashkuar ose nuk do të jetë fare ». Gati në të njëjtën kohë prijësi spiritual i lëvizjes nacionaliste serbe, shkrimtari dhe akademiku i shquar Dobrica Qosiç theksonte publikisht: « Populli serb e ka humbur gjithmonë në paqe atë që e ka fituar në luftë ». Kërkesa për domosdoshmërinë e një lufte të re për t'i riparuar humbjet dhe tradhtinë, për ta krijuar një shtet serb etnikisht « të pastër » brenda kufijve që i përgjigjen « drejtësisë historike », që nënkupton të jenë sa më të gjerë, u formësua brenda mitingjeve populliste që iu kushtuan çështjes së Kosovës. Në ato mitingje e hapësira u zhvillua trajnimi i « popullit » për një luftë që do të shpërthejë më vonë në Kroaci, por me tema të ngjashme. Parullat kryesore të këtyre mitingjeve- « na jepni armë » dhe « vdekje shqiptarëve » paraqiteshin rregullisht në mediet e Serbisë si një « mllef i arsyeshem i një populli të fyer e të përbuzur ».

Një tipar karakteristik i veprimeve politike të shtetit serb në fillim të viteve '80 mund të rezymohet me formulën « të ndiqet armiku kudo ». Prosia kryesore e propagandës dhe instrumentit të saj më të fuqishëm – medie- mund të shprehet kështu: mbrapa të gjitha formave të aktiviteteve të shqiptarëve – në fushat e arsimit, kulturës, shkencës, ekonomisë, sportit, etj., në të kaluarën dhe në të tashmen sikurse fshihet doemos një armiqësi kundrejt interesave të Jugosllavisë dhe Serbisë. Prosedetë që i përdorte kjo propagandë, ishin të huazuara nga repertori klasik: falsifikimi i fakteve,

⁵ Po aty, f.113.

⁶ Po aty, f.113-114.

përsëritja e përhershme e të pavërtetave, ndërtimi i një gënjeshtre të madhe me akumulimin e « të vërtetave të vogla » dhe të « gjysmë të vërtetave ».

Ndryshe nga ajo situatë, ata cekin se në rastin e *Bosnjës dhe Kosovës u ndërtua një koalicion* i shoqatave të shoqërisë civile në Francë me kërkesa politike ndaj qeverisë; më e rëndësishmja prej tyre ishte ajo për intervenimin ushtarak të NATO-s kundër trupave serbe. Gjatë rrjedhës së intervenimit ato shoqata madje kërkuan që intervenimi të mos jetë vetëm nga ajri, por që në terren të dërgohen edhe trupa tokësore.

Autorët saktësojnë se në rastin e Kosovës ishim dëshmitarë të një *kontrate* që « njerëzimi i qytetëruar » përkatësisht opinionin bëri me fuqitë që pohojnë se po veprojnë në emër të së drejtës. Kjo nënkupton se qytetarët francezë të angazhuar për mbrojtjen e Kosovës nga regjimi kriminal, me këtë marrëveshje politike nuk e humbin pavarësinë e qëndrimit të tyre karshi strukturave shtetërore, e ruajnë, brenda kësaj aleance, lirinë e vet kritike – e kjo është shfaqur gjatë gjithë rrjedhës së Luftës së Kosovës. Është shfaqur një rezervë sa i takon vendimit të fuqive që intervenimi të jetë vetëm nga ajri.⁷

Autorët kritikojnë verbërinë ideologjike të rrymave të ndryshme politike, të cilat i futin në të njëjtin thes bombardimet e NATO-s me bombardimet e shqiptarëve në Kosovë nga trupat serbe: « Ata janë të verbër ndaj kësaj asimetrie, e cila i takon raportit që mbajnë dhuna totalitare apo praktikat gjenocidale në emër të Serbisë së Madhe në Bosnjë dhe në Kosovë, nuk janë e kundërta e dhunës, por një modalitet tjetër i dhunës ». Njerëzimi i civilizuar, i cili u kundërvihet krimeve të regjimit serb, shtojnë autorët, nuk është naiv dhe nuk spekulon me « kundërshtinë thjeshtëzuese midis të drejtës dhe forcës, midis formës juridike dhe aksionit të dhunshëm ». Ngase ai opinion i emancipuar « e di nocionin, të cilin e kishte shtruar Walter Benjamin në një qarkore në të cilën dhuna e jashtëzakonshme përkufizohet përherë themeluese dhe mbështetëse e rregullës të së drejtës.⁸

Pikërisht pse në ideologjinë dhe praktikat gjenocidale të regjimit serb Brossat e Potel kishin parë tiparet e një regjimi totalitar, ata legjitimojnë luftën politike dhe atë ushtarake si luftëra kundër « një dhune që është forcë e pushtimit, e ekspansionit, shkatërrimit, shfarosjes dhe vdekjes ». Kësodore, saktësojnë ata, ajo forcë mund të cilësohet si *e mirë* dhe të emërtohet si e « drejta » në atë masë sa ajo është forcë që reziston përballë fuqisë vdekjeprurëse të totalitarizmit.⁹

⁷ Po aty, f.68.

⁸ Po aty, f.69.

⁹ Po aty, f.70.

Anton Kolë Berishaj

FEHMI AGANI -
KONTEKSTI SHKENCOR SOCIOLOGJIK
I AKTIVITETIT POLITIK

Abstrakt

Fehmi Agani (1932-1999), ishte dhe mbetet njëri ndër personalitetet më komplete të historisë kosovare dhe shqiptare përgjithësisht. Kompleksiteti i tij krijues, aktiviteti patriotik e politik, guximi intelektual i shpalosjes së temave të ndaluara për regjimet në kohë, angazhimi në themelimin dhe mëkëmbjen e institucioneve shkencore e arsimore, aftësia e bartjes së njohurive dhe përvojave të gjeneratave të reja, si arsimtar shumëvjeçar i sociologjisë në Universitetin e Prishtinës, por edhe të popullata e gjerë – sidomos viteve 80 e '90 kur pas zhbërjes së ish-Jugosllavisë, Kosova sërish u shndërrua në tokë të shënjestruar nga politika, shkenca dhe Kisha serbe.

Ndër shumë dimensione që shpërfaqen në veprimtarinë e prof. Aganit, veçohet modestia e paraqitjeve publike, guximi i publikimit të përmbajtjeve sociologjike dhe politike, që për kohën kishin jehonë blasfemike, pikërisht nga fakti se ishin të çliuara nga dozat e euforisë, subjektivizmit fiktiv dhe ngulmi nacionalist. Përkundrazi, ky autor në vazhdimësi publikonte qasje e përmbajtje të mbështetura në përvojën shkencore, madje që nga Greqia e lashtë antike e gjerë në kohën e tij. Njerëzia, është po ashtu një ndër segmentet e veçanta që këtë personalitet e bën të veçantë.

Krijimtaria e tij është e nduarnduar, prej asaj sociologjike, filozofike, politike e gjer tek ajo historike, andaj edhe synimi që të shkoqitet njëri nga shumëdimensionalitetet e saj, dëshmohet si punë e vështirë, meqenëse, sidomos në kohën e krizave të mëdha, pas vitit 1981, autori shquhet me një qasje shumë komplekse. Për të argumentuar çështjet – historikisht të ngatërruara dhe të ndërthurura me falsifikime e imponime të disbalansit të forcave, që në vazhdimësi lansoheshin nga “kuzhinat”, sidomos ajo serbe, qasjet njëdimensionale nuk më mjaftuan që të nxjerr në shesh të vërtetën. Andaj, edhe më këtë rast, synova që **kontekstin shkencor sociologjik të krijimtarisë së prof. Aganit, ta shikoj dhe analizoj nëpërmjet aktivitetit të tij politik dhe praktik**. Shpërfaqja e përmbajtjeve shkencore, kryesisht sociologjike, më së miri vërehen në synimin e tij që të vihen në shërbim të aktivitetit të tij, të bujshëm politik, fakt ky që këtë personaliteti i kushtoi me jetë.

SOCIOLOGJIA DHE POLITIKA

Në përpjekjet tona që të shkruajmë për ndonjë personalitet, është krejt e zakonshme që atyre t'u qasemi që nga biografia, e pastaj të

përqendrohemi në ndonjërin nga dimensionet dhe segmentet që personaliteti ka lënë gjurmë, i ka pasur objektiv shqyrtimi dhe i ka lënë në trashëgimi. Mirëpo, në rastin konkret, kur me një shkrim synohet përmbledhja e biografisë dhe veprimtarisë së Fehmi Aganit, kjo, thjesht del e pamundur. Arsyeja, mbase është se ky personalitet, si rrallë ndonjëri në këtë nënqiell, biografinë e ka të shkrirë në veprimtari, konkrete, në krijimtari, në aktivitete arsimore, politike, praktike, patriotike e shkencore... Pra, kemi të bëjmë me një figurë jo të zakonshme, tepër komplekse por edhe shumë të veçantë. Ata që e kanë njohur do ta aprovojnë këtë konfuzion timin ndërmjet Fehmi Aganit si personalitet i shkencës, atdhetarisë, arsimit, politikës, etikës dhe zgjidhjeve ideore e praktike.

Fehmi Agani, fillimisht si model i njerëzisë, i edukatës, i ndjesisë për fatin e të tjerëve, i vullnetit të paparë, që njohuritë dhe përvojën e vet ta përcjellë te gjeneratat e opinioni, por edhe i krijimtarisë sistematike për të hapur horizonte të reja, gjithnjë duke synuar e prekur majat e shkencave – kryesisht teorike. Ai, synonte gjetjen e mekanizmave për sigurimin e terrenit të qëndrueshëm, për realizimin e ideve, po ashtu, gjithnjë të mbështetura në jetën e përditshme, pra, në atë reale, praktike. Ky kompleksitet dhe multidimensionaliteti i strukturës mentale, por edhe i aparençës praktike që është hetuar te profesor Agani, mbase, kërkon edhe qasje që imponojnë ndjesi të veçantë – sidomos në shkoqitjen dhe analizën sociologjike të atyre dimensioneve. Fehmi Agani, nxënës e student i shkëlqyer, bashkëthemelues i institucioneve me peshë të veçantë – sidomos kur merret parasysh konteksti kohor në të cilin veproi, siç është Instituti Albanologjik, Departamenti i filozofisë dhe sociologjisë, Instituti i Filozofisë dhe Sociologjisë etj. Më vonë, u dëshmuua si kreator dhe ideolog i funksionalizimit të subjekteve politike, në sensin e pluralizimit të skenës së ngufatur politike e shoqërore në Kosovë, e mbi të gjitha, ligjërues i shkëlqyer universitar, veprimtari kjo që e filloi që nga vitet '60 në Fakultetin Filozofik.

Profesorin pata rastin dhe nderin ta takoj për herë të parë, tanimë në vitin e largët 1974, si student i posaregjistruar në Departamentin e filozofisë dhe të sociologjisë, që ai e udhëhiqte. Pra, në cilësinë e shefit të atij departamenti, si bashkëthemelues i tij, përveç barrës së rëndë¹ dhe përgjegjësisë në kompletimin e personelit të kualifikuar për këto fusha, ai mori edhe barrën e ligjërimit të lëndëve, që për kohën (po

¹ Shih: Fehmi Agani, Studime sociologjike dhe politologjike, ASHAK, Prishtinë, 2008, fq. 69-85

flasim për vitet 70, kur në Bllokun socialist të Lindjes, këto fusha ishin shkrirë në një marksizëm diamat), ligjërimi i të cilave, jashtë kornizave ideologjike, as që guxohej të imagjinohej. Kemi të bëjmë me realitetin kur ende konsiderohej mëkat blasfemik e partiak, për ideologjinë komuniste të kohës, me vetë faktin se duheshin shpalosur, përmendur e analizuar vepra e autorë, që këtë thelb të diktaturës e demistifikonin dhe e zhvishnin nga veli dhe errësira ideologjike.

Përveç në ish-Jugosllavi ku ligjërimi i këtyre shkencave kishte filluar më herët, në shumë vende të tjera ish komuniste, ato kanë filluar të shijohen nga gjeneratat e studentëve vetëm pas rënies së Murit të Berlinit. Mirëpo, profesor Agani, në vorbullin e kërcënimeve e qortimeve (që më vonë u dëshmuar si serioze dhe e penalizuan me largim nga puna në Universitet), ligjëronte madje edhe Sociologjinë politike, Teoritë shoqërore-politike, sociologjinë e përgjithshme, logjikën etj. Pikërisht në pajtim me dimensionin kompleks të personalitetit të tij, me zbardhjen e përmbajtjeve të anatemuara diktatoriale komuniste, ai në vazhdimësi përpiqej të gjente zgjidhje dhe rrugë logjike për implementimin e institucioneve dhe krijesave shoqërore që, sidomos neve në Kosovë na mohoheshim. Këtu kam parasysh liritë dhe të drejtat e njeriut, konceptcionin etiko-sociologjik të utilitarizmit, të drejtën për vetëvendosje, pozitivizmin sociologjik të Kontit, demokratizimin rrënjësor të Rusos, tolerancën dhe konfliktet shoqërore, universalitetin e lirisë e shumë të tjera.

Ajo që, përveç tjerash, e bënte të veçantë këtë Profesor, shpjegohet edhe me faktin se problemet sociologjike, që në shikim të parë, shpesh, sidomos për kohën dhe kontekstin e rrethanave shoqërore e politike të Kosovës, ngjasonin iluzore, si të pazgjidhura dhe utopike, i shpjegonte me themel. Profesori, jo rastësisht, kurset akademike i fillonte me *mendimin shoqëror e politik të lashtësisë greke*, mandej me *enigmat e Makiavelit*, me *teoritë shoqërore të revolucionit francez...* për të dalë te *teoritë shoqërore të elitizmit* (Pareto, Mosca etj). Pra, pa ndonjë ngulm euforik dhe pa tone që fshikullojnë vrazhd realitetin e kohës, ofronte premisa e përmbajtje, shkencërisht të mbështetura e të argumentuara, që gjithmonë e dëshmonin dhe e synonin të mundshmen. Ndër përmbajtjet që u ofronte studentëve, e më vonë ASHAK dhe redaksia e përbërë nga profesorët Ismajli, Islami e Murtezai, me botimin e përmbledhur në **Studime sociologjike dhe politologjike**, ia kanë ofruar edhe lexuesit të interesuar për këto tema, çështje dhe përmbajtje, që pavarësisht nga ndërrimet që ndodhën në Kosovë e më gjerë, nuk e kanë humbur aktualitetin dhe nuk do ta humbasin asnjëherë.

Siç u apostrofua, fillonte që nga zanafilla e mendimit shkencor, me mendimin shoqëror-politik të lashtësisë greke (Sokrati, Platoni, Aristoteli), për të vazhduar pastaj me enigmat e Makiavellit, me konceptin etiko-sociologjik të utilitarizmit, me Hobsin dhe Leviatanin e tij, me mendimin shoqëror të Revolucionit Borgjez Francez, me *Demokratizimin rrënjësor* të Rusoit, me mësimet e Monteskies – *frika është parim i despotizmit*, mandej me *fshikullimin e tiranëve dhe fanatikëve*...për të synuar terrenin e sigurt të *Qytetërimit të pabarazisë* – sërish të Rusoit që shpinin te **sovraniteti i popullit**. Siç shihet, sovraniteti i popullit ishte objektiv kryesor i profesorit Agani, mirëpo, për të sensibilizuar – jo vetëm ata që këtë vlerë madhore e konsideronin se është privilegj vetëm e disa popujve të zgjedhur, pra, vetëm e tyre, floskulë kjo që qarkullonte ndër shtresat intelektuale – sidomos të SANU-s dhe Kishës Ortodokse Serbe, por edhe për zgjimin e vetëdijes së fjetur dhe çlirimin nga frika, të individëve e shtresave të caktuara shoqërore, të lodhura nga torturat e robërisë, të dorëzuara para të keqes, por në masë të caktuar edhe të indoktrinuara e të tëhuajsuara nga presionet e gjata ideologjike që vegjetonin ndër ne.

Ndër çështjet që i hyjnë në punë Profesorit, për të spastruar terrenin politik – historikisht të ndotur të ambientit ku jetonte, ai i qaset *Teorisë së oligarkisë së Robert Mihelsit*², duke synuar relaksim in e bindjeve historike para *ligjit të hekurt të oligarkisë*, por edhe të pamundësisë së demokracisë dhe të socializmit. Kur fliste për Revolucionin përgjithësisht, e sidomos për atë Borgjez Francez, Profesori, zakonisht u referohej vëllezërve **dë Gonkur** dhe thënies së tyre se: “Revolucioni filloi në opinionin publik (thënie kjo e këtyre vëllezërve në monografinë e tyre për shoqërinë franceze në kohën e revolucionit. Dhe, vërtet, vazhdon profesori, sado të burojë nga kundërthëniet e thella ekonomike dhe shoqërore, sado të jetë nxitur drejtpërdrejt nga kriza ekonomike dhe politike që i paraprin, sado të jetë, më në fund vepër e aksionit revolucionar, të masave të gjera të rendit të tretë, Revolucioni Francez u përgatit dhe u sendërtua së pari në kokat e mendimtarëve më të shquar, në filozofinë dhe artet, në teorinë shoqërore e politike, në opinionin publik dhe në sallonet ku kryesisht formohej ky opinion.”³

S’do mend se ky formulim aludues e bartte dhe e përçonte mesazhin e fuqishëm të inkuadrimit të shtresës intelektuale në lëvizjen që po përgatitej edhe në Kosovë. I vetëdijshëm për rrethanat socio-kulturore,

² Po aty, fq. 135

³ Po aty, fq.72

ekonomike dhe politike të kohës, profesori vazhdonte t'i referohej ngjarjes historike të revolucionit që ka përcaktuar, por për të motivuar kuadrot e kohës së vet, se vetëm

“filozofia dhe mendimi francez i shekullit XVIII, me racionalizmin dhe frymën e vet kritike, me sulmin e guximshëm kundër marrëdhënieve dhe institucioneve të vjetra, me militantizmin kundër dogmave e paragjytimeve, kundër kishës dhe obskurantizmit, me frymën e lirisë dhe të tolerancës, synimet e veta çlirimtare e përparimtare, me këmbënguljen për kthesa radikale dhe transformime rrënjësore, me frymën optimiste dhe besimin në përparimin shoqëror e të përgjithshëm, shumë para revolucionit i kishin tejkaluar dhe shkelur marrëdhëniet me gjendjen ekzistuese. Revolucionit i kishin shpirtëror u realizua para vitit 1789. Monteskie e kishte demaskuar despotizmin. Volteri zhvillonte luftë kundër injorancës, kundër mosdurimit fetar, kundër kishës si institucion. Didëroi, Holbahu, Helveci e Dalamberi botonin Enciklopedinë dhe e zhvilluan atë amterializëm...”⁴⁴

Ndër shumë çështje të tjera që e pushtojnë lexuesin e shkrimeve sociologjike të autorit, patjetër se vlen të veçohet fakti se, edhe përbri vështrësive objektive në sigurimin e burimeve dhe literaturës shkencore sociologjike, sidomos marrë parasysh kontekstin e rrethanave politike të kohës, në krijimtarinë shkencore të profesorit Agani, në asnjë vend nuk mungojnë referencat dhe citimet e autorëve dhe veprave klasike e kapitale, që e kanë trasuar rrugën e prosperitetit shoqëror, ekonomik, politik, kulturor etj. Në këtë kontekst duhen parë edhe analizat që u bëhen veprave të Ogyst Kontit dhe *pozitivizmit* të tij, Teorive shoqërore të *egalitarizmit*, e sidomos shtyllave të shkencës së sociologjisë, siç janë **Weberi** e **Dyrkemi**. Profesori, mbase nga rrethanat e kohës ishte i preokupuar me konceptet qendrore të krijimtarisë dyrkemiane, të **vetëdijes kolektive**, të ndarjes së punës dhe të **solidaritëtit shoqëror**. S’do mend se pikërisht këto koncepte përkonin me rrethanat dhe kohën në të cilën ai vepronte. Vetëdija kolektive, koncept ky i avancimit nga stadi i vetëdijes individuale, familjare, vëllazërore e fisnore, të krijuara dhe të fuqizuara në kontekstin e rrethanave të jetës në strukturën arkaike shoqërore, por të parcializuara gjerë në kufijtë e lidhjeve farefisnore, ku përkatësia kombëtare ende mbetej iluzore, pra jashtë kontekstit kolektiv të vetëdijes.

Në njërin nga kapitujt e titulluar *Mbi shoqërinë civile*, koncept ky që shikuar nga perspektiva e sotme imponohet si i natyrshëm, i domosdoshëm dhe i paevitueshëm, mirëpo konteksti i rrethanave – jo vetëm

⁴ Po aty

politike të kohës në ambientin kosovar, por edhe ideologjike të diktaturës komuniste përgjithësisht, nuk përfilllej dhe injorohej meqenëse për aktivitetet që synonin shoqëritë civile, përgjegjëse, pra edhe kompetente ishte vetëm Partia Komuniste. Megjithatë, profesori, me vështrime rreth shoqërisë civile (siç i titullon ai), del te temat e ndjeshme të tolerancës dhe konflikteve shoqërore, të *universalitetit të lirisë dhe të individualitetit* si begati e zhvillimit, koncepcione këto të njohura të Xhorxh Stjuart Millit, pastaj te Utopia e Thomas Morit e gjerë te *ideologjitë e reja konservatore e të djathta*. Kapitullin e përmyll me formulimin – *nga mendimi i sotëm sociologjik e politik...*⁵

Ideologjia

Siç vërehet nga vargimi i problematikave, autori synon terrenin e rrëshqitshëm socio-kulturor e politik të kohës. I vetëdijshëm për implikimet ideologjiko-politike që kishte lënda e **Sociologjisë politike**, ai, pikërisht kësaj çështjeje ia kushton një nënkapitull të tërë në këtë vepër. Fjala, pra, është për një qasje ndryshe, të re, tjetërfare krahasuar me ligjërimet e kohës që kryesisht zhvilloheshin brenda kornizave diamate, të ngurtësuara ideologjike, komuniste, të diktaturës. Në këtë kontekst duhet vështruar edhe qasjen që pason, të titulluar pikërisht – *Ideologjizimi i ideologjisë*, për të vazhduar me *ideologjia si faktor i praktikës shoqërore* dhe në fund, me *Politika dhe ideologjia*.⁶

Për të sqaruar këtë koncept, për ta analizuar dhe kuptuar peshën, kompleksitetin dhe mesazhet që i njëjti i bart që nga rrënjët e tij, autori pohon se:

“koncepti i ideologjisë, një ndër konceptet më komplekse dhe më të rëndësishme të teorisë shoqërore dhe të praktikës shoqërore-historike e politike, me gjithë mungesat dhe paqartësitë, moskuptimet e keqkuptimet eventuale, me gjithë trajtimet shpesh të njëanshme e ideologjikisht të ngarkuara, ka hyrë gjerësisht në përdorim shkencor e politik.”⁷

E, për t’i mbështetur shkencërisht këto pohime, autori, siç vepron zakonisht, i referohet mendimtarit të përmasave botërore, Teodor Adornos, i cili, siç pohon autori,

⁵ Po aty, fq.201-276

⁶ Po aty, fq.289

⁷ Po aty, fq. 283

“përmend thënien e një autori tjetër, të E. Sprangerit, se sot ‘vetëm rrallë flitet për idetë dhe idealet, kurse, përkundrazi, shumë shpesh për ideologjinë politike. Vetë termi ideologji i përdorur për herë të parë në fillim të shekullit të kaluar nga Desty de Trasi (Destutt de Tracy), pjesëtar i një shkollë filozofike e cila duke hedhur metafizikën përpiqej për një fundamentim antropologjik dhe psikologjik të shkencave shpirtërore, mirëfilli shënonte teorinë e ideve.”⁸

Nocioni i ideologjisë, me implikime dhe shtrirje të gjerë në teorinë e përgjithshme mbi shoqërinë, me kohë mori ngjyrimë dhe interpretime të cilat oscillojnë që nga shpërftyrimi i saj e gjerë te cementimi në thelbin e lëvizjeve shoqërore të kohës. Në këtë mënyrë, për të vënë në pah këto qasje që ideologjinë si koncept e shfrytëzojnë edhe në vende që nuk përkojnë me funksionin e saj, autori e pasqyron me sintagmën – **ideologjizimi i ideologjisë**. Sipas tij

“e tërë ideologjia gjermane ka karakter të theksuar të polemikës dhe të konfrontimit me filozofinë idealiste të kohës, prandaj përmban stërthesime dhe pohime që duken të njëanshme dhe ekstreme. Po të mos merret parasysh ky karakter i veprës, atëherë do të merrej tekstualisht p.sh. pohimi se morali, feja, metafizika dhe format e tjera ideologjike nuk kanë zhvillim, nuk kanë histori dhe do të mund të përfundohej, sikundër pohon Altyseri, se teoria e ideologjisë së Marksit, e dhënë në ideologjinë gjermane, ‘nuk është marksiste’!”⁹

I vetëdijshëm se shfrytëzimi i koncepteve që lidhen me ideologjinë – siç ishte **ideologjizimi i ideologjisë** etj., mund të ketë implikime praktike, pavarësisht se trajtimi dhe interpretimi i tyre është gjithnjë i nivelit teorik, autori edhe më këtë rast insiston në sqarime rrënjësore kur pohon se:

“dhe, nuk është vetëm Altyseri që na duket se e trajton njëanshëm konceptcionin e Marksit për ideologjinë, madje jo vetëm si zhvillohet si në **ideologjinë gjermane**. Përkundrazi, shumë të përhapura janë trajtimet e njëanshme të pikëpamjes së Marksit për ideologjinë, ideologjizimet e ideologjisë, madje si në mesin e kundërshtarëve teorikë të marksizmit ashtu edhe në teoritë që nominalisht lidhen me Marksit. Njëanshmëri është shikimi i ideologjisë vetëm nga aspekti gnoseologjik, sikurse është ideologjizëm reduktimi i saj në njohje të deformuar, të përmbysur në vetëdije të rrejshme.”¹⁰

⁸ Po aty

⁹ Po aty fq.285

¹⁰ Po aty, fq. 286

Pas një analize të thukët të trajtimit të nocionit ideologji, të Marksit, Th. Gajgerit, M. Veberit e gjerë te Z. Bauman, i cili, sipas autorit, pohon se:

“insistimi për ndarjen e rreptë të shkencës nga ideologjia, studimet pa principe dhe orientime paraprake, trajtimi i objektivitetit si të kundërt me ideologjinë, më në fund, teza për sociologjinë si joideologjike, të gjitha këto dëshmojnë sipas Z. Baumanit, se autorët e tyre kanë punuar në mënyrë jokritike qëndrime të ndryshme ideologjike ose se kanë hequr dorë nga zgjedhja e vlerave ideologjike...Teza për pavarësinë e shkencës shoqërore nga ideologjia është një tezë ideologjike, shprehje e pranimit të vlerave të caktuara, e akomodimit në gjendjen e dhënë, pra, është tezë e ruajtjes së status quosë.”¹¹

Nga teoria në praktikë

Qasja, analiza dhe interpretimi teorik i nocioneve që lidhen me organizimin e jetës së popujve, kombeve, komuniteteve dhe përgjithësisht shoqërisë njerëzore, që autori me shumë kujdes dhe interesim i bën në një pjesë të mirë të krijimtarisë së vet, manifestohet si përgatitje e qëllimshme e terrenit për të hyrë në tema të “nxehta” me të cilat ballafaqohet opinioni shqiptar përgjithësisht, e në veçanti ai i Kosovës. Në nënkapitullin, *Kombi, Pakicat dhe Vetëvendosja*, të botuar në “Tema”, Prishtinë 1993, e pastaj e rimarrë nga revistat ndërkombëtare, ai, përveç të tjerash nënvizon: “Të përcaktohen përmbajtja, karakteristikat dhe relacionet e kategorive të kombit, që u studiuva gjatë dhe intensivisht dhe për të cilin u krijuan teori të tëra; të pakicës kombëtare, e cila ishte kryesisht objekt interesimi sporadik e marginal dhe më tepër çështje e imponimit teorik dhe e trajtimit ndjekës e represiv politiko-shtetëror; të raportit midis tyre dhe vetëvendosjes, do të thotë të shqyrtohen kategori të rëndësishme shoqërore, me ngarkesa të mëdha politike, të cilat sot janë objekt studimi intensiv në shkencat e politikologjisë, të sociologjisë politike, të së drejtës ndërkombëtare etj. dhe të elaborimit politik të shumanshëm.”¹²

Duhet rikujtuar se koha kur autori u qaset këtyre temave përkojnë me periudhën pas rënies së Murit të Berlinit dhe ndryshimeve të mëdha në Evropën Lindore, të dekompozimit të Bashkimit Sovjetik, e sidomos të, siç e quan autori, shembjes tronditëse të Jugosllavisë. Pas këtyre

¹¹ Po aty, fq. 287

¹² Agani Fehmi, vep.cit. 409

ngjarjeve të mëdha në skenën shoqërore e politike të shteteve të Lindjes, pasojnë implikimet tragjike (u referohet luftërave në ish- Jugosllavi (A.B.), e rreziqet e këtij procesi, ristrukturimet shtetërore e politike, kontestet kufitare, përmbysjet institucionale, kushtetuese e statusore, problemet e krijuara rreth legalitetit dhe legjitimitetit të kërkesave, pretendimeve e gjendjeve të krijuara ose të imponuara, i aktualizuan dhe ashpërsuan posaçërisht shqyrtimet e përmendura.¹³

I vetëdijshëm për problemet me të cilat do të përballet Kosova, në mënyrë të veçantë – jo vetëm për shkak të statusit specifik në ish shtetin e dekompozuar, por edhe për shkak të raporteve historikisht komplekse me fqinjët, e sidomos me Serbinë, ai i qaset vështrimit, që siç pohon, në fokus do të jenë:”shqyrtimi i kategorive të kombit, të pakicës kombëtare e të vetëvendosjes nga aspekti i ndryshimeve të bëra dhe i problemeve të krijuara me rrënimin e Jugosllavisë, veçanërisht lidhur me pozitën, kërkesat dhe perspektivat e zgjidhjes së çështjes shqiptare në ish-Jugosllavi¹⁴”.

Për një argumentim të qëndrueshëm – jo vetëm shkencërisht, por edhe logjikisht e praktikisht, autori nisat nga konstatimi fundamental, që është se: në peshën e kontradiktave dhe të mëkateve të veta, Jugosllavia e Versajës dhe AVNOJ-it u shemb. Shteti që sot quhet ose pretendon të quhet Jugosllavi, një federatë ekstremisht asimetrike e dy republikave apo dy popujve, njërin prej të cilëve, paradoksalisht nuk e njihte ose nuk donte ta pranonte as kryetari i parë i deridjeshëm i shtetit federal, s’është tjetër veçse një surrogat dhe një mashtrim.¹⁵ Meqenëse koha kur autori i shkruan këta rreshta, në ish- Jugosllavi ende nuk ishte ndalur lufta e përgjakur ndërmjet popujve që, madje konsideroheshin strumbullarë të asaj ngrehine që u shemb, nuk ka asnjë dyshim dhe nuk heziton që Serbinë ta cilësojë si shkaktare kryesore – jo vetëm të shembjes, por edhe të mekanizmave të dhunshëm që e përcjellin këtë proces. Andaj, ai pohon se:

“S’është vështirë të dëshmohet se pikërisht hegjemonizmi serb, që përbën burimin kryesor të antagonizmave ndërnacionalë, të cilët e rrënonin Jugosllavinë qysh prej fillimit të saj, me shkallëzimin e tij euforik në fund të viteve tetëdhjetë, me iluzionet e tij serbomëdha, me programin e tij të qartë të dominimit mbi të tjerët, me brutalitetin e pashembullt në reali-

¹³ Po aty

¹⁴ Po aty

¹⁵ Po aty

zimin e këtij programi të hegjemonisë, me koncepcionet, vlerat dhe praktikën që i solli, esencialisht të ngjashme ose identike me ato të fashizmit, e bëri të pamundshëm ekzistimin e Jugosllavisë.”¹⁶

Jam i bindur se çfarëdo komenti lidhur me peshën, argumentimin dhe cilësimin e fqinjët kosovar, madje në një kohë kur popullata shqiptare në Kosovë ishte deinstitutionalizuar dhe ishte shndërruar në shënjestër të grupeve militare e paramilitare serbe, sidomos pas luftërave të përgjakshme në Bosnjë dhe Hercegovinë e Kroaci, është i tepërt. Jo vetëm guximi intelektual, por edhe argumentimi shkencor që i parapriu këtij pasusi, flet për kompleksitetin e personalitetit që – apanenca i shfaqte qetësi, vetëpërmbytje, butësi dhe gatishmëri për kontakte, biseda, marrëveshje, e paqe, por vetëm nëse për këtë ka bazë, arsye dhe argumentim të qëndrueshëm. Pra, jo me çdo kusht! Përndryshe, cilësimi i këtillë i Serbisë nuk mund të kuptohet as si nxitje për konflikt, por si sinjalizim gjenial i asaj që i pret, sidomos shqiptarët. Ai nuk ishte aspak jugonostalgjik, siç do të mund ta kuptonin ata që nuk e kanë njohur më afër, apo nuk i kanë lexuar veprat e profesorit. Përkundrazi! Andaj, ai në vazhdim thekson:

“Shqiptarët, viktima e parë e madhe e grykësisë së shovinistëve serbë, nuk kanë pse të ankohen për shembjen e kësaj Jugosllavie. Ata ishin të shtypur e të ndjekur gjatë tërë periudhës së ekzistimit të atij shteti, por, edhe sot, pas rrënimit të Jugosllavisë, Serbia pretendon ta mbajë Kosovën, ta trajtojë si pjesë integrale të saj. Duke qenë se përbërja nacionale e popullsisë së Kosovës, ku serbët e malazezët së bashku nuk e kalojnë dhjetë përqindëshin e popullsisë së përgjithshme, nuk ofron kurrfarë mbështetje për pretendimet hegjemoniste. Serbia e sotme, përveç forcës e dhunës, që janë “argumentet” kryesore të saj, pretendimet e veta përpiqet t’i racionalizojë e mbrojë dhe me “argumentin historik”, që, në të vërtetë, është një histori e shpifur, më tepër trillim e legjendë, histori e mit, ose, thënë më saktësisht, mit si histori dhe me pseudoargumente teorike. Konstruktin themelor të këtij pseudoargumentimi teorik e përbëjnë: ndarja dikotomike e absolutizuar e komuniteteve nacionale në kombe e pakica kombëtare, në “popuj sovranë” të Jugosllavisë dhe pakica kombëtare, si do të shprehet Millosheviqi, një ndarje e absolutizuar që nuk ka për qëllim njohjen e veçantisë e të specifikave të ekzistimit dhe të zhvillimit të komuniteteve kombëtare, por errësimin e shumëllojshmërisë e të veçantive për hir të përlligjes së dominimit mbi pakicat...”¹⁷

¹⁶ Po aty, fq.410

¹⁷ Po aty

Autori, vazhdon me argumentimin e prapavijës politike të gllabërimit, mohimit të identitetit shoqëror e kombëtar, shpërfytyrimit dhe minimizimit të peshës dhe veçorive kombëtare të – siç quheshin komunitete e pakica kombëtare, që u bëhej në atmosferën e pushtimit nga të fuqishmit. Në vazhdim do të shkëpus një pjesë, që autori e lidh me fjalimin helmues të Millosheviqit, nga viti 1989, ku përveç të tjerash, apostrofohen thekse, tanimë të njohur, por edhe të ruajtura në vokabularin nacional-shovinist serb, si parulla që nisin mesazhe urrejtjeje e kërcënimi e që mund të dëgjohen në tubime të ndryshme, e madje edhe nëpër evenimente sportive gjithandej vendit e më gjerë, Kosova është Serbi.

“Në mendimin dhe praktikën serboshoviniste, statusi i pakicës nuk përcaktohet vetëm në raport me vetëvendosjen, nuk reduktohet vetëm e drejta e shkëputjes. Përkundrazi, të jesh pakicë do të thotë të mos jesh në vendin tënd, të jesh në shtet të huaj dhe në mëshirë të huaj. Ilustrativ është fjalimi i Milosheviqit në Ushqë, në fillim të vitit 1989, në fazën kur serboshovinizmi agresiv ishte në shkallëzim dhe kriza në Kosovë, pas grevave të pandërprera, po merrte përmasa dramatike. mendimi themelor i tij dhe pohimet kryesore ishin: **Kosova është Serbi**, por shqiptarët mund të jetojnë në të, sepse Serbia është zemërgjerë; ata mund të jetojnë mirë, por të mos jenë të këqinj dhe të mbrapshtë! Natyrisht, nuk eksplikohen ç’do të thotë të jesh i keq dhe i mbrapshtë. Kjo mbetet çështje e interpretimit dhe e sanksionimit arbitrar të pushtetit serb.”¹⁸

Fjalime, paraqitje publike, shkrime dhe publikime të këtilla – jo vetëm në kohën së cilës i referohet autori, prof. Agani, por edhe në ditët e sotme nuk kanë të ndalur, pavarësisht se kaluan dekada nga pavarësimi i Kosovës. Mirëpo, vlen të theksohet edhe një fakt që kësaj platforme nacionalshoviniste serbe ia mohon karakterin euforik dhe të rastit, e lidhet me etimologjinë e saj burimore të mentalitetit, krijimtarisë, folklorit, historisë dhe opinionit serb. Autori, prof. Agani e quan “...përforcim për “argumentimin e sipërm, ish- kryetari i RFJ-së, Dobrica Qosiq, shton një margaritar, që po e përmendim vetëm sa për të ilustruar tërë konfuzionin e diskursit serbo-shovinist – dallimin në mes të popujve shtetformues dhe atyre joshtetformues, ku i numëron edhe shqiptarët. Në një intervistë dhënë gazetaës “Le Quotidien”, në korrik të viti 1992, i pyetur pse u mohohet e drejta e vetëvendosjes shqiptarëve, Qosiqi përgjigjet: *Ndryshimi është esencial, sepse kroatët, serbët,*

¹⁸ Po aty, fq.410-411

sllovenët e boshnjakët (por jo maqedonasit, malazezët, myslimanët (vërejtja jonë), janë popuj konstitutivë në Jugosllavi. Bashkërisht luftuan kundër agresionit turk. Përkundrazi, Kosova është rezultat i një kolonializimi të trefishtë: kolonializimit otoman, italian, gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe komunist!”¹⁹

Pas citimit të kësaj deklarate të Dobrica Qosiqit, lidhur me statutet e popujve dhe komuniteteve që ishin pjesë i ish –Jugosllavisë, pavarësisht argumentimit shkencor dhe analizave të shkrimeve që u referohen këtyre çështjeve, për autorin mbetet enigmë, i vetëdijshëm se jo gjithmonë e drejta fiton dhe argumentet shkencore nuk zbehen para argumentit të forcës. Andaj, ai me mëdyshje pohon dhe shprehet, pavarësisht nga besimi i mbështetur në normat dhe mbrojtjen ndërkom-bëtare, por edhe në qenien, forcën, vullnetin, dëshirën e qenies kombëtare të Kosovës për të mbrojtur identitetin e vet kombëtar dhe trojet shqiptare: “por sa është i qëndrueshëm argumentimi i sipërm dhe sa kanë mbështetje pretendimet serbe për Kosovën dhe viset me shumicë shqiptare, kur të merret parasysh zhvillimi i sotëm politik, afirmimi i të drejtave të popujve, normat dhe mbrojtja ndërkombëtare e tyre dhe qenia kombëtare e Kosovës. Dhe, nga ana tjetër, sa gjejnë mbështetje në realitetin kombëtar, shoqëror e politik të Kosovës dhe në normën ndërkombëtare, kërkesat e lëvizjes politike shqiptare që çështja e Kosovës dhe e viseve me shumicë shqiptare të zgjidhet në bazë të parimit të së drejtës së popujve për vetëvendosje?”²⁰

E drejta ndërkombëtare, sipas mendimit të Profesorit, pavarësisht nga përpjekjet shekullore që të definojë nocionin e kombit, nuk ka arritur një pajtim rreth konceptimit të tij të plotë. Kjo, mbase është edhe pasojë e interesave të ngushta të fuqive të caktuara, por edhe nga jopreciziteti i definimit të nocioneve e kategorive, siç janë populli, kombi, pakicat kombëtare. Konfuzioni mund të burojë edhe nga fakti, se zakonisht si pikënisje merret përcaktimi i popullit që bëri Cristescu si raportues special i Nënkomisionit për Evitimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen e Pakicave të KB-së.²¹ Andaj, shkruan:

¹⁹ Po aty

²⁰ Po aty

²¹ Shih: A.Critescu, The Right to Self-determination. Historical and Current Developmant on the Basis of UN, Instruments, New Zork, 1991, pas, Veniamin Karakostanoglou, The Right of Self-Determination and the Case of of Yougoslavia (dorëshkrim),

“E drejta e sotme ndërkombëtare, duke u nisur nga një realitet shtetëror dhe politik ndërkombëtar, që është shumë më i gjerë dhe i ndryshëm nga gjendja e Evropës, në përcaktimin e komuniteteve etnike nisat kryesisht nga kategoria e popullit, e të drejtave dhe marrëdhënieve të popujve. Por, edhe këtu, madje edhe me më shumë të drejtë se kur është fjala për definimin e kombit, mund të thuhet se mungon një definicion kënaqshëm. Kjo ndodhë pjesërisht edhe pse përkufizimi i kategorisë së popullit, që bëhet për nevoja të hartimit të dokumenteve të caktuara ndërkombëtare, e ngushton në mënyrë të konsiderueshme këndvështrimin e çështjes.”²²

Kjo ishte sa u përket konfuzioneve dhe paprecizitetit që ishte i zakonshëm në konceptimin e nocionit popull e komb. Ndërsa, definimi i kategorisë së pakicave, sipas mendimit të autorit, janë edhe më të pakta dhe më të mangëta. “Definicionet si ai i Luis Wirth-it, sipas të cilit pakicat janë grupe njerëzish, të cilët për shkak të cilësive fizike ose kulturore të tyre, janë objekt i diskriminimit kolektiv, më tepër janë përshkrim i gjendjes së mjerë të shumë pakicave sesa përcaktim substancial i tyre. (Shih: B.Vukas, Etniçe manjine i medjunarodni odnosi, Zagreb, 1978. fq.11)” Bredhjet pa kriter në përcaktimin e pakicave, sipas mendimit të profesorit, që rezultojnë nga interesat dhe presioni i shumë shteteve, të cilat nuk duan ta pranojnë ekzistimin e pakicave në vendet e tyre ose nuk janë në gjendje ta ndryshojnë pozitën e pakicave, i ilustron edhe definicioni për pakicat, të cilin Nënkomisioni për Pengimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen e Pakicave ia sugjeroi Komisionit për të Drejtat e Njeriut të KB-së. Në këtë definicion, që nuk u pranua, pakicat përcaktohen si grupe jodominante të popullsisë, të cilat kanë dhe duan të ruajnë traditat dhe karakteristikat etnike, fetare ose gjuhësore, të cilat i dallojnë nga popullsia tjetër.²³

PARIMET FUNDAMENTALE TË SË DREJTËS NË VETËVENDOSJE

Vetëvendosja dhe vullneti i lirë

U theksua disa herë gjatë kësaj analize të përmbajtjeve të publikuara nga autori, prof. Agani, se preokupimi kryesor, pra edhe objektivi i qasjeve teorike, i analizave të burimeve të autorëve që nga lashtësia,

²² Po aty, fq.412

²³ Shih: Fehmi Agani, op.cit, cituar sipas B.Vukas, Etnike manjine i medjunarodni odnosi, Yagreb, 1978.11

ishte Kosova, çështja e zgjidhjes së statusit të saj, sidomos pas shembjes së shtetit jugosllav.

Duke zbardhur interpretime e analiza të autorëve që kanë lënë gjurmë në teorinë sociologjike të konceptimit të kategorive të popullit, kombit dhe pakicave kombëtare, autori synon sigurimin e një bazamenti të qëndrueshëm – shkencërisht dhe politikisht, për vetëvendosjen e shqiptarëve në Kosovë. Si njohës i shkëlqyer i rrethanave, politikave dhe ideologjive që qarkullonin me shekuj në mentalitetin serb, që asnjë modus të pavarësisë së shqiptarëve nuk e pranonte, por, përkundrazi, e konsideronte si secesionizëm, irredentizëm, armiçësi dhe shpallje e luftës nga ana shqiptare, Andaj, autori pohon se: “Vetëvendosja, si e drejtë e përgjithshme e të gjithë popujve, është thelbësisht demokratike, shprehje esenciale e demokratizimit. Si e këtillë, ajo është e lidhur, gërshe-tohet me të drejtat individuale, njerëzore. Por, si e drejtë kolektive, e drejtë e komuniteteve, nuk mund të reduktohet në të drejtat individuale njerëzore dhe as të shterret me to. Që të mund të realizohet e drejta e vetëvedosjes presupozon shprehjen e lirë e të sigurt të vullnetit të popullit përkatës. Prandaj, referendumet, votimet ose procese të tjera me pjesëmarrje të tërë popullit, janë parakusht për realizimin e saj.”²⁴

Përpyekjet e politikave serbe fokusoheshin në konceptin e të drejtave të njeriut, si koncept i vetëmjaftueshëm për sigurimin e jetës së qetë në bashkësi shoqërore, por edhe për jetë simbiotike me fqinjët sllavë. Mirëpo, nuk ka asnjë dyshim se ky qëndrim e mohonte çdo të drejtë e përpjekje për vetëvendosje, për pavarësi dhe për integritet territorial të popullatës shqiptare. Kjo parullë edhe mund të shitej në qarqet ndërkombëtare, mirëpo e kaluara e përbashkët në një shtet kishte deshmuar se të drejtat e njeriut – edhe po të siguroheshin me standardet më të larta, nuk mjaftonin për të siguruar të drejtat e një komuniteti shumicë, në një njësi federale, siç ishte Kosova. Paradoksi tjetër, të cilin autori prof. Agani e shtron si argument të politikës dyfytirëshe serbe është edhe fakti se:

“Në emër të të drejtës së popujve për vetëvendosje Serbia kërkon pavarësim shtetëror të serbëve të Bosnjës dhe të Kroacisë, madje me shtrirje më të gjerë territoriale sesa ishin territoret ku ata përbënin shumicën, e edhe bashkimin e tyre me Serbinë, pikërisht kur këto ua mohon shqiptarëve në Kosovë dhe jashtë saj. Edhe Maqedonia di t’ua mohojë shqiptarëve pikërisht ato që i kërkon për vete. Kjo çështje është e shpeshtë dhe e rëndësishme, dhe Tomas Fleiner, i mbështetur pikërisht në ish-Jugosllavi,

²⁴ Agani, Fehmi, vep.cit. fq. 418

kërkon: *‘të mos pranohen kombet si subjekte legjitime ndërkombëtare, dhe pse pranohet e drejta e tyre për vetëvendosje’*.²⁵

Edhe në shumicën e dokumenteve ndërkombëtare të cilat i referoheshin vetëvendosjes së popujve, kombeve dhe pakicave kombëtare, në mënyrë të qartë ishin përcaktuar kushtet dhe rrethanat në të cilat vetëvendosja (nuk) mund të ndodhë. Në vargun e masave që kërkohen si norma e parakushte, patjetër se prinin ato që krijesat shtetërore të mos shpërbëhen, të mos defunksionalizohen, të mos shkapërderdhen, me çka do të paralizohej edhe funksioni parësor dhe vital i tyre. Andaj, edhe e drejta për vetëvendosje imponohet si e drejtë - “shumë komplekse shoqërore e politike shumë të ndryshme e edhe të kundërta. Prandaj, një ambiguitet, një shumëkuptimësi e konceptit të të drejtës së vetëvendosjes është e pashmangshme. Por, shkak kryesor i konfrontimeve dhe i tensioneve rreth të drejtës për vetëvendosje dhe të realizimit të saj, qëndron në interesat e kundërta të shteteve dhe të komuniteteve të ndryshme, në konfrontimin e forcave që kërkojnë ndryshime dhe të forcave të status quo-së”.²⁶

Shqiptarët, Kosova dhe vetëvendosja

Gjetja e burimeve, dokumenteve, analizave të rasteve konkrete që i kanë aplikuar dhe jetësuar të drejtat për vetëvendosje, si parime të përcaktuara nga dokumentet që përkrijnë me standardet e pranuar ndërkombëtare, autorin e sjellin te ballafaqimi me rastin konkret të Kosovës. Që në pasusin e parë të këtij nëntitulli, autori thekson se: Një ndër kërkesat themelore shqiptare dhe të lëvizjes së tyre politike është kërkesa për të drejtën e vetëvendosjes dhe, duke marrë parasysh qenien kombëtare të shqiptarëve, realitetin politik në ish-Jugosllavi dhe normat e synimet e bashkësisë ndërkombëtare, del qartas se shqiptarëve në ish-Jugosllavi nuk mund t’u mohohet e drejta për vetëvendosje.²⁷

Në frymën shkencore dhe të standardeve ndërkombëtare të njohjes së të drejtës për vetëvendosje, argumentimit shkencor dhe specifikave të rastit në fjalë, autori i vargon edhe një numër argumentesh të tjera që lidhen specifikisht me Kosovën dhe për të drejtën e saj në vetëvendosje. Argumenti i parë është se **shqiptarët nuk janë pakicë**.

²⁵ Po aty

²⁶ Po aty, fq. 417

²⁷ Po aty, fq. 422

E drejta e vetëvendosjes është, para së gjithash, e drejtë e popujve. Por edhe shqiptarët në ish-Jugosllavi janë popull e jo pakicë kombëtare.

“Në lëvizjen e madhe politiko-kulturore e nacional-çlirimtare, ç’prej mesit të shekullit XIX, të njohur si periudhë e Rilindjes Kombëtare, shqiptarët në tërësi arritën definitivisht formimin e tyre kombëtar, kulturor dhe etnik, kurse me luftëra dhe kryengritje të pandërprera kundër Perandorisë Osmane në fund të shekullit XIX dhe në fillim të këtij shekulli shprehën qartas vetëdijen kombëtare dhe interesin e tyre për çlirim kombëtar dhe formim të shtetit të pavarur. Jo rastësisht Kosova ishte një ndër qendrat kryesore të Rilindjes kombëtare.”²⁸

Në vazhden e argumenteve, shkencërisht të qëndrueshme, por që burojnë edhe nga realiteti i cili mund të mos përfillet, por patjetër duhet të pranohet, autori ofron edhe **sprovën e ngushtësisë së autonomisë**. Kjo i referohet doktrinës zyrtare jugosllave mbi shqiptarët si minoritet, në realitetin dhe zhvillimin politik e edhe kushtetues-juridik të Jugosllavisë, shqiptarët dhe Kosova i tejkalojnë suazat për trajtim minoritar dhe të një autonomie. Mirëpo, në vazhdim, autori e bën një veprim – sa dinak, aq edhe të fuqishëm në aspektin e shembjes së teorive që qarkullojnë (e në Serbi, ende qarkullojnë), në mileun jugosllav për shqiptarët si minoritet. Ai pohon se gjatë Luftës së Dytë Botërore – dhe kjo është indikative – subjekti politik që kryesisht e përcaktoi rezultatin e luftës dhe të zhvillimit për katër dekada pas saj, PKJ-ja dhe lëvizja së cilës ajo i printe, nuk i trajtonte shqiptarët haptazi si pakicë dhe nuk ua mohonte atyre të drejtën për vetëvendosje. Traktet, proklamatat, thirrjet u drejtoshin popujve të Kosovës, popullit shqiptar veçmas.²⁹

Territori

Është fakt i njohur në literaturën shkencore se ndër elementet qenësore që merren për bazë në konceptimin e popullit e kombit është territori. Ky, madje imponohet edhe si parakusht i njohjes së statusit të këtyre grupeve, andaj autori i këtyre shkrimeve, prof. Agani, i vetëdijshëm për këtë fakt, territorin e shkoqit si element bazik, por edhe të veçantë. “Territori i Kosovës, suazat, karakteri dhe statusi i këtij territori, trajtimi i tij, është çështje esenciale, si për statusin e Kosovës, ashtu

²⁸ Po aty

²⁹ Po aty, fq. 423

edhe për përcaktimin e shqiptarëve si popull. Qëndrimin e Serbisë e karakterizojnë përpjekjet që Kosovën ta paraqesë si pjesë integrale të Serbisë, kurse Serbinë, duke përfshirë edhe Kosovën si njësi territoriale-politike dhe një tërësi.³⁰ Ai, madje, në këtë sens shkoqit edhe të dhëna të tjera që e përforcojnë qëndrueshmërinë e argumentimit, në vazhdimësi të mohuar nga politika serbe, që “i karakterizojnë përpjekjet që Kosovën ta paraqesë si pjesë integrale të Serbisë, kurse Serbinë, duke përfshirë edhe Kosovën si një njësi territoriale, politike dhe një tërësi. Në këtë rast, shqiptarët do të përbënin vetëm rreth 20% të popullsisë së saj dhe më lehtë do të imponohej statusi minoritar për ta. Kosova është një tërësi territoriale-ekonomike-shoqërore-politike me identitet të qartë e të lashtë.”³¹

Në këtë kontekst, autori i rendit periudhat historike kur Kosova ka funksionuar si territor i mëvetësishëm – që nga Dardania e vjetër, në periudhën e sundimit turk kur funksiononte si Vilajeti i Kosovës, në Jugosllavinë para Luftës dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, siç pohon autori, vërtet ishte ndarë në banovina, por Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore u konstitua si njësi e veçantë politiko-territoriale, jashtë Serbisë dhe pavarësisht nga Serbia. Ajo, madje nuk ishte në Serbi as në mbledhjen e AVNOJ-it (1943, as kur konstituohet Republika e Serbisë, nga fundi i vitit 1944... Kufijtë e Kosovës ishin të përcaktuar dhe nuk mund të ndërronin pa pajtimin e saj. Me Kushtetutën e vitit 1974, Kosova, më tepër nominalisht ishte në përbërje të Serbisë, por jo kurrësi pjesë përbërëse e saj.³²

Në vazhden e nxjerrjes dhe renditjes së argumenteve – shkencërisht, por edhe realisht të qëndrueshme, autori shkoqit “*Secesionizmin*” dhe *pushtimin* si rrethana që shkojnë në favor të qëndrimeve të sipërpërmendura për Kosovën si territor i integruar dhunshëm në krijesën ish-jugosllave, që pa asnjë dyshim shkojnë në favor të sigurimit të argumenteve shkencore dhe politike për mëvetësinë e Kosovës. Andaj, kërkesat për vetëvendosje të shqiptarëve dhe për mëvetësinë e Kosovës, nuk është secesionizëm, Jugosllavia njësi federale e së cilës ishte Kosova, e dekompozua. Ajo nuk ekziston më. Prandaj, nënvizon autori, nuk ka si të flitet për secesion nga një shtet i shpërbërë.³³ Argumentim ky – jo vetëm i qëndrueshëm në kontekstin e rrethanave të reja, por edhe shkencërisht i bazuar, pa asnjë mundësi të dyshimit.

³⁰ Po aty, fq. 426

³¹ Po aty

³² Po aty

³³ Shih: Po aty, fq.426

Në vargun e argumenteve për të drejtën në vetëvendosje të Kosovës, sidomos pas shpërbërjes së shtetit ish-jugosllav, autori e rendit edhe “**secesionizmin**” dhe **pushtimin**. Që në hyrje të këtyre ngjarjeve, ai e eviton secilën dilemë që qarkullonin dhe gatuheshin në kuzhinat serbe, se – kërkesa për vetëvendosje e shqiptarëve dhe për mëvetësinë e Kosovës nuk është secesionizëm. Nëse tërë kësaj që u pohua më lart, i shtojmë edhe realitetin e pamohueshëm historik se në rastin e shqiptarëve të Kosovës është ushtruar **trajtimi gjenocidal**, meqenëse Serbia zgjodhi dhunën dhe arbitraritetin. Me tanke e brutalitet ajo theu autonomitetin e Kosovës, suspendoi të gjitha organet e saj legale, bëri çmos për dëbimin e tërësishëm të shqiptarëve nga jeta publike, bllokoï të gjitha institucionet arsimore e kulturore të jetës shqiptare dhe, mbi të gjitha, zhvilloi një politikë të represionit brutal e të pandërprerë kundër shqiptarëve.³⁴ Për të siguruar lirinë dhe mirëqenien e popullatës së përndjekur shqiptare në Kosovë, autori sugjeron demokratizimin, siç pohon ai, në shprehjen e kërkesës për vetëvendosje, si sipas tij, është një argument i fortë plotësues në favor të Republikës së pavarur të Kosovës.³⁵

Realiteti, tani më, dihet dhe është i hidhur. Autori i tërë kësaj analize shkencore, të qëndrueshme e të argumentuar, madje, pikërisht në kohën kur Kosovën e ngufaste zhurma e tankeve dhe rafaleve të forcave militare dhe paramilitare serbe, ofroi një strategjie të bazuar – jo të ngarkuar me subjektivizëm dhe me premisa të “KANDJES”, që burojnë nga vullneti i mirë dhe dëshira, por të shkarkuara nga emocionet, që zakonisht e errësojnë rrugën për gjetjen e mekanizmave dhe të argumentimit të qëndrueshëm. Ky autor, që me këtë qasje njëdimensionale çfarë i bëra unë në këtë shkrim, duke gjurmuar vetëm kursin socio-logjiko-politik shkencor, mbase edhe do të duket i mangët, por koha e ka dëshmuar se kompleksiteti i çështjeve që Fehmi Agani i shtroi në tryezën e analizave shkencore, përveç guximit të spikatur intelektual, u shtri edhe në dimensionin konkret, aktiv politik dhe praktik të kohës, pa asnjë droje se e tëra do t’ia merrte jetën, gjë që ndodhi para 25 vjetëve.

U prehtë në paqe profesori, shkencëtari, veprimtari dhe mbi të gjitha, njeriu i madh, akad. prof. dr. Fehmi Agani!

³⁴ Po aty, 427

³⁵ Po aty

Librat:

Në rrjedha të mendimit sociologjik, (një histori e veçantë e mendimit sociologjik), Prishtinë, 1990.

Demokracia, kombi, vetëvendosja, Dukagjini, Pejë, 1994.

Pavarësia – shpresa dhe gjasa, Dukagjini, Pejë, 1999.

Studime sociologjike dhe politikologjike, ASHAK, Prishtinë, 2008.

Ka lënë të botuara shumë studime sociologjike, politologjike, nëpër periodik në gjuhët shqipe, serbokroate dhe angleze. Ka lënë dorëshkrim monografinë “Partitë dhe grupet politike në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore” dhe shkrime të tjera.

Në vitin 2002, në 70-vjetorin e lindjes, Shtëpia botuese “Dukagjini” botoi Veprat në 8 vëllime:

Vepra 1, Në rrjedha të mendimit sociologjik, f. 1-375.

Vepra 2, Për shoqërinë civile, f. 1-411.

Vepra 3, Demokracia, kombi, vetëvendosja, f. 1-376.

Vepra 4, Partitë dhe grupet politike në Shqipëri (1939-1945), f. 1-486.

Vepra 5, Sindikatat gjermane dhe shkrime të tjera, f. 1-304.

Vepra 6, Gjuha e dhunës dhe zëri i arsyes, f. 1-437.

Vepra 7, Pavarësia- gjasa dhe shpresë, f. 1-487.

Vepra 8, Intervista, reagime, f. 1-386.

Botoi edhe shumë studime, artikuj, trajtesa e polemika në organe të ndryshme shkencore, në revista dhe gazeta në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera.³⁶

³⁷ Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës

Skënder Demaliaj
Albana Demaliaj
Neralba Demaliaj

KËNDVËSHTRIME TË REJA TË FEHMI AGANIT PËR VETËVENDOSJEN E SHQIPTARËVE TË KOSOVËS. RASTI I KONFERENCËS SË BUJANIT

Abstrakt

Profesor Fehmi Agani në studimet e tij ka paraqitur këndvështrime të reja dhe vizion të ri për vetëvendosjen e shqiptarëve të Kosovës. Ai ka mbrojtur me vendosmëri, me guxim intelektual dhe me argumente shkencore tezën se Krahina e Kosovës është një tërësi territoriale –ekonomike – shoqërore me identitet të qartë e të lashtë dhe se e drejta e shqiptarëve të Kosovës për vetëvendosje është e drejtë legjitime, universale dhe demokratike dhe në pajtim me Kartën e Atlantikut. Gjithashtu ka hedhur poshtë pretendimet serbe ndaj Kosovës si: argumentimi historik, manipulimet demografike mbi përmasat dhe lëvizjet e popullsisë në Kosovë dhe argumentet pseudoteorike.

Ka theksuar se ideja kombëtare dhe ideali kombëtar janë ndër elementet themelore konstitutive të kombit dhe ndër idetë më të rëndësishme frymëzuese dhe pjesë të lëvizjeve kombëtare. Thelbi i Rezolutës së Konferencës së Bujanit është pikërisht ideja dhe ideali kombëtar.

Për profesor Fehmi Aganin demokratizimi në shprehjen e kërkesës për vetëvendosje është një argument i fortë plotësues në favor të Republikës së pavarur të Kosovës. Bashkë me politologë të tjerë shqiptarë të Kosovës mbron idenë se shqiptarët e synojnë bashkimin, veç të tjerash, pikërisht sepse kanë nevojë të zhvillohen si të tjerët.

Fjalët çelës: vetëvendosje, Rezolutë, Karta e Atlantikut, Konferenca e Bujanit, shqiptarët e Kosovës, miti serb, nacionalizëm, memorandum, demagogji, qëndresë.

1. Këndvështrime të reja, vizion i ri i profesor Fehmi Aganit për vetëvendosjen e shqiptarëve të Kosovës Rasti i Konferencës së Bujanit

Vështrim i përgjithshëm

Parimi i të drejtës së popujve për vetëvendosje është e drejtë legjitime, universale dhe demokratike. Ky parim buron **së pari**, që nga

Deklarata Amerikane e Pavarësisë (1976) dhe Revolucioni Francez. Në emër të këtij parimi kërkohet bashkimi kombëtar – shtetëror i Italisë ose rrënimi i shteteve shumëkombëshe (Austro-Hungaria, Turqia Osmane, Rusia Cariste). Është edhe një nga 14 pikat e Presidentit Willson në Konferencën e Paqes në Paris.

Sipas tij vetëvendosje do të thotë se “Asnjë popull nuk duhet të lihet nën sovranitetin nën të cilin nuk dëshiron të jetojë. Çdo popull duhet të jetë i lirë që të përcaktojë vetë politikën dhe qeverisjen, si dhe asnjë territor nuk duhet të ndërrojë dorë përveç për të siguruar të drejtat e banorëve të tij për gjasa të barabarta për jetë dhe liri. Për të arritur paqe të vërtetë në një rajon sipas tij *“asnjë shtet apo popull nuk duhet lejuar të shtrijë pushtetin dhe politikën e tij mbi një komb apo popull tjetër”*. E drejta për vetëvendosje përfshin: *“Krijimin e një shteti sovran dhe të pavarur ose shpallje e ndonjë statusi tjetër politik e vendosur me vullnet të lirë nga populli”*¹. Parimi i vetëvendosjes është edhe pjesë e Kartës së Atlantikut, firmosur nga Frenklin Rusvelt e Winston Çërçilli, më 14 gusht 1941 në Newfaulend të Argjentinës. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe deklarorin se:

- Nuk aspironin shtim teritorësh.
- Nuk pranonin ndryshime teritoriale që ishin bërë pa vullnetin e lirë të popujve të interesuar.
- Respektonin të drejtën e popujve për vetëvendosje dhe kërkonin t’i jepnin pavarësinë, atyre që u ishte privuar.

Kjo deklaratë ishte e vlefshme vetëm për vendet dhe popujt evropianë.

Në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, si dhe në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Qytetare dhe Politike (dhjetor 1966) shkruhet:

“Të gjithë popujt kanë të drejtën e vetëvendosjes. Në bazë të kësaj të drejte ata përcaktojnë lirisht statusin e vet politik dhe vijojnë lirisht zhvillimin e vet ekonomik, social e kulturor.

Të gjithë popujt, për qëllime të veta mund të disponojnë lirisht të mirat dhe burimet natyrore... Në asnjë rast një popull nuk mund të privohet nga mjetet e veta të ekzistencës.

Shtetet anëtare, nënshkruese të kësaj Konvente, duke përfshirë edhe ato që kanë përgjegjësi për administrimin e vendeve të varura dhe nën

¹ Unite Nations Assembly Resolution 2625 (XXVO, 24 tetor 1970).

*kujdestari, duhet të ndihmojnë realizimin e të drejtave për vetëvendosje dhe duhet të respektojnë këtë të drejtë, në përputhje me dispozitat e Kartës së Kombeve të Bashkuara*².

Në kuptimin klasik, parimi i vetëvendosjes shprehet në dy forma: e brendshme (opozitë kundër një diktature dhe pjesëmarrjeje e dytë në qeverisje) dhe e jashtme (pavarësi ose shkëputje). Të gjithë popujt kanë të drejtë për vetëvendosje.

Për prof. Gazmend Pulën: *“Historia e vetëvendosjes është histori e ndërtimit të kombeve dhe e thyerjes së shteteve... Vetëvendosja mund të ketë dy objektiva të mundshëm: pavarësi të plotë, përfshirë edhe shkëputjen ose një status të caktuar kushtetues-juridik brenda një kor-nize të dhënë shtetërore si për shembull status Republike, Konfederative/Federative. Në këtë kuptim definohet më tej, përkatësisht edhe “vetëvendosje ekstreme apo vetëvendosje interne”*³.

Gjykatësi Dillard në deklaratën e tij të mirënjohur mbi parimin e vetëvendosjes përmbodhi: *“I takon popullit të vendosi fatin e territorit dhe jo territori fatin e popullit”*⁴.

Edhe Konferenca e Bujanit, nisur nga këto parime miratoi në Rezolutë të drejtën e shqiptarëve për vetëvendosje, shprehu dëshirën e tyre për t’u bashkuar me Shqipërinë.

Udhëheqja e PKJ-së pranoi se për zgjidhjen e problemit të Kosovës, në rrethanat dhe kushtet e Luftës së Dytë Botërore duhet t’i përmbaheshin Kartës së Atlantikut. Por kur shqiptarët vendosën në Konferencën e Bujanit të drejtën e tyre për vetëvendosje, ky nen i Rezolutës figuron si pjesë *“problematike”* e kësaj Konference. Rezoluta e Bujanit ishte një nevojë jetike, një domosdoshmëri historike që e diktonte vetë copëtimi i kombit shqiptar. Në Konferencën e Bujanit, shqiptarët u deklaruan për një përcaktim orientues kombëtar.

Studiues, historianë, politikanë e juristë janë marrë gjerësisht me këtë Konferencë e kanë analizuar gjatë gjithë kohës. Ndër ta është edhe profesor Fehmi Agani, veçanërisht në librin: *“Demokracia, kombi, vetëvendosja”*.

Profesori shtron pyetjen: A kanë shqiptarët të drejtë të bashkohen apo jo? Përgjigjen e jep duke cituar dr. Branko Horvat: *“Në të kaluarën*

² Human Rights: *A compilation of international instruments*, New York, 1988, 19.

³ *Shekulli 21, Mendime dhe opinione*, Gjon Lekaj, Publishing Company New York, 1996, f. 290.

⁴ Mirlinda Çelmeta, *E drejta për vetëvendosje e shqiptarëve të Kosovës*, Tiranë: Flesh, 2001, 53.

serbe dhe kroate lufta për bashkim kombëtar mbante gjithnjë aureolën e shkallës më të lartë të patriotizmit. Kjo vlen edhe për gjithë popujt e tjerë. Pse, pra, një të drejtë që për vete e konsiderojnë si të shenjtë të mos ua pranojnë edhe të tjerëve? Që atë gjë, të cilën për vete e konsiderojnë si atdheadashuri të jashtëzakonshme, te shqiptarët ta trajtojnë si separatizëm dhe kontrarevolucion”⁵.

1.1. Kosova është një tërësi territoriale ekonomike – shoqërore – politike me identitet të qartë e të lashtë

Në studimet e tij hedh poshtë tezën themelore neohegjemoniste serbe ndaj Kosovës se shqiptarët në Jugosllavi janë pakicë kombëtare dhe e drejta e vetëvendosjes dhe e themelimit të shtetit të tyre, ashtu edhe e shkëputjes nga shteti ku janë tani, nuk u takon pakicave kombëtare. Profesori i thekson kriteret se kush mund të quhet popull, duke u mbështetur në raportin e Takimit të Ekspertëve të UNESCO-s për të drejtat e popujve:

- karakteristikat e përbashkëta si: gjuha, raca, religjioni,
- numri i popullsisë,
- vullneti i identifikimit si popull ose vetëdija e të qenit popull, institucionet e mundshme për shprehjen e karakteristikave të përbashkëta dhe të dëshirës për identitet⁶.

Nisur nga këto kritere, ai argumenton se shqiptarët në Kosovë nuk janë pakicë kombëtare, por popull.

Në Kosovë flitet shqip, raca është shqiptare, myslimanët përbëjnë pjesën dërmuese të popullsisë. Shqiptarët atje gjithmonë kanë qenë mazhorancë, më shumë se 90 për qind e popullsisë. Edhe në ditët më të vështira ishin më shumë se 70 për qind e popullsisë.

Në të gjitha etapat e rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar kombi shqiptar, ata kanë shprehur vetëdijen e të qenit popull: në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, kërkesa themelore e së cilës ishte autonomia, shkëputja nga Perandoria Osmane, kërkesa për bashkimin e vilajeteve shqiptare në vitin 1912, Rezoluta e Bujanit, vetëvendosja, e drejta e shkëputjes dhe dëshira për t’u bashkuar me Shqipërinë, Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut 1990, e Kuvendit legal e legjitim, Referendumi i shtatorit 1991, Kushtetuta e Kaçanikut, zgjedhjet e majit 1992

⁵ Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja*, Pejë: Dukagjin, 1994, 44.

⁶ Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja*, Pejë: Dukagjin, 1994, 13.

për Parlament e kryetar të Republikës së Kosovës – janë një konfirmim jo vetëm i dëshirës, por edhe i aftësisë së Kosovës për të realizuar vetëvendosjen, shprehje e karakteristikave të përbashkëta dhe e dëshirës për identitet.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit duhej të zgjidhte tri detyra kryesore, të cilat përbënin shqetësimin për të gjithë shqiptarët:

Së pari, të kundërshtonte copëtimin e trojeve etnike, të banuara nga shqiptarët, siç ishte parashikuar në Traktatin e Shën Stefanit dhe në Kongresin e Berlinit të vitit 1878.

Së dyti, të realizonte bashkimin e trojeve shqiptare në një vilajet të vetëm në kuadër të Perandorisë Osmane.

Së treti, të dëshmonte në mbarë opinionin publik evropian se shqiptarët i shin një komb i veçantë në Ballkan, pavarësisht nga ndryshimet fetare.⁷

Në të gjitha dokumentet e LNÇ-së deri më 18 qershor 1944, shqiptarët e Kosovës quhen popull (narod), komb. Edhe Tito në letrën e 2 dhjetorit 1943 drejtuar KQPKSH-së ndër të tjera shkruan: “... sot te populli shqiptar në Kosovë e në Rrafshin e Dukagjinit...”⁸. Pra e cilëson popull. Regjimi Tito – Rankoviç e më vonë Millosheviçi i kanë quajtur shqiptarët pakicë kombëtare në Jugosllavi e Serbi. E shpreh dhe e mbron Millosheviçi në intervistën e tij: “Shqiptarët janë pakicë kombëtare në Jugosllavi e Serbi. Mendoj se të gjithë popujt jugosllavë kanë të drejta të njëjta për vetëvendosje, kurse shqiptarët janë pakicë kombëtare në Jugosllavi”⁹. Por ndryshe, ai mendon për serbët në Kroaci: “Nuk janë pakicë kombëtare, nuk ka popull jugosllav që të jetë pakicë kudo në Jugosllavi. Të gjithë popujt e Jugosllavisë në Jugosllavi janë të barabartë dhe asnjëri prej tyre nuk mund të jetë pakicë kombëtare”¹⁰. Kjo nuk vlen për myslimanët e Sanxhakut, ku në vitin 1876 ndodhi spatriimi etnik i shqiptarëve në këtë Krahinë. Pra serbët në Kroaci kanë të drejtë të vetëvendosin, të shkëputen nga Kroacia e të bashkohen me Serbinë, kurse shqiptarët e Kosovës nuk e kanë këtë të drejtë. Me argumente profesor Fehmi Agani këto qëndrime të Millosheviqit i quan “absurditet rreth të (pa)drejtave të pakicave”¹¹.

⁷ Arsim Bajrami, *Shtetndërtimi i Kosovës 1990-2020*, Prishtinë: AShAK, 2021, 47.

⁸ AEHK, dok. 264.

⁹ Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja*, Pejë: Dukagjin, 1994, 158.

¹⁰ Hakif Bajrami, *Nga Bujani në Kaçanik*, Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të Kosovës, 1997, 159.

¹¹ Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja*, Pejë: Dukagjin, 1994, 43.

Milloseviqi ka dy standarde për të drejtat e popujve në Jugosllavi. Nëse je serb, kudo që ndodhesh ke të drejtë të vetëvendosësh, të bashkohesh me Serbinë, vetëm me Serbinë për të krijuar “*Serbinë e Madhe Homogjene*”. Luftërat e tyre i quan të drejta, mbrojtëse: “*Në përleshjen me Kroacinë, Serbët gjithmonë janë mbrojtur. Asnjëherë nuk kanë bërë kurrfarë agresioni në territorin e Kroacisë. Populli serb në tërë historinë e tij asnjëherë nuk ka zhvilluar luftë agresive. Gjithmonë janë mbrojtur me mjaft sukses dhe gjithmonë kemi fituar*”¹². Si ndodhi që Serbia kurrë të mos ketë zhvilluar luftë agresive?! Ç’ishin luftërat ballkanike, pushtimi i Kosovës me shumicë të qartë popullsie shqiptare dhe pushtimi i Maqedonisë? A nuk humbën serbët, më 1389 përballë Turqisë Osmane?

Nënteksti është i qartë: Edhe në Kosovë serbët po mbrohen nga sulmet e shqiptarëve. Pikërisht edhe për këtë po shpërngulen nga Kosova.

Udhëheqësit serbë, ku bën pjesë edhe Milloseviçi të drejtën për Republikë të shqiptarëve të Kosovës e kanë quajtur “*kontrarevolucion*”, term i sajuar dhe i shpikur prej tyre si mbulesë për represion ndaj tyre, platformë për shpërnguljen dhe asgjësimin e shqiptarëve të Kosovës.

Në Enciklopedinë politike, fjala “*kontrarevolucion*” definohet si “*aksion i organizuar politik i drejtuar kundër sistemit shoqëror të krijuar me revolucion, kundër fryteve revolucionare, kundër forcave dhe raporteve shoqërore që synojnë transformimin revolucionar të shoqërisë*”¹³.

Akademiku Dobrica Qosiç flet për popuj konstruktivë dhe jokonstruktivë në Jugosllavi: “*Ndryshimi është esencial, sepse kroatët, serbët, sllovenët e boshnjakët (por jo maqedonasit, malazezët, myslimanët) janë popuj konstruktivë në Jugosllavi... Bashkë luftuan kundër agresionit turk. Përkundrazi, Kosova është rezultat i një kolonizimi të trefishtë: kolonizimit otoman, italian gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe komunist*”¹⁴. Një tjetër historian serb, Toma Miliçi përmend 4 kundërrevolucionet (1912, 1919, 1941, 1981, e separatistëve shqiptarë), të cilët janë përpjekur pa sukses që nga Mbretëria e Serbisë, Mbretëria e serbëve, kroatëve e sllovenëve të shkëputnin Kosovën¹⁵.

Politologët dhe historianët shqiptarë të Kosovës, si profesor Gazmend Zajmi kanë pohuar me zë të lartë dhe kanë parashtruar argu-

¹² Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja*, Pejë: Dukagjin, 1994, 156.

¹³ *Politička Enciklopedija Savremena Administracija*, Beograd: 1975, 476.

¹⁴ Hakif Bajrami, *Nga Bujani në Kaçanik*, Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të Kosovës, 1997, 10.

¹⁵ Hakif Bajrami, *Nga Bujani në Kaçanik*, Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të Kosovës, 1997, 192-193.

mente shkencore bindëse se janë katër boshte që shprehin individualitetin dhe mëvetësinë e Kosovës dhe që, si determinante sociopolitike e fuqizojnë dhe e formësojnë në mënyrë burimore statusin e pavarur të Kosovës me popujt e tjerë të Jugosllavisë Federative:

“Boshti i parë, është realiteti kombëtar – demografik – territorial i popullit shqiptar në Kosovë e Jugosllavi, është gjysma e kombit shqiptar në Ballkan, dy të tretat në Kosovë dhe katër të pestat e popullsisë në Kosovë.

Boshti i dytë i mëvetësisë së Kosovës është individualiteti kompleks historik, gjeografik, struktural – kombëtar dhe politik i Kosovës: Dardania që në botën antike, Vilajeti i Kosovës në Perandorinë Osmane, formësimi i pavarur i pushtetit popullor antifashist gjatë Luftës së Dytë Botërore, i shprehur edhe në Konferencën e Bujanit.

Boshti i tretë është vetë parimi i individualitetit dhe i barazisë kombëtare si princip “spiritus movens” i trajtësimit institucional dhe politik – territorial të shtetit polinacional, ku e drejta natyrore kombëtare e kolektiviteteve nacionale për pavarësi dhe barazi është më e qëndrueshme se çdo qasje dhe lëshim momental shtetëror.

Boshti i katërt është vullneti politik dhe demokratik i popullit shumicë të Kosovës, i shprehur dhe i specializuar nga baza dhe në bazën shoqërore për pozitë të pavarur dhe të barabartë të Kosovës në polinacionalitetin e Jugosllavisë”¹⁶.

Programet, të cilat kanë si qëllim rekrutimin e ithtarëve dhe mobilizimin e përkrahjes sa më të gjerë, përmbajnë, projeksione irrealë dhe synime utopike, premtime boshe dhe elementë të demagogjisë e të mashtrimit¹⁷. I tillë është edhe programi i Sllobodan Millosheviçit, të cilin prof. Agani e quan “anakronizëm, arkaizëm e jashtëkohësi”¹⁸. Ndryshe mendon dhe e vlerëson ultranacionalisti serb, Dobrica Qosiç: “Është një njeri që ka bërë shumë. Ai është një shfaqje e re në jetën e Serbisë, njeriu që e ka artikuluar zemërimin e popullit, duke e shndërruar në aksion politik. Ai është sigurisht i pari komunist serb që e ndërpreu raportin vasal me koalicionin antiserb, njeriu, i cili këtij populli fatkeq, të përrulur i ndihmoi të ngrihej e të drejtohej”¹⁹. Përse e

¹⁶ Gazmend Zajmi, *Veptra I*, Prishtinë: ASHAK, 1997, 16-18.

¹⁷ Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja*, Pejë: Dukagjin, 1994, 175.

¹⁸ Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja*, Pejë: Dukagjin, 1994, 169.

¹⁹ *Gazeta Politika*, 30.04.1989, Beograd, f. 6.

quan popull fatkeq, të përulur?! Përse është fatkeq?! Kush e ka përulur?! Çfarë duhet të bëjë në këtë situatë? I vjen në ndihmë Memorandumi i ASHS i vitit 1986.

1.2. E drejta e vetëvendosjes së shqiptarëve të Kosovës për të qenë shtet i pavarur është e mbështetur në të drejtën ndërkombëtare dhe praktikën ndërkombëtare

Gjatë shekullit të kaluar janë zbatuar tre lloje vetëvendosjeje:

- vetëvendosja postimperialiste – krijimi i shteteve pas shpërbërjes së perandorive të mëdha,
- vetëvendosja postkolonialiste – lindja e ish-shteteve të reja nga ish-kolonitë,
- vetëvendosja postkomuniste – krijimi i shteteve nga ish-Federatat Komuniste.

Kosova është shtet i pavarur si rrjedhojë e shpërbërjes së Federatës Komuniste të Jugosllavisë. Është një proces politik normal, objektiv, i pandalshëm si shumë shtete të tjera.

Për të siguruar vetëvendosjen duhen përmbushur gjashtë kriteret e mëposhtme:

- ekzistenca e një grupi të dallueshëm dhe të vetëkarakterizuar që mbështesin fuqishëm shkëputjen,
- pretendime legjitime mbi territorin,
- ekzistenca e një forme të një diskriminimi sistematik ose shfrytëzimi ndaj një minoriteti të konsiderueshëm në numër dhe të përcaktuar mirë,
- refuzimi nga ana e qeverisë qendrore për të gjetur zgjidhje me kompromis,
- prospekti i territorit dhe i popullit të interesuar për t'u bërë një shtet i qëndrueshëm,
- efektet që ka dhënia ose refuzimi i vetëvendosjes mbi paqen rajonale dhe ndërkombëtare, përmbushja e proceseve qeveritare me autoritetin e duhur dhe respekti për të drejtat e njeriut dhe ndikimet mbi vlerat dhe moralin e shoqërisë, si në planin rajonal, ashtu edhe global²⁰.

²⁰ Robert Howse & Karen Knop, Federalizëm, Shkëputje dhe Kufijtë e Zgjidhjeve

Të gjitha këto kritere i përmbush Kosova. Në rast se autonomia e etnive dhunohet në mënyrë sistematike nga një politikë shtypjeje e dhunshme, atëherë lind e drejta për shkëputje. Vetëvendosja është e aplikueshme. Sipas prof. dr. Georg Brunner, e drejta e sovranitetit shtetëror dhe e drejta e vetëvendosjes kanë të njëjtën domethënie dhe përparësi. Nëse cenohet e drejta e vetëvendosjes së brendshme, pra për një autonomi të brendshme të një grupi popullsie të ndryshme nga shumica, atëherë përparësi ka e drejta e vetëvendosjes aktive, që do të thotë e drejta për secesion²¹.

Kosova ka qenë koloni e Serbisë, e shtypur dhe e diskriminuar nga pushteti serb, ku sistematikisht i janë shkelur të drejtat njerëzore dhe është dhunuar me të gjitha format. Edhe gjenocid ka pasur ndaj shqiptarëve të Kosovës. Në këto kushte dhe rrethana shqiptarët e Kosovës nuk mund të jenë më në një shtet me Serbinë.

Vetëvendosja etnike nga ana tjetër nënkupton kombe etnike të dallueshme apo kolektivitete që kanë origjinë të njëjtë gjenealogjike. Kriteret për përcaktimin e realizueshmërisë së të drejtës për vetëvendosje janë të njëjta me ato për pranimin e kombeve etnike: prejardhja, përkatësisht etnogjeneza e njëjtë, gjuha e njëjtë, besimi i njëjtë, kultura e përbashkët apo çfarëdo kombinimi përkatës i tyre. Një komb etnik duhet të ketë institucionet e veta politike dhe njohjen ndërkombëtare për t' i dhënë identitet politik. Ky identitet mund të jetë qoftë shtet kombëtar i pavarur, qoftë entitet i dalluar etnik brenda një shteti. Kosova i përket entisë shqiptare, ka kufij të përcaktuar qartë, ka dallim thelbësor me serbët në gjuhë, në traditë, në mentalitet, në përkatësinë fetare, në konceptet e ndërtimit të shoqërisë. Deklarata e marrëdhënieve të paqes të OKB-së, kapitulli V, paragrafi 4 thotë:

“Arritja e një shteti sovran e të pavarur, bashkimi ose lidhja sipas zgjedhjes së lirë me një shtet tjetër, vendimi për zhvillimin e një statusi tjetër politik të dëshiruar – përbën formën e realizimit të së drejtës për vetëvendosje të popullit”.

Vite më parë studiues, analistë e politologë vendas e të huaj kanë paralajmëruar se në varësi të situatës politike të brendshme e ndërkombëtare, të zhvillimeve, veçanërisht në Ballkan, shqiptarët e Kosovës do të ushtrojnë të drejtën e tyre për vetëvendosje, për shkëputje dhe krijimin e një shteti të pavarur. Momenti dhe situata erdhi. Jugosllavia

Etnike një Perspektivë Kanadeze, New Europe Law Review, volum. 1, no. 2, p. 269.

²¹ Enver Bytyçi, *E drejta e vetëvendosjes, Rasti i Kosovës*, Tiranë: Koha, 2007, f. 226.

Federative u shpërbë, Kosova u çlirua, Parlamenti i Kosovës shpalli shtetin e pavarur, më 17 shkurt 2008. Një shtet i ri u shënua në hartën politike të Ballkanit, të Evropës e të botës. I njohur ndërkomëtarisht nga më se 100 shtete. Edhe nga Rezoluta e Rambujesë, pas tre vjetësh të administrimit të Kosovës nga OKB-ja parashikohej një Referendum sipas konceptit për vetëvendosjen për të ardhmen e Kosovës. Këtë e realizoi më së miri Kuvendi i Kosovës, i cili përfaqëson dëshirat dhe interesat e popullit shqiptar të Kosovës.

Kosova prej 16 vjetësh është shtet i pavarur dhe i plotëson të gjitha kërkesat për njohjen e një shteti:

- respekt për Kartën e OKB-së,
- garanci për të drejtat e grupeve etnike dhe minoriteteve, bazuar në Aktin Final të Hesinkit dhe Kartën e Parisit,
- pranimi i të gjitha zotimeve përkatëse në lidhje me çarmatimin dhe mosshtimin e armëve atomike,
- mosnjohja e entiteteve që janë rezultat i agresionit,
- respekt për paprekshëmrinë e të gjithë kufijve, përveç rasteve kur ndryshohen në mënyrë paqësore me marrëveshje të përbashkët,
- pranimi i zotimeve për stabilitet dhe sigurim rajonal,
- angazhim për të zgjidhur në paqe të gjitha problemet e trashëgimisë së shtetit²².

Edhe praktika ndërkombëtare është në anën e të drejtës së shqiptarëve të Kosovës për vetëvendosje. Po japim si shembull Ishujt Alande dhe përfundimet që ka nxjerrë Komisioni Ndërkombëtar. Ishujt Alande ishin vënë nën administrimin e Finlandës në vitin 1809 si rezultat i një marrëveshjeje paqeje të Suedisë me Rusinë, megjithëse këta ishuj banoheshin nga suedezët dhe jo nga finlandezët. Në atë kohë Finlanda ishte pjesë e Rusisë dhe për këtë arsye marrëveshja kishte fuqi vepruese. Në vitin 1917-1918, Finlanda u shkëput nga Rusia, prandaj lindi çështja e statusit të Ishujve Alande. Në qershor të vitit 1919 u organizua një referendum, ku 95% e banorëve votuan për shkëputje nga Finlanda dhe për bashkim me Suedinë. Finlanda u shpreh kundër referendumit, duke argumentuar se ajo ruante sovranitetin mbi ishujt dhe se këta ishuj i ishin bashkuar territorit finlandez dhe jo territorit rus, me një marrëveshje të nënshkruar edhe nga vetë Suedia. Asnjë masakër ndaj banorëve të saj nuk ishte bërë nga Finlanda, ndryshe çfarë ka ndodhur në

²² Roland Rich, *Njohja e shteteve: Rënia e Jugosllavisë dhe e Bashkimit Sovjetik, EJIL, Vol. 4, No. 1.*

Kosovë nga Serbia. Për këtë Finlanda iu drejtua Lidhjes së Kombeve dhe Gjykatës së Përhershme Ndërkombëtare që të japin verdiktin lidhur me këtë çështje. Grupi i ekspertëve me juristë nga Lidhja e Kombeve njohu të drejtën e vetëvendosjes për një pjesë të një populli dhe në rastin tonë suedezët e këtyre ishujve, pa e diskutuar fare një kufizim të mundshëm të kësaj të drejte vetëm për “*kombet e plotë*”. Kjo është shumë e arsyeshme se po të kufizohej vetëm për “*kombet e plotë*” d.m.th te kombi kryesor i shteteve-kombe, ky parim do të apelohej shumë rrallë dhe do të ishte i panevojshëm. Rëndësia kryesore në zbatimin e parimit të vetëvendosjes del në pah kur u drejtohet grupeve kombëtare. Për këtë, sot shumica e studiuesve janë të mendimit që jo vetëm çdo grupi, i cili e konsideron veten një komb ka të drejtën e vetëvendosjes, por gjithashtu kjo e drejtë i përket edhe atij grupi që është pjesë e një populli ose kombi, siç ishin suedezët e Ishujve Alande, siç janë edhe shqiptarët në Kosovë²³. Bile shqiptarët e Kosovës kanë më shumë të drejtë se banorët e Ishujve Alande, sepse siç thotë prof. dr. Georg Brunner, e drejta e sovranitetit shtetëror dhe e drejta e vetëvendosjes kanë të njëjtën domethënie dhe përparësi. Në rast se autonomia e etnive dhunohet në mënyrë sistematike nga një politikë shtypjeje e dhunshme, atëherë lind e drejta për shkëputje²⁴. Pra e drejta e shkëputjes së shqiptarëve nga Serbia është e ligjshme, sepse ndaj tyre nga shteti serb sistematikisht është ushtruar dhunë e pashembullt dhe gjenocid. Siç shkruante Edmund Burke: “... nuk qeveriset një komb që vazhdimisht duhet të pushtohet”²⁵.

1.3. Nacionalhegjemionizmi serb dhe vetëvendosja e shqiptarëve

Për prof. Fehmi Aganin: “*Nacionalizmi është, para së gjithash, absolutizim dhe hyjnizim i kombëtares dhe interesit kombëtar, ashtu si i trajtojnë kombëtares dhe interesin kombëtar klasat dhe grupet sunduese – përkundër qenies kombëtare dhe interesave të tjera normale kombëtare të kombeve të tjera*”²⁶.

²³ Mirlinda Çelmeta, *E drejta për vetëvendosje e shqiptarëve të Kosovës*, Tiranë: Flesh, 2001, f. 48-49.

²⁴ Enver Bytyçi, *E drejta e vetëvendosjes, Rasti i Kosovës*, Tiranë: Koha, 2007, f. 226.

²⁵ Fehmi Agani, *Studime sociologjike*, Prishtinë: ASHAK, 2008, f. 488.

²⁶ Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja*, Pejë: Dukagjin, 1994, 113.

Profesori mbështet tezën se çdo nacionalizëm është i dënueshëm aq sa është, sa mund të shprehet e të imponohet, kurse teza për agresivitetin dhe rrezikun e posaçëm të nacionalizmit të kombeve të reja sikur donte të legjitimonte nacionalizmin dhe hegjemoninë e kombeve të mëdha e “*të vjetra*”²⁷. Nacionalizmi për të është irracionalizëm, në teori e në metodë është reaksion ndaj racionalizmit, është mitizim i kombit, i gjakut, doktrinë e kategorive të mistifikuara²⁸.

Si reaksion ndaj racionalizmit, ata kanë mitizuar kombin serb, gjakun, traditën, racën dhe shtetin serb. Epika u bë histori dhe historia u kthye në mit të serbëve. Enciklopedia jugosllave e vitit 1953 e pranon: “*Visi ku u zhvillua Beteja e Kosovës midis koalicionit të të krishterëve ballkanikë dhe Perandorisë Osmane, më 1389 asokohe u konsiderua “Vis i Shqipërisë”*”²⁹. *Pra vetë serbët e pranojnë se Kosova është tokë shqiptare. Kur iu intereson ndryshojnë mendim dhe thonë se ajo është “tokë e shenjtë serbe, Jeruzalemi serb”*”.

Nacionalizmi edhe në planin etik është jonormal, sepse afirmon synime dhe përmban porosi johumane dhe antihumane. Drejtues të lartë të pushtetit serb, përfaqësues të inteligjencës serbe dhe të Kishës Ortodokse kanë bërë thirrje të vazhdueshme: “*Vritni shqiptarët, kudo që janë, me të gjitha mënyrat e mjetet! Vdekje shqiptarëve! Jashtë shqiptarët!*”

Serbët edhe në kohën e Mbretërisë, edhe në regjimin e Titos e më pas gjatë sundimit të Millosheviqit kanë pasur si qëllim të dominojnë në Jugosllavi, të sundojnë ata dhe vetëm ata, t’i nënshtrojnë e t’i luftojnë me të gjitha mjetet edhe me armë, ata që kundërshtojnë. Ata që janë josllavë, janë përbuzur, janë etiketuar me gjithfarë epitetesh fyese, janë quajtur “*racë inferiore, të prapambetur, kriminelë, barbarë, zullumqarë, despotë, tiranë*” dhe janë privuar nga e drejta për të vetëvendosur. Në shënjestër të tyre kanë qenë, veçanërisht shqiptarët. *Kombin shqiptar e kanë parë jo si një komunitet shoqëror dhe kategori historike, por si një bashkësi johistorike, që përcaktohet nga “gjaku dhe trolli”, me rrënjë dhe karakteristika parësisht biologjike*³⁰.

Në mendimin dhe praktikën serboshoviniste statusi i pakicës nuk përcaktohet vetëm në raport me vetëvendosjen, nuk reduktohet vetëm e drejta e shkëputjes. Përkundrazi, të jesh pakicë do të thotë të mos jesh në vendin tënd, të jesh në shtet të huaj e në mëshirë të huaj. Serbët

²⁷ *Pikëpamja e Dj Uskokoviç, Gledista, 1-2/1983, f. 161, 179.*

²⁸ Fehmi Agani, *Studime sociologjike*, Prishtinë ASHAK, 2008, 504.

²⁹ *Enciklopedia Jugosllavije, V, Zagreb, MCMIXI. 336: Istorija naroda Jugosllavije, II. Beograd, 1953, f. 419.*

³⁰ Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja* (Pejë: Dukagjin, 1994), 114.

shqiptarët i kanë konsideruar pakicë. Slobodan Millosheviçi në fjalimin në Ushqe në fillim të vitit 1999 tha: “Kosova është Serbi! (pra shqiptarët sipas tij janë të huaj, të ardhur këtu), por shqiptarët mund të jetojnë në të, sepse Serbia është zemërgjerë. Ata mund të jetojnë mirë, por të mos jenë të këqij e të mbrapshtë”³¹. Që do të thotë të mos kërkojnë të drejta më shumë, status politik më të lartë, të jenë koloni e Serbisë, të bëjnë atë që iu thonë serbët, të mos i kundërshtojnë për asgjë edhe kur kanë të drejtë, kur pushohen nga puna, u merret prona, u hiqen të drejtat kombëtare, flamuri, arsimimi në gjuhën amtare, shpërngulen me dhunë, burgosen e vriten, ndryshe janë të këqij e të mbrapshtë.

Gazeta “Borba”, organ i partisë ultranacionaliste të Millosheviçit mbledh, gjen dhe publikon teori që janë në interes të saj për të hedhur poshtë e argumentuar (në fakt janë pseudoargumente) parimin e vetëvendosjes:

Mbështetur në një studim të Institutit Aspen (Berlin): “I pakufizuar nga principet e tjera, principi i vetëvendosjes shpie në katastrofë. 10 mijë shtete do të krijoheshin së shpejti”³². Gënjeshtër, gënjeshtër dhe vetëm gënjeshtër! E dinë edhe vetë.

Sipas kësaj gazete: “Vetëvendosja etnike shpie në pastrime etnike”. Kërkojnë të justifikojnë spastrimin etnik të trojeve shqiptare në Kosovë.

Më tutje shkruan: “Parimi i vetëvendosjes duhet të gërshetohet me parime të tjera, siç janë mosndryshimi i kufijve me forcë, respektimi i të drejtave njerëzore dhe i pakicave. Principi i vetëvendosjes nuk guxon “të aplikohet si e drejtë universale, pa kushtëzime dhe pa marrë parasysh pasojat më të gjera”. Ku është parë vetëvendosje nën pushtimin serb?! Qëllimi: të gënjejnë shqiptarët e Kosovës me një “autonomi të zgjeruar”, por duke mbetur realisht Kosova koloni e Serbisë. Kushtëzimet kanë të bëjnë me një zgjidhje kompromisi. Serbia të mos dalë e humbur në marrëveshjen me Kosovën, të fitojë Veriun e pasur. Pasojat e pavarësisë së Kosovës sipas serbëve janë të mëdha: destabilizojnë Ballkanin e më gjerë dhe kërcënojnë paqen, çka është e kundërta.

Gazeta “Borba” citon Thomas Fleiner-in: “Të mos pranohen kombet si subjekte legjitime ndërkombëtare edhe pse pranohet e drejta e tyre për vetëvendosje.... Kushti është të krijojnë shtete.... zgjidhja e problemeve me fqinjët”³³. Pra Kosova të mos njihet ndërkombëtarisht.

³¹ Fehmi Agani, *Studime sociologjike*, Prishtinë ASHAK, 2008, 542.

³² Gazeta *Borba*, 3-4 korrik 1993.

³³ Gazeta *Borba*, 3-4 korrik 1993.

Edhe nëse i jepet statusi i Republikës, ajo të mbetet në kuadrin e Republikës së vogël Federative të Jugosllavisë, ku do të bëjnë pjesë Serbia, Mali i Zi dhe Kosova. Gjithsesi në çdo rrethanë e për çfarëdo zgjidhje të imponuar nga faktori i brendshëm dhe ai ndërkombëtar, Kosova të jetë me Serbinë, vetëm me Serbinë e nën kontrollin e rreptë të qeverisjes së saj.

Pra ata kanë mbajtur një qëndrim injorues, nihilist ndaj shqiptarëve të Kosovës, ndaj qenies dhe identitetit të tyre historik, shoqëror dhe kulturor. Duke qenë, në thelb, një ideologji dhe politikë antiliberale dhe antidemokratike i pengon popujt të vetëvendosin për fatin e tyre, të jenë të lirë, të barabartë dhe të ndërtojnë një sistem demokratik, pa shtypje dhe shfrytëzim.

Paragjykimet, mitet dhe stereotipat e serbëve për shqiptarët e kanë thelluar hendekun midis palëve, kanë rritur mosbesimin midis tyre, kanë krijuar konflikte të reja dhe kundërshtime të mëdha, kanë rritur represionin policor dhe ushtarak të pushtetit serb ndaj shqiptarëve, çka çoi në kryengritjen e armatosur të tyre, e shprehur me UÇK-në që u kurorëzua me çlirimin e Kosovës me mbështetjen e NATO-s dhe të ShBA-së.

Shkaku kryesor i konfrontimeve dhe i tensioneve rreth të drejtës për vetëvendosje dhe realizimit të saj qëndron në interesa të kundërta të shteteve dhe komuniteteve të ndryshme, në konfrontimin e forcave që kërkojnë ndryshime dhe të status quosë. Shqiptarët e Kosovës gjithnjë kanë kërkuar ndryshimin e statusit, një status më të lartë (republikë si kombet e tjera në ish-Jugosllavinë Federative), ndryshimin e status quosë, veçanërisht pas shpërbërjes së Jugosllavisë dhe shtet i pavarur pas çlirimit të saj nga pushtuesit serbë, më 12 qerdhor 1999.

1.4. Memorandumi i ASHS – një kërcënim serioz, drejtuar të gjithëve në ish-Jugosllavi, veçanërisht shqiptarëve

Profesor Fehmi Agani bën përkufizimin e saktë të këtij dokumenti: Manifest i Lëvizjes nacional - shoviniste serbe, burim dhe frymëzues i energjive të saj rrënimtare, karta që *“inicioi krimet dhe çmendinë”*³⁴. E quan tekst ekstremist nationalist, manifest i vërtetë i hegjemonisë dhe i arbitrarizmit serb. Këtë Memorandum, Noel Malcolm e konsideron si: *“një manifest virtual për politikën e “Serbisë së Madhe”, të cilën e ka*

³⁴ Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja*, Pejë: Dukagjin, 1994, 139.

ndjekur Beogradi në vitin 1990. Memorandumi i Akademisë së Serbisë – përbën bërthamën e tezave serbe për zhvillimin e nacionalizmit në shoqërinë e saj. Është një dëshmi se si mund të ndikojnë dhe udhëheq elita intelektuale e një vendi në politikën nacionaliste dhe dhunën etnike deri në masën e masakrave si ajo e Srebrenicës dhe e Kosovës. Memorandumi solli përfundimisht shkatërrimin e Jugosllavisë, por edhe një gjakderdhje të pashembullt në historinë e Pasluftës së Dytë Botërore³⁵.

Si shumë intelektualë të tjerë në Kosovë, Slloveni, Kroaci, Bosnjë, ai kërkon që të hiqet dorë publikisht sa më parë nga idetë e tij. Përse e kërkon këtë? Dhe si lidhet me çështjen e vetëvendosjes së shqiptarëve të Kosovës?

Memorandumi synonte afirmimin dhe realizimin e interesave hegjemoniste serbomëdha. Metoda e tij është metoda tinëzare e lamentit për fatin tragjik të popullit serb, duke fjetur arsyen dhe mobilizuar emocionet në drejtim të qëllimit të synuar³⁶.

Gënjeshtra, trillimi dhe insinuata, projektimi te të tjerët dhe akuzimi i të tjerëve pikërisht për mëkatet vetanake, manipulimi me gjysmë të vërteta, zhvendosja e fakteve dhe përmbysja e konteksteve, argumentimi i dyshimtë dhe konkludimet e paargumentuara, shfrytëzimi i streatipave dhe paragjykimeve të trashëguara – janë disa nga karakteristikat e kësaj metode. Gënjejnë pa pikë turpi dhe trillojnë tezën e mitit serb në Kosovë. Duke folur rreth këtij miti Dobrica Qosiç deklaroi: “*Kosova është vend i shenjtë serb që do të mbrohet nëse është nevoja edhe me armë*”³⁷.

Teza më skandaloze e Memorandumit është pohimi se Serbia dhe serbët në Jugosllavi janë të pabarabartë, të shfrytëzuar, të diskriminuar, se kombi serb nuk ka as të drejtën të ketë shtetin e vet, se serbët në republikat e tjera nuk lejohen të zhvillojnë gjuhën, shkrimin dhe traditat e tyre kulturore. Pozitën e pabarabartë e argumenton me gjoja:

- prapambetjen në zhvillimin ekonomik të Serbisë,
- marrëdhëniet e pazgjdhura shtetërore – juridike me Jugosllavinë dhe krahinat,
- gjenocidin në Kosovë!

Në janar të vitit 1986 u publikua Peticioni i 216 intelektualëve serbë, ku ankoheshin se “*serbët po vuanin gjenocid në Kosovë*”, duke i

³⁵ Enver Bytyçi, *E drejta e vetëvendosjes, rasti i Kosovës*, Tiranë: Koha, 2007, 125.

³⁶ Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja* (Pejë: Dukagjin, 1994), 141.

³⁷ Hivzi Islami, *Studime demografike: 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës*, Prishtinë: ASHAK, 2005, 307.

paraprirë Memorandumit të ASHS-së ku thuhej: “Nga viti 1981 shqiptarët kanë bërë luftë kundër serbëve”³⁸.

Tezat e këtij Memorandumi frymëzuan serbët në Bosnjë e Hercegovinë, Kroaci për t’u ngritur në luftë e për të kërkuar shkëputjen nga këto republika e bashkimin me Serbinë.

Memorandumi kritikon sistemin politik, sepse kënaq interesat e veçanta në dëm të të përgjithshmes. Me këtë kanë parasysh Krahinat Autonome të Kosovës dhe Vojvodinës, kompetencat që ato kanë me Kushtetutën e viti 1974. Sipas tij, autonomia tepër e gjerë dhe institucionalisht shumë e mbështetur e krahinave krijon dy plasaritje të reja në popullin serb dhe çështja e krahinave s’është punë e të tjerëve, por e serbëve dhe e Serbisë. Kërkohen ndryshime që do t’i krijojnë përparësi të tjera zhvillimit të Serbisë, krahasuar me Kroacinë e Slloveninë. Përmendja e hegjemonizmit serb sulmohet për t’iu rrënjësuar serbëve ndjenjën e fajit e të përgjegjësisë historike që duhet të ketë vetëm Serbia. Forcimi i shtetësisë së republikave dhe krahinave dobëson funksionet koordinuese të Federatës, kënaq interesat e veçanta në dëm të të përgjithshmes. Përgjithësisht nuk është efikas sistemi ku për secilin gjë duhet të merret vesh secili me secilin. Memorandumi e supozon si të padiskutueshme ekzistencën e Vojvodinës dhe të Kosovës në kuadër të Serbisë³⁹. Me Kushtetutën e vitit 1974, Kosova më tepër nominalisht ishte në përbërje të Serbisë, jo kurrsesi pjesë përbërëse e saj. Në Memorandumin e Akademisë së Sërbisë është mbështetur Millosheviçi dhe politika e tij, si pikëpamje, si sjellje, si përgjegjësi dhe rikonsideratë.

Thirrja që akademikët serbë bëjnë në këtë rast lidhet me ndryshime të rëndësishme, bile radikale që do të thotë t’u hiqet statusi që ato kanë. Pra akuza kryesore ishte për “pozitën e tashme kushtetuese, plot konflikte të brendshme të Serbisë”, pra pozita e krahinave, autonomia tepër e gjerë dhe institucionalisht shumë e mbështetur e tyre krijon dy plasaritje të reja në popullin serb⁴⁰. Nuk kaluan 3 vjet dhe Krahinave Autonome të Kosovës e të Vojvodinës iu hoq statusi i fituar me Kushtetutën e vitit 1974. Këto ndryshime politike, kushtetuese e kanë frymëzimin nga kauza themelore e Memorandumit, për sa i përket Jugosllavisë se sistemi politik jugosllav i sotëm nuk ka asnjë nga përparësitë e sistemeve politike bashkëkohore dhe si i tillë duhet të ndryshohet ose të përmbysset. Më 28 mars 1989 kur Kuvendi i Serbisë vendosi për këtë,

³⁸ Enver Bytyçi, *Shqiptarët, serbët, grekët*, Tiranë: Koha, 2005, 303.

³⁹ Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja*, Pejë: Dukagjin, 1994, 525.

⁴⁰ Revista Naše teme, 1-2/1989, f. 15.

Milloseviçi deklaroi: “Serbia ka rikthyer sovranitetin e saj shtetëror, kushtetues e ligjor në Kosovë”⁴¹.

Memorandumi parasheh “ekspansionin e shqiptarëve në Kosovë e Jugosllavi”, “ekspansion” ky që do të jetë “kërcënim real dhe i përditshëm për të gjithë popujt e Jugosllavisë”. Për ta ndalur këtë duhen përdorur të gjitha mjetet e mundshme, qofshin ato edhe rapresalie, ndjekje, shpërngulje, madje edhe likuidime fizike. Dobrica Qosiçi akuzon regjimin e Titos se ka shkaktuar ndjekjen e dyqind mijë serbëve, të cilët u gjendën para dilemës ose të bëheshin shqiptarë, ose të iknin⁴². Cila është zgjidhja sipas ASHS-së në këto kushte të rënda për serbët: “Përfshirja në gjirin tonë e territoreve etnikisht të pastra, duke vënë në përdorim mjetet e luftës... Fati i Kosovës mbetet një çështje jetësore për të gjithë serbët e Kosovës”⁴³.

Është dokument i rëndësishëm i synimeve serbosllaviste ndaj Kosovës dhe shqiptarëve, si dhe dëshmi se si do të duhej sipas këtij koncepti të zgjidhej çështja shqiptare në Kosovë:

Porositë e para të tij janë: reduktimi drastik i autonomisë, dealbanizimi, shkëputja e çdo lidhjeje me vendin amë dhe ndryshimi i strukturës etnike të popullsisë.

Shpall platformën se si të thyhen rezistencat që mund të pengojnë realizimin e këtij projekti, duke shpallur vitin 1981 si vit kur iu shpall luftë Serbisë, vërtet speciale, por e hapët dhe totale, e përgatitur në periudha të ndryshme administrative, politike dhe shtetërore administrative. Kërkohet që kjo luftë të përfundojë me “të vetmin rezultat të drejtë të luftës së imponuar... Ishte një shpallje lufte për shqiptarët”⁴⁴. Intelektualët serbë në fund të viteve '80 iu drejtoheshin intelektualëve shqiptarë: “Zotëri, ne jemi në luftë”⁴⁵.

1.5. Vetëvendosja e shqiptarëve dhe Konferenca e Bujanit

Konferenca e Bujanit u mbajt pas Mbledhjes së Dytë të AVNOJ-it të 28 nëntorit 1943, në Jajcë, ku u morën këto vendime:

⁴¹ Agjensia Tanjug, 28.03.1989, Beograd.

⁴² Gazeta Le tempo, 27.07.1989, f. 67.

⁴³ Mirko Grmek, Marc Gjidara, **Neven Šimac, Spastrimi etnik, Tiranë: 55, 2002, 215.**

⁴⁴ Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja*, Pejë: Dukagjin, 1994, 526 - 527.

⁴⁵ Gazeta “Koha Ditore”, 1-2 maj 2004, f. 11.

- Jugosllavia të ndërtohet në parimin federativ si bashkësi shtetërore e popujve të barabartë.
- Popujt e Jugosllavisë nuk e kanë njohur kurrë dhe nuk e njohin copëtimin e Jugosllavisë nga ana e imperialistëve fashistë.
- Jugosllavia ndërtohet dhe do të ndërtohet sipas parimit federativ, i cili do të sigurojë barazinë e plotë të serbëve, të kroatëve, të sllovenëve, të maqedonasve dhe të malazezëve, përkatësisht të popujve të Serbisë, Kroacisë, Sllovenisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe të Bosnjës e Hercegovinës.
- Kuvendi Antifashist i Çlirimit Kombëtar i Jugosllavisë është forum suprem dhe legjislativ e ekzekutiv i popujve të Jugosllavisë dhe përfaqësues suprem i sovranitetit të popujve dhe të shtetit të Jugosllavisë në tërësi.
- Pakicave kombëtare në Jugosllavi do t'u sigurohen të gjitha të drejtat kombëtare⁴⁶.

Tito deklaroi: *“Pse AVNOJ-i në reformim nuk po u drejtohet shqiptarëve? Nëse Jugosllavia ndërton socializmin, ndërsa Shqipëria kapitalizmin – sistem, atëherë Kosova shkon me Jugosllavinë. Nëse Jugosllavia ndërton sistemin kapitalist, ndërsa Shqipëria ndërton sistemin shoqëror socialist, Kosova shkon me Shqipërinë, siç ka vendosur me Rezolutë PKJ-ja në Drezden, më 1928 në kongresin e vet të rregullt”*⁴⁷. Po nëse në të dy vendet ndërtohet sistemi socialist? Kësaj nuk i jep përgjigje dhe i shmanget. Këtu qëndron edhe hilja e pabesia e PKJ-së.

1.5.1. Vendimet e Konferencës së Bujanit dhe mendimi politik i prof. Fehmi Aganit

Duke qenë se çështja shqiptare në Jajcë *“u harrua”*, u injorua sikur nuk ekzistonte fare, me justifikimin se *“do të vendosim për të pas përfundimit të luftës”*, në Bujan u morën vendime të rëndësishme. Koha nuk priste... Në Rezolutën e miratuar thuhet: *“Kosova e Rrafshi i Dukagjinit është një krahinë e banuar në shumicë nga populli shqiptar, i cili, si gjithmonë, ashtu edhe sot dëshiron të bashkohet me Shqipërinë”*. Me këtë Rezolutë në mënyrë burimore shprehet dëshira e popullit shqiptar të Kosovës, që si popull në shumicë dominante të bashkohet me

⁴⁶ Prevo I Drugo, Zasedanje, AVNOJ-a (Beograd, 1953), 227-228, 250-251.

⁴⁷ Hakif Bajrami, Pashtriku. Org. 28.03.2013.

Shqipërinë. Duke u nisur nga këto përcaktime burimore të Konferencës mund të thuhet se Rezoluta e Konferencës së Bujanit është një akt me fuqi konstitutive dhe me garanci ndërkombëtare. Në fakt, Rezoluta e Bujanit paraqet dokumentin themelor të vetëvendosjes së shqiptarëve të Kosovës.

Konferenca e Bujanit është dëshmi e konstituimit mëvetësor politiko-territorial të Kosovës, jashtë dhe pavarësisht nga Serbia, madje relativisht pavarësisht edhe nga Jugosllavia. Ky është vendimi më i rëndësishëm që vuri themelet e një Kosove të mëvetësuar dhe arsyeja kryesore e pakënaqësisë së qarqeve serbo-hegjemoniste me Konferencën e Bujanit dhe sulmeve ndaj saj⁴⁸.

Kërkesat për zgjerim dhe thellim të autonomisë ose ato për Republikën e Kosovës (1968-1981), kërkesat për mbrojtjen e autonomisë, kur ajo ishte e rrezikuar, më 1988-1989, si dhe kërkesat për pavarësi të plotë të Kosovës gjetën dhe gjejnë jo vetëm inspirim, por edhe mbështetje dhe legjitimim në Konferencën e Bujanit dhe vendimet e saj. Këtë ide profesor Fehmi Agani e ka mbrojtur me vendosmëri dhe e ka argumentuar në punimet dhe botimet e tij.

Zbërthimi juridik - politik i Rezolutës nxjerr në pah tri elemente qenësore, që e përcaktojnë të drejtën e vetëvendosjes së popullit shqiptar në Kosovë:

Elementi etnik, sipas të cilit populli shqiptar është ai që vendos, dhe kjo e drejtë e tij buron nga të banuarit dhe shtrirja kompakte në shumicë në atë territor.

Elementi historik, i banueshmërisë së kësaj krahine nga shqiptarët dhe kontinuiteti historik i ekzistimit të saj.

Elementi politik, shprehje e vullnetit politik plebishitar për t'iu bashkuar një shteti, në këtë rast Shqipërisë, si synim shekullor dhe aktual i shqiptarëve të Kosovës.

Për akademik Fehmi Aganin: “*Konferenca e Bujanit dhe vendimet e saj shprehin një realitet kombëtar dhe politik të Kosovës, një vullnet dhe orientim politik të saj. Ato shprehin gjithashtu specifikën e lindjes, të kushteve e të raporteve të Luftës Çlirimtare në Kosovë, ndonëse nominalisht pjesë e LÇJ-së dhe nën drejtimin e PKJ-së, realisht dhe faktikisht ishte apo tentonte të jetë e mëvetësuar, nacionalçlirimtare në kuptimin autentik, objektivisht e pavarur nga strukturat dhe instancat serbe dhe jugosllave e natyrisht e lidhur me Shqipërinë më shumë*

⁴⁸ Fehmi Agani, *Studime sociologjike*, Prishtinë ASHAK, 2008, 430.

se do të donin këto struktura dhe instanca⁴⁹”. Sipas studiuesve të Kosovës Konferenca e Bujanit dhe vendimet e saj ishin një insistim për realizimin e asaj që premtuhej në formë të përgjithësuar, ishin një test sinqeriteti dhe vërtetësie të politikës së deklaruar nga Partia Komuniste Jugosllave. Ky test nuk u kalua me sukses. Sipas prof. Fehmi Aganit këtë e dëshmon më së miri Letra e 28 marsit 1944 e KQPKJ-së, e cila “është shprehje e plotë e tërë demagogjisë, falsitetit dhe ndërgjegjes së papastër të PKJ-së ndaj çështjes së Kosovës dhe të shqiptarëve⁵⁰. Akademiku duke analizuar këtë ngjarje madhore jep edhe arsyet e sulmit ndaj Konferencës së Bujanit nga PKJ-ja dhe shteti jugosllav: “*Sulmi ndaj Konferencës së Bujanit bëhej lidhur me dëshirën e shprehur të shqiptarëve për t’u bashkuar me Shqipërinë.... sulmi është jo vetëm kundër bashkimit me Shqipërinë, por edhe çdo forme të mëvetësisë së saj*⁵¹”.

⁴⁹ Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja* (Pejë: Dukagjin, 1994), 44.

⁵⁰ Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja* (Pejë: Dukagjin, 1994), 44.

⁵¹ Fehmi Agani, *Demokracia, kombi, vetëvendosja* (Pejë: Dukagjin, 1994), 44.

Blerina Rogova Gaxha

LETËRSIA SI DËSHMI: FUQIA E LETËRSISË PËR TA MBAJTUR GJALLË MEMORIEN E LUFTËS

Lufta është një ndër temat dominante në letrat e bukura, po më shumë se një ndikim, lufta priret ta riformësojë letërsinë, dhe më shumë se një temë për të rrëfyer histori, letërsia për luftën gjeneron kontraktat emocionale, intelektuale, sociale dhe politike që zhvillohen gjatë dhe pas saj.

Lufta dhe ndikimi i saj traumatik në letërsi farkohen në shkrirjen mes përvojës individuale dhe kolektive, historike, politike dhe kulturore, por gjithnjë nën hijen e memories. Kujtesa e viktimës ka prodhuar letërsinë e traumës si një lloj borxhi kolektiv dhe personal, duke e kthyer letërsinë në një mekanizëm të qëllimshëm të përzgjedhjes së dëshmimeve reale dhe imagjinare në histori dhe jetë. Kujtimet traumatike janë gjithmonë aty, situatat poetike kësisoj na ofrojnë një hapësirë të përsosur për palimpseste të tilla traumatike.

Kryqëzimi i madh historik në Kosovë në vitet 90: represioni politik, social e ekonomik, lufta, paqja, tranzicioni, kanë prodhuar një sërë fenomenesh socio-kulturore. Kryqëzimet e bartën efektin e vet edhe në letërsi. Shkrimtarët e ndien pulsën e kohës, të ndryshimit apo të mosndryshimit, të asaj çfarë jeta solli apo çfarë asaj i mungoi.

Letërsia si një formë arti që është bërë gjithnjë e më shumë e lidhur me dëshminë duket veçanërisht e përshtatshme për të shprehur jehonën e luftës dhe plagën e traumës. Plaga dhe zëri që vjen nga e kaluara të kërkuara në letërsinë dekadave të fundit, nxjerrin në pah tema themelore, si memoria, trauma, lufta, liria, identiteti, tjetërsimi, faji, vdekja, etj.

Letërsia e dalë nga mitra e luftës shpalos pëlhurën që e mbuloi traumën e thellë, për t'u kthyer në testament letrar të historisë më të re. Duke qenë vetë banorë të luftës, verbi i autorëve del si britmë shpirti, por shkruan njëkohshëm testamentin e lojës bizare të ushtruar mbi një popull. Letërsia e dy dekadave të fundit në Kosovë bëhet storja e madhe e njeriut të këtij vendi, saga nacionale që banohet nga vdekja, fantazmat, por edhe forca rilindëse nga hiri. Ajo është një *zeitgeist* i krijuar

mbi paradigmen e luftës e të pasluftës, një etnopoetikë që i flet kryqezimit të madh historik; një poetikë që shfaq frymën dhe disponimin e një kohe dhe kap gjithë atmosferën e epokës së errët të historisë më të re të Kosovës. Shpirti i epokës, si forcë a si demon i padukshëm që ka dominuar karakteristikat e kohës sonë, nga vitet 90 e këndej, shndërrohen në pamje e imazhe poetike me anë të perceptimeve estetike.

Kjo letërsi shpalos mikroperspektivën e historisë së luftës, amplifikon zërin e viktimave civile, siç amplifikon dhe zërin e njeriut në zgrip të ekzistencës pas viteve 99'. Ajo kontribuon në kuptimin e dinamikës së luftës, por kontributin e madh e jep në të kuptuarit e tronditjes që solli lufta dhe pasojat e saj.

Duke kaluar nga historia në letrat e bukura, nga autobiografia në artistiken, nga dëshmitë faktike në dëshminë fikzionale, letërsia e pasluftës në Kosovë e dokumenton traumën e luftës dhe nocionet komplekse të memories kolektive dhe individuale, për të dëshmuar kështu tronditjen radikale të një shoqërie në kryqëzimin e saj historik dhe luftën si fenomen që e eliminon dëshmitarin e vet. Poezia dhe proza e shkrimtarëve që zgjodhën artin e fjalës për t'u bërë rojtarë të memories së luftës, përforcon zërat traumatikë të heshtur e të shurdhuar të viktimave të luftës mes narrativave mbizotëruese heroike.

Lufta e viteve 1998-1999 në Kosovë i përket historisë së madhe të grahmave të vdekjes në ish-Republikën Socialiste të Jugosllavisë. Ngjarjet që e thyen 'kavanozin e qelqtë' jugosllav, do të përfundonin në Kosovë në fund të viteve 90 në një tjetër luftë brutale për ta fituar pavarësinë.

Konteksti historik dhe politik i Kosovës në periudhën nga shfuqizimi i autonomisë në vitin 1989 dhe ardhja në pushtet e Slllobodan Millosheviqit në fund të viteve 1980, çoi në masat e dhunshme që ndoqën vitin 1991 duke lënë të papunë mijëra shqiptarë të Kosovës. Përfshirja nga ndërmarrjet dhe institucionet publike, përfshirë universitetin, shkollat, spitalet, bankat, radion dhe televizionin, represioni politik dhe dhuna e shtuar policore, çuan në përshkallëzimin e situatës politike, ekonomike e arsimore, e cila shtroi udhën drejt konfliktit të armatosur në territorin e Kosovës. Lufta ndërmjet Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) e Serbisë në njërën anë, dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në tjetrën, nisi më 28 shkurt të vitit 1998 dhe përfundoi kur Aleanca Veri-Atlantike (NATO) ndërhyri duke filluar sulmet ajrore më 24 mars 1999, që rezultuan në tërheqjen e forcave jugosllave nga Kosova, më 10 qershor 1999.

Sipas të dhënave në Librin e Kujtimit të Kosovës, “si pasojë e konfliktit gjatë viteve 1998-1999 dhe pas përfundimit të luftës deri në fund të vitit 2000, 13.535 persona janë vrarë dhe/apo janë zhdukur me dhunë. Nga numri i përgjithshëm i viktimave, 10.317 ishin civilë (prej tyre 8676 shqiptarë, 1196 serbë dhe 445 nga grupet e tjera etnike) dhe 3218 nga forcat e ndryshme të armatosura (prej tyre 2131 nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, 1084 nga forcat e armatosura serbe dhe jugosllave dhe 3 nga forcat e NATO-s). Në anën tjetër, më shumë se 1600 persona ende rezultojnë të zhdukur” (FDHK 2022: 10). Periudha e viteve 1998-1999 u përcoll me zhvendosje në masë të popullsisë brenda vendit dhe në shtetet e rajonit. Më shumë se një milion qytetarë të Kosovës u detyruan me dhunë ta lëshojnë vendin (FDHK 2022: 10; UNHCR 2000: 7; 1999: 6). Përgjatë konfliktit, mijëra gra, vajza, djem e burra qenë viktimë të dhunës seksuale të ushtruar nga forcat policore e ushtarake serbe.

Lufta dhe dhuna e viteve 1998-99 tronditi themelet e shoqërisë, duke shkaktuar përmbysje që lanë pasoja të rënda në çdo aspekt social. Shkatërrimi që solli lufta dhe bishti i gjatë prej komete që la pas do të bëhen themeli mbi të cilat do të ringrihet një shoqëri e tërë. Njeriu i Kosovës, në kohën e *orës zero*, kur vendi po shtrihej në gërmadha, duhej të rilindej nga hiri, dhe ai e bëri këtë, duke u ringritur mbi hirin e luftës.

Fuqia e letërsisë për ta mbajtur gjallë memorien e luftës dhe memorializuar tragjedinë e së shkuarës është e jashtëzakonshme. Imazhet kinematografike dhe mediumet e tjera kulturore na dëftojnë të vërtetën e tyre për luftën, por cila është përgjigja e shkrimtarëve ndaj luftës së fundit në Kosovë?

E kaluara traumatike, ndjenja e humbjes dhe bllokimi brenda një botë të re, nën ndryshimet e mëdha politike, sociale e ekonomike, ka bërë që autorët si vetë përjetues lufte të fokusohen në ndikimin dhe pasojat e saj në individin. Autorë të shumtë kapën realitetin brutal dhe shpesh surreal të të jetuarit nën kërcënimin e vazhdueshëm të dhunës dhe nën realitetet e ashpra. Pamja depresive e pasluftës dhe e kaluara e tmerrshme nëpër të cilën kaloi njeriu i Kosovës, e bëri të pashmangshëm kthimin drejt traumës të së shkuarës, e cila do të ekspozohet artistikisht në letërsi dhe artet e tjera të bukura.

Autorë të ndryshëm fokusohen në transformimet, veçanërisht në mënyrën se si përvojat e luftës e transformojnë jo vetëm individin, por edhe botën përreth. Vrazhdësia dhe lakuriqësia e stilit të tyre, ndjekur nga imazhet shokuese të gjatë dhe pas luftës, do të krijojnë autenticitetin

artistik që të vërtetat t'i thonë të zhveshura në asht, dhe të cilat, jo rallë, përplasen me narrativat heroike.

Premisa se shkrimi është njëkohësisht “një akt kujtese dhe një interpretim i ri, me anë të të cilit çdo tekst i ri gdhendet në hapësirën e kujtesës” (Lachmann 2008: 301), përfaqësimi, transmetimi dhe qar-kullimi i memories së luftës, si dhe roli i memories personale dhe kolektive në formësimin e kuptimeve, qëndrimeve dhe identiteteve, shndërron në orbitë, graviteti i së cilës mban afër një numër të madh autorësh.

Letërsia që flet për luftën, priret të regjistrojë jo vetëm shkaqet dhe zhvillimin e luftës, por dhe mënyrën se si ajo përjetohet, ndjehet, përdoret dhe transformohet nga pjesëmarrësit. Është pikërisht ky element subjektiv ajo çfarë lexuesit kërkojnë në veprat fiksonale, në krahasim me veprat me karakter historik (Brosman 1992: 86); ato sjellin një lloj kënaqësie të ndryshme, për dallim nga njohja e thjeshtë fakteve, si dhe mbajnë një shenjë autenticiteti dhe të vërtetë që, në mënyrë paradoksale, historitë më objektive rrallë e arrijnë (ibid.).

Veprat e shkruara pas viteve 1999 qëndrojnë si ornamente strofike e prozaike që ruajnë gjurmët e atmosferës, vibrimin, vuajtjen, dhimbjen, gëzimin dhe zhgënjimin shpirtëror të viteve të pasluftës. Akoma më e shpirtëzuar dhe më ornamentale realizohet kjo atmosferë në poezi të shumta që vizualizojnë viktimat e luftës, në poezi intime, metafiziko-urbane, elegji e balada të nginjura me protestë, dëshpërim e trishtim. Shkrimi i dhimbjes dhe zisë, apo edhe absurditeti i kohës, krijon një sfond të përgjithshëm të atmosferës së pasluftës. Kjo letërsi sjell rezultate që dëshmojnë fuqinë e letërsisë si medium i kujtesës kulturore (Erl 2008; 2012) për ta mbajtur të gjallë kryqëzimin e madh të jetës gjatë viteve 1998-99 dhe rrjedhimisht, gjurmët e saj.

Hulumtimi i veprave të fjalës së shkruar në poezi dhe në prozë, nuk synon dhënien e një pasqyre të plotë të letërsisë së pasluftës në Kosovë dhe as që pretendon mbulimin e të gjitha tipareve apo karakteristikave që mund të lidhen, në një a në një tjetër mënyrë, me përfaqësimin e së kaluarës. Në vend të kësaj, dua të theksoj përqendrimin në disa tendenca intriguese që dëftojnë mënyrën se si ndërtohet kujtesa e luftës në dhe *nëpërmjet* letërsisë shqipe të Kosovës. Gjithashtu, nuk pretendohet se këto prirje janë karakteristikë ekskluzive e letërsisë shqipe të pasluftës, meqë të tilla hetohen në letërsitë aktuale në rajon, dhe në letërsitë e vendeve të paskonflikteve. Megjithatë, besoj se letrat shqipe të kujtesës na ofrojnë shembuj të veçantë për të kuptuar se si

letërsia mund ta përdorë, transformojë dhe pasqyrojë memorien kolektive dhe individuale të luftës.

Diskutimi këtu alternohet mes dy aspekteve të temës: pretendimit të veçantë për të vërtetën që parashtron letërsia si dëshmi dhe procesit që çon nga katastrofa në krijimtari, duke e kthyer viktimën në *shkrimtar/dëshmitar* me fuqinë e pezullimit të harresës dhe dokumentimit të së vërtetës. Kujtesa e luftës dhe kryqëzimi i saj me konceptin e traumës kërkohet brenda harkut kohor të veprave të shkruara pas lufte, dhe në harkun e veprave ilustrative përbrenda kësaj topike. Pikëpamjet dhe këndvështrimet e autorëve referencialë ofrojnë një sfond gjeopoetik dhe kulturor për një diskutim teorik të aspekteve letrare dhe kulturore të memories dhe traumës - mënyrës në të cilën kujtesa interpretohet dhe ripunohet në mënyrë kritike nga letërsia. Synimi im ka përcaktuar mbështetjen në teoritë letrare e kulturore të memories dhe të traumës dhe zbatimin e koncepteve dhe temave kryesore të diskutuara në këto teori. Fokusi nuk kufizohet vetëm në fenomenin e memories e të traumës dhe në manifestimet e tyre të ndryshme, por pos përqendrimit në kujtimet traumatike, gjithashtu eksplorohet dhe mënyra sesi praktikat kulturore në letërsinë e pasluftës e mobilizojnë kujtesën për një politikë shprese; hulumtohet pra nga paradigma e traumës te pikëpamjet jetës së pasluftës dhe perspektivat në mijëvjeçarin e ri.

Mjeshtëria e memories

Mjeshtëria e artit të memories karakterizohet nga fuqia magjike e mistike e fjalës në përpjekje për ta sjellë në jetë kujtesën, jo vetëm për hir të artit, por për hir të marrëdhënies së ngushtë të artit me jetën. “Letërsia është antropologjikisht kujtesë, sepse ndodh si regjistrim që rrjedh nga memoria” (Rahmani 2008: 166). Pamjet dhe ngjarjet e përjetuara më parë e pushtojnë jetën tonë duke i kombinuar marrëdhëniet mes memories dhe letërsisë, dhe në këtë marrëdhënie *arti mne-monik* luan një rol vendimtar (Lachmann 1997).

A është poeti rojtar i memories, ngjashëm me dragonjtë mitik? A është poeti i aftë ta krijojë muzikën transcendentale që e mbron ekzistencën dhe e gjithë kjo falë fuqisë së tij mnemoteknike, zotërimit të fjalës? Zhbirues të pasioneve dhe botëve që flenë, poetët u frymëzuan nga Muzat, bijat e Mnemozinës dhe Zeusit. Megjithatë, letërsia nuk do të ishte e mundur pa kujtimin e të zakonshmes, ngjarjeve, njerëzve, sendeve, imazheve dhe ideve (Rahmani 2008).

Trurit poetik i kujtohet gjithçka nga jeta e vet si individ. Kthimi drejt vetes në trajtën e kujtesës, është e prishja e letrave në një shoqëri të pasluftës. Memoria u kthehet realiteteve të një kohe tjetër, duke fituar kështu peshë poetike. Po, cila është memoria e luftës në veprën e autorëve që e kanë përjetuar luftën? Cila është dëshmia e tyre letrare, nëse *dëshmitari moral*, siç thekson Margalit “është ai që e përjeton vuajtjen – ai që nuk është vetëm një vëzhgues, por edhe një vuajtës” (2004: 150)?

Kujtesa e viktimës e ka prodhuar letërsinë e traumës si një borxh personal apo si një lloj borxhi kolektiv, duke e shndërruar letërsinë në një mekanizëm të qëllimshëm të përzgjedhjes së dëshmimeve reale dhe imagjinare në histori dhe në jetë.

Pika kthese e luftës, momenti i veçantë historik "në të cilin memoria kristalizohehet dhe sekretohet" (Nora 1989: 7), i shtyu shkrimtarët të reflektojnë në kujtesën dhe në mënyrat se si identiteti është krijuar nga një ndërveprim i çuditshëm dhe shpesh i paparashikueshëm i së shkuarës dhe së tashmes. Rezentimi i memories së luftës në letërsinë e Kosovës luan rol kyç në kuptimin e ndikimit të luftës në shoqëri, duke e thelluar kuptimin e së vërtetës historike. Kujtesa si triumf i mendjes, siç theksohet nga Ender (2005: 3), bëhet kështu një faktor themelor për ta kuptuar procesin e tranzicionit: nevojat e shpirtit të komunitetit dhe përfaqësimin e kësaj fryme në rrëfimet letrare.

Perceptimi i jetës në një shoqëri postkonfliktuale dhe toni pikëllues që e përshkon atë ka prekur edhe imagjinatën e autorëve të letrave shqipe. Megjithëse fikcioni dhe poezia nuk janë të supozuara të ofrojnë dëshmi faktike, “ato mund të na tregojnë se çfarë do të thotë të jesh i traumatizuar” (Hunt 2010: 171). Në këtë mënyrë, marrëdhëniet e ndër-sjella mes historisë, artit dhe letërsisë janë thelbësore dhe shkrimtarët bëhen *arkitektë shembullorë të skenave mnemonike*. “Përmes përshkrimeve të hollësishme të proceseve mnemonike, ata zbulojnë truqet e imagjinatës dhe të ligjërit që sjell në jetë të kaluarën” (Ender 2005: 5). Lufta nuk u imagjinua si një lloj projekcioni fikcional, ajo ishte aty - e ndodhur, e vërtetë, e shtrirë në tërë kompozicionin e me tërë intensitetin e vet - me të paimagjinueshmen, dhunën, terrorin, dramën. Artistët, duke qenë ‘dëshmitarë’ jashtëzakonisht të mprehtë të kohës së tyre, duhet të merren seriozisht si mendimtarë dhe agjentë moralë, argumenton Dançev: veprat e tyre kanë forcë politike dhe etike (2009: 1-5).

Nëse trauma është gjithnjë “historia e një plage që thërret, e cila na drejtohet në përpjekje për ta shpjeguar një realitet apo një të vërtetë

që ka një interpretim të vetëm” (Caruth 1996: 4), përgjigjja e shkrimtarëve ndaj pikëpyetjeve të mëdha rreth luftës dhe përvoja e tyre personale si ‘e përjetuar apo e vëzhguar’, i jep letërsisë me temë luftën një rëndësi jashtëletrare; kjo për shkak të së vërtetës autoriale dhe temës që trajton.

Koncepti i traumës - paralel me konceptin e kujtesës - ka evoluar në lidhje me studimet letrare (Kurtz 2018). Zhvillimi i tij u përshpejtua pas vitit 1990, paralelisht me ndarjen nga komunizmi në Evropën Juglindore. Edhe pse "letërsia e traumës përcaktohet nga identiteti i autorit të saj" (Tal 1996: 17), "të menduarit e arkivit është, në këtë kuptim, jo vetëm një mendim i (nga) kujtesës, por një mendim si histori" (Caruth 2014: 18). Kështu, filozofia e kujtesës është kryesisht e fokusuar në sqarimin e ndërveprimit mes agjencive të ndryshme të mendjes dhe emocioneve, koncepteve e perceptimeve.

Duke e vështruar letërsinë nën dritën e kujtesës "ajo shfaqet si art mnemonik *par excellence*" pohon Lachmann-i (2008: 301). Prandaj, në fokusin tonë është analiza e reagimit letrar ndaj luftës dhe mënyrës se si letërsia si *medium i kujtesës kulturore* (Assman, A. 2012, Assman, J. 2008, Erll 2008) e mban gjallë memorien individuale dhe kolektive të luftës - një faktor ky themelor dhe i domosdoshëm për t'i kuptuar medimet dhe narrativat e humbjeve të luftës. Gjithashtu, argumentohet se letërsia e pasluftës në Kosovë nuk konsiston vetëm në të dëshmuarit e luftës dhe mbajtjen gjallë të memories së luftës, por edhe në kthimin e ngjarjeve të caktuara historike, vendeve apo objekteve në 'lieux de mémoire' (*vende/hapësira të kujtesës*), nëse i referohemi konceptit të njohur të Pierre Nora (1984).

Rikthimi i autorëve në të kaluarën e afërt dëshmon reflektimin mbi mënyrat në të cilat ndërtohet memoria individuale dhe kolektive. Trazirat politike të viteve nëntëdhjetë, lufta dhe tranzicioni i kanë ngacmuar shkrimtarët, të cilët u janë përgjigjur këtyre situatave duke e rikthyer e rindërtuar të shkuarën, për të mos e lënë në harresë; dhe së dyti, lufta si fenomen i ndarjes radikale midis të shkuarës dhe të tashmes i shtyu të reflektojnë ndaj proceseve e kujtimit dhe harresës dhe mënyrës sesi individualja dhe kolektivja ndërveprojnë.

Veprën e shkrimtarëve në shqyrtim mund ta konsiderojmë në termat të cilëve i bën referencë Nalbantian-i si "mjete për çlirimin e procesit të kujtesës dhe katalizimin e saj në imazhe artistike" (2003: 2). Në këtë mënyrë, kujtesa e luftës dhe trauma e reprezentuar në poezi dhe në prozë kallëzojnë "për preokupimet tona me katastrofën, kujtesën dhe vështirësitë e mëdha që duket se ekzistojnë në negocimin mes botës së

brendshme dhe të jashtme” (Roth 90-91). Poetë e prozatorë, vepra e të cilëve na ofron një dimension tjetër të së kaluarës, diktojnë se memoria reprezentohet herë si dëshmi e herë si dokument, herë tjetër del si projektion i pastër imagjinar/fiksional. Kjo letërsi na kujton se memoria ka forma të ndryshme të reprezentimit. Por, duket se memoria mbijeton përmes një diskursi që është gjithnjë i motivuar emocionalisht dhe i përdorur intelektualisht, prandaj ka kuptim të këmbëngulësh se “jeta kuptimplote është jeta e kujtesës reflektuese, jo jeta e përvojave të verbëra” (Margalit 2004: 134).

Letërsia dhe lufta

Letërsia për luftën është një letërsi paradoksesh, më i madhi ndër ta është fakti se e komenton vazhdimisht paaftësinë e vet për ta përshkruar realitetin e vërtetë. Lufta ka qenë përherë temë mbizotëruese në letërsi, nga sagat e lashta, baladat e këngët popullore, poezitë elegjiake, romancat arthuriane, “Lufta dhe paqja” e Tolstoit, e deri te letërsia e luftërave botërore: lufta e ka ndryshuar perceptimin njerëzor mbi botën dhe i ka ndryshuar po ashtu edhe vetë pëlhurat e letërsisë.

Letërsia evropiane dhe ajo botërore që në fillimet e tyre janë përshkruar nga lufta dhe kohërat e luftës. Gilgameshi vret demin e shenjtë të perëndeshës Ishtar dhe Akili nënshtron Trojanët dhe vret Hektorin. Të dy heronjtë e veprave më të vjetra letrare, Gilgameshi dhe Akili, e dëshirojnë pavdekësinë, dëshira që çojnë në vrasje dhe luftë. Si “Epi i Gilgameshit”, ashtu dhe “Iliada”, janë projektuar në një botë të etikës heroike që lakmon arritjen e pavdekësisë duke mposhtur armikun. Ashtu si lufta, përpjekja për kuptimin e saj dhe dilemat për arsyetimin e vrasjes, janë gjithashtu tema të letrave të përbotshme.

Nga ky këndvështrim, letërsia për luftën është njëkohësisht edhe letërsi kundër luftës. Studimet letrare përqipen të kuptojnë luftën në letërsi nëpërmjet analizës historike-letrare, analizës narratologjike dhe interpretimit kulturor (Žunkovič 2022: 7). Në të parën kërkojmë karakteristikat e ligjërimit letrar të luftës dhe lidhjet apo dallimet e tij me ligjërimit e tjera; në të dytën, kërkojmë reprezentimet letrare të luftës; dhe në të tretën, kërkojmë kontekstin kulturor të reprezentimit letrar të luftës, siç është trauma në letërsi. Mirëpo, ndër të tre aspektet, veçoria më e rëndësishme e letërsisë së luftës mbetet në dimensionin e saj eksperimental, pohon Žunkovič. “Trajtimet letrare të luftës ruajnë të vërtete-

tën e tyre, të cilën as librat e historisë, as esetë, as dëshmitë e dëshmitarëve nuk mund ta arrijnë në mënyrë të barabartë (ibid.7-8). E vërteta e tyre është e vërteta e individit që e përjeton luftën në kontekstin e rrethanave personale, të përcaktuara nga situata sociale, perspektiva kombëtare e personale, reflektimi ekzistencial, përvoja e vdekjes dhe vdekshmërisë, si dhe nga kuptimi, shpresa, nostalgjia dhe dashuria” (Žunkovič 7-8). Natyrisht, letërsia mund të trajtojë çështjet sociale ose shkaqet ideologjike të luftës, qëllimet e vërteta të palëve ndërluftuese dhe pasojat historike të luftërave, por “detyra e vërtetë e letërsisë duket se është të tregojë se si individët e gjejnë veten në këto rrethana dhe situata historike” (ibid.).

Letërsia ka të bëjë më shumë se me faktet, me përshkrimet e përvojave reale të një individit ose me përvoja që duken të besueshme dhe bindëse për lexuesin. Përmes leximit, ne njohim dhe përjetojmë luftën siç e shohin të tjerët - ne njohim dhe përjetojmë lavdinë e luftës, por edhe vuajtjen dhe pafuqinë, humanitetin dhe ligësinë, intolerancën dhe urrejtjen, prandaj “ndikimi i letërsisë që e paraqet luftën nuk është kurrë vetëm estetik, por edhe social, moral dhe psikologjik” (ibid.).

Përmbyllje

Lufta dhe paqja do të sillnin pashmangshëm letërsinë post-traumatike, traumën si prani dhe pasojë aktive. Perceptimi traumatik dhe shkrimi bëhen kështu aleatë të perceptimit historik, i cili, dukshëm apo jo, shkrihet në diskursin dëshmues. Ato zbulojnë gjithashtu rëndësinë e identitetit individual dhe kolektiv të kërcënuar nga dhuna e luftës e cila i fshin njerëzit e zakonshëm, siç zbulojnë dhe kompleksitetin e marrëdhënieve që dehumanizojnë njerëzit duke krijuar identitete kolektive homogjene.

Letrat e pasluftës në Kosovë, janë dëftuese të rrugëve në të cilat letërsia si art i fjalës jo vetëm që e risjell dhe e rindërton të kaluarën, por gjithashtu reflekton në kuptimin e realitetit të ri dhe ndjenjën e përkatësisë, siç ofron edhe mundësinë e eksplorimit të një bote që ringrihet mbi rrënojat e së shkuarës.

Vepra letrare e trajtuar në këtë kornizë mbetet brenda poetikës së kujtesës, por njëkohshëm shkruan dhe biografinë e njeriut të shkelur kosovar si mikrokozmos i njerëzimit. Me dëshmi efektive (auto) biografike dhe poetike të krimeve kundër njerëzimit, poezia dhe proza amplifikojnë zërin drejtuar kundër idesë së luftës dhe çdo lloj terrori.

Hulumtimi i reprezentimit letrar të luftës në letërsinë e Kosovës vëzhgon interpretimin poetik të tronditjes dhe shkatërrimit që solli lufta, si dhe gjurmët e zgjatura në realitetin e pasluftës. Nga kjo perspektivë, kemi hetuar se poezia dhe proza me referencë luftën, si fenomen dhe si rrjedhojë, mëton të regjistrojë e të dokumentojë mënyrën se si ajo përjetohet, përdoret dhe transformohet nga krijuesit.

Reprezentimi i memories dhe traumës së luftës në letërsi, jo vetëm se e mban të gjallë memoriën kolektive, por eksploron gjithashtu një botë të paskonfliktit dhe mënyrën se si identiteti rifomësohet në rrethana të tronditjeve të mëdha historiko-politike.

Në përputhje me hipotezën tonë, lufta dhe pasojat e saj e kanë riformësuar letërsinë në Kosovë, duke sjellë motive dhe tema të përqendruara rreth luftës, kujtesës dhe identitetit, reflektuar në të njëjtën kohë në ndërlidhjen mes së shkuarës dhe së tashmes. Reagimi dhe revolta ndaj skenës publike, etike dhe politike, qasjet e ndryshme ndaj realitetit dhe gjuha e drejtpërdrejtë e kritike, janë gjithashtu disa nga pikat kryesore që kemi identifikuar.

Rikujtojmë këtu pohimin e Nalbantian-it se “vepra letrare mund të hulumtohet me qëllim përfitimi të historive të ndryshme e të shumta që tregojnë për një sërë operacionesh të kujtesës njerëzore” (2003: 3). Ndërveprimi i fiksionit dhe të vërtetës shpesh shkon dorë për dorë, pa e përjashtuar njëra-tjetrën, prandaj mbështetemi në argumentin e Caruth “se të menduarit e arkivit nuk është vetëm një mendim i kujtesës, por dhe një mendim si histori” (2014: 18).

Konsiderojmë se kontributi i veprës së shkrimtarëve sjell një kuptim më të gjerë të luftës së viteve 1998-99 në Kosovë dhe ndikimit të saj. Rrëfimet letrare shpalosin mikroperspektivën e historisë së luftës nga këndvështrime dhe qasje të ndryshme, duke amplifikuar kështu zërat e viktimave, por edhe duke përforcuar zërin e njeriut në tranzicion dhe luftën e tij për mbijetesë dhe fuqizim. Kjo vepër po aq sa jep deshimin letrare të luftës, flet edhe për sfidat e drejtësisë tranzicionale dhe integritit social në Kosovë, duke dëftuar rolin e viktimave dhe të mbijetuarve të të gjitha kategorive në kuptimin e luftës dhe në ndërtimin e memories kolektive.

Përderisa lufta është një përvojë intensive personale për individët që bëhen pjesë e saj, ajo është një veprimtari tërësisht publike. Lufta e ka më se të nevojshme të ketë kujtesën fiktive, interpretimin shpirtëror dhe emocional që shkon paralelisht me të vërtetën, dhe e cila u ofron lexuesve një këndvështrim tjetër mbi kuptimet dhe interpretimet, për të

vetmin fakt se “aftësia jonë për t’i dokumentuar përvojat e kaluara, i mbron themelet e individualitetit njerëzor” (Ender 2005: 3).

Letrat e kujtesës kanë peshën e madhe si një kundërpërgjigje ndaj harresës: ato nxisin e inspirojnë krijimin e rrëfimeve autentike të cilat nga një *dëshmi* autoriale, bëhen dëshmi e të tjerëve. Rrëfimet për luftën dhe gjurmët e luftës në shoqëri, mbërthejnë një kuptim më gjithëpërfshirës dhe ekzistencial të aspekteve universale të ekzistencës njerëzore. Është e evidente se transmetimi i memories kolektive dhe individuale të luftës dhe trauma si pasojë, janë ende në fazat e para të reprezentimit letrar. Lufta e viteve 1998-1999 në Kosovë do të ketë padyshim ‘interpretime të reja’ në ligjërimin letrar në vazhdim. Parashihet se pasojat e luftës do të kenë një ndikim esencial në letërsinë bashkëkohore dhe do të vazhdojnë ta formësojnë pamjen e letrave të bukura në dekadat në vijim.

Referencat

- Assman, A., 2012. *Cultural Memory and Western Civilization: Functions, Media, Archives*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Assmann, J., 2008. Communicative and Cultural Memory. ed., Erll, A. and Nünning, A., *Cultural Memory Studies. An International and Interdisciplinary Handbook*, 109- 119. Berlin/New York: De Gruyter.
- Brosman, C., S. 1992. The Functions of War Literature. *South Central Review*, 9(1), 85–98. <https://doi.org/10.2307/3189388>
- Caruth, C., 1996. *Unclaimed Experience: Trauma, Narrative, and History*. Baltimore and London: The Johns Hopkins University Press.
- Caruth, C., 2014. After the End: Psychoanalysis in the Ashes of History. ed., Nadal, M. and Calvo, M. *Trauma in Contemporary Literature: Narrative and Representation*. New York & London: Routledge, 17–34.
- Cornis-Pope, M., Neubauer, J., eds. 2004. *History of the Literary Cultures of East-Central Europe, II*. Amsterdam: John Benjamins Publishing Company.
- Danchev, A. 2009. *On Art and War and Terror*. Edinburgh. UK. Edinburgh University Press
- Ender, E., 2005. *Architexts of Memory: Literature, Science, and Autobiography*. Ann Arbor: University of Michigan Press.
- Erll, A. and Nünning, A., ed., 2008. *Cultural Memory Studies. An International and Interdisciplinary Handbook*. Berlin / New York: De Gruyter.
- Erll, A., 2008. Literature, Film, and the Mediality of Cultural Memory. ed., Erll, A. and Nünning, A. *Cultural Memory Studies. An International and Interdisciplinary Handbook*. 389-398. Berlin / New York: De Gruyter.
- Feldman, A. 2019. War Under Erasure: Contretemps, Disappearance, Anthropophagy, Survivance. *Theory & Event*, Volume 22, Number 1, January 2019, pp. 175-203. Johns Hopkins University Press.
- Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë. 2015. *Libër Kujtimi i Kosovës 1998-2000*. Prishtinë.
- Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë. 2022. *Memorializimi: Roli dhe rëndësia e tij në ballafaqimin me të kaluarën*. Prishtinë
- Hunt, N. C., 2010. *Memory, War and Trauma*. Cambridge: Cambridge University Press.

- Human Rights Watch. 1998. Human Rights Watch interviews, Gornje Obrinje, November 14, 1998. <https://www.hrw.org/reports/1999/kosovo/index.htm>
- The Institute for War & Peace Reporting, 2005: <https://iwpr.net/global-voices/investigation-serbia-more-mackatica-body-burning-revelations>
- Krasniqi, N., 2016. Letërsia e Kosovës 1953-2000. Prishtinë. AIKD.
- Krasniqi, J. 2013. Pro et Contra: Idrizi “intelektual monstër”, Krasniqi “fashist primitiv”. Available at: <https://telegrafi.com/pro-et-contra-idrizi-intelektual-monster-krasniqi-fashist-primitiv/>
- Kurtz, J. R., ed. 2018. Trauma and Literature. New York: Cambridge University Press.
- Lachmann, R., 1997. Memory and Literature: Intertextuality in Russian Modernism, University of Minnesota Press.
- Lachmann, R. 2008. Mnemonic and Intertextual Aspects of Literature. *Cultural Memory Studies- An International and Interdisciplinary Handbook*. Edited by Astrid Erll, Ansgar Nünning. 301-311. Berlin, New York, Walter de Gruyter.
- The Humanitarian Law Center (HLC)., 2015. "Kosovo Memory Book Database Presentation and Expert Evaluation"
- Margalit, A. 2004. The Ethics of Memory. Cambridge, MA; London: Harvard University Press.
- Memorializimi. 2022. Fondi për të drejtën Humanitare Kosovë. Prishtinë.
- Nalbantian, S., 2003. Memory in Literature: From Rousseau to Neuroscience. New York: Palgrave Macmillan.
- Nadal, M., Calvo, M., 2014. Trauma in Contemporary Literature: Narrative and Representation. New York & London: Routledge.
- Nora, P., 1996 -1998. Realms of Memory: The Construction of the French Past, Volume 1. Ed. by P.Nora and L. D. Kritzman. Transld. by A.Goldhammer. New York: Columbia University Press
- Nora, P., 1989. "Between Memory and History: Les Lieux de Mémoire" (PDF). Representations: 7–24. doi:10.2307/2928520. JSTOR 2928520.
- Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE), Office for Democratic Institutions and Human Rights. 2003. *Kosovo/Kosova as seen, as told*. Documents - reports. <https://www.osce.org/files/f/documents/d/d/17772.pdf>
- UNHCR. 2000. Kriza e refugjatëve në Kosovë- një vlerësim i pavarur i gatishmërisë dhe reagimit ndaj emergjencave të UNHCR-së. Pdf.: <https://www.unhcr.org/media/unhcr-global-report-1999-kosovo-emergency>

Rrahmani, K., 2012. Një hyrje shkurte në letrat bashkëkohore shqipe. Prishtinë. AIKD.

Rrahmani, K., 2008. Antropoetikë- Një confession. Prishtinë. AIKD

Žunkovič, I., 2022. Literature and War (An Introduction). *Primerjalna književnost* (45) 2. E qasshme në: https://ojs-gr.zrc-sazu.si/primerjalna_knjizevnost/issue/view/718/322.

Hivzi Islami, Prishtinë

KONCEPTIMI I BALLKANIT, KOSOVA DHE HILET E EUROPËS “PLAKË”

Abstrakt

Në artikull gjithë materia përmbledhet në sa vijon: konceptimi dhe përcaktimi hapësinor i Ballkanit; Ballkani si histori e dhunës; Periudha postimperiale pas vitit 1919; Çarja më e madhe politike e Ballkanit këtë shekullin e fundit; Projektimi i “Serbisë së Madhe” dhe heroizimi i serbëve sipas Cvijiqit; Shkarja e realitetit politik në Europë pas “Luftës së Ftohtë”; Aventurat dhe popullizimi i Qeverisë Kurti; Hilet e kontinentit “plak” dhe BE-së ndaj Kosovës; Konfrontimi i regjimit hegjemonist serb me shqiptarët deri në rrënimin e subjektivitetit autonom të Kosovës (1989); Disa versione serbe të zgjidhjes së çështjes së Kosovës; Politikat hegjemoniste, kolonialiste dhe kolonizuese serbe ndaj Kosovës dhe shqiptarëve; Gënjeshtrat e regjimit të Millosheviqit për shpërnguljen e serbëve kinse nën presion të shqiptarëve; Agresioni rus në Ukrainë dhe ndikimi i tij në Ballkan dhe trimërimi i Serbisë zyrtare në planin prorus; Veprimi terrorist serb në dhe rreth Manastirit të Banjskës, në afërsi të Zveçanit më 24 shtator 2023.

Fjalët çelës: Konceptimi i Ballkanit, Kosova, hilet e Europës, gabimet e Qeverisë Kurti, hegjemonizmi serb, gjeopolitikat antishqiptare të Serbisë, Cvijiqi dhe heroizimi i popullit serb, Andriqi, Çubrilloviqi, Memorandumi i SANU-së, agresioni rus në Ukrainë, veprimi terrorist në Banjskë

Shqyrtime hyrëse

Për Ballkanin përdoren disa emërtime dhe ende është diskutabil përcaktimi i tij hapësinor, varësisht nga cili interes dhe këndvështrim trajtohet. Ballkani ose Gadishulli Ballkanik gjatë gjithë historisë së tij ishte skenë e lëvizjeve, kontakteve e konflikteve të popujve dhe kryqëzimit e shtresëzimit të kulturave dhe civilizimeve të ndryshme. Gadishulli ishte dhe mbeti nyja më neuralgjike historiko-politike, gjeopolitike dhe etnodemografike, duke prodhuar histori me bollëk. Evropa e më vonë edhe gjithë bota tashmë u lodhën me problemet e Ballkanit dhe mentalitetin e tij. Prandaj, politikani i madh angloeuropian, Sir W. Churchill (1874-1965), në kujtimet e tij, kishte theksuar se “Ballkani prodhon më shumë probleme se sa që mund t’i zgjidhë”!

Mirëpo, në përpjekje për dominim “Europa e plakë” vazhdimisht e ka nxitur destabilizimin e përgjithshëm të Ballkanit, sikundër edhe Rusia për shkak të interesave të saj të kahershme pansllaviste në këtë rajon. “Aleancat e Luftës I Botërore, Serbia dhe Greqia, i mbajtën shumicën e pushtimeve të tyre. Këtu e ka zanafillën diplomatike-historike edhe konflikti i Kosovës, pasi përkundër propozimit austro-hungarez që t’i jepej Shqipërisë pjesa perëndimore me shumicë shqiptare e Kosovës së sotme, Rusia dhe Franca arritën të vënin në zbatim interesat serbe. Shqiptarët në Ballkan për herë të parë në historinë e tyre u ndanë në shtete të ndryshme”.¹

Regjimi i Millosheviqit, me qëllim të krijimit të Serbisë së Madhe, në vitet ‘90 të shekullit të kaluar, i nxiti dhe i humbi tri luftëra: në Kroaci, në B e H dhe në Kosovë, duke lënë pas tragjedi masive njëzëzore dhe materiale. Edhe sot e gjithë ditën Ballkani mbeti politikisht i pastabilizuar dhe i përshkuar nga tensione dhe konflikte ndëretnike në dimensione të reja strukturore. Dallohet sidomos pjesa qendrore e tij, më saktësisht Kosova e sotme dhe viset e tjera etnike shqiptare përreth, përfshirë Luginën e Preshevës, me një pozitë të ndërlikuar gjeohapësinore dhe gati një shekull e gjysmë me hekurudhë dhe rrugë automobilistike. Në BE ende nuk kanë hyrë Shqipëria, Maqedonia, Kosova, Serbia, Mali i Zi dhe B e H. Kosova ishte futur në një geto të pakuptimtë, duke mbetur jashtë të drejtës për lëvizje të lirë në hapësinën e BE-së. Vetëm nga 1 janari 2024 qytetarët e Kosovës mund të lëvizin lirshëm në këtë hapësinë.

Problem qendror në këto shqyrtime janë përcaktimi hapësinor i Ballkanit, “heroizimi” i popullit serb dhe “superioriteti gjenetik” i tij, politikat hegjemoniste, kolonialiste dhe kolonizuese serbe ndaj Kosovës dhe shqiptarëve dhe hilet e “Europës plakë” ndaj çështjes shqiptare, në veçanti këto 100 vjetët e fundit, pas shturrjes së tri Perandorive: Otomane, Austro-Hungareze dhe Ruse, kur u tentua që mosmarrëveshjet dhe konfliktet të zgjidheshin me dhunë, sikundër që historia e këtij rajoni, siç thekson historiani i njohur O. J. Schmitt, shihet si histori e dhunës, përkatësisht si “fuçi baruti”. Sipas tij, periudha pas shturrjes së këtyre perandorive njihet si periudhë postimperiale, në të cilën ndodhi edhe çarja më e madhe në historinë politike të Ballkanit!²

¹ O. J. Schmitt, *Shqiptarët – një histori midis Lindjes dhe Perëndimit*, Shtëpia Botuese K&B, Tiranë, 2012, f. 169.

² O. J. Schmitt, *Ballkani në shekullin XX, Një histori post-imperiale*, “Botime Artini”, Prishtinë, 2001, ff. 1-639 (E përktheu nga gjermanishtja Shkumbin Brestovci).

Konceptimi dhe përcaktimi hapësinor i Ballkanit

Shumë studiues janë marrë me problemin e Ballkanit, por jo të gjithë me përcaktim hapësinor të tij. Më tepër janë marrë me dimensionin historik dhe të qytetërimit, çfarë janë p.sh. historianët e njohur Georges Castellan³ dhe Ferdinand Schevill.⁴ Prof. Oliver J. Schmitt e shkroi një histori më të mirë për Ballkanin, me theks të veçantë për periudhën post-imperiale, pas shthurjes së tri perandorive: Otomane, Austro-Hungareze dhe Ruse para një shekulli. Pa këtë studim nuk mund të kuptohen zhvillimet historiko-politike dhe shoqërore në Gadishullin Ballkanik këto 100 vjetët e fundit.⁵

Që në fillim duhet të jepet një shpjegim për emrin, nocionin, konceptimin dhe përkufizimin territorial të Ballkanit. Është i njohur fakti se “Ballkani” njihet edhe me emrat “Gadishulli Ballkanik”, “Siujdhesa Ballkanike” ose “Europa Juglindore”. Emri “Ballkan” vjen nga mali Ballkan, siç e ka quajtur gjeologu dhe natyralisti Ami Boué (1794-1881),⁶ sipas malit Ballkan apo Stara Pllanina, siç e quajnë bullgarët dhe serbët. Fjala Ballkan është me prejardhje turke, që do të thotë mal. Sipas Boué-së⁷ dhe të tjerëve para dhe pas tij, të gjitha vendet në jug të Stara Pllaninës e përbëjnë Ballkanin (Bullgaria, Maqedonia, Shqipëria, Greqia). Si siujdhesë është e papërcaktuar mirë. Në literaturën profesionale dhe në botime enciklopedike ekzistojnë disa definicione për përkufizimin e kësaj hapësire. Veçanërisht paraqitet i paqartë kufiri verior.

Sipas një pikëpamjeje, kufiri natyror në veri shkon përgjatë lumenjve Danub-Sava-Kupa deri te Gjiri i Rjekës, që është konsideruar deri vonë edhe si kufi kulturor dhe politik. Edhe pse nuk bëhet fjalë për siujdhesë të vërtetë, megjithatë, ky emërtim është përdorur për një rajon

³ G. Castellan, *Histoire des Balkans (XIVe - XXe siècle)*, Librairie Arthème Fayard, Paris, 1991.

⁴ F. Schevill, *Ballkani. Historia dhe qytetërimi*, Shtëpia botuese « Eugen », Tiranë, 2002.

⁵ O. J. Schmitt, *Ballkani në shekullin XX, Një histori post-imperiale*, “Botime Artini”, Prishtinë, 2001, ff. 1-639 (E përktheu nga gjermanishtja Shkumbin Brestovci).

⁶ A. Boué, *La Turqui D’Europe V4 (1840)*, Paris, 1840.

⁷ Ami Boué bëri tri udhëtime studimore në Gadishullin Ballkanik. Ndonëse ishte natyralist, ai një pjesë të veprës së tij ia kushtoi edhe Shqipërisë dhe shqiptarëve, prandaj konsiderohej edhe ndër albanologët e parë (Shih më hollësisht studimin shterues për veprimtarinë e këtij dijetari në: A. Papa, “Ami Boué: një dashamirës i hershëm i Shqipërisë dhe i shqiptarëve”, *Studime*, 13, AHAK, Prishtinë, 2006, ff. 249-268).

më të gjerë. Sipas pikëpamjes tjetër, veçanërisht të gjeografëve serbë (J. Cvijiqi etj.), Siudhësa ka shtrirje më të gjerë dhe shkon përgjatë Danubit, Savës deri te Ljubljansko Barje dhe lumi Idrica në Soçë, duke përfshirë Adriatikun Verior. Shtrihet përgjithësisht ndërmjet detit Adriatik në perëndim dhe Detit të Zi, Marmara dhe Egje në lindje, përgjatë rrjedhjes së poshtme të Danubit dhe luginës së Savës në veri dhe deri te deti Mesdhe në jug.⁸ Pikëpamja serbe, përmes këtij versioni, ka pasur për qëllim zgjerimin e aspiratave dhe dominimin e serbizmit në gjithë territoret e sllavëve të jugut.⁹ Me kufirin perëndimor të Ballkanit deri në Soçë, që e mbështeste J. Cvijiqi, nuk pajtoheshin dijetarët dhe gjeografët e njohur të kohës, si p. sh. akademiku i njohur slloven Anton Melik¹⁰ dhe akademiku në zë kroat Josip Rogliq.¹¹

Ndërkaq, historiania bullgare Maria Todorova në veprën e saj “Imagining the Balkans” thotë se “gjeografët dhe historianët provojnë ta definojnë Ballkanin, duke u mbështetur kryesisht në karakteristikat fizike, prandaj nuk kanë lidhje me dekontekstualizimin e mëvonshëm të nocionit të Ballkanit. Gjeografët, sipas rregullit, e pranojnë që Gadishulli është i përkufizuar qartë me dete në lindje, në jug e perëndim, ndërsa e përqendrojnë debatin e tyre në kufirin verior dhe veriperëndimor. Pikërisht në këtë segment, në diskursin e tyre përfshihen kriteret historike dhe kulturore, ndonëse këto shpesh të maskuara nga arsyet e supozuara gjeografike. Sipas Cvijiqit lumenjtë e Danubit dhe Savës duhet marrë si kufij veriorë të Gadishullit Ballkanik.¹² Me këtë rast ai

⁸ Këtë pikëpamje serbe e gjejmë kryesisht në veprat e J. Cvijiqit. Shih: J. Cvijić J., *Balkansko poluostrvo i južnoslovenske zemlje. Osnovi antropogeografije*, “Državna štamparija”, Beograd, 1922; *Balkansko poluostrvo i južnoslovenske zemlje. Osnovi antropogeografije*, Knj. I-II, “Zavod za izdavanje udžbenika socijalističke republike Srbije”, Beograd, 1966.

⁹ H. Islami-A. Ejupi, *Ballkani*, në *Fjalori enciklopedik i Kosovës, I, A-K*, ASHAK, 2018, f. 110.

¹⁰ A. Melik, “Meja med Balkanskim poluotokom in evropskim trupom”, *Glasnik Srpskog geografskog društva*, XIV, Beograd, 1928, str. 107-121.

¹¹ J. Roglić, “O geografskom položaju i ekonomskom razvoju FNR Jugoslavije”, *Geografski glasnik*, 11-12, Zagreb, 1950, str. 7-16.

¹² Brigjet perëndimore të Gadishullit lagen nga ujërat e deteve Adriatik dhe Jon, ndërsa në lindje lagen nga ujërat e deteve Egje, Marmara dhe Detit të Zi. Këto të fundit përmes ngushticave të Bosforit dhe Dardaneleve mundësojnë komunikimin me Gadishullin e Azisë së Vogël. Në anën e kundërt, Kanali i Otrantos, i gjerë vetëm 75 km² e ndan Gadishullin Ballkanik nga ai Apenin. Varësisht nga përcaktimi hapësinor është edhe madhësia e Ballkanit, që sillet midis 475.000 deri 785.000 km². Diku e gjejmë se Gadishulli Ballkanik ka një shtrirje prej 950 km në drejtim veri-jug dhe 1.200 km në drejtim lindje-perëndim (H. Islami-A. Ejupi, *Ballkani*, në “*Fjalori enciklopedik i Kosovës, I, A-K*”, ASHAK, 2018, f. 110).

qartë e përjashton Rumaninë nga vështrimi i tij si komponent po aq edhe kontravers. Në anën tjetër, Cvijiqi bën një përjashtim kur flitet për sllavët e jugut, duke përdorur kriterin politik dhe antropologjik, ashtu që sllovenët dhe kroatët i përfshinë në të ashtuquajturin civilizim ballkanik”.¹³ Oliver J. Schmitt në një studim mbi albanologjinë si detyrë shkencore nënvizon se “Debati i filluar nga Maria Todorova në lidhje me keqpërdorimin e termit “Ballkan” shtyu shumë studiues të kalojnë në termin Europë Juglindore...por siç tregohet në një hap të dytë, termi “Ballkan” është politizuar po ashtu ashpër brenda vetë Ballkanit nga intelektualë dhe studiues ashtu si edhe jashtë rajonit”.¹⁴

Në kufijtë e përmendur, sipas vlerësimeve, Ballkani përfshin këto njësi territoriale shtetërore: Bullgarinë (100%), Maqedoninë (100%), Greqinë (85%, pa ujëdhesa), Shqipërinë (100%), Kosovën ((100%), Malin e Zi (95 %, pa Bokën), B e H (100%), pjesë të Kroacisë (47%), një pjesë të madhe të Serbisë (75%, pa Vojvodinën), Rumaninë (9%, Dobruxha) dhe pjesën evropiane të Turqisë (5%, Rumelia). Në Ballkan, në kufijtë e gjerë të tij, jetojnë shumë popuj: grekët (10.8 milionë), turqit (9.2 milionë në pjesën evropiane), serbët (6.2 milionë), bullgarët (7 milionë), shqiptarët (7 milionë), boshnjakët (4.4 milionë), maqedonasit (1.4 milionë), rumunët (22 milionë), kroatët (4.5 milionë), malazezët (0.4 milionë), me kultura, gjuhë, besime, zakone të ndryshme etj. Në fillim të viteve 20 të shek. XXI këto shifra janë dukshëm më të vogla për shkak të emigrimit të madh të popullsisë; secili vend ka humbur qindra mijëra dhe miliona banorë. Religjionet kryesore janë ortodokse, katolike dhe islame. Politikisht Ballkanit i përkasin Greqia, Bullgaria, Serbia, Shqipëria, Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, B e H, Rumania dhe Turqia. Kufiri fiziko-geografik i tij nuk përputhet me kufirin etnografiko-politik. Kroacia dhe kroatët nuk pranojnë të jenë pjesë as e ”Ballkanit”, as e ”Siujdhesës Ballkanike” e as e ”Ballkanit Perëndimor” me arsyetim se emri Ballkan ka domethënie përbuzëse, pezhorative, të varfërisë, të konflikteve etj. Për Slloveninë dhe sllovenët, që Cvijiqi i fuste në kornizën ballkanike, as që mund të bisedohet.¹⁵

¹³ M. Todorova, *Imaginarni Ballkan*, “Biblioteka XX vek”, Beograd, 2006, str. 91-92.

¹⁴ O. Schmitt, “Ballkanologjia si detyrë shkencore”, *Studime Shoqërore*, 3, ASHAK, 2016, ff. 17-18.

¹⁵ H. Islami-A. Ejupi, *Ballkani*, Po aty, f. 110.

Projektimi i “Serbisë së Madhe” sipas Jovan Cvijiçit

Pas konflikteve dhe luftërave në përmasa rajonale e botërore dhe ndryshimeve që pasuan në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX paraqiteshin autorët serbë me projektet dhe porositë e tyre, por gjithnjë nga pozitat e hegjemonizmit serb. Ndër ta dallohej veçanërisht Jovan Cvijiçi (1865-1927),¹⁶ një figurë e njohur në shkencën dhe politikën serbe të kohës. Veprimi dhe në shumë çështje influençoi në kohën e thyerjeve të rëndësishme historiko-politike, gjeopolitike dhe etnodemografike në Ballkan pas Krizës Lindore dhe Kongresit të Berlinit (1878), përfundimit të sundimit pesëqindvjeçar osman (1912), luftërave ballkanike (1912-1914), copëtimit të tërësisë etnike shqiptare (1913), Luftës I Botërore (1914-1918) dhe veçanërisht në krijimin e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene (Jugosllavisë së Versajës ose Versajës Serbe 1919) etj. Serbinë e Madhe si ide dhe aspiratë politike, të përpunuar “shkencërisht” e gjejmë pikërisht në veprat antropogjeografike dhe etnografike të Cvijiçit; për Kosovën dhe shqiptarët Cvijiçi bën fjalë në shkrimet e botuara kryesisht midis viteve 1912 dhe 1921, pas pavarësisë së Shqipërisë, të cilët i trajton në kuadër të çështjeve mbi Siujdhesën Ballkanike, ku shquhet angazhimi i tij mbi daljen e Serbisë në detin Adriatik¹⁷ etj. Edhe Nikolla Pashiq (1845-1926), ndër personalitetet më të shquara në historinë politike të Serbisë dhe kryetar i Qeverisë së Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene ëndërronte “për një Serbi të madhe që do të shtrihej nga lindja në perëndim, nga Deti i Zi në Adriatik, duke përfshirë rrugët e mëdha tokësore që të çonin nga Europa Qendrore në Egje”.¹⁸

Cvijiçi shquhej sidomos në Konferencën e Paqes në Versajë (1918-1919), ku në cilësinë e ekspertit kishte një rol jo të vogël edhe politik në vlerësimin e rrethanave dhe argumenteve “nga terreni” për caktimin e kufijve midis shteteve dhe bashkësive etnike, ku më së shumti u dëmtuan shqiptarët. Ai e drejtonte Seksionin Etnografiko-historik të Delegacionit politik serb (kryesues Nikolla Pashiq) në këtë konferencë, ku bëheshin edhe hartat etnike dhe caktoheshin kufijtë.¹⁹ Në

¹⁶ Shih veçanërisht shkrimet në botimet e tij: “Osnove za geografiju i geologiju Makedonije i Stare Srbije”, “Glasnik Srpskog geografskog društva”, “Govori i članci”, “Balkansko poluostrvo i južnoslovenske zemlje”, “Etnografski spisi”, “Promatranja o etnografiji Makedonskih Slovena” etj.

¹⁷ J. Cvijiçi, “Izlazak Srbije na Jadransko more”, “Glasnik Srpskog geografskog društva”, God. 1, br. 2, Beograd, 1912, str. 192-205.

¹⁸ M. Macmillan, *Paris 1919, Gjashtë muaj që ndryshuan botën*, “Plejad”, Tiranë, 2006, f. 144.

¹⁹ Bërthamën e Seksionit Etnografik-Historik e përbënin intelektualët serbë më në

fillim të shekullit XX do të angazhohej edhe në skenën akademike dhe publike të Serbisë (dy herë rektor i Universitetit të Beogradit: 1906/07 dhe 1919/20 dhe në vitet 1921-1927 kryetar i Akademisë Mbretërore të Shkencave). Ishte edhe mik i shquar i klubit “Slovenski jug”, anëtarët e të cilit vepronin legalisht në klub, ndërsa ilegalisht në organizatën terroriste “Crna ruka”.²⁰

Me një perfiditet e dinakëri spekulonte me argumentet etnodemografike dhe gjeopolitike në favor të serbëve e në dëm të të gjithë popujve të tjerë, duke e hedhur tezën se serbët kanë një shtrirje të gjerë gjeografike në Ballkan dhe në Europën JL dhe në këtë shtrirje nënkuptonte edhe territoret të cilat serbët, sipas tij, i kishin populluar më herët, por që për shkaqe të ndryshme i kishin braktisur dhe tashmë kishin mbetur pakicë. Në interpretimet e tij politiko-gjeografike, në emër të shkencës zbatonte kritere joshkencore dhe mbështeste e nxiste aspiratat hegjemoniste dhe nacionalshoviniste e raciste serbe. Kjo më së miri vërehej në konstatimin e tij se “*serbët janë një popull relativisht i madh, i cili është gjithnjë në rritje. Ne jemi popull me vetëdije më të lartë kombëtare në Ballkan*”,²¹ duke u kërcënuar se Serbia “*në pikëpamje kombëtare-politike është shtet i rrezikshëm*”.²²

Cvijiqi në shkrimin e tij, atëherë shumë aktual në qarqet serbe dhe më gjerë, “Dalja e Serbisë në detin Adriatik” (1912),²³ theksonte se “nga aspekti gjeografik Serbia kishte dy mundësi që me zgjerimin e territorit të saj të dalë në det” dhe atë përmes luginës së Moravës dhe të Vardarit në gjirin e Selanikut (deti Egje) dhe përmes luginës së Drinit dhe Matit që shpie në portet e Durrësit dhe Medovës (deti Adriatik),²⁴ qoftë me uzurpimin e territorit, qoftë përmes sigurimit të të drejtave ekonomike dhe komunikative për këtë hapësirë”,²⁵ ndërsa, fatkeqësisht,

zë të kohës: Jovan Cvijić, Tihomir Đorđević, Aleksandar Belić, Jovan Radonić, Boža Marković, Stanoje Stanojević, Niko Zupanić etj. (A. Mitrović, *Jugoslavija na Konferenciji mira 1919-1920*, “Zavod za izdavanje udžbenika SR Srbije”, Beograd, 1969, str. 23).

²⁰ B. Čović, “Politika obmana i nasilja”, Grup autorësh, *Izvori velikosrpske agresije*, Rasprave-dokumenti, (Red. B. Čović), “A. Cesarec”-“Školska knjiga”, Zagreb, 1991, str. 32.

²¹ J. Cvijić, *Govori i članci, I*, Beograd, 1921, f. 63 (fjalë e mbajtur në vitin 1907).

²² J. Cvijić, *Po aty*, f. 58 (fjalë e mbajtur në vitin 1907), nënvizoi H. I.

²³ J. Cvijić, “Izlazak Srbije na Jadransko more”, “*Glasnik Srpskog geografskog društva*”, God. 1, br. 2, Beograd, 1912, ff. 192-205.

²⁴ J. Cvijić, *Po aty*, ff. 195-196.

²⁵ J. Cvijić, *Po aty*, ff. 202-203; shih edhe në *Govori i članci, II*, 1921, ff. 22-23 dhe “*Govori i članci*”, knjiga 5, 1989, f. 20 (teksti i vitit 1912).

Konferenca e Ambasadorëve e Londrës në vitin 1913 ia pranoi Serbisë të drejtën e daljes në det!

Dalja e Serbisë në det është një aspiratë shekullore e faktorëve politikë të saj dhe e autorëve serbë nga qarqet intelektuale dhe akademike, ndër të cilët në hartimin e politikave ekspansioniste veçanërisht dallohej Jovan Cvijiqi (1865-1927). Në punimin e tij të njohur me titull “Dalja e Serbisë në detin Adriatik”,²⁶ e arsyeton edhe nevojën e Serbisë për dalje në detin Adriatik për motive ekonomike, por e përdor edhe “argumentin” e ndërlidhjes historike midis Shqipërisë Veriore dhe “Serbisë së Vjetër” (Kosovës dhe viseve përreth). Nën pretekstin e rritjes demografike të serbëve dhe nevojës së tyre për “hapësirë jetësore”, Serbia “për shkak të pavarësisë së saj ekonomike duhet patjetër të del në detin Adriatik dhe në një pjesë të bregdetit shqiptar qoftë me uzurpimin e territorit, qoftë përmes sigurimit të të drejtave ekonomike dhe komunikative për këtë hapësirë”. Cvijiqi thoshte se “Serbia është vend i rrethuar” dhe “serbët janë popull i arrestuar”²⁷, ndërsa kërkonte që “problemi serb duhet të zgjidhet me forcë”.²⁸ Qysh në vitin 2007 Cvijiqi theksonte se “duhet të jemi një vend i përgatitur për luftë dhe Serbia duhet ta ketë një ushtri të madhe dhe të përgatitur”.²⁹

Për daljen e Serbisë në detin Adriatik është angazhuar edhe nobelisti Ivo Andriqi (1892-1975), i cili në vitin 1939 hartoi elaboratin special në të cilin përpunoi idenë e kahmotshme ekspansioniste të Serbisë për dalje në detin Adriatik, madje edhe me hekurudhë, identike me idenë e Cvijiqit të vitit 1912.³⁰ Edhe Konferenca e Ambasadorëve e Londrës në vitin 1913 ia pranoi Serbisë të drejtën e daljes në detin Adriatik në dëm të tokave shqiptare,³¹ me përjashtim të Austro-Hungarisë,³² sikundër që ia pranoi edhe Konferenca e Paqes në Paris në

²⁶ J. Cvijić, “Izlazak Srbije na Jadransko more”, “Glasnik Srpskog geografskog društva”, God. 1, br. 2, Beograd, 1912, str. 192-205.

²⁷ Më gjerë në: J. Cvijić, “Aneksija Bosne i Hercegovine i srpski problem”, në *Srpski naučnici o Bosni i Hercegovini*, “Službeni list Savezne Republike Jugoslavije”, Beograd, 1995, str. 41-73.

²⁸ J. Cvijić, *Po aty*, str. 73.

²⁹ O. Popović - Obradović, “Vojna i civilna vlast u Srbiji 1903-1914; sipas: L. Perović, *Dominantna i neželjena elita (Beleške o intelektualnoj i političkoj eliti u Srbiji – XX-XXI vek)*, II izdanje, “Dan Graf”, Beograd – “Javna medijska ustanova “Radio-televizija Vojvodine”, Beograd - Novi Sad, 2016, f. 433.

³⁰ B. Krizman, “Elaborat dra Ive Andrića o Albaniji iz 1939.godine”, *Časopis za suvremenu povijest, II*, Zagreb, 1977, str. 89 e tutje.

³¹ B. Krizman, *Po aty*, str. 89.

³² “Mbështetja parësore për çështjen shqiptare në konferencë erdhi nga Austro-Hungaria, politika e së cilës kishte qenë kurdoherë për t’i mohuar Serbisë qasjen

vitin 1919. Në pikën XI të Katërmbëdhjetë pikave të njohura të Presidentit Amerikan, Woodrow Wilson, thuhej: “Serbia lejohet të ketë liri dhe siguri daljeje në det”,³³ pa specifikuar si dhe në dëm të cilit vend dhe popull bëhej kjo dalje.

Serbia e Madhe dhe “heroizimi” i serbëve sipas Cvijiqit

Cvijiqi duke “heroizuar” popullin serb dhe “superioritetin gjenetik” të tij del lakuriq dhe qartë racist e nacist! Drejtpërdrejt apo tërthorazi thotë se të gjithë banorët e Ballkanit janë një popull dhe në etnogjenezën e popujve ballkanikë të gjithë u përkasin serbëve! T’i përmbledhim tezat e tij: “serbët janë një popull relativisht i madh, i cili është gjithnjë në rritje”; “serbët janë popull me vetëdije më të lartë kombëtare në Ballkan”; “Serbia në pikëpamje kombëtare-politike është shtet i rrezikshëm”; “serbët janë populli më i vyeshëm” dhe “me të drejtë për territor dhe sundim të madh”, “BeH është hapësirë e racës së pastër serbe”, “myslimanët janë serbë të turqizuar”, “kroatët janë serbë të besimit romano-katolik”, “Dubrovniku është qytet serb”, “maqedonasit janë një masë amorfe sllave”, “bullgarët janë popull i pakulturuar”, “gjuhët kroate, maqedonase dhe malazeze nuk janë gjuhë, ato janë dialekte të gjuhës serbe”, “malazezët janë pjesë e popullit serb”, “bunjevçasit dhe shokcët janë serbë të konvertuar në katolikë”, “Shqipëria Veriore është tokë serbe dhe përmes saj, Serbia duhet ta realizojë të drejtën natyrore për të dalë në det” etj.

Një hulumtim dhe vlerësim për rolin e Jovan Cvijiqit në “heroizimin” e popullit serb dhe “superioritetin gjenetik” të tij, të përmbledhur në 18 pika, na duket interesant dhe objektiv, prandaj po e japim të plotë. Përpyekjet aktuale të Serbisë, të mbështetura nga “Bota Ruse” e Putinit, të çojnë në këto objektiva:

Sipas Cvijiqit: a) të gjithë banorët e Gadishullit Ballkanik i përkasin “një populli”! Ai këtë e argumenton me fjalimin për të ashtuquajturën “traditën historike ballkanase” (!), si dhe elementet gjenetike, kulturore, gjuhësore dhe historike të cilët janë të përbashkët për të gjithë

në detin Adriatik...Austro-Hungaria shpresonte të krijonte një Shqipëri të mëvetësishme e të madhe që do të përfshinte krahina periferike që përmbanin jo vetëm shqiptarë, por edhe kombësi të tjera” (B. J. Fischer-O. J. Schmitt, *Një histori e përmbledhur e Shqipërisë*, “Botime Artini”, Prishtinë, 2022, f. 126).

³³ M. Macmillan, *Paris 1919, Gjashtë muaj që ndryshuan botën*, “Plejad”, Tiranë, 2006, f. 556.

banorët në hapësirën e “Gadishullit Ballkanik”; b) ky “popull i vetëm”, “i ndotur me ndikimet e shteteve fqinje ndaj Ballkanit” (Austro-Hungarisë, Gjermanisë, Perandorisë Osmane, armiq politikë të Serbisë) jeton i përçarë në “më shumë fise jugosllave” të cilët në një të ardhme të afërt do të “bashkohen sërish në një popull dhe me një emër”. Popullin serb me emrin serb, natyrisht!; c) Serbët, në aspektin historik, etnologjik dhe antropogjeografik janë populli më i vyeshëm dhe bërthama e Gadishullit Ballkanik prandaj “kanë të drejtë” që në shtetin e tyre të përfshijnë të gjitha vendet ku ka serbë dhe gjithsesi, të sundojnë me ta; ç) Serbët janë populli më i shpërndarë në Ballkan dhe “populli me vetëdijen më të fuqishme në Ballkan”. Për këtë arsye, “Bota duhet ta dijë dhe të vërtetohet se Serbia mund të operojë me një tërësi shumë më të madhe nga territori i saj i tanishëm. Nga Serbia mund të fillojnë transformimet më të mëdha territoriale. Nuk duhet të hiqet dorë nga ajo që kjo frikë të mbillet në botë, nëse kjo është e dobishme për interesat tona kombëtare”; d) Fshatari serb është fleksibil, elastik, inteligjent, mendimtar, në vete posedon iniciativat e fshehura vetanake, është emocional, nervat e tij vibrojnë shpejt dhe me amplituda të mëdha”. Kjo e argumenton superioritetin gjenetik të serbëve në Europë. (Cvijiqi harron të përmend rakinë prej kumbullës, ndoshta në të fshihet çelësi i “elasticitetit dhe vibrimit të shpejtë të nervave me amplituda të mëdha?”); dh) Populli i Bosnjë dhe Hercegovinës është një ndër pjesët më të freskëta dhe më të fuqishme të popullit serb, ndërsa në aspektin kombëtar përbën një tërësi me popullin e Serbisë Perëndimore, Sanxhakut të Novi Pazarit dhe Malit të Zi. Bosnja dhe Hercegovina për Serbinë është ajo çka është hapësira e Moskës për Rusinë. “B dhe H është hapësirë e racës së pastër serbe...hapësirë qendrore dhe bërthama e një populli...”; e) Katolikët e Bosnjës janë një bashkësi etnike e panjohur e përbërë prej kroatëve, serbëve të ikur dhe xehetarëve saksonë. Myslimanët e Bosnjës janë serbë të turqizuar; ë) Popullsia e bregdetit të Adriatikut pjesën më të madhe të kohës e kalon jashtë shtëpisë, është shumë e ndjeshme ndaj titujve fisnikë dhe dekoratave. Ky është regjioni që ka dhënë shumë aventurierë. (përsëri flet për superioritetin gjenetik të serbëve); f) Kroatët janë serbë të besimit romano-katolik. Fjala « kroat » është e papranueshme, eventualisht mund të flitet për katolikët ose serbo-kroatët, por më së miri është të përdoret definicioni “popullsi katolike e gjuhës serbe”. Shpërndarjen e “katolikëve” Cvijiqi e markon me vija të ngushta dhe atë vetëm rreth qyteteve *Agram* dhe *Spalato* dhe në pjesët më pak të zhvilluara të *Fiumes* dhe *Osekut*. Hapësira etnike e kroatëve kufizohet në hapësirën e Zagrebit dhe Kroacisë Veriperëndimore, derisa sipas Cvijiqit kroatët janë nën ndikimin e fuqishëm të

priftërinjve dhe klerikëve katolikë si pak kush prej popujve në Europë; g) Dubrovniku është qytet serb, emri i të cilit padyshim është me prejardhje serbe. Veprat kryesore të letërsisë dubrovnikase të shekullit të 16-të dhe të 17-të janë shkruar në gjuhën serbo-kroate, përkatësisht ajo është letërsi e përbashkët serbo-kroate e shkruar me dialektin e shtokavishtes hercegovase; gj) “Varieteti sllavon” na përkujton “shpirtin rus” (tash duhet të jemi të sinqertë: a nuk janë edhe rusët popull periferik dhe kufitar, si bëhet atëherë që ata të mos e kenë ndotur “traditën historike ballkanase” siç kanë bërë gjermanët dhe hungarezët? Ndoshta sepse ata janë aleatët historikë të Serbisë?; h) Në hapësirën jugosllave tipat mongoloidë janë me energji më të dobët intelektuale, shumë shpejt lëshojnë pe në luftën e tyre për mbijetesë – këto janë veçori të lindura të popullsisë së Baranjës, Baçkës dhe Banatit; i) Maqedonasit janë një masë amorfe sllave. Maqedonia është hapësira në drejtim të së cilës shteti i Serbisë dhe Bullgarisë zgjerohet. Edhe pse pjesa më e madhe i takon Maqedonisë – “lugina e Moravës dhe Vardarit” përbën një tërësi gjeografike, në të cilën duhet të krijohet një shtet që i takon Serbisë; j) Bullgarët janë popull i pakulturuar i cili nuk veçohet për mendjempreshtësi dhe trimëri; k) Gjuhët kroate, maqedone dhe malazeze nuk ekzistojnë. Ato nuk janë gjuhë, por “të folme” dhe me e saktë është të thuhet se ato janë dialekte të gjuhës serbe. Në Bosnjë dhe Hercegovinë flitet me gjuhën më të pastër serbe; l) Malazezët janë pjesë e popullit serb; m) Bunjevçët dhe shokcët janë serbë të konvertuar në katolikë dhe prandaj është më e drejtë të emërtohen si “serbë katolikë”, kurse kroatët e Vojvodinës janë “serbo-kroatë”. Vojvodina gjithashtu bën pjesë në tokat serbe; n) Në toka serbe bën pjesë edhe Shqipëria Veriore, sepse “nëpërmjet Shqipërisë Veriore, Serbia do të realizojë të drejtën e saj natyrore për të dalë në det”.³⁴

Shkarja e realitetit politik në Europë pas “Luftës së Ftohtë”

Përveç konflikteve të brendshme të pandërprera, veçanërisht këta dy shekujt e fundit, hapësirat ballkanike u bënë joshëse edhe për okupimet dhe dominimet e huaja. Në Ballkan u ndeshën interesat e ndryshme, para së gjithash të Austro-Hungarisë dhe Rusisë, të cilat provuan ta

³⁴ Autor: *Bigbanitu/Prometej.ba*, kol-avg 23, 2012. “Društveno-kulturna web stranica”, e themeluar nga studentët e Sarajevës në vitin 2011. Teksti është i shkruar nga njohësit e mirë të pikëpamjeve të Cvijiqit.

shtrinin ndikimin e tyre në territoret të cilat ishin nën kontrollin e Perandorisë Osmane. Por aspirata drejtpërdrejt shfaqën edhe Franca, Anglia, Italia, Gjermania, ndërsa më vonë edhe ShBA-ja tregoi një interes për Ballkanin dhe Evropën Juglindore në përgjithësi. Disa vende ballkanike, në radhë të parë Serbia, të përkrahur nga fuqitë e mëdha (Anglia, Franca, Rusia, Italia), në këto konstelacione gjeopolitike dëshironin t'i jetësonin synimet e tyre hegjemoniste për zgjerim territorial, duke pushtuar e nënshtuar popujt fqinj pa mbështetje, veçanërisht shqiptarët.

Gjysma e parë e shekullit XX ishte më brutalja në historinë e njerëzimit: ndodhën disa luftëra rajonale dhe dy luftëra botërore dhe dy bomba atomike, me dhjetëra miliona viktima në njerëz dhe shkatërrime masive materiale. Bota u nda në dy blloqe, me tendosje të mëdha midis shteteve dhe kombeve; u nda Gjermania posthitleriane midis Perëndimit dhe Lindjes, vendeve demokratike dhe atyre komuniste. Pasoi “Lufta e Ftohtë”, që e arriti kulminacionin në fillim të viteve ’60 (ndërtimi i Murit të Berlinit më 1961 dhe rënia e tij më 1989; Kriza Kubane me 1962).³⁵ As pas përfundimit të “Luftës së Ftohtë” në fund të shek. XX, Evropa sikur nuk e kuptoi realitetin politik, mbi të gjitha nuk u tregua e aftë që t’i zgjidhë problemet në truallin e vet, përfshirë kryesisht Ballkanin Perëndimor. Kjo u dëshmuua në rastin e ish-Jugosllavisë, kur neohegjemionizmi dhe gjeopolitikat ekspansioniste serbe me forcë ushtarake donin t’i nënshtonin dhe biologjikisht t’i zhduknin popujt joserbë, veçanërisht shqiptarët, kroatët dhe boshnjakët.

Si Evropa e djeshme, ashtu edhe kjo e sotmja me shumë vështirësi po arrin sukses në zgjidhjen e problemeve në Ballkan, ose në shumë raste nuk po kanë asnjë sukses. Shkaqet sigurisht duhen kërkuar në diversitetin gjeoetnik, kontekstin e ndërlikuar historik, rivalitetet dhe kontradiktat e saj të brendshme,³⁶ por dhe oportunitizmit. “Unioni European, për shkak të problemeve të brendshme, ka humbur një pjesë të ndikimit të tij në Ballkanin Perëndimor, përveç të një pranie të fuqishme të Gjermanisë (deri diku edhe të Francës) si shtet i cili ndër vendet europiane tregon interesim më të shtuar për rajonin.

Nuk ka dyshim se Gjermania në Ballkan ka interesa evidente ekonomike, por edhe mbështetja e saj në proceset e demokratizimit në këtë hapësirë deri tash ishte e rëndësishme. Në veçanti ishte e rëndësishme nisma e njohur si “Procesi i Berlinit” (me A. Merkelin në krye), qëllimi

³⁵ Shih më gjerë në: W. Laqueur, *Evropa në kohën tonë, 1945-1992*, “Dituria”, Tiranë, 1996 (përkthim), ff. 1-465.

³⁶ Më gjerë në: V. Avijucki, *Kontinentalne geopolitike, Svet u XXI veku*, “CLIO”, Beograd, 2009 (përkthim nga frengjishtja), f. 40 e tutje.

i të cilit ishte të ushtrojë ndikim në bashkëpunimin e ndërsjellë, si një nga kushtet dhe kriteret e suksesit të afrimit të anëtarësimit në UE”.³⁷ Por “epoka” 16-vjeçare e A. Merkelit pati edhe dështime të rënda në raportet BE-Federata Ruse. Qëndrimi i saj “prorus” në sferën ekonomike (gazi)³⁸ e forcoi Rusinë e Putinit, e cila sot e gjithë ditën po i shantazon vendet europiane përmes gazit dhe po vazhdon me destabilizimin e Ballkanit përmes Serbisë së Vuçiqit. “Epoka” e A. Merkelit pret një vlerësim të gjithanshëm dhe objektiv në raport me Rusinë.³⁹

Gazi është një resurs natyror, i krijuar para miliona vjetëve: atë nuk e ka krijuar as Stalini e BRSS-ja e as Putini e Rusia! Gazi u vu në funksion tash vonë dhe Rusia po e përdor si mjet ekonomik, politik dhe ushtarak.⁴⁰ Një arsye tjetër pse vitet e fundit BE-ja nuk po ka sukses në rajonin e Ballkanin, duket se është rivaliteti i gjatë “i heshtur” me ShBA-në, sepse, duke u përpjekur ta largojë ndikimin amerikan nga rajoni u komplikuan çështjet edhe më shumë. I dhanë hapësirë dhe mundësi që Rusia të depërtojë thellë në konstelacionin politik, ekonomik, diplomatik dhe ushtarak të Evropës, veçanërisht të Francës dhe Gjermanisë si shtyllat e Bashkimit Evropian sot pas daljes së Britanisë së Madhe nga BE-ja. Edhe ndonjë hap që kishte ndërmarrë BE-ja, p. sh. për formimin e një force të përbashkët për intervenime të shpejta më tepër sikur ishte bërë për ta mënjeluar ndikimin amerikan në Ballkan sesa për të zgjidhur situata të krizave. Presidenti Emmanuel Macron, në një vizitë zyrtare që i bëri Kinës dha një deklaratë shumë të çuditshme: “Evropa nuk mund më të jetë vasale e ShBA-së” (11. 4. 2023). Nga eksperiencat e hidhura me evropianët, shqiptarët kudo në Ballkan kanë më tepër besim tek amerikanët. Vetëm Qeveria aktuale e Kurtit gjen qime në ve në marrëdhëniet Kosovë-ShBA dhe e kundërta!

³⁷ *Jugoslavija u istorijskoj perspektivi*, “Helsinki odbor za ljudska prava”, Beograd, 2017, f. 520.

³⁸ Më se 60% të ekonomive familjare gjermane e kanë shfrytëzuar gazin dhe po aq është përdorur në industrinë e Gjermanisë.

³⁹ Një grup i historianëve më në zë në Gjermani këto ditë “i janë drejtuar Partisë Socialdemokrate (SPD) të kancelarit Olaf Scholz me një letër të ashpër... Autorët e letrës shprehin paknaqësi me mungesën e qëndrimeve të qarta dhe mungesën e solidaritetit të padyshimtë të Gjermanisë ndaj Ukrainës...Historianët akuzojnë socialdemokratët se nuk po koordinohen me aleatët dhe çdo mungesë uniteti trimëron Putinin në luftën e tij kundër Ukrainës...Këtu historianët aludojnë në ish-kancelarin Gerhard Schröder dhe presidentin e tanishëm Frank Walter Steinmeier si krijues të varësisë së Gjermanisë nga gazi rus” (E. Robelli, “Pesë historianë gjermanë kundër kancelarit Scholz”, në “Koha Ditore”, 27 mars 2024).

⁴⁰ Në kohën e A. Merkelit më se 60% e ekonomive familjare e përdorte gazin dhe po aq për qind përdorej në industrinë gjermane!

Edhe sot, mjerisht, qarqe të caktuara politike dhe intelektuale, por edhe vende evropiane nuk e kanë ndërruar qëndrimin ndaj disa çështjeve në Ballkan dhe veçanërisht ndaj Kosovës dhe shqiptarëve.⁴¹ Angazhimi njëzetvjeçar amerikan në Afganistan (u tërhoq plotësisht ushtarakisht, ekonomikisht dhe politikisht në vitin 2021), në Irak dhe në luftë kundër terrorizmit global sikur i kurajoi këto qarqe evropiane, veçanërisht Rusinë dhe Francën. Gjatë viteve 90 të shekullit të kaluar, kur po zhvillohej lufta në Bosnjë, u pa qartë animi i politikave zyrtare, angleze dhe franceze ndaj Serbisë dhe serbëve, ndërsa Anglia dhe Franca mbajtën haptas qëndrim antiboshnjak dhe proserb gjatë luftës në BeH. Srebrenica, si zonë e mbrojtur e Kombeve të Bashkuara, ku u masakruan 8.372 burra dhe djem boshnjakë në gusht të vitit 1995 ishte turpi më i madh i Evropës, i NATO-s dhe i Kombeve të Bashkuara. “Srebrenica, masakra më e madhe e kryer në Evropë pas vitit 1945, nuk u parandalua në korrik të vitit 1995.⁴² Çka është edhe më zi, e kanë kryer ata të cilëve iu mundësua që lirisht ta realizonin çmendurinë e tyre vrastare, duke menduar se do të liroheshin nga përgjegjësia, ngase atëherë kishin qenë të inkuadruar në procesin e paqes. Kështu Fuqitë e Mëdha nga viti 1999 nuk kanë armë tjetër pos aksionit ushtarak për ta ndaluar gjakderdhjen e re, kësaj radhe në Kosovë. Përgjegjës për këtë ekspeditë s’është kush tjetër pos Milosheviqit dhe vrastarët e tij të paguar, ata që tashmë kanë qenë në listën e të dyshuarve për krime lufte më 1992”.⁴³

Pa ndërhyrjen e SHBA-së, e cila po ashtu i ka interesat e veta strategjike në Evropën JL, nuk do të ishin ndaluar luftërat dhe krimet në Kroaci, BeH dhe në Kosovë. Pa amerikanët as në Maqedoni e as në

⁴¹ Ish-Presidenti i Kroacisë Stipe Mesiq nënvizoi në Forumin e Gjashtë Energjetik të Maqedonisë, që u mbajt në Shkup më 30-31 qershor 2023: “Problemin e Kosovës disa akoma nuk e kuptojnë. Kur është fjala për Kosovën, problemi është para së gjithash në Serbi. Është shumë e vështirë nëse zhvillonin një politikë ku e keni të kthyer vetëm pasqyrën e pasme, të drejtuar nga historia. Dhe ne jemi në situatë që kemi shumë histori për metër katror. Kjo është diçka që na pengon, sepse ne shikojmë vetëm prapa, kështu që kjo politikë ndaj Kosovës është një politikë totalisht e humbur. Nëse dikush mendon se Kosova mund të kthehet me luftë, ai është një i humbur. Është një i humbur që e gjen veten në politikë dhe që mendon se Kosova mund të kthehet ushtarakisht. Nuk mundet, kjo mundësi thjesht nuk ekziston” (Sipas “Anadolu”, 1.6.2023).

⁴² Vetëm pas 28 vjetësh Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 23 maj 2024 me shumica votash e miratoi Rezolutën për shpalljen e 11 Korrikut Ditë Ndërkombëtare të Përkujtimit të Viktimave të Gjenocidit në Srebrenicë. Forcat serbe në Srebrenicë vranë 8.372 burra e djemë në korrik të vitit 1995!

⁴³ F. Hartman, *Paqja dhe ndëshkimi*, “Koha”, 2011, f. 32.

Serbi të Jugut, Evropa nuk do të kishte sukses në parandalimin e konflikteve shqiptaro-maqedonase dhe shqiptaro-serbe. Çlirimi dhe pavarësia e Kosovës nuk do të vinin kurrë pa SHBA-në, sikundër sot që nuk po ka asnjë zgjidhje për raportet Kosovë-Serbi pa SHBA-në. Mirëpo SHBA-ja ndonëse kishte rol vendimtar në çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës, megjithatë, në të ardhmen do të preokupohet me probleme të tjera, shumë më të rëndësishme se Kosova dhe Ballkani Perëndimor, e ato janë tensionet me Rusinë, Kinën dhe Iranin. Kosovës mjerisht i ndodhi diçka që nuk e ka menduar kurrë asnjë shqiptar dhe askush në botë. Për sjelljes kryeneçe dhe arrogante të Kurtit, BE-ja i vëri sanksione të rënda ekonomike, që kapin qindra miliona euro. Plus ndëshkimet politike, çfarë ishte mospranimi i Kosovës në Këshillin e Evropës më 16 maj 2024). Pasuan edhe gafat e Ministres së Jashtme znj. Gërvalla kur ditën e mbajtjes së mbledhjes së Këshillit të Evropës i drejton letër (krejt në adresa të gabueshme) KE se deri në fund të muajit maj 2024 do ta dërgojmë draft-statutin e Asociacionit të Qeverisë së Kosovës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të cilin, pas dy ditëve e tërhoqi. Këtu morën fund mashtrimet e Kurtit. Mbetet çështje e hapur se kur do të votojë Këshilli i Ministrave të BE-së për hyrjen e Kosovës në Këshillin e Evropës.

Populizmi dhe aventurat e Kurtit

Pas zgjedhjeve komunale në katër komunat në veri të Kosovës (23 prill 2023), ku shumica e popullsisë janë serbë, ndërsa me disa qindra vota Qeveria jonë me polici donte t'i instalonte për kryetarë të komunave kandidatët shqiptarë, pa asnjë marrëveshje me aleatët tanë strategjikë. Në mungesë të koordinimit të aksioneve të Qeverisë së Kosovës me aleatin dhe mikun tonë më të madh e më të sigurtë (SHBA), që na ka çliruar dhe pavarësuar, shpalli masa të rënda ndaj Kosovës. Më 30 maj 2023 ambasadori amerikan në Kosovë Jeff Hovenier dha një deklaratë shumë shqetësuese për Kosovën, që përmbante disa masa ndëshkuese, ndërsa Kurti i quajti deklaratat e Sekretarit të Shtetit Amerikan Antony Blinken, “të padrejta, të gabuara dhe naive”, diçka që nuk e bëri as S. Lavrovi, ministër i Punëve të Jashtme të Rusisë.

Shumë shqetësuese ishte deklarata e ambasadorit amerikan në Prishtinë, J. Hovenier. Ai tha: “Jemi shumë të brengosur për situatën në veri të Kosovës. Mendojmë që kjo ishte një krizë, nga perspektiva jonë, e panevojshme. Operacioni që ka ndodhur të premtën për të siguruar

qasje me dhunë në ndërtesat komunale ishte i pakoordinuar me ShBA-në. Kur e kuptuam që kjo po ndodh, këshilluam që kjo të ndalet, sepse i parashikuam pasojat të cilat po i shohim tash. Besojmë që ky aksion ka pasur pasoja negative për reputacionin e Kosovës, e ka kthyer prapa procesin e avancimit, normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Ashtu siç ka thënë Sekretari Blinken në deklaratën e tij, dhe si kemi thënë ne, kjo do t'i afektojë marrëdhëniet tona bilaterale. Indikatorri i parë i kësaj është vendimi i gjeneral Komolit, udhëheqësit të ushtrisë amerikane për Evropë për të përjashtuar pjesëmarrjen e Kosovës në Evropë Defender 23 që ndodhi gjatë natës dhe, siç e keni parë, sot nuk pati aktivitete të Defender 23 dhe as nuk do të ketë... Për Kosovën ky ushtrim ka marrë fund... Jemi duke menduar për implikime të tjera. Më duhet të them se në këtë moment i kemi kërkuar Kurtit të marrë hapa urgjentë që të arrijë deeskalim në Veri. Nuk ka reaguar ndaj kërkesave tona. Kështu që jemi duke menduar se cilat do të jenë veprimet tona të mëtutjeshme. Mirëpo, në këtë moment nuk do të mund të gjeni shumë entuziazëm prej anës së ShBA-së të reagojë ndaj interesave të tjera të Kosovës, si për shembull të angazhohemi me shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën ose që të punojmë aktivisht në trajektoren e integritit evropian e ndërkombëtar të Kosovës. Na vjen shumë keq që situata ka ardhur deri këtu, por më duhet të jem i sinqertë duke ju treguar se kemi arritur deri në këtë pikë...”.⁴⁴

Qeveria Kurti që erdhi në pushtet përmes “tymit dhe flakës”, parullës populiste të “bashkimit kombëtar” dhe agjendës “anti-Zajednicë”, ra qartë në grackat e politikës zyrtare serbe. Me këtë rast, Perëndimi e mori Vuçiqin si njeri të dialogut, ndërsa Kurtin si refuzues të tij. Kjo Qeveri e mori pushtetin me premtime të mëdha, ndërsa shumë pak realizoi në projektet kapitale, në punësim dhe pothuajse asgjë në ngritjen e të ardhurave në të dy sektorët dhe në rritjen e pensioneve. Si rezultat u venit shpresa për të jetuar në Kosovë dhe u përshpejtua eksodi drejt vendeve evropiane. Për arsye të zëna në gojë më parë dhe tash edhe për shkak të ndalimit të “Dinarit” serb (sigurisht qëndrim i ligjshëm), pa një periudhë transitore, si dhe pa njoftim dhe pajtim me SHBA-në dhe BE-në, Qeveria nuk arriti ta kapitalizonte politikisht as agresionin ushtarak të Serbisë në Banjskë më 24 shtator 2023 dhe as vjedhjen industriale të votave në zgjedhjet parlamentare dhe komunale të Serbisë më 17 dhjetor 2023, të dënuara nga BE-ja, por edhe SHBA-ja. Për rastin “Banjska”, mjerisht, as BE-ja dhe as SHBA-ja deri sot nuk ndërmorën asgjë për zbardhjen e tij. Dhe sikur na doli fitues kryetari i Serbisë

⁴⁴ Sipas: “Kallxo.com, Jeta Xharra”, 30.5.2023.

Vuçiq, një ish-ministër i kriminelit Millosheviq. Pasi edhe një gafë tjetër: në emër të “vendosjes së rendit dhe ligjshmërisë autoritetet e Kosovës më 21 maj 2024 përmes një operacioni policor ndaj institucioneve financiare serbe në veri të Kosovës, që rezultoi me mbylljen e gjashtë objekteve të bankës së Kursimeve të Postës dhe Bankës Popullore të Serbisë në katër komunat në veri. Më këtë sjellje të Qeverisë së Kosovës jo vetëm që po vështirësohet heqja e masave të vëra nga BE-ja, por do të krijohet edhe perceptimi se Qeveria e Kurtit po i ndjek dhe “terrozon” serbët e Kosovës.

Është e vërtetë se grupacionet e caktuara politike dhe Qeveritë e Kosovës deri në vitin 2020 ishin shumë tolerante ndaj kërkesave të Serbisë dhe të ndërkombëtarëve, në veçanti lidhur me formimin, votat dhe bizneset me “Listën Sërpska”⁴⁵, por me njerëzit e kësaj “Liste” ka bashkëpunuar për vota edhe Partia në pushtet, Vetëvendosja (takimet e fshehta të shëfës së Grupit parlamentar të VV-së, Kusari Lilës me përgjegjësitë e Listës Sërpska, Simiqin dhe Radojçiqin). E vërtetë është se Qeveria Kurti ka arritur t’i “disiplinojë” grupet dhe bandat serbe në Veri për shkeljet e ligjeve dhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, por ka bërë gabime, duke mos u koordinuar me faktorin ndërkombëtar, sidomos me ShBA-në dhe KFOR-in. Një sjellje e tillë e Qeverisë Kurti, e pamatur, populiste dhe pa marrëveshje me partnerët tanë solli diçka që nuk e ka pritur askush! Në vazhden e situatës së krijuar rreth ndaljes së “Dinarit” nga BQK-ja dhe Qeveria e Kosovës, Ndhimës Sekretari i Departamentit të Shtetit Amerikan, James O’Brien, duke komentuar sjelljen e Qeverisë së Kosovës theksoi se: “nëse ne nuk trajtohem si partner, edhe ne nuk do ta trajtojmë Qeverinë e Kosovës si partnere” (13.02.2024)! Edhe emisari i ShBA-ve për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar deklaroi “se kemi problem me Albin Kurtin dhe me të ka probleme edhe BE-ja, NATO-ja, Anglia dhe shtetet e rajonit, çfarë janë Shqipëria dhe Maqedonia”.

G. Escobar ishte i zemëruar veçanërisht sa i përket ndalimit të përdorimit të dinarit për serbët e Kosovës, por edhe dialogut, i cili, sipas tij ka “hyrë në një fazë kritike” (12.03.2024)! “Serbët po vuajnë nga vendimi për dinarin; ShBA-ja do ta mbajë përgjegjësinë Kurtin si i trajton ata” (15.03.2024)! Në një anë, Qeveria e Kurtit insistonte në zbatimin e ligjeve të Kosovës në Veri, por në anën tjetër nuk i zbatonte vendimet e gjykatave të Kosovës në jug të vendit. Më në fund, Kurti lëshoi pe nën

⁴⁵ Me kriminelin Radojçiq kanë bashkëpunuar ngushtë pushtetarët shqiptarë (para pushtetarëve të VV-së!), me pranimin e tij në zyre të shtetit, takimet publike në restorane ekskluzive të Kosovës etj.

presionin e faktorit euroatlantik, duke zbatuar vendimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës të vitit 2016 që të regjistrohen në kadastër pronat prej 24 ha për Manastirin e Deçanit, që e lehtësonte pranimin e Kosovës në Këshillin e Europës (KE). Megjithatë, i dërguari i posaçëm i SHBA-së për Ballkanin Perëndimor G. Eskobar përmendi si tërthorazi edhe dy kushte të tjera për anëtarësim në KE: shpronësimet në veri (fshatrat Dren dhe Leshak të komunave Leposaviq dhe Zubin Potok), ku parashihet ndërtimi i katër bazave të Policisë së Kosovës në tokat private dhe shoqërore, si dhe krijimi dhe zbatimi i Asociacionit. Pas votimit të Kosovës në KE, tërthorazi mbetën shumë obligime për Qeverinë e Kosovës, përfshirë asociacionin, si “angazhim i saj shtesë pas anëtarësimit”, por edhe çështja e shpronësimeve në veri, në përputhje me ligjin dhe Planin e Ahtisarit” - thuhet në Raportin e D. Bakojanisit (27.03.2024). Rasti i “Dinarit” e çoi Kosovën në KS të OKB-së dhe e rigjallëroi UNMIK-un. Prezenca e Kosovës duhet të jetë sa më e rrallë në KS të OKB-së, ndërsa UNMIK-u duhet të zhbëhet sa më parë. Për zhbërjen e tij ka sa kohë që angazhohen SHBA-ja, Britania e Madhe etj., por pas “ftohjes” së raporteve me SHBA-në dhe partnerët e tjerë, ky angazhim po zbehet. Mosmirënjohja, fjala e shkelur, megalomania ciniste dhe gënjeshttrat janë sjelljet më të rënda në marrëdhëniet midis shteteve dhe miqve. Amerikanët këto sjellje nuk i tolerojnë! Kjo u pa në disa raste, përfshirë nervozizmin e përfaqësueses së SHBA-së në KS të OKB-së në rastin e dinarit serb, në urimet e “tharta” të Presidentit Biden për 16-vjetorin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës më 17 Shkurt 2008 etj.

Dobrica Qosiqi, “babai” i kombit serb, si më e keqja e shqiptarëve dhe e popujve joserbë, pas disfatave në luftërat e Serbisë në Kosovë e gjetiu në shek. XX, thoshte se *“Kosova nuk kthehet me luftë. E vetmja mënyrë për ta kthyer Kosovën është kur klima antiamerikane zë rrënjë në Kosovë⁴⁶ dhe kur shqiptarët ndjehen të vetëmjaftueshëm dhe nacionalizmi për të mbajtur e ruajtur pushtet del para strategjisë amerikane e evropiane. Shërbimet tona duhet të punojnë në Kosovë e ta ndërtojnë një imazh që e imiton nacionalizmin e verbër të Millosheviqit. Kur të*

⁴⁶ Në bisedat për keqbërjet e Shërbimit të Sigurimit Serb ndaj shqiptarëve të Kosovës para vitit 1966, që e kontrollonte A. Rankoviqi, në bisedë me filozofin dhe delegatin e Kuvendit Federativ Ivan Supekun, Qosiqi nuk i pranonte deformimet e këtij Shërbimi, duke theksuar se “Kosova është vend i shenjtë serb, i cili nëse është nevojë do të mbrohej me pushkë” (I. Supek, *Krivovjernik na ljevici*, “Globus Nakladni zavod”, Zagreb, 1992, f. 164).

vijë ai moment, atëherë ngjallet shpresa serbe” (nënvizoi H. I.).⁴⁷ Këtë “moment”, mjerisht, e solli kokëfortësia dhe egocentrizmi i Kurtit. Edhe më herët, në përrurimin e librit të tij “Kosovo”(më 4 nëntor 2004 në Beograd), Qosiqi në fjalën e tij theksoi: ”Totalitarizmi dhe nacionalizmi ekspansionist i shqiptarëve, i mbrojtur me ideologjinë islamiste dhe me energjitë e islamizmit nuk është i drejtuar vetëm kundër serbëve, maqedonasve, malazezëve dhe grekëve; nacionalizmi shqiptar është i drejtuar kundër Evropës dhe qytetërimit të saj...Ta lirojmë Serbinë nga Kosova! Ta mbrojmë Serbinë nga shqiptarizmi barbar! Ta bindim BE-në se në Kosovë po punohet kundër Evropës, kurse SHBA-në se në Kosovë nuk po punojnë për veten”.⁴⁸

Edhe komandanti i KFOR-it Angelo Michele Ristuccia, në intervistën e tij dhënë gazetës italiane “Corriere della Sera” e fajësoi Kurtin për sjellje të gabuar me vendosjen e kryetarëve jolegjitimë në komunat e Veriut të Kosovës.⁴⁹ Me këtë rast Ristuccia deklaroi: “Para së gjithash, vendimi i kryeministrit kosovar Albin Kurti për të vendosur kryetarë komunash me përkatësi etnike shqiptare, të panjohur nga shumica serbe, është marrë pa këshillat e kundërta të gjithë bashkësisë ndërkombëtare. Veprimi i dytë i njëanshëm i Qeverisë së Prishtinës ishte përdorimi i forcës pa u konsultuar me ne, duke e bërë kështu të nevojshme ndërhyrjen tonë për të shmangur një tragjedi”. Ndërkaq, thotë historiani dhe akademiku i njohur Oliver J. Schmitt nënvizoi: “Përshkallëzimi në Veri të Kosovës është një dhuratë për Rusinë dhe Vuçiqin”.⁵⁰ Kosovës i duhet stabiliteti; jostabiliteti i saj krijon jostabilitet rajonal dhe evropian. Fitorja në paqe nuk është e lehtë; paqja fitohet vetëm me punë e përgjegjësi, sjellje racionale e mençuri politike dhe me mbështetje ndërkombëtare. Presidenti i SHBA-së Bill Clinton, kur erdhi menjëherë pas çlirimit (1999) në Ferizaj, deklaroi: “ Ne e fituam luftën, ju fitoni paqen”!

Qeveria Kurti gati gjithë mandatin katërvjeçar e çoi duke u marrë me Veriun e Kosovës dhe serbët e atjeshëm, duke mos e hequr nga vokabulari fjalën “luftë”, që ndjellte frikë te qytetarët dhe investitorët e

⁴⁷ D. Ćosić, “*Piščevi zapisi 1999—2000: Vreme zmija*”, *Službeni glasnik*, Beograd, 2008; e përcjell edhe “Demokracia.com” (1.06.2023).

⁴⁸ Sipas raportit të korrespondentes së *Kohës ditore* nga Beogradi Naile Imami, “*Koha ditore*”, 6 nëntor 2004 (Për më pak se dy javë libri u shitë në 30.000 ekzemplarë)!

⁴⁹ Komandanti i KFOR-it Angelo Michele Ristuccia, në “*Corriere della Sera*”, 4. 6. 2023, Romë.

⁵⁰ Nga intervista e prof. O. Schmitt-it në Portalin gjerman të lajmeve “*T-online*”, 3. 06. 2023 (Sipas: “*Koha ditore*”, 3.6. 2023).

huaj. Qeveria nuk reshti të merrej me probleme, të cilat miqtë dhe partnerët tanë i konsiderojnë si veprime të “njëanshme dhe të pabashkërenduara”, si p.sh. "Hapja e urës së Ibrit" dhe “Mbyllja e nëntë degëve të postës së Serbisë në veri të Kosovës” (5 gusht 2024). "Ndryshe, ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se vendet e QUINT-it dhe NATO-ja nuk e mbështesin hapjen e urës së Ibrit në Mitrovicë në këtë kohë” (2 gusht 2024) dhe ka shprehur zhgënjimin e thellë me mbylljen e degëve të postës së Serbisë nga ana e Policisë së Kosovës (5 gusht 2024)!⁵¹ Ndërkaq, masat e Bashkimit Evropian ndaj Kosovës mund shtohen nëse Qeveria vazhdon me vendime që bashkësia ndërkombëtare po i konsideron si të njëanshme e të pakoordinuara-kërcënon BE-ja. Kosova mund edhe të izolohet; bashkësia ndërkombëtare nuk ka më asnjë simpati ndaj Kurtit. Përkundrazi!

KFOR-i ka deklaruar se “hapja e urës mbi lumin Ibër duhet të merret në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi, të ndërmjetësuar nga BE-ja” (8.08.2024). Por sa më shumë KFOR dhe EULEX në Veri, aq më pak sovranitet në Kosovë, tha një analist yni. Ndërsa analisti tjetër nga Brukseli, njohës shumë i mirë i rrjedhave në BE dhe kritik ndaj sjelljeve të Qeverisë, por edhe më kritik ndaj BE-së, nënvizon se “Hapja për qarkullim të automjeteve mbi urën mbi lumin Ibër në Mitrovicë nuk do t’ua ndryshojë shumë jetën qytetarëve në asnjërinë anë të lumit. Edhe ashtu disa qindra metra më larg është ura përmes së cilës kalojnë automjetet. Por mbajtja e asaj ure mbyllur është një simbol i dështimit të BE-së, e cila e ka sjellë veten në një situatë në të cilën bllokimi i urës konsiderohet si ruajtje e stabilitetit e hapja si nxitje. Kjo është bizare sa edhe thëniet se përdorimi i euros është mënyrë e spastrimit etnik. BE-ja duhet të angazhohet që ura të hapet menjëherë e jo të përhapë frikë

⁵¹ Zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, Matthew Miller, ka deklaruar "se veprimet e fundit të pakoordinuara të Qeverisë së Kosovës, rrezikojnë mundësitë të cilat i ka krijuar vendi me ndihmën e SHBA-së. Jemi të shqetësuar nga vendimet e vazhdueshme të pakoordinuara të lidershit të Kosovës. Besojmë se ata kanë vënë në rrezik mundësitë, të cilat ne e kemi ndihmuar Kosovën t’i krijojë. Nëse shikoni ngjarjet që nga pavarësia e Kosovës, SHBA-ja fuqishëm ka mbështetur integrimin e saj të plotë në komunitetin ndërkombëtar si demokraci multietnike sovraane. Por, të realizohet ky vizion ne kemi bashkëpunuar me liderë të suksesshëm politikë të Kosovës në masa që kanë forcuar paqen e prosperitetin në vend, ndërsa avancon Kosovën në rrugën euroatlantike. Ajo që e inkurajojmë Qeverinë e Kosovës të bëjë është që të rikthehet në bashkëpunim të ngushtë dhe konstruktiv me SHBA-në, BE-në dhe NATO-n. E kemi bërë këtë të qartë, ia kemi bërë të qartë Qeverisë edhe privatisht” (7.08.2024).

nga hapja e saj. Nuk mundet më BE-ja që vetëm të angazhohet për ruajtjen e status quos, duke lejuar politizimin e kësaj ure”... Është për keqardhje pse BE-ja mendon kështu. Është për keqardhje pse ura vazhdon të jetë e mbyllur. Është për keqardhje pse Qeveria e Kosovës e përdor edhe këtë temë për qëllime politike në prag të zgjedhjeve. Është po aq për keqardhje se si serbët në veri të Kosovës e konsiderojnë mbajtjen e urës të mbyllur si kusht për mbijetesën e tyre. Por në anën tjetër, mos-hapja e urës godet rëndë në vlerat e BE-së e besa edhe të NATO-s. NATO-ja, pa marrë parasysh se çfarë pyetjesh ua dërgoni strukturave të saj rreth Kosovës, gjithmonë përgjigjet me fjalinë se NATO-ja është atje “për të siguruar lirinë e lëvizjes për të gjithë”.⁵² Ndërsa Vuçiqi kërcënon: nëse KFOR-i nuk i mbron serbët, Serbia do t'i mbrrojë ata.

Në aksion tjetër, i ndërmarrë nga Qeveria e Kosovës më 30 gusht 2024, është edhe mbyllja e komunave paralele në të ashtuquajturin Qark Administrativ i Mitrovicës, ku përfshihen komunat e Mitrovicës, Zvečanit, Zubin-Potokut dhe Leposaviqit, që kanë vepruar nga vitit 1999. Veprimtaria e tyre është e paligjshme, por faktori ndërkombëtar e kundërshtoi aksionin e Qeverisë Kurti. Ndihmëssekretari amerikan për Europë dhe Euroazi, James O'Brien, e kundërshtoi këtë veprim, duke

⁵² “As vendimi për përdorimin e euros si valutë, as mbyllja e postave të Serbisë në territorin e Kosovës, e as hapja eventuale e urës mbi lumin Ibër nuk do të duhej të rrezikojnë mbijetesën e serbëve. Kjo përdoret si propagandë nga ana e Beogradit dhe u imponohet si narrativë edhe serbëve në Kosovë. E në fakt problemi i vetëm është tek insistimi i Serbisë që strukturat e saj shtetërore të vazhdojnë të funksionojnë në Kosovë, sepse në këtë mënyrë dëshmohet prania e Serbisë, e cila Kosovën e konsideron si pjesë të saj. Edhe opozita në Serbi, edhe disa struktura të serbëve në Kosovë, ankohen se si dita-ditës shteti i Serbisë po i humb institucionet e saj në territorin e Kosovës. Pra nuk janë as postat, as bankat, struktura “të mbështetura nga Serbia” siç pohon Brukseli, por janë struktura të Serbisë në territor të Kosovës. Këtë konfuzion e ka krijuar Bashkimi Evropian, e sidomos është rritur prej kur udhëheqjen e dialogut e ka marrë përsipër Miroslav Lajçak. Në vend të shpërbërjes së strukturave paralele ishte forcuar roli i tyre dhe në një moment ishte bërë sikur të jetë normal...Edhe për urën mbi lumin Ibër bëhet garë se kush ka të drejtë të vendosë. Sepse ajo është bërë simbol dhe test i pushtetit. Beogradi insiston se pa pajtimin e Serbisë nuk mund të hapet ura. Por në anën tjetër, Kosova, nëse e konsideron veten si shtet, nuk mund të pres leje nga një shtet fqinj, për më tepër i cili ka qëllime armiqësore ndaj Kosovës, nuk mund të pres leje nga Serbia për hapjen e urës. Kjo garë se kush e kontrollon Veriun nuk është e re. Ekziston që nga çlirimi i Kosovës dhe po vazhdon. Qytetarët nga të dyja anët e lumit janë përdorur vetëm si vegël në këtë garë politike. E kështu do të jetë edhe në të ardhmen... (Augustin Palokaj, *Ura e Mitrovicës, simbol ironik i pafuqisë dhe joseriozitetit të BE-së*, 12 gusht 2024).

thënë se “veprimet e pakoordinuara ndikojnë negativisht në partneritetin tonë” (31 gusht 2024); kundërshtimin e bëri edhe ambasadori amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier, si dhe ambasadorët e Gjermanisë, Francës etj. dhe BE-ja.

Hilet e kontinentit “plak” dhe BE-së ndaj Kosovës

Me vendimet e Konferencës së Londrës (1913) dhe me vonë të Versajës (1919) dhe të Parisit (1945), përkundër vullnetit të popullit shumicë, Kosova mbeti nën Serbi/Jugosllavi. Grushtin më të madh çështjes shqiptare si një “kurban” ia dhanë dy Konferencat e para. Kryesuesi i Konferencës së Ambasadorëve në Londër, Ministri i Jashtëm i Anglisë, Eduard Grej pas Konferencës, më 12 gusht 1913 deklaroi: “Unë e di fare mirë se kur gjithçka do të bëhej e njohur, kjo (zgjidhje) në shumë pika do të japë shkas për kritika të mëdha nga kushdo që e njuh vendin dhe që e gjykon çështjen nga një pikëpamje e ngushtë lokale. Duhet të mos harrohet se gjatë përpjekjeve për të gjetur një zgjidhje të tillë, *qëllimi kryesor ka qenë që të ruhej marrëveshja ndërmjet vetë Fuqive të Mëdha dhe, në qoftë se vendimi për Shqipërinë e ka siguruar këtë, atëherë ai e ka bërë punën më të rëndësishme në të mirë të paqes së Europës*” (nënvizoi-H. I.).⁵³ Sa cinik tingëllon konstatimi se u arrit paqja dhe stabiliteti për t’i kënaqur etjet e interesave të Europës “plakë” dhe, mbi të gjitha, për t’i favorizuar interesat e Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë në dëm të të drejtave legjitime të popullit shqiptar për të krijuar shtetin e tyre në kufijtë etnikë. Konferenca e Versajës (1919) i verifikoi rezultatet e dhunës dhe të vendimeve të Konferencës së Londrës.

Hilet dhe mashtrimet politike vazhduan edhe më vonë me pjesët e mbetura jashtë tërësisë shtetërore shqiptare, në veçanti me Kosovën. “Pas çlirimit të Jugosllavisë, në mbledhjen e Tretë të AVNOJ-it nga 70-10 gusht 1945, që më vonë u quajt Kuvendi i Përkohshëm Popullor i Jugosllavisë Demokratike Federative (JDF), në bazë të të drejtave të popujve për vetëvendosje është aprovuar vendimi i Kuvendit të Parë të Vojvodinës të 31 korrikut 1945 dhe vendimi i Kuvendit të Krahinës (Oblasne) Autonome të Kosovës e Metohisë nga Mbledhja e 10 korrikut 1945 në Prizren për bashkimin e Vojvodinës dhe Kosovës e Metohisë “Serbisë Federale”.⁵⁴

⁵³ *Historia e popullit shqiptar, III, Periudha e Pavarësisë, 28 Nëntor 1912 -7 Prill 1939*, “Akademia e Shkencave e Shqipërisë” – “Botimet Toena”, Tiranë, 2007, f. 26.

⁵⁴ Mirëpo, “në vendimin për bashkimin e Vojvodinës dhe Kosovës e Metohisë Serbisë,

Rreth gjysma e shqiptarëve sot jeton jashtë shtetit shqiptar me të cilin kufizohet. “Duhet të shënohet se shqiptarët që jetojnë në shtetin e sotëm shqiptar janë një hise e historisë së shqiptarëve. Që prej 2008-shit, një përqindje domethënëse e këtyre shqiptarëve që më 1912 u lanë jashtë shtetit kombëtar kanë zhvilluar gjedhen e tyre të shtetësisë, shtetin e mëvetësishëm të Kosovës. Pavarësisht nga modeli i saj politik shumetnik, që i imponua nga bashkësia ndërkombëtare, Kosova sot është de facto shteti i dytë shqiptar, qytetarët e së cilës nuk e konsiderojnë më Shqipërinë si mëmëdheun e tyre”.⁵⁵

Bashkimi Evropian përmes përfaqësuesve të tij, si Federica Mogherini (italiane, që angazhohej për ndarjen e Kosovës) dhe Josef Borell (katalan; spanjoll, Spanja nuk e ka pranuar Kosovën shtet sovran dhe të pavarur), që të dy përfaqësues të Lartë të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së, si dhe përfaqësuesi special i BE-së për dialogun Kosovë-Serbi Miroslav Lajçak (sllovak; Sllovakia nuk e ka pranuar Kosovën shtet sovran dhe të pavarur) - vazhduan të pozicionohen në anën e Serbisë dhe kundër Kosovës, që shihej haptas në bisedimet Kosovë-Serbi këto vitet e fundit. Në një rast ”(17.6.2021), M. Lajçak deklaroi me arrogancë të paparë: “nëse ju të Kosovës nuk i besoni BE-së, shkoni diku tjetër!” Kosova i vetmi vend si më proeuroamerikan në botë deri më 1 janar 2024 u pengua në lëvizjen e lirë (liberalizimi) në hapësirën e BE-së dhe këtu printe Franca si shtet me lidhje tradicionale me Rusinë dhe Serbinë. Ky ishte një turp i paparë dhe një racizëm sui generis. Nuk është i pafajshëm edhe një pjesë e vetë faktorit politik shqiptar të Kosovës, i cili duke mos e votuar vijën kufitare me Malin e Zi në vitin 2016, që ishte vendosur menjëherë pas Luftës II Botërore midis Serbisë dhe Malit të Zi (Kosova ishte Oblast dhe askush nuk e pyeti për asgjë). Grupacioni partiak i Haradinajt dhe një pjesë e deputetëve të LDK-së më vonë, për interesa pushtetore, më 21 mars 2018 e votuan Marrëveshjen midis Kosovës dhe Malit të Zi për kufirin pa ia

askund decidivisht nuk qëndron se ato i bashkohen Serbisë dhe se në këtë status ruajnë veçorinë e njësisë autonome. Vetëm pas nxjerrjes së Ligjit mbi zgjedhjen e deputetëve për Asamblenë Kushtetuese të Jugosllavisë Demokratike Federative shihet se Vojvodina dhe Kosova e Metohia kanë status autonom në kuadër të Serbisë, por juridikisht të ndryshëm. Vojvodina është krahinë, ndërsa Kosova e Metohia regjion autonom (Autonomna oblast)” (D. Dimitrijević, *Državne granice nakon sukcesije SFR Jugoslavije*, “Institut za međunarodnu politiku i privredu”, Beograd, 2012, f. 276; shih gjithashtu: M. Zečević-B. Lekić, *Državne granice i unutrašnja podela Jugoslavije*, “Gradjevinska knjiga”, Beograd, 1991, str. 24)

⁵⁵ B. J. Fischer-O. J. Schmitt, *Një histori e përmbledhur e Shqipërisë*, “Botime Artini”, Prishtinë, 2022, f. 17.

hequr asnjë presje versionit që e kishin kundërshtuar egërsisht bashkë me VV-në nga fillimi i vitit 2015.

Ish-ambasadori amerikan në Kosovë Grag Delawie, në mbështetje të mendimit të ekspertëve dhe analistëve të State Departamentit, theksoi se “Kufiri është aty ku ka thënë Komisioni, rrejshëm po thonë se humbin 8.000 ha”.⁵⁶ Dhe “ata që thonë se kufiri është dashur të vendoset sipas hartave, historisë apo nostalgjisë kjo nuk është e përshtatshme për ditët e sotme. Të dëshirosh që historia të jetë ndryshe nuk është bazë reale për marrëveshjet reale”.⁵⁷ “Janë kufijtë e njëjtë që janë dërguar në Euro-Geographics para shpalljes së pavarësisë, janë shënuara sipas planit Ahtisari dhe këta kufij shihen edhe në flamurin e Kosovës. Po të ishte ndryshe do të duhej përcaktuar tjetër flamur”.⁵⁸ Edhe Komisioni Shtetëror për Matjen e Territorit të Republikës së Kosovës (KSHMTRK), i përbërë nga 12 përfaqësues të organizatave dhe agjencive profesionale, shkencore, menaxheriale dhe të shoqërisë civile, me pjesëmarrjen e disa përfaqësuesve të instancave ndërkombëtare në cilësi të vëzhguesve (NATO, BE, SHBA), ka gjetur se Kosova nuk humb asnjë metër katrore. Sipas tij territori i Republikës së Kosovës ka 10.905 km katrore.⁵⁹ Por edhe Komisioni Ad-Hoc profesional i ftuar nga Presidentja Jahjaga më 30 mars 2016 (në përbërje Fletcher M. Burton nga SHBA, Dr. Ing. Herbert Wilmes nga Gjermania dhe Fred Newton nga Anglia) erdhi në përfundim se Kosova nuk humb asnjë pëllëmbë nga sipërfaqja e saj.⁶⁰

Me gjithë orientimin dhe simpatitë e shqiptarëve për Europën dhe Perëndimin, Europa nuk u tregua e gatshme që t’ua hapë rrugën. Qëndrimi i saj më tepër se një shekull nuk evoluoi pozitivisht ndaj çështjes shqiptare. Përkundrazi, Europa u rreshtua në anën e hegjemonizmit serb dhe të fuqive të tjera antishqiptare, duke i copëtuar territorialisht, kështu që sot e gjithë ditën ndjehen pasojat nacionale, ekonomike, politike,

⁵⁶ Grag Delawie, “Koha ditore”, 4 gusht 2016, f. 2.

⁵⁷ Grag Delawie, *Po aty*.

⁵⁸ Grag Delawie, *Po aty*.

⁵⁹ Shih Raportin e hollësishëm të Komisioni Shtetëror për Matjen e Territorit të Republikës së Kosovës (KSHMTRK) në faqen e Qeverisë të dt. 8. 03. 2017, që udhëhiqej nga Kryeministri Isa Mustafa, ku gjendej e gjithë faktografia, në qindra faqe (gjeoinformacioni, hartat e kadastrit të tokave, hartat topografike, skicat, të dhënat statistikore, planet zhvillimore e mjedisore, baza ligjore, faktet shkencore etj., që lidhen me madhësinë territoriale të Kosovës dhe të njëjësive më të vogla territoriale-administrative).

⁶⁰ Shih gjetjet e hollësishme të tij në: H. Islami, *Demografia e Kosovës*, ASHAK, Prishtinë, 2021, ff. 804-805.

sociale, familjare etj.⁶¹ Në fund të shek. XX, me bombardimet e NATO-s mbi forcat serbe, Kosova u bë një problem i madh europian dhe botëror, por edhe potencial i krizës në marrëdhëniet me Serbinë dhe tendencat e Ruisë që përmes saj të provokojë konflikte në Kosovë dhe ta destabilizojë rajonin dhe më gjerë.

Kontesti rreth Kosovës dhe për Kosovën, që zhvillohet midis shqiptarëve dhe serbëve për një kohë të gjatë ka një histori shekullore. Kontesti deri në ditët tona zhvillohej mbi bazë të argumenteve të njëjta, por të ndryshme për palët e konfrontuara; argumentet janë të karakterit historik dhe etniko-demografik. Serbët qysh në kohën e sundimit turk kishin aspirata që Kosovën ta fusnin nën juridiksionin e tyre me arsyetim se edhe në mesjetë i përkiste shtetit serb dhe se Kosova paraqet “zembrën dhe shpirtin serb”. Ndërkaq, shqiptarët e konsideronin si pjesë të pandashme të tërësisë etnike dhe, më vonë, të shtetit shqiptar, me arsyetim se është popull shumë më i vjetër se serbët dhe sllavët në Ballkan, se shumica absolute e popullatës është shqiptare dhe se lëvizja shqiptare për çlirim dhe pavarësi ishte pikërisht më e forta në Kosovë.⁶²

Konfrontimi i shqiptarëve me regjimin hegjemonist serb deri në vitin 1999

Pas vdekjes së Titos (1892-1980), ashtu siç pritej, në Kosovë nisi kriza e sistemit dhe shtetit jugosllav. Meqenëse Kosova ishte hallka më e dobët në sistemin e shtetit jugosllav, strukturat e shërbimeve partiake, policore dhe ushtarake serbe në Kosovë e nxitën krizën në formë të konfrontimit të Serbisë me shqiptarët, pastaj edhe me popujt tjerë – me sllovenët, kroatët dhe boshnjakët. Krizën në Kosovë duhet parë në kuadër të krizës së përgjithshme të ish-Jugosllavisë, që rezultoi nga kundërtëhëniet

⁶¹ Në truallin gjeoetnik të shqiptarëve u bë edhe prerja e kulturave perëndimore dhe lindore, që lë pasoja të shumënduarshme, ndërsa tragjeditë më të mëdha nacionale, ekonomike, politike, sociale, familjare etj. shqiptarëve u kanë sjellë *injorimi i vullnetit politik dhe ndarjet e njëpasnjëshme, të imponuara e të dhunshme*, të cilat vetëm në shek. XX u përsëritën disa herë: deri më 1912 vilajetet, formimi i shtetit të cinguar shqiptar më 1913, midis dy Luftërave Botërore banovinat, gjatë Luftës II Botërore zonat okupuese dhe në kohën e Jugosllavisë komuniste shqiptarët u ndanë në një krahinë autonome (Kosova) dhe në tri republika të tjera (Maqedonia, Serbia, Mali i Zi). Shih më gjerë në: R. Ismalji, “Shqiptarët dhe Evropa Juglindore”, “Thema”, 11, Prishtinë, 1993, f. 29-38.

⁶² Më gjerë shih në: Sh. Maliqi, *Nyja e Kosovës (As Vllasi, as Millosheviqi)*, “Knjižna zbirka KRT”, Ljubljana, 1994.

dhe konfliktet e brendshme, të akumuluar gjatë gjithë periudhës së ekzistimit të këtij shteti, e këto janë moszgjidhja e çështjes nacionale dhe mungesa e demokratizimit të shoqërisë. Por në këto hapësira ballkanike konfliktet e brendshme dhe antagonizmat ndërtnike ishin më të mëdha se çdokund tjetër. Jugosllavia e Versajës, ashtu siç u krijua mbi bazë të forcës ushtarake dhe të politikës hegjemoniste serbe, ashtu edhe u shkatërrua nga veprimi i konceptit të shtetit unitarist e hegjemonist.⁶³ Titoja me reformën e Federatës dhe formimin e udhëheqjes kolektive federative duket se donte ta pengonte vendosjen e çfarëdo hegjemonie pas tij. Mirëpo trashëgimtarët e tij nuk u treguan të aftë ta zgjidhnin krizën si ekonomike, ashtu edhe politike dhe t'u kundërviheshin tendencave të hegjemonizmit serb; mungesën e autoritetit suprem politik të gjitha qarqet serbe nisën ta shfrytëzojnë si përgatitje për dominim, që në fund shpuri në shpërbërjen e Jugosllavisë përmes rrugës së përgjakshme.⁶⁴

Ushtria (APJ-JNA) mbeti pa komandant suprem, ndërsa, në këtë fazë, elitës ushtarake i përgjigjej një njeri i tipit të Millosheviqit, i cili angazhohej për ruajtjen e Jugosllavisë njëpartiake, unitare dhe autoritare, ku do të sundonin serbët. “Kur u themelua Jugosllavia pas Luftës I Botërore, interesi kryesor i Serbisë ishte që gjithë serbët të jetonin në një shtet të vetëm. Para Titos Serbia e kishte dominuar këtë shtet. Tash pas Titos Millosheviqi kërkonte të rivendoste këtë dominim. Në fund të viteve 1980 pengesa e tij kryesore ishte Sllovenia, ironikisht e vetmja republikë që nuk kishte një numër të madh serbësh. Sllovenët ishin të parët që i bënë sfidë unitetit të Jugosllavisë”.⁶⁵ Pas vdekjes së Titos ideologjia komuniste u zëvendësua nga nacionalizmi serbomadh, me tendencë që të gjithë serbët të “bashkohen në një shtet të vetëm serbomadh... Në mars të vitit 1989 Parlamenti i Serbisë shfuqizoi statusin autonom të Kosovës. Ishte ky fillim i politikës brutale të shtypjes së popullatës shumicë shqiptare nga ana e Serbisë. Që nga ai moment në shkolla dhe universitete nuk mund të ligjërohej dhe të mësohej më në gjuhën shqipe. Policia dhe sistemi shëndetësor u pastruan nga shqiptarët, ndërsa në fillim të vitit 1989 në Kosovë u vendos gjendja e jashtëzakonshme. Ky hap i Qeverisë në Beograd u pasqyrua me dhunën pa kontroll të aparatit serb të sigurisë të ushtruar kundër popullatës shumicë shqiptare”.⁶⁶

⁶³ Sh. Maliqi, *Po aty*, ff. 283-289.

⁶⁴ Më gjerë në: P. Garde, *Vie et mort de la Yougoslavie*, “Fayard”, Paris, 1992.

⁶⁵ W. Zimmermann, *Burimet e një katastrofe*, “Besa (Libra për një shoqëri të hapur)”, Tiranë, 1996, f. 27.

⁶⁶ J. Fischer, *Vitet kuq-gjelbër. Politika e jashtme gjermane – nga Kosova e deri më*

Mirëpo pas vdekjes së Titos dhe sidomos pas shkatërrimit të LKJ-së (1990), Armata Jugosllave, e cila dominohej nga serbët, bënte politikën shtetërore.⁶⁷ Kosova e cila ballafaqohej me probleme të mëdha ekonomike, sociale e nacionale në krizën e sistemit federativ ishte hallka më e dobët. Sipas dëshmive të Fadil Hoxhës, udhëheqësit kryesorë të Kosovës në majën e pushtetit politik jugosllav, vërehet qartë se demonstratat e vitit 1981 në Kosovë ishin tashmë të përgatitura nga qarqet antishqiptare dhe vetëm pritej vdekja e Titos.⁶⁸ Pas vdekjes së Titos forcat hegjemoniste e shfrytëzuan Kosovën⁶⁹ për hapjen e të ashtuquajturës “çështje serbe” në Jugosllavi nga pozitat nacionaliste dhe shtetomëdha, duke propaguar tezën se Serbia nuk është e barabartë me republikat e tjera, ndërsa serbët si popull më i madh gjithkund janë të shtypur: në Kosovë, në Kroaci, në BeH etj. Shqiptarofobia dhe shovinizmi serb u shtrinë gjerësisht në të gjitha shtresat e shoqërisë serbe, duke shpikur teza që hyjnë në modelin gjenocidal të të menduarit dhe

11 shtator, “Koha”, Prishtinë, 2008, f. 99.

⁶⁷ M. Hadžić, “Srpski kraj jugoslovenske armije”, në botimin “*Srbija između prošlosti i budućnosti*”, Beograd, 1995, ff. 281-299; D. Janjić, “Srbija između krize identiteta i izazova modernizacije”, në “*Srbija između prošlosti i budućnosti*”, f. 24.

⁶⁸ “Në vitin 1981 Tito nuk ishte gjallë. Qysh kur ka qenë gjallë, kanë pas bërë njëfarë përgatitje. Me vdekjen e Titos thoshin se do të ndodhë dita X. Thoshin se do të bëhen kryengritje, do të shkatërrohej Jugosllavia. Përgatitjet kanë qenë bukur të mëdha. Edhe në radhët e udhëheqjeve të Jugosllavisë, të Serbisë dhe të Kosovës ka qenë gjithmonë prezente ideja që Kosova të mos na shërbejë objekt i shkallëzimit të marrëdhënieve të tilla. Ka qenë këtu hallka më e hollë, që mund të këputej, që mund të nxiteshin nacionalizma të ndryshëm, por edhe emocione të ndryshme” (*Fadil Hoxha në veten e tretë – me shënime dhe parathënie të Veton Surroit*, “Koha”, Prishtinë, Qershor 2010, f. 326).

⁶⁹ Historiani i njohur Noel Malcolm, që në fillim të librit të tij të njohur “Kosova – një histori e shkurtër” (1998), pas përfundimit të luftërave të përgjakshme në Kroaci dhe në BeH, kishte një observim interesant për çështjen e Kosovës dhe zgjidhjen e saj. Ai theksonte se “Asnjëri nuk e di se si do të përfundojë çështja e Kosovës. Zgjidhjet e mundshme përfundimtare përfshijnë autonominë, ndarjen dhe pavarësinë, kurse mjetet e realizimit të tyre mund të jenë si negociatat paqësore ose imponimi ndërkombëtar, ashtu edhe paduegjueshmëria qytetare, si intifada me dhunë, ashtu edhe lufta e vërtetë. Mirëpo të gjitha palët mund të pajtohen se çështja e Kosovës është, thënë thjesht, një ndër konfliktet më të ndërlikuara politike në Ballkan. Kjo është pa dyshim një ndër rajonet me shkeljet më të rënda të të drejtave të njeriut dhe të lirive qytetare në mbarë Europën; me siguri është edhe vendi ku, në qoftë se shpërthen lufta, vrasjet dhe shkatërrimet do të jenë të përmasave shumë më të mëdha se çdo gjë që është parë deri tash në këtë rajon” (N. Malcolm, *KOSOVA – një histori e shkurtër*”, “Koha”, Prishtinë, 1998, f. xxiii).

të sjelljes. U nxorën disa dokumente partiako-shtetërore me përmbajtje neomaltusianiste dhe raciste për pengimin e natalitetit të shqiptarëve; një shkrimtar i njohur serb (M. Beçković), me rastin e një vizite në Izrael, kishte deklaruar: "Më vjen shumë keq që nuk kam marrë me vete një kafaz me një shqiptar që të shihni se çfarë egërsirash janë". Por "zbulimi" më i madh që bënë forcat neohegemoniste serbe, të tubuara rreth Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, Shoqatës së Shkrimtarëve të Serbisë, Universitetit të Beogradit, Kishës Ortodokse Serbe etj. Sipas tyre, burim i problemit në Serbi dhe Jugosllavi ishte barazia e shqiptarëve me serbët dhe "diskriminimi" i serbëve të Kosovës mbi bazë të Kushtetutës së vitit 1974 dhe statusi politik i Kosovës në ish-Federatën Jugosllave.

Disa versione serbe të zgjidhjes së çështjes së Kosovës

Sa i përket çështjes së Kosovës, Serbia zyrtare dhe qarqet e ndryshme serbomëdha nga fundi i viteve '60 të shekullit të kaluar e deri në intervenimin e NATO-s (mars 1999) kishin pasur disa variante të zgjidhjes së saj, por gjithnjë në dëm të shqiptarëve. Statusi konstitucional-politik i Kosovës me Kushtetutën e vitit 1974 bënte përjashtim, sepse ishte arritur pa vullnetin e Serbisë; kjo Kushtetutë si duket ishte përgatitur për t'u zbatuar pas vdekjes së Titos. Përveç mbetjes së Kosovës brenda sistemit juridiko-politik të Serbisë, variantet, me shumë ose me pak përkrahje, varësisht nga evolucioni i pozitës së përgjithshme të Serbisë në ish-Jugosllavi dhe më gjerë, ishin edhe rikolonizimi, ridefinimi territorial i Kosovës, enklavizimi, ndarja e saj në dy entitete apo edhe ndarja midis shqiptarëve dhe serbëve, që e mbështeste "babai" i kombit serb dhe inspiruesi i të gjitha tragjediave në ish-Jugosllavi Dobrica Qosiqi. Me tezën për ndarjen e Kosovës qysh nga fundi i viteve 60 kishte dalë "babai" i kombit serb, Dobrica Qosiqi. Kur u bë kryetar i të ashtuquajturës Jugosllavi e Zhablakut (1992), si zgjidhje definitive të problemit të Kosovës dhe, më konkretisht, të çështjes shqiptaroserbe, siç thoshte ai, projektin për ndarjen e Kosovës në fillim të vitit 1993 (60:40% në favor të serbëve) ia paraqiti edhe bashkëkryetarëve të Konferencës së Gjenevës për ish-Jugosllavi, S. Vensit dhe D. Ovenit në selinë e OKB-së në Gjenevë. Mirëpo, me sa dihet, këta dy diplomatë të rangut të lartë këtë projekt e hodhën poshtë pa diskutim.

Ndërkaq, Millosheviqi dhe regjimi i tij vazhdonin ta shihnin Kosovën vetëm si pjesë integrale të Serbisë, Kosovën me numër të reduktuar të shqiptarëve (600.000 deri 800.000) ose madje pa shqiptarë në

saje të zbatimit të politikës së spastrimit etnik etj. Këtë fakt dhe këtë strategji të reduktimit të numrit të shqiptarëve e dëshmuuan në procesin gjyqësor kundër Millosheviqit në Hagë edhe shumë dëshmitarë të kombësisë serbe, të afërt me Millosheviqin dhe partinë e tij në vitet '90 të shekullit të kaluar.⁷⁰ Ruajtja me çdo kusht e ish-Jugosllavisë ishte një gabim i rëndë i Europës dhe Perëndimit në përgjithësi, sikundër që pati përpjekje të ruhej edhe Unioni Serbi-Mal i Zi, disproporcional në madhësi territoriale dhe demografike, deri te disfunkcionalizimi dhe rrjedhimisht dekompozimi i tij. Kur Mali i Zi vendosi të dalë nga Unioni me Serbinë dhe të pavarësohet në vitin 2006 përmes referendumit, BE-ja i vuri kusht që duhet mbështetja jo e standardit 50+1, por validitetin e rezultatit e çoi në 55% të numrit të përgjithshëm të votuesve (!); referendumi ishte i suksesshëm, ngase votuan pro 55,4%, ku roli i boshnjakëve dhe i shqiptarëve ishte vendimtar. BE-ja donte me çdo kusht ta pengonte shkëputjen e Malit të Zi nga Unioni edhe për shkak se nuk donte që Kosova të pavarësohej.

Në vazhden e ideve dhe projekteve të shumta të qarqeve e institucioneve shkencore, kulturore dhe kishtarë serbe, si dhe të të gjitha regjimeve serbe për pastrime etnike, krime e veprime gjenocidale me qëllime ekspansioniste e shtetomëdha këto dy shekujt e fundit duhet veçuar një projekt të Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, të iniciuar jo nga një grup akademikësh,⁷¹ siç thuhej në fillim, por nga organet më të larta të këtij institucioni në gjysmën e viteve 80 të shekullit të kaluar dhe më saktësisht në vitin 1986, kur edhe doli në opinion me emrin “Memorandumi”.⁷² Në synimet shekullore për formimin e Serbisë

⁷⁰ Dëshmitari i partisë “Nova demokratija”, kundër S. Millosheviqit në Tribunalin e Hagës, Ratomir Taniq, disa herë në koalicion qeveritar me Partinë Socialiste të Millosheviqit, përveç të tjerash, theksoi se politika e reduktimit të numrit të shqiptarëve në Kosovë përmes spastrimit etnik ishte qëllim dhe strategji e regjimit të Millosheviqit (Shih: “Koha ditore”, 21-22 maj 2002).

⁷¹ Thuhej se Memorandumi është paraqitur si një dokument “i papërfunduar”. Mirëpo akademiku Mihajlo Marković pohon se “Memorandumi kishte qenë i përfunduar, por se shpërndarja në opinion kishte ndodhur para miratimit procedural”, pohon Llatinka Perović në bisedë me gazetarin Skënder Latifi. Shih botimin: Skënder Latifi, *Ashtu ka qenë*, “Qendra Multimedia”, Prishtinë, 2021, f. 88. Edhe akademik Vasilije Krestić, anëtar i Grupit punues të Memorandumit, në fund të vitit 2017 thotë se “dokumenti ishte i përfunduar dhe i lektuar, por nuk kishte vendim zyrtar që të publikohej” (Wikipedia, hr.m.wikipedia.org).

⁷² “Memorandum” SANU (Grupa akademika Srpske akademije nauka i umetnosti o aktuelnim društvenim pitanjima u našoj zemlji). Teksti i këtij “Memorandumi” merret nga revista “*Naše teme*”, 33 (1-2), Zagreb, 1989, ff. 128-163. E përktheu në shqip Hivzi Islami.

së Madhe, ky dokument nuk është larg programeve serbomëdha në rrethana të tjera, çfarë janë “Načertanije” e Ilija Garashaninit (1844),⁷³ “Srbi svi i svuda” e Vuk Karaxhiqit,⁷⁴ “Homogena Srbija” e Stevan Moleviqit⁷⁵ etj. Në hartimin e “Memorandumit” si “program strategjik i intiligjencisë serbe”, të mbështetur nga strukturat shtetërore të Serbisë së kohës së S. Millosheviqit, morën pjesë emra të njohur të shkencës dhe të kulturës serbe, të cilët pas ngjarjeve të vitit 1981 në Kosovë, ishin angazhuar në përpilimin e suazave shkencore dhe politike në zbatimin e dhunës, të migrimeve “humane” dhe të gjenocidit ndaj popujve joserbë.

Ndonëse ishin të rralla, megjithatë nuk munguan edhe reagimet e ndonjë autori serb për “Memorandumin” si produkt shkatërrimtar për ish-Jugosllavinë. “Për tragjedinë e tashme të Serbisë dhe të popullit serb përgjegjësinë themelore e bart inteligjencia serbe. Luftërat e tashme janë njëherësh edhe disfatë e plotë e saj: ajo i përgatiti këto luftëra, për to u përpoq, popullin e ftoi në to, kurse sot nuk di fare të përgjigjet pse po bombardohen qytetet, po digjen kishat dhe po vriten fëmijët. Pasi të kesh nxitur dhe çmendur popullin me vite të tëra, të thuash se një zhvillim i këtillë ishte i papritur (si tha para disa muajsh Qosiqi) do të thotë ose të jesh plotësisht i verbër (gjë që e diskrediton plotësisht atë që thotë kështu), ose të jesh plotësisht hipokrit”.⁷⁶ Akademikët dhe intelektualët serbë kishin vënë bazat ideologjike dhe shkencore për dëbimin dhe shfarosjen biologjike të shqiptarëve edhe midis dy luftërave botërore dhe menjëherë pas saj, siç bënë akademiku Vasa Çubrilloviqi më 1937 e 1944 dhe nobelisti Ivo Andriqi më 1939.

Qëllimi i “Memorandumit” ishte pa dyshim krijimi i Serbisë së Madhe ose dominimi serb në gjithë Jugosllavinë komuniste, që duhej të arrihej me përdorimin e forcës ushtarake (APJ-së) përmes ndërrimit të

⁷³ M. Vučković, *Program spoljne politike Ilije Garašanina na koncu 1844 godine*, Delo XXXVIII, Beograd, 1906, ff. 321-336 dhe D. Stranjaković, “Kako je postalo Garašaninovo “Načertanije”, “Spomenik SKA”, XCI, Beograd, 1939, ff. 76-102.

⁷⁴ V. Stefanović Karadžić, “Crna Gora i Boka Kotorska, “Kovčević za istoriju, jezik i običaje Srba sva tri zakona, 1. Članak”, Beograd, 1972, ff. 113-134; sipas: *Izvori velikosrpske agresije*, Rasprave-dokumenti, (Red. B. Čović), “A. Cesarec”-“Š. Knjiga”, Zagreb, 1991, ff. 81-98.

⁷⁵ S. Moljević, “Homogena Srbija, programski dokument”, *Zbornik dokumenata i podataka o narodnooslobodilačkom ratu naroda jugoslavije, XIX, knjiga I, Dokumenti četnickog pokreta Draže Mihajlovića 1941-1942*, Vojnoistorijski institut, Beograd, 1981, ff. 1-10; sipas: *Izvori velikosrpske agresije*, Rasprave-dokumenti, (Red. B. Čović), “A. Cesarec”-“Školska Knjiga”, Zagreb, 1991, ff. 141-147).

⁷⁶ Branko Milanović, *Milošević i srpska inteligencija*, “Borba”, 22. 11. 1992.

dhunshëm të Kushtetutës së vitit 1974, zbatimit të represionit, luftës dhe krimeve masive e gjenocidit ndaj shqiptarëve, kroatëve dhe boshnjakëve, gjë që edhe ndodhi midis viteve 1990 dhe 1999, derisa nuk u mposht definitivisht makineria ushtarako-policore serbe në fillim të qershorit 1999 me intervenimin e forcave të NATO-s. “Memorandumi” i paraqiste shqiptarët si armiq shekullorë, të cilët, njëherësh biologjikisht e pastaj edhe politikisht kinse po e rrezikonin popullin serb, hapësirën e tij jetësore dhe prosperitetin gjeodemografik, kombëtar dhe ekonomik të sllavëve të jugut, veçanërisht të serbëve. Aty madje shqiptarët akuzohen edhe për raste perverse, çfarë ishte rasti “Martinoviq”, kur ky serb i sëmurë nga Gjilani, në maj të vitit 1985, për motive vetëkënaqësie, kishte futur një shishe në prapanicë. Për këtë rast u alarmuan edhe organet politike-partiake, policore dhe ushtarake të Serbisë dhe të Jugosllavisë; u bënë shumë shkrime në media, u shkrua madje edhe një libër i tërë me rreth 500 faqe.⁷⁷

Krimi dhe gjenocidi ishin të paramenduar dhe të planifikuar nga strukturat politike, shtetërore dhe ushtarake të Serbisë, ndërsa arsyetimin dhe legjitimitimin e tyre e bënë intelektualët,⁷⁸ shkencëtarët, shkrimtarët serbë, mediet serbe dhe Kisha ortodokse serbe; intelektualët serbë ishin pikërisht ata që në vitet 80 të shekullit të kaluar inicuan idenë dhe projektin e “pacifikimit” të Kosovës sipas modelit izraelit. Këtë e bëri me dije sociologu i njohur slloven, Rudi Rizman, në simpoziumin “Kosovo-Serbija-Jugosllavija” në fillim të vitit 1989. “Kam menduar se është ky një konstruksion utopik, por më duhet të them se nga shokët e mi serbë, intelektualët, kam marrë një kundërgargument që flet për mundësinë e pacifikimit, duke pasur parasysh atë që ka ndodhur në Izrael, pacifikimi madje në një funksion civilizues. Kjo ide është e mundur të shpjegohet

⁷⁷ Shih: S. Stanojević, *Shučaj Martinović*, “Partizanska knjiga”, Beograd, 1986, ff. 1-485. Edhe Akademia Serbe (SANU) në “Memorandumin” e saj e politizoi këtë rast deri në ekstrem për ta akuzuar pozitën kushtetuese-juridike të Kosovës, duke nënvizuar: “Rasti i Martinoviqit është i rëndësishëm jo vetëm për shkak të dhunës së veçantë, të paparë, që të përkujton kohët më të errëta turke të nguljes në hu, por edhe për shkak të refuzimit energjik që në procedurën e rregullt gjyqësore të vërtetohet dhe pranohet e vërteta. Në vend që të jetë shkas për të dëshmuar vlerat supreme të ligjit dhe të drejtave të njeriut, ky rast në Kosovë është kuptuar si rrethanë që të theksohet sovraniteti i Krahinës, të cilin ajo as sipas Kushtetutës nuk e ka, dhe, në anën tjetër, që RS të Serbisë t’i imponohet parimi “i mospërzierjes në punët e brendshme” të Krahinës, sikurse të jetë fjala për raportin ndërshtetëror, ndërkombëtar” (*Memorandum SANU*, Beograd, 1986).

⁷⁸ Shih diskutimin e prof. Rudi Rizmanit në Simpoziumin, punimet e të cilit u publikuan në: *Zbornik Kosovo-Srbija-Jugosllavija*, “Knjižna zbirka KRT”, Ljubljana, 1989, ff. 66-67.

dhe kuptohet racionalisht në atë mënyrë që plotësisht pajtohem me rrezikun e imitimit të një modeli, të një paradigme e cila në përmasa jugosllave do të ishte e trishtueshme dhe e cila do të kishte efekte fatale, më shumë se që kishte kthimi i hebrenjve në Palestinë”.⁷⁹

Në këtë funksion ishte pikërisht “Memorandumi” si projekt i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, i përgatitur gjatë dhe i shkruar e i arsyetuar “shkencërisht”. Për ta arritur këtë objektiv duhej të shkatërrohej Jugosllavia dhe atë jo me rrugë paqësore, por me krime dhe gjakderdhje masive. Që në fillim “Memorandumi” parashihte se kriza e shtetit të atëhershëm nuk “përrjashton përfundimin edhe ashtu katastrofik, çfarë është rrënimi i bashkësisë shtetërore jugosllave”. Për regjimin e Millosheviqit ky projekt ishte platforma kryesore e veprimit për 15 vjet rresht, por “Millosheviqi nuk e prodhoi Memorandumin; atë e krijoi atmosfera që e krijoi Memorandumi”.⁸⁰ “Memorandumi” ishte një lloj *in memoriam* për Jugosllavinë komuniste. Lidhur me “Memorandumin”, Llatinka Peroviçi, historiane e shquar dhe ish-politikane e Serbisë, theksoi: “Sipas përmbajtjes së vet dhe sipas karakterit të krijuesve të tyre, ky dokument mund të krahasohet me platformën e Klubit Kulturor Serb nga viti 1937, por me një ndryshim që nga platforma e Klubit Kulturor Serb gjatë kohës së Luftës II Botërore veçoi Qeveria në emigracion dhe Lëvizja e Ravnagorës nën komandën e saj, kurse “Memorandumi” solli deri te konsenzusi në Serbi kundër Kushtetutës koncensuale nga viti 1974, dhe këtë në një kthesë të rëndësishme historike në të cilën do të gjendej Serbia, pa marrë parasysh shpartallimin e regjimeve komuniste në Europën Lindore pas vdekjes së Josip Broz Titos”.⁸¹

Politikat hegjemoniste, kolonialiste dhe kolonizuese serbe ndaj Kosovës dhe shqiptarëve

Me qëllim që të justifikonte ndërmarrjet kolonialiste dhe dhunën ndaj shqiptarëve, përfshirë kolonizimin klasik pushtetit serb ka manipuluar shumë me faktorin demografik shqiptar të Kosovës. Me këtë

⁷⁹ R. Rizman, *Po aty*, ff. 66-67.

⁸⁰ L. Perović, *Dominantna i neželjena elita (Beležke o intelektualnoj i političkoj eliti u Srbiji – XX-XXI vek)*, II izdanje, *Dominantna i neželjena elita (Beležke o intelektualnoj i političkoj eliti u Srbiji (XX-XXI vek)*, II izdanje, “Dan Graf” – “Javna medijska ustanova Radio-televizija Vojvodine”, Beograd-Novi Sad, 2016, f. 46.

⁸¹ Ligjëratë e Llatinka Peroviçit, e penguar të mbahej nga Kisha Ortodokse Serbe dhe udhëheqësit serbë më 26 tetor 2008 në Beograd. Shih: P. Imami, *Serbët dhe shqiptarët ndër shekuj*, “SAMIZDAT”, Vëllimi II, B92, Beograd, 2017, f. 117

manipulim nuk pushoi jo vetëm deri në çlirimin dhe pavarësinë e saj, por vazhdon edhe sot e gjithë ditën. Serbia ka shumë kohë që normën e lartë të natalitetit të shqiptarët e ka konsiderua armikun numër një, duke derdhur lot krokodili për mposhtjen e saj. Me një qasje të neomaltusianizmit *sui generis*, me elemente raciste provoi disa herë që ta pengonte përparimin vitalo-demografik të shqiptarëve me masa kundërhumane, antisociale dhe administrative, madje i kishte parasysh edhe përvojat e hidhura të tipit indiano-kinez. U nxorën edhe disa dokumente partiakeshtetërore me përmbajtje neomaltusianiste për pengimin e normës së lindshmërisë.⁸² Deri në ditët tona pushteti serb provoi me politikat hegjemoniste, kolonialiste, kolonizuese dhe dëbime masive me mjete ushtarake me qëllim që ta pastronte Kosovën nga shqiptarët dhe ta serbizonte atë.⁸³ Por këtë objektiv, fatmirësisht, për arsye të ndryshme, kryesisht gjeopolitike, nuk arriti ta realizonte. Herën e fundit provoi në Vitin e Madh 1999, por edhe këtu dështoi, duke lënë pas krime të llahtarshme në njerëz dhe shkatërrime masive materiale. Edhe midis dy luftërave botërore, por edhe pas tyre, Serbia dhe ish-Jugosllavia problemin e shqiptarëve planifikonin ta zgjidhnin me dëbimin e tyre në Turqi, në shkretëtirat e Anadollisë, por duke mos përjashtuar as nënshtrimin kulturor dhe asimilimin e tyre për çka po ashtu dështoi.

Gjeopolitikat dhe politikat e spastrimeve etnike të Serbisë ndaj shqiptarëve vazhduan gjatë gjithë shekullit XX, me intensitet të ndryshëm, varësisht nga rrethanat e përgjithshme në Ballkan dhe në Europë për të arritur kulminacionin në fund të viteve 90. Vetëm në gjysmën e parë të vitit 1999 ajo deportoi afër një milion shqiptarë të Kosovës me mjete dhune dhe gjenocidi; pjesa dërmuese e tyre u vendos në Shqipëri e Maqedoni dhe në vendet e tjera. Ndërkaq, indiferenca e BE-së dhe e bashkësisë ndërkombëtare ndaj shtypjes dhe terrorit serb mbi shqiptarët zgjati deri më 24 mars 1999, kur NATO-ja dhe SHBA-ja me aleatët intervenuan ushtarakisht dhe e ndalën tragjedinë humanitare dhe politiken e spastrimit etnik ndaj shqiptarëve.

⁸² S. Drakulić, “Natalitet i represija”, *“Danas”*, br. 310, 26. Siječnja 1988, Zagreb, f. 30.

⁸³ V. Čubrilloviq qysh më 1937, në Klubin Kulturor Serb, e theksonte këtë faktor të progresit popullativ të shqiptarëve, duke nënvizuar se “kemi të bëjmë me një racë të gjallë, të fuqishme dhe pjellore, për të cilën Cvijiqi thoshte se është raca më ekspansive në Ballkan dhe se pjellshmëria e grave shqiptare ka ngadhënjyer mbi politikën tonë të kolonizimit” (V. Čubrillović, *Iseljavanje Arnauta*, Predavanje održano u Srpskom kulturnom klubu od Dr. Vase Čubrillovića, 7. marta 1937. godine, “Vojnoistorijski institut”, “Arhiv bivše jugoslovenske vojske”, br. 2, Fasc. 4, kutija 69 (në shtojcë: një hartë, dy tabela dhe dy grafikone; teksti ka 19 faqe makine, i shkruar me alfabet cirilik, në original është i nënshkruar me dorë).

Kualifikimi i demonstratave të vitit 1981 si “kundërrevolucionare” kishte pasoja të rënda për Kosovën. “Klasa politike jugosllave ra në provim në Kosovë. Nga presioni i një pjese të kreut politik jugosllav, por edhe atij serb, edhe udhëheqja kosovare e pranoi fatkeqësisht (ndoshta me gjysmëzëri), vlerësimin se demonstratat ishin kundërrevolucionare”.⁸⁴ Statusi politik i Kosovës mbi bazë të Kushtetutës së vitit 1974 dhe barazia e shqiptarëve me serbë shihej si pengesë për forcat hegjemoniste serbe. “Memorandumi” i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve (1986),⁸⁵ si produkt i inteligjencisë serbe, u bë platforma kryesore për veprimet shkatërrimtare serbe dhe politikën e Millosheviqit për krijimin e Serbisë së Madhe përmes përdorimit të forcës ushtarake (JNA-APJ).

Ish-republikat joserbe dhe ish-organet e Federatës, duke menduar se Serbia do të ndalet në Kosovë, iu dhanë përkrahje të plotë veprimeve policore e ushtarake dhe e ndihmuan materialisht represionin dhe segregacionin ndaj shqiptarëve. Të gjitha entitetet shtetërore-politike e dhanë pëlqimin që në Kosovë të vihej gjendja e jashtëzakonshme, të likuidohej me forcë autonomia federale, të vendosej sistemi diskriminues e kolonial dhe të stimulohej politika e kolonizimit të serbëve me qëllim që të ndërrohej struktura etnike e Kosovës. Millosheviqi e shfrytëzoi mirë këtë përkrahje të ish-Jugosllavisë dhe duke manipuluar me mitin mbi Kosovën dhe duke i instrumentalizuar serbët e Kosovës, e forcoi pushtetin. BE-ja dhe bashkësia ndërkombëtare përgjithësisht bënë gabime me pasoja të mëdha kur Kosovën nuk e trajtuan të barabartë me njësitë e tjera të ish-Federatës, por u nisën nga gjendja e krijuar pas vitit 1989, e vënë me mjete policore dhe ushtarake. Me indiferencën ndaj dhunës në Kosovë deri më 1991 dhe me pranimin e gjendjes faktike të krijuar pas suprimimit të autonomisë federale faktori ndërkombëtar e mbështeti politikën e aktit të kryer (fait accompli), që e kurajonte Serbinë për sjellje edhe më agresive ndaj shqiptarëve, ndërsa Millosheviqin e pranonte si një njeri të paqes.

Pas Marrëveshjes së Daytonit, të nënshkruar në nëntor të vitit 1995, SHBA-ja arriti ta ndalë luftën në BeH, “por njëkohësisht nuk kishte hapur një perspektivë thelbësore strategjike për rajonin në tërësi.

⁸⁴ Llatinka Peroviç në bisedë me gazetarin Skënder Latifi. Shih botimin: S. Latifi, *Aшту ka qenë*, “Qendra Multimedia”, Prishtinë, 2021, f. 82.

⁸⁵ “Memorandumi” për herë të parë doli në opinion publik në gazetën “Večernje novosti” më 25 shtator 1986 (në vazhdim).

Në ndërlidhje me krizën në Kosovë, kjo duhej të korrigjohet domosdo”.⁸⁶ Pas kësaj Marrëveshjeje, “shqiptarët e Kosovës e kuptuan se pa luftë nuk do t’i realizonin kurrë synimet e tyre kombëtare. Ngase Marrëveshja e Dejtonit nuk e përfshiu Kosovën, dhe kjo do të dëshmohej si një gabim i madh... Edhe kritikët në anën tjetër të spektrit argumentojnë gjithashtu me të drejtë, se mospërfshirja e Kosovës vetëm sa ka hapur shtegun për luftën e ardhshme. Nganjëherë diplomacia ishte përballur me detyra që nuk mund t’i zgjidhte, pa situata tragjike. Dejtoni ishte një situatë e tillë”.⁸⁷ Edhe “arkitektja” e çlirimit të Kosovës, Sekretarja e Shtetit Madeleine Albright (1937-2022), në librin e saj nënvizonte se pas Marrëveshjes së Daytonit shqiptarët u ndjenë të hiluar pasi kroatët, sllovenët, boshnjakët dhe maqedonasit u shkëputën nga Jugosllavia dhe krijuan shtetet e tyre, ndërsa “shqiptarët kishin të njëjtën dëshirë, por Marrëveshja e Daytonit nuk bëri asgjë për ta”.⁸⁸ Albright bëri përpjekje mbinjerëzore derisa u mor vendimi për bombardimin e forcave serbe për çlirimin e Kosovës në vitin 1999. Sipas saj, motoja e NATO-s ishte: “Serbët jashtë, NATO-ja brenda, refugjatët në shtëpi”.⁸⁹

Bota përëndimore bëri gabime edhe në kohën e luftërave në ish-Jugosllavi më 1991 kur vendosi ndalimin e dërgimit të armëve në Kroaci dhe Slloveni, që ishte mbështetje e drejtpëdrejtë për regjimin e Beogradit, i cili e kishte kontrollin mbi JNA (APJ) dhe natyrisht krejt arsenalin luftarak të kohës së Titos. Ndërkaq, suprimimi me dhunë i autonomisë së Kosovës në mars të vitit 1989 dhe rrënimi i të gjitha institucioneve të shoqërisë kosovare tregonin qartë se regjimi serb kishte për qëllim jo vetëm okupimin dhe forcimin e sistemit kolonialist në Kosovë, por degradimin sistematik të shqiptarëve, varfërimin, rrezikimin e ekzistencës biologjike dhe dëbimin në masë, sikurse në pjesën e parë të shek. XX!

Gënjeshttrat e regjimit të Millosheviqit për shpërnguljen e serbëve kinse nën presion të shqiptarëve

U konstruktuan shumë teza. Një ndër tezat më të rënda dhe me shumë pasoja ishte shpërngulja e serbëve nga Kosova kinse nën presion

⁸⁶ J. Fischer, *Vitet kuq-gjellbër. Politika e jashtme gjermane – nga Kosova e deri më 11 shtator*, “Koha”, Prishtinë, 2008, f. 242.

⁸⁷ J. Fischer, Po aty, ff. 99-100.

⁸⁸ *Zonja Sekretare (Autobiografi) Madeleine Albright*, Botimet “Dudaj”, Tiranë, 2004, f. 443.

⁸⁹ Po aty, f. 479. Shih më gjerë faqet 441-497.

të shqiptarëve, të pranuar mjerisht nga udhëheqja e Kosovës së asaj kohe. Ishte kjo shpifje e rëndë që shërbeu si pretekst për akuzat dhe dhunën ndaj shqiptarëve. Ndonëse sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 1981 më shumë se 9 milionë banorë ose 41,0% të popullsisë së gjithmbarshme të ish-Jugosllavisë e ndërruan vendin e lindjes, problem u bë vetëm shpërngulja e serbëve dhe malazezëve nga Kosova në Serbi, me numrin e të cilëve bëhej një nga manipulimet më perfide; ndonëse me regjistrimin zyrtar të vitit 1991 ishin evidentuar 194.000 serbë në Kosovë, numrin e të shpërngulurve serbë propaganda serbe e çonte deri në 400.000 veta. Qyteti më atraktiv për serbët nga Kosova ishte Beogradi me rrethinë (38% e tyre u ngulitën aty), pastaj Vranja, Leskovci, Kurshumlia, Prokupla, Aleksinci, Krushevc, Kraleva, Çaçaku, Uzhica, Nishi etj.

Por shpërngulja e serbomalazezëve tyre nga Kosova pas vitit 1966 ndodhte kryesisht për shkak të humbjes së privilegjeve që gëzonin deri atëherë dhe ekskluzivish për arsye të mostolerimit të barazisë së shqiptarëve me ta, pastaj për shkaqe të pasigurisë së atyre serbëve që i përkisnin aparatit shtetëror e policor e që u kishin bërë shumë të këqija shqiptarëve (në kohën e sundimit të A. Rankoviqit), për arsye të gjendjes shumë më të mirë ekonomike në Serbi dhe fitimeve të mëdha nga shitja e pasurisë së patundshme në Kosovë, pastaj për arsye familjare etj. Një numër i madh i serbëve të shpërngulur ishte me origjinë kolonizuese, prandaj edhe kthehej në vatrën e tyre, në Serbi dhe Mal të Zi. Një numër tjetër i serbëve dhe malazezëve të shpërngulur u përkiste eprorëve ushtarakë, të cilët, në kuadër të ndërrimit të vendit të shërbimit evidencoheshin si të shpërngulur, madje nën "presion" të shqiptarëve. Shpifën edhe tezën tjetër se shqiptarët në mënyrë të organizuar po ua blejnë serbëve tokat dhe po lindin shumë fëmijë⁹⁰ për shkaqe nacionaliste me qëllim që t'i ndjekin serbët nga Kosova dhe të krijojnë "Kosovën etnikisht të pastër" dhe "Shqipërinë e Madhe".⁹¹ U aprovua edhe një program segregacionist dhe racist me emrin "Programi Jugosllav për Kosovën" (1989) me qëllim të ricolonizimit të Kosovës (sjellja e kolonëve serbë nga Kroacia e BeH dhe serbo-malazezët nga Shqipëria;

⁹⁰ Një anëtar i kreut partiak dhe shtetëror i ish-Jugosllavisë (ministër i Punëve të Brendshme, slloven) dha deklaratën e tmerrshme: "Ne e njohim shumë mirë njërën nga parullat kryesore të irridentës: blej tokë dhe lind fëmijë" (Stane Dollanc, Intervistë në të përjavshmen e kohës "Teleks", Lubjanë, nëntor, 1988).

⁹¹ Më gjerë në: H. Islami, *Demografia e Kosovës*, ASHAK, Prishtinë, 2021, 330-367.

ndërtimi i banesave falas, ndarja e trojeve dhe ndërtimi i infrastrukturës) dhe vënies së baraspeshës etnike.

Asnjë e dhënë nuk fliste në të mirë të tezës se serbët dhe malazezët në vitet '70 e '80 të shekullit të kaluar ishin të diskriminuar, ndërsa shqiptarët si shumicë e popullsisë të privilegjuar. Sa i përket normës së punësimit në sektorin shoqëror, malazezët dhe serbët ishin më të privilegjuarit, ndërsa shqiptarët, në raport me numrin e popullsisë, gjendeshin shumë pas tyre.⁹² Në vitin 1958 nga gjithsej 55.490 veta të punësuar në sektorin shoqëror, vetëm 26.247 ose 43,7% ishin shqiptarë, ndonëse sipas regjistrimit zyrtar të popullsisë në vitin 1961 në përbërjen e popullsisë merrnin pjesë me 67,0%. Nga fillimi i viteve 70 dhe veçanerisht me nxjerrjen e Kushtetutës së vitit 1974, kur Kosova fitoi një shkallë më të lartë të pavarësisë nga Serbia, si element konstitutiv i ish-Federatës, me të drejtë të vetos, ajo arriti dhe një shkallë të konsiderueshme në planin e zhvillimit ekonomik, shoqëror, arsimor-edukativ, shëndetësor etj. Në veçanti arsimit i të gjitha niveleve ishte në ekspansion. Në vitin 1984 numri i shqiptarëve të punësuar në sektorin shoqëror përbënte 68,4% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, ndërsa në popullsi merrnin pjesë me 77,4% (1981). Ndërkaq, te serbët raporti ishte 22,5% në punësim ndaj 13,2% në popullsi (malazezët 3,3%:1,7%).⁹³

Numri absolut i serbëve të punësuar në sektorin shoqëror ishte në rritje të vazhdueshme në gjithë periudhën e pasluftës. P. sh. në vitin 1970 32.739, më 1980 45.183 dhe në vitin 1986, në kohën e histerisë antishqiptare, 48.429 (në periudhën 1970-1986 punësimi i tyre kishte shënuar rritje për 47,9%). Sipas regjistrimit të vitit 1971 norma e punësimit ishte te malazezët 22,7, te serbët 14,3, te shqiptarët 5,8 dhe te turqit 5,0 (mesatarja kosovare 7,8), ndërsa në vitin 1981 kjo normë rritet te të gjithë, por shumë më e lartë ishte te malazezët (27,5) dhe serbët (21,5) sesa te shqiptarët (9,3) dhe turqit (17,9). Ose, në vitin 1971, në sektorin shoqëror ishte i punësuar çdo i katërti malazias, çdo i shtati serb, çdo i nënti turk dhe çdo i shtatëmbëdhjeti shqiptar (mesatarja e Kosovës 8,9). Serbët dhe malazezët më tepër ishin të punësuar në administratë, në polici dhe në organe të Sigurimit Shtetëror (UDB),⁹⁴ në drejtorate, në banka, në kontabilitet, në mbrojtjen sociale e shëndetësore, në

⁹² Shih më hollësisht në: N. Bashota, "Osnovni problemi privrede Kosova", "Časopis "Pogledi" (Kosovo danas i sutra)", Split, 1988, pp. 411-417.

⁹³ H. Islami – A. Ejupi, *Gjeopolitika, kufiri, konflikti – Politikat hegemoniste, kolonialiste dhe kolonizuese serbe ndaj Kosovës dhe shqiptarëve*, ASHAK, Seksioni i Shkencave Shoqërore, Libri 76, Prishtinë, ff. 164-165.

⁹⁴ Përbërja kombëtare e të punësuarve në polici dhe në organet e shërbimit të

ish-BVI-të, pastaj në vende udhëheqëse, në tregti, komunikacion, hotelieri dhe në veprimtaritë sekondare, ndërsa shqiptarët më tepër në veprimtaritë e sektorit primar (profesionet bujqësore) dhe në kurbet (ish-Jugosllavia dhe bota e jashtme).⁹⁵

Serbët dhe malazezët kishin shkallë më të lartë të urbanizimit dhe normë më të ulët të ruralitetit në Kosovë. Sipas regjistrimit të vitit 1961 në qytete jetonin 36,3% të malazezëve dhe 20,3% të serbëve, ndërsa në vitin 1981 këto përqindje rriten te malazezët në 70,0% dhe te serbët në 38,1%. Shqiptarët, përkundrazi, kishin shkallë më të ulët të urbanizimit dhe më të lartë të ruralitetit në Kosovë: në vitin 1961 16,7% dhe më 1981 28,9% e tyre jetonte në qytet (mesatarja kosovare 19,7% dhe 24,4%). Serbët dhe malazezët ishin të koncentruar në bërthamat e qendrave urbane, kryesisht në banesa shtetërore (mënyra urbane e jetës), kurse shqiptarët në periferitë e qyteteve dhe kryesisht në shtëpi private, shpeshherë pa elemente të sistemeve urbane (mënyra rurale e jetës). Sipas regjistrimit të vitit 1981, nga numri i përgjithshëm i banesave në pronësinë shoqërore në Prishtinë (8.075 banesa, që përbënte 1/3 e fondit të Kosovës), 41,0% u takonte shqiptarëve (ndaj 70,1% në popullsinë e qytetit), 38,0% serbëve (ndaj 15,6% në popullsi), 11,0% malazezëve (ndaj 3,8% në popullsi), 3,0% myslimanëve (ndaj 2,3% në popullsi), 2,0% turqve (ndaj 1,7% në popullsi) dhe 1,0% romëve (ndaj 1,4% në popullsi). Banesa shoqërore më tepër kishin malazezët (84,7% e tyre), “jugosllavët” (82,7%), serbët (70,3%) dhe myslimanët (60,5% të tyre), ndërsa më pak shqiptarët (26,9%) dhe turqit (35,9%).⁹⁶

Në vitet 80 të shek. XX pushteti serb dhe organet e ish-Federatës, Maqedoninë e përdornin si model dhe territor provues për represionin, ndjekjen dhe shpërnguljen e shqiptarëve, kryesisht për ta kufizuar normën e natalitetit të tyre, reduktimin e shkollimit në gjuhën shqipe dhe zhvillimin e përgjithshëm, në mënyrë që pastaj t’i zbatonin më lehtë në Kosovë. Çdo lëvizje mekanike (migrimet) e shqiptarëve drejt Serbisë së Jugut, Maqedonisë, Podgoricës dhe gjetiu, Serbia dhe ish-shteti e shpjegonin si “zgjerim të hartës nacionaliste të Shqipërisë së Madhe”.⁹⁷

sigurimit (UDB-a) p. sh. në vitin 1956 ishte kështu (në %): në polici shqiptarët 31,3 (në popullsi 64,9), serbët 60,8 (23,5) dhe malazezët 7,9, (3,9), ndërsa në organet e sigurimit shtetëror shqiptarët 13,3, serbët 58,3 dhe malazezët 28,3 (Burimi: *Revista "Intervju"*, 4. IX. 1987, f. 68; sipas B. Horvat, *Kosovsko pitanje*, Plava biblioteka, Globus, Zagreb, 1988, f. 62).

⁹⁵ H. Islami – A. Ejupi, Po aty.

⁹⁶ *Sociološka studija grada Prištine*, “Ekonomski institut”, Priština, 1986, ff. 40-41.

⁹⁷ S. Šuvar, “Kosovska zbivanja i nacionalistička euforija”, “*NIN*”, br. 600, Beograd, 1981, f. 15.

Regjimi i Millosheviqit me të gjitha mjetet u vërsul mbi themelet e jetës së shqiptarëve: përmes deportimit masiv dhe zhdukjes së dokumentacionit (letërnjoftimet, pasaportat, regjistrat kadastralë, librat amë të të lindurve, të kurorëzuarve dhe të të vdekurve, numrat personalë, librat e nënshtetësisë etj.) më 1999, ky regjim donte ta dehumanizonte gjithë bashkësinë shqiptare dhe ta këpuste çdo lidhje juridike të shqiptarëve me truallin gjeoetnik të tyre, ta rrëronte tërësisht një etni, një kulturë dhe një shoqëri.

Pas Planit të quajtur Franko-Gjerman (versioni i parë u prezantua më 27 shkurt 2023, ndërsa ai final më 6 mars 2023) dhe platformës së zbatimit të tij, që u pranua në takimin e Ohrit më 18 mars 2023, të cilin po e mbështet fuqimisht edhe SHBA-ja, ndarja territoriale e Kosovës duket se ka marrë fund. Këto dy dokumente konsiderohen marrëveshje ndërkombëtare. “Por jo mes Kosovës dhe Serbisë. Është mes Serbisë dhe BE-së dhe Kosovës e BE-së, diçka krejtësisht e pazakontë në një proces normalizimi”.⁹⁸ Ky fakt nënkupton se obligimet e marra janë të ndara, Serbia të vetat dhe Kosova të vetat. Disa obligime të Kosovës kanë afate, ndërsa të Serbisë sikur nuk kanë afate. Krejt çka kërkon BE-ja dhe SHBA-ja nga Serbia është njëfarë “distancimi” nga Rusia. Duket se për këtë arsye SHBA-ja e ka emëruar ambasador Kristofer Hillin në Beograd. SHBA-ja ndonëse kishte rol vendimtar në çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës, megjithatë, në të ardhmen duket se përparësi nuk do t’i jepet Kosovës dhe Ballkanit Perëndimor, sepse do të ballafaqohet me probleme të tjera në rrafshin global, çfarë janë Rusia, Kina, Irani dhe lufta izraelito-palestineze.

Agresioni rus në Ukrainë dhe ndikimi i tij në Ballkan

Pas agresionit rus në Ukrainë më 24 shkurt 2022 ndryshuan raportet SHBA-Rusi, BE-Rusi, Lindje-Perëndim sikundër që ndryshoi edhe rendi botëror dhe raportet në përmasa planetare. Me këtë plan fashist të Rusisë po nis një fazë e re e “neosovijetizimit” të Rusisë apo një epokë e re gjeopolitike si “Luftë e Re e Ftoftë”, me një Stalin të ri apo Hitler të ri; bota nuk është më ajo që ishte. Nuk ka shumë dallim midis Hitlerit të Gjermanisë nacistë dhe Putinit të Rusisë agresore. Dallimi është vetëm se Putini posedon armë bërthamore, me të cilat po e kërcënon gjithë planetin, por frikën më të madhe e mbolli te ish-republikat e BRSS-së. Por as Perëndimi dhe as NATO-ja nuk kishin

⁹⁸ V. Surroi, “Terra incognita”, “Koha Ditore”, 22 mars 2023.

reagime të fuqishme kur Rusia e pushtoi Krimenë në vitin 2014. Reagimet dhe mbështetja ushtarake dhe humanitare për Ukrainën erdhën vetëm pas 24 shkurtit 2022, kur i kuptuan mirë ambiciet ruse të Putinit. “Në Ballkan tash kemi përpjekjen për bërjen e “Botës serbe”⁹⁹ si njëfarë vazhdimi të “Botës ruse” në rajonin e Rosisë, si tentojnë ata ta kthejnë ndikimin që e kishte Bashkimi Sovjetik, këtë po e bën sot Serbia.¹⁰⁰ Këto janë politika retrograde, ato nuk dëshirojnë të sundojnë në vendet e tyre, ato dëshirojnë të sundojnë me popuj. Këtë e shohim në rajon, ku Serbia tenton ta sundojë Malin e Zi, Bosnjë e Hercegovinën, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut. Dhe fatkeqësisht, kjo politikë ende nuk ka marrë përgjigje adekuate nga partnerët tanë perëndimorë”.¹⁰¹

Mirëpo, pamundësia për ta marrë lehtë dhe shpejt kryeqytetin, Kievin, dhe për ta rrëzuar udhëheqjen legjitime tregoi se ushtria ruse nuk ishte ajo që mendohej pas Luftës II Botërore, veçanërisht gjatë periudhës së “Luftës së Ftoftë”. Megalomania ruse, planifikimet e gabuara ushtarake, keqmenaxhimi i logjistikës, mungesa e ushqimit, veshmbathjes, mjetet e vjetruara luftarake, mungesa e moralit etj. e nxorën të zhveshur Putinin dhe sistemin mbrojtës rus.¹⁰² Mbivlerësimi i vetvetes (me arsenalin bërthamor), ndërsa nënvlerësimi i qëndresës dhe heroizmit të popullit ukrainas e lakuriquan mitin për ushtrinë e pamposhtur. Nuk dolën të sakta edhe vlerësimet e qarqeve ushtarake dhe të sigurisë amerikane për ushtrinë e pamposhtur ruse. Këto qarqe amerikane e mbivlerësuan forcën ruse, ndërsa e nënvlerësuan forcën, kurajon dhe moralin e popullit ukrainas dhe udhëheqje e tij në mbrojtjen e vendit. Senatori Roger Wicker, republikan nga Misisipi, i bëri një pyetje

⁹⁹ Pas përzierjes së Kurtit në Shqipëri, në Luginën e Preshevës dhe tash së fundit edhe në Maqedoninë Veriore, që rezultoi me përçarjen e shqiptarëve, analistët shqiptarë të Kosovës po flasin edhe për “botën e Albinit”. Drejtori Ekzekutiv i KIPRED-it, Institutit Kosovar për Kërkim dhe Zhvillim të Politikave, Lulzim Peci, thotë se “Perëndimi do t’i shohë me të njëjtat thjerrëza “Botën serbe” dhe “Botën e Albinit” (L. Peci, *Gazeta Express*, dt. 25.12.2023).

¹⁰⁰ Më 8 qershor 2024 u mbajt në Beograd “Svesrpski sabor-i”, me moton “Një popull, një sabor” – Srbija i Srpska”. Në prani të zyrtarëve të Serbisë dhe të Republika Sërpskës, Vuçiq dhe Dodik, fjalën kryesore e mbajti patriarku serb Porfirije, i cili kërkoi unitet të popullit serb e të serbizmit!

¹⁰¹ Nga fjala e Presidentit të Malit të Zi Millo Gjukanoviç në Institutin për Paqe në SHBA më 30 mars 2023: sipas VOA, Zëri i Amerikës në gjuhën serbe, Beograd, 30 mars 2023.

¹⁰² F. Fukuyama, “*The end of History and the Last Man*”, Free Press, New York 1992, p. 418; <https://moderndiplomacy.eu/2022/03/22/fukuyamas-remarks-on-russias-ear-in-ukraine-are-doomed-to-fail/>

indikative shefit të Komandës Europiane të Ushtrisë Amerikane, gjeneralit Tod Wolters: “A kishte një mungesë të Inteligjencës Amerikane, që mbivlerësonte forcën e Rusisë dhe nënvlerësonte mbrojtjen e Ukrainës”?!¹⁰³

Çështje thelbësore mbetet a do të trimërohen aleatët e Rusisë, para së gjithash Serbia, e cilësuar si “Rusia ballkanike” dhe a do të përkëdhelet Serbia (aleate e Rusisë) nga Europa sikurse edhe deri tash? Me gjithë përpjekjet e SHBA-së dhe BE-së që Serbia të distancohet nga Rusia, agresioni dhe krimet masive të saj në Ukrainë, ajo nuk po e bën këtë; pjesa dërmuese e opinionit serb, e kurajuar nga udhëheqja e Serbisë, po del mbështetësja më e madhe e Putinit krahasuar me vetë rusët në Rusi. Haptazi po vërehet se presioni i Amerikës dhe UE-së ndaj Serbisë po venitet, duke u lavdëruar pala serbe dhe Vuçiqi si “konstruktive” në dialog me Kosovën. Kjo po ndodh edhe pse Serbia nuk ka opozitë, e cila nganjëherë duket më e keqe sesa vetë pozita me Vuçiqin në krye, por edhe për arsye të “aventurave” të Kurtit si Kryeministër.

Megjithatë, është e sigurt se çizma policore-ushtarake serbe kurrë më nuk do të shkelë në Kosovë. Kur në kohën e krizës së targave dhe barrikadave në Veri të Kosovës në gjysmën e dytë të vitit 2022 kryetari i Serbisë A. Vuçiq, kërcënohej me ngritjen e shkallës së gatishmërisë së ushtrisë serbe “për të intervenuar në Kosovë me qëllim që t’i mbrojë serbët e rrezikuar të Kosovës”, menjëherë erdhi përgjigja e prerë e NATO-s “drejtuar Shtatmadhorisë së Ushtrisë së Serbisë për planin dhe orarin operativ të ndërhyrjes së NATO-s, së pari ndaj vetë kreut të ushtrisë serbe nëse ai ndërmerr çfardo aksioni që do ta rrezikonte sigurinë dhe stabilitetin e Kosovës”.¹⁰⁴

Përshkallëzimi i gjendjes në Veri të Kosovës kulmoi më 24 shtator 2023 (në 2,35 minuta pas mesnatës) kur u përleshën strukturat e policisë së Kosovës me banditët dhe eshallonet policore-ushtarake serbe të udhëhequra nga Millan Radoiçiq, nënkryetar i Listës Serbe, gjë që u dokumentua me material fotografik. Ngjarja dhe veprimi terrorist ndodhi në dhe rreth Manastirit të Banjskës, në afërsi të Zveçanit, ku u vra një polic i Kosovës (Afrim Bunjaku) dhe një tjetër u plagos rëndë (Alban Rashiti), por u vranë edhe disa banditë e fashistë serbë nga pjesëmarrja e disa qindrave, të cilët kishin marrë pjesë në agresion. Me

¹⁰³ Shih: CNN, Tue March 29, 2022.

¹⁰⁴ Më gjerë në: M. Kullashi, “Agresioni i Rusisë mbi Ukrainën dhe tronditjet gjeopolitike”, “Studime”, 9, ASHAK, Prishtinë, 2023, ff. 29-30. Për këtë bëri me dije edhe e përditshmja beogradase “Danas” (M. Kullashi, Po aty).

këtë rast u zu një arsenal i madh armatimesh ushtarake dhe policore serbe si brenda, ashtu edhe jashtë manastirit. Kryetari i Lidhjes Socialdemokrate të Vojvodinës dhe ish-deputeti në Kuvendin e Serbisë, Nenad Çanak, deklaronte publikisht se “kontrabandimi i armëve dhe rrjedhimisht edhe i terrorizmit në Kosovë po bëhet përmes Kishës Ortodokse Serbe” (25.11.2023), ndërsa kryetarja e Komitetit për Punë të Jashtme të Britanisë së Madhe dhe deputetja britanike Alicia Kearns ka kohë që ka bërë me dije se “kishat ortodokse serbe të Kosovës po kontrabandojnë armatim nga Serbia përmes autoambulancave” (4.7.2023) dhe se “grupet kriminale serbe po ruajnë armë të rënda brenda manastireve serbe” (26.9.2023).

Pas gjithë kësaj qëndron Serbia zyrtare, ushtria dhe policia e saj, që kanë mbështetje nga Rusia e Putinit; zatën ky është një skenar si i pushtimit dhe aneksimit të Krimesë më 2014. Skenari i agresionit fashist, qartë shumë gjatë i përgatitur, ishte që përmes “kryengritjes” së serbëve vendas të futet ushtria serbe brenda Kosovës dhe të ndahej Kosova. Skenarë të tillë serbë kemi parë në vitet 90 në Kroaci dhe BeH; në fillim të viteve 90 regjimi i Millosheviqit e akuzonte Kroacinë për kinse “terrorin” e pushtetit kroat ndaj serbëve. Ushtria serbe ka kohë që i është afruar Kosovës, por kërkesa e SHBA-së dhe e vendeve të tjera janë ultimative: Ushtria Serbe larg kufirit me Kosovën! Këto zhvillime dëshmojnë se Veriu i Kosovës mbetet pikë neuralgjike rajonale dhe europiane. Ekziston rreziku që nga sjelljet e papërgjegjshme të Qeverisë së Kosovës, me Kurtin në krye, agresioni fashist serb në Banjskë të mos kapitalizohet politikisht. Për rastin “Banjska”, mjerisht, as BE-ja dhe as SHBA-ja deri në fund të vitit 2023 nuk ndërmorën asgjë. Duhet theksuar gjithashtu edhe një fakt: BE-ja dhe bashkësia ndërkombëtare në përgjithësi ka një çerek shekulli që merren vetëm me menaxhimin e krizave, duke i lënë anash problemet ekonomike dhe jetësore të popullatës.

FUND

12.09.2024!

Hivzi Islami, Prishtinë

LA CONCEPTUALISATION DES BALKANS, LE
KOSOVO ET LES RUSES DE LA VIELLE EUROPE

Le résumé

Dans cet article nous avons abordé la conceptualisation et la définition spatiale des Balkans, ainsi que l'histoire des violences dans les Balkans; la période post impériale après 1919; le plus grand éclatement de la réalité politique des Balkans dans ce dernier siècle. Également, le projet de la « Grande Serbie » et l'héroïsation selon Cvijiq ; le morcellement en Europe après « La guerre Froide » ; les aventures et le populisme du gouvernement Kurti; les ruses du vieux continent et de l'UE envers le Kosovo ; la confrontation du régime hégémonique serbe avec les Albanais jusqu'à la destruction de la subjectivité autonome du Kosovo (1989). Quelques versions serbes de la solution de la question du Kosovo. Les politiques hégémoniques et coloniales serbes envers le Kosovo et les Albanais; les mensonges du régime de Milosevic sur les prétendues pressions sur les serbes. L'agression russe en Ukraine et son influence dans les Balkans.

Muhamedin Kullashi

LINDJA E BIOPOLITIKËS SIPAS MICHEL FOUCAULT

Abstrakt

Libri me titullin « Lindja e biopolitikës » përmban ligjëratat të cilat Michel Foucault (Fuko) i mbajti në institucionin prestigjioz Collège de France në vitet 1978-1979. Në këto kërkime Foucault trajton specificitetet dhe pluralitetet e shtetit modern të cilat i shpjegon me lidhjen e tij me mënyrën e qeverisjes. Nga aspekti ekonomik ai shtet sqarohet me merkantilizmin si doktrinë e cila ka të bëjë me organizimin e prodhimit dhe me rrjetet komerciale. Pastaj me parimin se shteti duhet të begatohet me akumulimin monetar, me forcimin dhe shtimin e popullsisë, e në anën tjetër me menaxhimin e brendshëm të shoqërisë me atë që dikur quhej policia, rregulloret e shumta për një vend, por njëherësh edhe me menaxhimin e një ushtrie permanente dhe të një diplomacie po ashtu permanente.

Nëse biopushteti ushtrohet ndaj një individi, biopolitika ndërkaq ushtrohet ndaj tërë popullsisë e një shteti.

Foucault vë në pah, në vijim, brenda këtij arti të qeverisjes, i lidhur me arsyen e shtetit, raportin me politikën e jashtme; në raportet me shtete të tjera ai i jap vetes një objektiv të kufizuar, ndyshe nga objektivat e mbretërve dhe perandorëve të Mesjetës.

Tani Foucault zhvendoset, në kërkimin e vet, nga mesi i shekullit XVIII te periudha në të cilën paraqitet arsyeja qeverisëse moderne. Karakteristikën e kësaj arsyeje ai e sheh te vendosja e parimit të kufizimit faktik të artit të qeverisjes si praktikë, në rastet kur ai nuk funksionon si duhet. Mu për këtë arsye do të shtrohet problemi i definimit të limitimit në raste kur qeverisja bën shkelje. Biopolitika u riaktualizua me shpërthimin e pandemisë Covid 19.

Fjalët çelës: biopolitika, shteti modern, mënyra e qeverisjes, merkantilizmi, politika e jashtme.

Në këto ligjërata trajtohet, në të vërtetë, çështja e *liberalizmit*. Ligjëratën e këtij viti (1978-1979) në Collège de France Foucault (Fuko) e orienton me thënien e qeveritarit anglez Walpole: « Ajo që mbetet e qetë nuk duhet të preket ». Preokupimi i përgjithshëm i këtij kërkimi, në të vërtetë, ka të bëjë me pyetjen *ç'është liberalizmi?*¹

¹ Michel Foucault, *Naissance de la biopolitique*, Cours au Collège de France. 1978-1979. f.3

Foucault synon këtu të vazhdojë me kërkimet e *artit të qeverisjes* të cilat i kishte zhvilluar edhe më parë në disa tekste të tjera. Me qeverisjen ai nënkupton diçka që nuk ka të bëjë me shumë forma që i përkasin *drejtimit të sjelljeve* të njerëzve: si, fjala vjen, qeverisja e fëmijëve, e familjeve, e shpirtërave, e bashkësive etj. Ai synon të ndriçojë qeverisjen e njerëzve « vetëm në atë masë sa ajo është ushtrim i sovranitetit politik². » Ai e ka parasysh artin e qeverisjes si mënyrë e të qeverisurit, përkatësisht si studim i racionalizimit të praktikës qeverisëse në ushtrimin e sovranitetit politik. Mirëpo Foucault saktëson se në qasjen e tij *ai lë anash*, qëllimisht, nocionet e sovranit dhe sovranitetit, popullit, shtetit, shoqërisë civile, karakteristike sa për analizën sociologjike aq edhe për atë historike, në shpjegimin e praktikës qeveritare.

Foucault, në fakt, niset *anasjelltas* nga një praktikë e caktuar, si racionalizohet ajo, si konstituohen disa gjëra, me statusin e të cilave ai do të merret, do t'i bëjë çështje: shteti dhe shoqëria, sovrani dhe subjektet (qytetarët) etj³. Kësisoj Foucault nuk niset nga universalet për t'i deduktuar pastaj prej tyre fenomenet konkrete, ai nisat nga disa *praktika konkrete* dhe arrin tek universaljet si grilë e këtyre praktikave⁴.

Ndryshe nga historicizmi, Foucault do të hulumtojë në ç'mënyrë paraqitet dhe si vendoset një lloj i racionalitetit i cili « e bën të mundur dhe rregullon mënyrën e të qeverisurit me atë që e quajnë shtet ». Foucault e sheh të arsyeshme të nënvizojë se shteti njëherazi tanimë ekziston por edhe është po kështu « objektiv që duhet të ndërtohet. »

Foucault këtu përgjigjet ndaj pyetjes *ç'është të qeverisurit* sipas parimit të arsyes së shtetit duke cekur se shteti, brenda kësaj optike, duhet të bëhet i fort dhe i qëndrueshëm përballë gjithë atyre faktorëve që mund ta rrezikojnë.

Në epokën moderne, thekson Foucault, qeveritari nuk ka më obligim, si në mesjetë të merret me *shpëtimin e shpirtit* të shtetasit të vet; e as të sajojë raporte baba-fëmijë, të ngjashme me famijen, ngase shteti nuk është as shtëpi, as kishë *dhe as perandori*. Shteti në këtë epokë ekziston vetëm brenda *një* shumësie të shteteve. Ndërkaq, më vonë, BE-ja ose OKB-ja nuk do ta kenë as rolin e as strukturën e një perandorie e cila përfytyrohej përmes një imazhi të trupit të mbretit ose të perandorit.

² *Naissance de la biopolitique*

³ Po aty, f.4.

⁴ Po aty, f.5.

Këtë specificitet dhe pluralitet të shtetit modern Foucault e shpjegon me lidhjen e tij me mënyra të qeverisjes: nga aspekti ekonomik, me merkantilizmin, i cili megjithatë nuk reduktohet vetëm në një doktrinë ekonomike. Sepse siç shpjegon ai, ky konceptcion ka të bëjë me organizimin e prodhimit dhe me rrjetet komerciale; ka parimin se shteti duhet të begatohet me akumulimin monetar, me forcimin dhe shtimin e popullsisë; pastaj menaxhimi i brendshëm me atë që dikur quhej policia, rregulloret e shumta për vendin etj. Por njëherësh edhe menaxhimi i një ushtrie permanente dhe i një diplomacie po ashtu permanente.

Kësodore, shteti nuk është një fakt historiko-natyror, apo monstrum i ftohtë, por korrelativ i një mënyre të caktuar të qeverisjes. Foucault do të hulumtojë historinë e shtetit, si zgjerohet apo ngushtohet ai, si shtrihet mbi një model të caktuar dhe si zbulon ai praktika të reja⁵.

Foucault vë në pah, në vijim, brenda këtij *arti të qeverisjes*, i lidhur me *arsyen e shtetit*, raportin me politikën e jashtme; në raportet me shtete të tjera ai i jap vetes një objektiv të kufizuar, ndyshe nga objektivat e mbretërve dhe perandorëve të Mesjetës. Mirëpo, me arsyen e shtetit, pranohet se çdo shtet i ka interesat e veta, të cilat duhet t'i mbrojtë, por pa pasur iluzionin se mund të arrijë pozicionin unifikues të një perandorie të përhershme. Pra, çdo shtet duhet të vetëkufizohet me objektivat e veta, ta sigurojë pavarësinë e vet. Foucault vë në pah se prej traktatit të Westfalisë (1648) deri te lufta e shtatë vjetëve (1756-1763) paraqitet e zhvillohet politika diplomatiko-ushtarake sipas principit të vetëlimitimit të shtetit, te parimi i konkurrencës së domosdoshme midis shteteve të tjera⁶.

Në rafshin e politikës së brendshme, të cilin në shekujt XVII dhe XVIII e quanin « shteti i policisë », është fjala për një varg të objektivave me të cilët meren ata që qeverisin: me aktivitetet e individëve dhe grupeve deri në imtësi⁷. Foucault rikujton se në manualët dhe traktatet e policisë nga ajo periudhë del në shesh se objektivi i policisë është shumë i gjerë. Kësodore, derisa fuqia e pavarur e një shteti karshi fuqive të tjera shtetërore është e kufizuar meqë duhet ta ketë parasysh një drejtpeshim sipas arsyes së shtetit, drejtpeshim në rrafshin ndër-kombëtar, fuqia e shtetit të policisë në planin e brendshëm është thujase e pakufizuar.

⁵ *Naissance de la biopolitique*, f.7-8.

⁶ *Naissance de la biopolitique*, po aty.

⁷ Po aty, f.8-9.

Mirëpo, Foucault vë në pah se gjatë mesjetës pushteti mbretëror ishte rritur gradualisht, duke u mbështetur në logjikën e së drejtës (ligjeve) dhe duke kufizuar gjithnjë e më shumë pushtetet e feudalëve. Ndërkaq, në veçanti nga shekulli XVI dhe XVII shfaqet fenomeni i ri i kufizimit të pushtetit të mbretit me teorinë e të drejtës dhe institucionet gjyqësore, përkatësisht me afirmimin e ligjeve themelore të mbretërisë⁸. Tani, e drejta e ndërtuar me ligjet themelore paraqitet jashtë arsyes së shtetit dhe shihet si parim i këtij kufizimi.

Në vijim Foucault vë në dukje edhe peshën e teorisë së *drejtës natyrore* të cilën nuk kishte të drejtë ta shkelë as mbreti. Pastaj ai rikujton rëndësinë e *teorisë së kontratës* me të cilën mbreti emërohet si mbret, prandaj ai kishte edhe obligimin ta respektojë atë. Është fjala për norma të cilat e kufizojnë pushtetin mbretëror dhe arsyen e shtetit. Ai rikujton debatet, shpesh të ashpra, shumëvjeçare rreth këtyre çështjeve në shekujt XVI e XVII⁹.

Megjithëkëtë, saktëson Foucault, këto teori mbi të drejtën, ishin *të jashtme* ndaj arsyes së shtetit, dilnin si *kufizime të jashtme*; pra ato vlenin vetëm në rastin kur arsyeja e shtetit i shkilte ato të drejta¹⁰.

Tani Foucault zhvendoset, në kërkimin e vet, nga mesi i shekullit XVIII, te periudha në të cilën paraqitet arsyeja qeverisëse moderne. Karakteristikën e kësaj arsyeje ai e sheh te vendosja e parimit të kufizimit faktik të artit të qeverisjes si praktikë, në rastet kur ai nuk funksionon si duhet. Mu për këtë arsye do të shtrohet problemi i definimit të *kufizimit* në raste të shkeljeve në qeverisje.

Së pari, disa kufizime të praktikës qeverisëse do të kenë karakter faktik; ajo del si një qeverisje jo e shkathët, qeverisje që nuk di të veprojë si duhet¹¹. Pastaj Foucault përmend kufizimin e brendshëm të artit të qeverisjes, kufizim ky që është sa faktik aq edhe me karakter të përgjithshëm: ky problem ka të bëjë me definimin e kufizimit të cilën një qeveri duhet t'ia imponojë vetes.

Një lloj tjetër të kufizimit të qeverisjes Foucault e sheh te kufizimi i cili paraqitet si njeri nga mjetet, ndonjëherë edhe vendimtar, për arritjen e disa objektivave të qeverisë¹².

⁸ Po aty, f.10.

⁹ *Naissance de la biopolitique*, f.10.

¹⁰ Po aty, f.11.

¹¹ Foucault, *Naissance de la biopolitique*, f.12

¹² Po aty, f.13.

Në suazë të këtij trajtimi Foucault e vë një dallim midis pyetjes e cila përkufizon hapësirën e të drejtave themelore dhe fushës së lirisë themelore. Kjo pyetje do të jetë e pranishme. Ai flet tani për periudhën e cila do të cilësohet me arsyen qeverisëse kritike¹³. Këtu nuk do të shtrohet aq pyetja për keqpërdorimin e pushtetit nga sovrani, por më shumë për *teprinë e qeverisjes*. Kësodore, aspekti i teprisë në veprimtarinë e një qeverie bëhet *kriter* i vlerësimit. Racionaliteti i praktikës qeverisëse do të matet sipas veprimeve dhe aksioneve të tepëruara të një qeverie¹⁴.

Pikërisht te kjo pikë Foucault heton një *transformim* të raporteve midis të drejtës dhe praktikës qeverisëse; është fjala për lindjen e një *kufizimi* të brendshëm të arsyes qeveritare nga mesi i shekullit XVIII.

Në këtë nivel të kërkimit të vet, Foucault dëshiron të vërë në pah instrumentin intelektual, formën e matjes dhe kalkulimit, si dhe racionalitetit e cili mund të lejojë vetëkufizimin e një arsyeje qeverisëse si vetëregullim faktik. Ai mendon se këtyre tipareve u përgjigjet jo e drejta por ekonomia politike¹⁵.

Foucault heton te kjo shprehje oscilimin midis disa poleve semantike: ajo del nëjherë si një lloj i analizës precize dhe e kufizuar e prodhimit dhe e qarkullimit të pasurive. Në anën tjetër, ajo ka të bëjë me ekonominë politike në një kuptim më të gjerë e më praktik si çdo metodë e qeverisjes, e përshtatshme për të siguruar prosperitetin e një kombi. Në këtë kontekst ai përmend edhe definicionin e Rousseau-së në artikullin e tij « Ekonomia politike » të *Enciklopedisë*, në të cilin ai zhvillon një refleksion të përgjithshëm mbi organizimin, distribuimin dhe kufizimin e pushteteve brenda një shoqërie. Foucault mendon se pikërisht ekonomia politike e ka bërë të mundur vetëlimitimin e arsyes qeverisëse¹⁶.

Ai saktëson se ekonomia politike, ndryshe nga mendimi juridik i shekujve XVI e XVII, nuk është zhvilluar *jashtë* arsyes së shtetit, e në fillim as kundër saj. Ajo është formuar, sipas Foucault, në suaza të vetë objektivave që arsyeja e shtetit ia kishte përcaktuar artit të qeverisjes. E këtu hyjnë pasurimi i shtetit, pastaj rritja simultane që mer parasysh popullsinë në njerën anë dhe mjetet për ekzistencë, në anën tjetër.

Rjedhoja e parë politike e refleksionit ekonomik që është paraqitur në historinë e mendimit evropian, për Foucault, është krejtësisht

¹³ Po aty, f.14.

¹⁴ *Naissance de la biopolitique*, f.15.

¹⁵ Po aty, f.15.

¹⁶ *Naissance de la biopolitique*, f.16.

në kundërshtim me synimin e juristëve. Ekonomia politike nga periudha e parë është ajo e fiziokratëve. Ata mendonin se qeverisja ekonomike e cila rrethohet vetëm nga ekonomia, është një *despotizëm* ngase ajo vetë e kontrollon këtë qeverisje.

Ekonomia politike, vrojton Foucault, i mer në shqyrtim rrjedhojat që i prodhon vendosja e një tatimi. Pra, gjithëherë është brenda vetë kësaj fushe të *praktikës* qeveritare dhe varësisht nga rrjedhojat e kësaj, e jo varësisht nga ajo që mund ta themelojë brenda të drejtës, që çështja ekonomike do të shtrohet: cilat janë efektet reale të qeverisjes gjatë ushtrimit të saj, e jo cilat janë të drejtat burimore që mund të jenë bazë e kësaj qeverisjeje¹⁷?

Ekonomia politike dhe arsyeja e qeverisjes vetëlimituese

Thënë ndryshe, është një natyrë karakteristike për objektet e aksionit qeveritar: me këto do të merret ekonomia politike. Kësodore, ekonomistët shpjegojnë se është ligj natyror që, fjala vjen, popullsia do të zhvendoset kah zonat ku rrogat janë më të larta¹⁸.

Fundja, do përmendim pikën e mbramë e cila shpjegon në ç'mënyrë dhe përse ekonomia politike ka mundur të paraqitet si arsye (*ratio*) e re e qeverisjes vetëlimituese. Ajo ka të bëjë me një natyrë e cila i cilëson qeverisjen, objektet dhe operacionet e saj. Mu për këtë arsye janë suksesi apo dështimi ato që bëhen kritere të aksionit qeveritar. Këtu qëndron problemi i filozofisë utilitariste¹⁹.

Kësisoj, tani çiftin suksesi apo dështimi do ta zëvendësojnë çifti legjitimiteti-jolegjitimiteti.

Me ekonominë politike, saktëson Foucault, hyjmë në një kohë parimi i së cilës mund të përkufizohet kësisoj: regjimi i së vërtetës është karakteristik për atë që quajnë *koha e politikës*. Ky moment, për Foucaultn, cilësohet me një seri të praktikave të një lloji të caktuar të diskursit, i cili në njerën anë mund ta konstitujë si një tërësi e lidhur me një lidhje inteligjibile e në anën tjetër mund të nxjerrë ligj mbi këto praktika si të vërteta apo të pavërteta. Pra, problemi të cilin ai do ta

¹⁷ *Naissance de la biopolitique*, f.17.

¹⁸ Po aty, f.18.

¹⁹ Po aty, 18-19.

trajtojë ka të bëjë me lindjen e një regjimi të të vërtetës si parim i vetëlimitimit që është temë të cilin ai e shqyrton në këto shkrime²⁰.

Foucault do ta trajtojë, në vijim të kërkimeve të veta, çështjen e liberalizmit ashtu si paraqitet në mbarim të viteve 1970 në Gjermani. Tani ai trajton këtu tiparet specifike të artit liberal të qeverisjes, çështjen e *drejtpeshimit evropian dhe marrëdhëniet ndërkombëtare*, paraqitjen e një racionaliteti qeveritar i shtrirë në përmasa botërore, sikurse edhe projektet e « paqes së përrjetshme » në shekullin XVIII²¹.

Foucault analizon në këto shkrime edhe mekanizmat e sigurisë; kontrollet disiplinare (panoptizmi i Benthamit), por edhe menaxhimin e lirisë dhe i krizave të saj.

Është kjo kohë kur sajohet arsyeja e shtetit (“raison d’Etat”), shteti policor dhe *organizimi i drejtpeshimit evropian*. Afirmohet synimi që të mos ketë asnjë shtet i cili mund t’i mbisundojë të tjerët, duke krijuar një unitetet perandorak në Evropë. Ishte ky një preokupimi politik për sajimin e *drejtpeshimit* midis shteteve për ta evituar *mbisundimin*²².

Foucault kësisoj orvatet të diktojë formimin, në mjedis të shekullit XVIII, e një arsyeje të re qeverisëse. Në këtë kohë kohë Adam Smith zhvillon pikëpamjet mbi lirinë e tregut, përkatësisht me oscilimin i cili e vë në lëvizje një mekanizëm reciprok.

Ai e cilëson këtë kohë me historicitetin ekonomik i cili do të drejtohet me pasurimin reciprok brenda vetë lojës së konkurrencës²³.

Në këtë pikë të zhvillimit të analizës së vet Foucault vë në pah shpërfaqjen e një ideje të re të Evropës, e ndryshme nga Evropa imperiale. Është kjo Evropë e cila *pasurohet*; por nuk është më fjala për pasurimin reciprok të individëve apo grupeve e shteteve. Këto shtete do të hyjnë në një udhë të *mondializimit* të tregut, i cili bëhet tani objektiv dhe parim i pasurimit të pakufishëm të shteteve.

Tani hapet perspektiva e *botës* për Evropën si *objektiv i pasurimit*; pra ajo e shikon *botën si treg të pakufishëm*, i mbështetur me rregullën e konkurrencës. Tani, cek Foucault, është koha e hapjes së një tregu botëror. Mirëpo, shton ai, kjo nuk është kohë kur ka filluar kolonializmi. Kjo nuk është madje as kohë e imperializmit në kuptimin modern; ky kishte filluar më vonë, në shekullin XIX, në kuptimin e imperializmit

²⁰ *La naissance de la biopolitique*, f.20.

²¹ Po aty, f. 53

²² *La naissance de la biopolitique*, f.53-54.

²³ Po aty, f.56.

të ri. Brenda praktikës qeveritare evropiane Foucault vë në pah paraqitjen e një tipi të ri të llogaritjes planetare, një formë të re të racionalitetit planetar²⁴.

Foucault merr si shembull historinë e të drejtës së detit në shekullin XVIII; është fjala për detin si hapësirë e konkurrencës së lirë dhe qarkullimit të lirë, e njëherësh për kushtet e domosdoshme në organizimin e një tregu botëror. Kësodore, juridicizimi i botës i menduar me terma të organizimit të një tregu²⁵. Si shembuj tjerë të racionalitetit të tërë planetit tokësor janë *projektet e paqes së përhershme* dhe ideja e organizimit ndërkombëtar që do të lidhen ndryshe. Sepse tani theksi nuk do të vihet te kufizimi i forcave të brendshme të çdo shteti por te pakufishmëria e tregut të jashtëm. Këtu paraqitet edhe e *drejta ndërkombëtare* që rregullon, brenda kontekstit të ri relacionet midis shteteve. Relacionet komerciale midis njerëzve do të ndikojnë në të drejtën komerciale. Kësodore, thekson Foucault, paraqitet një ngrehinë: e drejta civile, e drejta ndërkombëtare, e drejta kozmopolite apo e drejta komerciale; këto, zaten, kanë mbajtur disa udhëzime të së drejtës natyrore²⁶.

Në këtë kohë lind edhe teoria e *paqes së përhershme* e garantuar me popullimin e botës dhe me rrjetin e relacioneve komerciale. Asokohe shfaqet tregu botëror dhe planetar dhe pozicioni i privilegjuar i Evropës në raport me tregun botëror. Afirmohet edhe ideja e konkurrencës midis shteteve evropiane si faktor i pasurimit të përbashkët. Kjo nuk do të thotë për Foucault se në Evropë mbretëron një epokë e paqes evropiane, e pacifikimit të politikës. Ai rikujton se shekulli XIX është, në të vërtetë, epoka më e keqe e luftës²⁷.

Foucault e merr në shqyrtim këtu edhe traktatin e Vjenës nga viti 1815, i cili ka të bëjë me kërkimin e drejtpeshimit evropian. Ai thekson se ky traktat synon t'i japë fund idesë perandorake të Napoleonit. Ai njëherësh vë në pah se Napoleoni në njërin anë kërkonte mekanizma për ta kufizuar praktikën qeverisëse; ndërkaq në rrafshin e politikës së jashtme ai ishte “arkaik, në atë masë sa ka dashur të rikonstitujë diçka si “konfigurimi imperial, kundër të cilit ishte ngritur e tërë Evropa nga fillimi i shekullit XVII²⁸.”

Kjo ide imperiale kishte tre objektiva. Sipas historianëve dhe juristëve të shekullit 18 Perandoria e Karlit të madh, e themeluar në vitin

²⁴ Po aty, f.57.

²⁵ *La naissance de la biopolitique*, f.58.

²⁶ Foucault, *La naissance de la biopolitique*, f.59.

²⁷ Po aty, f.60

²⁸ *Naissance de la biopolitique*, f.61.

800 të epokës së re, ishte orvatur të ndërtojë në rrafshin e brendshëm për garanca të lirisë.

Në vijim Foucault e bën një rezyme të tipareve themelore të liberalizmit apo të një arti të qeverisjes ashtu si vijëzohet në shekullin XVIII.

Ai dëshiron të shpjegojë përse këtu është marrë me çështjen e liberalizmit, ndonëse e kishte parasysh një fenomen shumë më të përgjithshëm sesa doktrina e thjeshtë ekonomike apo thjesht ajo politike; apo madje një zgjedhje ekonomiko-politike e liberalizmit në kuptimin e ngushtë²⁹.

Duke i marrë parasysh gjërat në origjinën e tyre, ajo që cilëson këtë art të ri të qeverisjes, sqaron ai, cilësohet më shumë me një *natyralizëm* sesa me një liberalizëm: në atë masë sa kjo liri për të cilën flasin fiziokratët është më parë një natyralizëm, ngase është më shumë fjala për një *spontanitet* të natyrshëm sesa për lirinë juridike që u përket individëve. Ai shton se madje edhe te Kanti, i cili nuk është ekonomist, por më shumë jurist paqja e përhershme është e garantuar jo me të drejtën, por me natyrën. Fiziokratët nxjerrin përfundimin se qeveria duhet të njohë natyrën intime dhe komplekse të këtyre mekanizmave ekonomikë. Respektimi i këtyre mekanizmave nuk do të thotë të ndërtohet një armaturë juridike që duhet t'i mbrojtë të drejtat e njeriut dhe të drejtat individuale. Por se qeveria duhet ta furnizojë politikën e vet me një njohje precize dhe të vazhdueshme të asaj që ndodh në shoqëri, në veçanti në rrjetet e tregut; kësisoj, kufizimi i pushtetit të qeverisë nuk del nga respekti i lirisë së individëve, por nga qartësia e analizës ekonomike të cilën duhet ta respektojë³⁰.

Për këtë arsye, Foucault cek se në shekullin e 18-të paraqitet më parë një *natyralizëm* se një *liberalizëm*. Megjithëkëtë, ai saktëson se mund të përdoret edhe termi i liberalizmit në atë masë sa liria është brendapërbrenda kësaj praktike. Ai thekson në vijim se madje edhe Kanti pohon se paqja e përhershme garantohet jo me të drejtën por me natyrën.

Sadoqë në mesin e shek. XVIII vijëzohet një natyralizëm qeveritar, Foucault mendon se këtu mund të flitet pakështu për një liberalizëm; ndërkaq një natyralizëm paraqitet brenda konceptcionit fiziokratik të një *despotizmi* të arsimuar. Fiziokratët zbulojnë, nënvizon Foucault, mekanizmat spontanë të ekonomisë, natyrën e tyre të brendshme,

²⁹ *Naissance de la biopolitique*, f.62.

³⁰ Po aty, f.63.

të cilat çdo qeveri duhet t'i respektojë pikërisht për t'i evituar pasojat e padëshirueshme. Respektimi i këtyre mekanizmave nuk do të thotë që fiziokrati duhet ta krijojë një *armaturë juridike* e cila respekton liritë individuale. E kjo do të thotë, për Foucault, se ai duhet të ndërtojë një njohje të saktë, të vazhdueshme, të qartë dhe të dallueshme (Descartes) për ngjarjet në shoqëri, dhe ato në fushën e ekonomisë.³¹

Foucault dëshiron këtu të theksojë se natyralizmi në shekullin XVIII gërshetohet ngushtë me liberalizmin, ngase *liria* megjithatë është në thelbin e kësaj praktike. Ndryshe nga disa pikëpamje të tjera, Foucault mendon se liberalizmi, ashtu si e kupton ai, është një raport aktual midis qeveritarëve dhe të qeverisurëve³².

Mirëpo është problematik pohimi i Foucault-it se “s’ka mundësi e kuptim që të matet sasia e lirisë, ngase nuk e dimë me cilën masë mund të bëjmë këtë matje³³.” Mirëpo *kriteret* me të cilat mund të matet shkalla e lirisë në një shoqëri e shtet nuk janë të pakta: a ka të burgosur politikë, a ka forma të diskriminimit të qytetarëve të një vendi në realizimin e të drejtave të tyre, a ka kufizime të lirive të tyre etj.

Më vonë, Foucault do të çilet kah rëndësia dhe pesha e të drejtave të njeriut; kjo do të hetohet sa në shkrimet e tij po aq edhe në angazhimet e tij bashkë me disa shoqata në zë për të drejtat e njeriut.

Praktika qeveritare, për Foucault, nuk ka të bëjë thjesht me respektimin e kësaj apo asaj forme të lirisë. Ajo, në mënyrë më të thellë është *konsumuese e lirisë*: në fakt, praktika qeveritare nuk mund të funksionojë pa ekzistimin e disa trajtave të lirisë, siç janë liria e tregut, liria për të shitur dhe për të blerë, liria e ushtrimit të së drejtës në pronësi, liria për të diskutuar, liria për të shfaqur mendime e bindje etj³⁴.

Liberalizmi krijon kushtet që njerëzit e një shoqërie të praktikojnë forma të ndryshme të lirisë, organizimi i kushteve që qytetarët të mund të jenë të lirë. Në vijim ai konstaton se arsyeja e re qeveritare jo vetëm që i respekton format e ndryshme të lirisë por ajo vet “konsumon lirinë³⁵.” Prandaj, arti i ri qeveritar do të paraqitet si menaxhues i lirisë. Liberalizmi thuhet thotë: “Do të bëj ashtu që ti “të jesh i lirë”. Kushtet gjegjëse për të jetuarit e lirë, realizimin e të drejtave të qytetarit dhe njeriut.

³¹ Po aty

³² Po aty, f.64.

³³ *La naissance de la biopolitique*, f.64.

³⁴ Po aty, f.65.

³⁵ Po aty, f.65.

Mirëpo, liria e tregtisë nënkupton edhe masat me të cilat, fjala vjen, SHBA-ja u ka imponuar anglezëve tarifat doganore për ta mbrojtur ekonominë amerikane. Këtu hapet hapësira për nxjerrjen e ligjeve me të cilët një vend synon të ruajë një liri të tregtisë të cilën një vend tjetër s'do të mund ta shkelë³⁶. Është fjala për ndërhyrjet qeveritare që prodhojnë liritë si kushte për të qeverisur.

Më tutje Foucault cek se arti liberal i qeverisjes do ta ketë parasysh edhe parimin e kalkulimit të sigurisë: në ç'masë interesat individuale, kur janë divergjente e madje edhe në kundërshtim njëri me tjetrin, mund të bëhen një rrezik për interesin e të gjithëve. Kësodore, problemi i sigurisë ka të bëjë me çështjen e mbrojtjes së interesit kolektiv kundër interesave individuale.

*Një krahasim me analizat e Claude Lefort
mbi liberalizmin*

Në këtë pikë të analizës, do t'i marrim në shqyrtim shkurtazi kërkimet shkencore të filozofit Claude Lefort mbi liberalizmin; në atë masë sa brenda këtyre gjejmë disa dallime më të theksuara në raport me ato të Foucault-së.

Lefort synon në analizat e veta të vërë në pah kufijtë e liberalizmit si doktrine *economiciste*. Ai thekson në veçanti pafuqinë e saj për të shpjeguar fenomenet e fashizmit dhe ato të komunizmit në periudhën bashkëkohore. Ai vë në pah veçantinë e procesit të ri “të inkorporimit të politikës brenda sociales», e njëherësh edhe paaftësinë e tij që të hetojë procesin e *kondensimit* brenda të njëjtit vend të pushtetit, të ligjit dhe të dijës sikurse edhe mekanizmin e identifikimit: bie fjala, atë midis popullit dhe proletariatit sikurse edhe me partinë si organ drejtues më i lartë³⁷. Lefort saktëson se liberalizmi i kompenson kufizimet e veta duke vërë në dukje dhunën e të drejtës natyrore. Në anën tjetër ai dikton brenda mendimit liberal edhe një vëmendje për « lojërat e pasioneve » të cilat hapin “një konceptcion “mbi një shoqëri e cila pranon peshën e dyshimit”, por edhe konceptcionin i cili bën të mundur të kuptojë “frikën dhe urrejtjen të cilat i nxit një botë pa pikorientime themelore të sigurisë³⁸.”

Duke e marrë në shqyrtim çështjen e dallimeve midis lëvizjes liberale dhe lëvizjes demokratike në Francë, nga fillimi i shekullit XIX, Lefort thekson se liberalët nuk e mbështesin atëherë argumentimin e

³⁶ *Naissance de la biopolitique*, f.66.

³⁷ Claude Lefort, *Le temps présent*, Belin, Paris, f.751-752.

³⁸ Po aty

tyre te këmbimi i lirë e në anën tjetër ia “hapin rrugën një teorie të demokracisë”, por njëherësh i kundërvihen ardhjes së një regjimi demokratik. Lefort e kishte hetuar të njëjtën dykuptimësi në mendimin e Tocqueville, ndonëse ky kishte përvetësuar disa ide të çmuara të B. Constant dhe Chateaubriand.

must prioritize four critical areas for future success: technology application, agility, accelerated innovation, and talent attraction and retention (Oxford Economics, 2017). By focusing on these aspects, SMEs can improve their performance and increase their potential for growth in an increasingly competitive environment. Thus, effective strategic management is an important investment for the future of these organizations. In Kosovo, strategic decision-making in small and medium-sized enterprises has several features related to the country's economic and social environment. SMEs make up the largest part of the economy in Kosovo and face unique challenges that shape the strategic decision-making process in this region. SMEs benefit from programs financed by the government or international organizations, such as the Kosovo Development Fund, which helps promote innovation and the development of new enterprises. However, these supports are limited and insufficiently aligned with the market's real needs. One of the main obstacles to strategic decision-making is the weak infrastructure in certain parts of Kosovo, which affects the competitiveness of SMEs compared to foreign or regional enterprises. This includes challenges related to transportation, electricity supply, and limited access to modern technology. Many Kosovar companies focus on exports, particularly to regional and European markets, to overcome the constraints of the limited domestic market. However, they often face commercial and regulatory barriers when attempting to enter international markets, necessitating careful strategic decisions to diversify their resources and expand trade networks. The role of government and economic policies, although policies have improved, progress has been slow. The Government of Kosovo has taken several steps to enhance the business environment for SMEs, including simplifying the business registration process and easing tax procedures. However, bureaucratic processes and the lack of consistent law enforcement remain significant obstacles. Involvement in open markets and international agreements Free trade agreements, such as the Stabilization and Association Agreement (SAA) with the European Union, present opportunities for Kosovar SMEs to expand their markets. However, the ability to compete in larger markets necessitates strategic planning, innovation, and technical and managerial capacity improvements. The role of the Diaspora in strategic decision-making and Investments in the Kosovar diaspora, particularly in Western Europe, has a substantial impact on economic development through financial remittances and direct investments. SMEs often seek to develop strategies that attract diaspora investors to expand their capital and international networks. Many businesses in sectors such as

gastronomy, crafts, construction, and professional services are oriented toward the demands of the Kosovar diaspora markets, which influences their product and service strategies. Like many other countries, SMEs in Kosovo benefit from flexibility and rapid decision-making. They can adapt more easily to changes in local and international markets. However, this flexibility is sometimes insufficient to achieve sustainable growth due to resource constraints. Enterprises that invest in technology, particularly in the information and communication technology sectors, have shown significant potential for growth in Kosovo. Initiatives such as the "Innovation Center Kosovo" and other funds aimed at promoting startups have contributed to fostering a culture of innovation in the country. Based on the findings from empirical research and ongoing communications with various owners and managers of SMEs in Kosovo, we conclude that differentiation and focus are two of the most important strategies for SMEs in Kosovo. Each of these strategies directly impacts these enterprises' development and long-term success.

VENDIMMARRJA STRATEGJIKE NË NDËRMARRJE TË VOGLA DHE TË MESME

(Analizë përshkruese empirike)

Rezyme

Ky hulumtim është bërë si analizë e faktorëve përmbajtësor që mund të ndikojnë në vendimmarrjen strategjike tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme NVM-të në Kosovë. Gjithashtu, duke ndihmuar ndërmarrësit në identifikimin e metodave, specifikisht objektivave të biznesit gjatë procesit të zhvillimit të politikave dhe planeve në aspektin e projekteve dhe programeve që si të tilla do të hartohen për të arritur këto objektiva. Konsiderojmë se rëndësia e veçantë e këtij hulumtimi është të ndihmoj ndërmarrësit që të aplikojnë praktikat më të mira, gjatë hulumtimit të teknologjive dhe inovacionit, dhe vlerësimin më të mirë të mundësive dhe sfidave me të cilat mund të ndeshen këto ndërmarrje. Ky hulumtim ofron një analizë përshkruese të bazuar në literaturën shkencore dhe rishikimet kritike dhe empirike përmes opinioneve të ndërmarrëseve, duke përfshirë njohuri nga ekspertë dhe profesionistë të fushës. NVM-të përbëjnë pjesën më të madhe të ekonomisë në Kosovë dhe si të tilla përballen me sfida unike që formësojnë procesin e vendimmarrjes strategjike në këtë rajon. NVM-të përfitojnë nga programet e financuara nga qeveria ose organizatat ndërkombëtare. Megjithatë, proceset burokratike dhe mungesa e zbatimit të vazhdueshëm të ligjit mbeten pengesa të rëndësishme.

Roli i diasporës në vendimmarrjen strategjike dhe investimet e diasporës kosovare, veçanërisht në Evropën Perëndimore, ka një ndikim thelbësor në zhvillimin ekonomik përmes remitancave financiare dhe investimeve direkte. Përfundimisht, diferencimi dhe fokusi janë strategji të rëndësishme që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e NVM-ve. Këto strategji ndihmojnë në përcaktimin e qëllimeve dhe misioneve të qarta, duke siguruar një orientim të fortë për organizatën dhe për të ndërtuar forcën konkurruese në treg. Bazuar në gjetjet nga hulumtimi empirik dhe komunikimet e vazhdueshme me pronarë dhe menaxherë të ndryshëm të NVM-ve në Kosovë, konkludojmë se këto strategji si të tilla ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin dhe suksesin afatgjatë të këtyre ndërmarrjeve në vendin tonë.

Bibliography

- Acquah-Sam, E. 2019. "Exploring the Factors Perceived to be Inhibiting the Realisation of the Objectives of the Ghana Alternative Market (GAX).
- Auka, Daniel Onwonga, and Jackline Chepngeno Langat. "Effects of Strategic Planning on Performance of Medium Sized Enterprises in Nakuru Town." *Benchmarking: An International Journal* 5, no. 1 (2016): 1–23.
- Aliu, F. 2018. "Strategic Management of Enterprises, Condition for Economic Development.
- Adebiyi, Julius Abosede, Kehinde Agbolade Obasan, and Olajide Johnson Alese. "Strategic Management and Small and Medium Enterprises (SMEs) Development: A Review of Literature." *International Review of Management and Business Research* 5, no. 1 (2016) 315-335.
https://www.researchgate.net/profile/Kehinde-Obasan/publication/309458240_Strategic_Management_and_Small_and_Medium_Enterprises_SMEs_Development_A_Review_of_Literature/links/58111fe408aea04bbcbd51dd/Strategic-Management-and-Small-and-Medium-Enterprises-SMEs-Development-A-Review-of-Literature.pdf
- Akingbade, Waidi Adeniyi. 2020. "Service Differentiation Strategy and Organizational Performance of Nigerian Small and Medium Enterprises in Lagos State." *Journal of Economic Behavior* 10: 15–35.
[file:///C:/Users/bceku/Downloads/lbravi,+2+\(20-01\)+-+Akingbade+C.pdf](file:///C:/Users/bceku/Downloads/lbravi,+2+(20-01)+-+Akingbade+C.pdf)
- Baum, J. R. 2001. "Motivation Mediators, Personal Characteristics, and New Venture Performance." Paper presented at the meeting of the Society for Industrial-Organizational Psychologists, San Diego, CA.
- Berisha, Gentrit, and Justina Shiroka Pula. "Defining Small and Medium Enterprises: A Critical Review." *Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences* 1, no. 1 March 2015
https://www.researchgate.net/publication/276294683_Defining_Small_and_Medium_Enterprises_a_critical_review
- Chak, Chiew Ming. "Strategic Management for Small and Medium Enterprises." Master's thesis, University of St. Clements, October 1998.
<https://stclements.edu/grad/gradchak.pdf>
- Chittithaworn, Chuthamas. "Factors Affecting Business Success of Small & Medium Enterprises (SMEs) in Thailand." *International Journal of Business and Management* 7, no. 5 (2010): 180–190. School of Business Innovation and Technopreneurship, University Malaysia Perlis, Malaysia.

- Cohen, W. M., and D. A. Levinthal. "Absorptive Capacity: A New Perspective on Learning and Innovation." *Administrative Science Quarterly* 35, no. 1 (1990): 128-152.
- Gürel, Emet, and Merba Tat. "SWOT Analysis: A Theoretical Review." *Uluslararası Sosyal Araştırmalar Dergisi* 10, no. 51 (August 2017).
- Gherghina, Ștefan Cristian, Mihai Alexandru Botezatu, Alexandra Hosszu, and Liliana Nicoleta Simionescu. "Small and Medium-Sized Enterprises (SMEs): The Engine of Economic Growth through Investments and Innovation." *Sustainability* 12, no. 1 2020:6-
- Goh Zhi Ji and Jugindar Singh Kartar Singh. "Digitalization and Its Impact on Small and Medium-Sized Enterprises (SMEs): An Exploratory Study of Challenges and Proposed Solutions." *International Journal of Business and Technology Management* 5, no. 4 (2023).
- Harris, Richard, Rodney McAdam, and Renee S. Reid. "A Comparative Analysis of Innovation Strategy and Implementation in the UK: The Effects of Peripherality." *International Journal of Innovation Management [Vol 09]*, no 4. 2005: 6-15
- Hallberg, Kristin. *A Market-Oriented Strategy for Small and Medium-Scale Enterprises*. Discussion Paper No. 40. Washington, D.C.: International Finance Corporation, The World Bank, October 1998
https://documents1.worldbank.org/curated/en/652031468741329732/585559324_200409289103649/additional/multi-page.pdf
- Kotler, Philip. *Marketing Management*. Upper Saddle River, NJ: Prentice Hall, 2016.
- Kosovo Statistics Office. Annual Statistical Report 2023.
- Kutllovci, Enver, and Shala, Venet. "The Role of Strategic Management on Small Business Growth in Kosova." *International Journal of Business and Social Research* 3, no. 4 (2013): 32-45
<https://thejournalofbusiness.org/index.php/site/article/view/32>
- Marshalok, Mykhailo, Volodymyr Saienko, and others. "Competitive Advantages of Small Business." Article, November 2021.
- Miller Christopher, Thomas Brychan, Murphy Lyndon. 2014. "Innovation and Small Business" Volume 2.
- Monday, James U., Grace O. Akinola, Patrick Ologbenla, and Oluwatobilola K. Aladeraji. "Strategic Management and Firm Performance: A Study of Selected Manufacturing Companies in Nigeria." *European Journal of Business and Management* 7, no. 2 (2015): 161-166
<https://core.ac.uk/download/pdf/234626209.pdf>
- Magretta, Joan. *Understanding Michael Porter: The Essential Guide to Competition and Strategy*. Boston: Harvard Business Review Press, 2011.

- Njuguna, V. N., Ochieng, I., and Odida, A. "The Contribution of Differentiation Strategy Adopted by SMEs to Their Competitive Advantage: A Case Study of Small and Medium Sized Enterprises in Nyahururu, Kenya." *European Journal of Business and Management* 7, no. 29 (2015): 125-130
<https://nru.uncst.go.ug/items/a2e83bf0-8af5-4c0a-9abe-8e614c1e2022>
- Oxford Economics. *SME Strategies for Success: A Global Study That Reveals the Key Drivers of Success for SMEs in 2017 and beyond*. 2017.
<https://oeservices.oxfordeconomics.com/publication/open/275530>
- Organization for Economic Co-operation and Development (OECD). *Financing SMEs and Entrepreneurs 2024: An OECD Scoreboard*. Paris: OECD Publishing, 2024.
- OpenAI. ChatGPT: Assistance in editing and processing empirical data
<https://www.openai.com/chatgpt>.
- Organization for Economic Co-operation and Development (OECD), "Declaration on International Investment and Multinational Enterprises," OECD/LEGAL/0144
- Prasanna, RPIR, JMSB Jayasundara, Sisira Kumara Naradda Gamage, EMS Ekanayake, and PSK Rajapakshe. "Sustainability of SMEs in the Competition: A Systemic Review on Technological Challenges and SME Performance." *Journal of Open Innovation: Technology, Market, and Complexity* 5, no. 4 2019
<https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S2199853122002189#bb0010>
- Parnell, J. 2011. "Competitive Strategy and Performance in Mexico, Peru, and the United States." <https://core.ac.uk/download/345085678.pdf>
- Porter, Michael E. *Competitive Advantage: Creating and Sustaining Superior Performance*. New York: Free Press, 1996
- Porter, Michael E. *On Competition*. Boston: Harvard Business Review Press, 1998.
- Ranawaka, Haritha Budara, and Ajantha Kumara Samarakoon. "The Impact of Personality Traits on the Business Performance of the Small and Medium Enterprises in the Gampaha District of Sri Lanka." *International Journal of Advancements in Research & Technology* 9, no. 10 (2020) 17-27. file:///C:/Users/bceku/Downloads/The-Impact-Of-Personality-Traits-On-The-Business-Performance-Of-The-Small-And-Medium-Enterprise-In-The-Gampaha-District-Of-Sri-Lanka%20(1).pdf
- Runst, Petrik, and Jörg Thomä. "Does Personality Matter? Small Business Owners and Modes of Innovation." *Small Business Economics* 58 (2022).

- Rajesh Singh, Suresh Garg, and S. G. Deshmukh, "Strategy Development by SMEs for Competitiveness: A Review," *Benchmarking: An International Journal* 15 (August 2008): 525–547
https://www.researchgate.net/publication/352172230_Does_personality_matter_Small_business_owners_and_modes_of_innovation
- Skokan, Karel, Adam Pawliczek, and Radomír Piszczur. 2013. *Strategic Planning and Business Performance of Micro, Small and Medium-Sized Enterprises*. Journal of Competitiveness.
<https://www.ejournal.cz/files/151.pdf>
- Sari, Herliana, and Lawiyah Nur. "SWOT Analysis Approach on SMEs Entrepreneurial Competence." *Academy of Entrepreneurship Journal* 24, no. 2 (2018) <https://www.abacademies.org/articles/swot-analysis-approach-on-smes-entrepreneurial-competence-7198.html>
- Sudirjo, Frans. "Marketing Strategy in Improving Product Competitiveness in the Global Market." *Journal of Contemporary Administration and Management (ADMAN)* 1, no. 2 (August 2023): 63–69.
- Sagar, Sahil. "Entrepreneurship: Catalyst for Innovation and Economic Growth." *International Journal of Innovative Science and Research Technology* 9, no. 1 (January 2024)
[file:///C:/Users/bceku/Downloads/IJISRT24JAN148%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/bceku/Downloads/IJISRT24JAN148%20(1).pdf)
- Teece, David. "Business Models, Business Strategy and Innovation." *International Journal of Strategic Management* Vol 43 (2010).
<http://www.bmcommunity.sitew.com/fs/Root/8jig8-businessmodelsbusinessstrategy.pdf>
- Tapera, Julius. *The Importance of Strategic Management to Business Organizations*. Lupane State University 2014
- Van Gils, Anita, Wim Voordeckers, and Jeroen van den Heuvel. "Environmental Uncertainty and Strategic Behavior in Belgian Family Firms." *European Management Journal* 22, no. 5 (2004): 588-595
<https://www.sciencedirect.com/science/article/abs/pii/S0263237304000970>
- Weidner, Nadia. *Three Essays on Absorptive Capacity Beyond R&D*. Inaugural Dissertation, Freie Universität Berlin, 2021
https://refubium.fu-berlin.de/bitstream/handle/fub188/32673/Weidner_Dissertation.pdf?sequence=1&isAllowed=y

Mirlinda Jashanica Gashi¹, Eneida Hoxha², Ira Gjika³

PËRDORIMI I INTEGRUAR I INSTRUMENTEVE MENAXHERIALE DHE DIGJITALE NË MENAXHIMIN EFEKTIV TË BIZNESEVE

Abstrakt

Mjedisi i biznesit përballet me ndryshime të natyrës teknologjike, menaxheriale, politike dhe mjedisore. Trendi i globalizimit dhe mundësitë që ofron teknologjia e informacionit i nxitin kompanitë drejt formave të reja të menaxhimit që kanë rezultuar efektive në vende apo industri të ndryshme. Bizneset në territoret tona shqipfolëse (Kosovë dhe Shqipëri) mund të bëhen më konkurruese dhe të qëndrueshme përmes integritit të qasjeve menaxheriale dhe mjeteve digjitale për të optimizuar proceset dhe për të rritur komunikimin dhe efektivitetin në biznes. Organizatat mund t'i arrijnë objektivat e tyre për të rritur performancën operacionale nëse ndjekin një qasje gjithëpërfshirëse dhe bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të ulur kostot dhe për të eliminuar humbjet.

Ky punim ka si qëllim të prezantojë konceptin e menaxhimit *Lean* dhe mënyrat konkrete të zbatimit të parimeve të tij në bizneset prodhuese dhe të shërbimeve. Punimi evidenton se përdorimi i integruar i veglave menaxheriale dhe mjeteve digjitale, të mbështetura nga udhëzimet e ITIL-së, përmirëson performancën dhe qëndrueshmërinë e bizneseve.

Studimi përdor metodën cilësore për të ngritur bazën teorike të tij dhe për të orientuar zbatimin praktik të kësaj qasjeje në bizneset tona. Në aspektin teorik punimi kontribuon në pasurimin e literaturës në lidhje me menaxhimin e operacioneve në territoret shqipfolëse. Në aspektin praktik, punimi ofron rekomandime konkrete për bizneset për të optimizuar përdorimin e të gjitha burimeve të tyre duke rritur njëkohësisht nivelin e përdorimit të teknologjisë dhe sistemeve digjitale në një treg global në zhvillim të shpejtë.

Fjalët çelës: performancë, përmirësim i vazhdueshëm, menaxhim i operacioneve, teknologjitë digjitale, menaxhimi *Lean*, sistemet e informacionit të menaxhimit, Information Technology Infrastructure Library.

¹ Kolegji UBT, Prishtinë

² Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, Tiranë

³ Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, Tiranë

1. HYRJE

Ndryshimet në mjedisin e biznesit, sidomos ato që lidhen me përdorimin e teknologjisë së informacionit pas pandemisë Covid-19, kanë nxitur kompanitë drejt digjitalizimit të proceseve të prodhimit dhe menaxhimit. Njëkohësisht ka një ndërgjegjësim të shtuar në nivel institucionesh publike dhe biznesi për të optimizuar përdorimin e të gjitha burimeve në dispozicion. Në nivel institucionesh ndërkombëtare (UN, OECD) kjo nxitet me qëllim që të arrihen objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (respektivisht SDG 9 lidhet drejtpërdrejt me prodhimin dhe transportin). Ndërkohë në nivel kombëtar për Shqipërinë dhe Kosovën faktorë shtytës të fuqishëm janë iniciativat për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian dhe tendenca drejt tranzicionit të gjelbër në kuadrin e Green Agenda for the Western Balkans (MMPHI, Kosova, 2023; EC, 2024). Në nivel biznesi, përveç këtyre faktorëve të natyrës politike dhe rregullatore, mbetet një faktor nxitës konkurrenca në treg, e cila tashmë po merr përmasa globale. Rrjedhimisht bizneset bëjnë përpjekje të përdorin me efektivitet inputet në të gjithë aktivitetin e tyre, duke u mbështetur në zhvillimet teknologjike dhe qasjet menaxheriale që praktika botërore dhe literatura bashkëkohore ofrojnë. Kompanitë e mëdha përgjithësisht janë më të prirura drejt adaptimit të këtyre metodave pasi kanë kapacitete financiare dhe menaxheriale për t'i njohur, përshtatur dhe zbatuar në mjediset e tyre. Bizneset e vogla dhe të mesme (SME) ndeshen me më shumë vështirësi dhe pengesa, të brendshme dhe të jashtme, kur duhet të rrisin performancën dhe konkurrueshmërinë e tyre në tregje, qofshin ato lokale apo rajonale. Kjo është evidente në mjedisin e biznesit në Shqipëri dhe Kosovë (Gashi, 2024; Taraku dhe Fortuzi, 2024), prej nga buron nevoja që akademia dhe institucionet e tjera profesionale të biznesit të kontribuojnë në ndihmë të kompanive për shtimin e njohurive mbi metoda, qasje dhe instrumente që ato mund të përdorin. Rritja e produktivitetit në prodhim/ shërbime, përmirësimi i cilësisë dhe performanca më e mirë në bizneset tona mund të arrihen përmes përdorimit të integruar të instrumentave menaxheriale dhe dixhitale. Prezantimi i kësaj qasjeje përbën qëllimin e këtij punimi. Ai synon të bëjë të njohur për kompanitë menaxhimin Lean, si një qasje menaxheriale që kontribuon në minimizimin e humbjeve dhe optimizimin e kostove, duke e kombinuar atë me përdorimin e shtuar të teknologjisë së informacionit në proceset në kompani. Në këtë mënyrë arrihen përmirësime në hallkat e zinxhirit të vlerës, që çojnë në përfitimet e pritshme për konsumatorin, kompaninë dhe ekonominë në tërësi. Punimi paraqet kuadrin teorik të kësaj qasjeje

duke e ilustruar me mënyra dhe rekomandime konkrete, që bazohen në vëzhgimet e kryera në disa raste studimi në bizneset në Shqipëri & Kosovë. Objektivat e punimit realizohen përmes strukturimit të tij si vijon: pas kësaj hyrjeje, në seksionin “Kuadri i kërkimit”, trajtohet gjerësisht kuptimi, parimet dhe mënyrat e implementimit të menaxhimit *Lean*, si dhe integrimi i këtyre elementeve me teknologjitë e prodhimit dhe të informacionit në kompani.

Seksioni i metodologjisë parashtron metodën e kerkimit të përdorur dhe qartëson burimet parësore dhe dytësore të përdorura. Diskutimi i gjetjeve nga vëzhgimi në terren, në seksionin 4, mundëson nxjerrjen e disa konkluzioneve dhe rekomandimeve që përmbyllin punimin.

2. KUADRI I KËRKIMIT

2.1. Origjina dhe përmbajtja e menaxhimit Lean

Menaxhimi Lean është një nga iniciativat menaxheriale që organizatat e mëdha botërore vazhdimisht bëjnë përpjekje ta implementojnë me qëllimin për të qenë sa më konkurrues në treg (Buer et al., 2020; Sgroi, 2014; Hines et al., 2018).

Në thelb, qëllimi i menaxhimit Lean është të identifikojë dhe të eliminojë çdo gjë që nuk shton vlerë për klientin në proceset e biznesit. Origjina e menaxhimit Lean rrjedh nga Sistemi i Prodhimit Toyota në vitin 1940. Toyota ka zhvilluar metodën e menaxhimit Lean me qëllim të eliminimit të mbeturinave dhe reduktimit të paaftësisë në mjediset e tyre prodhuese. Kjo metodë e menaxhimit pati sukses në zbatimin e saj pikërisht për shkak të ndikimit pozitiv në aspektin financiar në biznese apo më saktësisht në uljen e shpenzimeve. Pra shihet se *Lean* fillimisht lindi nga industria e prodhimit, por koncepti i *Lean*-it mund të aplikohet edhe në shërbime. *Lean* edhe në fushën e shërbimit mban të njëjtin parim, përkatësisht "përmirësim të vazhdueshëm" dhe "eliminimin e aktiviteteve që nuk shtojnë vlerë" (James, Womack & Jones, 2003).

Me prejardhje nga industria e prodhimit dhe e zbatuar fillimisht në kontekstin e një kulture specifike (japoneze), metoda *Lean* ka pësuar ndryshime, është shfaqur me disa variante të përshtatura gjatë kohës dhe për disa autorë mund të konsiderohet një sistem i paqartë (Hines et al., 2018). Dy versionet kryesore të *Lean* sipas Pettersen (Pettersen, 2009) përshkruhen si “Toolbox Lean” dhe “Lean thinking”. *Toolbox Lean* paraqitet si një koleksion apo kuti veglash për reduktimin e

humbjeve dhe mbetjeve. *Lean thinking*, nga ana tjetër, është më i përqendruar nga jashtë, duke marrë një perspektivë strategjike dhe sistematike.

Nga shqyrtimi i literaturës menaxhimi Lean shihet si një filozofi, një metodë planifikimi dhe kontrolli dhe si një kuti veglash për mirësimi. Brenda konceptit të menaxhimit *Lean* ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i veglave apo mjeteve menaxheriale *Lean* dhe secila prej tyre paraqet një metodë të veçantë.

Emiliani dhe Emiliani (2013) theksojnë se koncepti *Lean* mund të duket konceptualisht i thjeshtë, megjithatë kërkon një përfshirje të konsiderueshme për të mësuar dhe kuptuar. Praktika e përditshme menaxheriale është e nevojshme në mënyrë që të kuptojë kërkesat e menaxhimit Lean, një proces mësimi i cili ka të ngjarë të mos merret parasysh ose të njihet kur kthehet në konceptin *Lean*.

Kërkimet e vazhdueshme gjithnjë e më tepër tregojnë se për të mbështetur përpjekjet për zhvillimin dhe implementimin e menaxhimit *Lean* kërkohen ndryshime në të gjithë sistemin dhe menaxhimin efektiv të ndërmarrjeve. Prandaj është e nevojshme që përmes përdorimit të veglave të menaxhimit Lean të ndikohet në sistemin, kulturën dhe njerëzit e një ndërmarrjeje.

Ajo që është po aq e rëndësishme për të kuptuar është se si prezantimi i menaxhimit Lean ndihmon për zhvendosje të fokusit e menaxhimit përgjithësisht drejt përmirësimit dhe orientim me qëllim kryesor përmirësimin (Slack, Jones & Johnston 2013).

2.2. Parimet dhe efektet e menaxhimit Lean

Sipas Womack dhe Jones (2003), ekzistojnë pesë parime kryesore: identifikimi i vlerës, hartimi i hapave për rrjedhën e vlerës, rrjedha, tërheqja dhe përsosja.

Pesë hapat e procesit për zbatimin e teknikave të Lean përfshijnë:

1. Identifikimi dhe specifikimi i vlerës nga pikëpamja e konsumatorit/ klientit.
2. Hartimi i hapave për identifikimin e të gjithë hallkave/ nënproceseve për shtim të vlerës për çdo lloj të produktit apo shërbimit.
3. Implementimi i hapave të vlerës të realizohet në segment të ngushtë në mënyrë që produkti të arrijë pa ndërprerje, devijime apo vonesa te konsumatori.

4. Kur rrjedha e procesit të jetë e formuar, krijohet tërheqja nga klienti.
5. Riprocesimi i tërë hapave dhe procesit deri tek arritja e përsosur e vlerës dhe deri atëherë kur të gjitha mbeturinat ose humbjet të jenë eliminuar.




Figura 1. Pesë hapat për zbatimin e teknikave të Lean (Crawford, 2016)

Kjo qasje menaxheriale u mundëson bizneseve eliminimin e proceseve dhe veprimeve joproduktive duke mundësuar një mjedis të përshtatshëm monitorimi, analizimi dhe qasjeje të vazhdueshme të përmirësimit dhe rritjes së produktivitetit.

Literatura (Womack & Jones, 2003; Sgroi, 2014, Awad et al., 2024) argumenton se përfitimet e pritshme mund të jenë si më poshtë:

- Përmirësim i efikasitetit dhe produktivitetit;
- Përmirësim i monitorimit dhe analizës së proceseve;
- Rritja e fleksibilitetit dhe përshtatshmërisë;
- Kostot dhe kthimi i investimit

2.3. Definimi dhe reduktimi i humbjeve në ndërmarrje

Eliminimi i mbeturinave është ide thelbësore e menaxhimit Lean, andaj shprehjet japoneze: 'Muda', 'Mura' dhe 'Muri' përcjellin tri shkaqet e mbeturinave që duhen zvogëluar ose eliminuar (Slack, Jones & Johnston 2013).

Sipas Osterman-it (2015) **Muda** u referohet aktiviteteve të kota të një procesi, sepse ato nuk i shtojnë vlerë operacionit apo klientit. Pra, **Muda** është shkaktar i humbjeve kur shfrytëzohen më shumë burime sesa nevojiten për të përmbushur kërkesën.

Më tej, **Mura** është shkaku i mbeturinave që i referohet "mungesës së qëndrueshmërisë" apo një mosbaraspeshë që rezultojnë në mbingarkesë periodike të stafit ose pajisjeve. Ndërsa **Muri** njihet si shkaktari i humbjeve që ndodhin atëherë kur shfrytëzohen burime jo të mjaftueshme për të përmbushur kërkesën, duke rezultuar punë të tepërt dhe mbingarkesë.




Figura 2. Shkaktarët e humbjeve: Muda, Mura & Muri (Osterman, 2015)

Sipas Slack, Jones & Johnston (2013) këto tri shkaqe të mbeturinave lidhen qartë me njëra-tjetrën, sepse kur një proces përbëhet nga aktivitetet e panevojshme (**Mura**), mund të arrihet një mbingarkesë qoftë e stafit apo pajisjeve (**Muri**), që nga ana tjetër do të shkaktojë të gjitha llojet e aktiviteteve që nuk shtojnë vlerë (**Muda**).

2.4. Si mund të eliminohen humbjet në ndërmarrjeje?

Në menaxhimin Lean, mbeturinat janë çdo shpenzim apo përpjekje që paraqitet, e cila nuk i transformon lëndët e para në një produkt apo shërbim që klienti është i gatshëm të paguajë. Ekzistojnë 8 lloje të humbjeve në menaxhimin Lean. Shtatë nga tetë humbjet/ mbetjet janë pjesë e proceseve të punës, ndërsa e fundit lidhet drejtpërdrejt me aftësinë e menaxhimit për të shfrytëzuar potencialin profesional dhe kreativ të personelit (Gay, 2016). Përshkrimi i detajuar i humbjeve dhe mbetjeve, paraqitur në Tabelen 1 ndihmon në detektimin e tyre në kompani.

Tabela 1. Përshkrimi i humbjeve

Humbjet (Mbetjet)	Përshkrimi
1. Mbi-prodhimi	Mbi-prodhimi ndodh çdoherë kur prodhohet më shumë sesa është kërkesa. Ashtu si defektet dhe përpunimi i tepërt, edhe mbi-prodhimi mund të çojë në gjenerimin e mbetjeve shtesë të menaxhimit Lean si pritja, inventari dhe lëvizja, duke konsumuar sasi të mëdha të kohës dhe burimeve. Mbi-prodhimi mund të reduktohet duke punuar specifikisht sipas kërkesës së klientit (Kang & Manyonge, 2014).
2. Mbi-përpunimi	Mbi-përpunimi nuk i shton vlerë asnjë produkti apo shërbimi vetëm se përdoret disa herë para se të identifikohen humbjet. Shkaqe më të shpeshta të mbi-përpunimit mund të jenë: kërkesat e paqarta të klientëve, komunikimi i dobët, aprovimet e panevojshme apo edhe informacionet e tepërta.
3. Pritjet	Pritja është një referencë ndaj mosveprimit që shton koston për një produkt apo shërbim. Pritja mund të reduktohet duke u siguruar që gjërat të ndodhin (Just-In-time) vetëm në kohë (Gay, 2016).
4. Transporti	Lëvizje e tepruar e njerëzve, informacionit apo mallrave duke rezultuar në humbje dhe kosto (Hines et al., 2018).
5. Inventari i tepërt	Inventari/ rezerva konsiderohet mbetje apo humbje sepse gjeneron kosto. E gjithë koha që një produkt është në inventar, gjeneron kosto ngase ka shpenzimet e përgjithshme për të ruajtur produktin në inventar, dhe kjo kërkon një hapësirë shtesë të trajtimit dhe ruajtjes, e cila rrit koston, kohën dhe ul cilësinë (Kang & Manyonge, 2014).
6. Defektet	Gabime të shpeshta në prodhim, cilësi e produktit/ shërbimit probleme, ose performancë e dobët e dorëzimit (Hines et al., 2018).
7. Lëvizjet e tepërta	Operacionet standarde dhe të dokumentuara mirë janë thelbësore për të zvogëluar lëvizjen e tepërt (Kang & Manyonge, 2014).
8. Talenti i papërdorur	Ky lloj i mbeturinave ndodh kur menaxhimi në një mjedis nuk arrin të sigurojë që të shfrytëzohen gjithë potencialet mendore, krijuese e inovative të punonjësve (Gay, 2016).

Eliminimi i tetë humbjeve përmes implementimit Lean është shumë më i lehtë kur procesi është plotësisht i dukshëm. Organizatat duhet të kuptojnë se çfarë është i gatshëm të paguajë klienti, atëherë mund të aplikohet menaxhimi Lean për të eliminuar sistematikisht tetë humbjet brenda proceseve të një organizate në mënyrë që të maksimizohet përfitimi.

2.5. Mjetet digjitale në mbështetje të Lean production

Digjitalizimi dhe menaxhimi Lean kontribuojnë individualisht në përmirësimin e performancës operationale në biznese. Për një kohe të gjatë akademia dhe industria kanë pranuar se TI dhe menaxhimi Lean nuk përshtaten mes tyre (Pinho and Mendes 2017). Prodhimi Lean përdor kontrollin e decentralizuar duke i dhënë autonomi punonjësve lokale dhe e ve theksin te thjeshtësia dhe transparenca. Në një sistem prodhimi Lean, çdo problem duhet të trajtohet menjëherë, duke u kujdesur për të gjetur shkakun kryesor të problemit (Åhlström, Kosuge dhe Mähring 2016). Ndërsa TI nga ana tjetër fokusohet në krijimin e një baze të dhënash të centralizuar dhe "një versioni të vetëm të saktë", i cili krijon një shkëputje midis asaj që ndodh në procesin e prodhimit (shop floor) dhe informacionit abstrakt të gjeneruar nga sistemi i TI. Autorë të tjerë mbrojnë tezën që teknologjia mund të integrohet në një sistem prodhimi Lean për sa kohë që mbështet parimet Lean dhe i shton vlerë procesit. Aktualisht kjo lehtësohet, sepse futja e sistemeve kibernetike fizike (CPS) dhe Interneti i Gjërave (IoT) mundësojnë elementë të autonomisë që zakonisht nuk gjenden në sistemet tradicionale të centralizuara të TI (Buer, Strandhagen, and Chan 2018; Ghobakhloo 2020).

Ne duam të hulumtojmë se si përdorimi i njëkohshëm sjell efekt plotësues apo sinergjik dhe çfarë ndikimi ka në biznese përdorimi i kombinuar, duke identifikuar se si përdoret digjitalizimi për implementim efektiv të menaxhimit Lean. Aftësia e kompanive për të vënë në përdorim teknologjitë më të reja digjitale dhe t'i kombinojë ato parimet e provuara të menaxhimit lean bëhet një faktor me ndikim të lartë në performancën operationale.

3. METODOLOGJIA

Korniza teorike e mësipërme ka mundësuar të formulohet pyetja kërkimore: Cilat mjete dhe teknologji specifike digjitale mund të përdoren për të zbatuar parimet e menaxhimit Lean në bizneset e rajonit tonë?

Objektivat e kërkimit janë:

- të evidentohet në cilat procese ose hallka të zinxhirit të vlerës dhe funksione ka humbje dhe mbetje,
- sa përdoren teknologjitë e avancuara të prodhimit/ shërbimit dhe ato të informacionit në këto procese dhe në tërësi në kompani,
- si mund të shmangen ose të minimizohen humbjet e evidentuara për çdo grup burimesh nëse përdoren instrumentet dhe sistemet digjitale nga kompanitë.

Këta objektiva, që mund të konsiderohen edhe si pyetje ndihmëse të kërkimit, janë arritur përmes një kërkimi të natyrës cilësore. Punimi bazohet në një kombinim të kërkimit parësor në terren me kërkimin dytësor. Hulumtimi i literaturës dhe kërkimi dytësor në bazat e të dhënave ka sjellë gjetjet e identifikuar nga studiues të fushës menaxheriale mbi menaxhimin Lean dhe tendencën e viteve të fundit për të kombinuar thjeshtësinë e kësaj qasjeje me mundësitë që TI aktualisht ofron për përpunimin e shpejtë të të dhënave, gjetjen e rrugëve për përmirësim dhe vendimmarrjen për zbatim në kohë shumë të shkurtër për eliminimin e humbjeve. Mbi këtë bazë teorike është dizajnuar modeli i studimit, i cili është aplikuar përmes kërkimit primar në kompani në Shqipëri dhe Kosovë.

Natyra specifike e çështjes nuk lejon shtrirjen e kërkimit në numër të madh kompanish, pasi kjo qasje menaxhimi është pak e njohur dhe aq më pak e përdorur në SME-të në rajon. Rrjedhimisht, kërkimi primar është bazuar në metodologjinë e rasteve të studimit të shumëfishtë (multiple case study (Wisnhardt, 1989; Andrews, 2021), duke realizuar një analizë eksploruese të SME-ve në sektorë të ndryshëm prodhues.

Të dhënat parësore për analizën e proceseve ose funksioneve ku evidentohen humbjet në zinxhirin e vlerës në kompani dhe për fushat e aplikimit të mjeteve digjitale janë mbledhur përmes instrumentit të intervistës. Intervistat gjysmë të strukturuar me drejtues të nivelit të lartë në kompani u realizuan gjatë vizitave në mjediset e tyre.

Pyetjet kishin për qëllim të zbulohej/ evidentohet në çfarë procesesh, nën-procesesh prodhimi dhe menaxheriale kishte humbje dhe cilat ishin shkaqet kryesore të tyre. Njëkohësisht synonin të hulumtonin nëse përdorimi i mjeteve digjitale dhe sistemeve të informacionit lejonte minimizimin e humbjeve dhe si mund të arrihej në përmirësim të kësaj natyre.

Studimi për detektimin e humbjeve në proceset e prodhimit, kombinuar me përdorimin e sistemeve të informacionit përfshiu 12 ndërmarrrje në Shqipëri dhe 2 në Kosovë. Kompanitë ishin nga sektori prodhues (metale, letër, riciklim dhe prodhim plastike, prodhim mobiljesh, përpunim produktesh ushqimore, etj.), me numër punëtorësh dhe xhiro vjetore të kufizuar që i takojnë kategorisë SME. Kjo zgjedhje lidhet me qëllimin e studimit që të inkurajojë njohjen dhe përdorimin e qasjeve efektive menaxheriale dhe instrumenteve digjitale në kompanitë që përbëjnë pjesën kryesore të bizneseve në vendet tona.

Të dhënat iu nënshtruan një analize cilësore, përmes së cilës u arrit në disa rezultate dhe gjetje.

Numri relativisht i ulët i rasteve të vëzhguara dhe fakti që ata funksionojnë në sektorë të ndryshëm përbën një nga kufizimet e punimit. Me gjithë ngjashmërinë në praktikat e menaxhimit, në nivelin e teknologjisë që përdorin dhe në digjitalizimin që kanë arritur, SME-të e sektorëve të ndryshëm kanë edhe diferenca. Rrjedhimisht, gjetjet e këtij punimi dhe rekomandimet mund të aplikohen brenda sektorëve, por jo domosdoshmërisht edhe në sektorë të tjerë.

4. DISKUTIM

Prodhimi "Lean", sipas përkufizimit të Womack-ut, Jones dhe Roos (1990), synon reduktimin e mbetjeve dhe aktiviteteve që nuk shtojnë vlerë. Brenda procesit të prodhimit, kjo manifestohet përmes proceseve të standardizuara, të qëndrueshme dhe të optimizuara; inventareve minimale; rrjedhës së ndërprerë të produkteve; prodhimit bazuar në kërkesën aktuale të tregut; kohëve të shkurtra të konfigurimit; dhe përfshirjes së punonjësve në përpjekjet për përmirësim të vazhdueshëm (Chavez et al., 2015). Të gjitha këto aspekte mund të mbështesin përmirësime në dimensione të ndryshme të performancës operacionale, si cilësia e produktit dhe kostoja e prodhimit, koha e realizimit, fleksibiliteti dhe besueshmëria (Belekoukias et al., 2014).

Nisur nga kjo qasje dhe bazuar në vëzhgimin në disa kompani prodhuese në Shqipëri dhe Kosovë, mund të analizohet situata në SME në aspektin e përdorimit të burimeve, njërive/ reparteve apo funksioneve ku evidentohen humbje dhe shkaqeve të tyre.

Analiza e menaxhimit të prodhimit në aspektin e projektimit të produktit dhe të procesit, të sistemimit të njërive, kapacitetit dhe automatizimit, skedulimit, dhe mënyrës se si këto aktivitete dhe nënaktivitete janë të ndërlidhura lejoi disa gjetje në nivel kompanie.

Në shumicën e kompanive investimet në teknologjinë e prodhimit janë bërë në kohë të ndryshme, me pjesë, duke shtuar makineri e pajisje të gjeneratave të ndryshme. Kjo ka vështirësuar integrimin e makinerive të linjës së prodhimit në një zinxhir të vetëm, që mund të monitorohet ose komandohet nga një qendër e vetme. Kjo shkakton humbje të kohës (pritja), në transport, rritje të rezervave të produktit në proces ndërmjet makinerive/ proceseve dhe të fuqisë punëtore.

Në mënyrë të ngjashme, kompanitë kanë zgjeruar prodhimin duke shtuar sipërfaqe dhe sektorë gjatë viteve, duke vështirësuar lidhjen e tyre në një sistem të integruar. Në këto kushte, pavarësisht nga njohuritë e drejtuesve të kompanive dhe dëshirës së tyre për të përdorur pajisje robotë, vetë sistemimi i linjës së prodhimit vështirëson përdorimin e tyre. Sipas të intervistuarve, robotët mund të programohen që të realizojnë detyra të ndryshme duke u orientuar në mjedisin përreth falë instalimit të sensorëve të sigurisë e videokamerave kur layout u përshtatet kërkesave teknike. Kjo do të çonte në rritjen e produktivitetit (uljen e kostos për njësi prodhimi), shmangien e gabimeve ose defekteve në proceset e punës, lehtësimin e punës së punëtorëve dhe përdorimin më të mirë të aftësive dhe talentit të tyre. Teknikisht, mund të bëhet menaxhimi i linjës së prodhimit duke i ndërlidhur makineritë ndërmjet tyre dhe duke përdorur sisteme informacioni (software të sofistikuara) për monitorimin ose komandimin e tyre nga një qendër, që lejon optimizimin e vendimmarrjes dhe të veprimeve korrigjuese në proces.

Me gjithë përmirësimet, mekanizimi ose automatizimi i proceseve në këto kompani është larg asaj që teknologjia e avancuar e kohës lejon në këto degë industrie (në vendet me nivel më të lartë zhvillimi teknologjik). Përsëri, për shkak të zgjerimit të linjës së prodhimit dhe reparteve në kohë të ndryshme, sistemet conveyer ishte e vështirë të përshtaten në mjediset e prodhimit dhe të magazinimit. Kjo mangësi ka çuar në përdorimin e një force më të madhe punëtore në proceset e transportit, me efekt në kosto, kohën e realizimit të prodhimit, cilësi dhe në sigurinë e punës. Nga ana tjetër, sigurimi i të dhënave për këto procese kërkon kohë dhe angazhim të menaxherëve funksionalë, duke impaktuar funksionet e logjistikës dhe të operacioneve.

- Mungesa e lidhjes së aktiviteteve të zinxhirit të furnizimit në një sistem të integruar sjell ndikim edhe në menaxhimin e shitjeve dhe plotësimin e porosive të klientëve. Lidhja ndërmjet furnizimit me lëndë të parë dhe hedhjes së porosive në procesin e prodhimit mund të përmirësohet ndjeshëm përmes përdorimit të teknologjive të reja të afta për të monitoruar të gjithë rrjetin e furnizimit dhe kohën e dorëzimit të

mallit sipas porosive. Sistemet e Menaxhimit të Zinxhirit të Furnizimit (SCM) mundësojnë menaxhimin e lëvizjes/ rrjedhës së mallrave, shërbimeve dhe informacionit gjatë gjithë zinxhirit të furnizimit. Përdorimi i tyre do të çonte në uljen e humbjeve nga mbiprodhimi (prodhimi i pabalancuar me kërkesën), nga rezervat e tepërta të inputeve dhe/ ose outputit, mbipërpunimi (shpenzimet e tepërta/ të panevojshme për prodhimin).

- Menaxhimi i cilësisë është një nga funksionet ku vërehen mangësi, për shkak të faktorëve pengues/ sfidave të zhvillimit të SME-së. Mungesa e njohurive digjitale, besimi në metodat tradicionale të drejtimit dhe rezistenca ndaj ndryshimit nuk lejojnë përqafimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse (TQM) lidhur me cilësinë. Nëse kompanitë do të përdorin sistemet e integruara të prodhimit dhe informacionit që ofrojnë mundësi për kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë në hallkat e procesit të prodhimit dhe ndërhyrjen në proces në kohë reale, do të mund të përmirësonin cilësinë e produkteve, duke minimizuar produktet me defekt, mbetjet e panevojshme dhe duke reduktuar/ shmangur koston e cilësisë së ulët. SME-të pjesë e vëzhgimit përgjithësisht nuk ishin të informuara për këto mundësi dhe aq më pak mund të flitet për përdorim të tyre.

- Parashikimi i kërkesës dhe planifikimi i porosive të prodhimit në përputhje me kërkesën çon në shmangien e humbjeve nga mbi-prodhimi, optimizimin e inventarit/ rezervave, uljen e sasive të produkteve që mund të kalojnë afatet e skadencës (në rastet e produkteve ushqimore që prishen) dhe në përdorimin optimal (pa humbje) të fuqisë punëtore. Kompanitë mund të përdorin Sistemet e Menaxhimit të Marrëdhënieve me Klientët (CRM) në ndihmë të raporteve me klientët dhe që ndihmojnë edhe në sigurimin e parashikimeve sa më të sakta për periudhat e ardhshme. Rekomandohet përdorimi i tyre për gjurmimin e shitjeve, menaxhimin e shërbimit ndaj klientit, menaxhimin e fushatave të marketingut, me efekt në shmangien e humbjeve të kohës, burimeve, mbiprodhimit dhe në optimizim të shpenzimeve marketing.

Në kushtet e kompanive me kapacitete më të larta teknologjike, njerëzore, financiare mund të instalohen sisteme më gjithëpërfshirëse, siç janë:

Sistemet e Informacionit të Menaxhimit (MIS) që përfshijnë përdorimin e teknologjive të informacionit dhe mjeteve digjitale për të mbledhur, analizuar dhe menaxhuar informacionin në mënyrë që të mbështesin vendimmarrjen dhe efikasitetin operativ në organizata. Ato

u ofrojnë menaxherëve mjete për të organizuar, vlerësuar dhe menaxhuar departamentet në mënyrë efikase përmes gjenerimit të raporteve të rregullta dhe ofrimit të të dhënave për marrjen e vendimeve.

Sistemet e Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes (ERP) integrojnë proceset kryesore të biznesit ndërmjet departamenteve të ndryshme në një sistem të unifikuar. Përgjithësisht përfshijnë modulet si financa, burimet njerëzore, zinxhirin e furnizimit, menaxhimin e inventarit dhe prodhimin.

Tabela 2. Përfitimet nga zbatimi i ITIL-së

Procesi	Përshkrimi
<i>Rritja e efikasitetit operativ</i>	Përdorimi i mjeteve digjitale dhe metodave menaxheriale si Lean dhe ITIL lejon organizatat të optimizojnë proceset, duke eliminuar humbjet dhe përmirësuar fluksin e punës.
<i>Reduktimi i kostove</i>	Përdorimi i teknologjisë për automatizimin e proceseve dhe menaxhimin e burimeve ndihmon në reduktimin e kostove operative dhe rritjen e marzhit të fitimit.
<i>Përmirësimi i kënaqësisë së klientëve</i>	Duke ofruar shërbime më të shpejta dhe më cilësore përmes integritit të teknologjisë, organizatat rrisin kënaqësinë e klientëve dhe besnikërinë ndaj markës.
<i>Fleksibiliteti dhe adaptimi në Treg</i>	Integrimi i mjeteve menaxheriale dhe teknologjike ndihmon organizatat të jenë më fleksibile dhe të adaptohen shpejt në ndryshimet e tregut dhe preferencat e konsumatorëve.
<i>Inovacioni i vazhdueshëm</i>	Një kulturë e përmirësimit të vazhdueshëm dhe adoptimi i praktikave moderne inkurajon inovacionin, duke lejuar organizatat të zhvillojnë produkte dhe shërbime të reja që plotësojnë kërkesat e tregut.

ITIL (Information Technology Infrastructure Library) është një koleksion praktikash dhe kornizash të miratuara për menaxhimin e shërbimeve të TI, që ndihmon organizatat (praktikisht sistemin e informacionit të tyre) të ofrojnë shërbime efektive dhe të qëndrueshme duke optimizuar proceset dhe përmirësimin e vazhdueshëm (Agutter, 2019). Zbatimi i ITIL në bizneset shqipfolëse ofron qëndrueshmëri dhe përmirësim të vazhdueshëm që proceset të jenë të standardizuara dhe të dokumentuara, gjë që çon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve,

rritjen e kënaqësisë së klientëve dhe qëndrueshmëri në ofrimin e shërbimeve.

Përfitimet e integrimit të menaxhimit dhe teknologjisë, duke përfshirë menaxhimin Lean dhe ITIL, përfshijnë rritjen e efikasitetit operativ, reduktimin e kostove, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, dhe rritjen e kënaqësisë së klientëve, duke krijuar një mjedis më të qëndrueshëm dhe inovativ për organizatat.

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Përvoja e kompanive që kanë përshtatur parimet e menaxhimit Lean dhe i kanë aplikuar ato në sistemin e tyre të prodhimit/ shërbimit të integruara me instrumentet dhe sistemet e informacionit nxitën këtë punim. Qëllimi i tij është që t'u ofrojë bizneseve në Shqipëri dhe Kosovë, sidomos SME-ve, njohuri dhe rekomandime se si mund të përmirësojnë performancën operacionale duke minimizuar humbjet dhe mbetjet të ndihmuar nga sistemet e informacionit që funksionet e veçanta ose e gjithë kompania mund të instalojë dhe përdorë.

Qasja e integruar menaxheriale dhe digjitale kombinon praktikën e menaxhimit tradicional me teknologjitë moderne, duke krijuar një sistem të unifikuar që maksimizon efikasitetin, përmirëson vendimarrjen dhe rrit fleksibilitetin në përballjen me sfidat e tregut. Kjo qasje ndihmon në optimizimin e proceseve, eliminimin e humbjeve dhe rritjen e kënaqësisë së klientëve, duke siguruar që organizatat të jenë të gatshme për të përballuar kërkesat e një ambienti gjithnjë e më dinamik. Kështu integrohet teknologjia me sistemin e prodhimit Lean dhe mundësohet shtimi i vlerës në proces.

Si rezultat i implementimit të kësaj qasjeje të integruar, organizatat arrijnë të krijojnë një mjedis më të qëndrueshëm që inkurajon përmirësimin e vazhdueshëm të performancës. Kjo ndihmon në uljen e kostove, rritjen e efikasitetit operativ dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve, duke i lejuar ato të jenë më konkurruese në tregun global. Për më tepër, një fokus në inovacion dhe adoptimi i praktikave të reja menaxheriale kontribuon në adaptimin e shpejtë ndaj ndryshimeve në preferencat e klientëve dhe kërkesat e tregut, duke siguruar një rritje të qëndrueshme afatgjatë.

INTEGRATED USE OF MANAGERIAL AND DIGITAL TOOLS FOR EFFECTIVE BUSINESS MANAGEMENT

Abstract

The business milieu is facing rapid changes of technological, managerial, political and environmental nature. The trend of globalization and the opportunities offered by information technology encourage companies towards new forms of management that have proven effective in different countries or industries. Companies in our Albanian-speaking territories (Kosovo and Albania) can become more competitive and sustainable through the integration of managerial approaches and digital tools to optimize processes and increase communication and effectiveness in business. Companies can achieve their objectives to increase operational performance if they follow a comprehensive approach and make continuous efforts to reduce costs and eliminate waste.

This paper aims to present the concept of Lean management and the effective ways of implementing its principles in manufacturing and service companies. The paper points out that the integrated use of this management approach and digital tools enables higher operational efficiency, quality improvement, and better risk management, impacting the performance and sustainability of businesses.

The study uses the qualitative method to raise its theoretical base and to guide the practical implementation of this approach in our businesses. The paper contributes to the enrichment of the literature on operations management for academia and practitioners in our region. In practical terms, it provides recommendations for businesses to optimize the deployment of all their resources while simultaneously increasing the level of using the technology and digital systems in their activity.

Key words: performance, continuous improvement, operations management, digital technologies, Lean management, management information systems, Information Technology, Infrastructure Library.

Burime dhe referenca

- Agutter, C. (2020) ITIL® Foundation Essentials ITIL 4 Edition: The ultimate revision guide.
- Awad, M.M.; Hashem, A.; Naguib, H.M. The Impact of Lean Management Practices on Economic Sustainability in Services Sector. *Sustainability* 2022, 14, 9323. <https://doi.org/10.3390/su14159323>
- Belekoukias, J., Garza-Reyes, J. A., Kumar V. (2014) The impact of lean methods and tools on the operational performance of manufacturing organisations. *International Journal of Production Research*, Pages 5346-5366. <https://doi.org/10.1080/00207543.2014.903348>.
- Bicheno, J. and Holweg, M. (2016) *The Lean Toolbox: The Essential Guide to Lean Transformation*.
- Crawford, M. (2016) “5 Lean Principles Every Engineer Should Know”, Available at: <https://www.asme.org/engineering-topics/articles/manufacturing-design/5-lean-principles-every-should-know>
- Emiliani, M.L. and Emiliani, M. (2013) “Music as a framework to better understand Lean leadership”, *Leadership and Organization Development Journal*, Vol. 34 No. 5, pp.407-426.
- European Commission (2024) Available online: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/news/commission-approves-reform-agendas-albania-kosovo-montenegro-north-macedonia-and-serbia-paving-way-2024-10-23_en
- Hines, P., Holweg, M. and Rich, N. (2004) ‘Learning to evolve’, *International Journal of Operations and Production Management*, Vol. 24 No. 10, pp.994-1011.
- Hines, P., Found, P., Griffiths, G. and Harrison, R. (2008) *Staying Lean. Thriving, Not Just Surviving*, Lean Enterprise Research Centre, Cardiff University, Cardiff, Wales.
- Hines, P., Taylor, D. and Walsh, A. (2018) ‘The Lean journey: have we got it wrong?’, *Total Quality Management and Business Excellence*. <https://doi.org/10.1080/14783363.2018.1429258>.
- Gashi, Sh. Barriers in the Development of Small Businesses in Kosovo. *Theoretical and Practical Research in Economic Fields*, [S.l.], v. 15, n. 2, p. 256-266, June 2024. ISSN 2068-7710. Available at: <https://journals.aserspublishing.eu/tpref/article/view/8465>
- Gay, C. (2016) “8 Wastes of Lean Manufacturing”, *Machinometrics Blog*. Available at: <https://www.machinometrics.com/blog/2016/1/24/8-wastes-of-lean-manufacturing>

- Kang, P.S., Manyonge, L. M. (2014) “Exploration of Lean Principles in Higher Educational Institutes – Based on Degree of Implementation and Indigence”. January 2014, *International Journal of Scientific and Engineering Research* 5(2):831-838
- Marksbury, P. (2012). *The modern theory of the Toyota Production System*. London: Productivity Press.
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, (2023) “Circular Economy Roadmap of Kosovo”.
- Osterman C. (2015) “Towards a Lean Integration of Lean” Doctoral Thesis, Malardalen University, Sweden. ISBN 978-91-7485-208 Available at: <https://www.researchgate.net/publication/319351076>
- Pickett, L.K. (2024) *Master IT Service Management with Ease: Optimize Your Service Delivery through Comprehensive IT Service Management*.
- Slack, N., Brandon-Jones, A., Johnston, R. (2013) *Operations Management*, 7th edition, Pearson Education Limited, ISBN: 978-0-273-77620-8
- Sgroi, Anthony Jr. (2014) *The Innovative Lean Enterprise*.
- Sven-Vegard Buer, Marco Semini, Jan Ola Strandhagen & Fabio Sgarbossa. (2020) The complementary effect of lean manufacturing and digitalisation on operational performance, *International Journal of Production Research*, 59:7, 1976-1992, DOI: 10.1080/00207543.2020.1790684
- Womack, J. P., Jones, D. T. (2003) “Lean Thinking”, Free Press, ISBN 0-7432-4927-5.

KUD: 004.89:37
004.89:304

Ajkuna Mujo¹
Dhimitri Tole²

THE IMPACT OF ARTIFICIAL INTELLIGENCE ON STARTUPS

Abstract

Recently artificial intelligence has become more sophisticated and has evolved the ability to stimulate innovation and become a powerful factor in the success of startups. This paper will study the impact of AI on Albanian startups, focusing on its practical applications, effects on operations, decision-making, and business modeling. Through the automation of routine processes and advanced data analytics, AI empowers organizations to enhance efficiency and make data-driven decisions.

As everyday startups need to improve their strategic advantage in product development and rapid adaptation to market changes.

However, the integration of AI presents considerable challenges, including the lack of specialized skills, ethical risks, and data privacy implications. This study concludes that the strategic adoption of AI can help drive innovation and competitive sustainability in enterprises and startups, but it requires a careful and structured approach to managing the accompanying challenges.

Keywords: Startups, Artificial Intelligence, Data Analytics, Efficiency, Decision-Making, Product Development, Innovation.

HYRJE

Inteligjenca Artificiale (IA) po transformon me shpejtësi mënyrën se si operojnë bizneset, veçanërisht startup-et që mbështeten shumë tek inovacioni dhe aftësia për t'u përshtatur me tregje dinamike. Startup-et shpesh përballen me sfida të tilla si burime të kufizuara, ekipe më të vogla dhe nevoja për vendimmarrje të shpejtë. IA ofron zgjidhje për këto sfida duke automatizuar detyrat rutinë, duke ofruar analiza të avancuara të të dhënave dhe duke mundësuar procese vendimmarrëse më të informuara dhe strategjike. Nëpërmjet IA-së, startup-et mund të racionalizojnë operacionet, të ulin kostot dhe të bëjnë rregullime më të

¹ Mediterranean University of Albania. ajkuna.mujo@umsh.edu.al

² Mediterranean University of Albania. dhimitri.tole@umsh.edu.al

shpejta për t'iu përgjigjur ndryshimeve të tregut, duke u pozicionuar për rritje të shpejtë dhe avantazh konkurrues.

Integrimi i IA-së në operacionet e biznesit u jep startup-eve mundësinë për të çliruar nivele të reja efikasiteti dhe kreativiteti. Mjetet e drejtuara nga IA-ja, si algoritmet e të mësuarit automatik (machine learning), përpunimi i gjuhës natyrore dhe analizat parashikuese, ndihmojnë startup-et të përpunojnë sasi të mëdha të dhënash shpejt dhe me saktësi, duke ofruar njohuri të vlefshme që përndryshe do të ishin të vështira për t'u marrë. Këto njohuri fuqizojnë startup-et të inovojnë në zhvillimin e produkteve, të përmirësojnë përvojat e klientëve dhe të rafinojnë modelet e biznesit. Ndërsa IA-ja vazhdon të evoluojë, ajo u ofron startup-eve jo vetëm aftësinë për të optimizuar proceset ekzistuese, por edhe për të eksploruar drejtime krejtësisht të reja inovacioni.

Ky punim fokusohet specifikisht në ndikimin e IA-së te startup-et në Shqipëri, një treg ku transformimi digjital po bëhet gjithnjë e më jetik. Startup-et shqiptare po përdorin IA-në për të rritur efikasitetin, përmirësuar vendimmarrjen dhe inovuar si përgjigje ndaj kërkesave të tregut lokal dhe global. Megjithatë, adoptimi i IA-së sjell edhe sfida, përfshirë nevojën për aftësi të specializuara, shqetësimet etike dhe çështjet e privatësisë së të dhënave. Ky studim synon të eksplorojë si mundësitë ashtu edhe pengesat e adoptimit të IA-së në startup-et shqiptare, duke ofruar njohuri se si mund të shfrytëzohen fuqinë e IA-së për të drejtuar suksesin afatgjatë.

RISHIKIM LITERATURE

IA në operacionet e startup-eve

Automatizimi i detyrave rutinë është një nga mënyrat kryesore sesi Inteligjenca Artificiale (IA) po transformon operacionet e startup-eve. IA-ja u mundëson startup-eve të automatizojnë detyra të përditshme, duke përmirësuar ndjeshëm efikasitetin dhe duke ulur kostot operacionale. Për shembull, Airbnb dhe Zalando kanë implementuar chatbot-e të fuqizuara nga IA-ja për t'iu përgjigjur automatikisht pyetjeve të klientëve në kohë reale, duke ofruar një përvojë të personalizuar pa ndërhyrjen e njeriut. Kjo ka ndihmuar në përmirësimin e përvojës së klientit dhe reduktimin e kohës së përgjigjes, duke mundësuar efikasitet më të lartë dhe kursime të mëdha [1][2].

Një aplikim tjetër i rëndësishëm i IA-së është në përmirësimin e efikasitetit operativ përmes optimizimit të proceseve logjistike dhe zinxhirit të furnizimit. Për shembull, startup-i logjistik Flexport përdor IA-në për të analizuar rrjedhën e furnizimit dhe për të sugjeruar mënyra për të ulur kostot dhe për të përmirësuar dërgesat. IA-ja ndihmon në monitorimin në kohë reale të dërgesave, duke mundësuar që startup-et të reagojnë më shpejt dhe të menaxhojnë më mirë burimet e tyre.

Përveç kësaj, shumë startup-e përdorin IA-në për të automatizuar detyra rutinë administrative. Xero, një platformë për menaxhimin e financave për bizneset e vogla dhe të mesme, përdor IA-në për të automatizuar detyra si përgatitja e faturave dhe llogaritja e taksave. Kjo ka ndihmuar pronarët e startup-eve të menaxhojnë më lehtë financat e tyre me ndërhyrje minimale njerëzore, duke rritur efikasitetin dhe reduktuar kohën e harxhuar në detyra rutinë.

Dentem³ është një aplikacion për menaxhimin e praktikave dentare që ofron mundësi të avancuara si ruajtja e informacionit të pacientëve dhe analizën e imazheve dentare përmes një algoritmi të njohjes kompjuterike (Dx Vision) që përdor IA-në. Ajo gjithashtu ofron një ndihmës virtual me zë për të automatizuar detyrat e përditshme. *Dentem* synon të përmirësojë produktivitetin dhe efikasitetin në praktikën dentare.

IA në vendimmarrje

Inteligjenca Artificiale (IA) po revolucionarizon proceset e vendimmarrjes në startup-e duke mundësuar vendime të bazuara në të dhëna. Përdorimi i algoritmeve të avancuara të IA-së lejon startup-et të analizojnë sasi të mëdha të të dhënave për të identifikuar modele dhe për të parashikuar trendë të tregut. Sipas studimit të Davenport dhe Ronanki (2018), përdorimi i IA-së për vendimmarrje strategjike ndihmon kompanitë të përmirësojnë saktësinë e parashikimeve dhe të rrisin reagimin ndaj ndryshimeve të tregut, duke siguruar një avantazh konkurrues në ambientin e biznesit dinamik.[3]

Një nga përfitimet kryesore të përdorimit të IA-së është shpejtësia në përgjigje ndaj ndryshimeve në treg. Me anë të analizave prediktive, startup-et mund ta parashikojnë sjelljen e klientëve dhe të përshtatin strategjitë e tyre të marketingut dhe prodhimit në përputhje me këto

³ <https://www.dentem.co/>

njohuri. Theksojnë se analiza e sjelljes së konsumatorëve përmes IA-së mund të ndihmojë startup-et të identifikojnë nevojat dhe preferencat e klientëve, duke mundësuar krijimin e produkteve dhe shërbimeve më të përshtatura dhe më atraktive

Për më tepër, IA-ja ofron mundësi të reja për të parashikuar trendë të tregut, duke i lejuar startup-et të qëndrojnë një hap para konkurrencës. Një shembull konkret është përdorimi i IA-së për të analizuar të dhënat e tregut dhe për të identifikuar trendë emergjentë, siç është rritja e kërkesës për produkte të qëndrueshme. Startup-e si Unilever⁴ dhe Coca-Cola kanë implementuar modele prediktive për të analizuar preferencat e konsumatorëve dhe për të planifikuar strategjitë e tyre të marketingut, duke optimizuar shpenzimet dhe rritur shkallën e suksesit në lansimin e produkteve të reja. Këto aplikime të IA-së në vendimarrje u japin startup-eve një avantazh të rëndësishëm në një ambient të pasigurt dhe në ndryshim të shpejtë. Publer-i⁵ përdor IA-në për të përmirësuar menaxhimin e medieve sociale, duke përfshirë planifikimin e përmbajtjes dhe analizën e performancës. Kjo ndihmon përdoruesit t'i optimizojnë strategjitë e tyre në rrjetet sociale në mënyrë më efikase.

IA në zhvillimin e produkteve

Inteligjenca Artificiale (IA) luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e produkteve, duke kontribuar në inovativen dhe përmirësimin e tyre. Përdorimi i teknologjive të IA-së lejon startup-et të krijojnë produkte më të avancuara dhe më efikase, duke përmirësuar përvojën e përdoruesit dhe duke rritur vlerën e ofruar.[4] IA-ja ndihmon në identifikimin e mundësive për zhvillimin e produkteve të reja duke analizuar të dhëna nga konsumatorët dhe duke parashikuar nevojat e tregut, gjë që çon në produkte më inovative dhe të suksesshme.

Një nga avantazhet kryesore të IA-së është aftësia për të përsheptuar procesin e prototipizimit dhe testimit. Teknologjitë si modeli 3D dhe simulimi i avancuar, të cilat janë të mbështetura nga IA-ja, lejojnë zhvilluesit të krijojnë prototipe të shpejta dhe të testojnë idetë e tyre përpara se të investojnë në prodhimin masiv. Kjo qasje redukton ndjeshëm kohën dhe kostot e zhvillimit të produkteve, duke përmirësuar kështu konkurrencën në treg.[5]

⁴ <https://www.unilever.com/>

⁵ <https://publer.io/>

Përveç kësaj, IA-ja ofron mundësi për personalizimin dhe diferencimin e produkteve në treg. Me anë të analizave të të dhënave dhe inteligjencës prediktive, startup-et mund të ofrojnë produkte që janë të përshtatura për nevojat dhe preferencat specifike të klientëve. Një shembull konkret është përdorimi i IA-së nga disa kompani, të cilat lejojnë klientët të personalizojnë produktet e tyre bazuar në të dhënat e mbledhura nga preferencat e përdoruesve. Kjo strategji jo vetëm që rrit angazhimin e klientëve, por gjithashtu krijon një avantazh konkurrues për kompanitë që implementojnë praktika të ngjashme.

RASTI STUDIMOR

Rasti studimor nr 1

Dentem është një start-up shqiptar që ofron shërbime të avancuara stomatologjike duke përdorur teknologjitë e Inteligjencës Artificiale (IA) për të përmirësuar përvojën e pacientëve dhe efektivitetin operativ. Ky startup është një shembull i shkëlqyer se si IA-ja mund të transformojë industrinë e shëndetësisë, veçanërisht në fushën e stomatologjisë.

Inovacioni me anë të IA-së

1. Diagnostikimi i saktë: *Dentem* ka integruar algoritme të IA-së për të analizuar skanerët dentarë dhe për të diagnostikuar sëmundjet dentare në një mënyrë më të saktë dhe më të shpejtë. Kjo teknologji ndihmon stomatologët të identifikojnë probleme të mundshme që mund të kalojnë lehtësisht pa u vënë re, siç janë kariesët e hershëm ose sëmundjet periodontale.
2. Planifikimi i Trajtimit: IA-ja u ndihmon profesionistëve të shëndetësisë në *Dentem* të krijojnë plane trajtimi më të personalizuar për pacientët. Duke analizuar të dhënat e pacientëve, si historiku i shëndetit dhe preferencat personale, *Dentem* mund të ofrojë trajtime që janë të përshtatura për nevojat specifike të secilit pacient, duke rritur kështu shkallën e kënaqësisë së pacientëve.
3. Menaxhimi i programimeve dhe komunikimit me pacientët: *Dentem* përdor IA-në për të optimizuar menaxhimin e programimeve dhe për të komunikuar me pacientët. Një sistem i automatizuar i kujtesës për takimet ndihmon pacientët të mbajnë mend oraret e tyre dhe ofron kujtesa të personalizuar për trajtimet. Kjo qasje rrit efikasitetin e operacioneve dhe zvogëlon numrin e takimeve të humbura.

Tri karakteristika të rëndësishme të dentem në aspektin e inteligjencës artificiale (AI):

1. Analiza e të Dhënave: Inteligjenca artificiale mund të analizojë një sasi të madhe të dhënash, siç janë imazhet dentare, historitë mjekësore të pacientëve dhe raportet e trajtimit. Kjo ndihmon dentistin të bëjë diagnostikime më të sakta dhe të zhvillojë plane trajtimi të personalizuar.
2. Automatizimi i proceseve: AI-ja mund të automatizojë shumë procese të punës në klinikat dentare, si planifikimi i takimeve, menaxhimi i regjistrimeve dhe përpunimi i faturave. Kjo e bën punën më efikase dhe ndihmon në uljen e ngarkesës administrative për dentistët.
3. Përmirësimi i Trajtimit: Me ndihmën e algoritmeve të mësimit të makinerive, AI-ja mund të parashikojë rezultatet e trajtimeve dhe të sugjerojë metoda më të mira për menaxhimin e dhimbjeve apo ndihmën në rehabilitimin e pacientëve. Kjo rezulton në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dentare dhe kënaqësisë së pacientëve.

Rezultatet

Përmes implementimit të IA-së, Dentem ka arritur të rrisë saktësinë e diagnostikimit dhe efikasitetin e trajtimeve, duke rritur ndjeshëm nivelin e kënaqësisë së pacientëve. Përdorimi i teknologjisë IA-ja u ka lejuar atyre të bëjnë një përmirësim të konsiderueshëm në cilësinë e shërbimeve dhe në menaxhimin e operacioneve. Kjo tregon se si startup-et në fushën e stomatologjisë mund të përfitojnë nga IA-ja për të ofruar shërbime më inovative dhe efektive në Shqipëri.

Rasti studimor nr 2

Publer është një startup shqiptar që ofron një platformë të menaxhimit të medieve sociale, e cila përdor Inteligjencën Artificiale (IA) për të ndihmuar individë dhe biznese në automatizimin dhe optimizimin e postimeve të tyre në platformat e ndryshme sociale. Me një fokus në inovacion dhe efikasitet, Publer ilustron se si IA-ja mund të transformojë operacionet dhe strategjitë e marketingut për startup-et.

Inovacioni me Anë të IA-së

1. Automatizimi i postimeve: Publer lejon përdoruesit të planifikojnë dhe automatizojnë postimet e tyre në rrjete sociale. Algoritmet e IA-së analizojnë sjelljen e audiencës dhe identifikojnë momentet optimale për të publikuar, duke maksimizuar angazhimin dhe duke rritur shikueshmërinë e postimeve.
2. Analiza e performancës: Përdorimi i IA-së në Publer u lejon përdoruesve të analizojnë performancën e postimeve të tyre në kohë reale. Kjo përfshin metrika si pëlqimet, ndarjet dhe komentet, që ndihmojnë në identifikimin e përmbajtjes më të suksesshme. Këto të dhëna mund të përdoren për të optimizuar strategjitë e ardhshme të marketingut dhe për të përshtatur përmbajtjen sipas preferencave të audiencës.
3. Rekomandime për përmbajtjen: Algoritmet e IA-së ofrojnë rekomandime për llojet e përmbajtjes që mund të jenë më tërheqëse për audiencën e caktuar. Kjo ndihmon përdoruesit të krijojnë përmbajtje më të përshtatshme dhe interesante, duke rritur angazhimin dhe duke ndihmuar në ndërtimin e një marke më të fortë.

Rezultatet

Si rezultat i përdorimit të IA-së, Publer ka arritur të rrisë ndjeshëm numrin e përdoruesve dhe të përmirësojë angazhimin në postimet e tyre. Platforma ka lejuar shumë biznese dhe individë të përmirësojnë strategjitë e tyre të marketingut dhe të optimizojnë përmbajtjen e tyre në media sociale. Kjo tregon sesi përdorimi i IA-së në menaxhimin e mediave sociale mund të ofrojë një avantazh të rëndësishëm për startup-et dhe kompanitë që kërkojnë të rriten në tregun e sotëm konkurrues.

SFIDAT E ADAPTIMIT TË IA-SË NË STARTUP-E

Mungesa e Aftësive të Specializuara të IA-së: Një nga sfidat kryesore me të cilat përballen startup-et në Shqipëri është mungesa e ekspertëve të trajnuar në Inteligjencën Artificiale. Shumë startup-e shpesh kanë burime të kufizuara dhe mund të kenë vështirësi në rekrutimin e profesionistëve me aftësi të nevojshme për të zhvilluar dhe implementuar zgjidhje të IA-së. Kjo mungesë njohurish dhe aftësish ndalon inovacionin dhe mund të reduktojë efikasitetin e projekteve të IA-së.

Rreziqet etike: Përdorimi i IA-së përmban disa rreziqe etike, duke përfshirë përçarjet (bias), transparencën dhe përgjegjshmërinë. Algoritmet e IA-së shpesh mund të pasqyrojnë përçarje të pranishme në të dhënat me të cilat janë trajnuar, çka mund të çojë në vendime të padrejta. Kjo përbën një sfidë të rëndësishme për startup-et që duhet të sigurojnë që zgjidhjet e tyre të jenë të drejta dhe të përgjegjshme ndaj shoqërisë.

Kërcënimet për privatësinë e të dhënave: Në një botë ku mbrojtja e të dhënave bëhet gjithnjë e më e rëndësishme, startup-et duhet të përballen me shqetësime të mëdha në lidhje me privatësinë e të dhënave dhe përputhshmërinë me rregulloret, siç është GDPR (Reguli i Përgjithshëm mbi Mbrojtjen e të Dhënave). Këto kërkesa ligjore mund të jenë të komplikuar dhe të kushtueshme për startup-et që të implementojnë, duke rritur kështu barrierat për hyrjen në tregun e IA-së.

Përçarjet dhe diskriminimi: Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në vendimmarrje ngre shqetësime etike të rëndësishme. Algoritmet e IA-së, nëse nuk trajtohen si duhet, mund të pasqyrojnë përçarje të pranishme në të dhënat e trajnimit, duke rezultuar në vendime diskriminuese. Kjo është veçanërisht e rrezikshme në sektorë si shëndetësia, financat dhe punësimi, ku vendimet e padrejta mund të dëmtojnë individë dhe grupe të caktuara.

Mungesa e transparencës: Një sfidë tjetër etike është mungesa e transparencës në proceset e vendimmarrjes të mbështetura në IA. Përdoruesit shpesh nuk janë të vetëdijshëm për mënyrën se si merren vendimet e automatizuara, gjë që e bën të vështirë për ata të kuptojnë ose të kontestojnë këto vendime. Kjo krijon një nevojë për startup-et që të jenë të hapur dhe të sigurojnë që algoritmet e tyre të jenë të shpjegueshme dhe të arsyeshme.

Kërcënimet për sigurinë e të dhënave: Startup-et që përdorin IA-në janë të ekspozuara ndaj rreziqeve të sigurisë së të dhënave, siç janë breçjet e të dhënave dhe sulmet kibernetike. Informacioni i ndjeshëm i përdoruesve mund të jetë nën kërcënim, duke shkaktuar dëm të madh për reputacionin dhe besueshmërinë e biznesit.

Privatësia e të Dhënave: Në epokën e GDPR-së dhe rregulloreve të tjera të mbrojtjes së të dhënave, startup-et duhet të sigurojnë që të dhënat e përdoruesve të mblidhen dhe përdoren në përputhje me ligjet përkatëse. Mospërputhja me këto rregullore mund të çojë në ndëshkime të rënda financiare dhe ligjore.

REKOMANDIME DHE KONKLUZIONE

- *Mundësitë e IA-së për Startup-e:* Inteligjenca Artificiale ofron mundësi të mëdha për startup-et në fushat e inovacionit, efikasitetit dhe vendimmarrjes. Përdorimi i teknologjisë IA mund të ndihmojë startup-et të zhvillojnë produkte dhe shërbime më të avancuara, të optimizojnë proceset operacionale dhe të përmirësojnë përgjigjen ndaj kërkesave të tregut. Kjo e bën IA-në një mjet të rëndësishëm për rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të bizneseve.
- *Sfidat në implementim:* Megjithatë, ekzistojnë sfida të rëndësishme që duhet të adresohen për të shfrytëzuar potencialin e plotë të IA-së. Mungesa e aftësive të specializuara, rreziqet etike dhe shqetësimet për privatësinë e të dhënave janë disa nga pengesat më të cilat përballen startup-et. Adresimi i këtyre sfidave kërkon një qasje të qartë dhe strategjike.
- *Adoptimi strategjik për rritje të qëndrueshme:* Për të arritur rritje të qëndrueshme dhe inovacion, startup-et duhet të adoptojnë një strategji të menaxhuar mirë për pranimin e IA-së. Kjo përfshin investimin në trajnimin e stafit, ndjekjen e udhëzimeve etike dhe sigurimin e përputhshmërisë me rregulloret përkatëse. Një qasje e tillë jo vetëm që do të ndihmojë në përmirësimin e operacioneve, por gjithashtu do të sigurojë që startup-et të jenë të përgatitura për të përballuar sfidat e së ardhmes.

Referencat

- [1] Giuggioli, G. and Pellegrini, M.M. (2023), "Artificial intelligence as an enabler for entrepreneurs: a systematic literature review and an agenda for future research", *International Journal of Entrepreneurial Behavior & Research*, Vol. 29 No. 4, pp. 816-837, <https://doi.org/10.1108/IJEBR-05-2021-0426>
- [2] Chalmers, D., MacKenzie, N.G. and Carter, S. (2021), "AI and entrepreneurship: implications for venture creation in the fourth industrial revolution", *Entrepreneurship Theory and Practice*, Vol. 45 No. 5, pp. 1028-1053.
- [3] Davenport, T. H., & Ronanki, R. (2018, January 9). Artificial Intelligence for the Real World. *Harvard Business Review (HBR)*. <https://www.bizjournals.com/boston/news/2018/01/09/hbr-artificial-intelligence-for-the-real-world.html>
- [4] Ahmed, Mohammed & Ahmed, Betty. (2023). Artificial Intelligence and Product Development. 27. 10-18. 10.2139/ssrn.4534559.
- [5] Sharma, Anurag. (2023). Product design and development using Artificial Intelligence (AI) techniques: A review. 10.31224/2958.

Eros Angjeli¹, Eriola Hoxha², Adrian Civici³

EKONOMIA DHE FINANCAT E BIZNESIT, MIKROKREDIA

Abstrakt

Që në fillimet e saj në vitet '70, mikrokredia është parë si një mjet financiar, i cili ofron kredi të vogla për individë dhe biznese, të cilët në kushtet që janë nuk mund t'u ofrohet shërbim në bankat e nivelit të dytë ose nga agjencitë e tjera të dhënies hua. Në vitet në vazhdim, ajo ka pasur një rol të rëndësishëm në ekonominë dhe financat e biznesit duke nxitur veprimtarinë ndërmarrëse në zonat pa shërbime. Programet e mikrokredisë lejojnë bizneset e vogla të fillojnë të zgjerohen, duke përkrahur rritjen e ekonomisë në komunitetet lokale dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Nëse i referohemi qasjes së rritjes ekonomike, ndikimi që mikrokredia ka, tregon se ajo është e rëndësishme për të krijuar sisteme financiare gjithëpërfshirëse dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë ekonomike.

Nga një këndvështrim financiar, mikrokredia vë theksin te sfida se si ofrohen shërbimet financiare për individët me të ardhura të ulëta, të cilët nuk plotësojnë kriteret për të aplikuar për një kredi të thjeshtë. Edhe pse normat e interesit për kredinë mikro janë zakonisht më të larta për të mbuluar rrezikun që marrin përsipër huadhënësit, ato mbeten një opsion më i arsyeshëm, krahasuar me burimet e tjera së dhënies hua

Me gjithë potencialin e saj, mikrokredia ndodhet përballë disa sfidave, duke përfshirë probleme mbi normat e interesit dhe efektivitetin afatgjatë të programeve në përbushjen e qëllimit për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Diskutimet rreth mikrokredisë theksojnë nevojën për vlerësim dhe përmirësim të vazhdueshëm të këtyre programeve për të rritur sa më shumë përfitimet pozitive. Ky studim përdor të dhëna dytësore nga institucionet financiare ndërkombëtare, agjencitë rregullatore dhe institucionet publike në Shqipëri. Si përfundim, këto probleme duhet të korrigjohen nëse mikrokredia do të përdoret si një mjet për rritje të drejtë ekonomike dhe inovacion.

Fjalët çelës: Mikrokredi, ekonomia e biznesit, përfshirja financiare, zhvillimi ekonomik, financa e biznesit të vogël

Kodet JEL: G21, O16, L26

¹ eros.angjeli@umsh.edu.al

² eriola.hoxha@umsh.edu.al

³ adrian.civici@umsh.edu.al

HYRJE

Qëllimi i studimit

Ky studim ka për qëllim të analizojë ndikimin e mikrokredisë në ekonominë dhe financat e biznesit, duke përqendruar vëmendjen në përfitimet e saj për përfshirjen financiare dhe përmirësimin e mirëqenies ekonomike në zona të përjashtuara nga shërbimet financiare tradicionale.

Rëndësia e studimit

Mikrokredia është shfaqur që nga vitet '70 si një mekanizëm për ofrimin e kredive të vogla për individë dhe biznese që nuk kanë qasje në sistemin tradicional bankar. Duke ndihmuar ndërmarrjet e vogla dhe individët me të ardhura të ulëta, mikrokredia ka përmbushur një rol të rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe ka ndihmuar në reduktimin e varfërisë.

Sfondi teorik dhe rishikim i literaturës, Mikrokredia dhe përfshirja financiare

Mikrokredia është konceptuar si një mjet për të ofruar mbështetje financiare për individët dhe bizneset e vogla që nuk përfitojnë nga shërbimet tradicionale bankare për shkak të mungesës së kolateralit, historikut të kreditimit, ose të ardhurave të qëndrueshme. Duke vepruar jashtë kriterëve tradicionale të huadhënies, mikrokredia ka zgjeruar qasjen në kapital për grupe të ndryshme, duke i ndihmuar ata të fillojnë ose të zgjerojnë biznese të vogla në sektorë si bujqësia, artizanati dhe biznesi i vogël. Ky model është veçanërisht efektiv në komunitetet rurale dhe në zonat e izoluara që shpesh përballen me përjashtim financiar dhe kanë vështirësi për të siguruar burime të qëndrueshme të të ardhurave.

Përfitimi nga mikrokredia u mundëson këtyre individëve të ndërmarrin iniciativa ekonomike që jo vetëm përmirësojnë jetesën e tyre, por gjithashtu nxisin zhvillimin ekonomik të komunitetit të tyre. Ajo ka një ndikim të rëndësishëm jo vetëm në aspektin ekonomik, por edhe social, pasi fuqizon grupet e margjinalizuara, përfshirë gratë dhe minoritetet, duke rritur autonominë dhe përfshirjen e tyre në tregun ekonomik. Ky proces kontribuon në përfshirjen financiare dhe krijon një model të qëndrueshëm

për zhvillimin ekonomik, duke e bërë mikrokreditin një faktor kyç për nxitjen e rritjes së qëndrueshme dhe përmirësimin e mirëqenies në zona që kanë nevojë për mbështetje financiare.

Mikrokredia dhe ekonomia e biznesit

Studimet e mëparshme tregojnë se ndërmarrjet e vogla që përfitojnë nga mikrokredia kanë potencial të lartë për të ndikuar në ekonominë e biznesit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve. Duke krijuar vende të reja pune dhe duke nxitur aktivitete sipërmarrëse, mikrokredia ndihmon në rritjen e punësimit dhe në përmirësimin e të ardhurave në nivel lokal, duke ndihmuar gjithashtu në diversifikimin e burimeve ekonomike të komuniteteve rurale dhe në tërheqjen e më shumë aktorëve ekonomikë. Ndërmarrjet e vogla të mbështetura nga mikrokredia mund të kontribuojnë në prodhimin lokal, të përmirësojnë aftësitë e punës në komunitet dhe të krijojnë një zinxhir ekonomik të qëndrueshëm që stimulon rritjen e qëndrueshme.

Megjithatë, mikrokredia përballet me sfida të konsiderueshme që kufizojnë efektivitetin e saj të plotë, përfshirë normat e larta të interesit që institucionet vendosin për të mbuluar rrezikun dhe kostot e menaxhimit të kredive të vogla. Këto norma të larta shpesh janë një barrierë për përfituesit, duke i ekspozuar ata ndaj një borxhi të lartë që mund të pengojë përfitimet ekonomike të kredive. Kjo sfidë nënkupton nevojën për politika dhe rregullore që të mbrojnë përfituesit nga normat e larta të interesit dhe që të krijojnë modele të qëndrueshme financimi që lehtësojnë kthimin e kredive, duke bërë të mundur që përfitimet e mikrokredisë të jenë të arritshme për një gamë më të gjerë individësh dhe biznesesh.

Në përfundim, për të siguruar që mikrokredia të luajë një rol më të madh dhe më efektiv në ekonominë e biznesit, kërkohen përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e qasjes së shërbimeve, uljen e normave të interesit dhe mbështetjen e vazhdueshme për përfituesit.

Metodologjia e kërkimit, burimi i të dhënave

Ky studim përdor të dhëna dytësore të siguruara nga institucione financiare ndërkombëtare dhe agjenci publike në Shqipëri, duke përfshirë të dhëna për përfituesit e mikrokredisë dhe ndikimin e saj ekonomik.

Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave për këtë studim përfshin një krahasim të përfitimeve dhe sfidave kryesore të mikrokredisë, duke vlerësuar ndikimin e saj në përfshirjen financiare dhe në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm. Për të pasuruar analizën me kontekstin shqiptar, janë marrë parasysh edhe të dhëna nga Banka e Shqipërisë mbi situatën e sektorit të mikrokredisë në vend për vitin 2023.

Të dhënat nga Banka e Shqipërisë tregojnë një rritje të numrit të individëve dhe bizneseve të vogla që përfitojnë nga shërbimet e mikrokredisë. Sipas statistikave të publikuara për vitin 2023, numri i kredive mikro ka arritur në rreth 120,000, duke shënuar një rritje prej 15% krahasuar me vitin e kaluar. Vlera totale e mikrokredisë është raportuar të jetë rreth 8 miliard lekë, duke reflektuar një trend pozitiv të përfshirjes financiare për individët dhe ndërmarrjet e vogla që përballen me vështirësi për të siguruar mbështetje financiare nëpërmjet institucioneve tradicionale bankare.

Normat e interesit për mikrokreditë në Shqipëri për vitin 2023 kanë një mesatare prej 12%, që është më e lartë se kreditë e zakonshme, të cilat arrijnë rreth 8%, por gjithsesi mbetet një opsion më i përballueshëm se burimet joformale të financimit. Kjo diferencë tregon rëndësinë e mikrokredisë si një opsion financiar për shumë individë dhe biznese, veçanërisht në zonat rurale.

Ndikimi në krijimin e vendeve të punës është gjithashtu i rëndësishëm: të dhënat sugjerojnë se sektori i mikrokredisë ka mbështetur zhvillimin e rreth 5,000 vendeve të reja të punës në vitin 2023, duke kontribuar ndjeshëm në uljen e papunësisë dhe në rritjen e të ardhurave familjare në këto zona. Kjo rritje e punësimit në sektorin e mikrokredisë ka ndihmuar në forcimin e ekonomisë lokale dhe ka kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës për shumë individë.

Përmes përfshirjes së këtyre të dhënave, analiza arrin të identifikojë më qartë modelet e suksesit të mikrokredisë në Shqipëri dhe sfida të saj, si normat e larta të interesit dhe rreziku i borxhit për përfituesit. Këto të dhëna do të shërbejnë si një bazë e fortë për diskutimet mbi politikën e ardhshme dhe strategjitë që mund të ndihmojnë në rritjen e efektivitetit të mikrokredisë si një mjet për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.

REZULTATET

Ndikimi i mikrokredisë në zhvillimin ekonomik lokal

Rezultatet e analizës tregojnë se programet e mikrokredisë kanë ndikuar ndjeshëm në zhvillimin ekonomik të komuniteteve lokale, veçanërisht në zonat ku aksesimi i shërbimeve financiare tradicionale ka qenë i kufizuar. Përfituesit e mikrokredisë, shpesh të përjashtuar nga institucionet financiare tradicionale, kanë gjetur në këto programe një mjet për të siguruar kapitalin fillestar të nevojshëm për krijimin e bizneseve të vogla apo për zgjerimin e aktiviteteve ekzistuese.

Të dhënat nga Banka e Shqipërisë për vitin 2023 tregojnë se numri i kredive mikro është rritur me 15% krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në 120,000 kredi të miratuara. Kjo rritje tregon se individët dhe biznese të vogla po shfrytëzojnë më shumë mundësitë që ofrojnë programet e mikrokredisë. Vlera totale e mikrokredisë është raportuar të jetë rreth 8 miliard lekë, e cila ndihmon në fuqizimin e zhvillimit ekonomik lokal.

Nga një analizë më e detajuar, rezulton se mikrokredia ka kontribuar në disa aspekte kryesore të zhvillimit lokal:

1. Krijimi i vendeve të punës

Mikrokredia ka mundësuar krijimin e vendeve të reja të punës në bizneset e vogla, duke lehtësuar kështu reduktimin e papunësisë në komunitetet e përjashtura nga shërbimet tradicionale bankare. Sipas Bankës së Shqipërisë, sektori i mikrokredisë ka mbështetur rreth 5,000 vende të reja të punës në vitin 2023. Shumë nga këto biznese punësojnë individë brenda komunitetit, çka ndihmon në përmirësimin e nivelit të jetesës dhe fuqizon stabilitetin ekonomik të zonave përkatëse.

2. Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM)

Kreditë e vogla kanë ndihmuar në fuqizimin dhe zgjerimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, që janë motori kryesor i zhvillimit ekonomik të zonave rurale dhe periferike. Përmes mikrokredisë, këto ndërmarrje kanë fituar qasje në kapitalin e nevojshëm për të investuar në teknologji të reja, për të përmirësuar infrastrukturën dhe për të zgjeruar aktivitetin e tyre.

3. Rritja e të rdhurave dhe përmirësimi i standardeve të jetesës

Duke mundësuar aksesin në kredi për individët me të ardhura të ulëta, mikrokredia ka përmirësuar të ardhurat për familjet që merren me aktivitete ndërmarrëse. Si rezultat, shumë prej këtyre individëve kanë qënë në gjendje të sigurojnë një mirëqenie më të mirë për familjet e tyre, duke rritur aksesin në arsim, shëndetësi dhe shërbime të tjera bazike.

Sfida të mikrokredisë

Edhe pse mikrokredia është një mjet i dobishëm për promovimin e përfshirjes financiare, ajo përballet me disa sfida të rëndësishme që kufizojnë efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e saj. Përballja me këto pengesa është thelbësore për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të dobishëm për të gjithë përfituesit e mikrokredisë. Disa nga sfidat kryesore përfshijnë:

1. Normat e larta të interesit

Institucionet që ofrojnë mikrokredi vendosin norma interesi të larta për të mbuluar kostot e larta të operacioneve dhe rrezikun e madh që paraqet huadhënia për klientët e pambrojtur financiarisht. Kjo shpesh ndodh për shkak të mungesës së garancive dhe të historisë së kreditit nga ana e përfituesve, të cilët në shumicën e rasteve nuk kanë asete për të siguruar huan. Për shumë individë dhe biznese të vogla, këto norma të larta interesi krijojnë një barrë financiare që e bën të vështirë shlyerjen e kredive, duke reduktuar potencialin e mikrokredisë për t'i ndihmuar ata në përmirësimin afatgjatë të gjendjes së tyre ekonomike.

2. Efektiviteti afatgjatë i programit

Ndërsa mikrokredia shpesh rezulton efektive në ofrimin e kapitalit fillestar për bizneset e vogla, sfida qëndron në sigurimin e efektivitetit të saj në periudha afatgjata. Bizneset e vogla që përfitojnë mikrokredi, shpesh kanë mungesë përvoja në menaxhimin e biznesit dhe planifikimin financiar, gjë që mund të çojë në dështimin e tyre. Mungesa e mbështetjes së vazhdueshme për këto biznese përbën një sfidë të madhe për institucionet financiare që synojnë të krijojnë një ndikim të qëndrueshëm në zhvillimin ekonomik lokal. Kështu, mbështetja në aftësimin e sipërmarrësve dhe trajnimi i tyre mbi menaxhimin e financave do të mundësonte që mikrokredia të siguronte rezultate më të qëndrueshme.

3. Rreziku i borxhit të lartë për përfituesit

Mikrokredia është e destinuar për individë dhe familje me të ardhura të ulëta, por ky grup është më i ndjeshëm ndaj rrezikut të borxhit të lartë. Duke marrë parasysh kufizimet financiare, këta përfitues shpesh përballen me vështirësi në shlyerjen e borxhit dhe, në disa raste, përfundojnë në një cikël të pafund borxhi që ndikon negativisht në mirëqenien e tyre financiare. Kjo gjendje e rëndë mund të ndikojë jo vetëm në bizneset e tyre, por edhe në shëndetin ekonomik të familjeve dhe komuniteteve të tyre. Në shumë raste, individët që e kanë të vështirë të shlyejnë borxhet mund të kërkojnë kredi të reja për të shlyer ato ekzistuese, duke përkeqësuar gjendjen e tyre financiare dhe duke rritur rrezikun e falimentimit.

4. Varësia nga subvencionet dhe financimet e jashtme

Shumë programe të mikrokredisë mbështeten në burime të jashtme financiare për të mbuluar shpenzimet dhe për të mbajtur normat e interesit sa më të ulëta. Kjo varësi nga subvencionet dhe ndihmat financiare e bën të vështirë sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të mikrokredisë. Nëse ndihmat apo subvencionet e jashtme ndërpriten, shumë institucione të mikrokredisë mund të mos jenë në gjendje të mbulojnë shpenzimet operationale dhe, për rrjedhojë, të zvogëlojnë gamën e shërbimeve të ofruara për përfituesit.

5. Kufizimet rregullatore dhe mungesa e politika të qarta

Në disa vende, mungesa e rregulloreve të qarta dhe politikeve mbështetëse për mikrokreditë krijon sfida për institucionet financiare që ofrojnë këto shërbime. Ndërhyrjet rregullatore të papërshtatshme ose mungesa e një kornize mbështetëse mund të ndikojë negativisht në efektivitetin e programeve të mikrokredisë. Një kornizë rregullatore e favorshme mund të ndihmojë në sigurimin e transparencës, stabilitetit dhe qëndrueshmërisë në sektorin e mikrokredisë.

6. Pengesat kulturore dhe sociale

Në disa komunitete, prania e barrierave kulturore dhe sociale mund të ndikojë negativisht në efikasitetin e mikrokredisë. Në komunitete ku ka stigmatizim ndaj ndërmarrësisë për gratë ose për grupet e marginalizuara, përfituesit e mikrokredisë mund të përballen me sfida të mëdha për të shfrytëzuar plotësisht mundësitë financiare që u

ofrohen. Për të tejkaluar këto barriera, institucionet e mikrokredisë duhet të marrin masa për të inkurajuar përfshirjen sociale dhe për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me përfitimet e mikrokredisë.

Mikrokredia ka vërtetuar vlerën e saj si një instrument kyç për përfshirjen financiare dhe rritjen ekonomike, veçanërisht në komunitete të marginalizuara dhe për individët pa qasje në shërbimet tradicionale financiare. Duke ofruar mundësi të reja financimi për individë dhe biznese të vogla, mikrokredia i ka dhënë një impuls pozitiv zhvillimit ekonomik lokal dhe ka ndihmuar në përmirësimin e mirëqenies sociale. Këto kredi të vogla u mundësojnë sipërmarrësve dhe grupeve me të ardhura të ulëta që të investojnë në biznese të vogla, të cilat gjenerojnë të ardhura dhe kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve.

Në këto zona të pamundura për shërbimet tradicionale bankare, mikrokredia ka arritur të mbështesë krijimin e bizneseve të vogla, të përmirësojë të ardhurat e përfituesve dhe të krijojë një bazë të qëndrueshme për rritje ekonomike lokale. Për më tepër, ndikimi i mikrokredisë nuk kufizohet vetëm në aspektin ekonomik: ajo gjithashtu fuqizon individët, veçanërisht gratë dhe grupet e tjera të marginalizuara, duke rritur aftësinë e tyre për të kontribuar në ekonominë e komunitetit dhe për të ndikuar pozitivisht në jetën e tyre dhe të familjeve të tyre. Në shumë komunitete, mikrokredia ka çuar në përmirësime të dukshme në standartet e jetesës dhe ka ofruar alternativa për varfërinë.

Megjithatë, suksesi i mikrokredisë është i varur nga adresimi i sfidave që ndikojnë në efektivitetin e saj afatgjatë. Normat e larta të interesit mund të pengojnë suksesin e përfituesve në shlyerjen e kredive, duke i lënë ata të ekspozuar ndaj rrezikut të borxhit të lartë dhe duke e bërë të vështirë për ta që të përfitojnë plotësisht nga mikrokredia. Në të njëjtën kohë, mungesa e mbështetjes për menaxhimin financiar dhe trajnimin e sipërmarrësve, të cilët shpesh nuk kanë përvojë në drejtimin e një biznesi, mund të ndikojë negativisht në qëndrueshmërinë e këtyre bizneseve të vogla, të cilat përballen me sfida të mëdha për mbijetesë në treg.

Për të siguruar që mikrokredia të ofrojë një ndikim afatgjatë dhe të qëndrueshëm, është thelbësore që institucionet financiare dhe ato të mikrokredisë të përmirësojnë politikat e tyre duke siguruar qasje të drejtë dhe të përballeshme për të gjithë përfituesit. Ulja e normave të interesit, krijimi i programeve mbështetëse për trajnime në menaxhim financiar dhe zhvillimi i qasjeve që u përgjigjen nevojave të përfituesve mund të rrisin efektivitetin e mikrokredisë. Këto ndryshime gjithashtu

mund të kontribuojnë në krijimin e një cikli të qëndrueshëm ekonomik në komunitetet e varfra, duke mundësuar që bizneset e vogla të rriten dhe të krijojnë vende të reja pune, duke e shndërruar mikrokreditin në një mjet të fuqishëm për zhvillim dhe stabilitet ekonomik.

Ndërkohë që mikrokredia vazhdon të ofrojë përfitime për përfshirjen financiare, ky studim sugjeron se, për të maksimizuar ndikimin e saj, është e nevojshme një strategji e integruar që përfshin uljen e normave të interesit dhe ofrimin e mbështetjes për menaxhimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të bizneseve të vogla. Përveç kësaj, krijimi i një kornize rregullatore që inkurajon përgjegjësinë sociale dhe etikën në ofrimin e mikrokredisë do të ndihmojë në promovimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe përfshirës për të gjitha grupet e shoqërisë.

Konkluzionet dhe rekomandimet

Ky studim nxjerr në pah rëndësinë e mikrokredisë si një mjet thelbësor për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe përfshirjen financiare në komunitetet me mundësi të kufizuara financiare. Rezultatet tregojnë se mikrokredia ka pasur një ndikim pozitiv në nxitjen e aktiviteteve sipërmarrëse, krijimin e vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e standardeve të jetesës në shumë komunitete. Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, numri i përfituesve të mikrokredisë ka arritur në 120,000 në vitin 2023, me një vlerë totale prej 8 miliardë lekësh, duke theksuar rolin e saj si një burim i rëndësishëm financimi për individët dhe bizneset e vogla.

Megjithatë, për të maksimizuar përfitimet e mikrokredisë dhe për të siguruar që ndikimi i saj të jetë i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, nevojiten përmirësime dhe angazhime të vazhdueshme. Mikrokredia përballet ende me disa sfida të rëndësishme, përfshirë normat e larta të interesit dhe mungesën e mbështetjes për menaxhim dhe zhvillim të qëndrueshëm për përfituesit. Për të përmirësuar efektivitetin dhe për të siguruar që ndikimi ekonomik të jetë afatgjatë, rekomandohet që:

1. Programet e mikrokredisë të zhvillohen me politika që përqendrohen në uljen e normave të interesit për përfituesit me të ardhura të ulëta

Kjo do të ndihmonte në lehtësimin e barrës financiare për individët që kanë vështirësi ekonomike, duke e bërë më të përbalueshme

kthimin e kredive. Duke ulur normat e interesit, programet e mikrokredisë mund të rrisin përfshirjen e më shumë individëve dhe bizneseve të vogla, duke i ndihmuar ata të përfitojnë nga kreditë me kosto më të ulët dhe duke zvogëluar rrezikun e borxhit të lartë për përfituesit.

2. Të krijohen mekanizma mbështetës për të siguruar që ndikimi ekonomik të jetë afatgjatë dhe të përfshijë një gamë më të gjerë përfituesish

Mekanizmat mbështetës duhet të përfshijnë programe për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm që garantojnë ndikim afatgjatë të mikrokredisë, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për rritjen e bizneseve dhe për zhvillimin e komuniteteve. Në këtë kontekst, institucionet e mikrokredisë dhe ato rregullatore duhet të bashkëpunojnë për të siguruar një kornizë që promovon stabilitet dhe zhvillim gjithëpërfshirës.

3. Të zhvillohen programe trajnimi për përfituesit e mikrokredisë për të përmirësuar aftësitë e tyre financiare dhe menaxheriale

Edukimi financiar dhe trajnimi për menaxhim është një nga faktorët kryesorë për të siguruar që bizneset e vogla të jenë të suksesshme në periudhën afatgjatë. Sipas Bankës së Shqipërisë, vetëm 40% e përfituesve të mikrokredisë raportojnë se kanë marrë trajnim për menaxhimin e financave. Trajnimet për përmirësimin e aftësive menaxheriale dhe financiare do të ndihmonin sipërmarrësit të jenë më të përgatitur për të përballuar sfidat e tregut dhe për të marrë vendime të zgjuara për biznesin e tyre.

Në përfundim, mikrokredia ka potencialin për të qenë një forcë transformuese në përfshirjen financiare dhe për të kontribuar në një zhvillim ekonomik më të drejtë dhe gjithëpërfshirës. Ndërhyrjet e propozuara në këtë studim janë thelbësore për përmirësimin e ndikimit të mikrokredisë, duke e bërë atë një mjet efektiv për të luftuar varfërinë dhe për të promovuar mirëqenie ekonomike të qëndrueshme për grupet e marginalizuara dhe komunitetet me të ardhura të ulëta.

BUSINESS ECONOMICS AND FINANCE: THE ROLE OF MICROCREDIT

Abstract

Since its beginnings in the 1970s, microcredit has been seen as a financial tool that offers small loans to individuals and businesses that, under current conditions, cannot receive services from second-tier banks or other lending agencies. In subsequent years, it has played an important role in the economy and business finance by promoting entrepreneurial activity in underserved areas. Microcredit programs allow small businesses to start expanding, supporting economic growth in local communities and creating new jobs. From an economic growth perspective, the impact of microcredit shows that it is crucial for creating inclusive financial systems and improving economic sustainability.

From a financial standpoint, microcredit emphasizes the challenge of providing financial services to low-income individuals who do not meet the criteria to apply for a standard loan. Although interest rates for microloans are usually higher to cover the risk assumed by lenders, they remain a more reasonable option compared to other lending sources.

Despite its potential, microcredit faces several challenges, including issues with interest rates and the long-term effectiveness of programs in achieving sustainable economic development. Discussions around microcredit highlight the need for continuous assessment and improvement of these programs to maximize positive benefits. This study uses secondary data from international financial institutions, regulatory agencies, and public institutions in Albania. In conclusion, these issues must be addressed if microcredit is to be used as a tool for equitable economic growth and innovation.

Keywords: Microcredit, Business Economics, Financial Inclusion, Economic Development, Small Business Finance

JEL Codes: G21, O16, L26

Referencat

1. Armendáriz, B., & Morduch, J. (2010). *The Economics of Microfinance* (2nd ed.). MIT Press.
2. Yunus, M. (2007). *Creating a World Without Poverty: Social Business and the Future of Capitalism*. PublicAffairs.
3. Ledgerwood, J., Earne, J., & Nelson, C. (Eds.). (2013). *The New Microfinance Handbook: A Financial Market System Perspective*. World Bank Publications.
4. Cull, R., Demirgüç-Kunt, A., & Morduch, J. (2009). Microfinance Meets the Market. *Journal of Economic Perspectives*, 23(1), 167–192.
5. Banerjee, A. V., Duflo, E., Glennerster, R., & Kinnan, C. (2015). The Miracle of Microfinance? Evidence from a Randomized Evaluation. *American Economic Journal: Applied Economics*, 7(1), 22–53.
6. Hermes, N., & Lensink, R. (2011). Microfinance: Its Impact, Outreach, and Sustainability. *World Development*, 39(6), 875–881.
7. Morduch, J. (1999). The Microfinance Promise. *Journal of Economic Literature*, 37(4), 1569–1614.
8. Karlan, D., & Zinman, J. (2009). Expanding Credit Access: Using Randomized Supply Decisions to Estimate the Impacts. *Review of Financial Studies*, 23(1), 433–464.
9. Copestake, J., Dawson, P., Fanning, J. P., McKay, A., & Wright-Revollo, K. (2005). Monitoring the Diversity of the Poverty Outreach and Impact of Microfinance: A Comparison of Methods Using Data from Peru. *Development Policy Review*, 23(6), 703–723.
10. Robinson, M. S. (2001). *The Microfinance Revolution: Sustainable Finance for the Poor*. World Bank Publications.
11. Banka e Shqipërisë. (2023). Raporti mbi performancën e mikrokredisë në Shqipëri për vitin 2023.,
https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime_Periodike/Raporti_Vjetor_i_Mbikeqyrjes/Raporti_Vjetor_i_Mbikeqyrjes_2023.html

Arsim Bajrami

SFIDAT DHE KONTRAVERSAT E DIALOGUT KOSOVË-SERBI

Hyrje

Në këtë punim do t'i bëhet një analizë kushtetuese-juridike procesit të gjertanishëm të dialogut Kosovë-Serbi. Në mënyrë të veçantë do të trajtohen sfidat dhe rreziqet me të cilat përballet Republika e Kosovës, si rezultat i presioneve ndërkombëtare për t'i bërë kompromise Serbisë, përtej kompromiseve të bëra me Planin Gjithëpërfshirës të Ahtisarit, me ç'rast pakica serbe që jeton në Kosovë, me Kushtetutën e Kosovës është trajtuar në mënyrë afirmative me të drejta, të cilat nuk i posedon asnjë pakicë tjetër në Evropë.

Dialogu Kosovë – Serbi është një proces kontravers që synonte arritjen e një marrëveshjeje ligjërish të detyrueshme me të cilën i jepet fund konfliktit midis Kosovës dhe Serbisë. Janë tri rreziqe të cilat e kanë sfiduar Kosovën në procesin e dialogut. *E para*, kërkesa që tani më mund të quhet e konsumuar për ndarje të Kosovës, për korrigjime kufijsh, për rishikime kufijsh, për t'i mundësuar Serbisë marrjen nën kontroll të plotë të pjesës veriore të Kosovës dhe mbrojtjen e territoreve me shumicë serbe në brendi të Kosovës. Tani më ky opsion do të mund të quhet edhe i konsumuar, sepse bashkësia ndërkombëtare, në radhë të parë Bashkimi Evropian, mendon se çfarëdo rishikimi i kufijve do të ketë efekt domino në shumë shtete të tjera dhe do të krijonte një destabilitet të përgjithshëm. *Rreziku i dytë* është krijimin i asocioacionit të komunave me shumicë serbe që, në fakt, do të thotë instalimi i një autonomie politike–territoriale për serbët e Kosovës. Ky asociacion me kompetenca ekzekutive, Kosovën do ta bënte një shtet jofunksional, me një rend jounik kushtetues dhe do të mundësonte një destabilizim të përhershëm të Kosovës nga Beogradi dhe nga serbët lokalë. *Rreziku i tretë* do të ishte ideja e një kompromisi që po quhet *Ahtisari plus*, pra dhënien e drejtave shtesë për serbët e Kosovës, gjë që shqipëtarët duhet ta refuzojnë kategorikisht. Plani i Ahtisarit është kompromisi maksimal që shqipëtarët kanë mundur ta bëjnë dhe duhet të insistojmë që kjo

marrëveshje historike të mos cenojë Kushtetutën e Kosovës, Deklaratën e Pavarësisë së saj. Duhet me këmbëngulje të mbrohen pesë vlerat themelore të shtetit të Kosovës: pavarësia, sovraniteti, karakteri unitar, integriteti territorial dhe pacenueshmëria e kufijve. Pala kosovare duhet të jetë shumë e përgatitur, e vendosur që këto vlera të jenë bazë e cilësdo marrëveshjeje dhe të mos bëjnë asnjë kompromis tjetër i cili vë në dyshim identitetin shtetëror të shtetit të Kosovës.

Procesi i normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shtetit të Serbisë, i cili tani pas 13 vjetësh po shkon drejt komplikimit, pa shpresa se do të prodhojë një marrëveshje përfundimtare në formë të një traktati ndërkombëtar me garanci të fuqishme ndërkombëtare për zbatimin e tij.

Konteksti i procesit nga një dialog teknik në një dialog politik

Marrëdhëniet Kosovë-Serbi mund të përshkruhen, përveç të tjerash edhe përmes një të kaluarë të largët historike. Kosova pas Luftës së Dytë Botërore u aneksua dhunshëm nga Serbia përmes administrimit ushtarak dhe dhunës shtetërore. Përmes një procesi shtetëror, ish-Jugosllavia ndaloi Kosovën të bashkohet me shtetin amë, me Shqipërinë. Qysh në Konferencën e Bujanit përfaqësuesit e zgjedhur të popullit në mënyre legjitime kishin shprehur vullnetin e popullit të Kosovës që pas Luftës së Dytë Botërore do të bashkohen me shtetin amë – Shqipërinë. Rezoluta e Konferencës së Bujanit ishte një akt me fuqi konstitutive dhe me garanci ndërkombëtare. Në të vërtetë, Rezoluta e Bujanit paraqiste dokumentin themelor të vetëvendosjes së shqiptarëve të Kosovës¹.

Periodha pas miratimit të Rezolutës së Bujanit karakterizohet me presione të vazhdueshme politike, e që kishin për qëllim krijimin e rrethave politike, në të cilat kjo Rezolutë do të diskualifikohej dhe do të krijoheshin kushtet për aneksimin e dhunshëm të Kosovës në kuadër të Jugosllavisë. Në këtë kontekst, në periudhën prej 8 shkurtit e deri në gjysmën e majit 1945, në Kosovë, me urdhrin e komandantit suprem (Tito)² vendoset administrimi ushtarak si organ i pushtetit ushtarak-shtetëror³. Ndonëse, me vendosjen e gjendjes së administrimit (sundimit)

¹ Noel Molcolm, “Kosova një histori e shkurtër”, Macmillan, London 1998, fq. 307-308.

² Më gjerësisht, Stipe Mesiç, “Si u shkatërrua Jugosllavia”, Prishtinë, 2011.

³ Bob Allen, “Why Kosovo? Anatomy of a Needless War”, Canadian Centre for Policy

ushtarak nuk u rrëzua plotësisht pushteti popullor, puna e organeve të pushtetit popullor dukshëm qe zbehur, meqë ai iu nënshtrua detyrave që parashtrroi ushtrimi ushtarak⁴.

Serbia e ndaloi këtë bashkim dhunshëm, duke vendosur gjendjen ushtarake dhe duke zbatuar politikat e terrorit dhe dhunës për t'i frikësuar shqipëtarët që të heqin dor nga kjo ide. Të gjitha këto argumente çojnë në konkluzionin që Kosova asnjëherë nuk ka qenë pjesë e Serbisë⁵. Si pasojë e kësaj, Kosova është aneksuar dhunshëm dhe gjer në vitin 1989, përkatësisht deri më 2 korrik 1990 ishte dhunshëm pjesë e Jugosllavisë dhe në kuadrin e Serbisë. Momentin e lindjes së një autonomie të Kosovës, lidhen me protestat gjithëpopullore të popullit shqiptar të vitit 1968 kur ai në mënyrë masive kërkoi të drejtën e vet për të pasur një kushtetutë, të drejtën e përdorimit të flamurit, të drejtën e përdorimit të gjuhës shqipe dhe për të hapur dhe për të pasur institucione kulturore, arsimore dhe institucione të tjera.

Pas krijimit të Republikës Federative të ish-Jugosllavisë, Kosova përjetoj periudha të ndryshme brenda këtij shteti federal, ndërsa në vitin 1974 kishte statusin e njësisë federale dhe ishte e përfaqësuar në nivelin federal njëjtë sikur edhe Republikat e tjera. Konflikti ndërmjet Serbisë dhe Kosovës kishte eskaluar me luftën në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, e cila kishte përfunduar me intervenimin e NATO-s. Pas ndërhyrjes ushtarake dhe miratimit të Rezolutës 1244 nga Organizata e Kombeve të Bashkuara – OKB-ja, Kosova filloi një realitet të ri politik e juridik, krejtësisht të ndryshëm nga ai i para vitit 1999. Ky realitet zgjati deri me shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008.⁶

Shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 hapi një kapitull të ri të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si dy shtete të ndryshme. Se shteti i Kosovës ishte një realitet tanimë i krijuar, këtë e vërtetoi edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë – GJND-ja, e cila në Opinionin Këshilldhënës të datës 22 korrik 2010 lidhur me Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës dhe rrjedhimisht shpalljen e pavarësisë së Kosovës ndër të tjera kishte konstatuar se shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 nuk ishte në kundërshtim me të drejtën

Alternatives, July 1999, fq.8

⁴ Gazmend Zajmi “*Vepra I*”, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, libri 9, Prishtinë, 1997, fq.10-11.

⁵ Arsim Bajrami, Shtetndërtimi i Kosovës, fq. 59, botim i ASHAK, Prishtinë 2023

⁶ Shih më shumë kontekstin e këtyre ngjarjeve në: Marc Weller, “*Shtetësia e Kontestuar - administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*”, Prishtinë 2011, f. 255-386.

ndërkombëtare, si dhe nuk kishte shkelur Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe Kornizën Kushtetuese.⁷

Nxjerrja e Opinionit Këshilldhënës të GJND-së për deklaratën dhe rrjedhimisht shpalljen e pavarësisë së Kosovës kishte krijuar një moment të disfavorshëm për Serbinë sa i përket raportit me Kosovën. Kështu, më 9 shtator 2010 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi një rezolutë, e cila u mbështet nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, sipas së cilës Asambleja e Përgjithshme kishte pranuar përmbajtjen e opinionit këshilldhënës të GJND-së për Kosovën dhe, ndër të tjera, kishte përshëndetur procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke e cilësuar atë se kishte katër qëllime si: paqja dhe stabiliteti në rajon, promovimi i bashkëpunimit, arritja e përparimit në rrugën drejt BE-së dhe përmirësimi i jetës së popullit.⁸ Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme e OKB-së konsiderohet akti i parë përmes të cilit filloi një proces i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në të cilin ishin të kyçura të dyja shtetet. Pas nxjerrjes së rezolutës nga OKB-ja shihej qartë gatishmëria e dy shteteve që të futen në një proces të dialogut, me ndërmjetësimin e BE-së.

Hapi i parë i Kosovës në raport me fillimin e dialogut me Serbinë ishte rezoluta e nxjerrë më 10 mars 2011 nga Parlamenti (kuvendi). Përmes kësaj rezolute Kuvendi i Republikës së Kosovës kishte mbështetur dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si dy shtete të pavarura dhe sovrane. Sipas kësaj rezolute, dialogu do të zhvillohej vetëm për çështje teknike, pa e prekur sovranitetin, integritetin territorial dhe rregullimin e brendshëm kushtetues të Republikës së Kosovës.⁹ Në këtë rezolutë përcaktohej se udhëheqës i dialogut do të jetë një i emëruar nga Kryeministri. Për këtë ishte emëruar personi përgjegjës nga qeveria, si dhe më vonë Republika e Kosovës krijoi ministrinë e veçantë për çështjen e dialogut me Serbinë. Kjo ishte edhe e ashtuquajtura faza kur dialogu zhvillohej në nivel teknik.

⁷ International Court of Justice Reports of Judgments, Advisory Opinions and Orders Accordance with International Law of the Unilateral Declaration Of Independence in Respect Of Kosovo Advisory Opinion of 22 July 2010, paragrafi 120.

⁸ Resolution adopted by the General Assembly, [without reference to a Main Committee (A/64/L.65/Rev.1)] 64/298. Request for an advisory opinion of the International Court of Justice on whether the unilateral declaration of independence of Kosovo is in accordance with international law, 9 September 2010.

⁹ Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 04-R-001, Prishtinë, më 10 mars 2011.

Gjatë kohës së udhëheqjes së dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në nivel teknik janë arritur shtatë marrëveshje: 1. Marrëveshja për lëvizjen e lirë, 2. Marrëveshja për menaxhimin e integruar të kufirit/-Marrëveshja e IBM-it, 3. Marrëveshja për regjistrat kadastralë, 4. Marrëveshja për regjistrat civilë, 5. Marrëveshja për përfaqësimin rajonal, 6. Marrëveshja për njohjen e diplomave dhe 7. Marrëveshja për njohjen e ndërsjellë të vulave doganore. Ndërsa u iniciuan diskutimet për çështjet lidhur me telekomunikacionin dhe energjinë.¹⁰

Pas një procesi njëvjeçar të një dialogu teknik, Kuvendi i Kosovës nxori përsëri një rezolutë tjetër (më 18 tetor 2012) për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e cila e ngre këtë proces në nivel politik, pasi rezoluta përcaktonte që udhëheqjen e dialogut do ta bënte qeveria.¹¹ Një ditë pas miratimi të kësaj rezolute në Kuvendin e Republikës së Kosovës kishte pasuar takimi ndërmjet Kryeministrit të Kosovës dhe Kryeministrit të Serbisë, të cilët me takimin e tyre në mënyrë automatike e kishin ngritur dialogun në nivel politik.¹²

Statusi kushtetues i marrëveshjeve të arritura në dialogun Kosovë-Serbi dhe trajtimi i ndryshëm nga të dyja shtetet

Që nga koha e fillimit të procesit të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, nga viti 2011 e deri në vitin 2015, janë arritur njëzet marrëveshje si rezultat i këtij procesi. Pjesa më e madhe e marrëveshjeve janë arritur gjatë kohës kur procesi i dialogut është udhëhequr nga të deleguarit e qeverisë dhe rrjedhimisht ka qenë në nivel teknik, kurse marrëveshjet më të rëndësishme të cilat kanë pasur ndikim dhe implikime kushtetuese janë arritur gjatë kohës kur procesi i dialogut është udhëhequr nga ish-kryeministrit e Kosovës dhe të Serbisë.¹³

Ajo që është me rëndësi të trajtohet në këtë pjesë ka të bëjë me atë se si i trajton rendi kushtetues i Kosovës dhe i Serbisë këto marrëveshje. Kjo çështje shtrohet në këtë kontekst, duke pasur parasysh faktin

¹⁰ *Dialogu Kosovë-Serbi, sfidat dhe rruga përpara (analizë e shkurtë)*, mars 2018, botoi Kosovo Democratic Institute, f.7.

¹¹ Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 04-R-08, Prishtinë, më 18 tetor 2012.

¹² Bëhet fjalë për Kryeministrin e atëhershëm të Kosovës z. Hashim Thaçin dhe atë të Serbisë Ivica Daçiq.

¹³ *Dialogu Kosovë-Serbi, sfidat dhe rruga përpara (analizë e shkurtë)*, mars 2018, botoi Kosovo Democratic Institute, f.18. Në këtë analizë janë identifikuar edhe zbatimi i marrëveshjeve, bazuar në të dhënat që ka ofruar Qeveria e Republikës së Kosovës.

që asnjëra prej marrëveshjeve të arritura deri tani ndërmjet Kosovës dhe Serbisë gjatë procesit të dialogut nuk i janë nënshtruar ratifikimit kushtetues dhe nuk janë shpallur në gazetën zyrtare. Përjashtim nga kjo bën vetëm marrëveshja e parë e parimeve që rregullon normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë dhe atë vetëm sa i përket Republikës së Kosovës. Kjo marrëveshje është ratifikuar me 2/3 e votave të Kuvendit të Republikës së Kosovës më 27 qershor 2013.¹⁴ Kjo marrëveshje asnjëherë nuk ishte ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Serbisë.

Pra asnjëra nga marrëveshjet e arritura në dialogun Kosovë-Serbi nuk kanë kaluar në procedurën e ratifikimit të brendshëm, kurse në Republikën e Kosovës vetëm një marrëveshje ka kaluar në procedurën e ratifikimit të brendshëm përmes parlamentit. Por si e përcakton Kushtetuta e Kosovës dhe e Serbisë ratifikimin, respektivisht statusin e marrëveshjeve ndërkombëtare? Në përgjithësi Kushtetuta e Republikës së Kosovës ofron një qasje miqësore me të drejtën ndërkombëtare;¹⁵ ky fakt dëshmohet me një numër të caktuar të neneve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, siç është për shembull neni 19 i Kushtetutës. Në këtë kontekst sistemi kushtetues i Kosovës vendin e marrëveshjeve (traktateve) ndërkombëtare për nga fuqia e ka caktuar mbi dispozitat ligjore dhe nën dispozitat kushtetuese, sepse kështu qartë e përcakton neni 19 i Kushtetutës.

Marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat lidhen sipas Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve 1969, mund të ratifikohen në Republikën e Kosovës në dy mënyra dhe atë: Nga Kuvendi në qoftëse marrëveshjet kanë të bëjnë me: *territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake; të drejtat e njeriut; anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe marrjen përsipër të detyrimeve financiare të Republikës së Kosovës*.¹⁶ Të gjitha këto marrëveshje ratifikohen me 2/3 e votave. Kurse marrëveshjet e tjera, të cilat nuk hyjnë në kuadër të këtyre kategorive konsiderohen të ratifikuara

¹⁴ LIGJ nr. 04/L-199 PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË PARË NDËRKOMBËTARE TË PARIMEVE QË RREGULLOJNË NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SERBISË.

¹⁵ Visar Morina, Fisnik Korenica and Dren Doli, “*The relationship between international law and national law in the case of Kosovo: A constitutional perspective*”, Oxford University Press and New York University School of Law, I•CON 9, 2011, f.296.

¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, neni 18.1.

vetëm pas nënshkrimit nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës.¹⁷ U kuptua se asnjë marrëveshje ndërkombëtare nuk mund të hyjë në fuqi në Republikën e Kosovës nëse ato nuk shpallën në gazetën zyrtare. Në rastin konkret, asnjë nga marrëveshjet e nënshkruara në procesin e dialogut Kosovë-Serbi nuk janë shpallur në gazetën zyrtare, gjithnjë në përjashtim të marrëveshjes të cilën e përmendëm më sipër dhe e cila është ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës në muajin qershor 2013.¹⁸ Nisur nga ky argument kushtetues, për rendin juridik të Kosovës asnjë nga marrëveshjet e arritura në procesin e dialogut, sipas kushtetutës, nuk mund të cilësohet e ratifikuar për shkak se nuk ka kaluar në procedurën e ratifikimit të brendshëm kushtetues dhe as nuk është shpallur në gazetën zyrtare; këtu përjashtim bën pra vetëm një marrëveshje, siç u tha më sipër.

Pra, që një marrëveshje të jetë pjesë e rendit juridik në Republikën e Kosovës duhet të plotësojë kushtin e ratifikimit, si dhe të shpallet në gazetën zyrtare, gjë që nuk ka ndodhur me marrëveshjet që janë pjesë e dialogut. Megjithatë, këtu përveç ratifikimit të brendshëm nuk duhet të anashkalojnë ratifikimin ndërkombëtar, që lidhet me nenin 14 të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve. Megjithatë, kjo nuk është me rëndësi për rendin e brendshëm të Republikës së Kosovës. Duke marrë parasysh pikërisht argumentin që marrëveshjet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk kanë kaluar procedurën e ratifikimit të brendshëm për t'u bërë pjesë e rendit kushtetutës të Republikës së Kosovës, nganjëherë këto marrëveshje janë cilësuar edhe si marrëveshje politike dhe që nuk i plotësojnë kushtet për të qenë traktate ndërkombëtare në kuptim kushtetues. Këto marrëveshje si të tilla janë trajtuar, në zbatimin e tyre, sipas parimit të mirëbesimit të palëve që i kanë nënshkruar, e që në këtë rast janë Kosova dhe Serbia.

Përkitazi me atë se si janë trajtuar kushtetushmërisht marrëveshjet e dialogut Kosovë-Serbi, në Republikën e Serbisë situata qëndron edhe më keq se në Republikën e Kosovës. Madje në Republikën e Serbisë asnjëra prej marrëveshjeve të lidhura në procesin e dialogut nuk i janë nënshtruar procedurës së brendshme të ratifikimit. Kjo është kështu edhe për faktin se Kushtetuta e Republikës së Serbisë e përcakton qartë ratifikimin e traktateve ndërkombëtare, se ajo bëhet me shumicën e

¹⁷ Ibid, neni 18.2.

¹⁸ Shih: LIGJ nr. 04/L-199 PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË PARË NDËRKOMBËTARE TË PARIMEVE QË RREGULLOJNË NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SERBISË.

votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Serbisë. Po ashtu ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare në Republikën e Serbisë sipas kushtetutës së saj përcaktohet edhe me ligj.¹⁹

Një çështje kushtetuese e rëndësishme për sa u përket marrëveshjeve ndërkombëtare në Republikën e Serbisë është edhe fakti se ato mund të vlerësohen na Gjykata Kushtetuese, nëse të njëjtat janë në pajtim me Kushtetutën.²⁰ Madje, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Serbisë, duke u bazuar në këtë kompetencë të saj, në vitin 2014, me anë të një vendimi të saj kishte shpallur si akte politike marrëveshjet që ishin lidhur nga ana e Serbisë në procesin e dialogut me Kosovën, duke nënkuptuar se ato nuk kanë ndonjë vlerë juridike në sistemin kushtetues serb dhe se nuk i plotësojnë kushtet që si të tilla të trajtohen si akte që kanë efekt juridik në rendin kushtetues të Republikës së Serbisë.²¹ Duke pasur parasysh faktin që marrëveshjet e arritura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në procesin e dialogut nuk janë trajtuar në atë mënyrë që të bëhen pjesë e rendeve juridike të brendshme përmes ratifikimit kushtetues, kjo ka bërë që edhe zbatimi i tyre të mos jetë i plotë, sidomos kjo ka qenë e shprehur nga ana e Serbisë. Nga të gjitha marrëveshjet e lidhura, vetëm katër prej tyre janë zbatuar plotësisht.²²

Kryesisht zbatimi i marrëveshjeve të dialogut është bërë sipas parimit të vullnetit të palëve dhe mirëbesimit.²³

Në kuptim të faktit se si janë trajtuar kushtetushmërisht marrëveshjet e arritura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në procesin e dialogut flasin dy argumente kryesore kushtetuese. Argumenti i parë ka të bëjë me atë se të gjitha marrëveshjet e arritura nga ky proces nuk kanë kaluar nëpër procedurë të ratifikimit dhe argumenti i dytë ka të bëjë me atë se të gjitha marrëveshjet nuk janë shpallur në gazetën zyrtare, një kusht ky i domosdoshëm që të ato të konsiderohen si marrëveshje ndërkombëtare me efekt juridik në rendin juridik të Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Siç e thamë, përjashtim nga kjo bën marrëveshja e arritur më 19 prill 2013 për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë,

¹⁹ Kushtetuta e Republikës së Serbisë (2006), nenin 105, (15.6).

²⁰ Ibid, neni 99.

²¹ Ibid, neni 167.2

²² *Dialou Kosovë-Serbi, sfidat dhe rruga përpara* (analizë e shkurtë), mars 2018, botoi Kosovo Democratic Institute, f.18. Në këtë analizë janë identifikuar edhe zbatimi i marrëveshjeve bazuar në të dhënat që ka ofruar Qeveria e Republikës së Kosovës.

²³ Ilir Deda dhe Ariana Qosaj - Mustafa, "Analiza e zbatimit të marrëveshjeve teknike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Analizë politike nr.2/13, qershor 2013, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave-KIPRED, f.18-20.

cila është ratifikuar dhe është shpallur në gazetën zyrtare vetëm nga kuvendi i Republikës së Kosovës, duke u konsideruar kështu pjesë e rendit juridik në bazë të nenit 19 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Të njëjtën marrëveshje, pra atë të 19 prillit 2013, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Serbisë e kishte konsideruar si një akt politik, e cila nuk i plotëson kushtet që të jetë një traktat ndërkombëtar me efekte juridike në rendin kushtetues serb.²⁴ Ky fakt për më tepër vë në pah edhe trajtimin e ndryshëm që i ka bërë Republika e Kosovës dhe ajo e Serbisë të njëjtës marrëveshje, ku në njërën anë është bërë ratifikimi nga Republika e Kosovës,²⁵ kurse në anën tjetër të njëjtën Republika e Serbisë e ka shpallur akt politik dhe që nuk i plotëson kushtet e një traktati ndërkombëtar sipas Kushtetutës së Republikës së Serbisë.

Trajtimi në mënyra të ndryshme i marrëveshjeve të arritura në dialog nga ana e Kosovës dhe e Serbisë shihet edhe nga pikëpamja e zbatimit të tyre. Serbia në vazhdimësi është treguar neglizhente dhe ka bllokuar zbatimin e marrëveshjeve që kanë dalë nga dialogu në Bruksel.²⁶ Një qasje e tillë e Serbisë ndaj dialogut vjen edhe si pasojë e perceptimit të saj për statusin e Kosovës, duke pasur parasysh faktin që në vazhdimësi Republika e Serbisë e konsideron Kosovën, sipas kushtetutës së saj, si krahinë autonome, kurse institucionet e Kosovës si institucione të përkohshme vetëqeverisëse, duke mos e njohur Deklaratën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës të datës 17 shkurt 2008 dhe Opinionin Këshilldhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me shpalljen e pavarësisë së Kosovës të 22 korrikut 2010, që vërteton se shpallja e pavarësisë së Kosovës është tërësisht në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Një trajtim i tillë i statusit të Kosovës si palë në dialogun nga ana e Republikës së Serbisë shihet edhe në arsyetimin që i ka bërë Gjykata Kushtetuese konkluzionit të saj të datës 10.12.2014 përmes të cilit nuk e ka pranuar kërkesën e qeverisë për shqyrtimin e

²⁴ Edhe një herë shih: Konkluzioni (përfundimi) i datës 10.12.2014 për refuzimin e propozimit për vlerësimin e kushtetutshmërisë së marrëveshjes së parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, 19 prill 2013. Konkluzioni - Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë nr.13/2015. I qasshëm <http://www.ustavni.sud.rs/page/predmet/sr-Cyrl-CS/11165/?NOLAY-OUT=1>, qasur me 4.1.2019.

²⁵ Kuvendi i Republikës së Kosovës ka ratifikuar me 2/3 e votave Marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë në qershor të vitit 2013.

²⁶ Shih më shumë: “Raport mbi gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit”, Ministria për Dialog e Republikës së Kosovës, 1 janar - 15 qershor 2016. Nga përmbajta e raportit dhe gjendja e zbatimit shihet që zbatimi i disa marrëveshjeve të arritura në procesin e dialogut janë bllokuar nga Republika e Serbisë.

kushtetutshmërisë së marrëveshjes së parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (19 prill 2013), ku në vazhdimësi potencohet se Kosova është pjesë kushtetuese e Serbisë, në nivel të Krahinës, si dhe që institucionet e Republikës së Kosovës cilësohen si institucione të përkohshme vetëqeverisëse, kurse shteti i Kosovës, cilësohet si “e ashtuquajtura Republika e Kosovës”, duke konstatuar në fakt realitetin e krijuar pas 17 shkurtit 2008, kur Kosova u shpall shtet i pavarur dhe sovran.²⁷

Implikimet kushtetuese të dialogut në Republikën e Kosovës dhe atë të Serbisë

Procesi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka pasur një sërë pasojash dhe implikimesh kushtetuese sidomos në Republikën e Kosovës. Ky fakt lidhet drejtpërsëdrejti me argumentin që Kosova në vazhdimësi i ka trajtuar më seriozisht obligimet e marra nga procesi i dialogut dhe një gjë e tillë është vërejtur edhe në procesin e zbatimit të marrëveshjeve. Ndërkaq në anën e kundërt, Serbia, në kuadër të rendit të saj kushtetues, marrëveshjet e arritura i ka trajtuar si akte politike që nuk kanë një formë të traktatit ndërkombëtar obligativ, ashtu siç përcaktohet në Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve 1969, respektivisht në nenin 2.

Sa i përket palës kosovare implikimi i parë kushtetues në raport me dialogun Kosovë-Serbi lidhet me vetë ratifikimin që i ka bërë Republika e Kosovës marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve të nënshkruar më 19 prill 2013 nga ana e Kosovës dhe Serbisë. Me faktin që kjo marrëveshje është ratifikuar dhe është shpallur në gazetën zyrtare, e njëjta është bërë pjesë e sistemit juridik dhe për të Republika e Kosovës ka marrë obligime për ta zbatuar këtë marrëveshje.²⁸ Sikundër Republika e Serbisë kësaj marrëveshjeje nuk ia ka njohur statusin e aktit juridik, por e ka cilësuar si akt politik, duke e ndërlidhur këtë me natyrën politike të procesit të dialogut. Së këndejmi, marrëveshja e arritur më

²⁷ Shih më shumë arsyetimin e konkluzionit (përfundimit) i datës 10.12.2014 për refuzimin e propozimit për vlerësimin e kushtetutshmërisë të marrëveshjes së parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, 19 prill 2013, paragrafët I-IX. Konkluzioni - Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë nr.13/2015.

²⁸ Raporti i Misionit Diplomatik të Republikës së Kosovës në Beograd dërguar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës më 1 prill 2015.

19 prill 2013 në procesin e dialogut mund të konsiderohet si ndër marrëveshjet më të rëndësishme deri më tani që nga fillimi i dialogut në vitin 2011. Këtë e themi edhe për faktin se marrëveshja e 19 prillit 2013 ka pasur më së shumti implikime kushtetuese, sidomos në Republikën e Kosovës.

Destrukcioni i Serbisë në dialogun Kosovë-Serbi

Sa u përket implikimeve kushtetuese të dialogut Kosovë-Serbi, në Republikën e Serbisë duhet përmendur se ky proces ka provokuar disa vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Serbisë, gjithnjë mbi supozimin e shprehur nga Serbia se Kosova është pjesë integrale e kushtetutës së saj. Serbia më shumë e ka parë dialogun si një proces politik, duke e kontestuar pozitën e barabartë me Kosovën në këtë proces dhe duke mos e njohur Kosovën si shtet, por si pjesë të saj. Ky faktor ka ndikuar drejtpërsëdrejti që Republika e Serbisë të krijojë pengesa të qarta në zbatimin e marrëveshjeve, por edhe t'i trajtojë marrëveshjet që kanë ndalë nga dialogu si akte politike, që nuk kanë efekt juridik dhe që nuk i plotësojnë kushtet të jenë traktate ndërkombëtare sipas nenit 167 të Kushtetutës.²⁹ Në njëfarë forme Serbia nuk i ka pranuar si obligim i saj ndërkombëtar marrëveshjet e dala nga dialogu dhe i ka zbatuar ato në një mënyrë selektive dhe me një dinamikë shumë më të ulët sesa Kosova.

Përveç kësaj, sa u përket implikimeve të tjera kushtetuese të marrëveshjeve që kanë dalë nga procesi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, vlen të veçohet edhe fakti tjetër që Gjykata Kushtetuese e Serbisë ka shfuqizuar marrëveshjet për diplomat dhe atë për regjistrat kadastralë.³⁰

Nga i gjithë procesi i dialogut, ajo që është diskutuar në raste të caktuara në opinionin publik në Serbi është ndryshimi i Kushtetutës së Serbisë për të mundësuar heqjen e autonomisë së Kosovës nga Kushtetuta e Serbisë. Gatishmëria për të hequr Kosovën nga Kushtetuta e Serbisë, përkatësisht preambula dhe neni 8 e 182, në opinionin publik nuk shihej si një rezultat i dalë nga dialogu, por më shumë si një rezultat i presionit dhe kushtit të vënë nga Bashkimi Evropian, si dhe për anëtarësimin e Serbisë në të.

²⁹ Artikull i gazetës „Danas“ mbi ndryshimet e mundshme të Kushtetutës serbe „Serbia fshin autonominë e Kosovës nga Kushtetuta“ Autore: Marija Stojanoviç, 17.10.2017.

³⁰ Ibid.

Perceptimi i dialogut në mënyra të ndryshme nga ana e Serbisë, sidomos në kuptim të obligueshmërisë së marrëveshjeve të arritura, në vazhdimësi ka qenë një sfidë për procesin e dialogut dhe normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Vështrimi kritik i procesit të dialogut Kosovë - Serbi

Siç u theksua më sipër, dialogu Kosovë-Serbi, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian (BE), kishte kaluar në faza të ndryshme dhe me një qasje krejt të ndryshme ndaj këtij procesi nga të dyja palët. Megjithatë në këtë punim nuk do të merremi shumë me qasjen e Serbisë në procesin e dialogut, pasi në vazhdimësi është parë që Serbia nuk e trajton Kosovën si palë e barabartë në këtë proces, duke kontestuar shtetësinë e saj të shpallur më 17 shkurt 2008, të vërtetuar edhe me Opinionin Këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në vitin 2010, dhe ky është një fakt i ditur botërisht dhe ndërkombëtarisht deri më sot.

Siç u tha edhe më sipër, dialogu Kosovë-Serbi kishte pasur dy faza, atë të nivelit teknik, që përfundoj në vitin 2013, si dhe atë të nivelit politik,³¹ që filloi pas takimit të parë të dy ish-kryeministrave të Kosovës dhe Serbisë në fund të vitit 2013. Faza politike e dialogut krijoi edhe Marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve të cilën Kosova e ratifikoi, në procedurë kushtetuese, me 2/3 e votave të parlamentit. Kjo marrëveshje deri tani mund të konsiderohet si hapi më i madh që është bërë në procesin e dialogut.

Që nga fillimi i dialogut në vitin 2011 e deri tani, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka nxjerrë disa rezoluta, ku kishte rikonfirmuar qëndrimin e Republikës së Kosovës për këtë proces. Kështu në Rezolutën e nxjerrë më 10 mars 2011, Kuvendi i Kosovës kishte shprehur mbështetjen e dialogut, duke vënë në dukje që dialogu do të zhvillohet ndërmjet dy shteteve sovrane.³² Pasi dialogu mes Kosovës dhe Serbisë kaloi në nivel politik, në muajin tetor 2012 Kuvendi i Republikës së Kosovës nxori edhe një rezolutë tjetër përmes së cilës autorizoi qeverinë për udhëheqjen e dialogut dhe konfirmoi që në procesin e dialogut

³¹ Për një klasifikim të tillë të fazës teknike dhe politike të dialogut shih grafikën në studimin: Donika Emini and Isidora Stakic "Belgrade and Pristina: lost in normalisation?", European Union Institute for Security Studies (EUISS), prill 2018, f.4-5.

³² Rezolutë e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 04-R-001, Prishtinë, 10 mars 2011.

dhe rezultatet e tij duhet të kihet parasysh sovraniteti i Republikës së Kosovës, rendi unik kushtetues dhe integriteti territorial, çështje këto që për Republikën e Kosovës ishin dhe janë të panegociueshme.³³

Parimet e mishëruara në rezolutat e Kuvendit të Republikës së Kosovës, atë të vitit 2011 dhe 2012 i kishte mbështetur edhe Qeveria e Republikës së Kosovës në platformat e saj përkitazi me procesin e dialogut. Kështu në Platformën e vitit 2011 Qeveria e Republikës së Kosovës kishte vendosur si parime të panegociueshme në dialog parimet si në vijim: statusin e Republikës së Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran; sovranitetin dhe integritetin territorial; rregullimin e brendshëm kushtetues të Republikës së Kosovës.³⁴ Të njëjtat çështje si të panegociueshme nga Republika e Kosovës në procesin e dialogut ishin përfshirë edhe në Platformën katërvjeçare për dialogun të qeverisë së Republikës së Kosovës 2014-2018.³⁵

Procesi i dialogut Kosovë - Serbi kishte kaluar në faza të ndryshme të dinamikës dhe pas arritjes së marrëveshjes së dytë për asociacionin e komunave me shumicë serbe, praktikisht deri në fund të vitit 2017 ishte udhëhequr nga qeveria, respektivisht në nivel kryeministral. Megjithatë, normalizimi i marrëdhënieve dhe procesi i dialogut pësoi një regres të konsiderueshëm për faktin se Republika e Serbisë dhe diplomacia e saj u angazhuan maksimalisht për të penguar Republikën e Kosovës të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare, përfshirë këtu Interpol-in dhe UNESCO-n.³⁶ Viti 2017 e gjeti procesin e dialogut në një gjendje jo të mirë dhe pa një agjendë të qartë të negociimit. Pas zgjedhjes së qeverisë së Republikës së Kosovës më 9 shtator 2017, Republika e Kosovës, respektivisht qeveria, emëroi një përgjegjës për dialogun teknik dhe një gjë të tillë e bëri edhe Republika e Serbisë,³⁷ pra në të njëjtën mënyrë kishte vepruar edhe Republika e Serbisë.³⁸

³³ Rezolutë e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 04-R-08, Prishtinë, 18 tetor 2012.

³⁴ Platforma e Republikës së Kosovës për dialogun teknik ndërshtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Prishtinë, mars 2011, f. 6.

³⁵ Programi i Qeverisë i Republikës së Kosovës për Dialogun e Brukselit /periudha 2014 – 2018, Prishtinë 15 janar 2015, f. 6.

³⁶ *Dialogu Kosovë-Serbi, sfidat dhe rruga përpara, (analizë e shkurtë)*, mars 2018, botoi Kosovo Democratic Institute, f.11.

³⁷ Artikull: “Avni Arifi emërohet shef i negociatave me Serbinë”, portali Koha.Net, 12.1.2018. I qasshëm: <https://www.koha.net/arberi/68765/avni-arifi-emerohet-shef-i-negociatave-me-serbine/>, qasur më 5.1.2019.

³⁸ Artikull: “Belgrade-Pristina dialogue continues at technical level”, botuar në b92, 15.01.2018. I qasshëm në: https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2018&mm=01&dd=15&nav_id=103267, qasur më 6.1.2019.

Ajo që duhet theksuar lidhur me pozicionin e Republikës së Kosovës në raport me dialogun me Serbinë është obligimi që ka marrë Republika e Kosovës për këtë proces përmes Marrëveshjes së stabilizim-asociimit të cilën e ka lidhur me Bashkimin Evropian, marrëveshje kjo e ratifikuar edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës në muajin nëntor të vitit 2015.³⁹ Procesi i normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë përmes dialogut tani më është një obligim kontraktual i Republikës së Kosovës, i cili është marrë përmes Marrëveshjes së stabilizim-asociimit.⁴⁰ Kjo do të thotë që normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është një obligim dhe kusht për Kosovën në rrugën e saj për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Një gjë e tillë vlen edhe për Republikën e Serbisë. Një obligim i rëndësishëm për Republikën e Kosovës, që rrjedh nga Marrëveshja e stabilizim-asociimit me BE-në ka të bëjë edhe me zbatimin e marrëveshjeve që kanë dalë nga dialogu me Serbinë. Neni 13.3 (pika a) i kësaj marrëveshjeje përcakton ndër të tjera që *“Kosova vazhdimisht duhet të zbatojë në mirëbesim të gjitha marrëveshjet e arritura në dialog me Serbinë”*. Kjo lidhet edhe me faktin që përveç marrëveshjes së prillit të vitit 2013, Republika e Kosovës asnjë marrëveshje tjetër nuk e ka ratifikuar dhe nuk e ka shpallur në gazetën e saj zyrtare dhe në vazhdimësi i ka zbatuar marrëveshjet e dialogut sipas parimit të mirëbesimit. Zbatimi në mirëbesim i marrëveshjeve të dialogut është edhe një ndër faktorët që Republika e Serbisë nuk i ka marrë seriozisht zbatimin e marrëveshjeve, duke krijuar në vazhdimësi barriera. Kjo ka ndodhur edhe si pasojë e mungesës së mekanizmave efikas për zbatimin e këtyre marrëveshjeve, por edhe për shkak të statusit juridik të tyre sidomos në Republikën e Serbisë.

Edhe fillimi i vitit 2018 e gjeti dialogun në një fazë të heshtur dhe pa progres, ku palët shkëmbenin deklaratata njëra me tjetrën për mospërmbushje të obligimeve të dyanshme. Gjatë vitit 2018 në procesin e dialogut kishte takime në nivel të presidentëve të të dyja shteteve. Gjatë këtyre takimeve Republika e Serbisë kryesisht aludonte në mospërmbushjen e obligimeve lidhur me moskrijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe nga ana e Republikës së Kosovës, duke e bërë përgjegjëse kështu edhe Bashkimin Evropian. Ky qëndrim i Serbisë

³⁹ Artikulli i Bekim Shehut *“Kuvendi i Kosovës ratifikon marrëveshjen e MSA-së”*, Deutsche Welle shqip, 2.11.2015.

⁴⁰ Marrëveshja e stabilizim-asociimit ndërmjet Kosovës*, në njërën anë, dhe Bashkimin Evropian e Komuniteti Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, 2015, neni 13.

kishte ardhur përmes deklaratave të presidentit serb Aleksandër Vuçiq.⁴¹ Ndërkaq deklaratat e Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga presidenti Thaçi, aludonin në nevojën për të pasur një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve, me qëllim të lehtësimit të jetës së qytetarëve.⁴²

Nga veprimet dhe deklaratimet e bartësve të funksioneve shtetërore në Republikën e Kosovës dhe të Serbisë, pas një stagnimi të procesit të dialogut në vitin e fundit, dukej që ky proces po shkon drejt fazës finale. Megjithëse nuk kishte një agjendë të qartë se si do të përmbillet dhe se çka do të bisedohet në fazën finale të procesit të dialogut. Ka pasur deklarime që pjesë e marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të jetë edhe çështja e kufijve shtetërorë ndërmjet dy shteteve, në mënyrë që kjo çështje të definohet.⁴³ Në mungesë të një agjende të qartë për përmbylljen e fazës përfundimtare të dialogut në Kosovë gjatë vitit 2018 në vazhdimësi kishte qëndrime të ndryshme rreth këtij procesi, për çka edhe u shtrua nevoja për një unitet politik në këtë procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Si rrjedhojë e kërkesave për unitet politik Kuvendi i Republikës së Kosovës më 15 dhjetor 2018 ka nxjerrë një rezolutë të re, ku ka përcaktuar kornizat e dialogut, duke emëruar edhe një delegacion shtetëror gjithëpërfshirës, i cili do ta udhëheqë dialogun në fazën përfundimtare.⁴⁴

Se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ishte duke shkuar drejt përmbjlljes qartësohet edhe në pjesën përfundimtare të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës të 15 dhjetorit 2018, ku përmendet marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.⁴⁵ Megjithatë, edhe para nxjerrjes së kësaj rezolute në spektrin politik dhe profesional të Republikës së Kosovës është folur për një marrëveshje ligjërisht të obligueshme dhe me fuqi detyruese.⁴⁶

⁴¹ Artikulli “No Progress Reported In Kosovo, Serbia Normalization Talks”, radio Free Europe, 24.03.2018. I qasshëm: <https://www.rferl.org/a/no-progress-reported-talks-vucic-thaci-normalize-relations-kosovo-serbia-brussels/29120862.html>, qasur më 6.1.2019.

⁴² Ibid.

⁴³ Shih më shumë artikullin Andrew MacDowall, “Could land swap between Serbia and Kosovo lead to conflict?”, botues The Guardian, 22.8.2018. I qasshëm: <https://www.theguardian.com/world/2018/aug/22/serbia-kosovo-could-land-swap-between-lead-conflict>, qasur më 6.1.2019.

⁴⁴ Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës 06-R-015, datë 15.12.2018.

⁴⁵ Ibid, f.5

⁴⁶ Artikulli “Marrëveshja përfundimtare Kosovë - Serbi, me fuqi detyruese”, botoi “Zëri”, 3.5.2018. I qasshëm: <https://zeri.info/aktuale/197392/marreveshja->

Një çështje tjetër e cila ka krijuar debat në Republikën e Kosovës në fazën përfundimtare të dialogut me Serbinë është edhe fakti se kush mund ta udhëheqë dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë në këtë fazë. Ka pasur edhe debate që një gjë e tillë nuk mund të bëhet nga presidenti i shtetit për shkak të mungesës së legjitimitetit kushtetues.⁴⁷

Nëse e shikojmë këtë çështje nga prizmi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ligjeve në fuqi, duhet theksuar se në nenin 84.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës i jepet kompetencë presidentit që të nënshkruajë marrëveshje ndërkombëtare, por edhe një rol aktiv në përfaqësimin e shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në anën tjetër, kompetencën për të ndërmarrë të gjitha veprimet për lidhje të marrëveshjes ndërkombëtare presidentit ia jep edhe Ligji në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare i Republikës së Kosovës, i cili përcakton se Presidenti, Kryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme mund të ndërmarrin të gjitha veprimet për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare pa pasur nevojë për autorizim nga ndonjë institucion tjetër.⁴⁸ Edhe në bazë të Konventës së Vjenës për të drejtën e traktateve, presidenti i shtetit, kryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme konsiderohen si të parët që kanë fuqi të plota për ndërmarrjen e veprimeve për lidhjen e një marrëveshjeje ndërkombëtare.⁴⁹ Gjithashtu në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës, ligjet në fuqi i japin kompetencën presidentit jo vetëm për të lidhur, por edhe për të autorizuar lidhjen e një marrëveshjeje ndërkombëtare e cila bën pjesë në grupin e marrëveshjeve që ratifikohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, përfshirë këtu edhe procedurat e negociimit.⁵⁰

Megjithatë, pavarësisht debateve për udhëheqjen e dialogut, krijimi i ekipit për dialog nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës përmes rezolutës i ka dhënë një rrugë tjetër kësaj çështjeje dhe tani Republika e Kosovës do të përfaqësohej në procesin e dialogut me një delegacion gjithëpërfshirës shtetëror që do të udhëheqë dhe përfaqësojë Republikën e Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë.⁵¹ Dukebërë

perfundimtare-kosove-serbi-me-fuqi-detyruese/, qasur më 6.1.2019.

⁴⁷ Artikull: “*Opozita në Kosovë: Presidenti nuk ka legjitimitet të udhëheqë dialogun me Serbinë*”, botoi AlsatM, datë 3.7.2018.

⁴⁸ LIGJI nr. 04/L-052 për marrëveshjet ndërkombëtare, neni 6.1.

⁴⁹ Konventa e Vjenës për të drejtën e traktateve 1969, neni 7.

⁵⁰ LIGJI nr. 04/L-052 PËR MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE, neni 7.1., i cili përcakton që veprimet për lidhjen e marrëveshjeve që ratifikohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës autorizohen nga ana e presidentit.

⁵¹ Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës 06-R-015, datë 15.12.2018, f.3-4.

përpyqje për krijimin e një uniteti të brendshëm përkitazi me përfaqësimin në procesin e dialogut me Serbinë nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës është propozuar edhe një projektligj i veçantë për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë. Ky projektligj e përcakton delegacionin shtetëror që do të përfaqësojë Republikën e Kosovës në dialog si një organ i veçantë, i cili do të përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, pjesë e të cilit do të jetë edhe shoqëria civile.⁵²

Përmes projektligjit për delegacionin shtetëror në procesin e dialogut, Republika e Kosovës synonte të zgjidhë problemin e unitetit të brendshëm për mënyrën e udhëheqjes dhe menaxhimit të dialogut me Serbinë dhe përmes këtij delegacioni shtetëror të paraqitet edhe një platformë dhe agjendë e qartë për përmbylljen e procesit të dialogut me Serbinë. Kjo pasi çështja e unitetit të brendshëm në skenën politike kosovare është shfaqur e nevojshme edhe pas deklarimeve të ndryshme të bartësve të institucioneve përkitazi me procesin e dialogut me Serbinë.

Megjithatë, Projektligji për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë u shpall në kundërshtim me dispozitat kushtetuese nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Përmes këtij vendimi Gjykata Kushtetuese u mundua që të sqarojë se cili institucion kushtetues duhet të udhëheqë dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ajo çfarë është e sigurt dhe që mund të nxirret si përfundim nga vendimi respektiv i Gjykatës Kushtetuese ka të bëjë me faktin se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë trajtohet kushtetushmërisht si pjesë e politikës së jashtme dhe ushtrimit të kompetencave kushtetuese në këtë fushë nga ana e institucioneve kushtetuese.⁵³

Asociacioni i komunave me shumicë serbe

Marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve e 19 prillit 2013, mes tjerash, obligon Republikën e Kosovës për krijimin asociacionit të komunave me shumicë serbe në Republikën e Kosovës. Krijimi i asociacionit me shumicë serbe ka dalë të jetë edhe pasoja ose implikimi më i madh kushtetues që kanë pasur marrëveshjet e arritura në kuadër të

⁵² Projektligji për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Kosovës.

⁵³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 18.1 dhe neni 19.1.

dialogut, pasi për krijimin e këtij asociacioni ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është dashur të nënshkruhet edhe një marrëveshje tjetër me qëllim që të detajohet mënyra e funksionimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe. Kjo marrëveshje ishte nënshkruar në vitin 2015 nga ana e dy ish-kryeministrave, ai i Kosovës dhe i Serbisë.⁵⁴ Marrëveshja e dytë për asociacionin e komunave me shumicë serbe e nënshkruar në vitin 2015 kishte për qëllim themelimin e këtij asociacioni mbi bazën e kornizës që kishte përcaktuar marrëveshja e nënshkruar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë më 19 prill 2013 dhe e ratifikuar nga ana e kuvendit të Republikës së Kosovës.⁵⁵

Nënshkrimi i marrëveshjes së dytë nga ana e Kosovës dhe e Serbisë për krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, obligim të cilin Kosova e kishte marrë nga marrëveshja e parë për normalizimin e marrëdhënieve, e ratifikuar në vitin 2013 nxiti debat në skenën politike dhe profesionale në Republikën e Kosovës, ku fillimisht u hodhën dyshime se marrëveshja e dytë ishte në kundërshtim me Kushtetutën dhe se i kishte dhënë asociacionit të komunave me shumicë serbe edhe kompetenca ekzekutive dhe pushtet përtejkushtetues dhe një rol që mund të cenonte edhe kompetencat e pushtetit qendror në Republikën e Kosovës.⁵⁶ Madje për të kundërshtuar krijimin e një asociacioni të komunave me shumicë serbe në nivel të tillë, partitë politike opozitare organizuan edhe peticion për kundërshtimin e kësaj marrëveshjeje sipas të cilëve e njëjta i hapte rrugë edhe ndarjes së Kosovës,⁵⁷ e rastin e nënshkrimit të marrëveshjes së dytë për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe (2015), në Kosovë u krijua një situatë e paqartë ndërmjet obligimit për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, që dilte nga marrëveshja e parë për normalizimin e marrëdhënieve e 19 prillit 2013 dhe dilemave për pajtueshmëri me kushtetutën e marrëveshjes së dytë të datës 25 gusht 2015, e cila ishte

⁵⁴ Marrëveshja: Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore, 25 gusht 2015.

⁵⁵ Shih: LIGJ nr. 04/L-199 PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË PARË NDËRKOMBËTARE TË PARIMEVE QË RREGULLOJNË NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SERBISË, pika 1-6 e tekstit të Marrëveshjes.

⁵⁶ Artikull: “Asociacioni pa kompetenca ekzekutive”, botoi gazeta “Zëri”, 8 korrik 2015. E qasshme në: <https://zeri.info/aktuale/41033/asociacioni-pa-kompetenca-ekzekutive/>, qasur me 5.1.2019.

⁵⁷ Artikull “Opozita në Kosovë, me peticion kundër marrëveshjeve me Serbinë”, 18.9.2015, botoi Radio Evropa e Lirë. I qasshëm në: <https://www.evropalire.org/a/27255557.html>, qasur më 5.1.2019.

një marrëveshje implementuese e marrëveshjes së parë, duke detajizuar themelimin dhe mënyrën e funksionimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe. Në një situatë që prodhoi debat të madh në Kosovë duke ngritur dilema që marrëveshja e dytë për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe ishte në kundërshtim me Kushtetutën, presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga, kërkoi nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti "*Asociacioni - Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/elementet kryesore*" me frymën e kushtetueses, respektivisht me nenin 3.1, si dhe me kapitullin II dhe III të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Presidentja e Republikës së Kosovës kërkesën e saj e dorëzoi në Gjykatën Kushtetuese më 31 tetor 2015, ose më shumë se dy muaj pas nënshkrimit të Marrëveshjes së dytë (2015). Kërkesa e presidentes Jahjaga u bazua në kompetencën e saj për të dërguar çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese sipas nenit 84.9, ndërlidhur me nenin 112 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.⁵⁸

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, pas vlerësimit të kërkesës së Presidentes së Republikës së Kosovës lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së dokumentit *Asociacioni - bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme / Elementet kryesore*, që ishte një marrëveshje e dytë që kishte dalë nga dialogu si marrëveshje zbatuese e asaj të 13 prillit 2013, gjeti se ky dokument nuk ishte plotësisht në pajtim me frymën e Kushtetutës, që reflektohet në nenet 3, 7, 12, 21, 44, 57, 59, 60, 61, 62, 79, 81, 93, 101, 112, 123, 124 dhe 127 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kjo nënkupton se marrëveshja e dytë për krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe prekte 18 nene të Kushtetutës dhe si rrjedhojë nuk ishte në pajtim me frymën që mishërohet në këto nene të Kushtetutës. Ndër të tjera, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës i dhjetorit të vitit 2015 jepte udhëzime për qeverinë e Republikës së Kosovës se cilat nene të Kushtetutës së Republikës së Kosovës do të duhej të merreshin parasysh me rastin e themelimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë.

Pra e tërë situata e krijuar në Republikën e Kosovës lidhur me themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, i bazuar në dy marrëveshje ndërkombëtare që prodhoi edhe një aktgjykim të

⁵⁸ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim ne Rastin nr. K0130/15 Parashtrues Presidentja e Republikës se Kosovës. Prishtine, 23 dhjetor 2015 Nr. ref.:AGJ877/15, (procedura në Gjykatë, paragrafi 6 dhe 7).

gjykatës kushtetuese, i cili gjeti se marrëveshja e dytë mbi parimet për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe e 25 gushtit 2015 ishte në kundërshtim me 18 nene të Kushtetutës. Ky fakt fuqizon argumentin se dialogu Kosovë-Serbi, posaçërisht marrëveshja e parë e 19 prillit 2013 dhe ajo e 25 gushtit 2015 kishin implikime të mëdha kushtetuese dhe si të tilla krijuan edhe pasoja konkrete juridiko- kushtetuese në Republikën e Kosovës për faktin se procesi i krijimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe mori një rrugë tjetër pa një derë të qartë dalje.

Pavarësisht nga gjetjet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, sipas aktgjykimit të datës 23 dhjetor 2015, duhet të kuptohet që obligimi për krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe është një obligim ndërkombëtar të cilin Kosova e ka marrë me rastin e ratifikimit të marrëveshjes së 19 prillit 2013 në kuvend me 2/3 e votave dhe këtij obligimi Kosova nuk mund t'i ikë.

Duhet theksuar se nga më shumë se tridhjetë marrëveshje⁵⁹ të arritura deri me tani në procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Marrëveshja për krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe e datës 25 gusht 2015, ndërlidhur me obligimet e dala nga Marrëveshja e 19 prillit 2013, ka krijuar më së shumti pasoja kushtetuese duke prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ndonëse transparenca në kuadër të procesit të dialogut Kosovë-Serbi ishte një karakteristikë negative që e ka përcjellë këtë proces që nga fillimi, ka pasur edhe marrëveshje të tjera të nënshkruara të cilat në mënyrë indirekte kanë prekur sistemin kushtetues, ani pse për këtë nuk ka pasur vlerësim nga Gjykata Kushtetuese. Me këtë rast vlen të përmendet Marrëveshja e ashtuquajtur për drejtësi e datës 9 shkurt 2015, sipas të cilës në pjesën veriore të Mitrovicës do të ketë një njësi të Gjykatës së Apelit.⁶⁰ Çështja kryesore këtu qëndron se me nenin 21 të Ligjit për gjykatat e Republikës së Kosovës, Gjykata e Apelit ka juridiksion në tërë territorin e Kosovës dhe se selia e saj është në Prishtinë. Ekzistenca e një njësi të Gjykatës së Apelit është në kundërshtim me këtë dispozitë dhe në njëfarë forme e prish parimin e

⁵⁹ Shih më shumë numri marrëveshjet e arritura në dialogun Kosovë-Serbi: *Dialou Kosovë-Serbi, Sfidat dhe Rruga Përpara*, (analizë e shkurtë), Mars 2018, botoi Kosovo Democratic Institute, f.16-17.

⁶⁰ Marrëveshja për drejtësinë, lidhur më 9 shkurt në Bruksel, pika 11. Teksti jozyrtar i botuar në portalin Koha.Net me titull: “*Teksti i Marrëveshjes Kosovë-Serbi për Gjyqësorin*”, datë 11.2.2015.

një sistemi unik gjyqësor dhe është në kundërshtim edhe me vetë organizmin e brendshëm të Gjykatës së Apelit.⁶¹ Duke pasur parasysh që të gjitha marrëveshjet e tjera, përpos asaj të 19 prillit 2013, nuk janë ratifikuar dhe nuk janë shpallur në gazetën zyrtare, atëherë ato nuk do të trajtohen si pjesë e këtij punimi në kuptimin e implikimeve dhe pasojave eventuale kushtetuese që kanë pasur.

Ajo që duhet ritheksuar ka të bëjë me atë që Republika e Kosovës e ka bërë pjesë të sistemit juridik, përmes ratifikimit kushtetues vetëm Marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë e datës 19 prill 2013. Përmes kësaj Marrëveshjeje, Republika e Kosovës ka marrë obligim që të krijojë asociacionin e komunave me shumicë serbe, të bëjë integrimin e strukturave të sigurisë së Serbisë në strukturat e sigurisë së Kosovës, respektivisht në policinë e Kosovës, të organizojë zgjedhjet në ato komuna etj.⁶² Kosova është treguar mjaft e përgjegjshme në zbatimin e këtyre obligimeve,⁶³ megjithëse Serbia nuk e ka bërë një gjë të tillë, madje siç u theksuar edhe më sipër Marrëveshjen e 19 prillit 2013, të cilën Kosova e ka ratifikuar, Serbia e ka shpallur akt politik përmes gjykatës së saj kushtetuese.

Ani pse Republika e Kosovës ka marrë përsipër themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe sipas Marrëveshjes së 19 prillit 2013, një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur për shkak të gjetjeve (shkeljeve) që i ka bërë Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në Vendimin e saj të 23 dhjetorit 2015. Megjithatë, ky është një obligim që Republika e Kosovës duhet ta përmbushë, gjithnjë duke pasur parasysh sugjerimet e dhëna nga ana e Gjykatës Kushtetuese të saj lidhur me mënyrën e krijimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe. Republika e Kosovës ka bërë përpjekjet e saj për krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe duke krijuar ekipin menaxhues për themelimin e tij, por në opinionin publik e profesional në Prishtinë vazhdimisht është shfaqur frika për krijimin e mundshëm të një asociacioni

⁶¹ Ligji nr. 06/L - 054 për gjykatat, datë 18.12.2018, nenet 21 dhe 24.

⁶² Shih: **LIGJ nr. 04/L-199 PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË PARË NDËRKOMBËTARE TË PARIMEVE QË RREGULLOJNË NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SERBISË**, veçanërisht pikat 1-12 e tekstit të Marrëveshjes.

⁶³ Bahri Cani, Intervistë për Deutsche Welle me shefin e Policisë së Kosovës në Veri Zhelko Bojiq, datë 24.11.2016. "*Bojiq: Policët serbë nga strukturat paralele janë integruar!*" E qasshme në: <https://www.dw.com/sq/bojiq-polic%C3%ABt-serb%C3%AB-nga-strukturat-paralele-jan%C3%AB-integruar/a-36500191>, qasur më 5.1.2019.

të komunave me shumicë serbe, i cili mund të ketë kompetenca ekzekutive dhe se një gjë e tillë rrjedhimisht është jokushtetuese.⁷⁴⁸ Edhe pse asociacioni i komunave me shumicë serbe nuk është finalizuar ende, Kosova ka ndërmarrë veprimet konkrete për themelimin e këtij mekanizmi. Pas themelimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe, Republika e Kosovës do të përmbushë një obligim ndërkombëtar dhe kushtetues të cilin e ka marrë në vitin 2013 me Marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve.

Degradimi i dialogut nga një marrëveshje finale në një proces të normalizimit

Nga viti 2020, e deri me sot, dialogu mes Kosovës dhe Serbisë ka pësuar një degradim substancial në dëm të Republikës së Kosovës. Nga një qëndrim i mëhershëm harmonizuar i SHBA-së dhe BE-së, se ky dialog duhet të përfundojë me një marrëveshje finale ligjërish të detyrueshme me njohjen reciproke, dialogu aktualisht është riformatuar si proces i normalizimit të raporteve midis dy shteteve. Qëndrimi për njohje reciproke dhe marrëveshje finale ligjërish e detyrueshme ishte shprehur edhe nga Presidenti Biden dhe krerët e BE-së. Në letrën dërguar presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, Biden ka shprehur mbështetjen e tij për dialogun për normalizimin e raporteve me Serbinë, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. “*SHBA-ja do të vazhdojë të mbështesë integrimin e Kosovës në institucionet euroatlantike dhe dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja për normalizimin e raporteve me Serbinë. Ne mirëpresim pranimin e propozimit të BE-së për normalizim, me synimin përfundimtar të njohjes reciproke, që do të ndihmonte të arrihej një e ardhme më paqësore dhe prosperuese për popullin e Kosovës dhe Serbisë*”, thuhet në letrën e Bidenit.⁶⁴

Në anën tjetër Serbia ka vazhduar destrukcionin e saj dhe veprimet agresive ndaj Kosovës me qëllim të defunksionalizimit të rendit kushtetues dhe pengimit të Kosovës në anëtarësimin e saj në organizatat ndërkombëtare. Madje presidenti serb Aleksandër Vuçiq i është rikthyer retorikës së tij nacionaliste me pretendime të qarta territoriale. Ai përsërit

⁶⁴ Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ketë deklaratë e ka dhënë kur ka uruar Kosovën për 15-vjetorin e shpalljes së pavarësisë, duke u zotuar se Uashingtoni do të vazhdojë mbështetjen për Prishtinën <https://www.evropaelire.org/a/joe-biden-pavaresia-e-kosoves-njohja-reciproke-/32274753.html>

në vazhdimësi deklaratat e tij nacionaliste, duke pohuar se “nuk do ta njohë kurrë pavarësinë e Kosovës si President, edhe nëse më vrisni”.⁶⁵

Pa dyshim se ky riformatim i dialoguar, nga një marrëveshje finale me njohje reciproke, në një proces të normalizimit të raporteve Kosovë-Serbi, krijon sfida të reja për Kosovën dhe hap mundësinë për trysni dhe kompromise të reja nga ana e saj. Heqja dorë nga kërkesa eksplicite për njohje reciproke dhe zëvendësimi i saj me sintagmën e normalizimit të raporteve, paraqet një zhvillim shumë të disfavorshem për Kosovën. Duke marrë parasysh situatën e krijuar pas agresionit të Rusisë ndaj Ukrainës, komuniteti ndërkombëtar ka filluar ta trajtojë Kosovën si çështje sigurie dhe ka hequr dorë nga kërkesat eksplicite për njohje reciproke, duke kërkuar një fazë kalimtare përmes procesit të normalizimit të raporteve midis dy shteteve. Nuk duhet hezituuar së theksuar fakti, se në këtë rikonfigurim të dialogut Kosovë-Serbi kanë ndikuar edhe disa veprime jopragmatike të qeverisë së Kosovës, e cila duke u marrë me çështje teknike në veriun e Kosovës i ka kontribuar imazhit ndërkombëtar të Kosovës si një vend me problem të sigurisë dhe mundësi të eskalimit të një konflikti të armatosur. Ky opinion për Kosovë u rishfaq në mënyrë flagrante pas sulmit terrorist në fshatin Banjskë, kur grupi kriminal i kryesuar nga kriminelin Milan Radojčić, i mbështetur dhe organizuar nga Serbia, tentoi aneksimin e komunave veriore të Kosovës.

Ky ripozicionim ndërkombëtar krijon disa probleme dhe dilema për Kosovën. Po theksojmë disa sfida të këtij rikonfigurimi të dialogut;

1. Marrëveshje për normalizim nuk i jep fund konfliktit mes Serbisë dhe Kosovës;
2. Marrëveshje për normalizim vazhdon status quon dhe nuk siguron njohjen e Kosovës nga 5 shtetet mosnjohëse të BE-së dhe OKB-ja;
3. Marrëveshja për normalizim shtynë marrëveshjen finale ligjërisht të detyrueshme me njohje reciproke në kohë të pacaktuar;
4. Krijimi i rendit të ri ndërkombëtar, pas përfundimit të agresionit rus në Ukrainë mund të krijojë një baraspeshë të re politike dhe ushtarake, e cila nuk i konvenon Kosovës dhe aleatëve të saj në arritjen e një Traktati të paqes midis Kosovës dhe Serbisë.

⁶⁵ Deklarata e Aleksandër Vuçiç në një intervistë për Tanjug, *ju mund të më vrisni vetëm, por kjo nuk do të ndodhë. U them, anglezëve dhe gjermanëve se nuk do ta bëj atë. Më goditi, por unë s' do ta bëj. Mund të jem president edhe për 15 vjet, por nuk e njoh Kosovën* <https://www.balkanweb.com/vucic-mund-te-me-vrisni-por-nuk-do-e-njoh-kurre-kosoven/#gsc.tab=0>

Pra Marrëveshja për normalizim është vetëm një hap i mesëm drejt marrëveshjes përfundimtare, të tilla siç kanë qënë marrëveshjet e deritanishme mes Serbisë dhe Kosovës, që nga Marrëveshja e Brukselit, pastaj ajo që u nënshkrua ulur në tavolinën e presidentit Donald Trampit, e deri te marrëveshja për targa.

Pa dyshim se këto shqetësime janë bërë shumë më reale, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit dhe Aneksit të Ohrit, të cilët hapën një kapitull të ri të Dialogut Kosovë-Serbi me shumë të panjohura dhe me rreziqe për Republikën e Kosovës.

Marrëveshja e Brukselit dhe Aneksi i Ohrit

Pas shumë takimeve të pasuksesshme, nën trysinë e madhe ndërkombëtare më 27 shkurt 2023 dhe 18 mars 2024, Kosova dhe Serbia kanë pranuar në parim Marrëveshjen Bazë në Bruksel dhe Aneksin e zbatimit në Ohër. Këto dy dokumente bazohen në propozimin franko-gjerman, dhe paraqesin propozimin evropian, të emërtuar si Marrëveshje drejt normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Marrëveshja Bazë. Propozimi franko-gjerman që ‘trazoi’ skenën politike në Prishtinë dhe Beograd u është dorëzuar dy liderëve në fund të verës të vitit të kaluar, fillimisht si “plan fillestar”, pastaj si dokument i modelit “merre ose lëre”. Ky propozim parasheh të drejta të barabarta për Kosovën dhe Serbinë, respektim të integritetit territorial, paprekshmëri të kufijve, njohje të simboleve shtetërore dhe garanci shtesë për komunitetin serb në Kosovë. Aty nuk përmendet njohja reciproke. Këtij dokumenti me 11 nene, më 18 mars i është bashkëngjitur një aneks i zbatimit⁶⁶.

Teksti i propozimit evropian, u publikua menjëherë, pas përfundimit të takimit ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Kreu i i diplomacisë evropiane, Josep Borrell, deklaroi pas takimit se "palët shprehën gatishmërinë e tyre për të vazhduar me zbatimin e kësaj marrëveshjeje”.

⁶⁶ Në mesin e 11 neneve, marrëveshja bazë parasheh që Serbia të mos e bllokojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. Mirëpo, vetëm tri ditë pas Marrëveshjes së Ohrit, presidenti serb, Vuçiq, ka thënë se vendi i tij nuk do ta zbatojë pjesën e marrëveshjes lidhur me anëtarësimin e Kosovës në Kombet e Bashkuara.

Teksti i plotë i propozimit

Palët kontraktuese; Të përkushtuara për të kontribuar në bashkëpunimin dhe sigurinë e frytshme rajonale dhe për të kapërcyer trashëgimin e së kaluarës;

Të vetëdijshme për përgjegjësinë e tyre për ruajtjen e paqes;

Të përkushtuara të kontribuojnë në sigurinë dhe bashkëpunimin e frytshëm rajonal në Evropë;

Të vetëdijshëm për paprekshmërinë e kufijve dhe respektimit të integritetit dhe sovranitetit territorial, si dhe mbrojtja e pakicave kombëtare, janë kushtet themelore për paqen;

Duke vepruar nga fakti historik dhe pa paragjykuar pozicionet e ndryshme të palëve në lidhje me çështjet themelore, përfshirë çështjen e statusit;

Me dëshirën për të krijuar kushte për bashkëpunim midis palëve për të mirën e njerëzve, kanë rënë dakord që:

Neni 1. Palët do të zhvillojnë marrëdhënie normale të fqinjësisë së mirë me njëra-tjetrën mbi bazën e të drejtave të barabarta.

Të dyja palët do t'i njohin dokumentet relevante dhe simbolet kombëtare të njëra-tjetrës, përfshirë pasaportat, diplomat, targat e automjeteve dhe vulat doganore.

Neni 2. Të dyja palët do të udhëzohen nga qëllimi dhe parimet e përcaktuara në Kartën e Kombeve të Bashkuara, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me të drejtat sovrane të shteteve, respektimin e pavarësisë, autonomisë dhe integritetit territorial të tyre, të drejtën për vetëvendosje, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimin.

Neni 3. Në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, palët do ta zgjidhin çdo mosmarrëveshje ndërmjet tyre vetëm në mënyrë paqësore dhe do të përmbahen nga kërcënimi apo përdorimi i forcës.

Neni 4. Palët nisen nga supozimi se asnjëra nga këto të dyja nuk mund ta përfaqësojë palën tjetër në sferën ndërkombëtare apo të veprjës në emër të saj. Serbia nuk do ta kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në asnjë organizatë ndërkombëtare.

Neni 5. Asnjëra palë nuk do të bllokojë, ose do të inkurajojë të tjerët të bllokojnë përparimin e palëve në rrugët e tyre perspektive drejt BE-së bazuar në meritat e tyre. Të dyja palët duhet të respektojnë vlerat e përmendura në nenin 2 dhe 21 të Traktatit të Bashkimit Evropian.

Neni 6. Përderisa kjo marrëveshje bazë përfaqëson një hap të rëndësishëm të normalizimit, të dyja palët do të vazhdojnë me një shty-së të re në procesin e dialogut të udhëhequr nga BE-ja, që do të çojë në marrëveshjen ligjërish të detyrueshme, gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve.

Palët bien dakord ta thellojnë bashkëpunimin në të ardhmen në fushat e ekonomisë, shkencës dhe teknologjisë, transportit dhe lidhshmërisë, marrëdhënieve në drejtësi dhe zbatim të ligjit, postë dhe telekomunikacion, shëndetësi, kulturë, fe, sport, mbrojtje të mjedisit, persona të zhdukur, dhe fusha të tjera të ngjashme përmes arritjes së marrëveshjeve specifike. Detajet do të pajtohen në marrëveshjet shtesë në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja.

Neni 7. Të dyja palët janë të përkushtuara në arritjen e marrëveshjeve specifike dhe garancive, në përputhje me instrumentet perkatëse të Këshillit të Evropës dhe duke përdorur përvojat ekzistuese evropiane, për të siguruar një nivel të përshtatshëm të vetëqeverisjes për komunitetin serb në Kosovë dhe mundësinë e ofrimit të shërbimeve në disa fusha specifike, përfshirë mundësinë e ndihmës financiare nga Serbia dhe kanalet e drejtpërdrejta të komunikimit të komunitetit serb me Qeverinë e Kosovës.

Palët do ta zyrtarizojnë statusin e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë dhe do të ofrojnë një nivel të lartë të mbrojtjes së trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe, në përputhje me modelet ekzistuese evropiane.

Neni 8. Palët do të shkëmbejnë misione të përhershme. Ato do të vendosen në selitë përkatëse të qeverive. Çështjet praktike që lidhen me vendosjen e misionëve do të trajtohen veçmas.

Neni 9. Të dyja palët vënë në dukje angazhimin e BE-së dhe donatorëve të tjerë për ta krijuar një pako të veçantë ndihme financiare për projektet e përbashkëta të palëve për zhvillimin ekonomik, lidhshmërinë, tranzicionin e gjelbër dhe në fusha të tjera kyçe.

Neni 10. Palët do ta krijojnë komisionin e përbashkët, të kryesuar nga BE-ja, për monitorimin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Të dyja palët konfirmojnë detyrimet e tyre për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të dialogut nga e kaluara.

Neni 11. Palët angazhohen të respektojnë udhërrëfyesin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Teksti i Aneksit të Marrëveshjes për Rrugën e Normalizimit

Bashkimi Evropian ka publikuar në ueb faqen e tij “Aneksin e zbatimit të Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë”.

Më poshtë po japim tekstin në tërësi:

Dialogu ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës: Aneksi Zbatues i Marrëveshjes për Rrugën e Normalizimit të Marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

- Kjo Shtojcë është pjesë përbërëse e Marrëveshjes;

- Kosova dhe Serbia angazhohen plotësisht të respektojnë të gjitha nenet e Marrëveshjes dhe këtë Aneks, dhe të zbatojnë të gjitha detyrimet e tyre që dalin nga Marrëveshja, dhe kjo në mënyrë të shpejtë dhe në mirëbesim;

- Palët kanë parasysh se Marrëveshja dhe Aneksi për zbatim do të bëhen pjesë integrale e proceseve përkatëse të anëtarësimit të Kosovës dhe Serbisë në BE. Palët theksojnë se menjëherë pas miratimit të Marrëveshjes dhe këtij Aneksi, ndërmjetësi i BE-së do të fillojë procesin e ndryshimit të kriterëve për Kapitullin 35 për Serbinë për shkak të detyrimeve që dalin nga Marrëveshja dhe ky Aneks. Agjenda e Grupit Special të Kosovës për Normalizim do të pasqyrojë në mënyrë të barabartë obligimet e reja që ka Kosova, të cilat dalin nga Marrëveshja dhe ky Aneks;

- Palët bien dakord të pranojnë urgjentisht Deklaratën për Personat e Zhdukur, siç është rënë dakord në kuadër të Dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja;

- Me qëllim të zbatimit të nenit 7, Kosova menjëherë fillon negociatat në kuadër të Dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja për vendosjen e aranzhimeve dhe garancive specifike për të siguruar një nivel të duhur të vetëqeverisjes për komunitetin serb në Kosovë, në përputhje me marrëveshjet përkatëse të mëparshme të dialogut. themeluar nga ndërmjetësi i BE-së;

- Palët bien dakord të krijojnë një Komitet të Përbashkët Monitorues, të kryesuar nga BE-ja, brenda 30 ditëve. Zbatimi i të gjitha dispozitave do të sigurohet dhe monitorohet nga Komiteti i Përbashkët i Monitorimit;

- Me qëllim të zbatimit të nenit 9, BE-ja do të organizojë një konferencë donatorësh brenda 150 ditëve me qëllim të krijimit të pakos së ndihmës për investime dhe financiare për Kosovën dhe Serbinë. Ndihma nuk do të jepet përpara se BE-ja të përcaktojë se të gjitha dispozitat e Marrëveshjes janë zbatuar plotësisht;

- Kosova dhe Serbia pajtohen që të gjitha pikat do t'i zbatojnë në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra;

- Rendi i paragrafëve të kësaj shtojce nuk e vë në dyshim rendin e zbatimit të tyre;

- Kosova dhe Serbia pajtohen që të mos bllokojnë aplikimin e asnjë neni (pika);

- Të gjitha diskutimet lidhur me zbatimin e Marrëveshjes do të zhvillohen në kuadër të Dialogut të udhëhequr nga BE-ja;

- Kosova dhe Serbia kanë marrë parasysh se çdo mospërbushje e detyrimeve të tyre nga Marrëveshja, ky Aneks apo marrëveshjet e mëparshme të dialogut mund të ketë pasoja të drejtpërdrejta negative për proceset e tyre të anëtarësimit në BE dhe për ndihmën financiare që marrin nga BE-ja.

Dy palëve u kërkohet ta respektojnë integritetin dhe sovranitetin territorial të njëra-tjetrës.

Palëve u kërkohet që t'ia njohin njëra-tjetrës dokumentet relevante dhe simbolet kombëtare, përfshirë pasaportat, diplomat, targat e automjeteve dhe vulat doganore.

Rreziqet e Marrëveshjes së Brukselit

Krahas pjesëve pozitive që kanë të bëjnë me faktin se palëve u kërkohet ta respektojnë integritetin dhe sovranitetin territorial të njëra-tjetrës⁽⁶⁷⁾, t'ia njohin njëra-tjetrës dokumentet relevante dhe simbolet kombëtare, përfshirë pasaportat, diplomat, targat e automjeteve dhe vulat doganore, kjo marrëveshje bart në vete edhe 3 rreziqe vetëmenaxhimi, statusit të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë dhe Asociacioni i komunave me shumicë serbe.

⁶⁷ Për autoritetet në Kosovë, kjo pikë nënkupton që Serbia e njëj de fakto shtetësinë e Kosovës.

Vetëmenaxhimi për komunitetin serb

Aneksi e veçon pikën 7 të Marrëveshjes Bazë. Kjo pikë ka të bëjë me sigurimin e një niveli të duhur të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë, në përputhje me marrëveshjet e arritura më parë në kuadër të dialogut. “Të dyja palët përkushtohen për arritjen e aranzhimeve specifike, në përputhje me instrumentet relevante të Këshillit të Evropës dhe duke përdorur përvojat ekzistuese evropiane, për të siguruar një nivel të përshtatshëm të vetëqeverisjes për komunitetin serb në Kosovë dhe mundësinë për provizione të shërbimeve në disa fusha specifike, përfshirë edhe mundësinë e asistencës financiare nga Serbia dhe kanale të komunikimit direkt të komunitetit serb me Qeverinë e Kosovës”. Pa dyshim shprehja e përdorur një *niveli të duhur të vetëmenaxhimit për komunitetin serb*, paraqet një risi në procesin e dialogut dhe ajo mund të mos kufizohet vetëm në kërkesën për formimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, por mund të rezultojë edhe me një model joformal të autonomisë territoriale dhe politiko-territoriale e cila bie haptazi ndesh me rendin kushtetues të Republikës së Kosovës. Kjo kërkesë edhe po qe se kufizohet apo akomodohet brenda asociacionit të komunave me shumicë serbe mund të shpjerë në një sistem paralel të strukturave vendimmarrëse të këtij asociacioni i cili merr kompetenca edhe nga juridiksioni i pushtetit qendror.

Statusit të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë

Marrëveshja parasheh edhe zyrtarizmin e statusit të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë dhe ofrimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe. “Palët do të formalizojnë statusin e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë dhe të ofrojnë nivel të lartë të mbrojtjes së trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe, në përputhje me modelet ekzistuese evropiane”, thuhet në nenin shtatë. Edhe me Planin gjithëpërfshirës të Ahtisarit, Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë ka status të veçantë. Por tani Marrëveshja e Brukselit kërkon nga Kosova ta zyrtarizojë statusin e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë dhe do të ofrojë një nivel të lartë të mbrojtjes së trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe, në përputhje me modelet ekzistuese evropiane. Ky zyrtarizim mund të rezultojë me një marrëveshje apo ligj me të cilin kësaj kishe i garantohet statusi i veçantë në Kosovë.

Rreziqet e Asociacionit të komunave me shumicë serbe

Bazuar në këtë Marrëveshje, asociacioni do të ishte një strukturë e komunave me shumicë serbe në Kosovë: *Mitrovicë e veriut, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq, Graçanicë, Shtërpçë, Novobërdë, Kllokot, Ranillug dhe Partesh, e cila synon t'i integrojë serbët në tërë territorin e Kosovës*. Ky asociacion, në veçanti synonte që të nxisë tranzicionin e serbëve të Kosovës (në komunat veriore), nga sistemi i Serbisë në atë të Kosovës, dhe që ta lehtësojë integrimin e plotë të strukturave të mbetura paralele në veri, përfshirë ato të shëndetësisë dhe arsimit. Asociacioni mbështetet në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale dhe në Planin e Ahtisarit. Sipas marrëveshjes, kompetencat e AKS-së, do të ushtroheshin kolektivisht dhe përfshijnë vështrimin e plotë në fushat e zhvillimit ekonomik, arsimit, shëndetësisë e kujdesit social, si dhe planifikimit urban dhe rural.

Edhe në draftëstatutin evropian, që bazohet në planin franko-gjerman, janë ofruar modelet të ndryshme evropiane si praktika të mira të asociacioneve, të cilat bazohen në konceptet e konsociacionizmit, regjionalizmit, devolucionit dhe decentralizimit. Të gjitha këto modele janë të ndryshme dhe aplikohen në rrethana të ndryshme socio-politike të secilit shtet.

Konsociacionizmi është sistem qeverisjeje që synon të promovojë paqen dhe stabilitetin në shoqëritë e ndara, duke arritur marrëveshje për ndarjen e pushtetit midis grupeve të ndryshme etnike, fetare ose sektare.

Regjionalizmi apo autonomia rajonale nënkupton rastin në të cilin një rajoni ose njësi nënkombëtare brenda një vendi i jepet një shkallë e konsiderueshme e autonomisë politike, administrative dhe financiare për të qeverisur veten në fusha të caktuara.

Ndërsa **devolucioni** u referohet transferimit të pushtetit politik dhe autoritetit vendimmarrës nga një qeveri qendrore në njësi të nivelit më të ulët të qeverisjes si shtetet, provincat, regjionet ose bashkitë lokale.

Në fund, **decentralizimi** etnik komunal u referohet transferimit të kompetencave politike, administrative dhe financiare nga qeveria qendrore në komunat me një identitet të caktuar etnik ose kulturor.

Një nga format më të përhapura në Evropë është regjionalizmi (i kombinuar me devolucion të kompetencave) që u ka sjellë autonomi

regjioneve të ndryshme me tipare të veçanta kulturore, etnike apo gjeografike. Disa shembuj janë Ishujt Aland në Finlandë, komuniteti gjermanofolës në Belgjikë, komuniteti sami në vendet nordike dhe komuniteti shqiptar në Maqedoninë e Veriut. Sado që këto modele konsiderohen praktika të mira evropiane të asociacioneve, në rastin e Kosovës gjithnjë duhet pasur parasysh fakti se pakica serbe në Kosovë me Kushtetutën e Kosovës gëzon të drejta përtej standardeve evropiane për të drejtat e minoriteteve. Pra, tani Kosovës, krahas trajtimit afirmativ të Kushtetutës, i kërkohen kompromise të reja për asociacionin dhe sigurimin e një nivel të avancuar të vetëmenaxhimit, përkatësisht vetëqeverisjes për komunitetin serb. Ky nivel i dyfishtë i kompromiseve, qartazi shkon drejt konceptit *Ahtisari-plus* dhe sërish nuk rezulton me njohjen e pavarësisë nga 5 shtetet mosnjohëse të BE-së.

Vijat e kuqe për Asociacionin e komunave me shumicë serbe

Çfarë duhet refuzuar në mënyrë kategorike, me rastin e themelimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe;

1. Asociacioni nuk mund të ketë kompetenca ekzekutive dhe nuk guxon të paraqet nivel të tretë të pushtetit;

2. Asociacioni, nuk mund të ketë asnjë kompetencë kushtetutëdhënëse, legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore;

3. Asociacioni nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë e cila, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës është në juridiksionin e organeve republikane;

4. Asociacioni i komunave me shumicë serbe nuk mund të ketë karakter monoetnik dhe ai duhet të ndërtohet, funksionojë në parimet kushtetuese të shoqërisë shumëetnike;

5. Asociacioni duhet të funksionojë tërësisht brenda kuadrit kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës dhe në bazë të parimeve dhe praktikave të mira në kuadrin e Kartës Evropiane të Qeverisjes Lokale.

Republika e Kosovës duhet t'i ndërtojë këta mekanizma për të kontrolluar punën, veprimtarinë e Asociacionit;

1. Kontrolli qeveritar i Statutit të Asociacionit me rastin e nxjerrjes së aktit nënligjor-Dekretit me rastin e themelimit të tij;

2. Kontrolli administrativ nga MPL-ja përmes, inspektimit administrativ me mundësinë e anulimit të çdo akti apo veprimi, joligjor dhe kundërkushtetues;

3. Kontrolli kushtetues përmes Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, duke zgjeruar juridiksionin e saj për vlerësimin e kushtetutshmërisë së çdo akti normative të asociacionit;

4. Kontrolli financiar nga Ministria e Financave për të mbikëqyrur burimet e financimit dhe mënyrën e menaxhimit të financave të asociacionit, përfshirë këtu edhe raportet vjetore të auditimit.

Pala kosovare në të gjitha çështjet e pazgjidhur me Republikën e Serbisë, të cilat duhet të synojë që t'i mbyllë në procesin e dialogut, duhet të këtë kujdes maksimal që marrëveshja përfundimtare të mos e prekë dhe të mos e tejkalojë Planin Ahtisari në bazë të të cilit është shpallur dhe është njohur ndërkombëtarisht shteti i Kosovës më 17 shkurt 2008. Nëse marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të prekte në një formë apo një tjetër garancionet që ofron Plani Ahtisari për shtetin e Kosovës, praktikisht do të prekej edhe thelbi i shtetësisë së Kosovës dhe sistemi kushtetues që buron nga Deklarata e pavarësisë e vitit 2008. Rreziku real që të preket sistemi kushtetues dhe koncepti ahtisarian i shtetit të Kosovës ekziston te dizajnimi i asociacionit të komunave me shumicë serbe. Praktikisht përmes asociacionit të komunave mund t'i ofrohen më shumë të drejta komunitetit serb sesa edhe i njuh vetë Kushtetuta e Republikës së Kosovës, situatë kjo që do të krijonte pashmangshëm edhe ndryshime të Kushtetutës së Kosovës.

Një gjë që duket qartazi në sfond është që marrëveshja përfundimtare e dialogut ka pritshmëri reale që të krijojë ndryshime kushtetuese në Kosovë dhe në Serbi. Në Serbi kjo është evidente për shkak të heqjes së Kosovës nga kushtetuta serbe, kurse në Kosovë një pritshmëri e tillë lidhet me pozitën e pakicave, gjegjësisht të statusit të asociacionit të komunave rreth të drejtave të komunitetit joshumicë serb në Republikën e Kosovës.

Analiza juridike e Marrëveshjes së Brukselit dhe Aneksit të Ohrit

Nëse i bëjmë një analize juridiko kushtetuese Marrëveshjes së Brukselit dhe Aneksit të Ohrit, mund të nxjerrim katër konkludime.

E para, si kemi theksuar më herët nuk bëhet fjalë për marrëveshje përfundimtare, apo marrëveshje juridiko-detyruese, në formën e një marrëveshjeje ndërkombëtare, mbi nënshkrimin e së cilës muajt e fundit është folur shumë. Karakteri detyrues- marrëveshja ligjërishit e detyrueshme tani është zëvendësuar me marrëveshjen për normalizim. Në këtë rast bëhet fjalë për një marrëveshje të karakterit politik – meqë ra fjala – të tilla siç kanë qenë të gjitha marrëveshjet e deritanishme mes Kosovës dhe Serbisë për këtë çështje. Nga kjo Marrëveshje bazë rrjedh qartë se nënshkrimi i marrëveshjes përfundimtare, juridikisht detyruese, do të duhet bërë në të ardhmen. E kjo e ardhme nuk është përkufizuar në aspektin kohor, por varet nga rrethanat gjeopolitike në rajon dhe më gjerë.

E dyta, teksti i Marrëveshjes bazë bazohet në modelin e Marrëveshjes bazë të dy Gjermanive të nënshkruar në vitin 1972, e cila madje, në disa nene të veçanta, është kopjuar fjalë për fjalë, por në ndryshim nga ajo ka qenë Marrëveshje ndërkombëtare mes dy shteteve. Pasojë e kësaj Marrëveshjeje bazë (*mes dy Gjermanive*) ishte pranimi i dy Gjermanive në Kombet e Bashkuara, por, siç do të shpjegojë më poshtë, kjo nuk është ndoshta ecuria përfundimtare e nënshkrimit të Marrëveshjes sonë bazë, së paku jo në një afat të shkurtër ose të mesëm.

E treta, nënshkrimi i një marrëveshjeje të tillë nga ana e Serbisë nuk do të përbëjë njohjen e Kosovës. Koncepti i premtuar më parë për njohjen reciproke mes dy shteteve, tani është deplasuar me kërkesën për normalizim të raporteve si një faze kalimtare. Pra Marrëveshja bazë nuk përmban atë që është kërkesa kryesore e palës kosovare – njohjen – e cila Kosovës nuk i duhet vetëm për arsye simbolike, por edhe për arsye praktike.

E katërta, një nga kërkesat kryesore dhe risia themelore e kësaj Marrëveshjeje bazë është te neni që thotë se Serbia nuk do ta kundërshtojë hyrjen e Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Këtu para së gjithash mendohet për Kombet e Bashkuara, megjithëse kjo nuk përmendet në mënyrë eksplicite. Përkundrajt këtij formulim, Marrëveshja nuk detyron 5 shtetet mosnjohëse për njohjen e Kosovës.

Detyrimi bazë i palës kosovare është ai ekzistues, dhe ky është krijimi i një forme të vetadministrimit të serbëve në Kosovë. Të gjitha të tjerat në tekstin e Marrëveshjes bazë janë përgjithësuese ose çështje simbolike që për dikë ndoshta janë me rëndësi e për dikë tjetër jo, por praktikisht nuk kanë ndonjëfarë pasoje thelbësore.

Si mund të duket marrëveshja përfundimtare Kosovë-Serbi nga këndvështrimi i palës kosovare

Një proces i dialogut i filluar para më shumë se 13 vjetësh dukej që nuk është në përfundim e sipër. Të paktën një gjë e tillë mund të thuhet duke marrë parasysh veprimet që ishin ndërmarrë nga Republika e Kosovës për këtë proces përmes nxjerrjes së rezolutës dhe krijimit të delegacionit shtetëror për udhëheqjen e dialogut në cilësinë e një organi të veçantë.

Ani pse pa një agjendë të detajuar për dialogun, Kuvendi i Republikës së Kosovës në Rezolutën e tetorit 2018 përcaktoi tri qëllime kryesore që Republika e Kosovës synon t'i arrijë në këtë proces, siç janë: njohja e ndërsjellë e palëve të përfshira në proces, anëtarësimi i Republikës së Kosovës në OKB dhe përsheptimi i proceseve integruese në BE dhe NATO për Republikën e Kosovës. Ndërkaq, në rezolutën e Kuvendit (2018) përcaktohet qartë se për Republikën e Kosovës janë të paprekshme integriteti territorial dhe sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës, përfshirë edhe karakterin unitar të shtetit.

Në mungesë të platformës së dialogut Kosovë-Serbi, nga të dyja shtetet, mbetet akoma e paqartë se çka do të negociohet në fazën përfundimtare të këtij procesi, si dhe çfarë do të përmbajë marrëveshja potenciale përfundimtare që do të krijojë ky proces. Deri tani sidomos nga ana e Serbisë nuk ka pasur ndonjë indicie se cilat çështje do të negocohen në procesin e dialogut. Ndërkaq në këtë aspekt, sa i përket palës kosovare, është obligim i përcaktuar në Marrëveshjen e stabilizim-asociimit, se Kosova duhet t'i zgjedhë përmes dialogut çështjet e pazgjidhura me Serbinë, që hipotetakisht mund të jenë të shumta.

Procesi i dialogut stagnoi tërësisht gjatë vitit 2019, sidomos pas zhvillimeve politike në Republikën e Kosovës dhe dorëheqjes së kryeministrit Haradinaj. Ky zhvillim afektoi në mënyrë të drejtpërdrejtë procesin e dialogut dhe pasivizoi në shkallë maksimale të dyja palët. Kjo situatë vazhdon edhe sot e kësaj dite deri në krijimin e qeverisë së re të Republikës së Kosovës. Megjithatë, një gjë që duhet ta bëjë të qartë Republika e Kosovës në procesin e dialogut është ndryshimi i pozicionit të Serbisë në këtë proces, në kuptimin e asaj që procesi përfundimtar i dialogut nga Serbia të trajtohet si një dialog ndërshtetëror, që nënkupton njohjen e pavarësisë dhe subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës. Një gjë e tillë Serbia nuk e ka bërë, pasi në vazhdimësi në kuptim të rendit të brendshëm juridik të saj ajo Kosovën e ka trajtuar si pjesë të saj, kurse

institucionet e Kosovës si institucione të përkohshme vetëqeverisëse. Nëse një gjë e tillë nuk sqarohet, atëherë do të jetë problem i konsiderueshëm edhe natyra juridike e marrëveshjes përfundimtare. Duke pasur parasysh çështjet e shumta që kanë mbetur të pazgjidhura në procesin e dialogut të deritashëm, por edhe çështjet e ndërsjella ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ekziston supozimi i qëndrueshëm se teksti i marrëveshjes përfundimtare duhet të jetë i detajuar dhe të parashohë me precizitet të gjitha çështjet që janë objekt negocimi në dialog.

Është me rëndësi të thuhet se natyra juridike e marrëveshjes përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të ketë formën e tillë të një traktati të obligueshëm ndërkombëtar ndërmjet dy shteteve, ashtu siç parashihet në Konventën e Vjenës për të drejtën e traktateve 1969.⁷⁰ Kjo nënkupton që marrëveshja përfundimtare duhet të ketë të njëjtin status juridik në të dyja shtetet palë të dialogut, si në Kosovë ashtu edhe në Serbi. Gjithashtu, marrëveshja përfundimtare duhet të kalojë edhe në rrugën e ratifikimit kushtetues, në Republikën e Kosovës dhe Serbisë, bazuar në kushtetutat e të dyja shteteve.⁷¹ Nëse marrëveshja përfundimtare e dialogut nuk trajtohet në mënyrë të njëjtë nga të dyja palët në dialog dhe nëse nuk ratifikohet sipas procedurave kushtetuese të njëjta, si dhe nëse nuk shpallet në gazetën zyrtare të të dyja shteteve si e tillë, është vështirë e besueshme që mund të ketë një përmbyllje të suksesshme të procesit të dialogut. Serbia nga ana e saj e ka dëshmuar me rastin e Marrëveshjes së 19 prillit 2013 për normalizimin e marrëdhënieve se marrëveshjet e arritura në dialog nuk i ka trajtuar me status të njëjtë kushtetues sikurse Republika e Kosovës.

Nga ajo që është parë deri tani, Republika e Kosovës e ka bërë të qartë se në marrëveshjen përfundimtare me Serbinë në dialog nuk mund të preket integriteti territorial, sovraniteti i Republikës së Kosovës, karakteri unitar i shtetit dhe rregullimi kushtetues gjithashtu. Kjo, siç u tha më lart, është theksuar në të gjitha dokumentet që ka përgatitur për procesin e dialogut deri tani Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, kurse një gjë e tillë u bë e qartë edhe me Rezolutën e fundit të Kuvendit të muajit tetor 2018. Deri më tani në opinionin profesional juridik në Prishtinë janë bërë përpjekje për të nxjerrë konkluzione se cilat do të ishin çështjet që minimalisht duhet t'i zgjidhte Kosova në procesin e dialogut, e të cilat do të ishin edhe pjesë e marrëveshjes. Lidhur me këtë një analizë e Grupit për studime juridike dhe politike, ndër të tjera thekson disa çështje që mund të përbënin minimumin e përmbajtjes së marrëveshjes përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Disa nga këto çështje që përmenden në këtë studim janë:

Njohja juridikisht e plotë e Republikës së Kosovës nga Republika e Serbisë; Abrogimi i Rezolutës 1244; Zgjidhja gjyqësore e konflikteve në rast të moszbatimit të marrëveshjes; Një marrëveshje ku palë e tretë do të jetë edhe BE-ja; Një status të caktuar për forcat e KFOR-it në Republikën e Kosovës; Reciprociteti në çështjen e pozitës së komuniteteve joshumicë; zgjidhja e çështjes së personave të pagjetur etj.⁷⁰

Republika e Kosovës ka përcaktuar si një parim njohjen nga Serbia, si kusht që dialogu të ketë sukses. Në mënyrë që t'i përgjigjet neglizhencës së Serbisë në procesin e dialogut, Kosova i ka vendosur taksë 100% të gjitha produkteve që importohen nga Serbia në Kosovë.⁶⁸ Masa e tillë ka acaruar në mënyrë të konsiderueshme gatishmërinë për një vazhdim të fazës përmbyllëse të dialogut, dhe kjo u pa qartë gjatë pjesës më të madhe të vitit 2019.

Megjithatë, t'i kthehem çështjes së asaj se çka mund të përmbajë marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Natyrisht, një proces i pajtimit nuk mund të konsiderohet i përmbyllur nëse nuk do të ketë njohje të shtetësisë dhe pavarësisë së Republikës së Kosovës nga Serbia, që do të rezultonte me krijimin e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy shteteve, në pajtim me Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike të vitit 1969. Megjithëse një gjë e tillë nga deklarimet e bartësve shtetërorë të Serbisë duket aktualisht e pamundur.⁶⁹

Pashmangshëm një çështje tjetër e cila duhet të definohet në marrëveshjen përfundimtare është edhe abrogimi i Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe fitimi i një ulëse të Kosovës në OKB. Kjo do të përbente një hap të rëndësishëm në kompletimin e shtetësisë së Kosovës. Një gjë e tillë pala kosovare e ka bërë të qartë edhe në rezolutën e fundit të Kuvendit.

Duke pasur parasysh që Serbia nuk është sjellë korrekte dhe praktikisht ka qenë e papërgjegjshme në zbatimin e marrëveshjeve të dala nga dialogu, marrëveshja përfundimtare duhet të sigurojë një mekanizëm efikas, gjyqësor ose një mekanizëm tjetër i cili do të siguronte që marrëveshja përfundimtare e dialogut do të përmbushej.

“Një formë e shprehjes së këtij garancioni është që Marrëveshja të përfshijë një klauzolë që i njej GJND-së juridiksionin për të gjykuar

⁶⁸ Studim, Grupi për Studime Politike dhe Juridike - GLPS, “ÇFARË ËSHTË MINIMUMI I NJË PLATFORME PËR DIALOGUN E FAZËS FINALE NË MES TË KOSOVËS DHE SERBIË”, Prishtinë, nëntor-dhjetor 2018.

⁶⁹ Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/76, datë 21.11.2018.

dhe rrjedhimisht zgjidhur çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve, përfshirë zbatimin e detyrueshëm të vendimeve të saj në rastet kur njëra palë u shmanget detyrimeve të dhëna në marrëveshje, apo qëllimit të saj”⁽⁷⁰⁾

Përveç mekanizmit gjyqësor përmes GJND-së, mund të gjendet edhe ndonjë mekanizëm tjetër garantues për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, një opsion për këtë mund të jetë BE-ja, mund të vendosë sanksione në procesin e anëtarësimit të Kosovës apo Serbisë në BE në rast të moszbatimit të obligimeve që dalin nga marrëveshja përfundimtare. Kjo çështje megjithatë duhet të parashihet qartë dhe në mënyrë precize në marrëveshje.

Një aspekt tjetër duhet të definohet në marrëveshjen përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është edhe mbështetja e Serbisë ndaj Kosovës dhe praktikisht moskrijimi i pengesave reale për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe mekanizmat ndërkombëtarë. Një gjë e tillë do të nënkuptonte edhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete nga Serbia.

Çështja e të pagjeturve mbetet një temë pezull që nga koha kur kjo u diskutua në bisedimet e Vjenës dhe si rezultat u përfshi edhe në planin e Ahtisaarit në bazë të të cilit Kosova e shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008.⁷¹ Si probleme të pazgjidhura me Serbinë që mund të përfshihen në marrëveshje përfundimtare janë edhe çështjet ekonomike dhe pronësore të trashëguara dhe që kanë mbetur pezull, si dhe çështja e borxhit ndërkombëtar. Kthimi i artefakteve arkeologjike dhe etnologjike të Kosovës të marra nga Serbia është një problem tjetër që duhet të gjejë hapësirë në negociim në procesin përfundimtar të dialogut, si dhe të jetë pjesë e marrëveshjes përfundimtare.⁷²

Gjithashtu në marrëveshjen përfundimtare, ligjërisht të obligueshme në procesin e dialogut, duhet të rregullohet edhe fati i të gjitha marrëveshjeve që janë lidhur deri tani në procesin e dialogut. Një klauzolë e tillë do t’u ndihmonte palëve që të rregullonin statusin juridik të obligueshmërisë së marrëveshjeve të arritura deri tani, si dhe do të siguronte zbatim efikas dhe njohje të pasojave faktike që kanë krijuar marrëveshjet e nënshkruara në dialog.

⁷⁰ Studim, Grupi për Studime Politike dhe Juridike - GLPS, “ÇFARË ËSHTË MINIMUMI I NJË PLATFORME PËR DIALOGUN E FAZËS FINALE NË MES TË KOSOVËS DHE SERBIË”, Prishtinë, nëntor-dhjetor 2018.

⁷¹ Propozimi gjithëpërfshirës për marrëveshjen për statusin e Kosovës, 2 shkurt 2007, dispozitatat e përgjithshme, neni 5.

⁷² Ibid, neni 6, Aneksi V.

Përfundim

Dialogu është një storie mjaft kontraverse në raportet mes Kosovës dhe Serbisë. Kosova pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në vitin 2010, e cila konfirmoi legalitetin dhe legjitimitetin e shpalljes së pavarësisë nuk është dashur të hyjë në asnjë dialog. Ne është dashur të këmbëngulim në kërkesat, se e kemi vendimin e GJND-së, pavarësia jonë është legjitime dhe ne mund të bisedojmë me Serbinë vetëm pas njohjes reciproke dhe t'i zgjidhim problemet teknike një nga një. Kjo s'ka ndodhur, por jemi futur në një dialog, të cilin unë e quaj si “qorrsoak”. Dialogu i filluar si teknik sot në vitin 2024 nuk e ka një fund, madje ai ka ndërruar edhe kontekstin sepse nga një koncept i një dialogu për marrëveshje finale, ka devijuar në konceptin e normalizimit të marrëdhënieve.

Presionet që po i bëhen Kosovës nga faktori ndërkombëtar që ajo tani të lejojë një asociacion, e i cili në bazë të Marrëveshjes së Ohrit dhe Brukselit ka elemente esenciale dhe të dukshme të një autonomie, joformale në të ardhmen mund të cenojë edhe sovranitetin dhe integritetin dhe karakterin unitar të shtetit.

Procesi i normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, i cili tani pas 14 vjetësh po shkon drejt komplikimit, duhet të prodhojë një marrëveshje përfundimtare, e cila do të jetë një traktat ndërkombëtar i obligueshëm për të dyja shtetet, e që do të bëjë pajtimin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe të Serbisë.

Traktati përfundimtar duhet të sjellë një pajtim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, ku shtetet do t'i zgjidhin çështjet e mbetura pezull dhe do t'i normalizojnë marrëdhëniet e tyre si dy shtete të pavarura dhe me subjektivitet të plotë ndërkombëtar.

Marenglen Verli

ÇËSHTJA E KOSOVËS NË PARLAMENTIN SHQIPTAR 1920-1924

Çështja e Kosovës, Çamërisë dhe e viseve të tjera shqiptare lindi si një çështje e veçantë, natyrisht jetike për kombin shqiptar, në vitin 1913, me vendimet e marra në Konferencën e Londrës, nga ambasadorët e Fuqive të Mëdha. Trojet shqiptare në Ballkan, të organizuara administrativisht në Perandorinë Osmane në katër vilajete, me vendimet në fjalë u përgjysmuan dhe po kështu u la jashtë kufijve edhe pjesa më e madhe e kombit shqiptar, gati 2/3 e tij. (Në vitin 1912 kombi shqiptar përbëhej nga rreth 2 milionë banorë prej të cilëve në shtetin shqiptar u përfshinë vetëm 700 mijë. Në tërësi Shqipëria politike e 1913-ës pati 738 mijë banorë, përkatësisht rreth 700 mijë shqiptarë dhe 38 mijë minoritarë, kryesisht grekë, maqedonas e malazezë).¹

Qeverisë së Vlorës, të kryesuar nga Ismail Qemali dhe elitës patriotike të vendit të mbledhur rreth saj, i mbeti detyrë të përballej me situatën e paprecedent të krijuar në rrjedhën e Luftës Ballkanike dhe nga qëndrimi i Fuqive të Mëdha për rajonin. Delegacioni shqiptar i përbërë nga Mehmet Konica, Rasih Dino (i mbështetur edhe nga Filip Noga, Faik Konica e Fan S.Noli), i cili i mandatuar nga qeveria e Vlorës, mbërriti në Londër në dhjetor 1912, në fillim të janarit 1913 me mundësitë që pati, ende pa u marrë vendimi nga faktori ndërkombëtar për kufijtë e Shqipërisë, duke zbatuar vendimin e Kuvendit të Vlorës të 6 dhjetorit 1912², i paraqiti një memorandum Konferencës së

¹ Kristaq Prifti, *Popullsia e Kosovës (1831-1912)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2014, f. 1026-1030; *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. II (1920-1924), Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Botimet albanologjike, Tiranë: 2019, f. 222-223.

² Kuvendi i Vlorës, në mbledhjen e gjashtë, të datës 6 dhjetor 1912, kishte diskutuar për “njerëzit që duhet ta mprojnë çështjen shqiptare përpara Evropës” dhe pas diskutimit të I. Qemalit “se kjo punë është barrë e Qeverisë” kishte vendosur që “Qeveria të ketë liri të plotë në këtë çështje”; shih Lef Nosi, *Dokumente historike për t’i shërbye historisë tonë kombëtare (1912-1918)*, botimi i dytë, përgatitën për botim Marenglen Verli, Ferit Duka, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 2007, f. 184.

Ambasadorëve (dhe një shtojcë me statistika për përbërjen e popullsisë)³. Në këtë memorandum kërkohet që në shtetin shqiptar të përfshiheshin të gjithë viset me popullsi shqiptare, madje edhe rajone etnikisht të diskutueshme, të cilët, nëse do të gjendej mbështetje nga Fuqitë e Mëdha, mund t'i jepeshin Shqipërisë. Historiani britanik Joseph Swire (Suajer) ka shkruar se kufiri i propozuar nga Qeveria e Vlorës nuk ishte i paarsyeshëm, “qoftë historikisht, qoftë etno-grafikisht”⁴.

Kërkesat u përsëritën disa muaj më pas nga delegacioni që mbërriti në Londër nën kryesinë e Ismail Qemalit (pasi kishte vizituar më parë Romën, Vjenën dhe Parisin). Anëtarët e delegacionit deklaruan kudo që gjetën veshë t'i dëgjojnë, qoftë me stilin diplomatik e plot politesë të Ismail Qemalit, apo me stilin e thjeshtë popullor e të drejtpërdrejtë të Isa Boletinit, se shteti i ri duhet të kishte kufijtë e vet natyrorë dhe të përfshinte brenda tyre të gjitha trojet etnike shqiptare.⁵ Të dy delegacionet e sipërpërmendur nënvizuan gjithashtu se copëtimi i viseve shqiptare nuk do t'i shërbente paqes në rajon. Në korrik 1917, I. Qemali do t'i theksonte mbledhësit dhe redaktorit të kujtimeve të tij, Sommerville Story, se, sikurse më 1913-ën në Londër, ishte i bindur se “Rindërtimi i bllokut ballkanik dhe garancia e pavarësisë së tij, do të jetë një nga faktorët më të fuqishëm për paqen e Evropës Lindore dhe të botës. Kjo ndërtesë ballkanike, kish përfunduar I. Qemali, mund të forcohet vetëm me forcimin e Shqipërisë, që përbën kolonën e katërt që e mban”⁶.

Natyrisht në Londër, diplomacia e lartë, situatën e shihte të komplikuar. Aleancat, interesat gjeostrategjike dhe këndvështrimi i kohës për rregullimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, veçanërisht për caktimin e kufijve, nuk lejonin të merreshin vendime që respektonin kriteret etnike. Praktikisht aso kohe e konsideronin të natyrshme, madje të domosdoshme, shpërblimin e fitimtarëve të luftës me tokat që pushtonin gjatë konflikteve e konfrontimeve ushtarake. Interesat dhe konceptet mbi bazën e të cilave operohej në dekadat e para të shek. XX, përçaktuan kështu mënyrën e veprimit për formatin e shtetit të ri shqiptar. Ambasadori i Austro-Hungarisë, Mensdorff, njoftonte Vjenën më 18 dhjetor 1912, se, edhe pse “ato pjesë që janë të banuara vetëm nga

³ Ismail Qemal Vlora, *Kujtime*, Tiranë: Toena, 1997, f. 352.

⁴ Joseph Swire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie*, Tiranë: Dituria, 2005, f. 131.

⁵ I. Qemali, *Kujtime...*, f. 319; Tafil Boletini, *Kujtime. Pranë Isa Boletinit (1892-1916) & Përballë sfidave të kohës (1916-1963)*: Tiranë: Botimpex, 2003, f. 157-159.

⁶ I. Qemali, *Kujtime...*, f. 327.

shqiptarët duhet t'i përkasin Shqipërisë,... mendimi i të gjithë kolegëve është se nuk mund të shkohet përpara me konsiderata etnografike".⁷

Prandaj kufijtë e Shqipërisë dhe copëtimi i viseve shqiptare u vendosën me konsensusin e Fuqive të Mëdha pas një diskutimi, apo pazari, kryesisht midis përfaqësuesve të Austro-Hungarisë dhe Italisë, nga njëra anë dhe atyre të Rusisë dhe Francës nga ana tjetër, shtete të cilët shfaqnin interesa të veçanta për rajonin e Ballkanit.

Kështu, Pavarësia e shpallur nga shqiptarët më 28 nëntor 1912 në një kuvend mbarëkombëtar, ku u përfaqësuan të gjitha viset shqiptare, u njoh nga faktori ndërkombëtar vetëm për një pjesë të territoreve shqiptare dhe të kombit shqiptar. Madje, kombinacionet në politikën e Fuqive të Mëdha ndikuan që qeveria e dalë nga Kuvendi i Vlorës të mos siguronte njohjen as nga Austro-Hungaria dhe Italia, që mbështetën krijimin e shtetit shqiptar.

Periodha që pasoi, qeverisja e vendit nga princi gjerman Vilhelm Vidi dhe pazaret midis Fuqive të Mëdha, jo vetëm nuk sollën ndonjë situatë të favorshme për korrigjimin e vendimeve arbitrare të 1913-ës, por, madje, me akorde të ndryshme që pasuan, rrezikuan asgjësimin e arritjeve të deriatëhershme dhe copëtimin e mëtejshëm të viseve shqiptare, madje asgjësimin e plotë të shtetit shqiptar. (Shih Marrëveshjen Austro-Hungari-Itali të 8 majit të vitit 1913 dhe Traktatin e Fshehtë të Londrës të 26 prillit 1915).⁸

Kuvendi i Durrësit dhe qeveria e dalë prej tij, përmes delegacionit të dërguar në Paris, nën drejtimin e kryeministrit, Turhan Pashë

⁷ Arben Puto, *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha (1912-1914)*, Tiranë: 8 Nëntori, 1978, f. 50-51, 163.

* Nga 76 delegatë të përzgjedhur (71 arritën morën pjesë në Kuvend), 14 ishin nga Kosova dhe trevat shqiptare lindore, kurse 5 nga Çamëria (Myfti Vehbi Dibra, Rexhep Mitrovica, Bedri Pejani, Salih Gjika, Zyhdi Ohri, Dr. Myrtezai, Nuri Sojliu, Mehmet Dërralla, Isa Boletini, Ajdin Draga, Dervish Peja, Qerim Kajabegolli, Hamdi Ohri, Mustafa Barotçiu (Ohër-Strugë). Kuvendi vendosi më 1 dhjetor 1912 që zgjedhjet për Pleqësinë dhe Qeverinë të bëheshin pasi të vinin edhe delegatët e Janinës dhe Çamërisë Fehim Efendi, Veli Gera Reshadia, Jakup Vesel Margëlliçi, Azis Tahir Ajdonati, Rexhep Demi nga Filati; shih L. Nosi, *Dokumente historike për t'i shërbye histories...*, f. 176-186; shih edhe Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri, 1898-1942*, Tiranë: Neraida, 2000, f. 484.

⁸ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, Periudha e Pavarësisë (28 nëntor 1912 - 7 prill 1939), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 560; Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit (1912-1918)*, vëll.II, Tiranë: 8 Nëntori, 1987, f. 255-258. Marrëveshje e fshehtë midis Austro-Hungarisë dhe Italisë, nënshkruar në Romë, më 8 maj 1913.

Përmeti, e ngritën në Konferencën e Paqes në Paris qysh në fillim, në shkurt 1919, çështjen e rikthimit të Kosovës e më gjerë, brenda kufijve të shtetit shqiptar, por pa rezultat.⁹

Gjithsesi një mori faktorësh ndërkombëtarë e të brendshëm, në një kombinacion fatlum, e shpëtuan Shqipërinë dhe e ringritën shtetin shqiptar duke ruajtur me disa prerje të vogla, kufijtë e vitit 1913.*

Elita politike shqiptare, e unifikuar në qëndrime, në shumicën e saj, përballë rrezikut të asgjësimit të Shqipërisë, realizoi Kongresin kombëtar të Lushnjës. Edhe në këtë kongres, që u hap më 21 janar dhe zhvilloi punimet 28-31 janar 1920, ajo e ngriti çështjen e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare të copëtuara qysh më 1913, por jo me insistimin që ka një çështje shumë e rëndësishme. Natyrisht situata nuk ishte normale. Konferenca e Paqes e Parisit, qysh më 1919 kishte treguar qëndrimin e saj tërësisht refuzues për çështjen e korigjimit të kufijve midis Shqipërisë dhe fqinjëve të saj në të mirë të Shqipërisë. Madje, Kongresi i Lushnjës ishte mbledhur për të përballuar më të keqen, copëtimin e mëtejshëm dhe reduktimin e statusit të saj, që rrezikonte ta vinte Shqipërinë e ricunguar në nivelin e një territori nën protektorat, ose mandat. Orientimi kundër Italisë kërkonte kufirin të siguar nga krahu i Jugosllavisë, prandaj kjo nuk duhej ngacmuar për çështjen e Kosovës. Gjithsesi, 53 delegatët e mbledhur në Lushnjë, me aq sa mund të bëhej në atë situatë, u dëshmuar përfaqësues të denjë të kombit shqiptar. Duke përqendruar vëmendjen në shpëtimin e territoreve të Shqipërisë së vitit 1913 dhe mbrojtjen e pavarësisë së vendit, pra duke hedhur poshtë projektet e Konferencës së Paqes “që cenonin pavarësinë dhe tërësinë tokësore të shtetit shqiptar”, Kongresi u shpreh se nuk hiqej dorë nga ribashkimi me Shqipërinë i territoreve të shkëputura më 1913.¹⁰ Madje ai përfshiu në qeveri e senat disa personalitete nga Kosova dhe nga trevat shqiptare lindore e juglindore jashtë kufirit të 1913,

⁹ L. Nosi, *Dokumenta historike për t'i shërbye historiës ...*, f. 291-292. (Qysh ditën e parë të Kongresit, datë 25 dhjetor 1918, u diskutua që “edhe Shqipëri ndër shtet e Ballkanit t'i bashkohen gjithë ato vise ku flitet gjuha shqip e rron kombi shqiptar” si dhe “të çuemit e një Dërgate Shqiptare në Konferencën e Paqes”... nën kryesinë e Turhan Pashës për të mbrojtur të drejtat e Shqipërisë Ethnografike në Konferencën e Paqes); shih edhe diskutimin e Turhan Pashës, shkurt 1919; shih *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar (Përmbledhje dokumentesh)*, vëll. I, përgatitur nga Muin Çami (përgjegjës), Hidajete Luga (Bejtja), Dh. Andoni, M. Shuteriqi, Z. Rexha, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: 1975, dok. nr. 65, f. 117.

* Në territoret e reduktuara rishitas në viset verilindore e juglindore, banonin rreth 40 mijë banorë.

¹⁰ *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. III, f. 145. (Në telegramin e protestës dërguar

si Hoxhë Kadri Prishtinën (Ministër i Drejtësisë), Mehmet Konicën (lindur në Konicë), Bajram Currin e Irfan Ohrin¹¹.

Përmes këtij akti Kongresi dëshmoi jo vetëm dëshirën për të vlerësuar e pranuar kontributin e patriotëve shqiptarë të krahinave të mbetura jashtë Shqipërisë në ngritjen dhe konsolidimin e shtetit shqiptar, por edhe demonstroi interesin politik të shtetit të ri shqiptar për trojet shqiptare të aneksuara dhe lidhjet shumëformëshe me popullsinë e tyre.

Por, për momentin nuk u vlerësua dhe nuk ishte oportune të bëhej më tepër se kaq. Prioritet për shqiptarët ishte dëbimi i italianëve nga Vlora dhe asgjësimi i synimeve të tyre në Shqipëri. Largimi i Italisë përtej kanalit të Otrantos do t'i mbante larg fqinjët agresivë në veri e në jug, të cilët nga ana e tyre ishin gati të ulnin përkohësisht pretendimet, për të penguar praninë e Italisë në Ballkan. Gjithsesi “miqësia” e fqinjëve ishte e përkohshme dhe misioni i Sejfi Vllamasit në Beograd në prill 1920 nuk siguroi më tepër se një premtim të vakët për prapavijë të qetë në kufijtë shqiptarë, në kohën e zhvillimit të Luftës çlirimtare të Vlorës. Në kujtimet e tij S. Vllamasi shkruan se jugosllavëve nuk u pëlqeu kur ai gjatë bisedimeve, u shprehu në formë dëshire kërkesën që Jugosllavia t'i kthente Shqipërisë disa qytete thjesht shqiptare, që ndodheshin pranë kufirit shqiptaro-jugosllav, e me këtë gjest “të fitonte miqësinë e përjetshme të shqiptarëve”.¹²

Nga sa u tha më sipër, kuptohet se Shqipëria nuk pati kohë të ndërtonte jetë parlamentare me standarde moderne evropiane në vorbullën e destabilitetit politik dhe të konflikteve rajonale e botërore të viteve 1912-1918. Por edhe pas 27 marsit 1920, kur parlamentarizmi filloi të sendërtohej si një rregull legal, si një sistem qeverimi, pra pas

Konferencës së Paqes, më 30 janar 1920, shkruhej se shqiptarët ishin gati të bënin “të gjitha sakrificat, të derdhnin edhe pikën e fundit të gjakut të tyre kundër çdo vendimi që do të vinte në rrezik tërësinë tokësore dhe pavarësinë e tyre të plotë”); shih edhe Muin Çami, Marenglen Verli, *Shqipëria në Konferencën e Paqes (1919-1920)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2015, f. 390; shih *Lufta e Popullit Shqiptar...*, dok. nr. 46, f. 58-59.

¹¹ Në fund të janarit 1920, Komiteti “MKK”, duke llogaritur se mund të përfitohej nga kontradiktat italo-jugosllave rreth Shqipërisë, vendosi të hynte drejtpërdrejt në bisedime me përfaqësuesin e Beogradit, në Shkodër, Nishiq. Baza mbi të cilën palët mund të merreshin vesh sipas Komitetit ishte nëse Beogradi, përveç ndihmës për të nxjerrë Italinë nga Vlora, do të pranonte në parim që Kosova të bashkohej me Shqipërinë, e së bashku “me u shti në Konfederacionin Jugosllav” (*Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) Komiteti MKK, dosja (më tej: D.) 8; shih edhe M. Çami, M. Verli, *Shqipëria në Konferencën e Paqes (1919-1920)*..., f. 388).

¹² S. Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, f. 196.

çeljes së të parit parlament kombëtar, trajtimi i çështjes së Kosovës dhe viseve të tjera të shkëputura nga shteti shqiptar më 1913, do të mbetej më tepër çështje dëshire e retorike, por jo e alternativave konkrete që prodhojnë zgjidhje. Madje, problemi i kufijve u shtrua më tepër në disa momente iluzionesh, sikurse ishte rasti më 12 dhe 24 shkurt, si edhe më 7 mars e 15 prill të vitit 1919, kur të dërguarit e qeverisë shqiptare që shkuan në Paris në Konferencën e Paqes me në krye Kryeministrin Turhan Pashë Përmetin, të ndikuar nga politika italiane, iu drejtuan disa herë Kryetarit të Konferencës së Paqes Zhorzh Klemansoit, duke shpresuar se mund të dëgjohej sadopak fjala e tyre¹³. Gjithashtu, çështja e trajtimit të shqiptarëve në Jugosllavi e Greqi, do të ngrihej në disa raste. Ndër to përmendim notat e 11 marsit dhe 3 qershorit 1919 të Turhan Pashë Përmetit, drejtuar kryetarit të Konferencës së Paqes, Zhorzh Klemansoit, si edhe të 25 korrikut e të 10 shtatorit 1919, kur kryetari i delegacionit qeveritar shqiptar, Luigj Bumçi e shtroi përsëri problemin¹⁴.

Pas Kongresit të Lushnjës për çdo politikan e analist realist ishte e qartë se së pari duhej shpëtuar Shqipëria e 1913-ës dhe nuk ishte momenti për të kërkuar nga fqinjët atë që asnjë llogaritje e saktë nuk e konsideronte të mundur të merrej. Prandaj dëshirat dhe patriotizmi verbal mbeteshin të shpreheshin brenda mureve të “Këshillit Kombëtar” apo Senatit dhe gradualisht do të reflektonin përplasjet midis opozitës dhe pozitës. Natyrisht përfaqësuesit e të parës, kishin komoditetin që për kapital politik të kritikonin qeverinë për patriotizëm “të pamjaf-tueshëm”. Qysh në muajt e parë pas Kongresit, rivaliteti i hershëm midis parisë dhe anëtarëve të Krahut Kombëtar u riformatua mbi bazën e grupimeve politike që u krijuan nga interesa të momentit, nga llogari pragmatiste dhe simpati e antipati individualiste etj. Aqif Pashë Elbasani (Biçaku) dhe Hoxhë Kadri Prishtina u larguan nga “Krahu Kombëtar” për shkak se aty ishin forcuar pozitat e Ahmet Zogut. Po kështu pothuajse e gjithë paria e Kosovës e vendosur në Shqipëri, si Bajram Curri, Hasan Prishtina etj., dhe masa e muhaxhirëve që shkonte mbas

¹³ M.Çami, M.Verli, *Shqipëria në Konferencën e Paqes...*, f. 517-527, 539; *Shqipëria përpara Konferencës së Paqës*, Blë i Parë (Dokumenta zyrtarë të paraqitun nga ana e Dërgatës Shqiptare, qyshë prej 12 Shkurt e deri më 5 Qershor 1919, e të botuem nga ana e Qeverriës së Përkohëshme), Romë: 1919, f. 15-22, f. 41-42.

¹⁴ *Shqipëria përpara Konferencës së Paqes...*, Blë i parë, f. 43-44; *po aty*, Blë i Dytë (Dokumenta zyrtarë të paraqitun nga ana e Dërgatës Shqiptare qyshë prej 24 Korrik 1919 e deri më 11 Shkurt 1920 e të botuem nga ana e Qeverriës Shqiptare), Shkodër: Shtypëshkroja Franqiskane, 1921, f. 10, 19-21.

tyre, përveç disa të rinjve intelektualë si Rexhep Mitrovica, Beqir Vokshi, Ibrahim Gjakova, Bedri Pejani, Hadush Kastrati, Osman Tetova etj., u bënë pjesë e lobit proitalian, që sulmonin grupimin kundërshtar për çështjen e Kosovës ndoshta edhe duke shpresuar se vetëm kështu mund të rimerrej Kosova e të bashkohej me Shqipërinë.¹⁵

Sipas njohësit të mirë të situatës së kohës, S. Vllamasit, në opozitë me qeverinë e dalë nga Kongresi i Lushnjës u rreshtuan edhe qarqet klerikale katolike dhe bajraktarët, që ishin tepër konservatorë dhe donin të ruanin domenet e influencës së tyre në popullsinë e Shqipërisë së Veriut, gjithashtu edhe një pjesë e intelektualëve ambiciozë, që kërkonin sa më parë e me çdo kusht pushtet. “Të gjithë këto forca heterogjene, ka shkruar S. Vllamasi, formuan një koalicion të fortë kundër atyre liberale e demokratike që kishin për qëllim stabilizimin e shtetit...”¹⁶ Në këtë situatë të brendshme, që reflektonte emancipimin e pamjaftueshëm të kombit dhe kur mungonte një përkrahje e jashtme e fuqishme, sigurisht vështirësitë ishin të mëdha.

Qysh më 27 mars 1920 kur nisi punimet “Këshilli Kombëtar”, apo “Senati”¹⁷ në fjalën e mbajtur nga Këshilli i Lartë (Regjenca), u theksua se “qëllimi kombëtar asht mbrojtja e Atdheut pavarësia dhe sigurimi i kufijve të përcaktuar nga Konferenca e Londrës më 1913”. U theksua gjithashtu se “Me fqinjët tanë Jugosllavët e Grekët, kemi dëshirë të rrojmë në një harmonie miqësore” dhe, sigurisht me shumë ndrojtje e diplomaci, më tej u deklarua se “Kemi shpresë të madhe se, edhe fqinjët t’anë kanë me njoft të drejtat t’ona etnike e jetike”¹⁸. Në këtë mbledhje të parë, në prani të 24 senatorëve të pranishëm, senatori i Vlorës dhe njëherësh nënkryetar i Këshillit Kombëtar, Spiro Koleka, në fjalën e mbajtur “çfaqti idhnimin e tij nga se, sheh qi, dy pjesë të Shqipnias, Kosova e Çamëria s’përfaqësohen në Këshillin Kombëtar e lyp qi, ky idhnim të

¹⁵ S.Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri...*, f. 190.

¹⁶ *Po aty*.

¹⁷ Në krye të Senatit prej 37 anëtarësh u caktua Xhemal Naipi, nënkryetar Spiro Koleka, sekretar Hil Mosi. Senati funksionoi nga 27 marsi deri më 20 dhjetor 1920. Prej 37 deputetëve vetëm 13 nuk kryenin detyra administrative dhe nuk ishin drejtpërdrejt nën urdhrat e qeverisë, çka e ulte realisht pavarësinë e senatit dhe kompetencat e tij mbi qeverinë. *AQSH*, F. Kryeministria, V. 1920, D. I-217, fl. 1. Letër e Kryetarit të Këshillit të Naltë (Regjencës) për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar, Tiranë 31 mars 1920; “*Mbrojtja Kombëtare*”, Nr. 6, Vlorë, 18 nëntor 1920; shih *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX...*, vëll. II, f. 37.

¹⁸ *Bisedime Parlamentare 1920-1921*, përgatitur nga Shërbimi i Botimeve Parlamentare të Kuvendit të Shqipërisë, Tiranë: 2015, f. 10.

çfaqet prej gjith Këshillës e të shënohet në procesverbal”¹⁹. Por në diskutimet e Këshillit në ditët në vazhdim u bë e qartë se për të gjithë preokupimi ishte nëse Jugosllavia do të pranonte Shqipërinë në kufijtë e 1913-ës dhe nëse ajo dhe të tjerët do ta njihnin apo jo qeverinë e dalë nga Kongresi i Lushnjës.

Ndërkohë, qysh në prill të vitit 1920, në Këshillin Kombëtar evidentohen replikat për orientimin e politikës pro e kundër mbështetjes tek Italia apo Jugosllavia, akuza se kryengritjet në Kosovë “bahen me gjishtin e Italies nga ana e Qeveries”, thashetheme e akuza se misioni i S. Vllamasit në Beograd duhej lexuar si veprim “për t’ia shitur definitivisht Kosovën Jugosllavisë” se “toskët nuk e duan Kosovën” etj.²⁰ Për përfaqësuesit e rrymës që kërkonte dëbimin e Italisë nga Vlora për të shpëtuar Shqipërinë, ishte e qartë që Italia lëvizte gurët për të rrëzuar qeverinë e Sulejman Delvinës, të dalë nga Kongresi i Lushnjës dhe për ta zëvendësuar me një qeveri proitaliane, duke sponsorizuar idenë se vetëm Italia mund të nxirrte Jugosllavinë nga Kosova.²¹

Në një renditje në dukje edhe paradoksale, u përvijuan dy grupime: ai me në krye Aqif Pashën, që kryesisht kishte në radhët e tij elementë konservatorë, irredentistët kosovarë dhe ç’kishte mbetur nga qeveritarët e kabinetit të Durrësit, grup në të cilin aderonin shumica e senatorëve të Vlorës, Beratit dhe Gjirokastrës, si edhe grupimi i përbërë kryesisht nga anëtarët e “Krahut Kombëtar” etj., me A. Zogun në krye, që kishte mbështetjen e senatorëve të Korçës, Tiranës, Dibrës dhe Shkodrës, që kishin një qasje më realiste ndaj problemeve të Shqipërisë.²²

Më 10 tetor 1920 një grup deputetësh, për herë të parë në historinë e Parlamentit të parë Shqiptar, doli me një program politik, duke e quajtur veten “Partia Popullore Kombëtare” (kryetar Fan S. Noli). Më 21 nëntor një grup tjetër krijoi “Partinë Përparimtare” (kryetar Mehdi Frashëri), kurse disa deputetë u paraqitën si “independentë”²³.

¹⁹ *Po aty*, f. 11.

²⁰ *Bisedime Parlamentare 1920-1921...*, f. 33. Diskutim i Fazli Frashërit dhe replika mes tij e Ramiz Dacit, datë 19 prill 1920; shih edhe S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 195, 205. Dorëheqja e Hoxha Kadriut si ministër i Drejtësisë, më 11 maj 1920, lidhet me dërgimin e S. Vllamasit në Beograd, pa e informuar atë. Shih *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920...*, vëll. II, dok. nr. 224, f. 266. Letra e dorëheqjes e H. Kadriut për Këshillin e Naltë, 11 maj 1920.

²¹ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 206.

²² *Po aty*, f. 206-207; *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX...*, vëll. II, f. 49.

²³ Kaliopi Naska, *Këshilli Kombëtar 1920: (Parlamenti i parë shqiptar)*, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë: 2000, f. 104; shih edhe *AQSH*, F. 246, V. 1920, D. 40, fl. 15-20.

Me krijimin e këtyre partive lufta për pushtet do të ridimensionohej dhe kundërthëniet e akuzat në Këshillin Kombëtar do të rriteshin dukshëm, duke marrë shkas edhe nga kalimi i rrezikut kryesor për vendin pas tërheqjes së Italisë nga Vlora dhe sigurisë se intervencioni jugosllav në Koplik e Peshkopi nuk do të tolerohej nga Fuqitë e Mëdha, Britania, Franca dhe Italia, të cilat më 10-12 nëntor vendosën edhe marrëdhënie të rregullta diplomatike me Shqipërinë. Përplasjet me armë në kufi në Koplik e Peshkopi gjatë korrikut e gushtit dhe intervencioni jugosllav që pasoi, si edhe avancimi, në tetor deri në Shqipërinë e Mesme i forcave shqiptare projugosllave esadiste të Halit Lleshit, Osman Memës, Tafë Kaziut e Hamdi Agë Bashës, duke shkaktuar largimin e banorëve nga vendbanimet e tyre për shkak të terrorit²⁴, me sa duket ndikuan vetëm në largimin e vëmendjes nga çështja e Kosovës. Vihet re se pas rifillimit të punimeve të Këshillit Kombëtar më 23 shtator 1920, mungojnë diskutime për çështjen e shqiptarëve të mbetur jashtë kufijve²⁵.

Kështu për shkak të luftës për pushtet, pa përjashtuar situatën e disfavorshme në rajon, në Këshillin Kombëtar, gati një vit pasi po funksiononte jeta parlamentare në Shqipëri, edhe pse Italia i kishte larë duart nga Vlora, edhe pse Shqipëria qysh nga dhjetori i vitit 1920, ishte bërë anëtare e Lidhjes së Kombeve, trajtimi i çështjes së shqiptarëve të Kosovës ishte fare i zbehtë, madje edhe kur ishte fjala për të kërkuar vetëm respektimin e të drejtave kombëtare e njerëzore.²⁶

Në fjalën e lexuar para 56 deputetëve të pranishëm më 21 prill, ora 10 paradreke, Këshilli i Naltë (Regjenca) u shpreh me diplomaci, se përmes një “dërgate” në Beograd, Shqipëria kishte theksuar se “shteti ynë nuk ka tjetër qëllim, veç se të jetë në një harmoni të plotë me fqinjët. Kujtojmë se, theksohej në “Fjalën e Fronit”, edhe Qeveria Jugosllave, tue ushqye ndjenja ksidore, do të gjindet një marrëveshje në mest të dy

²⁴ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX...*, vëll. II, f. 88-89.

²⁵ *Bisedime Parlamentare 1920-1921...*, f. 78, 158. Mbledhja e datës 25 tetor 1920. Më 23 qershor – 23 shtator nuk pati punime dhe sesioni i dytë i legjislaturës së parë filloi më 23 shtator 1920.

²⁶ *Po aty*, f.188; shih edhe S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 230. Ai shkruan: “Pas shtatorit 1920, pa u forcuar mirë shteti, filluan rivalitetet e zakonshme, komplotet e luftërat nga ana e elementeve që nuk mund të duronin sukseset e arritura nga rivalët e tyre dhe shteti të drejtohej nga elementë të rinj.... Kishte edhe të tjerë që prisnin të merrnin në dorë frenat e shtetit për ta përvetësuar sundimin arbitrar dhe për të vënë jashtë rrezikut pasuritë e tyre të mëdha të fituara abuzivisht dhe më në fund, kishte edhe të tjerë ambiciozë edhe më të rrezikshëm se të tjerët që.... donin të vinin në pushtet me çdo kusht”.

shteteve dhe kështu do të na lirohen vendet tona të xanuna pre serbëve”.²⁷

Në këto rrethana kur Jugosllavia mbante, me apo pa pretekste, territore të Shqipërisë së 1913-ës dhe kishte masakruar popullsinë e zonave ku ishte zhvilluar qëndresë, në të dy anët e kufirit, sigurisht nuk kishte gjasa të flitej për çështje të territoreve, që ishin copëtuar në Konferencën e Londrës, por ishte lënë jashtë çdo diskutimi edhe çështja e trajtimit anormal të popullsisë së Kosovës nga autoritetet jugosllave. Me territore ende të okupuara, shteti shqiptar nuk kishte garantuar plotësisht as çështjen e mbijetesës në kufijtë e 1913-ës. Në këtë situatë ç’mund të thoshin dhe deputetët e Dibrës, anëtarë të Partisë Përparimtare, me origjinë nga viset e copëtuara, si Avni Gjilani, Gani Strazimiri, Hoxha Kadriu, Hasan Prishtina, Irfan Ohri, Ramiz Daci etj.? Edhe kur prekej çështja e Kosovës, ajo mbetej në fraza deklarative që nuk kapërcenin muret e parlamentit dhe përgjithësisht nuk ndërmerreshin hapa që të çonin në dyert e kancelarive të Fuqive të Mëdha, apo në forume e organizata ndërkombëtare si Lidhja e Kombeve.

Në diskutimet e majit 1921 (14 maj 1921) deputetët në fjalën e tyre, duke u përqendruar vetëm te nevoja e trajtimit të shqiptarëve jashtë kufijve me statusin e minoriteteve ishin të kujdesshëm se mos krijoheshin “komplikacione në politikën e jashtme”²⁸. Ali Këlcyra, deputet i Gjirokastrës dhe anëtar i Partisë Popullore, më 14 maj 1921, shtroi problemin që të kishte interesim shtetëror “për shqiptarët e jashtëm”. Kjo gjë, e përforcoi atë Leonidha Koja, deputet i Durrësit, nuk do të sillte “komplikacion në politikën e jashtme”, meqenëse “Lidhja e Kombeve vetë e ka vendue mbrojtjen e minoriteteve”. Kurse Kristo Dako, deputet i Dibrës, i kërkoi qeverisë të përpiqej “me pasë shkolla (shqipe) në Çamëri e në Kosovë”²⁹.

Gjithnjë në orientim të mbrojtjes dhe respektimit të statusit të minoriteteve, “sipas kartave të Lidhjes së Kombeve”, në qershor 1921 (mbledhja e 13 qershorit 1921) deputeti i Durrësit, Jusuf Barka, pasi me një ton më të lartë tërhoqi vëmendjen e kolegëve për “mizoritë e serbëve mbi vllaznit tanë të Kosovës”, theksoi se, nëse vijonin ato mizori “në dy vjet... s’ka me mbetë farë e Shqipnisë në Kosovë”. Ai kërkoi që të ndërmerreshin demarshe e t’u tërhiqej telegrafisht vëmendja Fuqive të Mëdha që të ndërhyenin për t’u dhënë fund “një orë e më parë këtyre

²⁷ *Bisedimet parlamentare 1920-1921...*, f. 188.

²⁸ *Po aty*, f. 231.

²⁹ *Po aty*.

ngjarjeve”. Jusuf Barka, njëkohësisht i kërkoi llogari qeverisë se çfarë kishte bërë për këtë çështje “me shumë rëndësi”. Kurse Ministrisë së Punëve të Jashtme i kërkoi shpjegime, se “përse nuk respektohej reciprociteti me Jugosllavinë dhe përse ishte lejuar hapja e Konsullatës Serbe” në Korçë “pa pas asnjë nënshtetas” të Serbisë, dhe ende pa shkëmbyer përfaqësi diplomatike të dy shtetet (Shqipëria e Jugosllavia) dhe përse në Ohër “tue pas shumë shqiptarë, qeveria s’ka dërgue një Konsull për me ruejt interesat e shqiptarëve”³⁰.

Pozicionet e deputetëve të dy partive pasqyronin qëndrimet e sipërpërmendura të grupimeve të vitit 1920, por kishin edhe ndryshime që ishin krijuar rishtas gjatë gjysmës së dytë të atij viti, ose që bartnin edhe specifikat e trevave nga vinin deputetët. Sipas S. Vllamasit, pavarësisht se u luftua egër e pas kulisave edhe brenda llojit, në përgjithësi “Korça e Vlora në unanimitet votuan politikën e Kongresit të Lushnjës, Gjirokastra për shkak të Myfit Libohovës u pozicionua midis dy politikave, asaj të Lushnjës e të Durrësit”, edhe pse shumicën e fituan mbështetësit e politikës së Lushnjës, kurse Elbasani, për shkak të Sh. Vërlacit u pozicionua për “politikën e Durrësit”. Gjithnjë sipas S. Vllamasit, në Berat, Tiranë e Durrës, shumicën e fituan përkrahësit e “politikës së Lushnjës”, në Mat, për shkak të A. Zogut, gjithashtu përkrahësit e kësaj politike, në prefekturën e Drinit kryesisht përkrahësit e politikës së Durrësit; në prefekturën e Kosovës, me ndikimin e B. Currit, votat u pjesëtuan midis dy partive, kurse zgjedhjet në Shkodër që u zhvilluan më vonë, e përfunduan më 8 shtator 1921, patën rezultat më shumë për Partinë Përparimtare.³¹

Ndërkohë që Italia kishte humbur terren në Shqipëri dhe Jugosllavia ende nuk dominonte në rajon për të bërë të mundur sendërtimin e synimeve të veta në Shqipëri, diskutimi i Kryeministrit Iljaz Vrioni, në parlament, më 29 qershor 1921, rezulton se preku shkurtazi vetëm çështjet e kujdesit për “independencën” e Shqipërisë dhe të kufijve të

³⁰ *Po aty*, f. 272.

³¹ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 238-240. Deputetë me peshë që u rreshtuan në Partinë Përparimtare ishin: në Berat Qemal Vrioni, në Elbasan Shefqet Vërlaci e Mehdi Frashëri; në Dibër – Hasan Prishtina, Hoxha Kadriu, Irfan Ohri, Ramiz Daci, Avni Gjilani, Kristo Floqi; në Shkodër – Shuk Gurakuqi, Hilë Mosi, Sulçe Bushati, Musa Juka, Xhemal Bushati. Kështu, Partia Popullore, nën kryesinë e F. Nolit kishte 38 deputetë. Partia Përparimtare, nën kryesinë e Mehdi Frashërit kishte 28 deputetë dhe “Grupi i Independentëve”, 10 deputetë që lëviznin midis dy grupeve, në përbërjen e të cilit bënin pjesë Gjon Fishta, Ndre Mjeda, Luigj Gurakuqi, Mustafa Kruja etj. Shumica e “independentëve” do të bashkoheshin me Partinë Popullore.

1913-ës, që në këtë kohë u mësua se do të diskutohej jo në Lidhjen e Kombeve, por nga Konferenca e Ambasadorëve. Ai njëherësh thekson te nevojën e marrëdhënieve miqësore me gjithë fuqitë e sidomos me fqinjët dhe përpjekjet, deri në atë moment të pasuksesshme, për vendosjen e “relacioneve miqësore me qeverinë jugosllave”³².

Gjatë korrikut të vitit 1921, situata në kufijtë shqiptaro-jugosllav agravoi me pasoja për popullsinë vendase. Shqipëria reagoi në mbrojtje të popullsisë shqiptare të dhunuar, çka nervozoi Beogradin. Duke marrë spunto nga një telegram i Parlamentit Jugosllav drejtuar atij Shqiptar, që akuzonte e protestonte për përzierjeje të Shqipërisë në punët e brendshme të Jugosllavisë, deputeti Hasan Prishtina, më 16 korrik 1921 do të deklaronte: “Kryetari i Parlamentit Jugosllav me telegram na thotë se Parlamenti Shqiptar nuk ka të drejtë m’u përzi në punë të përbrendshme të shtetit tonë [Jugosllavisë]. Kjo asht e drejtë, por nga pikëpamja e njerëzis kemi të drejtë m’u ankue e me i hjekë vrejten Parlamentit Jugosllav për masakra e barbarizma të panumërta qi po i bahen popullit shqiptar në Kosovë, pse pa farë mëshiret, po vriten e myten gra, fmi, jo për ndonjë arsye, si thotë Kryetari i Parlamentit [Jugosllav] se po bahen shkaktar ngatresash, por vetëm se janë shqiptarë,... Këshilli Kombëtar [i yni], - theksonte Hasan Prishtina, ka pasë pranue m’u interesua për fatin e atyne shqiptarëve, qi gjinden jashtë kufijve të Shqipnies. Pra proponoj qi Qeveria të *marrë masa të rrepta e urgjente*, me qenë qi me ankimet me shkrim nuk mund të kemi dobi të mjaftë, proponoj me *emërue një Komision parlamentar për me shkue në Romë, Paris, Londrë e në kjoftë nevoja edhe në Washington, për me u ankue verbalement*”.³³

Menjëherë pas H. Prishtinës reagoi edhe Hoxha Kadriu, i cili, duke analizuar si jurist telegramin e Parlamentit Jugosllav, theksoi se nëse mospërzierja e Parlamentit Shqiptar në punë të brendshme të Jugosllavisë teorikisht qëndronte, në rastin konkret ishte fjala jo për përzierje “Qëllim i jonë, theksoi Hoxha Kadriu, nuk ka qenë mu përzie ndër punë të brendshme të Shtetit Jugosllav, por ne e kemi ba këtë telegram dhe ua kemi heqë të gjithë botës së qytetnueme e ja kemi dërgue edhe Parlamentit Serb, tue kujtue se edhe ata kanë umanitet”. Qëllimi ynë ka qenë, shtonte H. Kadriu, që “Parlamenti Jugosllav t’i hjekun vrejten Qeveries së vet për me ba qi të ndalohen këto masakra”.³⁴ Pasi përmendte një varg masakrash të autoriteteve serbe kundër

³² *Bisedimet Parlamentare 1920-1921...*, f. 322-323.

³³ *Po aty*, f. 360-361.

³⁴ *Po aty*, f. 361-362.

shqiptarëve të Kosovës, H. Kadriu deklaroi se “Jugosllavia ka për qëllim të qitunit fare të popullit të Kosovës për me i thanë Europës se kjo pjesë nuk asht Shqipnie por Stara Srbije. Por si do të mund të thotë [këtë] kur 90% të banuesve janë shqiptarë?” Prandaj, përfundonte fjalën H. Kadriu, shqiptarët shpërngulen me terror e zëvendësohen me sllavë të ardhur “Nuk e shoh më të nevojshme t’i sillemi prapë Parlamentit Jugosllav – u tërhiqte vëmendjen kolegëve H. Kadriu, por t’ankohemi në botën e qytetnuem n’atë mënyrë si tha z. Hasan Prishtina”.³⁵

Mbledhja e 16 korrikut 1921 ishte tërësisht e fokusuar në çështjen e trajtimit çnjerëzor të shqiptarëve të Kosovës. Nuk munguan edhe diskutime që preknin në të njëjtin sens edhe çështjen e Çamërisë. Pas diskutimeve të deputetëve Hasan Prishtina e Hoxha Kadriu, në diskutime u përfshinë Ali Këlcyra – deputet i Gjirokastrës, Rexhep Mitrovica – deputet i prefekturës së Kosovës, Luigj Gurakuqi – deputet i Shkodrës, Sejfi Vllamasi – deputet i Korçës, Jusuf Barka – deputet i Durrësit, Leonidha Koja – deputet i Durrësit, Stavro Vinjau – deputet i Gjirokastrës, Irfan Ohri – deputet i Dibrës, Mustafa Kruja – deputet i prefekturës së Kosovës, Gjergj Fishta – deputet i Shkodrës, Bahri Omari – deputet i Gjirokastrës, Ali Koprencka – deputet i Beratit, Qazim Daci – deputet i Dibrës, Hysen Mushketa – deputet i Durrësit, Qazim Kokoshi – deputet i Vlorës, Ndre Mjeda – deputet i Shkodrës, pra deputetë nga të tria grupet parlamentare.

Fillimisht të gjithë deputetët që diskutuan dënuan dhunën ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë, përgjithësisht hodhën poshtë telegramin e kryetarit të Parlamentit Jugosllav dhe vlerësuan protestën e Parlamentit të Shqipërisë, e cila, u theksua se duhej bërë jo vetëm pranë Lidhjes së Kombeve. Por ata u ndanë kur qe fjala për të dërguar një delegacion pranë Fuqive të Mëdha për të paraqitur fakte e për të siguruar ndërhyrjen e tyre që të ndalej dhuna në Kosovë, apo për ta bërë demarshin përmes përfaqësuesve të Shqipërisë të akredituar jashtë vendit. Përkrahësit e variantit të dytë të prirë nga Ali Këlcyra e argumentonin qëndrimin e tyre edhe nga aspekti ekonomik, por kryesisht duke llogaritur se Komisioni i dërguar enkas nga Shqipëria nuk kishte njohje në sferat e larta evropiane dhe do të kishte më pak sukses krahasuar me përfaqësuesit e Shqipërisë pranë organizmave ndërkombëtarë.³⁶ Ali Këlcyra në diskutimin e tij, ndërsa u shpreh kundër dërgimit të një delegacioni theksoi se për çështjen e shqiptarëve të Kosovës “lipsej një propagandë sistematike, e këtë mund ta bënin njerëz që

³⁵ *Po aty*, f. 362.

³⁶ *Po aty*, f. 361-394.

ndodheshin gjithnjë atje (në Evropë) në të tilla detyra”. Me këtë rast, ai kërkoi t’i hiqej vërejtje qeverisë që nuk kishte zbatuar premtimin e bërë në programin e saj kur u votëbesua, se do të dërgonte “me të shpejtë përfaqësitë e saj në vendet e duhura”, të cilat do të tërhiqnin vëmendjen e “botës së qytetëruar mbi ngjarjet e Kosovës”. “Heshtja e moslajmërimi i këtyre ngjarjeve nëpër vendet e nevojshme, shtoi deputeti R. Mitrovica, kam frikë se po na i bjer (humb) të drejtat tona edhe në këtë copë Shqipërië”.³⁷

Ndërkohë nuk munguan akuzat e përfaqësuesve të Partisë Përparimtare, ndaj atyre të Partisë Popullore, se nuk preknin fare çështjen e kufijve, dhe nuk e shtronin me forcën e duhur çështjen e gjendjes në të cilën ndodheshin shqiptarët e Kosovës. Të dytët argumentonin se, duhej siguruar Shqipëria e 1913-ës, kufijtë e së cilës ende diskutoheshin dhe pjesë të territorit të së cilës ende mbaheshin të okupuara nga ushtria jugosllave.

Në mbrojtje të variantit për dërgimin e një delegacioni në Evropë, H. Prishtina, i akuzuar më se një herë se vepronte i nisur nga interesa biznesi,³⁸ duke iu kundërvënë variantit që mbrohej nga Ali Këlcyra, Stavro Vinjau etj., deklaroi me patos se ishte gati të linte peng për 5 000 lira mylkun që zotëronte në Selanik, i cili vlente 30 000 lira, vetëm që të mundësohej financimi për të dërguar delegacionin në Evropë.³⁹ Kurse Stavro Vinjau shfrytëzoi rastin për të akuzuar Fuqitë e Mëdha se “na premtuan me sa fjalë të bukura lirimin e popujve të robëruar” por nuk e bënë këtë. Ai rekomandonte të gjendej mbështetje te “socialistët e të gjithë botës”. Duke iu referuar shkrimeve të gazetës “Pravda”, S. Vinjau propagandonte se “vetëm socialistët kanë princip dhe guxim të nxjerrin të palarat e qeverive të tyre”.⁴⁰

S. Vinjau bënte pjesë ndër ata deputetë, që nuk ishin të paktë, të cilët e konsideronin të mbyllur përgjithmonë çështjen e korrigjimit të kufijve shqiptaro-jugosllav në të mirë të Shqipërisë, por u tregua ekzemplar, kur për këtë çështje do të deklaronte me dëshpërim fjalë që në politikë quhen “gafa të rënda”: “Ne nuk kërkojmë nga Serbia Kosovën, atë dhe shqiptarët e saj ja kemi falun... Vetëm kërkojmë t’i respektojë si njerëz e jo ti therin si berra”⁴¹. Me pikëpamjen e Vinjaut, bashkohen edhe Irfan Ohri.

³⁷ *Po aty*, 366-367.

³⁸ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 221.

³⁹ *Bisedimet parlamentare, 1920-1921...*, f. 386-387.

⁴⁰ *Po aty*, f. 371.

⁴¹ *Po aty*.

Pas diskutimeve të 16 korrikut, çështja e Kosovës do të vijonte të diskutohej në mbledhjen e 18 korrikut, që filloi duke lexuar një telegram të Eric Drummond-it, sekretar i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve. Drummond me seli në Gjenevë, në përgjigje të një note dërguar nga Vlora, më 28 qershor 1921, për të denoncuar terrorin mbi shqiptarët në Kosovë informonte më 4 korrik se... “s’kam mungue për me u komunikue këtë telegram [të ardhur nga Shqipëria] anëtarëve të Këshillit, si edhe anëtarëve të Shoqnies Kombeve, për me i informue. Urdhnoni me prit Zotni Kryetar, nderimet e mia më të mëdha”.⁴²

Sigurisht telegrami i Drummond-it ishte formuluar mbi bazën e normave të kortezisë së zakonshme në diplomaci, por që nuk rezultoi të ketë prodhuar efekte pozitive për shqiptarët e Kosovës. Madje, në fund të qershorit të vitit 1921, me nxitjen e Beogradit, kapedani i Mirditës, Markagjoni, kishte filluar rebelimin kundër qeverisë së Tiranës duke destabilizuar rendin në Shqipërinë përplot probleme.⁴³

Situata gjatë qershor-korrikut 1921, e tensionoi debatin parlamentar. Në replikat e datës 18 korrik bie në sy reagimi i H. Prishtinës ndaj S. Kolekës. “Z. Koleka tha se Kosovasi (deputetët kosovarë) lipset të marrin parasysh interesën e Shqipnjes e jo vetëm të Kosovës, u shpreh i irrituar H. Prishtina, e siguroj Zotnin e tij që e marrim parasysh interesën e Shqypnjes. Zotni e Tij thotë që kosovasi të rrinë urtë,... por Zotnia Juaj nuk din shka do me thanë serb”.

Për deputetin H. Myshqeta, mbrojtja e të drejtave të shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera të shkëputura nga shteti shqiptar, nga “një komb i vogël” si shqiptarët, mund të bëhej vetëm duke “trokëllitur” në dyert e të Mëdhenjve, që të zbatohet parimi “i mbrojtjes së minoriteteve”, kurse me rëndësi do të ishte të sigurohej “lirimi i vendeve t’ona shtetnore [të Shqipërisë në kufijtë e 1913-ës] të shkeluna nga të huajt, si edhe mbrojtja e të drejtës sonë ndjesore e gjutore që kemi jashtë kufijve”.⁴⁴

Diskutimet parlamentare gjatë verës së vitit 1921, dëshmojnë se po përvijoheshin qartë dy qëndrime për çështjen e Kosovës. Njëra palë, kryesisht deputetë të Partisë Popullore, që ishte në pushtet, mbronte pikëpamjen se duhej insistuar kryesisht në përpjekjet për konsolidimin e Shqipërisë së vitit 1913, kurse pala tjetër, kryesisht deputetë të Partisë

⁴² *Po aty*, f. 376. Telegrami jepet në përkthimin në gjuhën shqipe sikurse u lexua në Parlament).

⁴³ *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. III, f. 173, 564.

⁴⁴ *Bisedimet parlamentare, 1920-1921...*, f. 387.

Përparimtare në opozitë, akuzonin pozitën se nuk i kushtonte vëmendjen, madje e kishte braktisur Kosovën.

Natyrisht situata i jepte të drejtë atyre që kërkonin të siguroheshin arritjet e vitit 1913. Demarshet e qeverisë shqiptare gjatë majit 1921 për të gjetur mirëkuptim në Beograd e Athinë lidhur me konfirmimin e kufijve dhe të statusit të Shqipërisë dhe për të siguruar tërheqjen e trupave të tyre nga zonat e okupuara brenda kufijve të 1913-ës, nuk kishin dhënë rezultat. Fqinjët nuk i pranuan kërkesat modeste e krejt të natyrshme shqiptare dhe mbi bazën e sipërpërmendur, nënshkrimin e marrëdhënieve dypalëshe. Beogradi e Athina nuk reagueshan pozitivisht as për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike.⁴⁵

Trokitja e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve më 29 prill 1921 dhe përsëri më 21 qershor për të gjetur mbështetje që t'i rinjiheshin kufijtë e 1913-ës dhe fqinjët të lironin territoret e shtetit shqiptar, ende të pushtuara prej tyre, nuk dha rezultatin e pritshëm. Pavarësisht nga argumentimi i kërkesës shqiptare, që bëri F. Noli në Lidhjen e Kombeve, se Shqipëria, si vend asnjans në Luftën e Parë Botërore, duhet të gjente zgjidhje për çështjen e kufijve nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve, ky forum ndërkombëtar pranoi sugjerimet e fqinjëve të Shqipërisë dhe më 26 qershor 1921 vendosi që kërkesa e Tiranës zyrtare të diskutohet nga Konferenca e Ambasadorëve të katër Fuqive të Mëdha (Angli, Francë, Itali dhe Japoni).⁴⁶

Në këtë terren të lëvizshëm rajonal e ndërkombëtar, por edhe brenda vendit, për shkak të rebelimit të kapedanit të Mirditës⁴⁷. (Më 17 korrik 1921, Markagjoni, madje kishte shpallur në Prizren “Republikën e Mirditës”), sigurisht çështja e Kosovës në Parlament nuk mund të diskutohet në kushte normale.

Në diskutimin e tij të datës 18 korrik 1921 me rastin e një interpelance ku 28 deputetë i kërkonin prononcim qeverisë për politikën e jashtme dhe për çështjen e mbrojtjes së shqiptarëve në Jugosllavi, deputeti i Partisë Popullore, Qazim Kokoshi, atakoi Ali Këlcyrën dhe Avni Gjilanin, duke u shprehur se pa të drejtë kishin thënë se “Partia Popullore kundërshton për çështjen e Kosovës” dhe se “kryetari i Partisë Popullore, Fan Noli, paska thënë në Romë se na duam të sigurojmë vetëm kufirin e 1913 dhe s’interesohe mi për Kosovë. Ky, u shpreh në një

⁴⁵ *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. III, f. 172-173.

⁴⁶ *Po aty*.

⁴⁷ S.Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 245-252.

pozicion mbrojtës Q. Kokoshi, nuk përfaqëson mendimin e Partisë Popullore, pse ky komision asht një komision i Qeverisë* e mund ta ketë thanë mbas instruksioneve që ka pasë prej Qeverisë”.⁴⁸

Qëndrimin dhe interesimin e qeverisë mbi “minoritetet shqiptare që janë jashtë kufirit”, pikërisht me këtë togfjalësh, e kërkoi me forcë H. Prishtina, më aktiv në debatin e radhës. Ai theksoi se Këshilli Kombëtar e ka pranuar këtë gjë, d.m.th. “me u interesue” dhe ka dhënë një vendim. “Qeveria çka do të thotë, përfundoi diskutimin H. Prishtina. Qeveria drejt për drejt s’ka m’u përzi në këtë punë”, prandaj të zgjidhet komisioni që do të shkonte në Evropë për të denoncuar terrorin serb ndaj shqiptarëve të Kosovës.⁴⁹

Më 10 shtator 1921 në mbledhjen e radhës së Parlamentit ku u diskutuan probleme të politikës u shtrua edhe një herë çështja e kufijve shqiptaro-jugosllavë, por jo edhe çështja e shqiptarëve të Kosovës. Duke qenë “kërkues i shpjegimeve”, pra, kërkues i interpelancës për Ministrinë e Punëve të Jashtme, “mbi gjendjen politike të jashtme të Shqipërisë”, Hasan Prishtina pyeti se përse çështja e Shqipërisë, veçanërisht për përcaktimin e kufijve, ishte lënë në dorë të Konferencës së Ambasadorëve, ç’masa kishte marrë qeveria për zgjidhjen e çështjes dhe për njohjen zyrtare të Shqipërisë prej shteteve të tjera, veçanërisht nga Fuqitë e Antantës etj. Në replikë me ministrin e Jashtëm ai theksoi armiqësinë e fqinjëve, Jugosllavisë e Greqisë ndaj Shqipërisë, por këtë herë nuk e ceku çështjen e shqiptarëve në Jugosllavi.⁵⁰ Në të njëjtën ditë ishte Luigj Gurakuqi, që, duke akuzuar Konferencën e Paqes dhe dirigjuesit e saj, theksoi se çështja e korigjimeve të padrejtësive të 1913-ës për caktimin e kufijve të Shqipërisë mund të quhej në tërësi pa shpresë. “Me gjithë këtë, u shpreh Gurakuqi, ka mbetur akoma një fill shprese, që, në mos tjetër, një pjesë e shqiptarëve të mbetur jashtë atdheut të futen në gjë të tij: Sikur e dini, tha ai, Traktati i Servres, atje ku flet mbi kufijtë e Jugës, të Jugosllavisë, thotë se këto kufi do të caktohen më vonë... Tue qenë se Jugo-Sllavia po e anekson Malin e Zi në bazë plebishiti..., shpreh shpresë Gurakuqi në fjalën e tij, Qeveria jonë të marrë masat e nevojshme për shpëtimin e shqiptarëve të Malit të Zi, që nuk

* Qeveria e Iljaz Vrionit (11.07-16.10.1921) ishte qeveri koalicioni. Shih edhe *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, vëll. III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: 2009, f. 2157.

⁴⁸ *Bisedimet parlamentare, 1920-1921...*, f. 388.

⁴⁹ *Po aty*, f. 390.

⁵⁰ *Po aty*, f. 507-509.

morën pjesë n'atë plebishit⁵¹... Asht detyrë e domosdoshme e Qeveris s'onë mos me lan këtë rast kaq të bukur për me fitue që të futi në gji t'Atdheut shqiptarët... e Pejës, Gjakovës, Plavës, Gusinjes, Hotit, Grudës, Trepshit, Kuçit, Ulqinit, Anës Malit e të Krajës, të cilët kanë qenë shqiptarë e dëshirojnë të jenë shqiptarë”.⁵²

Në dhjetor 1921, situata politike në Shqipëri kishte agravuar dukshëm. Acarimi deri në përplasje midis grupimeve politike ishte shfaqur hapur në të gjithë nivelet, që nga regjenca e Parlamenti deri te administratat lokale. Më 22 dhjetor 1921, në mbledhjen e 73 të Parlamentit, të legjislaturës në vijim, Hasan Prishtina u akuzua se duke bërë kauzë me d'Annunzio-n për të shpëtuar Fiumen, vuri në rrezik Shkodrën, që sigurisht do t'i kalonte Jugosllavisë, nëse Fiume i kalonte Italisë. Emërimi i tij kryeministër në dekretin e Aqif Pashës së Elbasanit, dhe imzot Bumçit (Dr. Turtulli nuk ndodhej, kurse Abdi Beu kundërshtoi), duke detyruar P. Evangjelin të jepte dorëheqjen, deklaruan deputetët e Partisë Popullore e zhyste në një “aventurë” shumë të rrezikshme shtetin shqiptar. Dihet çfarë ndodhi më pas dhe si pasoi largimi i shumë deputetëve nga Tirana drejt Elbasanit. Turbullirat e dimrit të vitit 1921-1922, që përveç problemeve e dasive të faktorit të brendshëm u dimensionuan edhe nga ndërhyrjet e llojllojshme të faktorit të jashtëm, gishti i të cilit ishte i pranishëm në të gjithë ngjarjet e kohës, natyrisht e nxorën jashtë vëmendjes çështjen e mbrojtjes së shqiptarëve që jetonin në trojet e tyre në Jugosllavi e Greqi nga dhuna shtetërore, që ushtrohej për motive nacionaliste e shoviniste.

Gjatë muajve në vijim, kjo çështje e Kosovës nuk do të diskutohej më në parlament. Gjendja e rëndë e krijuar në kufijtë shqiptaro-jugosllavë nga qëndrimi agresiv i Beogradit prej më shumë se një viti, vuri më në fund në lëvizje Britaninë e Madhe, e përmes saj, Lidhjen e Kombeve. Kryeministri Lloid Xhorxh, nëpërmjet një note, që i dërgoi më 7 nëntor 1921, Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, i kërkoi të thirrej Këshilli i Lidhjes dhe “të detyrohej qeveria e Beogradit, të respektonte Kartën e Lidhjes së Kombeve, përndryshe të merren ndaj saj masat ndëshkimore të parashikuara në nenin 16 të Kartës”.⁵³

Ndërhyrja britanike ishte efikase. Më 9 nëntor, Konferenca e Ambasadorëve njohu kufijtë e Shqipërisë, dhe Jugosllavia do të detyrohej t'i respektonte ato, por ndërkohë Shqipërinë e përfshiu kaosi nga lufta

⁵¹ *Po aty*, f. 509-511.

⁵² *Po aty*, f. 511.

⁵³ *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. III, f. 174.

e brendshme politike e sponsorizuar jo pak nga fqinjët⁵⁴. Kështu parlamenti i parë i zgjedhur, që filloi punën më 21 prill 1921, e mbylli vitin duke prodhuar fare pak rezultat për çështjen e shqiptarëve të Kosovës.⁵⁵ Madje, në periudhën janar-mars 1922, pozita miratoi krijimin e “Gjyqit të Lartë të Shtetit për ndjekjen e ministrave e deputetëve” kundërshtarë, “Ligjin kundër të arratisurve”, “Ligjin për çarmatimin e popullsisë”, kurse në mars opozita, përkatësisht B. Curri, Mustafa Kruja, Hamit Top-tani, Elez Isufi, Hasan Prishtina etj., filluan kryengritjen kundër qeverisë. Problemet e brendshme të tilla dhe situata ndërkombëtare nuk jepnin shanse për t’u ardhur në ndihmë shqiptarëve në Kosovë e në viset e tjera të lëna jashtë shtetit shqiptar.

Në diskutimet parlamentare të vitit 1922, 1923 dhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 1924, sikurse u përmend, çështja e rregullimit të kufijve të Shqipërisë me fqinjët mbeti një çështje që priste të hapej pas vendimit të ndërkombëtarëve për vise të diskutueshme si territoret e Manastirit të Shën Naumit dhe të Vermoshit, kurse çështja e mbrojtjes së popullsisë shqiptare në Kosovë, Çamëri e vise të tjera, nuk u debata.⁵⁶ Gjatë vitit 1923 partitë “Popullore” e “Përparimtare” ishin shpërndarë. Gjatë rigrupimit të forcave u riformatuan dy grupime të reja, të drejtuara përkatësisht nga A. Zogu dhe F. Noli (të parët kishin pozitën në pushtetin e kohës, të dytët përbënin opozitën). Vëmendja u përqendrua në zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese, e cila do të përcaktonte formën e regjimit dhe do të miratonte Kushtetutën (Ligji u miratua më 30 shtator dhe zgjedhjet që nxorën 102 asamblistët, u zhvilluan më 27 dhjetor). Në këtë situatë, vetëm në një rast, në mars 1924 qeveria shqiptare e kryesuar nga Shefqet Vërlaci, protestoi në Lidhjen e Kombeve. Kjo u bë për masakrën që forcat ushtarake jugosllave bënë në zonën e Vushtrrisë (Dubnicë-Zagorth)⁵⁷.

Në një kohë kur pas konfrontimeve të përsëritura edhe me armë, deputetët në opozitë me qeverinë ishin reduktuar dhe kur elita politike në Shqipëri dhe krahu i saj i armatosur, i përbërë masivisht nga kaçakët e Kosovës, në të dy anët e kufirit politik i ishin kundërvënë pozitës në pushtet në Tiranën zyrtare, kuptohet se nuk kishte gjasa të diskutohej për çështjen e Kosovës. “Zona Neutrale e Junikut”, malet e Dibrës, Malësitë e Veriut etj., ku strehoheshin luftëtarët kryengritës ndaj të dy

⁵⁴ *Po aty*, f. 564.

⁵⁵ *Bisedimet Parlamentare...*, 1920-1921, f. 187-884.

⁵⁶ *Bisedimet parlamentare*, 1922/1, 1922/2, 1923/1, 1923/2.

⁵⁷ Marenglen Verli, *Kosova, sfida shqiptare në historinë e një shekulli*, Tiranë: Botimpex, 2007, f. 115; shih dhe *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, vëll.III..., f. 2158.

qeverive, asaj të Tiranës dhe asaj të Beogradit, ishin caqet që ata të kishin interesa të njëjta përkatësisht vendosjen e rendit, apo pacifikimin e zonave kryengritëse. Kështu, probleme kufitare-territoriale dhe probleme të mbrojtjes së popullsisë shqiptare në Kosovë, u lanë për t'u trajtuar në një kohë të ardhshme.

Në vitin 1924 ndodhën ngjarjet e njohura që filluan me atentate dhe përfunduan fillimisht, në qershor, me largimin e grupimit të A. Zogut nga pushteti dhe me marrjen e frenave në qeverisjen e vendit nga kryengritësit apo opozitarët e viteve 1921-1924, të cilët vunë Kryeministër, Fan Nolin. Është me interes të përmendim se qeveria e re nuk futi në përbërjen e saj elementë nga Kosova. Ata, e veçanërisht B. Curri, u mbajtën afër, por liberalët vlerësuan njësoj si konkurrentët e tyre konservatorë, që patën pushtetin deri në qershor, se mbështetja e irredentistëve haptazi mund të krijonte probleme jo vetëm me fqinjët, por edhe në arenën ndërkombëtare. Edhe qeveria e F.Nolit protestoi në Lidhjen e Kombeve në një rast, pikërisht në korrik-gusht, kur terrori i forcave jugosllave përfshiu zonën e Drenicës⁵⁸, por Shqipëria e pastabilizuar, e dobët dhe pa mbështetje, gjatë viteve 1920-1924 nuk mund të bënte më tepër.

Përfundime

Mbi bazën e dokumentacionit të viteve 1920-1924, që pasqyron jetën parlamentare e më gjerë, dhe veprimtarinë e parlamentit, qeverive dhe përgjithësisht të elitës politike të kohës lidhur me çështjen e Kosovës, qoftë territoriale, apo për të drejtat kombëtare e njerëzore, dalin disa konkluzione e përcillen disa mesazhe me vlerë aktuale.

Së pari, duhet theksuar se aspekti i çështjes që ka të bëjë me pretendimet territoriale, përkatësisht rikthim brenda shtetit shqiptar të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare të shkëputura në 1913-ën, qysh në muajt e parë të vitit 1920, konsiderohej një çështje e mbyllur për shkak të qëndrimit pa ekuivoke të Fuqive të Mëdha. Për trajtim të mëtejshëm ishte lënë vetëm ratifikimi në disa segmente, i kufirit të 1913-ës. Aspekti tjetër i çështjes së Kosovës lidhet me mbrojtjen e të drejtave kombëtare e njerëzore të popullsisë shqiptare që do të duhej të jetonte

⁵⁸ *Po aty.*

në shtetet fqinjë sipas normave të fiksuara në legjislacionin ndërkombëtar për mbrojtjen e minoriteteve.

de savoir à quelle communauté appartenait un acteur public par des sources écrites. C'est lors d'une entrevue avec le fils de l'un des députés démocrates d'Adana, qu'il m'a été donné de comprendre qui était d'origine arabe parmi les élus. Je lui ai montré la liste, il m'a simplement désigné tous ceux qui étaient d'origine arabe⁹, ce qui montre bien que l'appartenance ethnique des hommes politiques était bien connue sans qu'il en soit fait mention publiquement.

J'ai donc dû compléter cette étude de la presse locale: il m'a fallu rassembler des bouts éparés, combiner des sources très différentes par leur forme, mémoires d'acteurs de la période, rapports diplomatiques, documents tirés des archives de la présidence du conseil à Ankara, ouvrages de savants locaux.

Faire feu de tout bois

D'autres sources extrêmement précieuses pour notre étude du local sont les mémoires de figures politiques et d'hommes d'affaires locaux, qui donnent des témoignages vivants de la période (Has 2002; Sadun 1988). Les mémoires de Rifki Salim Burçak, qui a dirigé la politique locale dans la région d'Erzurum pendant toute la décennie démocrate, et qui, ayant été plusieurs fois ministre, disposait d'un accès au cœur du pouvoir à Ankara, nous ont offert des renseignements très intéressants sur le fonctionnement informel du parti au niveau national (Burçak 1998). D'autres livrent des renseignements utiles pour une perception plus fine des rapports de force et de rivalité au sein du parti, ou même au sein du monde des affaires. D'autres ouvrages, enfin, donnent à comprendre les perceptions d'une certaine génération, ou d'un certain groupe: ainsi des mémoires de nombreux hommes politiques kurdes et témoins de la période (Miroğlu 2005; Ekinci 2010; Anter 2007). L'analyse des informations conservées dans ce genre de sources exige la distance critique que nécessite toute étude de discours énoncés à la première personne.

Les ouvrages sociologiques contemporains de la période étudiée, publiés en turc ou en anglais, donnent une foule d'informations sur la vie politique au village, et plus largement sur la vie quotidienne d'un paysan, ou sur les transformations économiques et sociales de la période. Les excellents ouvrages de Paul Stirling, même s'ils ne portent

⁹ Seul l'un des députés a fait l'objet d'une hésitation de sa part.

sur aucune des régions choisies dans le cadre de notre thèse, sont indispensables pour comprendre la vie d'un village turc dans les années 1950. Fin anthropologue, Paul Stirling a saisi et expliqué, à l'échelle du village turc, les rapports de force, les potentiels conflits et ségrégations spatiales, les enjeux liés à l'argent, toutes dimensions indispensables pour comprendre comment la politique peut s'insérer dans les enjeux du village (Stirling 1965). Il en va de même pour Joseph Szyliowicz, qui a décrit de façon extrêmement détaillée le fonctionnement de l'arène politique dans un village situé non loin d'Adana (Szyliowicz 1966). Behice Boran, anthropologue marxiste, qui a publié en 1938 une étude sur plusieurs villages de la région de Manisa, décrit la vie de plusieurs villages, tout comme Niyazi Berkes et Ibrahim Yaşa (Boran 1994 [1945]; Berkas 1942). À la faveur, précisément, d'une étude de la région d'Adana au début des années 1960, Mübeccel Kıray se fait quant à elle l'observatrice des changements à l'œuvre depuis la fin des années 1940, ce qui donne à comprendre de façon beaucoup plus précise les enjeux politiques dont ce territoire fut le théâtre (Kıray 2000 [1970]). Quelques productions géographiques contemporaines de la période contiennent aussi des notations intéressantes (De Planhol 1958).

Les érudits locaux représentent également une source très importante. Animés par un souci de conservation, ils consignent très précisément des informations portant sur le folklore ou l'histoire d'une région qui, si elles ne semblent pas directement concerner la politique, peuvent se révéler très utiles. Un ouvrage relatant la vie de plusieurs maîtres en religion d'Erzurum montre ainsi leurs liens étroits avec plusieurs personnalités locales du Parti démocrate (Aras 2007). Un autre ouvrage sur les « coutumes » à Erzurum nous révèle les traditions encore très vivantes des corporations d'artisans dans les années 1950 (Himoğlu 2015).

Certains rapports diplomatiques peuvent donner quelques renseignements, lorsqu'y sont traités des sujets sociaux, tels que les conditions de vie des ouvriers, ou lorsqu'y sont abordés des problématiques locales— par exemple, lors des élections de 1957, l'ambassade de France a produit plusieurs cartes relatives aux résultats. C'est grâce à un dossier diplomatique que j'ai pris connaissance de l'importance du mécontentement ouvrier vers la fin des années 1950 – il n'en était pas question dans la presse, qui faisait l'objet d'une censure sévère sur ces sujets. Les archives britanniques contiennent des biographies détaillées de plusieurs personnalités (« *leading personalities* »), parmi lesquelles

des députés influents à Ankara et disposant d'un ancrage local en province. D'autres rapports d'observateurs étrangers, tels que les lettres de Robinson, jeune étudiant américain résidant en Turquie de 1948 à 1955, au *Institute of Current World Affairs*, ont la forme de comptes rendus très détaillés de voyages en Turquie.

Conclusion

Outre de proposer un ensemble de sources non-institutionnelles, qui, après divers recoupements, renseignent sur les partis politiques, j'ai voulu souligner, dans cet article, le biais que peuvent introduire les sources institutionnelles pour étudier un parti politique dans l'histoire. Elles poussent à donner aux règles formelles de fonctionnement du parti une importance qu'elles n'avaient probablement pas. L'absence de sources institutionnelles pousse au contraire à se confronter au fonctionnement informel du parti, et à nourrir une réflexion sur les pratiques quotidiennes de la politique.

Ouvrages cités

- Anter, Musa. 2007. *Hatıralarım* [Mes souvenirs], 2 volumes, Istanbul, Avesta.
- Aras, Sıtkı. 2007. *Erzurum'un Manevi Mimarları*, [Les architectes moraux d'Erzurum], Istanbul, Dergah yayınları/ Erzurum Kitaplığı.
- Berkes, Niyazi. 1942. *Bazı Ankara köyleri üzerinde bir araştırma* [Une enquête sur quelques villages d'Ankara], Ankara, Dil ve Tarih-Coğrafya Fakültesi Felsefe Enstitüsü yayınları.
- Boran, Behice. 1992 [1945]. *Toplumsal yapı araştırmaları: iki köy çeşidinin mukayeseli tetkiki*. [Recherches sur les structures sociales: une étude comparée de deux types de villages], Istanbul, Sarmal Yayınevi.
- Brockett, Gavin. 2011. *How Happy to Call Oneself a Turk: Provincial Newspapers and the Negotiation of a Muslim National Identity*. Austin, University of Texas Press.
- Burçak, Rıfkı Salim. 1998. *On Yılın Anıları* [Souvenirs d'une décennie], Ankara, Dağıtım Dergah Yayınları.
- Ekinci Tarık Ziya. 2010. *Lice'den Paris'e anılarım*. [Mes mémoires, de Lice à Paris]. Istanbul, İletişim yayınları.
- Gauvard, Claude et Sirinelli, Jean-François (dir.). 2015. *Dictionnaire de l'historien*, Paris, PUF, article « presse ».
- Geçikli, Recep Murat. 2010. *1946-1960 Yılları Arasında Erzurum'da Siyasi Hayat* [La vie politique à Erzurum de 1946 à 1960], Ankara, Atatürk Araştırma Merkezi.
- Gülalp Cevdet Naci, *Adana'yı Seviyorum* [J'aime Adana], Alev Dikici Ofset, Adana, 2007, p. 12.
- Has, Kadir. 2002. *Vatan borcu ödüyorum* [Je paie ma dette à la patrie], édité par Hulusi Turgut, Istanbul, ABC yayım ajansı.
- Himoğlu, Mücahit. 2015. *Tarihe Mühürünü Vuran Şehir Erzurum* [Erzurum, la ville qui marque l'histoire de son sceau]. Istanbul, Fener yayınları.
- Kıray, Mübeccel. 2000 [1970]. *Sosyo-Ekonomik Hayatın Değişen Düzeni: Dört Köyün Monografik Karşılaştırması* [Les changements socio-économiques: une comparaison monographique de quatre villages], Istanbul, Bağlam yayınları.
- Küçükkuşurlu, Murat. 2012. *Türk siyasi tarihinde Erzurum (1923-1950)* [Erzurum dans l'histoire politique turque (1923-1950)], Ankara, Atatürk Araştırma Merkezi.
- Magnarella, Paul. 1974. *Tradition and Change in a Turkish Town*, New-York, John Wiley and Sons.

- Miroğlu, Orhan. 2005. *Hevsel bahçesinde bir dut ağacı: Canip Yıldırım'la söyleşi* [Un mûrier dans le jardin du paradis, entretien avec Canip Yıldırım]. Istanbul, İletişim yayınları.
- (de) Planhol, Xavier. 1958. *De la plaine pamphylienne aux lacs pisidiens, nomadisme et vie paysanne*, Paris, Adrien Maisonneuve, Bibliothèque de l'Institut Français d'Archéologie d'Istanbul.
- Robinson, Richard. 1955. Lettre au *Institute of Current World Affairs*, « Gaziantep after five years », lettre du 10 mai 1955.
- Sadun, Tanju. 1988 [1983]. *Hacı Ömer Sabancı, The turkish village boy who built an industrial empire*, traduit du turc par Geoffrey Lewis, Londres, World of information.
- Stirling, Paul. 1965. *Turkish Village*, Londres, Wiley.
- Szyliowicz, Joseph, *Political Change in Rural Turkey: Erdemli*, New-York, Mouton, 1966.
- Türkdoğan, Orhan. 1965. *Erzurum ve çevresinde sosyal araştırmalar* [Recherches sociales à Erzurum et dans ses alentours], Ankara, Ankara Üniversitesi Basımevi.
- Türkmen, Parlak. 1989. *Yeni Asır'ın İzmir yılları*, [Yeni Asır [le siècle nouveau]: les années Izmir], 4 volumes, Izmir, Yeni Asır Yayını.
- Zürcher, Erik Jan. 2004. *Turkey, a modern history*, Londres, IB Tauris.




Figure 1. Carte de l'ambassade de France en Turquie, qui exploite les résultats des élections parlementaires de 1957

12 MAYIS PAZARTESİ 1958

DOĞU

İhtiyaz sabihı
Ve
Yeni İhtiyaz Fikri İhtiyaz Etkin
Türhan BİLGİN

TELEFONLAR : 2715 (Başmüdürlük) 2716 (Yaz İşleri) 2725

HAUKA TAPAR HAKKI TUTAR

VİLL 7. SAK. 16.1758 ERZURUM'DA ÇIKARILAN GÜNLÜK MUSTAKİL SİYASİ GAZETE FİATLI 1.60 KURUS

DZİLP BASILDIĞIYER DOĞU MATBAASI - ERZURUM

İlca Belediye Seçimleri Nihai Karara Bağlandı

Yüksek seçim kurulu D.P'nin itirazını reddederek C.H. Partisinin kazandığı seçimleri tasdik etti

Son dakikada alınan kararın ilca Belediye seçimi için D.P'nin itirazını reddederek C.H.P'nin kazandığı seçimi tasdik etmiştir.

Bu karar üzerine C.H.P'nin derhal Vilâyet mücazasatı ederek İlca Belediye meclisinin

hemeyn toplanması için gereken formaliteyi ikmal etmişlerdir.

İlca Belediye retliğine C.H.P. İl idare kurulu yerlerinden Cevdet

İlca'nın getirilmesi tasdik etmiştir.

Belediye Mevzuunda Kısa bir tetkik

Memleketin kalkınmasında, vatandaşın refah ve vâkıfında derin hissettiren bir mesele olan belediye mevzuatının, mahallî idareler için ve bu idarelerin faaliyetlerinde başarılı olmalarını sağlamak üzere, önem arz eden bir mesele olarak karşımıza çıkmaktadır. Belediye mevzuatının, memleketin kalkınmasında, vatandaşın refah ve vâkıfında derin hissettiren bir mesele olarak karşımıza çıkmaktadır.

Meselenin birz derinine inelim :

Demokrasinin en mühim vâkıfı, vatandaşların hâkimiyetinde olmasıdır. Bu hâkimiyetin, memleketin kalkınmasında, vatandaşın refah ve vâkıfında derin hissettiren bir mesele olarak karşımıza çıkmaktadır.

1 Nisan 1951 tarihli vâkıflar kanunu ile teklif olunan ilca belediyesi mevzuatı 2. Nisan 1952 tarihli raporda 1580 sayılı Belediye Kanunu Anlatım Demokrasinin birz derinine inelim :

İlca belediyesi mevzuatının, mahallî idareler için ve bu idarelerin faaliyetlerinde başarılı olmalarını sağlamak üzere, önem arz eden bir mesele olarak karşımıza çıkmaktadır.

1 Nisan 1951 tarihli vâkıflar kanunu ile teklif olunan ilca belediyesi mevzuatı 2. Nisan 1952 tarihli raporda 1580 sayılı Belediye Kanunu Anlatım Demokrasinin birz derinine inelim :

İlca belediyesi mevzuatının, mahallî idareler için ve bu idarelerin faaliyetlerinde başarılı olmalarını sağlamak üzere, önem arz eden bir mesele olarak karşımıza çıkmaktadır.



Cevdet İlca

Erzuruma Uçak Seferleri Ne Zaman Başlayacak ?

İlgililerin bir an önce harekete geçmesini ve zaman kaybetmemesini istirham ediyoruz

Mayıs ayının ortalarına gelinceye kadar Erzurum Uçak seferleri bir türlü işletmeye açılmamıştır. Trabzon, Elazığ, Diyarbakır ve Malatyaya Bütün yıl boyunca Uçak seferleri yapılmamıştır. Erzurum seferleri sonbahar ayında nihayete enirilmekte

Erzurum Uçak seferleri bir türlü işletmeye açılmamıştır. Trabzon, Elazığ, Diyarbakır ve Malatyaya Bütün yıl boyunca Uçak seferleri yapılmamıştır. Erzurum seferleri sonbahar ayında nihayete enirilmekte

Atık Palandöken'in KADROSU KALDIRILDI

D.P. İkinci Başkanı bu suretle Et Kombinası müşavirliğinden uzaklaştırıldı

Bundan bir müddet önce Erzurum Et Kombinası müşavirliğine tayin olan ghereim D. P. Vilâyet ikinci reisi Atık Palandökenin (Müşavirlik kadrosu kaldırılmak suretiyle) Kombina ile ilişkisinin kesildiği öğrenilmiştir.

Hususi itibarlarımızıza göre, Atık Palandöken



ATIK PALANDÖKEN

KISA BİR İZAH

Okuyucularımızın devamı istediği kâğıda basılı bir izah bulabilirsiniz. İlca belediyesi mevzuatının, mahallî idareler için ve bu idarelerin faaliyetlerinde başarılı olmalarını sağlamak üzere, önem arz eden bir mesele olarak karşımıza çıkmaktadır.



Selahaddin Bakıroğlu

Emniyet Müdürümüz Mardine tayin edildi

Selahaddin Bakıroğlu'nun Politiği sebebi r yazdının nakle edildiği Söylüyor



Selahaddin Bakıroğlu

Figure 2. Page of garde d'un journal local d'Erzurum, le 12 mai 1958. On y distingue des photographies d'hommes politiques locaux.



Figure 3. Photographie tirée d'un ouvrage de géographie tiré d'une recherche réalisée dans les années 1950. Elle montre un village d' « immigrés », construit par le gouvernement turc pour accueillir des réfugiés des Balkans. La régularité géométrique de la construction est très frappante; on constate que ce village n'est pas habité au moment où la photo a été prise.

Gëzim Selaci¹

JU, POPULLI I KOSOVËS: DISA KONSIDERATA PËR LEGJITIMITETIN E KUSHTETUTËBËRJES NDËRKOMBËTARE²

Abstrakt

Ky artikull shqyrton legjitimitetin e kushtetutëbërjes ndërkombëtare ndërhyrjes ndërkombëtare në procesin e hartimit dhe në përmbajtjen e kushtetutës së një vendi, në kontekst të praktikës së paqeruajtjes dhe shtetndërtimit ndërkombëtar. Artikulli analizon procedurën dhe përmbajtjen e kushtetutëbërjes, aktorët e përfshirë dhe rolin e tyre në të. Analiza e këtyre dimensioneve të kushtetutëbërjes ndërkombëtare ndihmon në kërkimin e përgjigjeve të pyetjeve që i shtron artikulli, të cilat kanë të bëjnë me pretendimet e autoritetit ndërkombëtar për të drejtën e tij në pushtet kushtetutëvënës, me bazën e këtij pretendimi dhe me subjektet nga të cilët pranohet ose jo pretendimi i tillë. Diskutimi përqendrohet në rastin e kushtetutëbërjes ndërkombëtare në Kosovë, që klasifikohet si “ndikim total”, domethënë ndikim i plotë i autoritetit ndërkombëtar në kushtetutëbërje, si në procesin e hartimit ashtu dhe në përmbajtjen e kushtetutës. Në këtë artikull, legjitimiteti i kushtetutëbërjes ndërkombëtare vlerësohet në dy nivele: në nivelin e jashtëm ose ndërkombëtar dhe në nivelin e brendshëm ose vendor, ku në secilin vlejnë norma të posaçme legjitimuese. Për t’u legjitimuar si proces dhe si përmbajtje, kushtetutëbërja ndërkombëtare duhet të përputhet, së paku deri në një masë, me ato norma dhe t’i realizojë kërkesat e tyre.

Hyrje: Çfarë është legjitimiteti politik dhe cila është rëndësia e tij?

Legjitimiteti politik merret me problemin e natyrës hierarkike dhe arbitrare të marrëdhënieve të pushtetit. Problematizimi i marrëdhënieve të këtij lloji shtron pyetjet kyç: nga buron e drejta për të sunduar mbi ose qeverisur të tjerët; përse i njihet dikujt ushtrimi i pushtetit mbi të

¹ Profesor Asistent në Departamentin e Sociologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës.

² Ky artikull është version i rishikuar i Kapitullit 10 të librit “Legjitimiteti politik në Kosovë” nga Gëzim Selaci (Prishtinë: Artini, 2019).

tjerët; si dhe nga kush u njihet kjo e drejtë sundimtarëve dhe qeveritarëve.

Duke qenë në fillim një koncept që kuptohej me terma juridikë, ku “legjitimiteti” kishte kuptimin me qenë në përputhje me ligjin, ai u mor për diskutim edhe në filozofinë politike, ku mori kuptime e nënkuptime normative. Ishte Max Weber ai që vuri themelet e analizës empirike të konceptit të legjitimitetit, teksa e përkufizonte një autoritet ose rend legjitim si një sistem normativ që ekziston dhe mbahet, sepse aktorët besojnë se ai është i duhur apo i drejtë (Weber, 1978: 36). Koncepti weberian i legjitimitetit si besim në legjitimitet, është i dukshëm te një pjesë e studiuesve, si, ta zëmë, David Easton i cili legjitimitetin politik e kishte konceptuar si “mbështetje politike” dhe e kishte përkufizuar si “besim i qytetarëve se është e drejtë dhe e duhur t’u binden autoriteteve dhe t’u përmbahen kërkesave të regjimit” (Easton, 1975: 436).

Duke u nisur nga kuptimet empirike të legjitimitetit të autoritet politik, le ta përkufizojmë konceptin “legjitimitet” si besim se një autoritet është në pajtim me parimet e së drejtës, pra është krijuar në bazë të procedurave të justifikuara dhe funksionon në bazë të rregullave ekzistuese që mbështetet në ide e vlera të përbashkëta të autoritetit dhe të subjekteve të atij autoriteti dhe që rezulton në vendime që besohet se janë në interes të subjekteve që i nënshtrohen atij autoriteti. Me një fjalë, autoriteti legjitim ka të bëjë me besimin në të drejtën morale të tij për të nxjerrë urdhra dhe për t’i zbatuar ato.

Kur flasim për “legjitimitetin” si gjendje dhe “legjitimen” si atribut (për shembull “autoritet legjitim”), është e nevojshme të dallojmë edhe procesin ose rrugën përmes së cilës arrihen ato, të cilën e emërojmë me termin “legjitimim”. Ky term tërheq vëmendjen ndaj mënyrës së pranimit të një autoriteti si legjitim, pra i referohet procesit dyfaqësh të pretendimit të legjitimitetit dhe të njohjes së tij. Rëndësia e këtij koncepti qartësohet sidomos kur analizohen strategjitë legjitimuese të një autoriteti, domethënë përpjekjet e tij për t’u legjitimuar, si dhe pranimi, njohja (ose mosnjohja) e këtyre pretendimeve nga të tjerët.

Legjitimiteti politik ka një rëndësi kyçe në marrëdhëniet e pushtetit, pasi ai ka të bëjë me aspektin moral të një marrëdhënieje të tillë. Ai jep shpjegim për të drejtën e sunduesve për të sunduar dhe bindjen e subjekteve ndaj tyre (Beetham, 1991: 25—26). Studiuesit theksojnë rëndësinë e legjitimitetit për ndërtimim e shtetit dhe konsolidimin e demokracisë (Linz and Stepan, 1996: 438) dhe argumentojnë se çfarëdo regjimi, demokratik ose jodemokratik, në mungesë legjitimiteti do të

lëngojë nga nivele të ulëta të mbështetjes politike dhe do të duhet ta ushtrojë pushtetin me një kosto shumë të lartë, si për shembull me ushtrim të forcës së ashpër ose me detyrim për të zbatuar politikat e caktuara (Fraser, 1974: 119).

Rëndësia e kushtetutëbërjes në legjitimimin e rregullave dhe institucioneve të qeverisjes

Në periudhën e pasluftës në Kosovë, domethënë prej qershorit të vitit 1999, legjitimiteti politik duhet të analizohet në kontekst të dinamikës politike, në të cilin sistemi politik i imponuar nga Serbia u rrënuar dhe ishte e nevojshme të krijohet një sistem i ri dhe institucionet politike të tij. Një analizë e tillë mund të përfshijë proceset politike të paqëndrueshmërisë,² shtetndërtimit³ dhe kushtetutëbërjes. Në fokus të analizës së këtij artikulli kam kushtetutëbërjen ndërkombëtare, që i referohet ndërhyrjes ndërkombëtare në procesin e hartimit dhe në përmbajtjen e kushtetutës së një vendi, në kontekst të praktikës së paqeruajtjes dhe shtetndërtimit ndërkombëtar. Para se të shqyrtoj në hollësi legjitimitetin politik të kësaj dukurie, duke marrë si rast për studim kushtetutëbërjen ndërkombëtare në Kosovë, në vijim drejtoi vëmendjen në rolin e kushtetutëbërjes në një shoqëri të pas konfliktit.

Në shoqëritë pas konfliktit, planifikimi i procesit të kushtetutëbërjes dhe hartimi i përmbajtjes së kushtetutës mund të luajë rol të rëndësishëm në tranzicionin e qeverisjes. Një rol i tillë është në dy drejtime: së pari, kushtetutëbërja pas konfliktit është rast për të krijuar një vizion të përbashkët për të ardhmen e shtetit dhe një hartë se si të

² Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së në vitin 1997 e ka përkufizuar paqëndrueshmërinë si veprime të ndërmarra me qëllim për t'i dhënë fund konfliktit, për të forcuar paqen dhe parandaluar kthimin e konfrontimit të armatosur. Që t'i kontribuojë këtij qëllimi, paqëndrueshmëria kërkon arritjen e paqes përmes realizimit të një shkalle të drejtësisë dhe pajtimit, si dhe zhvillimin në vendet përkatëse. Paqja, pra, ndërlihet me drejtësinë në afat më të gjatë dhe më të shkurtër. Kjo përfshin drejtësinë korrigjuese (*rectificatory*) dhe shpërndarëse (*distributive*), si edhe rikthimin e rikrijimin e sundimit të ligjit. Pajtimi dhe zhvillimi nuk mund të arrihet pa i adresuar shkaktarët rrënjësorë të konfliktit në kornizat ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe kujdesin për barazi dhe dinjitet për çdo qenie njerëzore... (Morphet, 2002: 141).

³ Termi “shtetndërtim” i referohet angazhimit ndërkombëtar në ndërtimin ose rindërtimin e institucioneve të qeverisjes përmes ndihmës në krijimin e sistemeve të zgjedhjeve, sundimit të ligjit, mbrojtjes së të drejtave të njeriut, reformimit të sektorit të sigurisë dhe zhvillimit (Chesterman, 2004: 5).

arrihet atje, dhe së dyti, kushtetuta është si një marrëveshje e paqes dhe vendosëse e rregullave se si do të funksionojë demokracia e re. Kështu, një proces ideal i kushtetutëbërjes mund të ndihmojë procesin e kalimit nga konflikti në paqe, duke vënë bazat e rregullave përmes të cilave kërkohet zgjidhje politike dhe paqësore e konfliktit. Si zgjidhje e tillë, kushtetuta parasheh mekanizmat dhe institucionet për zgjidhje politike të konflikteve të ardhshme duke formuar kornizën qeverisëse që rregullon aksesin në pushtet dhe burime—të gjitha këto arsye për konflikt (Samuels, 2006: 664).

Tranzicioni pas konfliktit kërkon jo vetëm ndryshime institucionale, por edhe shndërrime të kulturës politike të një shoqërie dhe ndryshime të normave dhe sjelljes politike. Kuptimi i dytë i tranzicionit kërkon kohë më të gjatë dhe strategji afatgjate që përfshin segmente më të gjera të shoqërisë në dialog politik dhe ndërtim të konsensusit shoqëror. Një proces i kushtetutëbërjes që është pjesëmarrës, domethënë që përfshin segmente të gjera të shoqërisë, mundëson një lloj dialogu që synon konsensusin për rregullat politike, dhe, në këtë mënyrë, mundëson ndërtimin e paqes dhe legjitimitetit (Samuels, 2006: 667).

Pra, koncepti i kushtetutëbërjes si rrugë e ndërtimit të paqes dhe si legjitimim i rregullave politike, shkon përtej konceptit të kushtetutëbërjes si ndërtim ose rindërtim teknik i institucioneve politike. Në rastin e Kosovës kushtetutëbërja e udhëhequr nga aktorët ndërkombëtarë ka qenë një shans për dialog drejt ndërtimit të paqes në shoqërinë e përcarë pas konfliktit. Një proces pjesëmarrës i kushtetutëbërjes në Kosovë ka mundur të ofrojë një forum për të negociuar mospajtimet që kanë çuar në konflikt, për të arritur te një marrëveshje se si të tejkalohen ato dhe për të ndërtuar konsensusin për një vizion për të ardhmen e shoqërisë së re, rrjedhimisht për të ndërtuar paqen në shoqërinë e përcarë pas konfliktit dhe për të legjitimuar rregullat dhe institucionet politike të shtetit të ri.

A mund të flitet për legjitimitetin e kushtetutëbërjes ndërkombëtare?

Ndërhyrja ose ndikimi i drejtpërdrejtë i jashtëm në kushtetutëbërje, qoftë në procesin a në përmbajtjen e saj, paraqet problem për legjitimitetin e kushtetutëbërjes, andaj duhet të merret në shqyrim të kujdesshëm. Arsyja e kësaj është se, sipas traditës ose konceptit të sovranitetit të popullit, kushtetuta përbën aktin fundamental të *pouvoir*

constituant-it (pushtetit konstituent), që domethënë se populli është forca konstitutive, pra trupi politik që e krijon rendin kushtetues. Kështu, sipas parimit demokratik, kushtetutëbërja shpreh “aktin më fundamental të vetëqeverisjes së një populli” (Dann and Al-Ali, 2006: 426).

Natyrisht, një pikëpamje e tillë mund të kritikohet si “vetëm një mitologji politike” pasi, “populli sovran” nuk ekziston para kushtetutës, si dokument që e konstituon atë si identitet ligjor i aftë të veprorë (Arato, 2009: 258). Pra, ndonëse pretendohet se kushtetuta buron nga populli sovran, në të vërtetë, është e kundërta: kushtetuta e sjell në ekzistencë ligjore popullin, domethënë e krijon popullin sovran si entitet ligjor.

Pra, kushtetuta e krijon “popullin” si entitet ligjor me anë të një fillimi jopopullor dhe e themelon përfaqësimin politik të popullit. Këto dy momente pasqyrohen në formulën “Ne, populli...”, me të cilën hapen shumë kushtetuta dhe në të cilën dy forma të “ne-së”: (a) “ne-ja” si “autor” që asnjëherë nuk vepron dhe (b) “ne-ja” si “aktori” që flet në emër të popullit, por që vetë nuk është “populli”. Kjo “ne” vepruese pretendon se është “përfaqësuese” e popullit si autor dhe rrjedhimisht pretendon të drejtën të veprorë në emër të tij. Ky akt nga një agjent i vetëmëruar, legjitimohet për aq sa kushtetuta e prodhuar nga aktori ose agjenti që flet në emër të “popullit” i kontribuon krijimit të autorit të saj, domethënë popullit (Arato, 2009: 258).

Ky agjent, sipas parimit të sovranitetit popullor, janë përfaqësuesit e popullit, por tradita e kushtetutëbërjes ndërkombëtare nuk e përjashton që mund të jetë një agjent ndërkombëtar që flet në emër të popullit, pa pretendime për përfaqësim të popullit. Në rastet e tilla, fraza “Ne, populli...”, në të vërtetë, nuk u referohet përfaqësuesëve politikë të popullit, që kanë të drejtë të flasin në vetën e parë bashkë *me* popullin, por agjentit ndërkombëtar i cili flet *për* popullin dhe i cili nuk mund të përfshihet në një “ne” me popullin, pasi nuk mund të pretendojë përfaqësim politik të popullit. Andaj, në këto raste, formula “Ne, populli...”, më e drejtë është të lexohet si “Ju, populli...”, që jep të kuptohet se agjenti ndërkombëtar flet në emër të popullit ose për të dhe jo si përfaqësues i tij. Dhe, për aq sa ky agjent, pavarësisht nëse është vendor a ndërkombëtar, pretendon pushtetin kushtetutëvënës, ky pretendim mund të studiohet duke e shqyrtuar nën prizmin e legjitimitetit.

Si të studiohet legjitimiteti i kushtetutëbërjes ndërkombëtare në Kosovë?

Në këtë artikull, kushtetutëbërja ndërkombëtare në Kosovë u referohet ndërhyrjes vendimtare të administratës dhe aktorëve ndërkombëtarë në Kosovën e pasluftës, veçanërisht të Përfaqësuesit Civilë Ndërkombëtarë, në procesin e hartimit dhe në përmbajtjen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës të miratuar në vitin 2008. Legjitimiteti i kushtetutëbërjes në Kosovë mund të studiohet duke këqyrë në dy aspekte. Së pari, në aspektin procedural, domethënë duke parë nëse kushtetuta është hartuar në një proces të pranueshëm ligjor që ka përfshirë edhe aktorët vendorë në procesin kushtetutëbërës. Aspekti tjetër ka të bëjë me përmbajtjen e kushtetutës dhe nëse ajo ka mundësi t'i kryejë funksionet të cilat pritet t'i kryejë.

Pyetja kyçe që e orienton këtë analizë ka të bëjë me bazën e legjitimitetit të administratës së përkohshme ndërkombëtare në Kosovë për të diktuar një kushtetutë për Kosovën. Kjo pyetje mund të zbërthehet në nënpyetjet vijuese:

- cilat janë pretendimet e autoritetit ndërkombëtar për të drejtën e tij në pushtet kushtetutëbërës;
- mbi çfarë baze i njihet kjo e drejtë autoritetit ndërkombëtar, dhe
- nga kush i njihet kjo e drejtë autoritetit ndërkombëtar.

Për të kërkuar përgjigjet e këtyre pyetjeve, në këtë artikull shqyrtoj, së pari, procesin e kushtetutëbërjes, duke e vlerësuar legjitimitetin e tij në diakroni dhe, së dyti, përmbajtjen e kushtetutës, duke vlerësuar legjitimitetin e saj sipas funksioneve që pritet t'i kryejë ajo. Në seksion e radhës diskutoj procesin e kushtetutëbërjes në Kosovë, ndërsa në seksionin pas këtij, përmbajtjen e vetë kushtetutës, duke u përqendruar në analizën e funksioneve të kushtetutës dhe sa është Kushtetuta e Kosovës e përshtatshme t'i kryejë ato.

Procesi i kushtetutëbërjes ndërkombëtare: vlerësimi i legjitimitetit në dy fazat e kushtetutëbërjes ndërkombëtare

Vlerësimi i dinamikës së legjitimitetit të kushtetutëbërjes ndërkombëtare është më i plotë nëse trajektoren e kushtetutëbërjes e analizojmë në diakroni, për të parë ecurinë e procesit të kushtetutëbërjes në

kohë. Modeli i kushtetutëbërjes në dy faza, i propozuar nga Andrew Arato në një studim të tij për kushtetutëbërjen në Irak, mund të merret si i përshtatshëm të aplikohet edhe në raste të ngjashme siç është rasti i Kosovës, ku roli ndërkombëtar në kushtetutëbërje është vendimtar.

Duke pranuar se shoqëritë e përçara priren nga konflikti dhe se nuk është e pritshme që ato të arrijnë konsensus për çështjet më kyçe, arbitrariteti i imponimit të rregullave në fazën e parë të kushtetutëbërjes synon t'i fuqizojë përfaqësuesit e zgjedhur me procedurë demokratike dhe të krijojë popullin e entitetit të ri politik. Në fazën e dytë, pasi kushtetuta të hyjë në fuqi dhe të amendohet sipas nevojës për t'iu përshtatur realitetit të krijuar politik në të cilin janë krijuar institucionet politike, përfaqësuesit e popullit gëzojnë autoritet demokratik të flasin në emër të popullit të cilin e përfaqësojnë sipas kushtetutës (Arato, 2009: 259—260).

Me fjalë të tjera, një faktor ndërkombëtar synon të themelojë popullin si entitet sovran dhe institucionet demokratike në shërbim të popullit, por këtë e bën duke përjashtuar popullatën nga kushtetutëbërja dhe ndërtimi i institucioneve politike. Është e rëndësishme që një ndikim i tillë të rregullohet me rregulla të pranura ndërkombëtarisht, pra sipas standardeve të ligjshmërisë dhe legjitimitetit të ndikimit të jashtëm në kushtetutëbërje. Sidoqoftë, në fazën e dytë të kushtetutëbërjes, populli duhet të përfshihet përmes fuqizimit të përfaqësuesve të tyre zgjedhur në mënyrë që ata, si dhe vetë sistemi politik, të legjitimohet. Mungesa e një koncepti të tillë në shoqëritë e paskonfliktit vështirë se ofron ndonjë themel për legjitimitet politik në sistemet e krijuara rishtas.

Nisur nga ky model, dallohen dy faza të procesit të kushtetutëbërjes në rastin e Kosovës nën administrimin ndërkombëtar: para pavarësisë dhe pas pavarësisë së Kosovës. Në fazën e parë, ishte miratuar një dokument autorizues nga administrata e përkohshme ndërkombëtare në Kosovë (UNMIK) që u quajt “Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë”. Në të vërtetë, dokumenti ka qenë një rregullore e UNMIK-ut e vitit 2001 e hartuar nga zyra ligjore e UNMIK-ut dhe ekspertë ndërkombëtarë që kishte paraparë themelimin e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisës të Kosovës (IPVQ), duke i çelur udhë bartjes inkrementale të autoritetit qeverisës nga strukturat politike ndërkombëtare tek ato vendore (UNMIK, 2001). Rregullorja, megjithatë, u quajt “Kornizë Kushtetuese” me insistimin e aktorëve politikë shqiptarë që dokumenti autorizues i UNMIK-ut të kishte një referencë të qartë të “kushtetutës” që arsyetohej me faktin se në historinë e saj

politike Kosova ka pasur një traditë kushtetuese, meqë në të kaluarën e saj ajo ka pasur dy kushtetuta, atë të vitit 1974 si njësi autonome kushtetuese në kuadër të Federatës Jugosllave, si dhe “Kushtetutën e Kaçanikut” të miratuar nga delegatët e Kuvendit të Kosovës më 7 shtator 1990. Sipas kësaj, ishte argumentuar se çfarëdo akti themelues i institucioneve vetëqeverisëse në Kosovë që nuk e pasqyron këtë fakt, kishte me qenë injorim i traditës kushtetuese të Kosovës dhe regres në historinë politike dhe konstitucionale të saj.

Në fazën e dytë, kushtetutëbërja që kishte rezultuar në hartimin dhe miratimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës pak muaj pas shpalljes së pavarësisë së Kosovë në vitin 2008, ishte karakterizuar me një ndërhyrje të ndjeshme të aktorëve ndërkombëtarë, domethënë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) përmes dokumentit të quajtur “Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës” të hartuar nga emisari special i Sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Marti Ahtisaari. Ky dokument, i njohur si “Pakoja e Ahtisarit”, që kishte përcaktuar statusin politik të Kosovës, kishte paraparë edhe procedurën e hartimit të Kushtetutës së Kosovës. Plani parashihte që “presidenti i Kosovës, në konsultim me kryesinë e Kuvendit të Kosovës, të formonte një komision kushtetues për të hartuar kushtetutën në konsultim me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar (PCN)” që do të “përbëhej nga njëzetënjë anëtarë kosovarë” të cilët do të ndihmoheshin nga përfaqësues të caktuar nga PCN-ja drejt themelimit të procedurave dhe konsultimit të modeleve kushtetuese të shteteve të tjera (United Nations Security Council, 2007).

Megjithëkëtë, siç vëren Marc Weller-i, Komisioni Kushtetues “kryesisht u mbajt jashtë procesit”. Ndonëse, Komisioni do të informonte publikun për punën e tyre në hartimin e kushtetutës në pajtim me dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës, roli i PCN-së mbeti vendimtar në miratimin e Kushtetutës, për aq sa Propozimi parashihte që PCN-ja të miratonte kushtetutën e hartuar para se ajo të miratohej formalisht në Kuvendin e Kosovës, për t’u siguruar se ajo ishte e pajtueshme me Propozimin Gjithëpërfshirës (United Nations Security Council, 2007: Neni 10). Dhe, ashtu kishte ndodhur: më 2 prill 2008 teksti i Kushtetutës së Republikës u certifikua nga PCN-ja dhe qeveria e Kosovës, gjë që i hapi rrugë paraqitjes së tekstit të Kushtetutës në Kuvendin e Kosovës dhe hyrjes në fuqi të saj më 15 qershor të po të njëjtit vit. Komisioni Kushtetues përbëhej nga forcat politike kosovare, duke përfshirë këtu edhe një përfaqësues të komunitetit pakicë turk të Kosovës (Weller, 2009: 400-405). Themelimi i Komisionit Kushtetues do të mund të

interpretohej si përpjekje për t'i dhënë legjitimitet procesit jodemokratik të kushtetutëbërjes. Megjithatë, është e diskutueshme nëse kjo strategji legjitimuese ka pasur sukses, pasi hartimi i kushtetutës ishte diktuar nga vullneti i aktorëve ndërkombëtarë fund e krye, që nga fillimi kur Propozimi Gjithëpërfshirës përcakton kornizat dhe hollësitë e përmbajtjes së saj, e deri në përfundim kur PCN-ja certifikoi projekt Kushtetutën përfundimisht, para se të miratohej formalisht në Kuvendin e Kosovës.

*Përmbajtja e Kushtetutës: vlerësim i legjitimitetit
përmbajtësor të kushtetutës sipas funksioneve të saj*

Propozimi Gjithëpërfshirës parashihte kornizat përmbajtësore të Kushtetutës së Kosovës, duke paracaktuar përmbajtjen e saj në fushat më kyçe, në mos në të gjitha. Nga një analizë e shpejtë e përmbajtjes së kushtetutës mund të shihet se ajo përbën “përkthim” të Propozimit Gjithëpërfshirës në nene kushtetuese, për aq sa ajo përputhej plotësisht me dokumentin në fjalë. Kapitulli i trembëdhjetë i Kushtetutës e konfirmon këtë duke iu dhënë përparësi dispozitave të Propozimit Gjithëpërfshirës dhe duke paraparë që vetë Kushtetuta, ligjet dhe aktet e tjera ligjore të Kosovës të interpretohen në pajtueshmëri me Propozimin Gjithëpërfshirës (Qeveria e Kosovës, 2008: Neni 143). Ndonëse kjo dispozitë është hequr në amendimet kushtetuese të vitit 2012 me përfundimin e mbikëqyrjes së pavarësisë (Qeveria e Kosovës, 2012: Amandamenti 4), Kushtetuta, megjithatë, mishëron parimet e vëna në Propozimin Gjithëpërfshirës.

Kështu, ndikimi ndërkombëtar në kushtetutëbërjen në Kosovë mund të kategorizohet si ndikim i plotë ose “ndikim total”, nëse bazohemi në tipologjinë e propozuar nga Dann dhe Al-Ali të cilët kushtetutëbërjen nën administrimin ndërkombëtar e zbërthejnë në tre lloje, varësisht prej shkallës së ndikimit: ndikim total (si në Bosnjë dhe Irak), ndikim marginal (si në Afrikën Jugore dhe shtetet e Evropës Jugore në fillim të viteve 1990) dhe ndikim i pjesshëm (si në Timorin Lindor). Sipas autorëve “ndikimi total” i aktorëve ndërkombëtarë emërton organizimin e procesit dhe imponimin e rezultateve përmbajtësore në kushtetutëbërje nga OKB-ja ose nga ndonjë forcë pushtuese (Dann and Al-Ali, 2006: 429—430, 449).

Ndërsa në rastin e Bosnjës, kushtetuta as ishte hartuar, as miratuar nga aktorët vendorë, por ishte pjesë e marrëveshjes së paqes ndërmjet

palëve ndërluftuese e negociuar ndërkombëtarisht, që njihet si “Marrëveshja e Daytonit” (United Nations Security Council, 1995: Annex 4), procesi kushtetues në rastin e Irakut ishte administruar fillimisht nga forcat pushtuese, domethënë SHBA-ja dhe Mbretëria e Bashkuar, e më pas ishte ndikuar nga aktorë të jashtëm ku në një fazë të mëvonshme ishin përfshirë edhe aktorë të emëruar vendorë (Dann and Al-Ali, 2006: 430 dhe 435). Pak më ndryshe nga rastet e Bosnjës dhe Irakut, ndikimi total ndërkombëtar në rastin e Kosovës ishte i një forme tjetër. Aty OKB-ja, përmes Emisarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Marti Ahtisaarit, kishte ushtruar ndikim vendimtar në përmbajtjen e vetë kushtetutës. Në procesin kushtetutëbërës në Kosovë aktorët vendorë kishin marrë pjesë përmes mekanizmit të Komisionit Kushtetues, por procedura dhe përmbajtja e saj ishin diktuar nga një faktor i jashtëm, domethënë nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar dhe Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës ose Plani i Ahtisaarit.

Për të vlerësuar legjitimitetin e kushtetutës nga aspekti përmbajtësor, në vijmë marrë në konsideratë funksionet që rëndom kanë kushtetutat. Në këtë kuptim, Ulrich K. Preuss dallon dy lloje funksionesh të kushtetutave. Ato njëllojësisht kryejnë funksione autorizuese që kanë për qëllim krijimin e një pushteti politik, si dhe funksione kufizuese që kanë për qëllim ta kufizojnë dhe ta zbusin atë pushtet. Ndërsa funksionet autorizuese të kushtetutës kanë të bëjnë me krijimin e autoritetit, legjitimitetin e tij dhe integrimin e shoqërisë, funksionet kufizuese kanë të bëjnë me kufizimin e pushtetit sovran të shtetit që të mos ushtrojë pushtet absolut mbi subjektet/zyrtarët e tij, si dhe me ndarjen e pushtetit ndërmjet degëve politike shtetërore (ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore) që asnjërës prej tyre të mos i lihet ushtrimi i pushtetit të plotë. Me një fjalë, ideja e kushtetutshmërisë është të krijojë dhe organizojë pushtetin sovran, ta krijojë e legjitimojë një strukturë të autoritetit politik, si dhe të kufizojë pushtetin qeverisës. Preuss vëren se “jo të gjitha kushtetutat kryejnë këto funksione në të njëjtën kohë e as në mënyrë të harmonizuar”, porse ato duhet të arrijnë një baraspeshë ndërmjet funksioneve legjitimuese dhe integruese me qëllim për të siguruar mekanizma institucionalë që mundësojnë e forcojnë bashkëpunim shoqëror dhe politik të forcave kundërshtarë në shoqëri (Preuss, 1993: 5—8).

Një nga funksionet e kushtetutës është edhe mundësia që ajo të legjitimojë autoritetin politik përmes rrugëve të ndryshme varësisht nga lloji i sistemit politik. Pa marrë parasysh dallimet e tilla, në përgjithësi,

parimi i sovranitetit popullor është parim i përbashkët legjitimues mbi të cilin bazohen shtetet dhe qeveritë kushtetuese. Pas rënies ose dështimit të një sistemi politik, paraqitet nevoja urgjente për të ndërtuar sistem të ri. Hartimi dhe miratimi i kushtetutës për sistemin e ri politik shkon krah për krah me ndërtimin e institucioneve të tij. Në këtë kontekst, qëllimi i kushtetutës është të krijojë një strukturë të pushtetit dhe të legjitimojë autoritetin politik. Siç u diskutua më sipër, praktika e kushtetutëbërjes në vendet e administruara ndërkombëtarisht është shoqëruar me ndikim më të madh a më të vogël të komunitetit ndërkombëtar, si në procesin e kushtetutëbërjes, ashtu dhe në përmbajtjen e kushtetutave.

Në rastin e Kosovës, kushtetutëbërja ka pasur për qëllim t'i ndërtojë institucionet demokratike si pjesë e mandatit të administratës ndërkombëtare për paqëndërtim, shtetndërtim, rindërtim dhe demokratizim pas konfliktit me qëllim për ta përgatitur Kosovën të vetëqeveriset me kushtetutë pas përfundimit të administrimit ndërkombëtar të saj. Sidoqoftë, kushtetuta ishte hartuar si plan ndërkombëtar për pavarësinë e kushtëzuar dhe të mbikëqyrtur ndërkombëtarisht për Kosovën, duke integruar dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës të Marti Ahtisaarit.

Ndikimi i jashtëm në procesin e kushtetutëbërjes dhe në përmbajtjen e kushtetutave mund të jetë i tërthortë dhe i drejtpërdrejtë në formë të ndërhyrjes aktive. Përveç një arsyeje të përgjithshme të ndikimit të tërthortë të jashtëm në kushtetutëbërje që bëhet në kuadër të ndërkombëtarizimit të ligjit kushtetues, arsyeja tjetër e ndërhyrjes së drejtpërdrejtë nga jashtë në kushtetutëbërje ka të bëjë në veçanti me shtetet dhe entitetet në kontekst të paqeruajtjes dhe shtetndërtimit ndërkombëtar. Arsyeja e parë domethënë se ligji ndërkombëtar vë standardet për kushtetutat kombëtare përkitazi me të drejtat e njeriut dhe formën e sistemit qeverisës së shteteve (Dann and Al-Ali, 2006: 428).

Veç kësaj, ndërhyrja e jashtme në kushtetutëbërje në kontekst të pajtimit në shoqëritë pas konflikteve bëhet për arsye se pandehet se këto shoqëri nuk janë në gjendje t'i tejkalojnë vetë ndarjet etno-politike të shkaktuara nga konflikti. Andaj, duke u orientuar nga kjo pikëpamje, për të krijuar një mundësi për paqe dhe të ardhme politike, përfaqësuesve politikë të Kosovës u ishte lënë një vend marginal dhe një rol sipërfaqësor në hartimin e kushtetutës së shtetit të tyre. Hartimi i kushtetutës nuk ishte pjesë e debatit politik dhe diskutimit publik, e as pasqyrim i negociimit shoqëror. Kushtetuta, ishte hartuar nga ekspertë, si pjesë e planit ndërkombëtar për Kosovën që pretendonte të flasë në emër të popullit të Kosovës e që ishte supozuar si zgjidhje kompromisi

e pranuar për palët e përfshira në konflikt. Mirëpo, sado qëllimmira që të jenë ato, problemi me planet e jashtme për shtetet e shoqëritë pas konflikteve është se, për të garantuar zbatimin e tyre, nevojiten misionet të jashtme monitoruese. Pikërisht mbi këtë arsytim janë krijuar misionet mbikëqyrëse dhe të sundimit të ligjit në Kosovë. Kjo, pashmangshëm, rezulton në një sistem qeverisës në të cilin pushteti është i shpërndarë në disa njësi të strukturave të pushtetit vendor dhe ndërkombëtar, ku, megjithatë, pushteti final rezervohet për këtë të fundit. Kështu, PCN-ja ka qenë autoriteti final për të interpretuar aspektet civile të Propozimit Gjithëpërfshirës (Qeveria e Kosovës, 2008: Neni 147), dokument të cilit autoritetet vendore i duheshin bindur dhe që kishte përparësi ndaj të gjitha neneve ligjore të Kosovës (Qeveria e Kosovës, 2008: Neni 143).

Në të vërtetë, këto rregullime institucionale bien ndesh me thelbin e idesë së kushtetutshmërisë që ka të bëjë me kundërshtimin e të gjitha formave të arbitraritetit të elitës sunduese dhe me pushtetin e kufizuar e të kontrolluar. Në themel të filozofisë së kushtetutshmërisë në demokracitë moderne është ideja se të sunduarit nuk janë vetëm objekte pasive të sundimit të të pushtetshmëve dhe pranues pasivë të vendimeve të tyre, por Kushtetuta u jep atyre hise në qeverisje duke i fuqizuar si anëtarë aktivë të komunitetit politik (Preuss, 1996: 12). Ky cenim i kushtetutshmërisë u tejkalua, së paku deri në një masë, vetëm në një fazë të mëvonshme të ecurisë politike në Kosovë, me përfundimin e fazës së mbikëqyrjes ndërkombëtare. Vetëm atëherë, kushtetuta mundi të kryejë në një shkallë të arsyeshme funksionin kufizues të saj.

Përveç funksioneve autorizuese, legjitimuese dhe kufizuese të kushtetutës, që kanë për qëllim krijimin e autoritetit politik, legjitimitimin e tij dhe kufizimin e pushtetit të tij, kushtetuta është mediumi përmes të cilit “pushteti kushtetutëvënës” (*constituent power*), krijon “pushtetin kushtetues” (*constituted power*). Si e tillë, kushtetuta kryen funksionin e një marrëveshjeje dhe një force përbashkuese me anë të së cilës vullneti i “popullit”, qyshdo që të përkufizohet ai, është burimi i kushtetutës e cila e institucionalizon vullnetin e popullit në autoritet shtetëror (Preuss, 1994: 149). Kësisoj, kushtetuta kryen funksionin integrues, duke qenë se përbashkon subjektet e pushtetit rreth idesë së popullit me pushtet kushtetutëvënës ose qytetarisë me të drejta kushtetuese.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës i referohet shtetit të Kosovës si shteti i “qytetarëve” të tij (Qeveria e Kosovës, 2008: Neni 1.2), “popullit” si bartës i sovranitetit të shtetit (Qeveria e Kosovës, 2008:

Neni 2.1), pra si pushtet kushtetutëvënës, si dhe “shqiptarëve” dhe “komuniteteve të tjera” si përbërës të “shoqërisë shumetnike” të shtetit (Qeveria e Kosovës, 2008: Neni 3.1). Siç është e zakonshme për shumë kushtetuta, edhe Kushtetuta e Kosovës hapet me një preambulë që i referohet “popullit”, ku “popullit të Kosovës” i përcaktohen aspiratat politike, si krijimi i shtetit të lirë, demokratik e paqedashës e deri te pjesëmarrja e plotë në procesin e integritimit evropian (Qeveria e Kosovës, 2008). Këto formulime që synojnë të integrojnë konceptin sociologjik të shumetnicitetit të shoqërisë me konceptin politik të qytetarisë së shtetit, pasqyrojnë vullnetin ndërkombëtar për të konstruktuar karakterin multietnik të Kushtetutës së Kosovës që nuk e njeh popullatën shqiptare të Kosovës si popull kushtetutëvënës, pavarësisht peshës demografike dhe politike që ka.

Në të kundërtën e kësaj, janë bërë përpjekje që Kushtetuta të sigurojë një bazë për krijimin e përbashkësisë politike që bazohet në vlera qytetare dhe jo në vlera etnike ose kulturore. Rregullimet institucionale të politikës konsociative që e përkrahin bashkëpunimin politik midis përfaqësuesve të komuniteteve, kanë dhënë rezultate, sado të kufizuara, në integrimin politik, kanë krijuar një sistem në të cilin pjesëmarrja dhe përfaqësimi politik në bazë të përkatësisë etnike nxitet dhe shpërblehet më tepër. Në këtë mënyrë, në vend se të kryejë funksionin integruës përmes mishërimit të qëllimeve të dëshiruara, aspiratave e vlerave të përbashkëta të shoqërisë në një afat më të gjatë, këto rregullime formalizojnë ndarjet ekzistuese duke i pasqyruar ato në institucione formale të autoritetit politik dhe kështu rrezikojnë të çimentojnë po ato ndarje të cilat synojnë t’i tejkalojnë (Hehir, 2006: 201; Selaci, 2009: 15).

Natyrisht, rregullimet konsociative që e përkufizojnë shtetin e Kosovës si shtet të komuniteteve (shqiptarëve dhe komuniteteve të tjera) dhe garantimi e mbrojtja e të drejtave të pakicave janë bërë për të shmangur kërcënimin e mazhoritarizmit me qëllim për të siguruar pranimin e komuniteteve pakicë—të serbëve, sidomos—të shtetit të Kosovës, pra për të siguruar legjitimitet të brendshëm ose vendor, por edhe të jashtëm ose ndërkombëtar në kuadër të kërkesës për një sistem që garanton të drejtat qytetare, duke përfshirë pakicat. Gjithashtu, shteti i ri duhej të respektonte kriteret me të cilat u kushtëzua pavarësia e tij, ndër të cilat ishte njohja e të drejtave speciale për komunitetet pakicë, dhe të përpiqej për të siguruar njohjen e Serbisë që e kundërshtonte shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Pas një kohe, strategjia legjitimuese që bazohej në “shtetin e komuniteteve” pati një sukses në pjesët e Kosovës ku në kuadër të decentralizimit të pushtetit u krijuan komunat me shumicë serbe në nivel të pushtetit lokal. Marrëveshja e arritur më 19 prill 2013 në mes Kosovës dhe Serbisë në Bruksel “për normalizimin e marrëdhënieve” e njohur si “Marrëveshja e Brukselit”, që parashihte mbajtjen e zgjedhjeve në komunat e veriut të Kosovës të banuara me shumicë serbe, mundësoi mbajtjen e zgjedhjeve të para lokale atje dhe krijimin e strukturave politike lokale dhe të sigurisë sipas ligjit të Kosovës, si dhe integrimin e autoriteteve gjyqësore në juridiksionin e Kosovës (Qeveria e Kosovës, 2013). Mund të argumentohet se kjo strategji legjitimuese deri diku ka shtuar shanset për pranimin e shtetit të Kosovës nga grupet e pakicave etnike dhe nga komuniteti ndërkombëtar, por ajo gjithashtu ka krijuar sfidë për legjitimitetin e brendshëm në mesin e shqiptarëve, domethënë popullatës shumicë në Kosovë (Landau, 2017: 442 dhe 444).

Legjitimiteti ndërkombëtar dhe legjitimiteti vendor

Në seksionet paraprake fola për procesin e kushtetutëbërjes dhe përmbajtjen e kushtetutës së Kosovës të diktuar nga autoriteti ndërkombëtar dhe parashtrua disa konsiderata për legjitimitetin e kësaj mënyre të kushtetutëbërjes. Sidoqoftë, deri këtu kam shikuar vetëm në njërin anë të legjitimitetit, domethënë në palën që pretendon legjitimitet.

Pasi legjitimitetin e kuptuam si pranim të një autoriteti politik si të drejtë e të duhur, në këtë kontekst, pyetja që shtrohet është: kush legjitimon? Duke qenë se legjitimiteti është koncept relacional, në këtë marrëdhënie identifikohen dy palë: objekti i legjitimitetit dhe subjekti legjitimues. I pari “ngre pretendim për legjitimitet, ndërsa kushtet për pranimin e tij varen nga një audiencë si pjesë e marrëdhënies” (Knoll, 2006).

Në kontekstin e kushtetutëbërjes ndërkombëtare të Kosovës, mund të identifikohen dy subjekte kryesore legjitimuese: i pari, komuniteti ndërkombëtar që e krijon autoritetin ndërkombëtar në Kosovë i përfaqësuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe organet e saj, dhe, i dyti, komuniteti i cili qeveriset nga autoriteti ndërkombëtar, domethënë popullata vendore dhe përfaqësuesit politikë të saj. Varësisht nga cila prej këtyre dy perspektivave analizohet legjitimiteti i kushtetutëbërjes ndërkombëtarë, flitet për legjitimitetin nga jashtë ose ndërkombëtar, nga njëra anë, dhe për legjitimitetin nga brenda ose vendor, nga

ana tjetër. Kriteret legjitimuese ndërkombëtare kanë të bëjnë me legjitimitetin që ndërtohet mbi bazën e validimit të procesit dhe përmbajtjes së kushtetutëbërjes ndërkombëtare nga komuniteti i organizuar ndërkombëtar, ndërsa kriteret legjitimuese vendore kanë të bëjnë me pranimin e procesit të kushtetutëbërjes ndërkombëtare dhe, sidomos, me pranimin e përmbajtjes së kushtetutës nga ana e subjekteve të tij, domethënë të popullatës së qeverisur ose përfaqësuesve politikë të tyre.

Në këtë artikull, i jap peshë të dy llojeve të legjitimitetit: kushtetutëbërja ndërkombëtare në Kosovë ka pretenduar legjitimitet të jashtëm (ndërkombëtar) si edhe të brendshëm (vendor) mbi bazën e zotimit për të garantuar paqe, qeverisje të mirë dhe demokratike, garantimin e të drejtave të komuniteteve, e të ngjashme. Natyrisht, një proces kushtetutëbërës ndërkombëtar, sado i plotë që të jetë ndikimi i autoritetit ndërkombëtar në të, dhe sado që t'i njihet e drejta për të folur në emër të popullatës të cilën e administron, nuk mund t'i përjashtojë aktorët dhe përfaqësuesit vendorë nga procesi, pa e cenuar legjitimitetin e vetë procesit. Së këndejmi, inkorporimi i aspiratave politike të përfaqësuesve të popullit është qenësor në pretendimet për legjitimitet, pasi legjitimiteti i brendshëm ose vendor i autoritetit ndërkombëtar ndërtohet nga opinioni që popullata vendore ka për kushtetutën, nëse ajo u shërben interesave të tyre politikë ose jo.

Një analizë e legjitimitetit të kushtetutëbërjes ndërkombëtare që këqyr jo vetëm në anën ndërkombëtare të procesit kushtetutëbërës, pretendimet dhe ndikimin vendimtar të autoritetit ndërkombëtar në të, por edhe në pikëpamjet e perceptimet e të qeverisurve, domethënë popullatës vendore e përfaqësuesve të tyre, në lidhje me procesin dhe, sidomos, përmbajtjen e kushtetutës, është e nevojshme për aq sa mundëson që legjitimiteti të analizohet edhe në nivel vendor. Natyrisht, analiza e legjitimitetit vendor duhet të marrë parasysh se popullata vendore, si subjekt legjitimues, nuk është një tërësi e pandashme, por përbëhet nga grupe, komunitete etno-politike, e aktorë të ndryshëm shoqërorë. Së këndejmi, në analizë duhet të merret në konsideratë edhe kjo vërejtje, duke parë se si pranimi ose mospranimi vendor i kushtetutëbërjes në Kosovë, nuk është i njëtrajtshëm, por ndryshon në varësi prej subjekteve legjitimuese, domethënë prej segmenteve të ndryshme të popullatës, sidomos përgjatë linjave etnike ku dallimet politike janë më të theksuara se kudo tjetër, në veçanti midis shqiptarëve e serbëve të Kosovës.

Përfundim

Ndërhyrja e drejtpërdrejtë ndërkombëtare në procesin e hartimit dhe në përmbajtjen e kushtetutës së një vendi është praktikë e kushtetutëbërjes në vendet e administruara nga misionet e përkohshme ndërkombëtare. Kjo praktikë është e pranishme veçanërisht në kontekst të paqeruajtjes dhe shtetndërtimit ndërkombëtar. Në këtë artikull shqyrtova legjitimitetin e një praktike të tillë të kushtetutëbërjes ndërkombëtare, duke analizuar procedurën dhe përmbajtjen e kushtetutëbërjes, aktorët e përfshirë në të dhe rolin e tyre në të. Analiza e këtyre dimensioneve dhe e dinamikës së kushtetutëbërjes ndërkombëtare ndihmon në gjetjen e përgjigjeve të pyetjeve kyçe në lidhje me legjitimitetin e një praktike së kushtetutëbërjes ndërkombëtare, të cilat kanë të bëjnë me pretendimet e autoritetit ndërkombëtar për të drejtën e tij në pushtet kushtetutëvënës, me bazën e këtij pretendimi dhe me subjektet nga të cilët pranohet ose jo pretendimi i tillë.

Duke u përqendruar në rastin e kushtetutëbërjes ndërkombëtare në Kosovë, që klasifikohet si “ndikim total” i autoritetit ndërkombëtar në kushtetutëbërje, si në procesin ashtu dhe në përmbajtjen e saj, artikulli propozon që legjitimiteti i kushtetutëbërjes ndërkombëtare të analizohet duke parë në marrëdhënien midis dy palëve: pretenduesit për legjitimitet dhe njohësit (a mosnjohësit) të atyre pretendimeve, domethënë midis trupave ndërkombëtare që e udhëheqin hartimin e kushtetutës, në njërën anë, dhe komunitetit të organizuar ndërkombëtar dhe përfaqësuesve të popullit që i nënshtrohen asaj kushtetute, në anën tjetër.

Kësisoj, legjitimiteti i kushtetutëbërjes ndërkombëtare vlerësohet në dy nivele: në nivelin e jashtëm ose ndërkombëtar dhe në nivelin e brendshëm ose vendor, ku në secilin vlejné norma të posaçme legjitimuese. Për t’u legjitimuar si proces dhe si përmbajtje, kushtetutëbërja ndërkombëtare duhet të përputhet, së paku deri në një masë, me ato norma dhe t’i realizojë kërkesat e tyre. Një analizë e legjitimitetit e kushtetutëbërjes ndërkombëtare që këqyr jo vetëm në anën ndërkombëtare të procesit kushtetutëbërës, pretendimet dhe ndikimin vendimtar të autoritetit ndërkombëtar në të, por edhe në pikëpamjet e perceptimet e të qeverisurve, domethënë popullatës vendore e përfaqësuesve të tyre, në lidhje me procesin dhe, sidomos, përmbajtjen e kushtetutës, është e nevojshme për aq sa mundëson që legjitimiteti të analizohet edhe në nivel vendor.

Planifikimi i procesit të kushtetutëbërjes dhe hartimi i përmbajtjes së kushtetutës në shoqëritë pas konfliktit mund të luajë rol të rëndësishëm në tranzicionin e qeverisjes. Rasti i Kosovës ilustron praktikën e kushtetutëbërjes ndërkombëtare, që udhëhiqet nga aktorët ndërkombëtarë, duke përjashtuar në masë të madhe nga procesi i përfaqësuesit politik të vendit për të cilin hartohet kushtetuta. Mirëpo, meqenëse roli i administratës ndërkombëtare është të krijojë një sistem politik demokratik, populli nuk mund të përjashtohet nga dizajnimi i atij sistemi pa u sfiduar vetë legjitimiteti i administratës ndërkombëtare. Mbi këtë konsideratë, përfshirja më e madhe e popullatës lokale në procesin e shtetndërtimit, në veçanti përmes konsultimit dhe pronësisë lokale në hartimin e kushtetutës për shtetin dhe shoqërinë e re, është e nevojshme për legjitimimin e kushtetutëbërjes ndërkombëtare, pasi popullatës i sigurohet një hisë më e madhe në sistemin politik të cilin synon ta ndërtojë kushtetuta.

Referencat

- Arato, Andrew (2009) *Constitution Making Under Occupation: The Politics of Imposed Revolution in Iraq*. New York: Columbia University Press.
- Beetham, David (1991) *The Legitimation of Power*. Houndmills: Palgrave.
- Chesterman, Simon (2004) *You, The People: The United Nations, Transitional Administration, and State-Building*. Oxford: Oxford University Press.
- Dann, Philip and Al-Ali, Zaid (2006) The Internationalized Pouvoir Constituant – Constitution-Making Under External Influence in Iraq, Sudan and East Timor. In Armin von Bogdandy and Rudiger Wolfrum, (eds.) *Max Planck Yearbook of United Nations Law*, 10: 423-463. Leiden: Martinus Nijhoff.
- Easton, David (1975) “A Re-Assessment of the Concept of Political Support,” *British Journal of Political Science*, 5(4): 435-57.
- Fraser, John (1974) “Validating a Measure of National Political Legitimacy,” *American Journal of Political Science*, 18(1): 117—134.
- Hehir, Aidan (2006) “Autonomous province building: Identification theory and the failure of UNMIK,” *International Peacekeeping*, 13(2): 200—213.
- Knoll, Bernhard (2006) “Legitimacy through defiance: The UN and local institutions in Kosovo.” *Helsinki Monitor*, 4: 313—326.
- Landau, Dana M, (2017) “The quest for legitimacy in independent Kosovo: the unified promise of diversity and minority rights.” *Nationalities Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity*, 45(3): 442—463.
- Linz, Juan J. and Stepan, Alfred (1996) *Problems of Democratic Transition and Consolidation: Southern Europe, South America, and Post-Communist Europe*. Baltimore: The Johns Hopkins University Press.
- Morphet, Sally (2002) “Current International Civil Administration: The Need for Political Legitimacy,” *International Peacekeeping*, 9(2): 140—162.
- Preuss, Ulrich K. (1993) *Constitutional Aspects of the Making of Democracy in the Post-communist Societies of East Europe*. Bremen: Zentrum für Europäische Rechtspolitik an der Universität Bremen.
- Preuss, Ulrich K. (1994) “Constitutional Powermaking for the New Polity: Some Deliberations on the Relations Between Constituent Power and the Constitution.” In Reosenfeld, Michel (ed.) *Constitutionalism, Identity, Difference, and Legitimacy: Theoretical Perspectives* (pp. 143—164). Durham: Duke University Press.
- Qeveria e Kosovës (2008) *Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 8 prill, 2008*. Në internet:

- <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702> Qasur më: 28 tetor 2024.
- Qeveria e Kosovës (2012) *Amandamentimi i Kushtetutës së Rrepublicës sëKkosovës lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë Kosovës, 7 shtator 2012*. Në internet: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3293> Qasur më: Qasur më: 28 tetor 2024.
- Qeveria e Kosovës (2013) *On ratification of the first international agreement of principles governing the normalization of relations between the Republic of Kosovo and the Republic of Serbia. Law No. 04/L-199, 27 June 2013*. Në internet: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11205> Qasur më: 28 tetor 2024.
- Samuels, Kristi (2006) “Post-Conflict Peace-Building and Constitution-Making”, *Chicago Journal of International Law*,6(2): 663—682.
- Selaci, Gëzim (2009) “Ethnic Politics in Post-Conflict Kosovo: Agonistic democracy as an alternative to antagonistic interethnic relations in post-conflict Kosovo,” *Albanian Journal of Politics*, V(1): 7—34.
- United Nations Security Council (1995) *General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina, 30 November 1995*. Në internet: <https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Bosnia%20S1995%20999.pdf> Qasur më: 28 tetor 2024.
- United Nations Security Council (2007) *Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement, S/2007/168, 26 March 2007/Add.1*. Në internet: <https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kosovo%20S2007%20168.Add1.pdf> Qasur më: 28 tetor 2024.
- UNMIK (2001) *UNMIK Regulation No. 2001/9 On a Constitutional Framework for Provisional Self-Government in Kosovo, 15 May 2001*. Në internet: https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/02english/E2001regs/RE2001_09.pdf Qasur më: 28 tetor 2024.
- Weber, Max (1978 [1921]) *Economy and Society: An Outline of Interpretive Sociology*. Edited By Guenther Roth and Claus Wittich. Berkley, CA: University of California Press.
- Weller, Marc (2009) *Shtetësia e kontestuar: Aministrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*. Prishtinë: Koha.

Abdulla Rexhepi, Prishtinë

PERËNDIMI DHE MODERNITETI NË
KËNDVËSHTRIMIN E MENDIMTARËVE
BASHKËKOHORË IRANIANË:
AHMED FERDID DHE DARIUSH SHAYEGAN

Abstrakt

Depërtimi i filozofisë dhe i koncepteve moderne në Iran, në mesin e mendimtarëve të këtij vendi solli reagime të ndryshme për dhe kundër tyre. I menduar dhe i konceptuar në një ambient krejt tjetër nga ai iranian-mysliman, moderniteti dhe si rezultat i tij edhe Perëndimi, si koncept gjeografik dhe kulturor, u bënë objekt i spekulimeve dhe i kritikave të shumë mendimtarëve të këtij vendi, dhe ndoshta bashkë me fenë, janë konceptet më të debatuar në dekadat e fundit. Ndërhyrjet e disa shteteve perëndimore në politikën e Iranit, sidomos rrëzimi i qeverisë demokratike të Muhamed Mosadegut në vitin 1953 dhe sjellja në pushtet e një regjimi despotik me koncepte mesjetare, në mesin e intelektualëve iranianë kishte krijuar një qasje skeptike ndaj botës perëndimore dhe çdo gjëje që kishte të bënte me modernitetin. Në këtë shkrim, do të trajtohen dhe analizohen disa nga konceptet kryesore kundrejt Perëndimit dhe modernitetit të dy intelektualëve me ndikim të madh në Iranin bashkëkohor, Ahmed Ferdid dhe Dariush Shayegan. Me një qasje deskriptive-analitike, artikulli mëton të ndërtojë një pamje rreth koncepteve filozofike të këtyre mendimtarëve iranianë, të cilët arritën të kenë ndikim, jo vetëm në mendimin filozofik dhe akademik, por edhe në atë politik.

Fjalët çelës: Perëndimi, moderniteti, Irani, oksidentalizmi, Ahmed Ferdid, Dariush Shayegan

Hyrje

Kur trajtohet zhvillimi shkencor e intelektual në botën mysli-mane, pyetjet që ngrihen janë të natyrshme: Çfarë ndodhi që bota islame, e cila për shekuj me radhë pati një hov të madh të zhvillimit, të arrijë në këtë gjendje? Prej cilës kohë filloi rënia në dekadencë? A e kanë shqyrtuar këto çështje mendimtarët e këtyre vendeve? Ndërsa njëra nga pyetjet më thelbësore ishte se si erdhën dijetarët e kësaj bote

në përfundimin se diçka nuk po shkonte siç duhej, dhe se duhet filluar një nismë për të dalë nga kjo gjendje e mjerueshme.

Një nga përgjigjet kryesore për këtë situatë të botës islame ishte humbja e njëpasnjëshme në luftëra përballë armiqve. Një rast i njohur është ai i shekullit XVIII kur ushtria franceze, me vetëm 12 000 ushtarë, mundi ushtrinë osmane me 30 000 ushtarë. Kjo humbje shënjonte jo vetëm një dështim ushtarak, por edhe një goditje për krenarinë kombëtare dhe për identitetin mysliman. Një tjetër humbje e rëndësishme ndodhi në vitet 1826-1828, kur ushtria iraniane u mposht nga ushtria ruse. Më pas, shpërbërja e Perandorisë Osmane, si një entitet që kishte mbajtur të unifikuar deri diku botën islame dhe identitetin e myslimanëve, shënoi gjithashtu një pikë kthese për të gjithë botën islame. Këto humbje u bënë shkak i një reflektimi të thellë midis dijetarëve myslimanë, të cilët filluan të mendojnë për arsyet e dështimeve dhe për mënyrat e daljes nga kjo gjendje e rëndë, e cila kishte prekur çdo dimension social e individual të botës islame.

Megjithatë e myslimanëve, megjithëse me numër shumë më të madh, kishin pësuar disfatë nga ushtritë me numër më të vogël të botës perëndimore, atëherë cila qe ajo pikë e fuqishme e këtyre ushtrive? Dijetarët myslimanë, me të drejtë, filluan të mendojnë se çfarë qëndronte pas teknologjisë ushtarake të ushtrive perëndimore. Prandaj vendosën të dërgojnë nxënësit më të mirë në Evropë, me qëllim që të mësojnë nga njohuritë dhe përvojat e perëndimorëve. Megjithëse qëllimi ishte që këta studentë të mësonin vetëm dijet teknologjike dhe shkencat natyrore, por disa prej tyre e kuptuan shumë mirë se pas këtyre dijeve qëndronte një strukturë e sofistikuar filozofike. Kështu dhe filluan të studionin filozofinë perëndimore, ku u njohën me mendimtarët kryesorë të modernitetit, si René Descartes, Immanuel Kant, Karl Marx, Sigmund Freud, etj.. Pasi u njohën me idetë dhe filozofinë e tyre, këta studiues myslimanë, filluan t'i përkthejnë dhe t'i përvetësojnë ata në gjuhët dhe kulturat e tyre. Dhe kështu filloi depërtimi i ideve moderniste në botën islame.

Lindja islame dhe Perëndimi modern

Lidhjet dhe shkëmbimet Lindje - Perëndim është një temë që ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve lindorë e perëndimorë, dhe jo pak studime e vështrime janë publikuar deri më sot, pa përjashtuar edhe ambientin tonë kulturor. Pas botimit të librit të njohur "Orientalizmi" të

Edward Said,¹ një vepër me ndikim tepër të madh në qarqet akademike e më gjerë, është krijuar një qasje nëpërmjet së cilës vihen në pah perceptimet e perëndimorëve karshi Lindjes dhe lindorëve. Gjithashtu ekziston një literaturë shumë e pasur që trajton gjurmët e kulturës klasike orientale-islame në kulturën perëndimore, një pjesë e së cilës është transferuar edhe në literaturën shqipe, dhe kështu është krijuar një mendim se vetëm lindorët kanë influencuar perëndimorët. Edhe pse diçka e tillë nuk mund të mohohet, megjithatë, ndikimet e kulturës moderne perëndimore në kulturën lindore nga shek. i 19-të deri në ditët tona, janë tepër të mëdha, por ndoshta më pak të gjurmuara, e kështu më pak të njohura. Në qoftë se vepra e Saidit ka ndikuar që në Perëndim të balancohen perceptimet për Lindjen, (ndikimi ka shkuar deri aty sa që studimet e Orientalistikës të ndryshojnë emrin dhe të bëhen studime aziatike, të Lindjes së Mesme, të islamistikës, etj.), në Lindje akoma nuk ka një “Said” që të dekonstruktojë mënyrën se si perceptohet Perëndimi në veprat dhe tekstet akademike e artistike të lindorëve. Perëndimi në trajtesat e këtyre intelektualëve më tepër se një nocion gjeografik, shënjon mendimin modern me të gjithë frytet e tij shkencore, intelektuale, teknologjike dhe sociale.

Në këtë mënyrë, në botën islame, sidomos në Iran, filluan polemikat në lidhje me modelin e metodën që duhet të ndjekin popujt myslimanë për të kthyer “gjendjen e lavdishme” që e kishin pasur dikur. Polemikata e tilla rezultuan disa qasje kundrejt botës dhe ideve perëndimore. Definimi i këtyre orientimeve të intelektualëve lindorë (lexo: myslimanë) është tepër i vështirë, për shkak të konteksteve dhe komplekseve të botës myslimane, por pak a shumë në secilin vend mund të hasen pikëvështrime të tilla:

- Disa intelektualë qenë të mendimit se myslimanët duhet të shkëputen nga tradita dhe feja e tyre islame, dhe t’i dorëzohen plotësisht Perëndimit, në këtë mënyrë të huazojnë pakushtimisht çdo vlerë që vjen nga bota e modernizuar. Sipas tyre, vetëm me një dorëzim të tillë ata mund të jenë në gjendje ta zënë hapin e kohës dhe të bëhen pjesë e realitetit të kohës. Për një qasje të tillë, në Iran është i njohur Ahmed Kasravi,² ndërsa në botën turke është filozofi me prejardhje shqiptare, Riza Tevfik Bylykbashi.³

¹ Said, Edward W. (2009). *Orientalizmi*. Përktheu: Xhevat Lloshi, Shkup: Logos A.

² Për idetë e Kesreviut shih: Farhang Rajaee (2010). *Islamism and Modernism: The Changing Discourse in Iran*, University of Texas Press.

³ Për më tepër shih: Hilmi Yücebaşı (1958). *Filozof Rıza Tevfik: hayatı, şiirleri, hatıraları*.

- Disa të tjerë pohuan se myslimanët duhet të marrin vetëm arritjet teknologjike dhe shkencore të Evropës, por jo dhe mendimin modern, i cili mund të prekte direkt traditën dhe fenë. I njohur për një qëndrim të tillë është poeti turk me prejardhjen shqiptare, Mehmet Akif Ersoj.⁴

- Disa thanë se duhet refuzuar çdo send që vjen nga Evropa, sepse idetë e saj janë ndër shkaqet kryesore për moszhvillimin e myslimanëve. Të tillët mendojnë se “koha e artë” e myslimanëve mund të kthehet vetëm duke iu rikthyer rrënjëve të traditës dhe fesë islame. Disa prej dijetarëve të këtij grupi do të trajtohen në këtë shkrim.

- Ndërsa grupi i katërt është i mendimit se çdo gjë që vjen nga Evropa s’duhet gjykuar apriori si të mirë apo të keqe, por duhet analizuar, menduar dhe përshtatur në kontekstin lindor, kurse në të njëjtën kohë, duhen rimenduar edhe tradita e feja islame, me qëllim që ato të kuptohen dhe interpretohen sipas rrethanave aktuale. Në këtë grup bëjnë pjesë intelektualët myslimanë, të cilët kanë artikuluar qasje kritike ndaj interpretimeve ortodokse të teologëve myslimanë, siç janë: Muhammed Arkoun, Nasr Abu Zajd, Abdulkarim Soroush, Muhamed Shabistari, etj..⁵

Prandaj, depërtimi i mendësisë dhe koncepteve moderne në Iran, në mesin e mendimtarëve të këtij vendi, zgjoi reagime të ndryshme pro dhe kundër tyre. I menduar dhe i konceptuar në një ambient krejt tjetër nga ai iranian-mysliman, modernizmi dhe si rezultat i tij edhe Perëndimi si koncept gjeografik dhe kulturor, u bënë objekt të spekulimeve dhe kritikave të shumë mendimtarëve të këtij vendi, dhe ndoshta bashkë me fenë, janë konceptet më të debatuar në dekadat e fundit.

Pas fitores së revolucionit në vitin 1979, dhe vendosjes së një sistemi islamik të paprovuar deri atëherë, Irani filloi të përballej me sfida të llojllojshme, qoftë në rrafshin kulturor e qoftë në atë politik. Siç e ka vërejtur edhe Mehrzad Boroujerdi, pas revolucionit, polemikat dhe debatet intelektuale në këtë vend ishin “më të avancuara filozofikisht, më të fuqishme intelektualisht dhe më moderne politikisht”.⁶ Kështu,

⁴ Shih: Alim Gür (1997). “Doğu ve batı dünyası karşısında mehmet âkif” në *Turkiyat Arastirmalari Dergisi-Journal of Studies in Turkology*. No 4. Pp. 29-46.

⁵ Më tepër rreth kësaj shkolle të mendimit shih librat: *Kritikë e arsyes islame, Përgatitën për botim: Gëzim Selaci & Abdulla Rexhepi* (Prishtinë: Botimet Artini, 2021) dhe *Hermeneutikë moderne e arsyes islame, Përgatitën për botim: Abdulla Rexhepi & Gëzim Selaci*. (Prishtinë: Botimet Artini, 2021).

⁶ Mehrzad Boroujerdi (1996). *Iranian Intellectuals and the West: The Tormented Triumph of Nativism*. Syracuse University Press, p. 13.

pas vendosjes së sistemit të Republikës Islamike në Iran, vend i cili njihet për një të kaluar të lashtë kulturore dhe shtetërore, në shoqërinë iraniane, veçanërisht në kulturën e mendimit të këtij vendi, dolën në skenë shkolla, lëvizje dhe mendimtarë të shquar. Duhet shtuar gjithashtu se iranianët dallohen edhe për rëndësinë që i japin diskutimeve teorike, prandaj në mesin e tyre ka një numër të madh mendimtarësh me orientime të ndryshme epistemike.

Ndërsa spekulimet e mendimtarëve iranianë në lidhje me Perëndimin si botëkuptim modern, filluan që nga periudha e konstitucionit modern (1905). Konceptet moderne që vinin nga Perëndimi, përveç pushtetit e klerit, e sfidonin seriozisht edhe mendimin islam dhe traditën iraniane, dhe ky realitet i alarmoi shumë shpejt mendimtarët iranianë. Ndërsa qëndrimet antiperëndim filluan të artikuloohen më qartë pas grushtetit të vitit 1953 (të mbështetur nga perëndimorët) kundër kryeministrit demokrat Muhamed Mosadeg, i cili rezultoi me instalimin e monarkisë pehlevite. Padyshim se një qasje të tillë antiperëndimore e forconte edhe kujtesa e hidhur e trashëguar nga koha e kryqëzatave, e cila nga kleri dhe njerëzit e fesë aktualizohej sipas rrethanave. Në të shumtën e rasteve, për këta të fundit, Perëndimi asoconte kryqëzatat dhe mësymjet kolonialiste të Perëndimit, për atë dhe as që pranonin të mendonin në lidhje me ngjarjet dhe zhvillimet intelektuale në botën perëndimore.

Por në Iran u zhvillua edhe një mendim tepër interesant rreth Perëndimit, nga intelektualë të cilët kishin studiuar në botën perëndimore. Mendimtarët më të zëshëm iranianë që spekuluan rreth modernizmit dhe Perëndimit janë Fahrudin Shadman, Hamed Enayet, Ehsan Neraghi, Seyid Ahmed Ferdid, Ali Sheriati, Seyid Husejn Nasr Dariush Shayegan, etj.. Ndërsa prej tyre i vetmi që pas revolucionit të vitit 1979 mbeti në Iran dhe shtriu ndikimin e tij në mesin e intelektualëve iranianë, madje që krijoi shkollë të mendimit, qe Seyid Ahmed Ferdid.

Ahmed Ferdid dhe idetë e tij mbi Perëndimin dhe modernitetin

Ahmed Ferdid (1912-1994) dhe projekti i tij intelektual mund të konsiderohen matrica e zhvillimit të mendimit politik dhe intelektual përgjatë dekadave të fundit në Iran. I lindur në qytetin Yazd, Ferdid fillimisht u shkollua në shkollat tradicionale fetare, kurse më pas, në Universitetin e Teheranit studioi për filozofi, ndërsa studimet i vazhdoi

në Universitetin Sorbonne (Francë) dhe Universitetin e Heidelbergut (Gjermani). Ferdid, llogaritet si filozofi i parë modern iranian, e meqë nuk tregoi interesim për të shkruar, mori epitetin “filozofi oral”. Ai është i pari që në Iran e përktheu, e ligjëroi dhe e bëri të njohur Martin Heideggerin, bile për arsye se i tërë projekti i tij filozofik, mbështetet në mendimet e filozofit gjerman, në Iran disa e kanë quajtur si “Heideggeri iranian”. Referencat kryesore të mendimit të tij ishin Martin Heidegger, tradita fenomenologjike gjermane, filozofia ekzistencialiste dhe sufizimi teorik i Muhjiddin Ibn Arabi, sufiut të njohur mysliman. Përveç disa shkrimeve dhe artikujve të shkurtër nga filozofia dhe kritika letrare, Ferdid nuk shkroi diçka serioze, por pas vdekjes, studentët e tij ia botuan ligjëratat, intervistat dhe fjalimet që i kishte mbajtur në departamentin e filozofisë në Universitetin e Teheranit dhe nëpër evente të ndryshme. Ai gjithashtu në shtëpinë e tij organizonte takime e ligjërata filozofike, dhe nga ky qark më pas dolën disa nga intelektualët më me ndikim të kohëve të fundit në Iran, siç qenë Xhalal Al-e Ahmad, Dariush Ashuri, Dariush Shayegan, Reza Davari, etj.. Ferdid vdiq në Teheran në moshën 82 -vjeçare.⁷

Në ndërmarrjen e tij intelektuale zënë vend temat si: historia/-historicismi, revolucioni, Lindja-Perëndimi, forma dhe përmbajtja e historisë, dhe oksidentalizmi. Ferdid njihet edhe për krijimin neologjizmave në dijet humane, por trashëgimia më e madhe e tij intelektuale ka të bëjë me kritikën filozofike kundrejt Perëndimit (lexo: modernizmit, iluminizmit, humanizmit, sekularizmit, etj.).⁸ Duhet vënë theksi se kritikën e Ferdidit më tepër patën konotacion identitar dhe politik sesa filozofik, sepse nuk shihet një konsistencë logjike në kritikën e tij dhe vërehen shumë paradokse, siç është për shembull fakti se derisa ai bën thirrje për të injoruar çdo rezultat intelektual të Perëndimit, në anën tjetër, modernizimin dhe Perëndimin e kritikonte nëpërmjet filozofisë perëndimore, veçanërisht të fenomenologëve gjermanë (Nietzsche, Husserl, Heidegger) dhe të postmodernistëve francezë (Foucault, Derrida).

I ndikuar nga filozofia e Heideggerit, Ferdid dikotomisë Lindje – Perëndim i dha një dimension të sofistikuar filozofik. Sipas tij, çdo periudhë historike përshkohet nga një e vërtetë që i mbulon të vërtetat e tjera, kurse e vërteta e kohës sonë historike është “Perëndimi”, sipas

⁷ Për jetën dhe veprën e Ahmed Ferdid shih: Hashemi, Muhamedreza (1383/2004). *Hovviiyetandishan ve miras-e fikri Ahmad Fardid* [Mendimtarët e identitetit dhe trashëgimia intelektuale e Ahmad Fardidit]. Tehran: Entesharat-e Kavir.

⁸ Ferdid, Ahmad (1349/1976) *Andishehay-e Sadegh Hedayet*. Edited by: Mohammad Katirayi. Tehran. Entesharat-e Ashrafi & Farzin. p.45.

kuptimeve të sipërmendura. Ferdidi pohon se pasi doli në skenë filozofia greke, lindi hëna e realitetit faktik (*vakiyet*) dhe perëndoi dielli i së vërtetës (*hakikat*). Për te, esenca e “Perëndimit” është metafizika, ndërsa kjo është një perceptim a interpretim i posaçëm i Qenies, si dhe i ballafaqimit me Qenien, pra është një ontologji e ndryshme nga të tjerat. Ferdidi ishte i mendimit se Lindja dhe Perëndimi janë dy koncepte të ndara ontologjike dhe dy kuptime të ndryshme për Qenien, të cilat praninë e tyre e shpërfaqin në dy kultura/qytetirime dhe në dy sisteme krejt të ndryshme sociale.

Për Ferdidin, projekti i modernizmit mbështetet në egon njerëzore, e cila është vetëm një nga dimensionet e individit, dhe thekson se reduktimi i tërë qenies njerëzore vetëm në ego, si dhe mospërfillja apo “vrasja” e dimensioneve të tjera të saj, siç janë imagjinata, ndjenja, intuita, ka për të sjellë rezultate shkatërrimtare. Sipas tij, njeriu parasokratik nuk mendonte për veten (egon), sepse ishte i preokupuar me Qenien, ndërsa filozofia greke e harroi mendimin e Qenies dhe u fokusua në qenien e krijuar/qenësorin, kurse pas Descartes-it, njeriu zuri vendin e Zeusit. Pra, “njeriu” i djallëzuar i deri para modernitetit, duke u modernizuar ishte bërë vetë djalli, dhe më jo vetëm që jetonte në errësirë, por vetë errësira buronte prej tij.”⁹

Njëra nga qasjet e mendimit të Ferdidit është edhe ndarja e historisë në epoka si ‘pardje’, ‘dje’, ‘sot’, ‘nesër’ dhe ‘pasnesër’. Sipas tij, ‘sot’ është epoka e sundimit të njeriut në kuptimin e sundimit të egocentrizmit mbi historinë, e cila ka filluar nga Renesanca, e që mund ta quajmë edhe ‘liberalizëm filozofik’. Kjo qasje sjell lirinë e plotë të ‘kërkesës/nevojës’ së njeriut, të cilat e kufizojnë tepër shumë atë. Për Ferdidin, e ‘djeshmja’ është epoka kur filloi metafizika, pra koha kur filloi mendimi grek, në të cilën njeriu burgoset në koncepte abstrakte e metafizike, dhe kështu filloi filozofia. E ‘pardjeshmja’ është epoka kur njeriu kishte të bënte me të vërtetën dhe jetonte në një ndërlidhje të pandashme me Qenien. Kjo periudhë për te ishte koha e profetëve. Njëjtë mendon edhe për të ‘pasnesërmen’, ku sipas tij, me ardhjen e Mehdiut (shpëtimtari i njerëzimit sipas fesë islame), njeriu sërish do ta gjejë lumturinë dhe do të jetojë me të vërtetën. E ‘nesërmeja’ për Ferdidin është periudha ku do të vazhdojë historia e errësirës së sotme dhe njeriu akoma nuk do të mund të arrijë të jetë i vetëdijshëm. Ai thotë se njerëzimi edhe gjatë epokës së ‘nesërme’ do të vazhdojë ta plotësojë

⁹ Dibaj, Sayed Musa (1383/2005). Ara ve akayed-i Ahmad Ferdid. [Mendimet dhe bindjet e Ahmad Ferdid]. Teheran. p. 279.

shpirtin e modernitetit. Vlen të theksohet se Ferdid-i edhe këtë ndarje e ka huazuar nga Heideggeri. Pra thënë shkurt, ai të ‘pardjeshmen’ dhe të ‘pasnesërmen’ i cilëson si manifestim të realizimit të Qenies, kurse të djeshmen, të sotmen dhe të nesërmen, manifestim të djallit, të egoizimit dhe subjektivizimit, megjithëse sipas tij, njeriu është krijesë e cila mund të qëndrojë edhe jashtë kufizimeve historike dhe në këtë mënyrë, mund të reflektojë dimensione të tjera historike të Qenies së tij.¹⁰

Ferdid-i është krijues i konceptit ‘Garbzedegi’ (Westoxication), në kuptimin e kontaminimit/infektimit me “Perëndimin”,¹¹ i cili më pas është shndërruar në konceptin më të përdorshëm në kritikën e mendimtarëve iranianë karshi Perëndimit. Koncepti ‘Garbzedegi’ i Ferdid-it dhe i përkrahësve të tij, ka kuptim filozofik-ontologjik, jo vetëm sociologjik. Ai shkruan: “Garbzedegi nënkupton pranimin e qytetërimit dhe kulturës perëndimore dhe imitim të verbër të tyre, pa u zhvilluar deri në shkallën e vetëdijes në të cilën kanë arritur perëndimorët. Renesanca të cilën e kam quajtur Garbzedegi, ka ardhur bashkë me simotrat e saj historike, si kolonializmi dhe pasojat që erdhën pas tij”.¹²

Ferdid-i nuk mendon se modernizmi perëndimor është vetëm një sundim nga lart ndaj shoqërive joperëndimore, por që ai ka depërtuar thellë në qenien e tyre, dhe ata më edhe veten e kuptojnë dhe e definojnë nëpërmjet botëkuptimeve perëndimore. “E vërteta e epokës sonë historike është e vërteta perëndimore, ndërsa Lindja aktualisht është e padukshme, në errësirë. Pra, me ardhjen e filozofisë greke, megjithëse pretendohet se “Drita vjen nga Lindja”, Lindja mbeti në errësirë dhe tani çdo gjë është perëndimore. Që nga ajo periudhë, historia ecën në binaret e hegjemonisë perëndimore.”¹³ Në këtë mënyrë, Ferdid-i është i mendimit se edhe mendimi iranian dhe teologjia islame janë të perëndimizuara, prandaj, “dhe kritikën që bëhen kundrejt Perëndimit në fakt janë kritika të bazuara në filozofinë perëndimore”, për atë dhe nuk janë kritika substanciale dhe sipas tij, rezultojnë në ideologji radikale. Kësh-

¹⁰ Ferdid, Sayed Ahmad (1381/2003). *Didar-i ferhi ve futuhat-i Ahiruzzaman, Dershay-i daneshgah-i Tehran*. [Takimi i fundit dhe zbulesat e kohës së fundit: Leksionet e Universitetit të Teheranit] Përgatit për botim: Muhammed Mededpur. Teheran, pp. 417-419.

¹¹ Hanson, Brad. “The ‘Westoxication’ of Iran: Depictions and Reactions of Behrangi, Āl-e Ahmad, and Shariati.” *International Journal of Middle East Studies*, vol. 15, no. 1, 1983, pp. 1–23. JSTOR, <http://www.jstor.org/stable/162924>. Accessed 3 Nov. 2024. P. 4.

¹² Ferdid, p. 392.

¹³ Ferdid, p. 392.

tu, për të, të gjitha “izmat” e joperëndimorëve si, nacionalizmi, islami- zmi, etj. janë koncepte perëndimore dhe të huaja për qenien autentike të tyre.

Ai e kritikon edhe filozofinë e teologjinë islame, të cilat i konsi- deron të helenizuara. Sipas tij, mendimi islam nuk është mendim auten- tik i myslimanëve, sepse është i konstruktuar vetëm pasi myslimanët ishin njohur me filozofinë greke, dhe sidomos pasi në gjuhën arabe ishte përkthyer Logjika formale e Aristotelit. Ferdidi thotë se filozofia greke po ashtu ka influencuar edhe jurisprudencën (*sheriatin*) e myslimanëve. Sipas tij, mendimi grek i përvetësuar nga myslimanët i dha fund traditës sufiste dhe poetike perse-islame. Nga pikëpamja e Ferdidit, pa njohjen e Qenies është e pamundur njohja e esencës së sendit, dhe meqë filo- zofët neglizhuan njohjen e Qenies, ata nuk arritën deri te njohja e vërtetë e sendit. Ai shkruan: “Vetëm gnostikët (*arifët*) janë thelluar në natyrën e sendeve dhe vetë natyrshmërinë. Sipas tyre, e vërteta e natyrës është manifestim i emrave hyjnorë, dhe kjo nënkupton se manifestimi i Qenies së të vërtetës është në natyrë, e cila në fakt i krijon sendet”.¹⁴ Pra, ai propozon kthimin në misticizmin apo urtësinë mistike, të cilën e huazon nga misticizmi teorik i Muhjiddin Ibn Arabiut. Sipas tij, vetëm mistikët si Ibn Arabiu mundën të njohin gjërat ashtu siç janë dhe të përjetojnë të vërtetën e Qenies absolute.

Por si mund të dilet nga kjo gjendje dhe si mund që joperën- dimorët të shpëtojnë nga “prania ontologjike perëndimore”?

Ahmad Ferdid-i me pesimizëm deklaroi se çlirimi nga kjo prani ontologjike nuk është aspak e lehtë, dhe aq më pak, një gjë e tillë mund të bëhet me projekte ideologjike e politike. E pranon se edhe vetë ai është i perëndimozuar, vetëm se për dallim nga të tjerët është i vetë- dijshëm për një gjë të tillë. Prandaj “vetëdija historike për epokën në të cilën jemi duke jetuar” mund të ndihmojë drejt hedhjes së një hapi të vogël për të dalë nga kjo gjendje. Megjithatë, pohon se pa u perëndimorizuar nuk mund të arrihet vetëdija historike e hegjemonisë perëndi- more, por Perëndimimizmin e kërkon vetëm në dimensionin epistemo- logjik, e jo edhe në atë ontologjik. Ferdid-i kundërshton zërat që thër- rasin për kthimin në traditë dhe thotë: “unë s’mund të kthehem te Saadi Shirazi, edhe pse mund të dialogojë me të dhe ta dëgjojë atë se çfarë po thotë, por historia dhe koha që qëndrojnë prapa meje nuk janë të njëjta

¹⁴ Dibaj, p. 432.

me të kohës së tij, ngase prapa kokës tani më qëndrojnë Hegeli dhe Einsteini”.¹⁵

Ferdid-i thotë se e ardhmja e Perëndimit është e “nesërmja”, kurse e lindorëve është e ardhme e “pasnesërme”, pra lindorët, myslimanët dhe iranianët do t’i kthehen Qenies në kohën e ardhjes së Mehdiut. Sipas tij, nuk mund të presim që të kthehemi në të kaluarën tonë të paperëndimizuar dhe të pamodernizuar, por duhet të mendojmë për të dalë nga kjo gjendje e të shkojmë drejt të ardhmes, drejt “të pasnesërme”. Ai shkruan: “Njeriu modern do të arrijë deri aty ku do ta shohë veten përballë një rreziku të madh dhe në atë kohë do t’i thotë ‘jo’ këtij qytetërimi. Po kjo ‘jo’ nuk është e mjaftueshme në vetvete, ngase ai duhet të depërtojë përtej perdeve që kanë mbuluar Lindjen dhe të shohë dritën e fshehur. Domethënë, pa u përpjekur fare për t’u kthyer në të kaluarën dhe pa ndjerë asnjë nostalgji për të, të lërë prapa errësirën e historisë së Perëndimzimit dhe të ndezë dritën që do ta ndriçojë të ardhmen, sepse kthimi në të kaluarën nuk ka asnjë kuptim”.¹⁶ Me këtë mendim, Ferdid-i kundërshton idenë e kthimit te të parët (salafët), siç bënin thirrje disa klerikë dhe intelektualë myslimanë.

Me gjithë kritikata që iu kanë bërë, duhet theksuar se ndikimi i mendimeve të Ferdid-it në Iran është tepër i madh dhe ai konsiderohet si një shtyllë e rëndësishme e mendimit bashkëkohor iranian, ndërsa pa kuptuar dhe zërthyer mendimet dhe idetë e tij, nuk mund të kuptojmë shumë realitetet kulturore, politike dhe shoqërore të Iranit të sotëm. Për shkak të natyrës së këtij shkrimi, nuk do të kem mundësi t’i trajtojë të gjitha idetë dhe konkluzionet filozofike të Ferdid-it për modernizmin dhe Perëndimin, për atë dhe në vazhdim do të diskutohen disa nga idetë themelore të ndjekësit të tij më serioz, Dariush Shayegan.

Dariush Shayegan dhe mendimet mbi Perëndimin dhe modernitetin

Dariush Shayegan (1935 –2018), filozof dhe kulturolog iranian-francez.¹⁷ I lindur në një familje heterogjene, nëna gjeorgjiane e sektiit sunit dhe babai azer-turk shi’it, gjë që ia dha mundësinë të mishërohet me gjuhët e kulturat perse, turke, gjeorgjiane. Ky diversitet kulturor e

¹⁵ Ferdid, p. 36.

¹⁶ Ferdid, p. 36.

¹⁷ Për jetën dhe idetë e tij shih: Nasri, Abdullah (1386/2007). Ruyay-i ba tajaddud [Ballafaqimi me modernitetin]. Tehran; Entesharat-e Ilm.

identitar e shoqëruan tërë jetën dhe u bënë shtrati i mendimit të tij filozofik. Pasi kreu shkollimin në shkollën katolike “Shen Lui”, ku mësoi gjuhën franceze, Shayegan shkollimin e vazhdoi në Londër e Gjenevë, e më pas studimet për Indologji i vazhdoi në Universitetin e Sorbonne’it, në Paris. Pasi u kthye në Teheran, një kohë ligjëroi religjionet sanskrite dhe indiane. Gjatë qëndrimit në Iran, frekuentoi dhe ambientet tradicionale të medreseve, dhe për një kohë u shoqërua me filozofin dhe iranologun francez, Henry Corben. Në Iran njihet për studimet në Indologji dhe veprat rreth traditës, modernizmit, ideologjisë, identitetit dhe për disa shkrime për poetët e mëdhenj persë. Ishte autor i një romani në frëngjisht “Land of Mirage”, me të cilin më 26 dhjetor 2004 nga Shoqata e shkrimtarëve francezë u shpërblye me çmimin ADELFI. Në vitin 2009 Shayegan u nderua me çmimin “Global” të Dialogut, një çmim ndërkombëtar për “arritje të jashtëzakonshme në avancimin dhe zbatimin e kërkimit të vlerave ndërkulturore”. Shumicën e librave i shkroi në frëngjisht dhe gati se të gjitha i ka të përkthyer në persisht, por edhe në gjuhë të tjera.

Në fillesat e veprimtarisë së tij filozofike, Shayegan-i duke qenë nën ndikimin e Heideggerit, Jaspersit e Jungut, në librin “Azia përballë perëndimit”¹⁸ flet për katër ndërmarrje që kishin çuar në degradimin e mendimit modern perëndimor. Sipas tij, ndër arsyet e mbizotërimit të nihilizmit në Perëndim është se mendimi spiritual-filozofik u zhvendos në mendimin teknik, të menduarit mbi qenien u zëvendësua me të menduarit rreth teknikës, egocentrizmi zuri vendin e shpirtërores dhe spekulimet për “jetën pas vdekjes” u zëvendësuan nga adhurimi i historisë dhe ekzaltimi me të. Ky projekt i mendimit modern kishte zbehur metafizikën dhe kishte varfëruar dimensionin shpirtëror e imagjinar të njerëzve, dhe kështu kundrohej si rrezik edhe për shoqëritë myslimane, të cilat që nga fundi i shek. XIX kishin filluar të modernizoheshin me një hov të madh. Me zbehjen ose thënë ndryshe me relativizimin e metanarrativave dhe idealeve të modernizmit, studiuesit e dijeve shoqërore hetuan kthimin ose ringjalljen e traditës dhe fesë në shoqëri. Preokupimi me modernizmin dhe Perëndimin në përgjithësi shihet edhe tek intelektualët lindorë, disa prej të cilëve, fenë dhe traditën e projektonin si mburojë përballë vrullit të modernizimit të shoqërive të tyre. Pra, për ata, tradita dhe feja nuk kishin kuptimin e të shenjtës dhe moralit siç kishin pasur dikur, ngase tashmë qenë shndërruar në ideologji për luftimin e një ideologjie tjetër që vinte nga Perëndimi.

¹⁸ Shayegan, Dariush (1393/2014). *Asya der beraber-e Gharb* [Azia përballë Perëndimit]. Tehran: Amir Kabir, p. 34.

“Kur një traditë ose një fe hyn në një koncept tjetër të historisë, natyrisht që i ndryshon dhe orientimi, dhe nga një sistem i caktuar intelektual futet në një tjetër sistem, dhe kështu detyrohet të rivalizojë botëkuptimet që sundojnë atë shoqëri ose të marrë formën e atyre koncepteve. Tradita dhe feja shndërrohen në përmbajtje të këtyre formave. Por në fakt, në raste të tilla është forma ajo që sundon dhe orienton përmbajtjen. Dhe kështu veproi Ali Sheriati, i cili përmbajtjen e fesë dhe traditës e futi në formën e marksizmit. Kjo është ajo që e quaj “Perëndimizim i pavetëdijshëm”, pra kur ti një koncept perëndimor e lufton me koncepte perëndimore, pa qenë i vetëdijshëm për një gjë të tillë. Ali Sheriati derisa luftonte marksizmin perëndimor, në fakt e kishte marksizuar fenë islame”,¹⁹ shkruan Shayegan.

Pra, nuk është i vogël numri i intelektualëve myslimanë që fenë dhe traditën e shfrytëz(ojnë)uan si instrumente ideologjike për luftimin e koncepteve dhe ideve perëndimore. Andaj duke mospërfillur dimensionet thelbësore të fesë dhe traditës, pra shpirtëroren, imagjinatën dhe moralin, krijuan individë dhe grupe radikale, të cilët përfunduan në nisma radikale dhe mbase dhe terroriste. Diçka të ngjashme Shayegani e kishte parë dhe përjetuar nga afër, dhe si rezultat kishte rimenduar pozicionet e mëparshme intelektuale, nga ku kishte filluar mendimi kritik i tij dhe veten e kishte gjetur në mes të kulturës tradicionale iraniane-islame dhe kulturës moderne. Kurse për të, tradita përfaqësonte origjinalitetin, origjinën dhe thellësinë e kulturës, ndërsa ideologjia shënjonte “dijen mashtruese” dhe sistemin e mbyllur, e cila të vërtetën apriori e konsideron të sajën dhe nuk është e gatshme të dialogojë dhe t’i ekspozohet kritikës. Por edhe pse në botën perëndimore në të kaluarën, por edhe sot hedhin shtat ideologji të ndryshme që mëtojnë dominimin e shoqërisë, si duket atje është instaluar, ose po përpiqet të imponohet racionalizmi kritik, i cili, në objekt të kritikës vendos çdo ide që pretendon se është e vërtetë absolute dhe përjashton e linçon idetë e botëkuptimet e rivale. Kështu, nisur nga ajo që një mekanizëm i tillë, siç është racionalizmi kritik, nuk funksionon në botën islame, atëherë rrethanat për instalimin e ideologjive absolutiste janë tepër të favorshme.

Për Shayeganin, ideologjitë në kohërat tona luajnë rolin e legjendave të kohërave të lashta, sepse nga njëra anë, shpirti ose intelektu kolektiv ushqen imagjinatën e një grupi të shoqërisë, ndërsa në anën tjetër, të dyja këto, miti dhe ideologjia pretendojnë se kanë mburojë

¹⁹ Shayegan, p. 56.

shkencore. “Çdo ideologji ka dhe një ngarkesë të madhe emocionale, të cilën e familjarizon me një patos dhe eksitim, dhe në anën tjetër, ka një dimension logjik-racional të cilit i jep formë shkencore-filozofike. Në këtë mënyrë, ideologjia nuk është as shkencë, as filozofi e as religjion.”²⁰ Ai është i mendimit se në qoftë se shkenca mbështetet në fakte dhe përvoja të sakta dhe të paanshme, ideologjia bazohet në dogma, dhe për të nuk ka rëndësi nëse hipotezat e saj janë të koordinuara kujdesshëm me fakte dhe përvoja, sepse ato pranohen apriori si të vërteta të pamohueshme. Andaj, duke pasur parasysh modernizimin kozmetik dhe sipërfaqësor të shoqërive myslimane, në to filloi të përjetohet një “skizofreni kulturore” (Shayegan) dhe në këtë mënyrë, feja dhe tradita u rikthyen në luftën kundër modernizmit, por kthimi i tyre ishte vetëm si ideologji, pra të zbrazura nga dimensionet e tyre ontologjike. Prandaj, sipas Shayegan-it, tradita e ideologjizuar më nuk është traditë, por është një formë e veçantë e ideologjisë që në vete përmban të gjitha të metat e ideologjisë. Me këtë ideologjizim, humbet dimensionin hyjnor dhe i shenjtë i fesë dhe i traditës. Si rezultat i kësaj, lindin fundamentalizmat dhe radikalizmat e ndryshëm, të cilët të zhveshur nga aspektet morale dhe hyjnore të feve dhe traditave të lashta, detyrohen të përqafojnë veprime të dhunshme dhe linçuese, karakteristika këto të ideologjive moderne.²¹

Ideologjizimi i traditës dhe fesë, sipas Shayegan-it rezultoi në katër zhvendosje. E para ndodhi në konceptimin e historisë, ku demitizimi i kohës dhe historisë sakrale u zëvendësua me historinë profane dhe sekulare. E dyta ishte ndryshimi në sferën kulturore, ku interpretimi sipërfaqësor e skriptual ngadhënjeu ndaj interpretimit filozofik-mistik. E treta u shpërfaq në sferën e antropologjisë, ku individit ideal më nuk ishte ai me virtyte morale e shpirtërore, por aktivisti revolucionar dhe radikal. Dhe e katërta ndodhi në fushën e diskursit, i cili tashmë fenë e ka shndërruar në teori politike dhe e ka zhveshur nga konceptet e saj thelbësore, si mëshira, mirësia dhe dashuria.²²

²⁰ Mirsepassi, Ali (2011). *Political Islam, Iran, and the Enlightenment: Philosophies of Hope and Despair*. Cambridge. New York. p. 132.

²¹ Shayegan, Dariush (1997). *Cultural Schizophrenia: Islamic Societies Confronting the West*. Syracuse University Press. pp 45-47.

²² Shayegan, Dariush (1380/2011). *Afsunzadagi jaded: Hovviyat-e chehel tikke ve tefekkur-e seyyar, dar bab-e moshkelat-e javame-e besheri dar asr-e fera modern [Magjepsja e re: identiteti dyzet pjesësh dhe mendimi ambulant, rreth sfidave të shoqërive në kohën përtej modernes]*. Tehran: Enteshara-te Zevvar. P. 139.

Donc cette nouvelle piste qu'emprunte Fichte et cette stratégie fondamentale qu'il met en oeuvre - nous en avons plusieurs fois parlé - n'est pas seulement tourné vers la complète fermeture de l'État mais également vers la détermination des meilleures manières que le gouvernement de cet État idéal - appelons le ainsi - puisse le plus facilement arriver à cette fin. Examinons la principale manière que Fichte avant tout, conformément au privilège des temps anciens, met à la disposition du politique. Le philosophe n'a qu'un seul privilège: justifier et convaincre de la nécessité d'une dernière guerre dont la finalité est la suppression, par la guerre, de la guerre même. Faire que par la dernière guerre, la possibilité de la guerre même à l'avenir, ne soit plus possible. Il existe ici un illogisme. En effet, si les frontières naturelles ne sont pas à leur place ou ne sont pas, *de facto*, celles sur lesquelles un État fait valoir ses droits, alors la guerre s'ensuit, parce que la souveraineté de l'autre l'État est une instance plus forte que le droit sur les frontières naturelles, vues par le premier État comme étant les siennes. Donc il est malaisé de savoir si les frontières naturelles sont les dernières causes de la guerre ou le contraire. Est-ce que les guerres précédentes, en se référant à la souveraineté que chaque État, en particulier, évoque sont la cause d'une mauvaise répartition des frontières? En suite, est-ce que la souveraineté de l'"autre État", son même droit à l'élargissement, est la cause de la guerre, qui, nous l'avons vu, éclatera inévitablement?

En suivant la logique de la dernière guerre, cette guerre doit se transformer en guerre mondiale, parce que toutes les frontières seraient mises en question et toutes, seraient devenues une cause d'hostilité. Fichte voit cet illogisme et il cherche à l'éliminer. Pour cette raison il s'efforce de rendre cette dernière guerre la plus pacifique possible. Concrètement, il désire que son exécution et son efficacité soient imaginées exister en l'absence, quasi totale, de l'emploi d'une force quelconque ce que lui donnera, en outre, le caractère d'une guerre locale.

Le gouvernement, dont nous parlons dispose, de par sa fortune, du pouvoir de s'équiper des ressources et des forces de l'étranger, d'en embaucher et d'en acheter tant, qu'aucune résistance (*Widerstand*) ne pourra lui être opposée; ainsi son but pourra être atteint sans effusion de sang (*Blutvergissen*) et presque sans coup férir (*Schwertschlag*), et cette entreprise tiendra bien plus de la marche d'occupation que de la guerre (*und das ihre Operation mehr ein Occupationszug sey, als ein Krieg*).¹⁰

Cette atténuation de la guerre par Fichte, se fait, en réalité, par un affaiblissement de la force chez l'autre ou, plus précisément, par une mise à l'écart de la souveraineté de l'autre. Ceci va si loin qu'on peut dire que, pour Fichte, l'autre n'existe plus. Plus loin nous verrons d'autres expressions de cette inexistence de l'autre. Il cherche, en effet, à écarter la possibilité de l'autre soit parce qu'il est pensé en tant que le négatif, soit que la notion de son inexistence joue le rôle de régulation, ce qui est le cas dans le passage cité. C'est dans ces conditions seulement que la logique de la dernière guerre serait valable et que son image de la marche d'occupation sans effusion de sang serait possible.

Néanmoins, cette possibilité, réduite à l'élargissement du territoire, donne l'impression d'être moderne en ce sens qu'elle nous découvre qu'un pays, que la géographie et les frontières naturelles, en tant que des tracés pérennes ou anciens gravés dans le sol ne sont pas déterminante pour Fichte. Ce qui est décisif pour lui, ce sont les hommes qui vivent sur ces territoires et qu'il faut maintenant assimiler).

Dans *L'État commercial fermé* Fichte précise à plusieurs endroits une de ses idées. Elle se rapporte à la fermeture de l'État. Elle doit être comprise comme la cessation, l'interruption, du commerce extérieur, des rapports commerciaux avec ce qui est extérieur à cet État.

¹⁰ J. G. Fichte, 1980, 170; J. G. Fichte, 1945/1965, 502.

Comme dans le cas de la guerre Fichte est parti de ce qui est originel et intérieur, d'une "guerre-nature", d'"une guerre sans fin de tous contre tous" (...) "opposant vendeurs et acheteurs".¹¹ Il a tenté de montrer qu'il est impossible de supprimer la guerre si le point de départ n'est pas la guerre commerciale qui règne entre les États. Dans l'un comme dans l'autre espace s'accomplit le commerce sans règles. C'est là qu'il faut voir la cause de l'hostilité inter-étatique. Donc les frontières territoriales (*Territorial Grenzen*) sont la cause fondamentale d'une tendance hostile (*feindseligen Tendenz*) entre État, qui se manifeste alors immédiatement en "une guerre commerciale, universelle mais secrète" (*ein allgemeiner geheimer Handelskrieg*).¹² De la même façon qu'il imagine la dernière guerre, Fichte imagine la dernière guerre commerciale secrète. Dans le passage plus haut cité, Fichte nous, *de facto*, dit que si le caractère de la dernière guerre est plus ou moins sanglant, cela dépend des armements secrets d'un État, de ses achats et de ses investissements non dévoilés. Donc, la dernière guerre commerciale précède, se déroule en même temps ou fait partie de la dernière guerre publique. La puissance de cette guerre commerciale secrète annihile la force brutale et le sang de la dernière guerre.

De cette façon Fichte précise le problème principal des anciens philosophes. Il est certain que le propos concerne la force brutale, le sang et les victimes. Pour que le projet puisse être idéal jusqu'à sa fin il est nécessaire que la guerre soit véritablement la guerre, et surtout soit la dernière avec la perte de toutes ses propriétés négatives. L'occupation dans ce sens signifie le dernier soin prodigué aux frontières, la dernière mobilisation, la dernière sortie de la population entière sur ses frontières et enfin la dernière poussée en avant de sa frontière et encore plus en

¹¹ *Ibid*, 125; *Ibid*, 457-458. Fichte a prévu pour l'intérieur d'un Etat commercial le même sort que pour l'extérieur par la fermeture extérieure. En effet, il appartient uniquement à l'Etat d'organiser la distribution des biens et de répartir les activités des professions. A la fermeture vers l'extérieur correspond, à l'intérieur, les frontières clairement tracées entre les habitants et entre leurs activités. Dans un tel état de chose la concurrence n'existe pratiquement plus. Karl Marx, dans la partie "Concurrence" de son ouvrage *Fondements de la critique de l'économie politique* (Tome II, Paris, 1969), ou *Grundrisse des Kritik des Politischen Ökonomie* (Wien, Frankfurt, 1939), définit la "concurrence comme l'abolition des frontières à l'intérieur d'un pays" (165-169 éd. Fr; 542-546, éd. all). Sous l'influence de la *Logique* de Hegel, dans une analyse compliquée, il essaie de penser le capital et son mouvement au delà de la frontière en passant continuellement du terme *Grenze* à celui de *Schranke*, l'un et l'autre insuffisamment précisé.

¹² J. G. Fichte, 1980, 135; J. G. Fichte, 1945/1965, 468.

avant de l'ennemi de son l'État. Pourtant Fichte imagine la guerre sans effusion du sang, parce qu'il l'imagine sans l'autre, qui parce qu'il ne résiste pas, se retire, pas seulement au delà de nos frontières mais aussi au delà de notre regard. De cet instant, l'autre, pas seulement qu'il n'est pas le produit d'une auto-activité d'un Moi étatique, c'est à dire la frontière de la force d'une auto-activité d'un Moi étatique, mais il n'est plus, complètement. Donc la frontière n'est pas seulement la frontière vers l'extérieur, elle n'est plus la frontière, elle n'unit pas et ne sépare pas, et dans cet interminable intérieur de l'État fermé elle n'est plus en mesure d'honorer, et encore moins d'exister devant l'autre, d'être en voisinage avec les autres. Être chez soi à l'intérieur de ce projet marque être dans la fortification, qui est cependant en entier tournée vers soi, de fait, vers son propre sang, vers son *Mutterland*. En tous cas la fiction de la frontière découvre le sang sans effusion du sang.

Ibrahim Gashi*

ZHVILLIMET NË KOSOVË PAS DEMONSTRATAVE TË VITIT 1968 SIPAS BURIMEVE DIPLOMATIKE SHQIPTARE

Abstrakt

Viti 1968, i njohur në vendet e ndryshme të Evropës si viti i lëvizjeve dhe protestave të fuqishme studentore, me kërkesa reformatore, me theks të veçantë sa i takon rritjes së masave të shtetit të mirëqenies sociale, në Kosovë njihet si viti i demonstratave studentore me kërkesa të qarta politike për forcimin e pozicionit kushtetues të Krahinës së Kosovës në kuadër të Jugosllavisë federative që do të ndikonte në forcimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve si popullsi shumicë e krahinës.

Diplomacia e shtetit shqiptar ka përcjellë me vëmendje gjithë këto lëvizje emancipuese të shqiptarëve të Kosovës, para dhe sidomos pas demonstratave të vitit 1968. Në raportet e gjata që kanë përgatitur diplomatët shqiptarë në Beograd është raportuar detajisht për përmbajtjet e ndryshimeve kushtetuese në strukturën e Federatës jugosllave që nisen me amendamentet e vitit 1967 dhe 1968, për të marrë formën e tyre të plotë në vitin 1974.

Në vijim të këtij punimi në mbështetje të dokumenteve diplomatike të provincencës shqiptare janë analizuar interesimet e diplomacisë së shtetit shqiptar ndaj zhvillimeve politike, arsimore dhe sociale në Kosovë pas demonstratave të vitit 1968. Të shumta janë dokumentet diplomatike shqiptare që sjellin informacione për lejimin e përdorimin e flamurit kombëtar nga shqiptarët e Kosovës.

Fjalët çelës: Lëvizje, bashkëpunim, marrëdhënie, kushtetutë, ndryshime, etj.

Mbarimi i Luftës së Dytë Botërore dhe vendimet që morën autoritetet jugosllave në Kuvendin e Prizrenit¹ më 8-10 korrik 1945 për mbetjen e “vullnetshme” të Kosovës nën Serbi, shënojnë pikënisje të një periudhe dramatike të presionit, diskriminimit, dhunës deri në

* Universiteti i Prishtinës

¹ Kuvendi i KKRK-ja (Krahinor për Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit) i mbajtur në Prizren dhe ishte i organizuar në rrethana të shtetrrethimit, i cili për epilog pati aneksimin e Kosovës Serbisë, përkatësisht Jugosllavisë., shih: Ana Lalaj: Kosova - rruga e gjatë drejtë vetëvendosjes (1948 1981), Shtëpia Botuese “Mësonjëtorja e parë” Tiranë, 2000, faqe 33-34.

shpërngulje të shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera në Jugosllavi. Dy decenie të plota paslufte Kosova dhe shqiptarët si popullatë shumicë atje u përballën me një mbijetesë të vështirë dhe me kërcënime sistematike të cilat vinin, përveç të tjerash edhe për faktin e pozicionit të fuqishëm që po ushtronte Republika e Serbisë përmes lidërshiptit të saj në vendimmarrjen shtetërore të Jugosllavisë Federative.

Zhvillimet e brendshme politike në Jugosllavi gjatë viteve 60 përjetuan batica kryesisht për shkak të forcimit të nacionalizmit serb në radhët e elitës politike serbe në nivelin federal dhe republikan. Sidomos u bë shumë i dukshëm forcimi i tendencave unitariste brenda radhëve të pushtetit. Flamurbajtësi i kësaj fryme unitariste dhe antidemokratike ishte ministri i Brendshëm Federativ, Aleksandër Rankoviçi, i cili përmes sigurimit shtetëror (UDB-së)², në një mënyrë apo në një tjetër, po kontrollonte pothuaj të gjitha institucionet dhe individët e pushtetshëm në Jugosllavi. Një pjesë e konsiderueshme e udhëheqjes në nivel të Federatës dhe të republikave filluan ta ngrenë zërin kundër këtyre tendencave unitariste. Fryma më liberale brenda udhëheqjes politike jugosllave doli në sipërfaqe menjëherë pas Kongresit të Tetë të LKJ-së (dhjetor 1964), ku në plan të parë gjetën shprehje kërkesat për “demokratizim sa më të madh” të lëvizjes shoqëror-politike, si rrugë e vetme që “çdo njeri punëtor të marrë pjesë në mënyrë të barabartë” në hartimin e jetës politike, ekonomike, kulturore etj. Për t’i sfiduar forcat unitariste në radhët e pushtetit, Titoja në mbledhjen e Komitetit Ekzekutiv të KQ të LKJ-së, e cila u mbajt më 16 qershor 1966, formoi një komision të posaçëm, për të shqyrtuar veprimtarinë e aparatit të Sigurimit të Shtetit (UDB-së). Detyra kryesore e komisionit ishte “të bëjë hulumtimin e gjendjes së përgjithshme në organet e sigurimit”, si dhe “për çfarë qëllimesh po përdoret ai aparat gjigand atje, kujt i shërben, deri në çfarë mase shkohet në vendosjen dhe veprimtarinë e tij etj.”³

Në këtë mbledhje me propozimin e Josip Broz Titos, më 1 korrik u caktua seanca e katërt plenare e KQ të Lidhjes së Komunistëve të

² UDB (Unutrašnja Državna Bezbednost) u formua në vitin 1946 nga riorganizimi i Departamentit për Mbrojtjen e Popullit (OZN) në një departament civil dhe ushtarak. Më pas, Drejtoria e Sigurimit Shtetëror (UDB) u formua nga Seksioni i Parë dhe i Dytë i Departamentit për Mbrojtjen e Popullit, në varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme të RFPJ-së, ndërsa Shërbimi i Kundërzbulimit (KOS) i Ushtrisë Jugosllave u formua nga Seksioni i tretë, nën Ministrinë e Mbrojtjes së RFPJ Shih: Vojna enciklopedija 6 1973, f. 495.

³ Grupa autora (2008). Snaga lične odgovornosti (PDF). Beograd: Helsinški komitet za ljudska prava u Srbiji. fq. 82–84. ISBN 978-86-7208-153-4. Marrë më 05. 11. 2023.

Jugosllavisë, me detyrë hetimin e “Rastit Rankoviç” dhe “aferës së përgjimeve”.⁴

Një kthesë e rëndësishme për Kosovën dhe shqiptarët ndodhi gjatë zhvillimit të punimeve të Plenumit IV të LKJ-së në Brione (ishullin personal të Titos).⁵ Punimet filluan më 1 korrik 1966, fillimisht me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm të LKJ-së Josip Broz Tito, nga të pranishmit u miratua rendi i punës i Plenumit IV të KQ të LKJ-së, ku ndër të tjera si pikë e rendit të ditës ishin edhe: “Problemet aktuale në lidhje me veprimet e dëmshme të disa organeve të sigurimit dhe pasojat e dëmshme të këtij veprimi në zhvillimin e sistemit dhe punën e Komitetit Qendror”.⁶

Përgjimet që ishin bërë ndaj Titos dhe veprimeve të tjera të ndërmarra nga Sigurimi Shtetëror nuk ishin arsyeja kryesore se pse ndodhi ky sulm ndaj Rankoviçit. Udhëheqja jugosllave në këtë kohë ishte ndarë në dy grupe, si reformist dhe dogmatist. Të parës i printe Eduard Kardeli, kurse të dytës Rankoviçi. Pra, këto sulme ndaj Rankoviçit ndodhin edhe për arsye politike dhe ideologjike, sepse Titoja donte që t’i jepte një kahje tjetër politikës jugosllave dhe Rankoviçi ishte bërë pengesë në shumë aspekte për Titon.⁷ Një element tjetër i rëndësishëm është që në këtë kohë Jugosllavia po kalonte një krizë ekonomike dhe politike, dënimi i Rankoviçit i shërbente Titos edhe për të vënë gishtin diku e për të formuluar një akuzë të drejtpërdrejtë për të gjitha krimet, gabimet e dështimet e politikës së LKJ-së⁸

Rrëzimi i Rankoviçit i hapi rrugë largimit nga modeli shtetëror de fakto centralist dhe shënoi fillimin e federalizmit të vërtetë të Jugosllavisë.⁹ Në këtë mënyrë u hap rruga drejt një faze të liberalizimit shoqëror, politik dhe ekonomik, nga i cili do të përfitojnë dukshëm edhe shqiptarët.

Ndryshimet që pasuan pas Plenumit IV në riorganizimin e Sigurimit të Shtetit u vërejtën edhe në Kosovë. Në 7 komuna të Kosovës u

⁴ Po aty.

⁵ Noel Malcolm, Kosova një histori e shkurtër, përktheu: Abdullah Karjagdiu, (Prishtinë: KOHA, 2011), 409.

⁶ Shkodran Imeraj, “Aspekte të jetës politike në Kosovë, gjatë viteve 1968-1990”, Temë Doktorature, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, 2017, 26.

⁷ S. Sahitaj, “Kosova në sfondin e....”, f. 28;

⁸ Ana Lalaj, Kosova – rruga e gjatë drejt vetëvendosjes 1948 – 1981, f. 141.

⁹ Oliver Jens Schmitt, Kosova - Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike, përktheu: Enver Robelli, (Prishtinë: KOHA, 2012), 179;

ndërruan udhëheqësit e organeve të punëve të brendshme dhe 4 funksionarë të Sekretariatit Krahinor të Punëve të Brendshme. Një numër i pjesëtarëve të Shërbimit të Sigurimit Shtetëror u larguan nga puna, shumë prej tyre u pensionuan, ndërsa kundër disave edhe u ngritën procedura gjyqësore¹⁰

Ndryshimet e përmendura më lart quan në vitin 1967 drejt një riorganizimi shtetëror të RSFJ-së, në bazë të projektit: “Ndërrimet dhe shtesat kushtetuese”. Sipas këtij projekti ndryshimi i Kushtetutës së RSFJ-së i vitit 1963 do të zhvillohej në tri faza; faza e parë gjatë vitit 1967, e dyta më 1968 dhe e treta më 1971¹¹ Paraprakisht të përmendim se Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) e vitit 1963 e njihte Kosovën vetëm si pjesë të Serbisë, kurse Kushtetuta e RDFJ-së e vitit 1946 e kishte cilësuar atë si një regjion (qark autonom, në origjinal “autonomna oblast”) brenda Serbisë dhe RDFJ-së, por pa ndonjë identitet kushtetues të veçantë: identifikohet me Serbinë dhe nuk mund të bëhet fjalë në atë kohë për ndonjë subjektivitet të veçantë të Kosovës¹².

Ndryshimet substanciale në strukturën e Federatës Jugosllave nisen me amendamentet e vitit 1967 dhe 1968, për të marrë formën e tyre të plotë në vitin 1971.¹³ Fillimisht, në vitin 1968 Kuvendi i Kosovës formoi: “Komisionin për studimin e çështjeve që kanë të bëjnë me ndryshimet dhe plotësimet e Statutit”. Kryetar i këtij komisioni ishte zgjedhur Fadil Hoxha, që njëherësh ishte edhe kryetar i Kuvendit Krahinor të Kosovës. Komisioni në atë kohë kishte për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të KA të Kosovës¹⁴

Në rrethana të një klime shumë më të relaksuar, të një perspektive të ndryshimeve të rëndësishme kushtetuese, si dhe nën ndikimin e lëvizjes studentore evropiane në fundin e viteve 60 edhe në Kosovë në një trajtë më specifike dhe me kërkesa më të ndryshme shpërthyen demonstrata studentore.

Sipas shumicës së studiuesve, demonstratat e vitit 1968 janë ndikuar fuqishëm dhe drejtpërdrejt nga katër ngjarje politike, duke filluar

¹⁰ Hysni Bytyçi, *Kosova dhe shqiptarët - Pozita kushtetuese - juridike e shqiptarëve në ish - Jugosllavi*, (Prishtinë: 2006), 79.

¹¹ Ana Lalaj, *Kosova – rruga e gjatë drejt vetëvendosjes*, 152-153;

¹² Mitja Žagar, “The collapse of the Yugoslav federation and the viability of asymmetrical federalism”, fq. 112-113; 115.

¹³ Ibrahim Berisha, *Vdekja e Kolonisë*, Prishtinë: Artini, 2016, f. 173;

¹⁴ Selatin Novosella, *Demonstratat e gjashtëdhjetetës*, monografi, (Prishtinë: Shoqata e të Burgosurve Politikë, 2008), 49.

nga Plenumi IV i KQ të PKJ-së i mbajtur në Brione më 1 korrik 1966 ku Tito arrin që politikisht ta mënjanojë Rankoviçin, duke e akuzuar për abuzimet dhe gabimet sidomos të atyre që ishin të kryera ndaj Kosovës e shqiptarëve në përgjithësi.¹⁵ Ngjarja tjetër që ndikoi ishte vizita e Titos në Kosovë në mars të vitit 1967, e cila arriti që tani në kontakt më shqiptarët Titoja të “pastronte” vetën nga përgjegjësia për abuzimet ndaj shqiptarëve, duke e adresuar atë te Rankoviçi, tashmë i shkarkuar.¹⁶ Ngjarja e tretë, ishin debatet për amendamente kushtetuese që bëheshin për ndryshimin e Kushtetutës së RSFJ-së, sidomos diskutimi për pozitën e Krahinave Autonome në Kushtetutën e re të Jugosllavisë. Në ato diskutime do të lindë kërkesa për avancimin e krahinës autonome të Kosovës e Metohisë, në Republikë¹⁷. Sipas Fadil Hoxhës kjo nismë i kishte kundërshtarët e tij në Federatë e sidomos në Serbi.¹⁸

Interesimet e diplomacisë së shtetit shqiptar ndaj zhvillimeve politike, arsimore dhe sociale në Kosovë pas demonstratave të vitit 1968

Bashkëpunimi midis Kosovës dhe Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore ka përbërë një periudhë të ndërlikuar, i ndikuar nga ngjarjet e kohës dhe forcave të shumta politike dhe shoqërore. Pas pushtimit të Jugosllavisë nga forcat naziste dhe formimit të një administrate të përkohshme në Prishtinë, u zhvillua edhe një lëvizje partizane në Kosovë, e drejtuar nga Jugosllavia e Titos. Kjo lëvizje e rezistencës u bë thelbi i bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Kosovës në këtë periudhë.¹⁹

Menjëherë pas luftës Shqipëria vazhdoi të ishte vendi më i varfër i Evropës dhe iu drejtua një sërë dashamirësve midis kombeve komuniste për mbështetjen ekonomike të nevojshme për të modernizuar ekonominë e saj. Fillimisht, Hoxha ndoqi një aleancë me Jugosllavinë,

¹⁵ Ana Lalaj: Libri i cituar, faqe 139.

¹⁶ SHBOK; IHK; IAP; Demonstratat e vitit 1968, Prishtinë 2018, Izet Barali: Rrethanat që iu paraprinë demonstratave shqiptare në rrethin e Therandës më 1968, f. 20.

¹⁷ R. Rajoviç: Zhvillimi kushtetues nga autonomia deri në reformën e vitit 1089: Kosovo, Past and Present”, Beograd, 1989, faqe 208.

¹⁸ Fadil Hoxha: Jemi në shtëpinë tonë, Prishtinë, 1986, faqe 204.

¹⁹ Milena Popovica, "The Impact of Èorld Èar II on Kosovo-Albania Relations: A Comparative Historical Study", European Journal of History, fq. 511-532 (2015).

fqinjin e madh të Shqipërisë në veri. Ngjashëm me situatën me Italinë në vitet 1930, Shqipëria e gjeti veten gjithnjë e më shumë të varur ekonomikisht dhe të integruar me Jugosllavinë. Nga fillimi i vitit 1948, Tito, udhëheqësi i Jugosllavisë, po përparonte me planet për të absorbuar Shqipërinë në Federatën Jugosllave, i ndihmuar nga Koçi Xoxe, ministri i Brendshëm i Shqipërisë.²⁰

Për 13 vjetët e ardhshme (1948-1961), sponsori komunist i Shqipërisë ishte Bashkimi Sovjetik. Marrëdhëniet filluan të përkeqësohen pas vdekjes së Josif Stalinit në vitin 1953, por gjatë atyre viteve të para kujdesi shëndetësor dhe infrastruktura arsimore e Shqipërisë u përmirësuan me shpejtësi.²¹

Rihapja e një perspektive të bashkëpunimit midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë ndodhi nga fillimi i viteve 70 ku subjekti i këtij bashkëpunimi u bë Kosova, por interesimet më të theksuara të Shqipërisë për Kosovën erdhën duke u shtuar pas demonstratave të vitit 1968.

Nga dokumentet diplomatike shqiptare të kohës që ruhen në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme (AMPJ), specifikisht nga Dosja Nr.B/VII-2/b, e titulluar *Informacione për udhëheqjen e partisë e të shtetit mbi Kosovën*, të vitit 1969 mund të lexojmë shumë të dhëna:

Disa të dhëna mbi gjendjen e arsimit në Kosovë

Lidhur me gjendjen e arsimit në Kosovë, duke filluar me arsimin parashkollor, ku në ndërmjet tjerash thuhet: “*Në Kosovë ka 27 institucione parashkollore me gjithsej 1.807 fëmijë, apo 1.6% e të gjithë fëmijëve të kësaj moshe.*”²² Është me interes të thuhet se kjo informatë theksin e ka venë te prapambetja dhe diskriminimi që i bëhej Kosovës në fushën e përfshirjes së të rinjve në të gjitha nivelet e arsimit. Kur bën fjalë për arsimin parashkollor thuhet se: “*Po të krahasojmë sasinë e institucioneve parashkollore të Kosovës më atë të Serbisë, duke pasur*

²⁰ *The Balkans Since the Second World War*. Crampton, R. J. “Chapter 3: Albania, 1944-1948. 2002. London: Longman, f.48-49;

²¹ Federal Research Division, Library of Congress. *Albania: A Country Study*. Sudetic, Charles. “Chapter 1: Historical Setting: Communist Albania: Albania and the Soviet Union.” [http://memory.loc.gov/cgi-bin/query/r?frd/cstdy-:@field\(DOCID+a10038\)](http://memory.loc.gov/cgi-bin/query/r?frd/cstdy-:@field(DOCID+a10038))

²² Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (AMPJ), Dosja Nr.B/VII-2/b, 18.3.1969, f. 1,

*parasysh numrin e popullsisë del se në Serbi ky numër është 5 herë më i madh se në Kosovë*²³

Në vijim të këtij raporti referuar arsimit fillor citohet një lajm nga Kosova dhënë Agjencisë “Tanjug” më 25 shkurt 1969 në të cilin thuhet se: *Për shkak të zhvillimit të pamjaftueshëm të rrjetit të shkollave fillore mbesin jashtë shkollës çdo vit 45.000 fëmijë të shkollës fillore... llogaritet se në Krahinën e Kosovës ka më shumë se 100.000 analfabetë deri në moshën 35 vjeç. Kosova ka përqindjen më të madhe të analfabetëve në Jugosllavi dhe në Evropë.*²⁴

Edhe pjesa e raportit që i referohet arsimit të mesëm theksin e vë të vështirësitë, pamjaftueshmëritë, mungesën e investimeve shtetërore, si dhe mungesën e kuadrit të kualifikuar për të punuar në këtë nivel të arsimit. *“Niveli arsimor i kuadrove për kategorinë e shkollave të mesme është shumë i ulët, pranohet fakti se në shumë shkolla dhe veçanërisht në ato profesionale 77.1% e mësuesve nuk kanë arsimin përkatës*²⁵

Raporti në vijim ofron të dhëna interesante edhe sa i takon arsimit të lartë. Në të mund të lexojmë se: *“Tani në Kosovë ka 6 shkolla të larta dhe tre fakultete, tri nga të cilat janë shkolla të larta pedagogjike. Nga të dhënat del se gjatë vitit shkollor 1967-198, në këto shkolla kanë vazhduar studimet 8690 studentë të rregullt dhe me korrespondencë, por nga kjo shifër vetëm 5373 janë të Krahinës së Kosovës, kurse 3.327 studentë janë nga radhët e kombësive jashtë Krahinës. Më tej në këtë përshkrim që i bëhet arsimit të lartë thuhet se: “Deri në vitin 1967 mësimet në këtë kategori shkollash janë zhvilluar në gjuhën serbo-kroate, përveç në grupet për gjuhën dhe letërsinë shqipe, por pas këtij viti edhe pse është vendosur që mësimet të jepen edhe në gjuhën shqipe gjendja nuk ka ndryshuar shumë, dhe kjo shpjegohet me mungesë kuadrosh të kombësisë shqiptare.*²⁶

Në pjesën përmbyllëse të raportit që i referohet arsimit flitet edhe për mungesën e literaturës dhe teksteve shkollore në gjuhën shqipe. Theksohet mungesa e fondeve dhe kërkesa e autoriteteve të arsimit në Kosovë për rritjen e numrit të teksteve në gjuhën shqipe, për t’u arritur plotësimi i kriterit të aplikimit të dygjuhësisë në të gjitha nivelet e

²³ Po aty.

²⁴ Po aty, f. 2-3.

²⁵ Po aty, f. 4.

²⁶ Po aty, f. 6.

arsimit në Kosovë. “Në krahinën e Kosovës nga i gjithë fondi i librave, 70% e tyre janë në gjuhën serbokroate dhe 30% në gjuhën shqipe.”²⁷

Në fund të këtij raporti për arsimit jepen edhe disa konkluzione si: “1. Lufat e popullsisë shqiptare në Kosovë për të fituar një të drejtë të saj të ligjshme, për të pasur shkollat e saja në gjuhën amtare e ka detyruar klikën titiste që të bëjë disa lëshime në këtë drejtim, që ajo të hapë në Kosovë, kundër vullnetit të saj, një numër shkollash shqipe të kategorive të ndryshme, por ato janë të pamjaftueshme dhe gjysmake. 2. Shkollat shqipe në Kosovë janë në një gjendje jashtëzakonisht të vështirë si nga pikpamja e objekteve dhe mjeteve mësimore, ashtu edhe për mungesë të kuadrove të nevojshme të kombësisë shqiptare”²⁸

Mbi ligjin e ri kushtetues të Kosovës

Në kuadrin e dosjes së sipërpërmendur që përmban më shumë se 100 faqe, raportohet edhe për ndryshimet në Kushtetutën e Federatës dhe të Serbisë që kishin të bënin me Kosovën. Në këtë raport thuhet mes tjerash: “Më 24 shkurt të këtij viti (1969-V.J) në një mbledhje të pesë dhomave të Kuvendit Krahinor të Kosovës, nën kryesinë e Fadil Hoxhës u aprovua ligji i ri kushtetues, i parë i Krahinës së Kosovës. Deri në këtë kohë Kosova ka pasur një statut, i cili është përgatitur me bazën e Kushtetutës së Serbisë, në të cilën bën pjesë Kosova si krahinë autonome.”²⁹

Në vijim të raportit duke folur për ligjin jepen informacione për rrethanat dhe zhvillimet e brendshme dhe të jashtme që po kalonte Jugosllavia, por dhe Kosova pas Plenumit të Brioneve dhe demonstratave të vitit 1968, të cilat ndikuan në fillimin e ndryshimeve kushtetuese. “Titua dhe përkrahisit e tij ishin të interesuar për të organizuar nga kombësitë e tjera një front anti-serb, sepse kjo i lehtësonte luftën për eliminimin e grupit të Rankoviçit. Popullariteti i madh që mori plenumi i Brionit, si brenda ashtu dhe jashtë Jugosllavisë kërkonte që ai të shoqërohej dhe me disa masa të rëndësishme. Prandaj, në këtë drejtim përveç masave të tjera u pa e nevojshme që të bëhej rishikimi i Kushtetutës së Federatës të atyre të Republikave, si dhe e statuteve të krahinave autonome, dhe në kuadrin e politikës së vetadministrimit të

²⁷ AMPJ, Dosja Nr.B/VII-2/b, f. 7.

²⁸ Po aty, 7-8.

²⁹ Po aty, mars 1969, f. 9.

*bëheshin ndryshime në to. Në Federatë, në republika dhe në krahina autonome u krijuan komisione kushtetuese.*³⁰

Me tej në këtë dokument flitet për zërat që tashmë hapur po dëgjoheshin që Kosova në kuadër të këtyre ndryshimeve të fitojë statusin e republikës në kuadër të Jugosllavisë. *“Kërkesa për një republikë autonome të Kosovës filloi të gjejë vend edhe në shtypin e krahinës ku argumentohej plotësisht kjo kërkesë. Në shumë shkrime që botohen për këtë qëllim jepen shifra të popullsisë së republikave të Jugosllavisë dhe të përbërjes së tyre etnike... p.sh: Mali i Zi ose Maqedonia që janë respektivisht 2.8% dhe 5.6% dhe përbërja kombetare e popullsisë së tyre është 72% dhe 71% janë republika, kurse Kosova që ka 5.2% të popullsisë së përgjithshme të Jugosllavisë dhe 74% të popullsisë së saj janë shqiptarë dhe nuk është republikë, por krahinë autonome.”*³¹

Në vijim dokumenti flet për diskutimet për ndryshime kushtetuese ku sipas hartuesit të këtij dokumenti, *“...gjatë përgatitjes dhe diskutimit të projektligjit kushtetues u zhvillua një luftë e gjerë politike ndërmjet rrymave dhe tendencave të ndryshme si brenda në Kosovë ashtu edhe jashtë saj.”*³² Gjithnjë sipas të njëjtit burim ishin tre rryma kryesore që morën pjesë në këtë luftë politike. *“E para, forcat e shëndosha patriotike të shqiptarëve të Kosovës, të cilët duke e parë se në kushtet konkrete të gjendjes në Jugosllavi kërkesa e tyre për krijimin e një republike më vete dhe bashkimi brenda saj i gjithë tokave shqiptare nuk mund të realizohej u munduan që brenda ligjit të ri kushtetues të arriheshin sa më shumë të drejta për barazi kombëtare dhe të shkëputeshin sa më shumë nga varësia serbe. Më këto forca u bashkuan edhe udhëheqësit e sotëm të Kosovës që i shërbenin me besnikëri Titos. E dyta, forcat shoviniste serbo-malazeze në Kosovë, interesat e tyre prekeshin direkt nga realizimi i kërkesave të shqiptarëve kërkuan dhe luftuan që krahinës së Kosovës të mos i jepeshin më tepër të drejta sesa ajo kishte më parë. Rryma e tretë përfaqësohej nga ata shqiptarë të cilët shfaqen hapur kundër platformës së Lidhjes së Komunistëve dhe i konsideruan si fare të pakta dhe ato të drejta që i jepte Ligji i ri kushtetues popullsisë shqiptare të Kosovës. Pikëpamjet e këtij grupi u dënuan nga udhëheqësit e Kosovës dhe kërkesat e tyre u quajtën joreale dhe të bëra me qëllime tendencioze...”*³³

³⁰ Po aty.

³¹ AMPJ, Dosja Nr.B/VII-2/b, f. 10.

³² Po aty,

³³ Po aty, f. 11.

Në analizën që i bën përmbajtjes së Ligjit kushtetues në mënyrë të përmbledhur në raport thuhet: “Nga një shikim i parë i Ligjit kushtetues del se të drejtat kryesore që ka fituar popullsia shqiptare e Kosovës me aprovimin e këtij ligji mund të përmbliidhen si më poshtë: 1. Nga një krahinë autonome që më parë varej plotësisht dhe tërësisht nga Serbia, tani ‘populli punues i Kosovës, sikurse thuhet në ligj, siguron dhe realizon të gjithë të drejtat e veta në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës, më përjashtim të atyre të drejtave që, në interes të përbashkët, janë përcaktuar si të drejta të Federatës dhe të Republikës’; 2. Krahina fiton të drejtën që të ketë Ligjin e saj kushtetues në vend të Statutit që kishte më parë.; 3. Fiton të drejtën që të caktojë deputetët e saj në Dhomën e Kombeve të RSFJ-së (më parë Krahinat autonome zgjidhnin nga 5 deputetë për në dhomën e Kombeve, por ata hynin në përbërje të deputetëve të Republikës së Serbisë, kurse tani zgjidheshin nga 10 deputetë të cilët nuk hynin në grupin e deputetëve të Serbisë. Republikat zgjidhnin nga 20 deputetë); 4. Kushtetuta e re konkretizon dhe e zhvillon konceptin themelor kushtetues mbi krahinën si bashkësi shoqërore demokratike e socialiste e pavarur në realizimin e të gjithë punëve kuadrin e të drejtave e detyrave të saj...; 5. Kosova fiton të drejtën që në kuadrin e të drejtave dhe detyrave të veta të marrë masa për realizimin e një sistemi unik të ekonomisë...; 6. Krahina ka të drejtë të nxjerrë ligje dhe akte të tjera normative lidhur me interesat dhe nevojat e saj. 7. Gjuha shqipe vihet në pozitë të barabartë me gjuhët e tjera që fliten në Kosovë. Në të kaluarën serbokroatishtja ka qenë gjuhë e obliguar për gjithë popullsinë e krahinës, tani nuk është më e tillë; 8. Krahina fiton të drejtën të bëjë vetë organizimin e organeve të pushtetit. Më parë këtë të drejtë e kishte Republika e Serbisë; 9. Territori i krahinës nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin e Kuvendit Krahinor; 10. Në Kosovë krijohet gjyqi suprem i krahinës me pozitën, të drejtat dhe detyrat e Gjyqit suprem republikan dhe 11. Sanksionohet e drejta e flamurit kombëtar, e drejtë që më parë i është mohuar popullsisë shqiptare të Kosovës.”³⁴

Në përmbyllje të këtij raporti lidhur me Ligjin Kushtetues, përfaqësuesi diplomatik shqiptar do të akuzojë udhëheqjen politike të Kosovës se po bëjnë akuza dhe propagandë kundër shtetit tonë. Ndërkaq në përshkrimin që i bënë situatës dhe rolin që mund ta luajë Shqipëria për të ndihmuar Kosovën në fund të raportit thuhet: “Në situatën e tanishme të gjendjes së brendshme dhe të jashtme të Jugosllavisë dhe të Kosovës në veçanti, detyra jonë është që duke përdorur

³⁴ AMPJ, Dosja Nr. B/VII-2/b, f. 12-13.

shtypin, radion dhe mjetet e tjera të propagandës të ndihmojmë popullsinë shqiptare në Jugosllavi që të luftojë për të vënë në jetë të gjitha ato të drejta që ajo i fiton me ligjin kushtetues dhe që lufta e saj për të drejta të plota si komb dhe si popull të marrë një hov të ri”³⁵

Informacion lidhur me përdorimin e flamurit kombëtar nga shqiptarët e Kosovës

Zyrtarizimi i të drejtës së përdorimit të flamurit kombëtar për shqiptarët e Kosovës si e drejtë e fituar me Ligjin kushtetues të vitit 1969 mund të konsiderohet një nga arritjet më të mëdha në afirmimin e politikës identitare të shqiptarëve në Jugosllavi. Në pjesën e mësipërme të këtij punimi kemi theksuar se në radhët e udhëheqjes së Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, por edhe të Kosovës kishte një rrymë që mendohej ta suprimonte dhe ta minonte këtë të drejtë të fituar të shqiptarëve. Lidhur me këtë një raport i misionit diplomatik shqiptar në Beograd i muajit korrik 1969 i kushtohet kësaj teme, pra temës së përdorimit të flamurit kombëtar. Raporti nis me sentencën: *“Flamuri kombëtar është një simbol i shenjtë për çdo komb e popull dhe përdorimi i tij i lirë është një e drejtë e pamohueshme.”³⁶*

Në vijim të dokumentit flitet gjerësisht për peripecitë e popullit shqiptar të Kosovës për realizimin e të drejtave minimale kombëtare edhe në shtetin komunist ku spikaste parulla shumë populiste e vëllazërim-pashkimit. *“Popullsisë shqiptare të Jugosllavisë kjo e drejtë legjitime i është mohuar nga kralet e vjetër serb, ju mohua për gadi një qerek shekulli edhe nga revizionistët titistë...”³⁷*

Me tej në dokument lexojmë: *“Me nenin 11 të Ligjit Kushtetues të krahinës së Kosovës thuhej se është e drejtë e shqiptarëve që në KSA të Kosovës... të përdorin flamurin kombëtar. Kushtet dhe mënyrat e përdorimit do të rregullohen me ligj”.* Autoritetet e misionit diplomatik shqiptar në Beograd në vijim të raportit ngrenë shqetësimin lidhur me formulimin e tillë *“rregullohet me ligj”* duke mos e saktësuar me cilin ligj. *“Me çfarë ligji do të caktohen këto rregulla sepse ligje nxjerr Federata, nxjerr republika, nxjerr edhe krahina.”³⁸*

³⁵ Po aty, f. 16.

³⁶ Po aty, korrik 1969, f. 58.

³⁷ Po aty.

³⁸ AMPJ, Dosja Nr. B/VII-2/b, korrik 1969, f. 60.

Pas përshkrimit të takimeve dhe debateve të gjata me mënyrën se si do të rregullohet përdorimi i flamurit kombëtar në jetën institucionale të krahinës së Kosovës, raporti mbyllet me disa konkluzione si vijon: "1) Me gjithë propagandën e madhe që kanë bërë dhe bëjnë revizionistët jugosllavë mbi masat që gjoja kanë marrë e po marrin për një barazi të plotë të popullsisë shqiptare të Kosovës - (në këtë drejtim dhe me lënien e lirë të përdorimit të flamurit kombëtar) janë një bluf dhe një mashtrim. Qëndrimi i tyre prej shovinisti e serbomadhi nuk ka ndryshuar aspak dhe as që ka për të ndryshuar me vullnetin e tyre. 2) Çështja e përdorimit të flamurit kombëtar për shqiptarët e Jugosllavisë në përgjithësi dhe të Kosovës në veçanti nuk është zgjidhur dhe nuk do të zgjidhet kurrë nga titistët. 3) Shovinistët serbë, maqedonas dhe malazias do ta përdorin këtë çështje ashtu si në të kaluarën për provokacione dhe represalie kundër popullsisë shqiptare, duke i akuzuar ata si "nacionalistë"; "shqiptaromëdhenj, etj". 4) Popullsia shqiptare në Kosovë është indinjuar për këtë të drejtë të shenjtë që ia mohojnë titistët dhe shovinistët serbomëdhenj dhe ajo është vendosur që të luftojë për këtë të drejtë. Nga shtypi i Kosovës del se rinia shqiptare është në krye të kësaj lufte dhe ajo e manifeston kudo këtë; shumë të rinj mbartin veshje kuqe e zi, -rinia i thur vargje flamurit kombëtar."

Përfundim

Duke analizuar me kujdes përmbajtjen e dosjes, pjesë të së cilës i kemi trajtuar në këtë punim, por edhe nga krahasimi i përmbajtjeve me burime të tjera arkivore, por edhe me literaturën dhe shtypin e kohës mund të arrijmë në disa përfundime.

E para, pas Plenumit të Brioneve (1966) impenjimi i diplomacisë shqiptare përmes misionit të saj diplomatik në RSFJ lidhur me zhvillimet politike që lidheshin me shqiptarët në Jugosllavi në përgjithësi dhe me shqiptarët në veçanti është i konsiderueshëm. Qeveria e shtetit shqiptar është mbajtur e informuar deri në hollësira rreth ngjarjeve dhe zhvillimeve që kanë ndodhur në trekëndëshin Federatë-republikë dhe krahinë e Kosovës e që kishin të bënin me shqiptarët.

E dyta, politika shqiptare sado që me shumë kujdes ka ngritur dyshimet dhe shqetësimet e veta se udhëheqja federative nën ndikimin e udhëheqjes së Republikës së Serbisë po ofron vetëm reforma sipërfaqësore sa u takon të drejtave të shqiptarëve. Kjo shihet kur jepen vlerësimet lidhur me situatën e vështirë në fushën e arsimit ku shqiptarëve

me gjithë premtimet mbeten edhe me tej të diskriminuar dhe me shkallë të lartë të analfabetizmit. Edhe kur analizohet Ligji kushtetues, politika shqiptare është e bindur se një reformë e tillë është e pamjaftueshme dhe për më shumë edhe e pagarantuar se do të zbatohet me përpikëri dhe pa abuzime nga autoritetet republikane. Po thuaj njësoj më shumë skepticism u pa edhe dhënia e të drejtës së përdorimit të flamurit kombëtar për shqiptarët e Kosovës, me dyshimin se qëllimshëm ishte lënë e padefinuar qartë se me cilin ligj do të rregullohej mënyra e përdorimit të tij.

E treta, konsiderojmë se provinienca arkivore diplomatike shqiptare është një burim i rëndësishëm, mjaft autentik, ani pse herë pas here i mbështjellë me petkun e interpretimeve ideologjike dhe qëndrimeve partiake, megjithatë ka hedhur mjaft dritë mbi zhvillimet politike në Jugosllavi dhe në Kosovë pas demonstratave të vitit 1968.

DEVELOPMENTS IN KOSOVO AFTER THE DEMONSTRATION OF 1968 ACCORDING TO ALBANIAN DIPLOMATIC SOURCES

Resume

The aim of this paper is to analyze the political, social, cultural and educational developments in Kosovo after the student demonstrations of 1968 according to the perspective of Albanian diplomatic documents.

Albanian diplomats accredited in Belgrade since the post-war period have focused their interests on the treatment of the Albanian population in Yugoslavia. The changes in the head of Yugoslav politics and the dismissal of the Minister of the Interior Aleksander Ranković after the Plenum in Briones (1966) open the perspective for reducing the level of discrimination against the Albanians of Kosovo by the authorities of the Republic of Serbia. Consequently, premises were created in Kosovo for the advancement of the constitutional position of the province.

For the constitutional changes that began after the demonstrations of 1968 that culminated in the adoption of the Constitutional Law, Albanian diplomacy has paid more attention, reporting on the effects that these changes have produced for Albanians in terms of improving their economic, educational, and cultural conditions. and above all in the affirmation of their language and identity values, such as the right to use the national flag.

In this paper, for comparative purposes, in addition to Albanian diplomatic sources, other alternative sources and relevant literature in Albanian and foreign languages were also consulted.

Bibliografia

Burimet

1. Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme – Tiranë, (AMPJ), Dosja Nr.B/VII-2/b, Informacion për udhëhëqjen e Partisë e të Shtetit mbi Kosovën
 - a. Disa të dhëna mbi gjendjen e arsimit në Kosovë, dt. 18.3.1969
 - b. Mbi Ligjin e ri kushtetues të Kosovës, dt. Mars 1969
 - c. Informacion mbi përdorimin e flamurit kombëtar nga shqiptarët e Kosovës, korrik 1969

Literatura

1. Lalaj Ana, Kosova - rruga e gjatë drejtë vetëvendosjes (1948-1981), Shtëpia Botuese "Mësonjëtorja e parë" Tiranë, 2000,
2. Vojna enciklopedija 6 1973.
3. Grupa autora (2008). Snaga lične odgovornosti (PDF). Beograd: Helsinški komitet za ljudska prava u Srbiji. fq. 82–84. ISBN 978-86-7208-153-4. Marrë më 05. 11. 2023.
4. Malcolm Noel, Kosova një histori e shkurtër, përktheu: Abdullah Karjagdiu, (Prishtinë: KOHA, 2011),
5. Imeraj Shkodran, "Aspekte të jetës politike në Kosovë, gjatë viteve 1968-1990", Temë Doktorature, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, 2017.
6. Schmitt Jens Oliver, Kosova - Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike, përktheu: Enver Robelli, (Prishtinë: KOHA, 2012).
7. Bytyçi Hysni, Kosova dhe shqiptarët - Pozita kushtetuese - juridike e shqiptarëve në ish - Jugosllavi, Prishtinë: 2006.
8. Žagar Mitja, "The collapse of the Yugoslav federation and the viability of asymmetrical federalism", in Sergio Ortino, Mitja Žagar, and Vojtech Mastny (eds.)
9. Berisha Ibrahim, Vdekja e Kolonisë, Prishtinë: Artini, 2016.
10. Novosella Selatin, Demonstratat e gjashtëdhjetetës, monografi, (Prishtinë: Shoqata e të Burgosurve Politikë, 2008).
11. SHBPK; IHK; IAP; Demonstratat e vitit 1968, Prishtinë 2018, Izet Barali: Rrethanat që iu paraprinë Demonstratave shqiptare në rrethin e Therandës më 1968.
12. Rajoviq R, Zhvillimi kushtetues nga autonomia deri në reformen e vitit 1089: Kosovo, Past and Present", Beograd, 1989.
13. Hoxha Fadil: Jemi në shtëpinë tonë, Prishtinë, 1986.
14. Milena Popovica, "The Impact of World War II on Kosovo-Albania Relations: A Comparative Historical Study", European Journal of History.
15. Crampton, R. J., The Balkans Since the Second World War. "Chapter 3: Albania, 1944-1948. 2002. London: Longman.
16. Federal Research Division, Library of Congress. Albania: A Country Study. Sudetic, Charles. "Chapter 1: Historical Setting: Communist Albania: Albania and the Soviet Union." [http://memory.loc.gov/cgi-bin/query/r?frd/cstdy:@field\(DOCID+al0038\)](http://memory.loc.gov/cgi-bin/query/r?frd/cstdy:@field(DOCID+al0038))

RECENSIONE

NË Ç'MËNYRË FOUCAULT E KA LEXUAR NIETZCHEN

Libri i porsabotuar i Michel Foucault-së me titullin *Nietzsche, Cours, conférences et travaux (Ligjërata, kumtesa dhe punime)*, (EHSS-Gallimard-Seuil, Paris, 2024) përmban tekste të shkruara nga fillimi i viteve 1950.

Në njërën nga artikujt e kësaj periudhe Foucault na njofton se zbulimi i teksteve të Nietzsches ka qenë për të një “shok filozofik”. Ai njëherësh aty shton se kurrë nuk kishte shkruar asgjë mbi Heideggerin, kurse për Nietzsche “vetëm një artikull të shkurtër”. Por megjithatë, shton ai, këta “dy autorë i kishte lexuar më së shumti”. Në vijim Nietzsche saktëson: “Mendoj se është e rëndësishme të kemi një numër të vogël të *autorëve me të cilët mendojmë*, me të cilët punojmë, por për të cilët nuk shkruajmë.”

Botuesit e këtij libri sqarojnë se këto tekste janë dëshmi të pabotuara të “punës” së Foucault-es me Nietzsche. Ata shtojnë se këto tekste i takojnë dy periudhave të mëdha të jetës së tij intelektuale: së pari asaj nga fillimi i viteve 1950, kur ai interesohej për Hegelin dhe fenomenologjinë, sikurse edhe për mendimin e Marksit. Foucault eksperimentonte asokohe, cekin autorët, me *qasje të reja* për ta zhvilluar një filozofi e cila mbështetet në eksperiencën dhe analizën e diskursit. Kurse pas botimit të veprës së tij *Fjalët dhe Gjërat (Les mots et les choses, 1966)*, kur Foucault i kthehet me entuziazëm Nietzsche, për ta elaboruar metodën e vet gjenealogjike, duke e aktualizuar kësodore sërish projektin e tij për një histori të së vërtetës dhe të thënit e vërtetë.

Botuesit saktësojnë se Foucault pikërisht përmes *konfrontimit me Nietzsche* do ta ndërtojë mënyrën e vet specifike të të filozofuarit. Ata, së fundit, shtojnë se tekstet e këtij libri na ndihmojnë të kuptojmë *në ç'mënyrë Foucault e ka lexuar Nietzsche*, në veçanti në momentin kur e zbulon atë. Ato tekste janë “thelbësore për Nietzsche e Foucault-së”.f.3

Në pjesën e parë të këtij libri Foucault (Fuko) merr në shqyrtim kërkimet « jobashkëkohore » (*Considérations inactuelles*) të Nietzsches, në radhë të parë, « individin johistorik », « individin historik » dhe « individin *mbihistorik*.

Në vijim ai zbërthen *tre tipat* e historisë të cilat Nietzsche i kishte emërtuar si *histori monumentale*, *histori antikuare* dhe *histori kritike*. Ndërkaq, « sensin historik » ai e problematizon si prirje për t'iu kundërvënë historisë, por jo aq si tendencë e cila do të synonte t'i ikë bashkëkohësisë në të cilën jetonte.

Foucault analizon në këto shkrime *zgjimin* në lidhje me procesin e të *ndodhurit* historik dhe sajimin e një njohurie historike. Zgjim ky që dallon nga një analizë historike, e cila mbështetet në filologjinë dhe historinë e popujve. Foucault njëherësh ndriçon formësimin e një njohurie të mirëfilltë historike.

Ai analizon këtu tri format e historisë në të cilat jeta gjen *dobishmërinë* e vet: historinë *monumentale*, atë *antikuare* dhe historinë *kritike*. Kurse në vijim ai shqyrton rrjedhojat e dëmshme nga një *tepëri* e historisë, e në veçanti *dobësimin e individualitetit* të njeriut në bashkëkohësi. f.4

Foucault shpjegon se *historia monumentale* kufizon duke zgjedhur sublimen; ajo përvetëson duke riaktivizuar diçka nga e kaluara e njëherësh synon të bëjë vetë diçka të madhe.

Kurse *historia antikuare* kufizon horizontin tonë. E prirur që të admirojë, ajo njëherësh *nënshtrohet* duke dashur të admirojë vazhdimësinë e vet.

Ndërkaq, *historia kritike* kufizon si praktikë e cila bën dallimin midis të drejtës dhe të padrejtës; ajo përvetëson duke pranuar apo duke refuzuar diçka; ajo njëherësh dëshiron të çlirohet nga pesha ngufatëse e së kaluarës; këtu shfaqet edhe prirja e Nietzsches që të vërë në pah atë që është e dobishme për jetën

Kurse historia kritike *kufizon* si praktikë e cila e bën dallimin midis të drejtës dhe të padrejtës; ajo përvetëson duke pranuar apo duke refuzuar diçka; ajo njëherësh dëshiron të çlirohet nga *pesha ngufatëse* e së kaluarës. Këtu shfaqet edhe prirja e Nietzsches që të vërë në pah atë që është *e dobishme* për jetën. f.5

Momenti i fundit vë në pah se e tërë njohja e historisë na ka shpënë te momenti përfundimtar: te skepticizmi ndaj ardhmërisë.

Foucault mendon se Nietzsche synonte ta çlirojë *mbihistorikën* nga karakteri eskatologjik, në mënyrë që ajo të paraqitet jo si akumulim i gjithçkaje, por si *kthim i së njëjtës*.

Nga kaptina e dytë për historinë jobashkëkohore Nietzsche flet më shpesh për *sensin historik* sesa për historinë si shkencë: *Njerëzor*,

tepër njerëzor, Agu i mëngjesit, Dija e gëzuar dhe Gjenealogjia e moralit.

Sensi historik, ndryshe nga historia, është ajo që zgjon kureshtjen dhe praktikën e historianëve.

Për Nietzsche-n *shqisat dhe trupi* kanë një histori. Ai cek se madje edhe shikimi vizionar i metafizikës varet nga dobësimi i shqisave.

Sensi historik ka një histori të vonshme, e madje këtë e gjejmë vetëm në Evropë. Foucault nënvizon se ky « është element diferencial i Evropës » .f.7

Kësodore, sensi historik është pra kushti ose kondita e historisë, e madje edhe kondita *trupore*.

Po kështu, saktëson Foucault, është elementi gjenealogjik ai që e bën të mundur njëherazi historinë dhe kritikën e shkencës; Nietzsche zaten shkruante se origjina e kulturës historike duhet të studiohet nga pikëpamja historike.f.13

Barbaria dhe barbarët si të padenjë për t'u njohur. Megjithëkëtë, ai shton se e gjermanëve dhe gotëve te portat e perandorisë romake ishte megjithatë një lloj i njohjes së një civilizimi të huaj.

Njohja historike është rënie në barbari.

Foucault shtron supozimin se te Nietzsche gjejmë mundësinë që sensi historik - ky element diferencial i Evropës moderne – bën të mundur një formë kulturore të ngritur.(« Lule e mrekullueshme me parfymë të mrekullueshme » (*Dija e gëzuar*, aforizmi 36.)

Më tutje ai shton: « Gëzimi ynë është gëzimi i të pakufishmes... ne i hudhim poshtë frerët përballë të pakufishmes, sikurse kalorësi me kalin e vet të lodhur... »

Nietzsche mendon se « *Mischmensch* » (« njeriu i përzier » i shekullit XIX kërkon *identitetin* e vet; ai e kërkon atë brenda të gjitha atyre identiteteve të përziera, me të cilat është formuar ai vetë. Ai kërkon brenda vetes *një identitet tjetër*.

Shijet e tij historike, saktëson Nietzsche, për njeriun greko-romak me Winckelmann, për njeriun e Mesjetës me romantikët, për njeriun e Renesancës me Burckhardt janë *dëshira të identifikimit*.

Nuk është fjala për të rikonstruktuar një identitet i cili do të na vinte disi nga jashtë. Për Nietzschen është me rëndësi që t'i nxjerrim nga *vetja jonë* të gjitha ato identitete dhe t'i bëjmë jo si të vërteta, por si « maska ». Të jemi mjeshtër të natyrës sonë, ose madje « travestitët » e vetvetes dhe « bufonët të zotit ».

Parodia është përsëritja që nuk ka qëllimësinë e unë-ve [ego-ve] të shumëfishtë, ashtu si janë shpaluar ato brenda *Fenomenologjisë* së Hegelit, por një « unë » i cili është historikisht i shumëfishtë. f.41-42.

Këtu Foucault citon tri pasazhe të Nietzsches: « falja vetes *Unin* tënd, sepse, sido që të jetë, ti ke brenda vetes një shkallë me njëqind nivele, me të cilat ti mund të ngrihesh te njohja ». Pastaj kërkesën e tij se duhet ta bëjmë një « udhëtim restrospektiv, duke ecur nëpër rrënojat në të cilat njerëzimi ka shënuar rrugëtimin e tij të mundimshëm nëpër shkretëtirën e tij të së kaluarës ». Ndërkaq, shton ai, ndonëse ti kërkon se në ç'drejtim « nyja e ardhmërisë është ende e mbërthyer, jeta juaj merr vlerën e një mjeti për të njohur.f.35

Duke shqyrtuar dallimet midis kulturave, Nietzsche thekson se ai nuk e kupton ardhmërinë e historisë si akumulim të një dije, por si « rritje e një ndjenje apo e një lumturie. » Ndërkaq, akumulimi pozitivist i të dhënave të një historie shkakton, në të vërtetë, « dobësimin e fuqisë së individit duke « ngrirë çfarëdo jete tek ai ».

Ai thekson se dallimi i individualitetit nënkupton « të jesh një dallim pa u krahasuar”.

Muhamedin Kullashi

Hivzi Islami dhe Arsim Ejupi “Gjeopolitika, territori,
konflikti: Politikat hegjemoniste, kolonialiste dhe
kolonizuese serbe ndaj Kosovës dhe shqiptarëve”
ASHAK, 2024, fq. 570

Botimi “Gjeopolitika, territori, konflikti”, me nëntitull “Politikat hegjemoniste, kolonialiste dhe kolonizuese serbe ndaj Kosovës dhe shqiptarëve” i autorëve akademik Hivzi Islami dhe profesor Arsim Ejupi është një studim i bazuar në qasje multidisiplinare ndaj problemeve të gjithëmbarshme që kanë preokupuar Kosovën dhe shqiptarët ndër vite.

Ky studim është i kompletuar, i mbështetur në literaturë relevante dhe i realizuar në përputhje të plotë me metodologjitë moderne shkencore. Punimi është shumë i pasur me të dhëna dhe fakte specifike nga gjeopolitika, historia, demografia, ekonomia, sociologjia dhe fusha të tjera që lidhen me konfliktet territoriale, luftërat dhe spastrimet etnike, në veçanti në Ballkan, të nxitura nga hegjemonizmi serb, nga i cili e pësoi më së shumti Kosova dhe shqiptarët.

Sipas autorëve, në vitet 80 të shek. XX pushteti serb dhe organet e ish-Federatës, Maqedoninë e përdornin si model dhe territor provues për represionin, ndjekjen dhe shpërnguljen e shqiptarëve, kryesisht për ta kufizuar normën e natalitetit të tyre, reduktimin e shkollimit në gjuhën shqipe dhe zhvillimin e përgjithshëm, në mënyrë që pastaj t’i zbatonin më lehtë në Kosovë. Regjimi i Millosheviqit me të gjitha mjetet u vërsul mbi themelet e jetës së shqiptarëve: përmes deportimit masiv dhe zhdukjes së dokumentacionit më 1999. Ky regjim donte ta dehumanizonte gjithë bashkësinë shqiptare dhe ta këpuste çdo lidhje juridike të shqiptarëve me truallin gjeoetnik të tyre, ta rrëronte tërësisht një etni, një kulturë dhe një shoqëri.

Për të përmyllur harkun kohor më shumë se njëshekullor të zhvillimeve të vullshme gjeopolitike në Ballkan dhe në veçanti në trojet shqiptare, autorët në këtë botim trajtojnë edhe “korrigjimin e kufirit” Kosovë-Serbi dhe idetë e reja (të vjetra) për shkëmbimin e territoreve dhe popullatave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Si projekte dhe ide i takojnë mendësisë së shekullit të kaluar të Serbisë hegjemoniste dhe të gjitha janë në kundërshtim të plotë me realitetin aktual,

sepse rrezikojnë zhbërjen e shtetit të ri të Kosovës dhe integritetin territorial të tij.

Autorët Islami dhe Ejupi trajtojnë edhe Planin e quajtur Franko-Gjerman (versioni i parë u prezantua më 27 shkurt 2023, ndërsa ai final më 6 mars 2023) dhe platformës së zbatimit të tij, që u pranua në takimin e Ohrit më 18 mars 2023. Këto dy dokumente konsiderohen marrëveshje ndërkombëtare. “Por jo mes Kosovës dhe Serbisë. Është mes Serbisë dhe BE-së dhe Kosovës e BE-së, diçka krejtësisht e pazakontë në një proces normalizimi”. Ky fakt nënkupton se obligimet e marra janë të ndara, Serbia të vetat dhe Kosova të vetat. Disa obligime të Kosovës kanë afate, ndërsa të Serbisë sikur nuk kanë afate! Krejt çka kërkon BE-ja dhe SHBA-ja nga Serbia është njëfarë “distancimi” nga Rusia.

Si njohës dhe ndjekës të zhvillimeve gjeopolitike në kontekstin historik dhe aktual, në përmasa rajonale dhe kontinentale, autorët nuk lënë anash pa përmendur as zhvillimet më të fundit pas agresionit rus në Ukrainë më 24 shkurt 2022, që ndikuan në raportet SHBA-Rusi, BE-Rusi, Lindje-Perëndim, sikundër që ndryshoi edhe rendi botëror dhe raportet në përmasa planetare. Me këtë plan fashist të Rusisë po nis një fazë e re e “neosovjetizimit” të Rusisë apo një epokë e re gjeopolitike si “Luftë e Re e Ftohtë”, me një Stalin të ri apo Hitler të ri; bota nuk është më ajo që ishte. Autorët bëjnë një analogji dhe tërheqin një paralele midis Hitlerit të Gjermanisë nacistë dhe Putinit të Rusisë agresore, me një dallim se Putini posedon armë bërthamore, me të cilat po e kërcënon gjithë planetin, por frikën më të madhe e mbolli te ish-republikat e BRSS-së. Por as Perëndimi dhe NATO-ja nuk kishin reagime të fuqishme kur Rusia e pushtoi Krimenë në vitin 2014. Reagimet dhe mbështetja ushtarake dhe humanitare për Ukrainën erdhën vetëm pas 24 shkurtit 2022, kur dolën sheshazi ambiciet ruse të Putinit.

Një aspekt tjetër i veçantë i këtij studimi janë edhe paradigmat “Bota serbe” dhe “Bota ruse”, të cilat janë eufemizma për realizimin e qëllimeve ekspansioniste të të dyja shteteve në hapësirat ku sundonin dikur: të Rusisë në hapësirën e dikurshme sovjetike dhe të Serbisë në hapësirën e ish-Jugosllavisë dhe rajonin e Ballkanit. Siç vënë në pah autorët këto janë politika retrograde. Kjo vërehet në rajon, ku Serbia tenton ta sundojë Malin e Zi, Bosnjë e Hercegovinën, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut. Dhe fatkeqësisht, kjo politikë ende nuk ka marrë përgjigje adekuate nga fuqitë perëndimore.

Në vazhdim autorët tërheqin vërejtjen për rrezikun e dëmtimit të raporteve miqësore të Kosovës me aleatët, në veçanti me SHBA-në. Në

këtë kontekst zënë në gojë Dobrica Qosiqin, i cili thoshte se “Kosova nuk kthehet me luftë. E vetmja mënyrë për ta kthyer Kosovën është kur klima antiamerikane zë rrënjë në Kosovë. Kur shqiptarët ndjehen të vetëmjaftueshëm dhe nacionalizmi për të mbajtur e ruajtur pushtet del para strategjisë amerikane e evropiane. Shërbimet tona duhet të punojnë në Kosovë e ta ndërtojnë një imazh që e imiton nacionalizmin e verbër të Millosheviqit. Kur të vijë ai moment, atëherë ngjallet shpresa serbe”!

Disa nga problemet shumë komplekse të cilat i trajtojnë autorët e këtij botimi janë edhe kufijtë dhe konfliktet territoriale dhe politikat hegjemoniste, kolonialiste dhe kolonizuese serbe ndaj Kosovës dhe trojeve të tjera etnike, si në Ballkani si “fuçi baruti” dhe paaftësia e “Kontinentin Plak” për zgjidhjen e problemeve në truallin e vet.

Çështja e kufijve trajtohet në përgjithësi dhe në hapësirat konkrete, sikurse është p.sh. kufiri midis Kosovës dhe vendeve fqinje, në veçanti me Serbinë, përfshirë debatet rreth shkëmbimit të territoreve midis saj dhe Serbisë dhe procesit të demarkimit të kufirit midis Kosovës e Malit të Zi. Tema e demarkacionit nisi dhe mbeti një kauzë e rrejshme e disa grupacioneve politike shqiptare të Kosovës dhe kufiri Kosovë - Mali i Zi mbeti aty ku ishte vijëzuar para 15 shkurtit 1947. Për moszgjidhjen e këtij problemi çmimin e paguan qytetarët e Kosovës, të cilët mbetën të izoluar në lëvizjen e lirë në hapësirën e BE-së. Liberalizimi faktik i qytetarëve të Kosovës ndodhi vetëm nga 1 janari 2024.

Tema në vete që trajtohen në këtë studim janë demopolitika dhe gjeopolitika; Kosova në rrjedhat gjeopolitike dhe gjeopopullative vështruar në prizmin historik dhe etnik; konteksti i ndërlikuar i një lufte mirë të përgatitur përmes të ashtuquajturit “Front i Jugut” në fillim të viteve 90; pastaj migrimet e jashtme dhe konteksti gjeohapësinor dhe gjeopolitik etj. Një pjesë e librit i kushtohet ujit si burim i konflikteve dhe mosmarrëveshjeve, si dhe bashkëpunimit ndërkuftitar të Luginës së Preshevës (përparësitë dhe problemet gjeopolitike), si dhe mbrojtja ndërkuftitare e natyrës në funksion të arritjes dhe mirëmbajtjes së paqes.

Në shtojcë jepen pjesë të zgjedhura të tri dokumenteve në bazë të të cilave mund të kuptohet rikonfigurimi dhe ristrukturimi gjeopolitik i hapësirës ballkanike, evropiane dhe botërore pas Luftës I Botërore dhe Konferencës së Versajës (1919): njëri që nxiti luftëra në baza etnike dhe solli gjakderdhje masive (“Memorandumi” i SANU-së, 1986); teksti i dytë në formë të konkluzave nga libri i njohur i autores Margaret Macmillan, *Six Months that Changed the World*, New York, 2001 (“Paris, 1919 - Gjashtë muaj që ndryshuan botën”, Tiranë, 2006), si dhe

i treti që ka të bëjë me “Katërbëdhjetë pikat” e njohura të Presidentit të SHBA-së, Woodro Wilsonit në Konferencën e Paqes në Versajë (1919). Shtojcës i bashkëngjitet edhe një tekstdokument në origjinal i vitit 1940 për Kosovën, i hartuar nga Mosha Pijade (1890-1957), si njeri i katërt në hierarkinë shtetërore të ish-Jugosllavisë. Pijade theksonte se zgjidhja e lëvizjes nacionale në Kosovë “mund të arrihet duke formuar Republikën e Lirë Fshatare-Punëtore të Kosovës përmes rrëzimit revolucionar të regjimit fashist dhe imperialist serbomadh”. Dhe krejt në fund jepet një pasqyrë e literaturës e burimeve, një rezyme në anglisht dhe indeksi i emrave.

Frashër Demaj

STUDIM ME RËNDËSI SHKENCORE DHE PRAKTIKE

Valbon Bytyqi “UJËRAT DHE POPULLSIA: Shpërndarja territoriale dhe kohore e ujërave dhe e popullsisë në Kosovë”, ASHAK, 2024, fq. 602

Prof. Valbon Bytyqi është tashmë një ekspert i njohur në shkencat gjeohapësinore. Ka botuar disa libra shkencorë dhe shumë artikuj në revistat prestigjioze shkencore ndërkombëtare në Evropë dhe jashtë saj. Vetëm në Akademinë tonë i ka botuar dy libra shkencorë dhe shumë artikuj në revistat e saj, në “Studime” dhe “Studime Shoqërore”; ka marrë pjesë në tryezat dhe konferencat tona shkencore dhe profesionale. Ka punuar dhe punon edhe në disa projekte shkencore në Akademi. Flet anglisht dhe gjermanisht, por lexon dhe kupton edhe serbokroatisht, të cilën e ka mësuar nga shfrytëzimi i hartave të ndryshme gjeohapësinore. Ka mbajtur ligjërata nga fusha e tij në disa universitete të huaja në kuadër të programeve përkatëse ndërkombëtare.

Dr Valboni ishte njëri ndër motorët kryesorë të realizimit të projektit “Leksikoni i vendbanimeve të Kosovës”, një trashëgimi e madhe për shkencën dhe kulturën tonë. Pa Valbonin pjesa fizike-hapësinore nuk do të realizohej me sukses. Ai i nxirrte në ekran hartat gjeografike, topografike, hidrologjike, klimatologjike, gjeologjike, pedologjike, statistikën zyrtare etj. dhe i lexonte, i analizonte të dhënat dhe i nxirrte konkluzionet. Kudo që gjendesh, nëse e ke Valbonin pranë, informohesh për çdo detaj dhe situatë mbi tokë dhe nën tokë.

Botimi që po e përurojmë sot shqyrton relacionet e ndërvarura dhe të ndërlidhura midis ujërave dhe popullsisë në Kosovë, duke trajtuar këtë binom në dimensionin hapësinor dhe kohor. Autori duke përdorur të dhënat ekzistuese për të gjitha objektet ujore të Kosovës, sikurse ujërat sipërfaqësore, ashtu edhe ato nëntokësore, tregon rolin e elementeve dhe faktorëve natyrorë në shtrirjen hapësinore dhe kohore të tyre. Në botim analizohen faktorët determinues në hidrografinë e Kosovës, ndërsa konkludohet se pjesa perëndimore e Kosovës, për shkak të klimës së ndikuar prej masave ajrore nga detet e nxehta mesdhetare dhe relievi malor është më e pasur me ujëra, ndërsa sistemi lumor i Drinit të Bardhë që korrespondon me pjesën perëndimore të

vendit është sistemi më i pasur lumor në Kosovë. Kurse, pjesa lindore është më e varfër me ujëra sipërfaqësore e nëntokësore. Në pikëpamje hidrologjike Kosova është ndër vendet më specifike nga se nuk merr ujë, por vetëm derdh ujë – Ujërat e saj derdhen në tri dete: në Adriatik, në Egje dhe në detin e Zi.

Studimi monografik “Ujërat dhe popullsia” përmban hyrjen dhe metodologjinë e punës, ku autori thekson rëndësinë e ujërave dhe ndërlidhjen me popullsisë, ndërsa te metodologjia shqyrton metodat dhe materialet e përdorura për t’i arritur përfundimet përkatëse shkencore. Botimi është shtjelluar në 16 kaptina e shumë nënkaptina dhe ka 602 faqe tekst, më shumë se 170 njësi bibliografike, 312 harta, shumë ilustrime origjinale e fotografi të terrenit të cilat dëshmojnë relacionet ujëra-popullsi, ka 106 tabela, përfundimin në shqip dhe anglisht, si dhe indeksin e emrave.

Në fillim analizohen kushtet natyrore të cilat kanë determinuar veçoritë ujore të Kosovës. Analizohen raportet e ndërvarura dhe të ndërlidhura me relievin, ndërtimin gjeologjik dhe klimën me veçoritë hidrografike të vendit. Autori nxjerr përfundimin se ndërtimi litologjik ka përcaktuar kushtet hidrogeologjike të vendit, ndërsa relievi dhe klima kanë ndikuar në veçoritë hidrografike, përkatësisht pasuritë ujore të Kosovës. Në hollësi analizohen ujërat e Kosovës, përfshirë ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, si dhe shpërndarja hapësinore dhe kohore e tyre (burimet, lumenjtë etj.) dhe paraqiten karakteristikat hidro-klimatike të tyre (prurja, regjimi, ujëdhënia etj.) si elemente specifike të sistemeve lumore në Kosovë.

Në një pjesë të librit jepen disa të dhëna të popullimit të hershëm të Kosovës, duke theksuar lokacionin e vendbanimeve dhe të popullsisë afër lumenjve, si vende me kushte më të mira për jetë, ku ka pasur në dispozicion përveç ujit edhe tokën bujqësore. Në bazë të dokumenteve të mëvonshme, autori konstaton se janë evidentuar thuajse vendbanimet e njëjta të cilat përmenden edhe sot në Kosovë. Jep të dhëna populative që nga fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX, duke analizuar ecurinë kohore dhe ndryshimet në hapësirë.

Pastaj analizohet shtrirja kohore dhe hapësinore e popullsisë dhe e vendbanimeve në raport me ujërat në Kosovë, më konkretisht në relacion me ujërat nëntokësore dhe ujërat rrjedhëse (sipërfaqësore). Duke analizuar shpërndarjen e popullsisë në akuiferët - me porozitet intergranular që gjenden kryesisht në fushat e Kosovës, autori konkludon se 81.1% e popullsisë së Kosovës në këto lloje akuiferësh janë të shtrirë 56.4% e vendbanimeve. (*Akuiferët janë formacion gjeologjik*

me material mjaftueshëm të depërtueshëm – rërë dhe zhavor – për të ruajtur ujërat nëntokësore). Ky dallim ndërmjet përqindjes së vendbanimeve dhe të popullsisë tregon rolin e ujërave nëntokësore në lokacionin e vendbanimeve dhe rritjes së numrit të popullsisë ndër vite. Madje këta akuiferë konsiderohen si akuiferë me dendësi të madhe të banimit (446 b/km²), 3 herë më e madhe se mesatarja e Kosovës. Krahas rritjes së popullsisë mbi këta akuiferë autori thekson rritjen e hapësirës së ndërtuar (zona artificiale) të cilat kontribuojnë në pengimin e infiltrimit të ujërave të reshjeve duke nxitur vërshimet. Në terrenet kodrinore-malore janë të lokalizuara rreth 1/3 e vendbanimeve, ndërsa vetëm 1/6 e popullsisë. Në akuiferët e pasur me ujëra dominojnë kryesisht vendbanimet e mëdha dhe të mesme, ndërsa ka më pak vendbanime të vogla. Ndërsa vendbanimet e vogla të terreneve kodrinore-malore kanë pësuar rënie të numrit të popullsisë në krahasim me vendbanimet e mëdha fushore.

Në vazhdim autori analizon shpërndarjen e popullsisë në raport me ujërat rrjedhëse të Kosovës. Duke analizuar pellgjet lumore në vend, vihet theksi te shpërndarja jo e barabartë e popullsisë sipas pellgjeve detare dhe sistemeve lumore. Pastaj, analizohet shpërndarja e popullsisë në largësi të lumenjve, ku dominon koncentrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë në distancë të vogël nga rrjedhat ujore ku ndodhet rreth 1/2 e territorit të Kosovës, ku janë të lokalizuara 60% e vendbanimeve, ndërsa jetojnë diçka më shumë se 70% e popullsisë (2011), duke deshmuar rolin e rrjedhave ujore në aktivitetet social-ekonomike të popullsisë së Kosovës. Ndërsa në aspektin kohor, ky brez i largësisë ka shënuar rritjen më të madhe të popullsisë në vend. Përveç këtij fakti, vihet theksi në rritjen e disa vendbanimeve të mëdha që nuk kanë rrjedha të fuqishme ujore (sikurse Prishtina, Ferizaj e Gjilani), të cilat janë zhvilluar si qendra regjionale dhe kryeqendër, duke siguruar ujin e pijshëm përmes akumulacioneve dhe sistemeve të furnizimit me ujë, që tregon zvogëlimin e varshmërisë së ekzistencës së vendbanimeve të mëdha me lumenjtë. Autori nënvizon faktin e ndikimit të burimeve ujore (gurrave) në lokacionin e vendbanimeve në terrenet karstike, të njohura si terrene të varfër me hidrografi sipërfaqësore. Në këto lokacione janë zhvilluar shumë vendbanimeve të mesme e të mëdha (p.sh. në Has), madje edhe qendra komunale (p.sh. Istogu).

Në një kaptinë analizohet shtrirja e popullsisë sipas lartësisë mbidetare. Duke marrë në konsideratë relievin si faktor përcaktues të klimës, tokës bujqësore dhe problemet që ndërlidhen me të jetuarit në lartësi të mëdha, autori konstaton se pjesa dërmuese e popullsisë dhe e

vendbanimeve në Kosovë është e lokalizuar në lartësi deri 700 m, ku janë të shtrira 71.7% e vendbanimeve dhe 92.7% e popullsisë së Kosovës, duke treguar koncentrim të madh në viset fushore të vendit dhe në terrenet përgjatë lumenjve. Kjo ndërlidhje ekziston për faktin se janë të pasura me ujëra nëntokësore në viset fushore, ndërsa nxjerrja e tyre është e lehtë (puset, bunarët).

Në një pjesë tjetër të botimit trajtohen resurset ujore të Kosovës. Theksohet prania e akumulimeve të rëndësishme të ujërave nëntokësore, sidomos në pjesën perëndimore dhe juglindore të fushës së Dukagjinit, ndërsa sa u përket ujërave rrjedhëse më i pasur është sistemi lumor i Drinit të Bardhë, pastaj i Ibrit, i Lepencit dhe i Moravës së Binçës.

Duke analizuar reshjet si faktor themelor në krijimin e resurseve ujore, në botim analizohet shpërndarja e reshjeve, e ujëdhënies dhe shpërndarja territoriale e kohore e ujërave rrjedhëse në Kosovë. Analizohet prurja, moduli i rrjedhës, variacioni brenda sistemeve lumore, për të ardhur në përfundim për shpërndarjen e resurseve ujore në nivel vendi dhe analizat për nivel të pellgjeve lumore. Këtu trajtohet shpërndarja e ujërave rrjedhëse në raport me popullsinë, ku Kosova klasifikohet si vend në kufi të stresit ujqor, ndërsa disa pellgje lumore si vende me stres ujqor, e që herë pas herë dëshmohej me mungesën e ujërave në sistemin e furnizimit të popullsisë. Për të zvogëluar impaktin e klimës së Kosovës e cila karakterizohet me vera të nxehta e mjaft të thata, në Kosovë gjatë shekullit të kaluar janë ndërtuar akumulacionet artificiale (liqenet) të cilat në studim trajtohen në një kaptinë tjetër, ku autori tregon karakteristikat morfometrike të tyre, përfshirë pozitën, vëllimin dhe distribuimin e ujit përmes hidroekonomisë etj.

Në kaptinën e fundit të librit shkencor analizohet shfrytëzimi i ujërave në Kosovë, që nga amvisëria, bujqësia, hidroenergjetika dhe rekreacioni, si sektorët me shfrytëzim më të madh të ujit, duke deshmuar rëndësinë e ujit dhe përdorimin e shumëfishtë në segmente të ndryshme të jetës. Pastaj analizohen objektet hidrike si lokalitete me rëndësi të veçantë për qëllime rekreacioni, turizmi, edukimi, studimi etj. Në botim paraqiten objektet hidrike si pika të veçanta në itinerarin e lëvizjeve turistike në Kosovë, sikundër që trajtohen problemet me ujërat në Kosovë, ku analizohen ndotja dhe monitorimi i ujërave, degradimi i shtretërve të lumenjve dhe vërshimet, duke pasqyruar edhe mundësitë e mbrojtjes nga këto rreziqe. Në fund, autori analizon aspektin ligjor të ujërave, duke trajtuar dokumente të Asamblesë së Kombeve të Bashkuara ku theksohen të drejtat e njeriut për ujë dhe kanalizim, pastaj

Direktivën 2000/60/EC të Bashkimit Evropian, si dhe pozitën e Kosovës në trajtimin e këtyre problemeve në raport me plotësimin e dokumenteve përkatëse. Duke qenë se ujërat rrjedhëse të Kosovës janë ujëra ndërkuftare, në studim analizohen Rregullat e Helsinkit, Rregullat e Berlinit, si dhe problemet me ujërat ndërkuftare të Kosovës në raport me vendet fqinje.

Në fund, mund të konkludohet se botimi shkencor *“Ujërat dhe popullsia” - Shpërndarja territoriale dhe kohore e ujërave dhe e popullsisë në Kosovë* paraqet një analizë të detajuar të shpërndarjes së ujërave dhe të popullsisë në Kosovë, duke treguar relacionet shumë-dimensionale të shfrytëzimit të ujit, ndërvarësisë dhe ndërlidhjes me njeriun, deri tek aspekti ligjor, hidroekonomik dhe problemet me ujërat në vend. Botimi është realizuar me një qasje të re, metodologji unike dhe ofertë krejtësisht të re shkencore dhe praktike për instancat e pushtetit, qendror dhe komunal, si dhe për vendbanimet për nevoja të ujit të pijes, për ujitje, për infrastrukturë, si dhe për planifikim hapësinor, ekonomik, urbanistik, shoqëror etj. Libri shkencor mund t’u hyjë në punë profesionistëve të fushave të ndryshme të cilët i trajtojnë relacionet ujëra-popullsi.

Autorin e përgëzojmë për punën e bërë dhe i urojmë suksese të tjera në të ardhmen!

Hivzi Islami

AKADEMIK MUHAMEDIN KULLASHI, NJË PERSONALITET I SHQUAR NË FUSHËN E SHKENCËS DHE TË DIPLOMACISË KOSOVARE

*(Me rastin e përrurimit të librit të tij “KOSOVA NË FUSHËN E
DIPLOMACISË NË FRANCË, 2008-2016”, ASHAK, 2022)*

Është i njohur fakti se diplomatët e kujdesshëm, me formësim të gjithanshëm dhe të përkushtuar në misionin e tyre për ta përfaqësuar sa më dinjitetshëm shtetin e tyre, sidomos ambasadorët e karrierës, lënë shkrime dhe dëshmi në formë të kujtimeve, ditarëve apo edhe autobiografive për vendet ku kanë shërbyer dhe raportet e tyre me vendin që e përfaqësojnë. Një rrëfim përtej këtyre modeleve, në formë të librit, na la edhe prof. Muhamedin Kullashi. Libri pasqyron historikun e marrëdhënieve franko-kosovare, kryesisht për një periudhë rezultative për ne, që kap vitet 2008-2016, kur ai ishte ambasador i parë i jashtëzakonshëm dhe fuqplotë i Republikës së Kosovës në Republikën e Francës. Botimi ka edhe një veçanti: përmban të dhëna, fakte dhe aparaturë shkencore.

Prof. M. Kullashi edhe para se të emërohej ambasador në Paris, si profesor i filozofisë në Universitetin “Paris 8”, gati dy dekada ishte ambasador joformal i Kosovës në këtë vend: ishte i pranishëm në çdo sferë të shoqërisë franceze, para së gjithash, në qarqet akademike, intelektuale dhe mediatike, ku luftonte për përhapjen e të vërtetës për Kosovën dhe ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës. Që në vitin 1992, prof. Kullashi mori pjesë aktivisht në themelimin e Komitetit të Kosovës në Paris në revistën prestigjioze për shkencat shoqërore “Esprit”, së bashku me intelektualët e shquar francezë Olivier Mongin, Antoine Garapon, Pierre Hasner, Pascal Brucner, André Gluksman, Véronique Nahoum-Grap, Edgard Morin, Claud Lefor etj. Komiteti për Kosovën zhvilloi aktivitete të shumta deri në vitin 2015, duke luajtur një rol të madh në sensibilizimin e çështjes së Kosovës, veçanërisht në kohën e agresionit të regjimit të Beogradit ndaj shqiptarëve të Kosovës në vitet 90. Prof. Kullashi me anëtarët e këtij Komiteti arriti të takohej në vitin 1999 dy herë me Presidentin J. Chirac gjatë bombardimeve të NATO-s për ta kurajuar që t’i mbështeste bombardimet në caqet legji-

time ushtarake dhe policore serbe, ngase ai kishte disa hezitime në sulmet e NATO-s mbi disa caqe serbe. Ai edhe vuri veto në bombardimin e Marinës dhe të Gazelës - urat e Beogradit.

Një shtet, i cili pothuajse gjithmonë, historikisht, ishte në anën e Serbisë, në një periudhë vendimtare për Kosovën këto 100 vjetët e fundit, u rreshtua mbarë: u shkëput nga politika e Presidentit F. Miteran si proserb i dëshmuar jo vetëm në rastin e Kosovës, por edhe të Bosnjë e Hercegovinës. Franca si anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së iu bashkua aleatëve në bombardimin e Serbisë më 1999, kur presidenti Jacques Chirac, në ditarin e lajmeve në TV-në shtetërore çdo ditë e njoftonte dhe e kurajonte opinionin se duhet ta mposhtin barbarinë serbe, siç e quante ai, në ndaljen e tragjedisë humanitare dhe politikës së spastrimit etnik të shqiptarëve. Këtë e bënte edhe Kryetari i Qeverisë Lionel Jospin. E dyta, në vitin 2008, Franca ishte ndër të parat që e njohu Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Vetëm disa ditë para shpalljes së njohjes zyrtare, presidenti Nicolas Sarkozy shkoi në një shkollë fillore dhe para një harte të botës u tha nxënësve se këto ditë kësaj harte do t'i shtohet edhe një shtet i ri, me emrin KOSOVA! Presidenti tjetër, François Holland drejtpërdrejt u angazhua për pranimin e Kosovës në FRANKOFONI në vitin 2014, një organizatë shumë e rëndësishme sot në botë. Akademik Kullashi, në rrethana dhe kontekste të ndryshme, kishte disa kontakte me këta presidentë.

Prof. Kullashi është autor i më se 20 librave shkencorë dhe i shumë artikujve shkencor-profesionalë, të botuar në revista profesionale-shkencore, kryesisht në botën e jashtme, para së gjithash, nga historia e filozofisë, filozofia politike, etika, sociologjia, politika dhe diplomacia, pastaj autor i problemit të identiteteve, i mendimit politik modern etj. Disa libra shkencorë dhe shumë artikuj i ka botuar edhe në Akademinë tonë nga këto fusha. Më shumë ka botuar në Francë ku ka qenë profesor i filozofisë bashkëkohore frënge më se tri dekada – deri në pensionim.

Duke qenë ende i njomë libri i tij **“Çështja e Kosovës në hapësirën publike të Francës”**, i botuar më 2021, doli libri tjetër në vitin 2022 me titull **“Kosova në fushën e diplomacisë në Francë (2008-2016)”**, të cilin po e përrurojmë sot; librat janë komplementarë dhe janë botim i Seksionit të Shkencave Shoqërore të ASHAK-ut.

Në librin *“Kosova në fushën e diplomacisë në Francë (2008-2016)”* shqyrtohen aktivitetet e Ambasadës së Kosovës në Francë në periudhën 2008-2016 kur akademik Kullashi ishte ambasador i

Kosovës në këtë vend. Këtu analizohet roli i kësaj Ambassade në ndertimin e bashkëpunimit midis autoriteteve të Kosovës dhe të Francës, midis instancave qeveritare të dy vendeve, pastaj në nivelin e Presidencës dhe të Qeverisë, në veçanti pasqyrohen aktivitetet diplomatike në zhvillimin e bashkëpunimit në rrafshin e arsimit, shkencës, kulturës dhe ekonomisë. Trajtohet gjithashtu zhvillimi i bashkëpunimit me *organizatat ndërkombëtare* të vendosura në Francë, si dhe roli i diplomacisë franceze në mbështetjen e komunikimit dhe bashkëpunimit të diplomacisë së Kosovës me organizatat ndërkombëtare në Francë: me Parlamentin Evropian, me Këshillin e Evropës (në Strasbourg), me Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës, me Organizatat ndërkombëtare, si ajo e Frankofonisë (OIF), e OKB-së për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO) etj., sikundër edhe me bashkëpunimin me diplomacinë franceze lidhur me *njohjet* nga shtetet frankofone (në Afrikë e Azi sidomos) dhe shtete të tjera të cilat Franca kishte një ndikim të theksuar politik e ekonomik, por edhe bashkëpunimi me përfaqësitë diplomatike të më se 160 vendeve, nga kontinente të ndryshme, që janë të vendosura në Paris. Ambasadori Kullashi u angazhua shumë për anëtarësimin e Kosovës në UNESCO, ku pati takime me më shumë se 40 ambasadorë, kryesisht të vendeve afrikane, duke ua shpjeguar situatën në Kosovë. Por mungesa e koordinimit të punëve të organeve tona më të larta shtetërore me qeveritë e vendeve votuese, bëri që të dështonim për 3 vota: na duheshin 2/3 e votave, 95 gjithsej, ndërsa ne i morëm 92 vota. 20 vende që e kishin pranuar pavarësinë e Kosovës nuk votuan pro hyrjes së saj në UNESCO.

Në ligjërimet politike e diplomatike në Francë personalitete të shquara e kanë mbështetur pavarësinë e Kosovës edhe në saje të analogjisë me themelimin e BE-së pas Luftës së Dytë Botërore afirmohej angazhimi që të mos rikthehen në Evropë krimet masive ndaj popullsisë civile në emër të ideologjive anakronike e ekstremiste. Në këtë botim trajtohet edhe roli i diplomacisë franceze rreth vendimit të GJND-së për Kosovën më 2010 e njëherësh edhe qëndrimi i diplomacisë franceze ndaj dialogut dhe negociatave midis Kosovës dhe Serbisë në Bruxelles. Në këtë libër analizohen po kështu edhe perceptimet e Kosovës, pas pavarësimit të saj, nga qarqet diplomatike të vendeve të ndryshme me seli në Francë.

Këto shqyrtime dhe analiza kanë parasysh traditën teorike e praktike të diplomacisë në Francë dhe në disa vende të tjera të Evropës, sikundër edhe teoritë dhe praktikat diplomatike në kohën e formimit të sistemit shtetëror evropian dhe të formimit të së drejtës ndërkombëtare,

por edhe refleksionet teorike në analizat për diplomacinë brenda suavezave kulturore dhe socio-profesionale të shekullit XX, me theks të veçantë te negociatat për vendosjen e paqes dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Në libër shqyrtohen edhe *qasjet krahasuese* ndaj kulturës, ligjëritimit dhe teorive e praktikave diplomatike, kryesisht në Francë, sidomos pas themelimit të Bashkësisë Evropiane.

Brenda teorive diplomatike moderne, *praktika* diplomatike merret si shtyllë e sistemit ndërshtetëror, me kulturën e negociimit si pjesë e kulturës politike evropiane. Ndërkaq, dinamika e zhvillimit dhe profesionalizimit të institucioneve diplomatike për udhëheqjen e marrëdhënieve ndërkombëtare do të shpjerë te bashkëpunimi midis sferës politiko-diplomatike dhe asaj akademike e shkencore.

Misioni diplomatik i Kosovës në Paris gjatë vitit 2009 ka përqendruar aktivitetet e veta së paku rreth dy objektivave kryesore: puna me diplomatët, ambasadorët dhe këshilltarët e vendeve që ende nuk e kishin njohur Kosovën si shtet të pavarur dhe dy, puna me institucionet franceze, në radhë të parë, me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Francës – e njohur tradicionalisht si Quai d’Orsay. Z. Kullashi ka shfrytëzuar edhe literaturë relevante lidhur me historinë e diplomacisë franceze dhe të politikës së jashtme të BE-së.

Ambasadori Kullashi ka takuar ambasadorë të vendeve afrikane e latinoamerikane, e në veçanti diplomatë të Afrikës frankofone. Në të njëjtën periudhë ai ka takuar edhe ambasadorë të vendeve të BE-së, SHBA-së dhe vendeve të Azisë, duke kërkuar prej tyre mbështetje për të zgjeruar ndikimin të diplomatët e vendeve që ende nuk e kishin pranuar Kosovën, e njëherësh duke i afirmuar pranë tyre interesat gjeopolitike e ekonomike të vendit tonë dhe objektivat e institucioneve tona shtetërore.

Këto njohuri dhe informata kanë qenë të nevojshme në sajimin e një argumentimi specifik, varësisht nga *përfaqësuesit* e vendeve me të cilat komunikonin, lidhur me pranimin e Kosovës: as sensibiliteti politik i përgjithshëm, as interesat ekonomike e strategjike të këtyre shteteve nuk ishin të njëllajta, e as rezervat që ushqenin ato karshi Kosovës. Marrja në konsideratë e specifikave gjeopolitike të këtyre vendeve ishte e nevojshme që shpjegimet për legjitimitetin e pranimin të pavarësisë së Kosovës të bëheshin më mirë të argumentuara.

Në ceremonitë diplomatike në Presidencën e Francës dhe në disa Ministri, gjatë vitit 2009, përveç me ambasadorë, Kullashi ka pasur rastin të bisedojë për situatën e Kosovës, disa herë, me presidentin N. Sarkozy, me ministrin B. Kouchner, Kryeadministratorin e parë të OKB-së

në Kosovë, pastaj me ministrin e Punëve Evropiane Pierre Lelouch, me ish-ministrin Jack Lang, ish-ministren Catherine Lalumière, me ish-ministren Martine Aubry, me Jacques Delorin, ish-kryetar i Komisionit Evropian, por edhe me ministrin e Punëve të Jashtme të Benin-it, vend ky që ende nuk e kishte njohur Kosovën. Njëherësh ai pati rastin ta takojë Kryetarin e Republikës Dominikane, që rezultoi edhe me njohjen e Kosovës shtet sovran dhe të pavarur më 2009.

Aktiviteti i ambasadorit tonë është përqendruar edhe në kontaktet me personalitete të çmuara të jetës intelektuale e kulturore të Francës, si dhe në tubimet ndërkombëtare lidhur me perspektivën evropiane, p.sh. në institucionin prestigjioz *Maison de l'Europe de Paris* etj. Në këtë drejtim kanë shkuar edhe intervistat e tij si ambasador për kanale të ndryshme të radiove e televizioneve, si *France inter*, *France culture*, RFI, radio Vatikani frëngjisht etj. dhe për disa gazeta, sikurse *Le Parisien*, *Le Monde*, *La Libération*, *Le Figaro*, *La Croix* etj. Prania e profesor Kullashit në mediet e mëdha franceze që nga viti 1991 ishte vërejtur edhe nga diplomatët francezë në nivele të ndryshme. Gjithnjë i ka evituar rrëfimet propagandistike, i bindur se ato nuk prodhojnë besueshmëri e aq më pak ndikim dhe respekt për pohimet publike lidhur me vendin të cilin e përfaqësonte.

Në vitin 2009, krahas aktiviteteve të rregullta diplomatike, misioni diplomatik i Kosovës do të organizojë tri konferenca: *e para* trajtoi investimet ekonomike të ndërmarrjeve franceze në Kosovë; *e dyta* zhvilloi analizën retrospektive të ngjarjes së dëbimit të 900.000 kosovarëve (me rastin e 10 -vjetorit), kurse *e treta* ishte Java e Kulturës Kosovare në Paris. Këto tri manifestime që u përkisnin tri fushave të ndryshme (ekonomi, politikë dhe kulturë) do të shoqërohen me aktivitetin e rregullt diplomatik karshi korit diplomatik ndërkombëtar në Paris, si dhe me përpjekjet për krijimin e lidhjeve midis Ministrive të Francës dhe Ministrive të Kosovës, por edhe me krijimin e lidhjeve midis parlamenteve të dy vendeve. Ky mision mundësoi veç të tjerash edhe lidhjen e konventave dypalëshe midis Kosovës dhe Francës.

Ambasadori Kullashi e bën edhe një analizë të tekstit prej 70 faqesh të delegacionit të ekspertëve francezë pranë GJND-së lidhur me çështjen që shtroi Serbia se a është *Deklarata e Pavarësisë së Kosovës në pajtim me të drejtën ndërkombëtare?* Ekspertët juridikë francezë, siç bën të ditur autori, në analizën e tyre fuqizojnë pavarësinë e Kosovës edhe me faktin e abstenimit të organizatave të mëdha ndërkombëtare që ta dënojnë apo t'i bëjnë vërejtje Deklaratës për pavarësi të Kosovës. Ata ekspertë saktësojnë se në veçanti abstenimi i organeve të OKB-së është

“shumë domethënës” meqë ato kishin autorizime të veçanta që i takonin Këshillit të Sigurimit dhe UNMIK-ut. Domethënia ka të bëjë me faktin se ato organe nuk kishin konstatuar asnjë cenim të parimeve që buronin nga rezoluta 1244 (e vitit 1999), konkretisht me adoptimin e Deklaratës së Pavarësisë në Kuvendin e Kosovës.

Duke marrë parasysh analizat paraprake, juristët francezë theksonin se “nuk është fare e befasishme që Këshilli i Sigurimit, sikurse edhe Sekretari i Përgjithshëm i UNMIK-ut, e po ashtu edhe Asambleja e Përgjithshme, si dhe BE-ja, të kenë abstenuar që të formulonin edhe vërejtjet më të vogla të Deklaratës.” Mungesa e çfarëdo vërejtje apo dënimi i Deklaratës së Pavarësisë nga ndonjëri nga organet e OKB-së e konfirmon konstatimin e mëparshëm se ato qartazi nuk e kanë parë atë si diçka që nënkupton një *shkelje* të së drejtës ndërkombëtare apo si diçka që vë në rrezik paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Një pjesë e rëndësishme e aktivitetit diplomatiko-politik ka qenë e përqendruar te *mënyra e trajtimit të çështjes së monumenteve të kulturës kosovare*, në veçanti të kishave ortodokse, në UNESCO. Në saje të ndihmës së ambasadorëve të disa vendeve mike në UNESCO, ambasadori Kullashi nga viti 2011 do ta takojë gjatë pesë vjetëve ambasadorët e Komisionit për Trashëgiminë e Kulturës në UNESCO dhe ambasadorët e tjerë të akredituar në UNESCO, zyrtarë të lartë të këtij institucioni, si dhe zyrtarë të MPJ-së së Francës. Qëllimi i këtyre takimeve ishte kundërvënia ndaj propagandës së disa delegacioneve në UNESCO lidhur me çështjen e monumenteve të kulturës së Kosovës: në veçanti lidhur me manipulimet historiko-politike për këto monumente dhe me propagandën për kinse “rrezikimin e tyre” në Kosovë, propagandë kjo që kishte për qëllim të ofrojë një imazh të shtrembëruar për Kosovën dhe institucionet e saj.

Nga organizatat ndërkombëtare me seli në Paris në të cilat Kosova do të anëtarësohet, më e rëndësishmja është Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë (OIF), në përbërjen e së cilës janë afro 90 shtete. Me këtë anëtarësim Kosova shënoi një arritje shumë të rëndësishme në rrafshin e bashkëpunimit ndërkombëtar, aq më tepër se OIF është pjesë e OKB-së dhe ka një ulëse në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Fakti që anëtarësimin e Kosovës e kanë mbështetur edhe 21 vende të OIF-it që ende nuk e kishin njohur Kosovën, doemos do të reflektohej pozitivisht në përafrimin e Kosovës me këto vende, ngase *brenda strukturave dhe OIF-it do të ketë veprimtari të përbashkëta* në shumë fusha. Në anën tjetër, takimet ministrore të vendeve anëtare për çdo vit, takimet e shefave të shteteve dhe qeverive çdo dy vjet të 80 shteteve (23 prej të

cilave kanë status vëzhguesi), krijuan një hapësirë të bashkëpunimit të përqendruar jo vetëm me vendet që nuk e kanë njohur Kosovën, por edhe me shumicën e madhe që tanimë e kishin njohur Kosovën.

Misioni diplomatik i Kosovës në Francë ka arritur edhe një numër të konsiderueshëm të njohjeve dhe vendosjes së marrëdhënieve diplomatike, veç tjerash me Gabonin, Beninin, Republikën Dominikane, Çadin, Xhibutin dhe Afrikën Qendrore. Kullashi ka ushtruar njëherësh funksionin e ambasadorit-jorezident në Portugali, Andorë dhe Monako. Së këndejmi, në libër janë analizuar format konkrete të ndërtimit të marrëdhënieve të Kosovës me rrjetet diplomatike jo vetëm me disa vende evropiane, por edhe me ato të Afrikës, Azisë dhe Amerikës Latine.

Prania aktive e misionit tonë diplomatik në Paris ka gjetur shprehje edhe në pjesëmarrjen e ambasadorit tonë gjatë tetë vjetëve, në konferenca të rëndësishme politiko-diplomatike ndërkombëtare që janë zhvilluar në kryeqendrën e Francës. Pjesëmarrja në këto konferenca ndihmonte afirmimin e legjitimitetit të shtetit të ri të Kosovës e njëherësh edhe formësimin e relacioneve me aktorë të ndryshëm politikë e diplomatikë jo vetëm të Francës, por edhe të vendeve të tjera që merrnin pjesë aty.

Dihet se diplomacia artikulon relacionet që mbajnë shtetet midis tyre, duke u dhënë kuptim raporteve të tyre, e njëherësh synimeve dhe strategjive të tyre në krijimin dhe mbajtjen e aleancave. E këto gërshetohen edhe me interesat e tyre ekonomike dhe me ato të sigurisë. Ky aspekt është i rëndësishëm edhe për Kosovën si shtet i cili doli nga lufta, duke u mbështetur nga fuqitë perëndimore. Kjo mbështetje për çlirimin e saj nga sundimi i Serbisë u bë pastaj bazë politike për *ndërtimin e aleancave* me këto shtete. Kësodore, në hapësirat e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës janë mbajtur disa herë konferenca të ambasadorëve të Evropës Qendrore e Lindore dhe të Ballkanit. Në anën tjetër, në institucionin prestigjioz “Maison de l’Europe de Paris” janë mbajtur disa konferenca për Kosovën dhe orientimin e saj proevropian. Këto çështje të rëndësishme për të sotmen dhe të ardhmen e Kosovës janë trajtuar bashkë me një publik me nivel të lartë politiko-diplomatik dhe shkencor.

Në përmbyllje mund të konkludojmë se bëhet fjalë për një botim të veçantë, që paraqet një dëshmi se si kanë frymuar marrëdhëniet franko-kosovare dhe si mund të frymojnë në të ardhmen. Botimi është realizuar brenda një kornizë metodologjike adekuate për natyrën e rrëfimeve të këtilla, i begatë me të dhëna e fakte relevante dhe paraqet

një referencë të rëndësishme për çështjet që shqyrtohen, aq më tepër që autori ishte drejtpërdrejtë i angazhuar në prezantimin dhe përhapjen e të vërtetës për Kosovën, tok me intelektualët, shkencëtarët dhe diplomatët më në zë të Parisit.

Në raste të ndryshme, qoftë në Francë, qoftë në Kosovë pas luftës, kur i falënderoja kolegët francezë, kryesisht studiuesit e Ballkanit, për angazhimin e tyre për Kosovën -, të gjithë njëzëri thoshin jo - duhet ta falënderoni ambasadorin dhe profesorin e filozofisë në Universitetin e Parisit 8, Muhamedin Kullashin – meritë e tij është ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës dhe përhapja e të vërtetës për Kosovën në shtetin dhe shoqërinë franceze.

Shpresojmë që rrugën e ambasadorit Kullashi, do ta ndjekin edhe ambasadorët tjerë, që kanë shërbyer në vende të ndryshme.

Hivzi Islami

STUDIME SHOQËRORE

11

2024

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Bahri Koskoviku

Redaktor teknik:

ASHAK

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia: 24 tabakë shtypi

Tirazhi: 200 copë

Formati: 16x24 cm

Shtypi:

Focus Print

Shkup

